RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

(Auditim Financiar dhe Përputhshmërie)

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

TETOR 2021

Nr Përmbajta Faqe

Përmbajtja

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....3-4
2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....4-39
3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....40-43

II.HYRJA
a) Objektivat dhe qëllimi. 48
b) Identifikimi i çështjes.....48
c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 48
d) Përgjegjësitë e audituesve.....48
e) Kriteret e vlerësimit.....49
f) Standardet e auditimit.....49
g) Metodat e auditimit.....49
h) Dokumentimi i auditimit.....49-52

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT
1.Informacion i përgjithshëm.....52
3.1.Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....50
3.2. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.....53-84
3.3. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.....84-91
3.4. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.....91-125
3.5. Auditimi i llogarive vjetore të administratës së institucionit.....125-158
3.6. Prokurimet e fondeve publike.....159-268
3.7. Mbi realizimin dhe monitorimin për Kontratën e Partneritetit Publik Privat ñPër ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore..... 267-308
3.8. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.....308-312
3.9. Vlerësimi i Auditimit të Brendshëm.....312-318
3.10.Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.....

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....319-347

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe funksionimin e KLSHò, në zbatim të Programit të Auditimit nr.359/1, datë 24.04.2020 dhe Programit të ri-Auditimit nr. 121/1 prot, datë 22.01.2021, i ndryshuar me shkresat nr.121/2 prot., datë 16.03.2021, nr.121/3 prot., datë 18.03.2021, nr.121/4 prot., datë 20.04.2021 dhe nr.121/5 prot., datë 30.04.2021, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale (MSHMS), nga data 25.01.2021 deri në 21.05.2021, u krye auditimi Financiar dhe Përputhshmërie, për periudhën e auditimit 01.01.2019 deri në 30.03.2021.
Grupi i auditimit, u mbështet në përputhshmërinë e aktivitetit të MSHMS, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, proceduratpër qarkullim e dokumentacionit,proçedurat e realizuara për përballimin e Covid-19, proçedurat eprokurimeve duke filluar nga buxhetimi i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat përpagesat dhe auditimin e brendshëm.
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta, në përputhje me legjislacionin përkatës,në përmbushje të misionit të saj ka për qëllim:

- Zhvillimin dhe monitorimin e politikave, të legjislacionit, të programeve e të veprimtarive që lidhen me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe treguesit shëndetësorë të popullatës;
-Zhvillimin e politikave që synojnë mbrojtjen, promovimin, integrimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies sociale të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë;
- Zhvillimin e politikave për adresimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore, të abuzimit ndaj fëmijëve, grave dhe grupeve të tjera;
- Zhvillimin e politikave dhe të modeleve për ndihmën e shërbimet shoqërore alternative për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike etj.

Gjithashtu, MSHMS e ndodhur në kushtet e një epidemie kombëtare dhe nevojave emergjente që kanë lindur për sigurimin e barnave, materialeve mjekesore, pajisjeve mjekesore, shërbime të ndryshme në pavionet e spitaleve me qëllim përshtatjen për trajtimin e të prekurve me Covid-19 të ndodhur në rrethanat e interesave thelbësore të shtetit ka përdorur VKM nr 203, datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit ò i ndryshuar meVKM nr.242 datë 22.03.2020 ñPër disa shtesa në VKM nr.203 datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësore të shtetitò, janë miratuar me qëllimin për ofrimin blerje/shërbime më të shpejta në kohë, duke krijuar garanci të proporcionalitetit në përputhje më Aktin Normativ të Qeverisë nr.243 datë 24.03.2020 ñPër shpalljen e gjendjes së Fatkeqësisë natyrore dhe Pandemia Botërore shpallur nga OBSHò.
Komiteti i Përkohshëm për Infeksionin e përhapur nga Koronavirusi (Komiteti Teknik) i ngritur

me Urdhër nr.53 datë 31.01.2020, i ndryshuar në kuadër të marrjes së masave në vazhdimësi të vlerësimit të situatës së epidemisë në Republikën e Shqipërisë, me qëllim parandalimin dhe luftimin e infeksionit të përhapur nga COVID-19, ka vlerësuar si të domosdoshme marrjen e një sërë masash për përmbushjen e nevojave me mallra dhe shërbime për të fuqizuar dhe garantuar ofrimin e shërbimit në strukturat shëndetësore spitalore publike konkretisht në QSUNT për Spitalin Covid-1 dhe me pas në QSSHN për Spitalin Covid-2. Më pas nga spitalet përkatëse janë reflektuar nevojat në bazë të kapaciteteve të shtretërve dhe të stafit të shërbimit mjekesor, për përballimin e situatës së krijuar.
Gjithë misioni zhvillohet nëpërmjet financimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit.
Rëndësia e këtij auditimi është vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë , në çdo aspect material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synimin e mirëpërdorimit të fondeve publike.

2.Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Nga auditimi rezultoi se, fondet prej **16,751,138 lekë** akorduar për përballimin e situatës së krijuar nga Covid -19, kanë ndryshuar destinacionin, dhe janë angazhuar për të shlyer detyrime që kanë rrjedhur nga kontrata ose projekte të nisura më parë, nga të cilat: ***15,791,138 lekë*** alokuar për të shlyer detyrime që kanë rrjedhur nga kontrata të mëparshme; dhe ***960,000 lekë*** alokuar për blerje pajisje kompjuterike të planifikuar që në PBA 2020-2022 (përpara situatës së pandemisë), konkretisht: *a)* Nga analiza e buxhetit të akorduar për përballimin e fatkeqësisë natyrore konstatohet se, me anë të shkresës nr. 3871, datë 20.08.2020 drejtuar MFE-së, S.P i MSHMS-së ka kërkuar transferimin e fondeve për investime në shëndetësi, sipas të cilës është kërkuar pakësimi i fondeve të parashikuara për projektet: - ñRehabilitimi i shërbimit të Urologjisë dhe Klinikës së Tretë Kirurgjikale për kthimin e tyre në Konvaleshencës dhe Terapi Intensive në QSUTò në vlerë totale të tij 13,717,119 lekë; dhe - ñTVSH për projektin për furnizimin me pajisje mjekësore te specializuara per mbrojtje/trajtim te covid-19, ne kuadër te marrëveshjes grant te BE ku përfituesi është MSHMSò në vlerën 2,074,019 lekë. Këto fonde u përdorën për projektet: - ñRikonstruksione në disa	53-84	**I LARTË**	**1.**Titullari i MSHMS të marrë masa për të ngritur një grupi të veçantë pune për të analizuar shkaqet dhe nxjerrë përgjegjësitë për ndryshimin e destinacionit të 16,751,138 lekë fonde Covid dhe në vijim, cka ka shkaktuar mospërdorimin e tyre për qëllimin për të cilin janë akorduar, përballimin e situatës së shkaktuar nga Covid-19. **2.** MSHMS, të marrë masat e nevojshme që në asnjë rast në vijim, mos të ndryshojë destinacioni i fondeve, për të siguruar kështu që fondet e saj të përdoren në funksion të qëllimit për të cilin janë akorduar, në përmbushje të nevojave të institucionit.

	ambiente të godinës MSHMSò (detyrim i vitit 2019) në vlerën **9,194,988 lekë,** - ñSupervizim dhe kolaudim për rikonstruksionet e disa godinave të MSHMSò (detyrim i vitit 2019) në vlerën **96,150 lekë,** - ñHartim i projekt preventivit të zbatimit për ndërtimin e Qendrës së re të Biosimulimit Klinik dhe edukimit në vazhdim për Universitetin e Mjekësisë tiranë në kuadër të paktit të Universitetitò (detyrim i vitit 2019) **6,500,000 lekë.** *b)* Me anë të shkresës nr. 2818, datë 15.06.2020, S.P i MSHMS i ka drejtuar MFE-së kërkesën për rialokimin e fondeve covid, duke pakësuar projektet: - *19AD302 F.V monitorë për spitalet* në vlerën 36,727,000 lekë; - *19AD306 Blerje autoambulancash për spitalet* në vlerën 60,000,000 lekë dhe - *19AD315 F.V pajisje mjekësore për covid 19* ne vlerën e plotë të këtij projekti 259,741,888 lekë dhe Këto fonde u alokuar në projektet: - 19AD317 F.*V pajisje mjekësore CT Skaner* 172,935,000 lekë; - 19AD318 *F.V pajisje mjekësore Rezonance magnetike MRI* 167,573,888 lekë; - *19AD316 Pagese TVSH për pajisjet e furnizuara donacion nga PNUDI ne kuadër te Covid-19* 15,000,000 lekë, dhe - ***18BA301** F.V pajisje elektronike ne kuadër te COVID-19***, 960,000 lekë.** Nëse do të referoheshim PBA 2020-2022, projekti 18BA301 ka qenë planifikuar më herët për tu realizuar në vitin 2020, pra përpara se të ndodhte pandemia Covid-19. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 7-42 të Projekt Raportit të Auditimit).*			
2	Nga auditimi, **në vitin 2019** nga MSHMS janë njohur detyrime të prapambetura në vlerën **49,700,000 lekë** me burim krijimi ñvendime gjyqësore për largime te padrejta nga punaò. Nga verifikimi i grupit të auditimit rezulton se, faktikisht vlera e detyrimeve te prapambetura në fund të	91-125	**I LARTË**	**1.**MSHMS të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar raportimin në MFE, Thesar dhe në vijim në pasqyrat financare të MSHMS, të detyrimeve të prapambetura dhe shlyerjen e tyre, në mënyrë të plotë, të saktë,

	vitin 2019 ishte të paktën 69,063,781 lekë[1], ose *19,363,781 lekë* (39%) më shumë se detyrimi i raportuar në MFE për këtë vit. Gjithashtu rezultoi se, detyrimi i prapambetur në vlerën 69,063,781 lekë ishte jo vetëm për vendime gjyqësore për largime të padrejta nga puna, **por** edhe për vendime të tjera gjyqësore, më hollësisht: - 34,712,371 lekë, detyrime për largime të padrejta nga puna; - 24,471,250 lekë detyrim i lindur nga 1 çështje gjyqësore e Spitalit Gjirokastër; dhe - 9,880,160 lekë detyrim i lindur nga vendime gjyqësore për mospagim në kohë të faturave ndaj kreditorëve nga ish-MMRS. Për vitin 2020, në raportimin për Thesarin, si dhe në Pasqyrat Financiare të MSHMS, janë njohur detyrime të prapambetura vetëm për largime të padrejta nga puna në vlerën 27,150,000 lekë. Nga auditimi rezultoi se, në fakt detyrimi i prapambetur për këtë vit ishte të paktën 33,878,384 lekë[2], ose *6,728,384 lekë* (20%) më shumë detyrime se ato të njohura në Pasqyrat Financiare të MSHMS dhe të raportuara në MFE. Nga auditimi u konstatua se, databaza e mbajtur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Mirëmenaxhimit Financiar në zbatim të pikës 4 të Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014, vënë në dispozicion grupi të auditimit**, nuk** përmban shumën e plotë të detyrimeve për largimet nga puna, pasi në të nuk janë reflektuar detyrimet e parashikuara nga vendimet e formës së prerë të viteve 2011 dhe 2013 për **dy** gjyqfitues, znj. S.L, dhe z. N. Z. Në këto kushte, grupi i auditimit nuk ka mundur të përllogarisë detyrimin e prapambetur për këta 2 tatimpagues. **Për vitin 2020**, pagesat e kryera për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të cilat rrjedhin nga vendimet gjyqësore, nuk janë kryer **vetëm** për vendime gjyqësore për largime nga puna sikurse është raportuar në MFE, por edhe për vendim të			të vërtetë dhe sipas formateve të diktuara nga Udhëzimet e MFE-së, me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, të cilat mund të shkaktojnë efekte negative në buxhetin e shtetit **2.** DBMF në MSHMS të ndërmarrë masat e nevojshme për paraqitjen e plotë dhe të saktë të gjyqfituesve të larguar në mënyrë të padrejta nga puna, si dhe detyrimet ndaj tyre në bazën e të dhënave që kjo drejtori administron për këtë qëllim.

[1] Themi se ñdetyrimi ishte të **paktën** 69,063,781 lekëò pasi në këtë vlerë nuk janë përfshirë detyrimet e rrjedha nga vendimet e formës së prere të viteve 2011, 2013 për dy gjyqfitues të larguar padrejtësisht nga puna zj. S.L, dhe z. N. Z, të cilat nuk ishin reflektuar në data bazën e detyrimeve të DBMF, dhe grupi i auditimit nuk mundi të përllogariste detyrimet e tyre.

[2] Themi se ñdetyrimi ishte të **paktën** 33,878,384 lekëò pasi në këtë vlerë nuk janë përfshirë detyrimet e rrjedha nga vendimet e formës së prere të viteve 2011, 2013 për dy gjyqfitues të larguar padrejtësisht nga puna zj. S. L, dhe z. N. Z, të cilat nuk ishin reflektuar në data bazën e detyrimeve të DBMF, dhe grupi i auditimit nuk mundi të përllogariste detyrimet e tyre.

	tjera gjyqësore. MSHMS ka raportuar në MFE detyrime të prapambetura të shlyera në vlerë **9,224,000 lekë,** me burim krijimi vendime gjyqësore për largime të padrejta nga puna. Nga auditimi rezultoi se, detyrimet realisht të shlyera janë në vlerën **42,486,262 lekë**, ose 33,262,262 lekë (360%) më shumë se ato të raportuara si të shlyera në MFE dhe **jo** vetëm për vendime gjyqësore për largime të padrejta nga puna, **por** edhe për vendime të tjera gjyqësore, si p.sh. vendim gjyqësor i Spitalit Gjirokastër, apo vendime gjyqësore për fatura të papaguara nga ish-MMRS **Gjithashtu nga auditimi,** për vitin 2019**, 2** nga **4 r**aportimet (50% të rasteve) e detyrimeve të prapambetura gjatë këtij viti **nuk** janë bërë sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimi plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 ñPër për zbatimin e buxhetit viti 2019. Në kundërshtim me këtë udhëzim, detyrimet e prapambetura **nuk** janë raportuar në MFE, në mënyrë analitike sipas kreditorëve dhe sipas burimit të krijimit të tyre. Nga analizimi i raportimeve tre-mujore për vitin 2020 konstatohet se, detyrimet e prapambetura për largimet e padrejta nga puna për aparatin e MSHMS, **nuk** janë raportuar në formatin e duhur (Udhëzimi nr. 2, datë 20.01.2020 dhe Udhëzimi nr. 37, datë 06.10.2020) në MFE, apo në Thesar, në **asnjë** prej raportimeve të këtij viti. Në kundërshtim me këto udhëzim, detyrimet e prapambetura **nuk** janë raportuar në mënyrë analitike sipas kreditorëve dhe sipas burimit të krijimit të tyre. Kjo situatë **nuk** siguron transparencë mbi detyrimet e prapambetura, burimin e krijimit, si dhe shlyerjen e tyre . Sa më sipër, nuk ka rezultuar në vlerësimin e detyrime të papaguara dhe raportimin e tyre në mënyrë të saktë dhe të plotë, sikurse përcaktohet në VKM nr.50, datë 05.02.2014 ñPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimitò, të ndryshuar.			
3	Këshilli i Ministrave në kushtet e emergjencës prej pandemisë Covid-19, gjatë periudhës marsï prill 2020 për parandalimin e saj ka nxjerrë disa akte nën ligjore ndër to edhe VKM nr 203, datë 26.02.2020 ñ*Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit*ò. Sipas kësaj VKM, çdo kontratë që do të lidhen në	164-185	I LARTË	**1.**Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masat për të propozuar ndryshimet e nevojshme në VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetitò: **2.**Në mënyrë që kjo VKM tô

	zbatim të saj do të miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Mirëpo konstatohet se përmbajtja e kësaj VKM, nuk i ka shërbyer situatave emergjente për lehtësimin dhe eliminimin e kësaj fatkeqësie natyrore, pasi përmbajtja e saj ka krijuar disa hapësira në lidhje me, zgjatjen e afateve kohore të furnizimit të medikamente, materiale mjekësor apo shërbimeve shëndetësorë, me llogaritjet në mënyrë apriori apo subjektive të vlerave të këtyre kontratave; me mënyrën subjektive dhe klienteliste të përzgjedhjes së operatorëve furnizues; me formalizma për monitorimin e zbatimit të kontratave, etj. Kështu në zbatim të kësaj VKM, autoriteti kontraktor (MSHMS) gjatë periudhës së pandemisë ka realizuar 7 (shtatë) procedura prokurimi, nga auditimi i të cilave u konstatuan disa anomali në lidhje me furnizimin dhe shërbimet emergjente të diktuara nga pandemia, si më poshtë: **(I)** Sipas VKM nr 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar pika VII (Miratimi i Kontratës), kontrata hyn në fuqi pas miratimi të VKM respektive dhe në rast se kontrata nuk miratohet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga Këshilli i Ministrave, atëherë procedura do të quhet e anuluar. Nga auditimi u konstatua se, kontratat janë miratuar, duke filluar nga 7 ditë deri në 10 dhjetë ditë më vonë nga data e lidhjes së kontratës duke bërë që të çedojë *"faktori kohë*ò, në kushtet e emergjencës prej pandemisë Covid 19. Për sa më sipër, u konstatua, miratimi me VKM-të respektive: **1**-Procedura ñBlerje Barna Anti Covid -19ò ndarë në 10 Lote, me fond limit total 36,812,915 lekë. Loti 5-Oseltamivir(Tamiflu) është lidhur kontrata me nr.1573/28, datë 06.04.2020, miratuar VKM nr.314, datë 18.04.2020 (12 ditë më vonë) Loti 8-Omeprazol është lidhur kontrata me nr.1573/31, datë 07.04.2020, miratuar me VKM nr.313, datë 18.04.2020 (11 ditë më vonë). Loti 9-Propofol, është lidhur kontrata me nr.1573/30, datë 06.04.2020, miratuar me VKM nr.320, datë 18.04.2020 (12 ditë më vonë). Loti10-Beclomethasone+salbutamol është lidhur kontrata me nr.1573/32 datë 07.04.2020, miratuar me VKM nr.315, datë 18.04.2020 (11 ditë më vonë). **2**-Procedura ñFurnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19ò me			shërbejë situatave emrgjente për kontrata që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit, në të duhet që afatet e parashikuara për miratimin e kontratave nga KM, të jenë në proporcion me emergjencën e situatës dhe jo ndryshe. **3.**Në VKM duhet të përcaktohet qartë mënyra e përllogaritjes së fondit limit dhe ku duhet të mbështetet autoriteti kontraktor për llogaritjen e tij, si psh: *çmimet e botuara nga INSTAT, çmimet e tregut, çmimet e kontratave të ngjashme, çmimet ndërkombëtare ,....etj..* **4.**Në VKM të parashikohen rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave si një element i rëndësishëm i kontrollit të mirëmenaxhimit të fondeve publike, për qëllimet e parashikuara në këtë VKM. **5.** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si ministria përgjegjëse të marrë masa që në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, nisur nga teknika legjislative, të rishikojë bazën ligjore të përdorur për nxjerrjen e këtij vendimi, me qëllim përcaktimin e dispozitave që, në kuptimin e nenit 118 të Kushtetutës, autorizojnë nxjerrjen e këtij akti nënligjor nga Këshilli i Ministrave, çështjet që duhen rregulluar si dhe parimet në bazë të të cilave nxirret ky akt. Në VKM të përcaktohet përkufizimi i gjendjes, rrethanave, apo rasteve kur kemi të bëjmë me ñ*interesa thelbësorë të shtetit*ò duke mos i lënë këto rrethana në vlerësim të autoriteteve kontraktore. Përkufizimi ñ*interesa thelbësorë të shtetit*ò duhet të përjashtojë situatat për furnizime në situata emergjencash dhe fatkeqësish, të cilat gjykojmë se Ligji nr. 9643/2016 ñ*Për prokurimin publik*ò i ka të rregulluar me nenin 33 ñ*Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit*ò mjaftueshëm për të garantuar kontraktime dhe prokurime të shpejta, eficente, inteligjente dhe

	fond limit 129,727,371 lekë pa tvsh. Është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1365/36 datë 27.03.2020, miratuar me VKM nr.274, datë 03.04.2020 (7 ditë më vonë). **3**-Procedura ñBlerje Materiale Për Mbrojtje Personale Për Covid -19ò me fond limit prej 307,844,333lekë pa tvsh. Është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1366/18, datë 18.03.2020, miratuar me VKM nr.241 datë 21.03.2020 (11 ditë më vonë). **4**-Procedura ñBlerje kite dhe reagent dhe evadim mbetje anti COVID-19ò, ndarë me 2 Lote. -Loti I ñBlerje kite dhe reagentë për Laboratorin Mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tôu përdorur për pajisjen e Existation të firmës Bioner ose ekuivalentò, është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1574/13, datë 30.03.2020, miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020. -Loti II ñTrajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19, është lidhur kontrata me nr.1574/12, datë 30.03.2020 , miratuar me VKM nr.273, datë 03.04.2020. **5**-Procedura ñFurnizim me produkte letre një përdorimëshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjenike për pacientët me Covid-19 dhe personelin mjekësor”. Është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1575/18, datë 07.04.2020, miratuar me VKM nr.323 datë 18.04.2020. **6**-Procedura ñSpostimi i sistemit të dializës nga Pediatria e Specialiteteve tek godina e Spitalit Infektiv (Shërbimi i Alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me Covid-19ò është lidhur kontrata nr.1575/19, datë 07.04.2020 , miratuar me VKM nr.323 datë 18.04.2020. **7**-Procedura ñBlerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò e ndarë në 4 Lote -Loti I ñBlerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò është lidhur kontrata me			proporcionale me interesat thelbësore të shtetit dhe përputhen me Aktin Normativ të Qeverisë Për Shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore dhe Pandemia Botërore shpallur nga OBSH. **6.** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si ministria përgjegjëse të marrë masa që të propozojë vendosjen e një pike të veçantë 13/1, në të cilën të parashikohet përfshirja e të drejtës së ankimimit në procedurën e drejtëpërdrejtë; gjithashtu në përputhje edhe me parashikimet të Kodit të Procedurës Administrative neni 129, për të shmangur çdo paqartësi gjatë zbatimit të vendimit, të parashikohet e drejta e ankimit të drejtëpërdrejtë në gjykatën kompetente.

	nr.1776/11 datë 14.04.2020 , miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020. -Loti i II ñBlerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò, është lidhur kontrata me nr.1776/13, datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.316, datë 18.04.2020. Loti i III ñBlerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò, është lidhur kontrata me nr.1776/12, datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.317, datë 18.04.2020. Pra, sipas VKM-së 203 për (Procedurën e drejtëpërdrejtë), nëse nuk miratohen për 90 ditë, kontratat duke të anullohen, duke lënë hapësirë që Këshilli i Ministrave, mund tõ miratojë kur të mundet brenda 90 ditëve, afat i cili nuk është proporcional me kushtet e emerjencës, si pasojë e Covid-19. **(II)** VKM nr 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar, pika IV-2 ñProcedura e drejtëpërdrejtëò dhe pika V, **nuk** ka të përcaktuar; mënyrën e përllogaritjes së fondit limit dhe ku duhet mbështetur ky fond si, çmimet e botuara nga INSTAT, çmimet e tregut, çmimet ndërkombëtare, çmimet e kontratave të ngjashme, etj; natyrën e vendosjes së kritereve dhe mënyrën e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të ftuar nga AK. Si pasojë e mungesës së sa më sipër, MSHMS, disa herë ka kërkuar edhe asistencë nëpërmjet kërkesave on-line në Agjencisë e Prokurimit Publik, e cila me arsyetimin shprehet se, në bazë të nenit 6 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimit publikò i ndryshuar, *"Ky ligj nuk zbatohet në përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike, në rast se zbatimi i tyre kërkon masa të veçanta sigurie, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi ose në rast se një gjë e tillë diktohet nga interesat thelbësore të shtetit,* për rrjedhojë nuk është shprehur në asnjë rast të kërkuar, për asistencë për VKM nr 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar. Si pasojë e mospërcaktimeve të mësipërme, kanë dështuar disa procedura, si vijon:			

	a-Nga auditimi i procedurës *"Blerje Barna Anti Covid -19" ndarë në 10 Lote* , me fond limit total 36,812,915 lekë, konkretisht *Loti 1* me objekt ñ *Blerje barna Hidroksichlorokinë 200 mg tableta"* me fond limt në vlerën prej 457,385.00 lekë dhe *Loti 4* me objekt ñ*Blerje barna Lopinavir/ritonavir*ò me fond limit në vlerën prej 179,458.00 lekë, kanë dështuar me argumentimin për shkak të mos pjesëmarrjes së OE. Nga auditimi u konstatua se, me shkresë nr.1573/3 prot datë 29.03.2020 të MSHMS, Komisioni i Vlerësimit, i është drejtuar operatorëve ekonomikë, ñR Pò shpk, ñIò shpk, ñEò shpk, ñL Pòshpk dhe ñD Pò shpk, për testim tregu për 11 barnat, por nga auditimi u konstatua se, jo për të gjithë barnat ka pasur oferta çmimesh të argumentuar qartësisht, ndonëse KV shprehet se ñ*Komisioni për nxjerrjen e fondit limit u mbështet në mesatarizimin e çmimeve dhe ka përcaktuar si fond limit pa tvsh vlerën prej 36,812,915 lekë*...ò më konkretisht: -Në këtë procedurë ishte planifikuar të realizohej dhe blerja për barin Remdesivir, por OE të përzgjedhur nga MSHMS, nuk kanë kthyer përgjigje, për pasojë Remdesivir nuk është futur në procedurë, ndonëse sipas OBSH, Remdesivir është pjesë e trajtimit të Covid-19 si dhe nga auditimi u konstatua se, bari Remdesivir (sasia 980 Flakon/Ampula) në momentin e hartimit të dokumentave të procedurës nuk ishte i regjistruar dhe asnjë OE nuk ishte i pajisur me leje importi nga MSHMS. -Gjithashtu sipas procesverbalit nr.1573/4, datë 29.03.2020 për barnat: Hidroksichlorokinë, Chlorochine phosphate, Ribavirin, Lopinavir/ritonavir, nga auditimi, u konstatua se ishin pa status rregjistrimi nga MSHMS; si dhe operatorët ekonomikë të përzgjedhur nga KV, në momentin e përllogaritjes së fondit limit nuk kishin leje importi për këto barna, për rrjedhojë nga ana e KV nuk del e qartë se cilave çmimeve u janë referuar për përllogaritjen e fondit limit. Kështu, nga KV është cituar për barin, Hidroksichlorokinë është e pajisur me leje importi për 2020 sipas PV nr.1573/5 datë 29.03.2020, por nga auditimi i Autorizimeve Importi për barnat të paregjistruara, për vitin 2020 lëshuar nga MSHMS, u konstatua se për barin Hidroksichlorokinë, Autorizimi nr.55 është marrë më datë 03.07.2020, pra katër muaj më pas. Ndërsa për barin Lopinavir/ritonavir, KLSH, iu referua			

	Autorizimeve Importi për barnat të paregjistruara, për vitin 2019 lëshuar nga MSHMS për QSUNT me nr.80 datë 26.08.2019, forma/doza paketimi 200mg/50 mg Box x120 dhe Box x 30, ndërsa për procedurën është kërkuar Shurup 60 ml/8-mg +20 mg, të cilat nuk përkojnë me të njëjtin çmim. Pra, për këto dy raste nuk del e qartë përllogaritja e fondit limit nga KV. **b-** Nga auditimi i procedurës për Loti II me objekt ñ*Trajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19*ò, me fond limit në vlerën prej 3,144,150 lekë pa tvsh, KV për përllogaritjen e fondit limit është bazuar në vlerësimin e bërë nga QSUT sipas shkresës nr.1387/4 prot datë 17.03.2020, me periudhë shërbimi për 3 muaj. Nga auditimi u konstatua se, në përllogaritjen e fondit limit për mbetjet ku përfshihen: veshje një përdorimshe, mbetje konsumi ushqimi, age, ampula, shishe serumi qelq/plastike, sistem perfuzioni, etj, është përllogaritur në vlerë prej **510 lekë pa tvsh**, vlerë e cila **nuk** është e kostuar duke u ndarë në elementë si: shpenzime transporti, trajtimi/Incenerimi, ambalazhim & materiale, punëtoria, landfilli, kosto operative, etj. KLSH, kryqëzoi të dhënat me punën e grupit të auditimit të KLSH-së paralel pranë QSUNT, nga ku u evidentua se, për vazhdimin e kësaj kontrate, nga AK i QSUNT është tenderuar në bazë të ligjit të prokurimit publik për vazhdimësi të këtij shërbimi dhe i njëjti OE, ñE Ròshpk, me vlerë të kostuar për njësi prej **336 lekë pa tvsh** (ose 174 leke/njësi më pak nga sa përllogaritur nga KV në MSHMS). Sa më sipër, në të dyja rastet kemi të njëjtin shërbim, por me me vlera për njësi të ndryshme, pasi sipas VKM nr.203, datë 26.02.2020 ñProcedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetitò i ndryshuar, **nuk** përcaktohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit duke lënë shteg për interpretime të ndryshme nga AK, e duke e justifikuar si situatë e panjohur më parë. Nisur nga sa më sipër, konstatuam se, KV ka gjetur ñmënyra alternative përllogaritjejeò, të cilat në fakt janë të njëjta duke iu referuar procedurave normale të prokurimit publik, por nga KV, kjo ñpërllogaritjeò **nuk** është e shoqëruar me dokumentacion referuar çmimeve. **(III)**Sipas VKM nr. 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar, **nuk** është parashikuar elementi i monitorimit të ekzekutimit të kontratave			

	të përftuara, kështu, nga auditimi u konstatua se, vetëm në procedurën ñFurnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19ò, është ngritur grupi monitorimit ndërsa në procedurat e tjera nuk është ngritur asnjë grup i tillë. MSHMS, është mjaftuar vetëm me ngritjen e komisioneve të marrjes në dorëzim të mallit, barnave,shërbimeve etj. Si pasojë, ka munguar gjurma e auditimit për këto procese dhe nuk rezultojnë të jenë përgatitur informacione përmbledhës për përputhshmërinë, korrektësinë financiare dhe cilësinë e zbatimit të kontratës në mënyrë të vazhdueshme, për të parë efektivitetin, eficiencën dhe ekonomicitetin, e përdorimit të fondeve të siguruara nga Buxheti i Shtetit. **(IV) a**. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 118 pika 2 të parashikon se: ñ*Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte"*. **b**. Neni 6 i Ligjit të Prokurimit Publik (*ku është mbështetur KM për nxjerrjen e kësaj VKM*) nuk autorizon nxjerrjen e një Akti Normativ të Veçantë për kontratat sekrete, kontratat që kërkojnë masa të veçanta sigurie dhe kontratat që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit. **c**. VKM nr. 203 nuk ka përcaktuar përkufizimin e gjendjes, rrethanave, apo rasteve kur kemi të bëjmë me ñ*interesa thelbësorë të shtetit*ò por këto rrethana i ka lënë rast pas rasti në vlerësim të autoriteteve kontraktore; Pra, në kushtet kur termi ñ*interesa thelbësorë të shtetit*ò nuk ka gjetur një rregullim ligjor, ngelet një situatë abstrakte e pa përkufizuar dhe në vlerësimin subjektiv të çdo autoriteti duke rritur riskun për arbitraritet. **(V)** Nga auditimi dhe studimi i VKM nr. 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar, konkretisht sipas VKM nr.242 datë 22.03.2020 ñPër disa shtesa në VKM nr.203 datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësore të shtetitò, pika 2 shprehet se ñ*Për procedurën e drejtëpërdrejtë, të përcaktuar në nënndarjen IV.1, të kreut IV, të këtij vendimi,* ***nuk zbatohet dispozita e parashikuar për procedurën e ankimit***.ò. Mos parashikimi i këtij kriteri, mbart risqe pasi OE nuk mund ta ushtrojnë të drejtën e ankimimit, nëse i lind nevoja. *Për më sipër*, KLSH del me konkluzion se,			

	autoriteti kontraktor (MSHMS) apo dhe autoritetet e tjera kontraktore i kanë pasur të gjitha mundësitë që në zbatim ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò i ndryshuar, nenit 33 dhe VKM nr. 914, dt. 29.12.2014 ñP*ër miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar,* neni 36, të realizonin procedura prokurimi me negocim të cilat do të shmangnin parregullsitë e mësipërme. Nisur nga këto parregullsi, nevojitet përmirësimi i përmbajtjes së VKM nr. 203, datë 26.02.2020 ñ*Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit*ò duke e përshtatur atë dhe harmonizuar me disa kërkesa të LPP dhe VKM për rregullat e prokurimeve publike.			
4	Pasqyrat Financiare për vitin 2019 dhe vitin 2020 përfshijnë vetëm ñTë drejtatò dhe ñDetyrimetò e ish Ministrisë së Shëndetësisë duke mos përfshirë në të, treguesit financiarë të ish Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, duke ***sjellë si pasojë jo vetëm mosnjohje dhe moskontabilizim të saktë dhe të plotë të të drejtave dhe detyrimeve të subjketit, si dhe siguri të kufizuar në konfirmimin e pohimit të ekzistencës së tyre,*** duke bërë një pasqyrim të mangët dhe jo real të bilancit kontabël. MSHMS në vitin 2020 ka lidhur kontratën me shoqërinë ñS L.E.A.Lò, me objekt realizimin dhe akt rakordimet me thesarin, për pasqyrat financiare për ish MMSR, me nr. 491/5 prot.date 12.02.2020. Bilanci i MMSR-së, për periudhën 01.01 ï 30.11.2017, ka përfunduar nga studio, dhe është dorëzuar në MSHMS me procesverbalin datë 19.10.2020; Gjithashtu është përcjellë në Thesar me shkresën nr.1320, datë 09.03.2021. Nga auditimi rezultoi se, edhe pse ndodhemi përpara faktit të pasjes së një bilanci për ish-MMSR, nga MSHMS nuk është marrë asnjë masë për të ndarë te drejtat dhe detyrimet e MMSR, mes tre institucioneve (Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) , të cilat pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 508, date 13.09.2017 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Socialeò përthithën programet e MMSR-së.	125-158	**I LARTË**	Nga ana e MSHMS duhet të merren masa në mënyrë ***urgjente***, për bashkëpunimin me dy ministritë e tjera : Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për ndarjen e të drejtave dhe detyrimeve sipas bilancit të hartuar dhe miratuar nga thesari te ish-MMSR, me qëllim pasqyrimin ***real, të plotë, të qartë të aktivitetit ekonomiko-financiar të Ministrisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale si një Institucion i vetëm buxhetor.*** Gjithashtu pas përfundimit të ndarjes së të ñTë drejtaveò dhe ñDetyrimeveò, MSHMS të marrë masa në inkorporimin e tyre si dhe kontabilizimin e plotë, të cilat në kushtet aktuale krijojnë jo vetëm risk për ruajtjen dhe mirëadministrimin e tyre por denatyrojnë gjithashtu treguesit financiarë të shtetit.

5	Nga auditimi u konstatua se, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)ka realizuar procedurën e hapur me objekt ñ*Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë*ò me fond limit në vlerën prej 668,493,718.32 lekë pa tvsh, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të cilit i është deleguar procedura e prokurimit në bazë të shkresës nr.243 prot datë 05.03.2020, nga institucioni i varësisë, Spitali Universitar Obsetrik-Gjinekologjik (SUOGJ)ñMbretëresha Geraldinaò (MG), me kërkesë që realizimi i procedurës, të bëhet nga MSHMS, mëqënëse SUOGJ ñMbreteresha Geraldinaò, *nuk disponon kapacitetet e duhura për të kryer zhvillimin e procedurës së prokurimit publik.* -Nga auditimi u konstatua se, vlera e fondit limit, **nuk** është përllogaritur nga MSHMS pasi gjithë dokumentacioni *(Projekti Teknik, Preventiv i punimeve, oponenca teknike, akt ekspertizat, miratimi i projektin nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, miratimi i Lejes së ndërtimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit*) janë përcjellë nga SUOGJ-MG me shkresat nr.4/2 prot datë 10.02.2020 dhe nr.363 prot datë 30.04.2020, në MSHMS. Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm në dosje fizike ï teknike të procedurës, u konstatua se: **(i)** Projekti Teknik është realizuar ngaInstituti i Ndërtimit, si rezultat i bashkëpunimit me SUOGJ ñMbretëresha Geraldinëò (SUOGJ - MG), **dhe jo** nëpërmjet një procesi të hapur të përzgjedhjes në bazë të rregullave të prokurimit publik. SUOGJ është institucion varësie i MSHMS dhe njësi shpenzuese e veçantë dhe si Autoritet Kontraktor, është vetë autoriteti përgjegjës për administrimin e fondeve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit të nevojave të tyre, procedurë të cilën në këtë rast nuk e ka realizuar. Nga auditimi rezultoi se, në dokumentacionin e paraqitur nga SUOGJ-MG, **nuk** është paraqitur Licenca profesionale për Projektim nga Instituti i Ndërtimit lëshuar nga Ministria e Infrastruktuës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr.943 datë 28.12.2016 ñPër disa ndryshime edhe shtesa ne VKM nr.759 datë 12.11.2014 ñPër licensimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtarinë në fushën e studimit në projektimit në	226-248	I LARTË	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale, si institucioni epror, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim verifikimin dhe vlerësimin e procedurës së ndjekur për *"Rikonstruksionin e godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtimin e ri 3 kat, Tiranë",* në kushtet kur ka munguar procedura e prokurimit, duke e shoqëruar me përgjegjësitë respektive në çdo hallkë të saj, si dhe marrjen e masave për personat përgjegjës.

	ndërtim dhe mbikqyrjeò, ndonëse IN ka realizuar hartimin e Projektit Teknik, duke ñpërdorurò licencat personale të punonjësve ose të personave fizikë që operojnë në fushën e projektimit. Midis SUOGJ-MG dhe Institutit të Ndërtimit, është realizuar Kontrata nr.477/10 prot SUOGJ-MG ñ*Për hartimin e projektit Teknik për* ñ*Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë*òdatë 28.06.2019 lidhur, me vlerë prej 5,487,357 lekë me tvsh, për të cilën më pas është bërë dhe Kontrata shtesë nr.477/14 prot datë 26.02.2020 me vlerë prej 7,712,994 lekë me tvsh.Për kontratat e mësipërme nga SUOGJ-MG nuk janë paraqitur Urdhër-Shpenzime mbi pagesën, në vlerë totale prej 13,200,351 lekë me tvsh, me përfitues Institutin e Ndërtimit,(i cili nuk merr financim nga Buxheti i shtetit, por është me vetëfinancim). Sa më sipër, institucionet shtetërore, SUOGJ-MG dhe IN, kanë manaxhuar fonde publike në vlerën prej 13,200,351 lekë me tvsh, duke shmanguar procedurat e prokurimit si dhe duke eliminuar garën dhe transparencën për realizimin e hartimit të projektit teknik. **ii)** Në vijim, nga Instituti i Ndërtimit në kuadër të bashkëpunimit me SUOGJ-MG, është realizuar Oponenca teknike,duke lidhur kontratë nr.1066/4 datë 17.12.2019 me objekt ñOponenca teknike për *"Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë",* veprim ky në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò të ndryshuar, neni 37 (Shërbimi i konsulencës) pika 3 /b, me ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, neni 5. Në kushtet kur projekti teknik është hartuar nga Instituti i Ndërtimit, oponenca teknike (potencialisht mendimi ndryshe) vlerësojmë se nuk duhet të kryhej nga i njëjti institucion. Ky fakt është kundërshtuar dhe nga MSHMS sipas shkresës nr.1055 prot datë 19.11.2019 të SUOGJ-MG, drejtuar IN për bashkëpunim dhe interpretim të kofliktit të interesit. Në bazë të Urdhër-shpenzimit nr.788 datë 31.12.2019, IN është likuiduar me vlerën prej 325,750 lekë me tvsh, për realizimin e Oponencës teknike. **iii)** Përsëri nga Instituti i Ndërtimit janë realizuar dy akt-ekspertiza, njëra e datës 30.11.2019 mbi verifikimin në terren të subjekteve të dëmtuara të tërmeti i datës			

	26.11.2019 dhe tjetra e datës 19.02.2020, e cila është e thelluar në bazë të VKM nr.26 datë 15.01.2020 ñPër kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuaraò, duke u shprehur në përmbajtje se, duhet të merren *masat për rikonstruksion dhe përforcimi i Godinës së Obstetrikës, ndërsa për Godinën e Neonatoligjisë paraqitet më e vështirë, e për pasojë riparimi dhe përforcimi i strukturës është joeficient për tu riparuar* (dmth duhet të rindërtohet). Në Akespertizën e datës 19.02.2020, anëtarët e grupit **nuk** janë shprehur si ka qënë gjendja e godinave para dhe pas termetit dhe për rrjedhojë dhe ndryshimet në efektet financiare që mund të ketë pësuar preventivi Teknik i hartuar nga vetë IN,kjo në kundërshtim me Aktin Normatin nr.9 datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò neni 34 paragrafi 2. Gjithashtu, dhe në këtë rast konstatuam se anëtaret e grupit që kanë hartuar akt-ekspertizën e datës 19.02.2020, janë në konflikt të interest me detyrat që kanë realizuar, pasi njëkohësisht kanë qenë edhe anëtarë të grupit të hartimit të projektimit teknik. **iv*)*.**Nga auditimi u konstatua se,procedura e realizuar nga MSHMS në cilësinë e AK, procedurë e hapur me objekt ñRikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranëò me fond limit në vlerën prej 668,493,718.32 lekë pa tvsh, është fituar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ñA Kò shpk & ñB Iò shpk me vlerë ofertë fituese prej 466,395,123.98 lekë pa tvsh ose rreth 28 % më e ulët se vlera e fondi limit (ofertë anomalisht e ulët), fakt që mund të mbart elementë për fryrje fiktive të përllogaritjes së fondit limit, dmth të preventivave të hartuara nga IN. **v)** Nga auditimi i specifikimeve teknike që lidhen me zërat e kapitujve të punimeve elektrike u konstatua se, vendosja e *kodeve dhe serive të produkteve* i bën referencë *prodhuesit "Schneider", duke* bërë të mundur orientimin në drejtim të operatorëve ekonomikë specifikë që kanë këtë produkt. Veprimi i paracaktimit të prodhuesit nga ana e IN, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar ñPër prokurimin publikò neni 23 ñSpecifikimet teknikeò, pika 2 dhe 5.			

6	Nga auditimi i zërave të Projektit Teknik*"Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë"*nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua sa vijon: - Nga auditimi i preventivit të punimeve, të prokuruar nga MSHMS, dhe të hartuar nga Instituti i Ndërtimit rezultoi se për godinën e re dhe në rikonstruksionin e godinës ekzistuese, zërat ndërtimore, në një pjese të konsiderueshme të tyre (llogaritur në shumën 149,418,232 lekë), janë bërë me analizë çmimesh (AN), dhe jo me çmime sipas manualit të çmimeve. Kështu, në godinën e re, kapitulli ñd. Punime muratureò, zëri ñFV shtrim i sallës operative me PVC antibacterialò, Kapitulli ñj. Punime izolimi themele e tarraceò, etj, janë bërë pothuajse me ñANò, duke emërtuar zëra pune komplekse që nuk gjenden me emërtim të njëjtë në manualin e çmimeve dhe të ndryshme nga ato të paraqitura në specifikimet teknike. Pra edhe pse këto zëra janë me analizë çmimi, bashkëlidhur **nuk** u evidentua asnjë listë e hollësishme çmimesh me analizë të detajuar të çmimit ku të përfshihet: vlera e mallit/pajisja+pagesa e sigurimeve shoqërore+pagesa e puntorisë+ transport, etj.kjo në kundërshtim me VKM- në nr.514 datë 15.08.2007 ñPër informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.òi ndryshuar me VKM 629 datë 15.07.2015. Në llogaritjen e kostove për punimet ndërtimore, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, **nuk** u gjet asnjë përllogaritje e çmimeve apo studim tregut sipas VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò Kreu VII, neni 59, ñPërllogaritja e vlerës limit të kontratësò pika 2, ku përcaktohet se: *në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); **ose/dhe** a) Çmimet e tregut; ose/dhe b) Çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe ç) Çmimet ndërkombëtare, të botuara.* **Në lidhje më këto zëra, u analizuan zërat si më poshtë:**	226-248	I LARTË	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale, si institucion epror i Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik, të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mosargumentimin dhe mosdokumentimin në përllogaritjen e fondit limit, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet, si dhe të marrë masa për eliminimin këtyre praktikave në të ardhmen.

	1.Për zërin e punës *"F.V Termo dhe hidroizolim i pllakës së themelit dhe katit nëntokë. Primer, termoizolim me polesterol ekspans me spensor 80mm. Hidroizolim me dy shtresa guajne bituminoze, gjeotekstil, shtresë mbrojtëse",* **me çmimin 30,000 lekë/m^2**, me vlerë totale 33,900,000 lekë pa TVSH (1130 m^2 x 30,000 lekë/m^2), ku konstatuam se,nënzërat e tyre, si: primer, termoizolim me polesterol ekspans me spensor 80 mm, Hidroizolim me dy shtresa guajne bituminoze, gjeotekstil, shtresë mbrojtëseò, janë zëra që mund të gjenden të njëjtë (ose të ngjashëm) në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi dhe nga rillogaritja e çmimit të ri, rezultoi se, *çmimi i këtij zëri pune është rritur me 12,309 lekë/m^2, ose në totalin e preventivit* ***13,909,170 lekë pa TVSH*** *(12309 lekë/m^2 x 1130 m^2).* **2.** Për zërin e punës nr. 13 të kapitullit ñ*e. Punime shtresash" me përshkrimin "FV shtrim i sallës operative me PVC antibacterial"*, me çmim njësi 4920 lekë/m^2, me vlerë 39,360,000 lekë (8000 m^2 x 4920 lekë/m^2), në mungesë të analizës së çmimit në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe nga kërkimi i bërë në internet për çmimin e këtij materiali në linkun https://www.made-in-china.com/products-search/hot-china-products/Pvc_Flooring_For_Hospital.html, rezultoi se çmimi i materialit PVC antibacterial për spitalet, varion nga 5-15 USD/m^2 (ose 505 ï 1545 lekë/m^2). Nga sa sipër, duke shtuar edhe nënzërat e tjerë të analizës së kostos (punëtori, transport dhe makineri), përsëri ekziston rreziku i rritjes së pajustifikuar të çmimit/njësi të këtij zëri pune. Analiza e çmimit me testimin e tregut për nënzërin ñmaterialò, do të jepte një vlerësim objektiv për çmimin e këtij zëri pune.			
7	Nga auditimi u konstatua se, me VKM nr.274, datë 03.04.2020, mes MSHMS dhe operatorit ekonomik ñT.ò, shpk është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1365/36, datë 27.03.2020, me vlerë kontrate 75,060,000 leke pa tvsh ose 90,072,000 me tvsh me objekt ñFurnizim vendosje respiratore me dy modalitete per adulte dhe moshe pediatrike per Covid -19ò, me afate lëvrimi: 20 respiratorë brenda 7 ditëve dhe 34 brenda 25 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të kontratës (datë 03.04.2020). -Nga MSHMS vetëm për kontratën	185-191	I LARTË	**1.** Nga MSHMS të merren masa për arkëtimin e penaliteteve të krijuara si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor, duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, konkretisht nga operatori ekonomik ñT.ò shpk, në vlerën prej 6, 371,760 lekë me tvsh, për mosrealizimin e afateve dhe mos dorëzimin në kohë të 49 respiratorëve. **2.** MSHMS, të ngrejnë grup pune

	ñFurnizim vendosje respiratore me dy modalitete per adulte dhe moshe pediatrike per Covid -19ò, është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës , në bazë të shkresës nr.1365/38, datë 03.04.2020, i cili ka raportuar vetëm dorëzimin e 5 respiratorëve të cilët janë dërguar në Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò SUSHN, në cilësinë Spitali ñCovid 2ò, ku më Urdhër të titullarit të SUSHN është ngritur Komisioni për pritjen e mallit për pajisjet mjekësore respiratore, kjo në bazë të PV në datën 04.04.2020 ,duke u shprehur se janë marrë në ruajtje 5 respiratorë. -MSHMS me shkresën nr.1782, datë 09.04.2020, i është drejtuar SUSHN në lidhje me marrjen në dorëzim të pajisjeve mjekësore, është kërkuar që pas instalimit dhe vënies në punë të hartohet një procesverbal dhe të bëhet kontabilizimi, dokumentacioni të dërgohet në MSHMS. -MSHMS me shkresën nr.1365/40, datë 27.04.2020, është vendosur transferimi i 5 respiratorëve nga Spitali ñShefqet Ndroqiò për në Qendrën Spitalore Universitare ñNënë Terezaò QSUNT. Komisioni i pritjes së mallit në Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò është mbajtur procesverbali në datën 30.04.2020 mbi dorëzimin e pesë pajisjeve respiratorë, në drejtim të QSUNT. Nga auditimi u konstatua se, respiratorët nuk u përdorën nga Spitali Universitar ñShefqet Ndroqiò, ndërsa qëndruan fizikisht për gati 1 muaj në këtë spital. -Nga auditimi konstatohet se përgjatë një muaji që respiratorët qëndruan në spitalin ñShefqet Ndroqiò, në MSHMS nuk është dërguar asnjë dokumentacion mbi marrjen në dorëzim të tyre. Si pasojë, arsyet e mospërdorimit të tyre nga ky spital **nuk** reflektohen nga grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, ngritur me shkresë nr.1365/38, datë 03.04.2020, duke rezultuar se ka munguar gjurma e auditimit, që lidhet me përgatitjen e informacionit përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës në mënyrë të vazhdueshme. -Me shkresën nr.578/303, datë 08.05.2020, nga Qendra Spitalore Universitare ñNënë Terezaò është dërguar një kopje e relacionit të kolaudimit të pajisjeve mjekësore në formë dhurimi , dhe kalimi nga SUSHN në QSUT, është trajtuar si donacion. - Nga auditimi u konstatua se, me shkresat nr.1803, datë 10.04.2020 dhe nr.1365/39 datë 24.04.2020 nga operatori ekonomik			të veçantë, për analizimin e shkaqeve dhe arsyeve, të mos arkëtimit të vlerës prej **9,007,200.00** lekë, si pasojë e mos konfiskimit të sigurimit të kontratës në favor të MSHMS si dhe te kërkojë arkëtimin e vlerës së mësipërme në favor të Buxhetit e Shtetit, duke ndjekur të gjithë rrugët ligjore.

	fitues ñT. shpkò, është kërkuar zgjatje e afateve të dorëzimit të pajisjeve deri në periudhën maj ï qershor (për shkak të mbylljes të transportit ajror, tokësor dhe detar), duke ceduar kështu kriteri i ñemergjencësò. Pavarësisht kësaj, AK nuk rezultoi të ketë marrë ndonjë veprim administrativ- juridik për amendimin e kësaj kontrate. - Nga auditimi rezultoi se, OE deri më 10.04.2020 ka dorëzuar ***vetëm 5 copë,*** nga 20 copë që duhet të dorëzonte brenda 7 ditëve, ndërsa 34 respiratorë do të lëvroheshin brenda 25 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e kontratës, ku as këto nuk mundën të siguroheshin, duke sjellë gjithashtu edhe dështimin e kontratës së mësipërme. Grupi i auditimit, pas kontrolleve të cilësisë në KLSH, si dhe në bazë të evidencave të auditimit si: kontratat respektive, proces verbalet dhe faturat tatimore të dorëzimit të mallit/pajisje/shërbimit, rishqyrtoi edhe njëherë dhe rivlerësoi detyrimin kontraktor në lidhje mbi ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò dhe me ñSigurimin e kontratësò, në lidhje me furnzimin me respiratorë sipas kontratës nr. 1365/36, datë 27.03.2020, si më poshtë: **a. Në zbatim të nenit 10 të kontratës nr. 1365/36, datë 27.03.2020** parashikohet se: **"**Kontraktuesi, **kur nuk realizon ketë kontratë brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000** të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratësò. Grupi i auditimit, verifikoi edhe njëëherë evidencat e auditimit si: kontratën përkatëse, proces verbalet dhe faturave tatimore të dorëzimit të mallit/pajisje/ shërbim për secilën kontratë, dhe më pas rivlerësoi dhe rillogariti detyrimin kontraktor në lidhje mbi ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò sipas nenit 10 të kontratës nr. 1365/36, datë 27.03.2020. Nga auditimi rezultoi se: - OE ñT. shpkò, deri më 10.04.2020 ka dorëzuar ***vetëm 5 copë respiratorë ,*** nga 20 copë që duhet të dorëzonte për 7 ditë, ndërsa 15 copë respiratorë rezultojnë të padorëzuar në tejkalim të afatit 7 ditor (vlera e një respiratori është 1,390,000 lekë pa tvsh ose 1,668,000 lekë me tvsh). Për këtë furnizim të padorëzuar OE-së duhet tõ përllogariten dhe mbahen shuma prej 700,560 lekë me tvsh ((15 respiratorë x 1,668,000) x 0.004 x 7 ditë=**700,560**			

	lekë me tvsh.) - Gjithashtu 34 copë respiratorë **nuk** u dorëzuan fare, duke mos respektuar as afatin e parashikuar në kontratë prej 25 ditesh. Për këtë furnzim të padorëzuar OE-së duhet tõ përllogariten dhe mbahet shuma prej 5,671,200 lekë me tvsh ((34 respirator x 1,668,000) x 0,004 x 25 ditë = **5,671,200 lekë me tvsh**) Pra. në total, për mosrealizimin e afateve dhe mos dorëzimin e 49 respiratorëve, kontraktuesi duhet të paguajë 4/1000 të vlerës **së mbetur pa u zbatuar**, nga çmimi total i kontratës, në vlerën totale **<u>prej 6, 371,760 lekë me tvsh,</u>** e cila nga auditimi rezultoi si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit. **b.** Gjithashtu, **në zbatim të nenit 16 (Sigurimi i Kontratës), të Kontratës Furnizim nr.1365/36, datë 27.03.2020** ñ *Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë AK garancinë e sigurimit të kontratës, 10% të vlerës së kontratës me tvsh në shumën **prej 9,007,200 lekë.** Kontrata të sigurohet deri në përfundimi të kontratës. Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet AK si kompesim për çdo humbje të rezultuar nga **dështimi i kontraktorit** në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës. Garancia e sigurimit të kontratës do t'i kthehet Kontraktuesit pas përfundimit të kohëzgjatjes së kontratës*ò. -Nga auditimi u konstatua se, nga OE ñT.ò shpk, është paraqitur Formulari i Sigurimit të Kontratës nga Kompania e Sigurimeve ñE...ò me Nr. Serial 070350260029567, datë 27.03.2020, midis të tjera thuhet se ñ..*Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e Ministria e Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, vlerën e siguruar, brenda 15 ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmënde mospërbushjen e kushteve të kontratës."* Nisur nga këto rrethana e kushte, MSHMS si pasojë e mosplotësimit të detyrimit kontraktor nga OE si dhe në zbatim të neni 16 (Sigurimi i Kontratës), me shkresat nr.1365/43, datë 27.05.2020; nr.1782/1, datë 16.06.2020 dhe nr.633, datë 03.02.2021, ka kërkuar nga Kompania e Sigurimeve ñE..ò dhe për dijeni OE fitues ñT.ò shpk, për shkak të mospërmbushjes së kushteve të kontratës, transferimin në llogarinë e MSHMS të vlerës prej 10% të kontratës. <u>Nga auditimi u konstatua se, deri në momentin e hartimit të këtij materiali nga Kompania e Sigurimeve ñE..ò, nuk është</u>			

	depozituar vlera e garancisë së kontratës si dhe nga MSHMS nuk është ndërmarrë asnjë veprim ligjor duke shkuar në gjykatë administrative për arkëtimin e kësaj vlerë, e cila mund të sjellë risk ekonomik në disfavor të Buxhetit të Shtetit, ***në vlerën prej 9,007,200 (nëntë milion e shtatë mijë e dyqind lekë) si e ardhur e munguar.*** Në përfundim, rezultoi se furnizimi me respiratorë, u realizua nga dy OE të tjera konkretisht ñMò shpk dhe ñMò shpk (referuar faturave te likuidimit date 28.10.2020 (M. shpk), date 13.11.2020 (M. shpk) dhe date 09.10.2020 (M. shpk). Edhe pse planifikuar per nevoja emergjente, kjo procedure në fakt dështoi të ofronte në kohë këtë pajisje kaq të rëndësishme/jetesore në kushtet e pandemisë Covid19.			
8	**a.** Në përfundim të procedurës ñ*Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisje e Existation të firmës Bioneer ose ekuvalent*ò është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1574/13, datë 30.03.2020, miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020, me vlerë kontrate 10,200,000 lekë me tvsh. Rezultoi se, operatori ekonomik ñO.Dò shpk ka dorëzuar 20 kite *"AccurPower Sars –Cov – 2 real time PCR"* 17 ditë me vonesë, për të cilin nuk u konstatua njoftim apo ndonjë dokumentacion shkresor, mbi vonesat e dorëzimit të mallrave. Kështu në bazë të detyrimit kontraktor neni 24 ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò , për vonesat e dorëzimit të mallit me 17 dite, nga data 30.03.2020 deri në 16.04.2020, penaliteti i llogaritur për dorëzim të vonuar është (10,200,00 lekë me tvsh x 0,004 x17 ditë = **693,600 lekë me tvsh,** si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit. **b-**Nga zbatimi i kontratës, në lidhje për procedurën ñ*Spostimi i sistemit të dializës nga Pediatria e Specialiteteve tek godina e Spitalit Infektiv (Shërbimi i Alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me Covid-19*ò është lidhur kontrata nr.1575/19, datë 07.04.2020 miratuar me VKM nr.323 datë 18.04.2020, me vlerë kontrate 850,000 lekë pa tvsh ose 1,020,000 lekë me tvsh. Ky shërbim dhe furnizimi duhej bërë brenda 24 orëve, ndërkohë që ka ardhur më datë 22.04.2020, dmth 2 ditë me vonesë (Nga Qendra Spitalore Universitare, është dërguar proces verbali nr. dt. 22.04.2020 i mbajtur nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 57/1, dt. 21.04.2020 ku vërteton	210-218	I LARTË	**1.** Nga MSHMS të merren masat dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore, në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e penaliteteve të përllogaritura si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor për dorëzimin në kohë të mallit, të cilat përfaqësojnë të **ardhura të munguara** ndaj buxhetit të shtetit, për arkëtimin e vlerave si vijon: -Për procedurën ñ*Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisje e Existation të firmës Bioneer ose ekuvalent*ò nga ñO. Dò shpk , vlera prej **693,600 lekë me tvsh;** -Për kontratën ñSpostimi i sistemit të dializës nga Pediatria e Specialiteteve tek godina e Spitalit Infektiv (Shërbimi i Alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me Covid-19ò, nga OE ñTò shpk vlera perj **8,160 lekë** me tvsh; -Për procedurën Loti I ñ*Blerje kite dhe reagent të përshtatshëm për të përdorur në pajisje Maglum 800 Snibe CoLtd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për Covid-19*ò, nga OE ñGò shpk , vlera prej **151,718 lekë me tvsh;** Për procedurën Loti 2 ñ*Blerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHP*ò,

	kryerjen e punimeve (Cinstalim, transporti, instalimi) ..... Këto punime u kryen respektivisht sipas kushteve të kontratës si dhe detyrimit vtë të gjitha palëve. Fatura tatimore nr. 4055, dt. 22.04.2020 për 850,000 lekë pa tvsh ose 1,020,000 lekë me tvsh.) Për rrjedhojë në zbatim të detyrimit kontraktor neni. 24 ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò, AK duhet të kishte përllogaritur dhe ndalur penalitetin për dorëzimin e vonuar nga operatori ñTò shpk është (1,020,000x0,0,004 x2 ditë =**8,160 lekë me tvsh**, vlerë kjo e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit. **c-**Nga zbatimi i kontratës, në lidhje për procedurën **Loti I** ñ*Blerje kite dhe reagent të përshtatshëm për të përdorur në pajisje Maglum 800 Snibe CoLtd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për Covid-19*ò është lidhur kontrata lidhur kontrata me nr.1776/11 datë 14.04.2020 , miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020, me vlerë kontrate3,512,000 lekë pa tvsh ose 4,214,400 lekë me tvsh. Në detyrim kontraktor neni 2 dhe sipas ofertës nga operatori ekonomik ñGòshpk, 50 kite duhet të lëvroheshin për 5 ditë nga hyrja në fuqi e kontratës. Nga auditimi u konstatua se, 6 kite me vlerë prej 252,864 lekë janë sjellë më datë 30.05.2020, pra 36 ditë me vonesë (24.04.2020 deri në 30.05.2020). Sipas faturës tatimore të shitjes nr.2202 datë 24.04.2020 në vlerën prej 3,301,280 lekë pa tvsh ose 3,961,536 lekë me tvsh. Kështu në bazë të detyrimit kontraktor neni 24 ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò, dëmi i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñGòshpk do të ishtë: (25% x 4,214,400) x 0,004 x 36 ditë = **151,718 lekë me tvsh,** vlerë kjo e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit **d -**Nga zbatimi i kontratës, në lidhje me procedurën **Loti 2** ñ*Blerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHP*ò është lidhur kontrata e furnizimit nr.1776/13 datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.316 datë 18.04.2020, me vlerë kontrate 21,725,500 lekë pa tvsh ose 26,070,600 lekë me tvsh. **d.1)** Në detyrimin kontraktor neni 2 dhe sipas formularit të ofertës nga operatori ekonomik ñB.Aò shpk ku parashikohen afatet e lëvrimit, sasia prej 3000 reaksione në vlerë prej 2,340,000 lekë me tvsh, nuk është sjellë ditën kur hyn në fuqi kontrata, por ka ardhur 5 ditë me vonë(18.04.2020-			nga OE ñB. Aò shpk, vlera prej prej **1,016,753 lekë me tvsh.**

	23.04.2020) si dhe sasia prej 100 shishe në vlerë prej 102,000 lekë me tvsh nuk është sjellë në datë 18.04.2020, por më datë 23.04.2020. Në bazë të nenit 24 të kontratës, ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò, nga AK duhet të përllogaritet dhe ndalet penaliteti për dorëzim të vonuar nga OE ñB.Aò shpk në vlerë prej (26,070,600 x 25%) x 0,004 x 5 ditë = **130,353 lekë me tvsh**), vlerë kjo e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit. **d.2)** Për artikujt nga 1 deri në tre, sipas formularit të ofertës do të levroheshin 5 kuti për secilën përmasë, 500 rack për secilin artikull brenda 30 ditëve që i përket data 18.05.2020, të cilët kanë ardhur më datë 30.05.2020, dmth 12 ditë me vonesë, (500 rack x 1925 lekë pa tvsh=1,155,000 lekë me tvsh x 3 artikuj = 3,465,000 lekë me tvsh vlerë e pa lëvruar. Në bazë të nenit 24 të kontratës, penaliteti i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñB.Aòshpk është e baravlefshme në vlerë prej (26,070,600 x 0.25) x 0.004 x12 ditë = **312,847 lekë me tvsh),** vlerë kjo e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit. **d.3)** Për artikullin 4 në sasinë prej 3000 sipas formularit të ofertës do të levroheshin brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës, që i përket data 08.05.2020, të cilët kanë ardhur më datë 30.05.2020, dmth 22 ditë me vonesë, (3000 reaksione x490 lekë pa tvsh = 1,764,000 lekë me tvsh, vlera e palëvruar. Në bazë të nenit 24 të kontratës (Likujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuar) Sa më sipër, penaliteti i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñB. Aòshpk është e baravlefshme në vlerë prej (26,070,600 x 0.25) x 0.004 x22 ditë = **573,553 lekë me tvsh**, si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit. Pra, operatori ekonomik ñB.Aòshpk, për dorëzimin e e vonuar nga detyrimi kontraktor me nr.1776/13 datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.316 datë 18.04.2020, duhet të paguar nga vlera e sigurimit të kontratës, penalitetin total në vlerë prej **1,016,753 lekë me tvsh,** si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.			
9	Nga auditimi i zërave të Projektit Teknik*"Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë"* nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se: -Në bazë të Preventivit teknik të hartuar nga Instituti i Ndërtimit, në Kapitulli i kuadrove elektrike (këtu futen 1.1 derin	226-248	I LARTË	**3.1. Rekomandim :**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale si institucion epror, të marrë masa duke verifikuar gjatë zbatimit të kontratës respektive për këtë investim si në situacionet pjesore /në situacionin përfundimtar, duke mos likuiduar tepër vlerën prej 1,331,384.3 pa

	1.34) konstatohet se, zëri ñ*F.V Morseta, kanalina plastike, zbara bakri, kabllo dhe të gjithë aksesorët e nevojshme për montim, përfshi kolaudimin, testim dhe komisionim*ò, është zë pune i mbivendosur i strukturës së preventivit të hartuar nga IN, në kundërshtim me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 ñ*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*ñ, pasi i njëjti zë[3] gjithashtu është përshkruar në zërat e tjerë, të veçuar sipas kapitujve të punimeve elektrike - kuadri kryesor, janë zërat për F.V Furnizim vendosje për kapak, automat, siguresa, instrumenta etj. Sa më sipër, për Kapitullin e Kuadrove Eletrike (1.1-1.34) zëri ñ*F.V Morseta, kanalina plastike, zbara bakri, kabllo dhe të gjithë aksesorët e nevojshme për montim, përfshi kolaudimin, testim dhe komisionim*ò në **vlerën prej 1,176,000 lekë pa tvsh përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit, pasi është i mbivendosur në punimet elektrike për zërat përkatës, duke sjellë fryrje të zërave të punës dhe rritje fiktive e vlerës së kontratës, në përfitim të sipërmarrësit. Gjithashtu, në Kapitullin II ñPunime elektrikeò /1.2 ñKanalina Metalikeò dhe Kapitullin III ñPunime Mekanikeò, u konstatua se **nuk** është vendosur sasia në 3 zëra që i korrespondon vlerës prej **155,384.3 lekë pa tvsh, e cila përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit, duke sjellë rritje fiktive e vlerës së kontratës. Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Institutin e Ndërtimit. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-228 të Projekt Raportit të Auditimit).*			tvshsipërmarrësit të punimeve BOE ñA. Kò shpk & ñB-Iò shpk ,për punime mbivendosura, me qëllim mirëmenaxhimin të fondeve buxhetore.
10	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës ñPrishje mur gipsi t=10 cm, çmimiò, ñPrishje tavan i varur gipsi 60 x 60 cm, çmimiò, ñGrila d/alumini me roleò, ñVetratë xhami e temperuarò, ñInstalimi i linjave të bakrit + linjat e kondesatitò, ñFV ndriçues emergjence evakuimi (Exit)ò, etj., për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-228 të Projekt Raportit të Auditimit).*	258-268	I LARTË	Nga MSHMS të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 2,349,902 lekë pa tvsh nga OE ñZ.Kò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2089/9 prot datë 07.08.2020 me ñRikonstruksioni i shërbimit të Reanimacionit të Spitalit Rajonal Vlorëò, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

[3]Zëri ñ*F.V Morseta, kanalina plastike, zbara bakri, kabllo dhe të gjithë aksesorët e nevojshme për montim, përfshi kolaudimin, testim dhe komisionim*ò

11	Nga MSHMS të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 2,349,902 lekë pa tvsh nga OE ñZ.Kò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2089/9 prot datë 07.08.2020 me ñRikonstruksioni i shërbimit të Reanimacionit të Spitalit Rajonal Vlorëò, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.	258-268	I LARTË	Nga MSHMS të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,373,684 lekë pa tvsh nga OE ñA. Kò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1076/72 prot datë 13.08.2020 me ñLoti I, Rikonstruksione të QSH-ve në qarqet Tiranë, Durrës, Dibër (viti 2020)ò, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.
12	Nga auditimi u konstatua dëm ekonomik ne vlerën **3,695,819 lekë** për likuidim e tarifave përmbarimore për vendime gjyqësore të formës së prerë të ish-MMRS prej të cilave**, 1,028,079 lekë** të paguara në vitin 2019, dhe **2,667,740 lekë** të paguara në vitin 2020. Më hollësisht: Në vitin 2019, në 3 raste nga 15, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për largime të padrejta nga puna, të kryer nëpërmjet firmave përmbarimore, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën *1,013,079 lekë* për likuidimin e tarifave përmbarimore, dhe një rast për cështje gjyqësore me shoqëri sigurimesh në vlerën *15,000 lekë*: -Vendimi gjyqësorë për gjyqfituesin i cili ka marr formë të prerë në 05.02.2015, A. Xh, tarifa përmbarimore në vlerën 413,804 lekë; -Vendimi gjyqësorë për gjyqfituesin M. C tarifa, i cili ka marr formë të prerë në 03.03.2016, përmbarimore në vlerën 534,325 lekë; -Vendimi gjyqësorë për gjyqfituesin A. Xh tarifa, i cili ka marr formë të prerë 24.05.201, tarifa përmbarimore në vlerën 64,950 lekë; -Vendimi i gjykatës i cila ka marr formë të prerë më datë 24.05.2017 me gjyqfitues Shoqërinë ñA-Sò, tarifa përmbarimore në vlerën 15,000 lekë, shlyer me urdhër shpenzimin nr. 986, datë 11.12.2019. Në vitin 2020, vendim gjyqësor i shoqëruar me gjoba, kamatvonesa dhe tarifa përmbarimore në vlerën *2,667,740 lekë*: -Vendimi i gjykatës me gjyqfitues shoqëria ñD. P. Aò për një detyrim të vitit 2015 të ish MMRS-në, është shoqëruar me 1,883,281 lekë kamatëvonesave, 5000 lekë gjoba, 15,000 lekë shpenzime për ekspertin fiskal, dhe 764,459 lekë tarifë përmbarimore, shlyer me urdhër	91-125	**I LARTË**	Pasi të jenë ezauruar të gjitha hapat ligjore, për mundësinë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë (referuar kërkesave të Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 ñPër zbatimin e vendimeve gjyqësore te formës së prerë, nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civilò, por edhe Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012, para.62, DHE Udhezimit nr.1, date 04.06.2014), strukturat përkatëse në MSHMS, për të gjitha rastet në vijim, të marrin masat e nevojshme për të shlyer në kohë detyrimeve financiare që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prere, me qëllim shmangen e gjobave, kamatvonesave dhe tarifave përmbarimore të cilat përbëjnë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit. Ekzekutimi i vendimeve gjyqesore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, të bëhet sipas rradhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes të bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të MSHMS, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut, në mënyrë që edhe përmbaruesi tõ i përmbahet grafikut të shyerjes së detyrimit të publikuar, duke shmangur kështu kostot e përmbarimit të cilat rëndojnë buxhetin e shtetit, në përputhje me sa dikton Udhëzimi nr. 1, datë Nr. 1, datë 4.6.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes

	shpenzimin nr. 450, datë 25.06.2020.			së përgjithshme në llogari të thesaritò.
13	Nga auditimi i procedurës së prokurimit "Blerje monitor pacienti për masat anti Covid-19ò, realizuar nga MSHMS, të zhvilluar në vitin 2020. Titullari i MSHMS ka miratuar Urdhrin e Prokurimit nr. 359, datë 06.06.2020, me njësi prokurimi me përbërje: A.P, E. L dhe L. P, të cilët kanë argumentuar përdorimin e llojit të procedurës së prokurimit ñNegocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratësò. Gjithashtu, titullari i AK, me shkresën nr. 2587 /1, datë 01.06.2020, ka miratuar Urdhër nr.359/1, datë 01.06.2020 për emërimin e Komisonit të Vlerësimit të Ofertave me përbërje: F.B, O. Dh dhe O. A. Në bazë të PV, të njësisë së prokurimit, janë përzgjedhur tre OE për të marrë pjesë si operatorë që kanë pasur kontrata të mëparshme të sukseshme me MSHMS, konkretisht ñO.Dò shpk, ñMò shpk dhe ñB. Eò shpk, të cilëve u janë dërguar ftesë për pjesëmarrje, kjo në përputhje me VKM nr.914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregulave të prokurimit publikò i ndryshuar, neni 36 pika 4. Nga auditimi u konstatua se, sipas procesverbalit të mbajtur nga KVO në datën 08.06.2020, është paraqitur *vetëm* një operator ñO.Dò shpk, me ofertë ekonomike 54,905,000 lekë pa tvsh (ose 30,605,265, lekë më pak nga fondi limit), ku midis të tjerave është konstatuar se, operatori ekonomik ñO. Dò shpk. Nga verifikimi qe bëri KLSH rezultoi se, modelet e paraqitura në formularin e ofertës, në fakt: (1) kanë *rezolucionin 800*600* dhe jo *1024*768*, sikundër është kërkuar në specifikimet teknike në DST(**pra me rezolucion më të ulët nga sa kërkuar në DST**).; dhe (2) *nuk kanë ndërfaqe të integruar protokolli HL7 dhe jo DIAP* sikundër është kërkuar në specifikimet teknike. Pamvarësisht sa më sipër, KVO ka vendosur ta pranojë këtë ofertë duke e konsideruar shmangien nga ky kriter si devijim të vogël, dhe që nuk ndikon në funksionet klinike të monitorit. Në fakt, devijime te vogla, në kuptimin që i njeh Ligji i Prokurimit Publik jane devijimet qe nuk ndryshojne materialisht ose nuk i kalojne specifikimet, kushtet, termat dhe kerkesat e tjera ose gabimet e shtypit apo pakujdesite dhe qe mund te korrigjohen pa ndryshuar thelbësisht karakteristikat dhe kërkesat e tjera të	219-226	I LARTË	Për të gjitha rastet në vijim, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të veprojnë në përputhje me parimet transparences, barazise dhe mos diskriminimit përgjatë zhvillimit të procedurave të tenderave në MSHMS, me qëllim vendosjen e operatorëve ekonomikë në kushte barazie si përgjatë fazës së përgatitjes së ofertave, ashtu dhe gjatë vlerësimit të tyre. Gjithashtu KVO-të, në cdo rast, të vleresojë si oferta te vlefshme, me devijime të vogla vetëm rastet kur këto devijime janë të argumentuara se **nuk ndryshojne thelbesisht** karakteristikat e percaktuara ne dokumentet e tenderit, në përputhje me sa dikton kuadri ligjor në fuqi, konkretisht KVO të konsiderojnë si oferta te vlefshme rastet kur oferta: a) permban devijime te vogla, te cilat materialisht nuk ndryshojne ose devijojne kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentet e tenderit; dhe b) oferta permban gabime apo lapsuse, te cilat mund te korrigjohen pa prekur perrnbajtjen e ofertes.

	përcaktuara në DST, ndërkohë që konstatojmë se elementet e ndryshuar tek malli i kërkuar ï monitorë, lidhen direkt me karakteristikat e produktit të kërkuar në DST (kjo gjithashtu është arsyeja dhe pse është vlerësuar që këto specifikime teknike (dhe jo të tjera) të hartuara nga institucionet përfituese - QSUT me shkresën nr.1403/1, datë 17.03.2020, SU ñShefqet Ndroqiò me nr.34/21, datë 31.03.2020 dhe SUOGJ ñMbretëresha Geraldinëò me nr.296, datë 27.03.2020) të kërkohen në DST). - Në vijim. operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumente duhet te refuzohen si te papranueshme, ne mbeshtetje edhe te pikes 3, te nenit 66 te VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, ne te cilen percaktohet se komisioni verifikon dhe vlereson ofertat e dorezuara, duke kualifikuar vetem ato oferta, qe perrnbushin kriteret per kualifikim, te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Nisur nga sa më sipër, duke kualifikuar një ofertë që nuk i plotëson të gjitha karakteristikat sipas DST, KVO ka vepruar në kundërshtim me piken 3, te nenit 66 te VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, ne te cilen percaktohet se komisioni verifikon dhe vlereson ofertat e dorezuara, duke kualifikuar vetem ato oferta, qe permbushin kriteret per kualifikim, te percaktuara ne dokumentet e tenderi. -Gjithashtu nje ndër parimet kryesore te zhvillimit te procedures se prokurimit eshte ai barazise ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve, parashikuar nga neni 2, i Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", te ndryshuar. Zbatimi i parimit te transparences, barazise dhe mos diskriminimit jane garancite kryesore ndaj ofertuesve qe ofron kuadri ligjor ne fuqi. Keto parime, nder te tjera nenkuptojne se operatoret ekonomike duhet te jene ne nje pozicion barazie, si kur pergatisin ofertat e tyre ashtu dhe kur këto oferta vleresohen. Në rastin konkret, parashikimi në DST: (1) i një **rezulocioni më të lartë** i cili më pas rezulton të jetë pranuar më i vogël, për OE fitues duke u trajtuar si ñdevijim i vogëlò; dhe (2) i **ndërfaqes së integruar**			

	të protokollit DIAP, e cila më pas rezulton të jetë ndryshuar dhe pranuar në HL7, për OE fitues duke u trajtuar si ñdevijim i vogëlò,tregon se KVO ka shkelur parimin e barazisë, duke i vendosur OE-të në pozita jo të barabarta përgjatë fazës së përgatitjes së ofertave dhe si pasojë edhe gjatë vlerësimit të ofertës. Vlerësimi i ofertave referuar kritereve të tjera të kualifikimit të cilat nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 55 pika 2 e LPP-së, por cënon gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar në nenin 2 të Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", te ndryshuar, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. Në vijim të sa më sipër, nga auditimi, rezultoi se Njësia e Prokurimit me anëtarë A.P, E.L dhe L.P, nuk kanë reflektuar në Aneksin nr.2, devijimet e vogla për monitorët, të miratuara nga KVO sipas proces-verbalit të datës 08.06.2020, por i kanë lënë specifikimet teknike të pandryshuara sikundër ishin në DST. Me shkresën nr.2587/7, datë 19.06.2020, është dërguar për zbatim kontrata me objekt ñBlerje monitorë pacienti për masat anti COVID-19ò autoriteteve përfituese: Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza, SU ñShefqet Ndroqiò dhe SUOGJ Mbretëresha Geraldinë. -Me shkresën nr.2587/9, datë 26.06.2020, titullari i AK ka miratuar Urdhrin me nr. 382, datë 26.06.2020 ñPër caktimin e koordinatorit për mbikqyrjen e kontratës së furnizimit nr.2587/6, datë 17.06.2020ò, znj.L.P. e cila është përgjegjëse për monitorimin e kontratës . Me anë të emaileve të datës 08.07.2020, zj.L.P, koordinatorja për mbikqyrjen e kontratës i ka kërkuar spitaleve përfituese të këtij prokurimi Procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallit, ku është konstatuar se, lista e pajisjeve, prodhuesi, modeli, numri i serisë, sasitë përkatëse, dokumentin e hyrjes në magazinë, janë marrë në zbatim të kontratës (pjese integrale e së cilës janë edhe DST, edhe oferta e OE-së). Materialet e mësipërme janë dërguar në MSHMS pa shkresa përcjellëse. Në observacionet e dërguara nga MSHMS, në KLSH, konfirmohet, shoqëruar me evidencat përkatëse se, <u>malli i marrë në dorëzim i referohet saktësisht modeleve të ofertuara nga O.D, pjesë e</u>			

	ofertës së tij teknike e shpallur fituese, dhe jo DST. Nga auditimi rezultoi se, koordinatori për mbikqyrjen e kontratës nuk ka përgatitur raportin përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me Urdhrin me nr.382, datë 26.06.2020 ñPër caktimin e koordinatorit për mbikqyrjen e kontratës së furnizimit nr.2587/6, datë 17.06.2020ò. Si përfundim, pajisjet monitorë janë marrë në dorëzim në kundërshtim me kontratën e nënshkruar. Zëri Monitor Pacienti multiparametrik në sasinë 50 copë në vlerën 18,250,000 lekë pa tvsh është marrë në kundërshtim me specifikimet teknike sipas kontratës me nr.2587/6, datë 17.06.2020 ñBlerje monitorë pacienti për masat anti COVID-19ò, duke vendosur në diskutim cilësinë e produkteve për rrjedhojë vlera prej **18,250,000 lekë pa tvsh *janë shpenzuar, pa ekonomicitet, pa eficiencë dhe pa efektivitet, të financuara nga Buxheti i Shtetit.***			
14	Në llogarinë e APP <u>në formatin elektronik</u> nuk del procedura e prokurimit ñ*Për dhënien e koncesionin /partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës"* pasi procedura nuk ka kaluar si ñ*shpallje e përfunduar*ò, në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 13, datë 28/05/2015 ñ*Për procedurat e dhënies me koncesion dhe partneritet publik privat në sistemin e prokurimit elektronik dhe dorëzimi i ofertave nga operatorët ekonomikë*ò. -Nga Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 417, dt. 02.10.2015 ñ*Për ngritjen e komisionit të dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës*ò i ndryshuar me urdhrin nr. 298, dt. 14.07.2016 dhe nr. 976/2, dt. 14.07.2016 me procesverbalin përmbledhës nr. 14, dt. 20.03.2017, ***janë vlerësuar ofertat*** për ñ*Koncesionin/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës"* me këshilltar transaksioni IFC-në. Në këtë mbledhje të komisionit përfaqësuesja e IFC ka kundërshtuar kualifikimin e BOE*: 1..SHPK (%41.7) &*	268-287	I LARTË	**1.**Autoriteti kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masat për rishikimin e zgjidhjen e kontratës me BOE të koncesionit/partneritetit publik privat ñ*Për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjë*ò përfituar në kundërshtim me Ligjin nr. 125, datë 25.04.2013 ñ*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*ò Neni 36 ñ*Zgjidhja e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat*ò pika 2. **2.** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duke u këshilluar paraprakisht me Avokaturën e Shtetit të marrë masat për të informuar Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të gjitha rrethanat e njohura, të cilat çojnë dhe krijojnë kushtet për zgjidhjen e kontratës me BOE të koncesionit/partneritetit publik privat ñ*Për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjë*ò dhe të kërkojë mendimin e saj, në përputhje me Ligjin nr. 125, datë 25.04.2013 ñ*Për koncesionet dhe*

	E.F (%25) & A.L.S B.V (%33.3) Holandë; duke ngritur **dy arsye**: **a.** Çështje integriteti të kompanisë ABLS (duke iu referuar standarteve të IFC në draft kontratën e koncesionit pika 2.1 (j) ku citohet: Që në datën efektive dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes, koncesionari deklaron dhe garanton se; 1. Koncesionari 2.1 deklarimi dhe garancitë e koncesionarit; as ai, as ndonjë prej ortakëve të tij të rëndësishëm (apo në dijeninë e tij, asnjë nga personat e lidhur të tij apo personat e lidhur të tyre) nuk është subjekt i ndonjë hetimi penal për mashtrim, korrupsion, bashkëpunim të fshehtë apo pastrim parash ..... etj IFC lidhur me këtë fakt është bazuar në dy artikuj gazetash spanjolle të cilat hedhin dyshime mbi përfaqësuesin ligjor të shareholder-it të ABSL-së (orinoco mining&resources B.V dhe anëtarin e bordit të saj, kompaninë ITPS0 i cili, sipas këtij shtypi është në ndjekje penale në Spanjë. Gjithashtu IFC rekomandon se (ultimate beneficiary owner) i ABSL nuk rezulton i qartë nëse kompania është shqiptare ñP.ò shpk pavarësisht dokumenteve të paraqitura sipas tyre. **b**. Çështjen e kontrollit mes kompanive ñEò dhe ñSò të cilat marrin përsipër realizimin e testeve ku sipas IFC-së ñSò nuk kontrollohet nga ñEò pasi nuk zotëron mbi 40% të së drejtës së votës te kjo kompani, sipas nenit L 233-3 të kodit Tregtar Francez, pika II. Për dy arsyet e mësipërme **IFC ka rekomanduar skualifikimin e këtij BOE** *1. L. SHPK (%41.7) & E. F (%25) & A. L. S. B.V (%33.3) Holandë.* *Komisioni me gjithë rekomandimin e IFC vlerëson se "Nuk disponon dhe as është në dijeni të ndonjë dokumenti zyrtar (vendim gjykate të formës së prerë) që provon se shoqëria A nuk përmbush kriterin e përcaktuar..* *Gjithashtu lidhur me (ultimate beneficiary oëner) komisioni sqaron se në bazë të dokumenteve të paraqitura nga L. U është kompani shqiptare "P" SHPK e cila nuk figuron të jetë në ndjekje penale apo e dënuar sipas kriterit të përcaktuar në DST.....* -Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë ka dërguar raportin përmbledhës me nr. **77/11**, dt. **03.04.2017**, i miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor znj. O. M. për **Raportin përmbledhës** për procedurën ñ*Koncesionin/partneritetit publik privat*			*partneritetin publik privat*ò, Neni 36 ñ*Zgjidhja e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat*ò pika 4.

	për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës" ku përshkruhet procedura e hapjes dhe vlerësimit të ofertave, kualifikimin e tyre dhe propozimin për shpalljen **fitues** të BOE: ñ*L SHPK (%41.7) & .E.F (%25) & A.L.S B.V (%33.3) Hollandë me një discount rate 10.7%.* ***(gjithsej 98.14 pikë)***. Në këtë raport përmbledhës nuk janë paraqitur kundërshtimet që ka pasur përfaqësuesja e IFC lidhur me kualifikimin e BOE në kundërshtim me Ligjin nr. 125/2013 ñ*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*ò neni 18 pika 5/c; 1. ñLò SHPK (%41.7) & ñEò France (%25) & ñA.L.S B.Vò (%33.3) Holandë; -Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 417, dt. 02.10.2015 **nuk ka kryer hetimet e arsyeshme** në përputhje me Dokumentet e Procedurës Konkurruese të miratuara në pikën 7.7, pikën 7.8. -Nga IFC është trajtuar çështja e kontrollit mes kompanive ñEò dhe ñSò të cilat marrin përsipër realizimin e testeve ku sipas IFC-së ñSò nuk kontrollohet nga ñEò pasi nuk zotëron mbi 40% të së drejtës së votës te kjo kompani, sipas nenit L 233-3 të kodit Tregtar Francez, pika II. **a.** Sipas letër konfirmimit dhe angazhimit të datës 09 shkurt 2017 të grupit ñLò përfaqësuar nga presidenti z. J.P.B konfirmohet se ñL. Gò është zotërues i ligjshëm direkt i 40% të kapitalit të ñEò; dhe 40% të kapitalit të ñSò dhe si e tillë ñLò kualifikohet si shoqëria mëmë e ñEò dhe ñSò dhe në terma ligjorë ajo i kontrollon të dyja si ñSò dhe ñEò, të cilat njihen sipas ligjit si degë të ñLò. **b.** Sipas letër konfirmimit dhe angazhimit të datës 17 mars 2017 nga presidenti z. J.P. B. ñLò është mbajtësi i drejtpërdrejtë i 33.7% të kapitalit të ñSò dhe 34.06% të kapitalit të ñEò. Për më tepër të gjithë aksionarët e ñSò janë gjithashtu aksionarë të ñLò; ndërsa të gjithë aksionerët e ñEò janë njëkohësisht aksionarë të ñLò. Kështu aksionarët e ñLò dhe ñLò mbajnë më shumë se 40% të aksioneve. **c.** Gjithashtu sipas Statutit të ñEò viti 2016, Artikulli 13, garancitë, pika II, paragrafi i parafundit faqe 39 ñ ... *përcaktohet shprehimisht se çdo investim, çdo hua... çdo hipotekë, çdo garanci, çdo qiradhënie, çdo garanci, çdo veprim që përfshin transferime të pasurive të paluajtshme klientëve. Çdo shitje e elementeve të caktuar të pasurive fikse që*			

	tejkalojnë shumën 100,000 Euro, angazhimet që tejkalojnë një shumë prej 100,000 Euro, blerje për një shumë më të madhe se 100,000 Euro nuk mund të kryhen, vetëm me autorizimin e mbledhjes së zakonshme të partnerëve". **d.** Gjithashtu sipas Statutit të ñLò viti 2016, Artikulli 13, garancitë, pika II, paragrafi i parafundit faqe 20 ñ ... *përcaktohet shprehimisht se çdo investim, çdo hua... çdo hipotekë, çdo garanci, çdo qiradhënie, çdo garanci, çdo veprim që përfshin transferime të pasurive të paluajtshme klientëve. Çdo shitje e elementeve të caktuar të pasurive fikse që tejkalojnë shumën 40,000 Euro, angazhimet që tejkalojnë një shumë prej 40,000 Euro, blerje për një shumë më të madhe se 40,000 Euro nuk mund të kryhen, vetëm me autorizimin e mbledhjes së zakonshme të partnerëve*ò. **e.** Në dokumentet e paraqitura nga operatori i mësipërm (të cilat janë në formatin elektronik të pa përkthyera në shqip, të pa noteruara dhe mungojnë në dosjen e operatorit fitues) mungon autorizimi i aksionarëve për angazhimet për shërbimet laboratorike sipas ofertës. -Lidhur me çështjet e integritetit të kompanisë A, IFC ka rekomanduar skualifikimin e këtij BOE 1. ñLò SH.P.K. (%41.7) & ñEò France (%25) & ñA. L. S. B.Vò (%33.3) Hollandë. Nga auditimi rezultoi se: **a**. Sipas letër konfirmimit dhe angazhimit të datës 17 mars 2017 të A.. citojmë; ñ*pronari i fundit përfitues i aksioneve të A. L.S BV Holandë (A..) është entiteti shqiptar "P" shpk* .....ò ndërkohë nga auditimi i dokumenteve të paraqitura rezulton se e vetmja marrëdhënie si ligjore dhe ekonomike midis A.. (*thw fiduciary*) dhe ñP.ò shpk (*the Principal*) është një Fiduicary Agreement (*Shares of A.L.S. BV*) nënshkruar në datë 06 Shkurt 2017, e cila në thelb të saj ka vetëm ruajtjen e 1800 aksioneve me vlerë nominale 10 Euro secila, të cilat sipas kësaj kontrate ñP.ò SHPK (*the principal*) ja beson në ruajtje në emër të Fiduciary (ABSL) por për llogari dhe risk të Principal, veprim ky i cili do të konsiderohet ñ*the Services*ò, shërbimi. Sipas pikës 4 të po kësaj kontrate ñIò, A në rolin e the fiduciary do të kryej të gjitha detyrat vetëm në përputhje me instruksionet e the Principal dhe vetëm në raste emergjence mund të ndërmarrë ndonjë veprim dhe për të cilin duhet të njoftojë pa vonesë The Principal.			

	Gjithashtu në pikën 5 po të kësaj kontrate Termination, ndërprerja ose mbarimi i kësaj kontrate është parashikuar në çdo kohë me njoftimin me email brenda tre ditëve pune, dhe në pikën 5.2 është parashikuar që të kryhet transferimi i aksioneve në një palë të tretë pa vonesë dhe pa pretendime. -Në thelb kjo kontratë nuk paraqet asnjë angazhim apo dhe pronësi të Pegassus mbi A, por është përdorur si ñ*koracë*ò përfaqësimi për konsorciumin dhe përfaqësimin në konkurrimin e hapur për koncesionin e laboratorëve, pasi nëse do të ishte paraqitur vetë P si aksioner në konsorciumin e ngritur atëherë pjesëmarrja e tij rezulton 75% të aksioneve dhe jo ndarja që është paraqitur në marrëveshjen e konsorciumit ñLò SH.P.K. (%41.7) & ñEò France (%25) & ñA.L.S B.Vò (%33.3) Holandë, ku natyrisht ndryshojnë dhe kushtet e vlerësimit të cilat në shumicën e detyrimeve i takojnë atij për ti përmbushur si nga ana ligjore dhe financiare. Sa më lart është qartësuar me dokumentacionin e mëposhtëm ku nga auditimi i dokumenteve të paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës **rezulton**: - Certifikata e regjistrimit në datën 07.05.2008 me nr. 70491729 për shoqërinë ñPò sh.p.k. Republika e Kosovës ortaku i vetëm J. K. - Me numrin unik të identifikimit të subjektit J...A në datën 01.07.1996 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit ñPò SH.P.K ortaku i vetëm J. K.; - Me numrin unik të identifikimit të subjektit L....D në datën 12.11.2012 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit ñP.Mò SH.P.K ortaku i vetëm J. K. - Me numrin unik të identifikimit të subjektit K....C në datën 12.06.2006 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit ñP-Vò SH.P.K me ortakët L.K me 50% të aksioneve dhe J. K me 50% të aksioneve. - Me numrin unik të identifikimit të subjektit K...A në datën 02.10.2007 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit ñLò SH.P.K ortaku i vetëm J. K. -Për sa konstatohet me dokumentet e mësipërme dy nga operatorët e këtij BOE. ñLò SH.P.K (%41.7) dhe ñA.L.S B.Vò i cili sqaron se në bazë të dokumenteve të paraqitura UBO (*ultimate beneficiary owner*) (*Pronari i fundit përfitues*) është ñPò SH.P.K ***janë kompani shqiptare me ortak të vetëm J. K më 100% të aksioneve.*** -Sa më lart kualifikimi i BOE ñLò SHPK (%41.7) & ñEò France (%25) & ñA. L. S			

	B.Vò (%33.3) Holandë është në kundërshtim me Dokumentet e Procedurës Konkurruese të miratuara në pikën 3 ñ*Procedurat konkurruese*ò nënpika 3.16 ñ*Bashkimi i shoqërive*ò pika 3.16.4. ***-Për këtë arsye Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 417, dt. 02.10.2015 duhej të kishte skualifikuar bashkimin e operatorëve të mësipërm.*** *(Më hollësisht trajtuar në faqe 270 – 290 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*			
15	Nga auditimi i kontratës së partneritetit publik privat ñPër ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësorëò rezultoi se deri më 21.05.2021 është likuiduar vetëm një faturë në shumën prej 30,670,190.00 lekë për koncesionarin në QSUNT. Konstatuam se: **1**.Kontrata për partneritetin publik privat është nënshkruar dy vite më vonë, pas dërgimit të raportit mbi propozimin e përzgjedhjes së ofertës së suksesshme tek Titullari i Autoritet Kontraktor. Këto ndryshime në afate nuk janë reflektuar në kontratë. Rezultoi që të gjitha spitalet universitare dhe ato referuese, i kanë lidhur Marrëveshjet e Ndërveprimit më vonë se data e parashikuar. **2**.Si rezultat i situatës së krijuar nga tërmeti i nëntorit 2019, gjendjes së krijuar nga pandemia, si dhe mos regjistrimit të aseteve nga spitalet referuese, data e synuar e komisionimit është shtyrë jo më vonë se data 21.06.2020 dhe për të gjithë laboratorët e tjerë, jo më vonë se data 28.01.2021. Aktualisht shërbimi laboratorik po realizohet nga Koncesionari në Qendren Universitare Spitalore "Nene Tereza", në Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik ñKoco Glozheniò, në Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik ñMbreteresha Geraldinë, në Spitalin Universitar të Traumës dhe në Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò. Në spitalet bashkiake të Lushnjës, Sarandës, në spitalin rajonal të Vlorës dhe Korçës kanë përfunduar përshtatja dhe rregullimi i ambienteve dhe po punohet për instalimin e aparaturave. **3**.Nga implementimi i kësaj kontrate, në laboratorin e QSUNT rezultoi se, sipas Shtojcës nr.5, pika 3, *Grafiku i planit të rekrutimit* për QSUNT, për vitin e parë të zbatimit të kontratës kërkon punësimin pranë koncesionarit të total 99 punonjësve, nga të cilët 13 mjekë, 80 teknikë laboratori	288-308	I LARTË	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për monitorim mbi zbatimin e kontratës koncesionare, dhe në rastet kur janë të parashikuara penalitete të aplikohen, me qëllim përmirësimin e performancës në ofrimin e shërbimeve laboratorike publike, si dhe për minimizimin apo eleminimin e risqeve të drejtëpërdrejta e të terthorta që mund të ndikojnë në buxhetin e shtetit.

	dhe 6 sanitarë; ndërsa nga auditimi u konstatuan se vetëm 48 nga këta punonjës janë transferuar në koncesionar. Në vijim rezultoi se, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucioni epror ndaj Qendrave Universitare Spitalore, Spitaleve Rajonale dhe atyre bashkiake, **nuk** ka kryer raporte periodike të monitorimit mbi zbatimin e kontratës koncesionare dhe ligjit nr.125/2013 ñPër koncesionet dhe parteritet publik privatò neni 10, pika 4,5. Në veçanti, nga verifikimi i raporteve të monitorimit të realizuara nga QSUNT rezultoi se: **1**.Janë përgatitur dy relacione për muajin Dhjetor 2020: relacioni mbi monitorimin sasior, dhe ai mbi monitorimin cilësor të aktivitetit laboratorik. Grupi i punës i ka hartuar relacionet, duke u bazuar në verifikimet në terren si dhe në bazë të përzgjedhjeve rastësore të disa shërbimeve mjekësore, konkretisht në Gastrohepatologji, në Hematologji, në Urgjencën Pediatrike, në Neurologji dhe në Stroke Post Stroke, duke konkluduar se: (i) nuk është raportuar saktë dhe me përgjegjshmëri numri i ekzaminimeve laboratorike të referuara dhe ato të kryera (përgjigjet). Në shumë raste përgjigja e analizave ka mbërritur në shërbim pasi pacienti i hospitalizuar ka lënë shërbimin, me një diferencë prej 914 analiza, të cilat nuk janë pasqyruar në raportin përfundimtar të shërbimeve; (ii) shumë mjekë janë regjistruar në sistemin LIS (*laboratory informacion system*) të Shoqërisë konçesionare në shërbimet e gabuara, duke sjellë vonesa apo mosdorëzim në shërbimin e duhur të përgjigjeve të analizave duke çuar deri mos referimin e tyre si analiza të kryera në raportimet mujore; (iii) nga ana e shoqërisë koncesionare janë pranuar dhe janë realizuar ekzaminime laboratorike, me formularë të cilët nuk përmbajnë elementët bazë të identifikimit. Për këtë arsye 43 ekzaminime biokimike të kryera nga laboratori nuk janë raportuar nga Shërbimi i Gastrohepatologjisë. Sa më sipër, formularët e parregullt sipas Kontratës së Ndërveprimit nuk duheshin pranuar dhe ekzekutuar nga ana e shoqërisë koncesionare; (iv) Referuar Kontratës së ndërmjetësimit, pika VII ñ*Standardet e shërbimit*ò ku ñ*Koncesionari duhet të respektojë kohën e propozuar për daljen e rezultateve për çdo analizë, qoftë rutinë apo në kushte urgjence, kohë 30 min....*ò, konstatuam se,			

	nga ana e shoqërisë konçesionare, jo gjithmonë, është respektuar koha maksimale për daljen e rezultatit, për të cilat duhej të aplikohej penalitet të parashikuar në kontratën koncesionare. **2**.Diferenca të konsiderueshme kanë rezultuar edhe në faturimin e analizave laboratorike nga shoqëria konçesionare, gjatë raportimit të ekzaminimeve laboratorike si Imunfenotipet dhe CD4 të cilat kryhen me markera të ndryshëm. Ndërsa Laboratori i faturon sipas kontratës me nr. markerash të kryer për çdo analizë, shërbimet mjekësore i raportojnë si një analizë e vetme. Në përfundim, konkluduam, se MSHMS, në rolin e institucionit epror, nëpërmjet Komitetit Ndërlidhës, **nuk** ka monitoruar ecurinë periodike të kontratës koncesionare në qendrat spitalore universitare, spitalet referuese dhe ato bashkiake. Vecanërisht, pas raportimeve të QSUNT mbi monitorimin periodik të kryer për periudhën Nëntor, Dhjetor 2020, **nuk** ka marrë asnjë masë për verifikimin e mëtejshëm të parregullsive të konstatuara nga grupet e punës së QSUNT, me qëllim korrigjimin e tyre, nxjerrjen e përgjegjësive dhe aplikimin e penaliteteve për rastet e konstatuara me devijime nga kushtet e kontratës koncesionare.			

3.Konluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Nga auditimi në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,u konstatuan problematikat si vijon:

- Pasqyrat Financiare për vitin 2019 dhe vitin 2020 përfshijnë vetëm ñTë drejtatò dhe ñDetyrimetò e ish Ministrisë së Shëndetësisë duke mos përfshirë në të, treguesit financiarë të ish Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, duke sjellë si pasojë jo vetëm mosnjohje dhe moskontabilizim të saktë dhe të plotë të të drejtave dhe detyrimeve të subjketit, por edhe siguri të kufizuar në konfirmimin e pohimit të ekzistencës së tyre, duke bërë një pasqyrim të mangët dhe jo real të bilancit kontabël.
- Nga auditimi u konstatua se, të gjitha sistemet e IT-së, janë ende pjesë e regjistrit të kontabilitetit të MSHMS. Mes MSHMs dhe AKSHI-t nuk është nënshkruar një marrëveshje ku të përcaktohen përgjegjësitë e ndërsjellta lidhur me këto sisteme.
- Kemi konstatuar mospasqyrim të saktë ne kontabilitet, (konkretisht ne vlerën 0) të makinave që janë në përdorim, duke mbartur risk për mosgjurmim të aktiveve, vecanërisht në raste të humbjes apo vjedhjes së tyre.
- Grupi i auditimit nuk jep dot siguri të arsyeshme mbi aktivet e MSHMS pasi

a. Nga analizimi i Regjistri i Aktiveve të MSHMS për vitin 2019, rezulton se në kundërshtim me pikën 26, 28 dhe 30 Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, <u>ai nuk përmban një informacion të plotë mbi aktivet e institucionit,</u>

b. Inventarizimi i aseteve të Aparatit të MSHMS është bërë mbi gjendjen fizike të aseteve, **pa** bërë krahasimin me gjendjen kontabël, duke **mos** identifikuar dhe analizuar diferenca midis gjendjes fizike dhe asaj kontabël. Nga auditimi u konstatuan diferenca në aktive në vlerën **227,612,894**

lekë;

c. Nga auditimi u konstatua se, në Regjistrin e Aktiveve nuk janë reflektuar ende aktivet e ish-MMRS-së. Përveç tyre, u konstatua edhe aktive të MSHMS-së në vlerën 5,566,024 lekë, të cilat kanë rezultuar nga inventarizimi dhe që nuk janë përfshirë në këtë Regjistër

d. Nga auditimi u konstatuan gjithashtu diferenca midis kostos historike të mjeteve të transportit të regjistruar në Regjistrin e Aktiveve (16,829,991 lekë) dhe kostos historike të mjeteve të transportit sipas inventarizimit (45,009,380 lekë

e. U konstatuan diferenca midis sistemeve elektronike të regjistruara në Regjistrin e Aktiveve në 269,302,755 lekë dhe vlerës për të cilën është shprehur grupi i inventarizimit (75,435,274 lekë).

- Për vitin 2020, në raportimin për Thesarin, si dhe në Pasqyrat Financiare të MSHMS, janë njohur detyrime të prapambetura vetëm për largime të padrejta nga puna në vlerën 27,150,000 lekë, ndërsa nga auditimi rezultoi se, në fakt detyrimi i prapambetur për këtë vit ishte të paktën 33,878,384 lekë[4], ose 6,728,384 lekë (20%) më shumë detyrime se ato të njohura në Pasqyrat Financiare të MSHMS dhe të raportuara në MFE.
- MSHMS ka raportuar në MFE detyrime të prapambetura të shlyera në vlerë 9,224,000 lekë, më burim krijimi vendime gjyqësore për largime të padrejta nga puna; ndërsa nga auditimi rezultoi se, **detyrimet realisht të shlyera janë në vlerën 42,486,262 lekë pra 33,262,262 lekë më shumë ose 360% më shumë se ato të raportuara si të shlyera në MFE** dhe **jo** vetëm për vendime gjyqësore për largime të padrejta nga puna, **por** edhe për vendime të tjera gjyqësore, si p.sh. vendim gjyqësor i Spitalit Gjirokastër, apo vendime gjyqësore për fatura të papaguara nga ish-MMRS.
- Nga auditimi u konstatuan shpenzime pa efektivitet në buxhetin e shtetit në vlerë 74,521,023 lekë, prej të cilave 23,945,042 në vitin 2019 dhe 50,575,981 në vitin 2020, për likuidimin e vendimeve gjyqësore
- Nga auditimi u konstatua dëm ekonomik ne vlerën 3,695,819 lekë për likuidim e tarifave përmbarimore për vendime gjyqësore të formës së prerë të ish-MMRS prej të cilave, 1,028,079 lekë të paguara në vitin 2019, dhe 2,667,740 lekë të paguara në vitin 2020.
- konstatuam likuidime të shpenzimeve pa dokumentacion justifikues bashkëlidhur, duke shkaktuar shpenzime pa efektivitet në buxhetin e shtetit në vlerë 1,058,000 lekë.
- MSHMS, për furnizime me mallra anti Covid, ka vijuar me procedura prokurimi të drejtpërdrejta dhe **nuk** i është referuar Ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar, Neni 33, dhe VKM nr. 914, dt. 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar neni 36, ñProcedura me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratësò pika 2/c,ò, edhe pse plotësohen të gjitha kushtet një nevoje ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, e që nuk i ngarkohen autoritetit kontraktor.
- Kontratat, produkte të VKM nr.203, datë 26.02.2020ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetitò i ndryshuar, janë miratuar me VKM respective, duke filluar nga 7 ditë deri në 10 dhjetë ditë më vonë nga data e lidhjes së kontratës **duke bërë që të humbas "faktori kohë"**, i cili është baza për përdorimin e procedurës që përdoret për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shteti.
- VKM nr. 203 nuk ka përcaktuar përkufizimin e gjendjes, rrethanave, apo rasteve kur kemi të bëjmë me ñinteresa thelbësorë të shtetitò por këto rrethana i ka lënë rast pas rasti në vlerësim të autoriteteve kontraktore. Pra, në kushtet kur termi ñinteresa thelbësorë të shtetitò nuk ka gjetur një rregullim ligjor, ngelet një situatë e paqartë, e pa përkufizuar dhe në vlerësimin subjektiv të çdo autoriteti duke rritur riskun për arbitraritet.

[4] Themi se ñdetyrimi ishte të **paktën** 33,878,384 lekëò pasi në këtë vlerë nuk janë përfshirë detyrimet e rrjedha nga vendimet e formës së prere të viteve 2011, 2013 për dy gjyqfitues të larguar padrejtësisht nga puna zj. S. L, dhe z. N. Z, të cilat nuk ishin reflektuar në data bazën e detyrimeve të DBMF, dhe grupi i auditimit nuk mundi të përllogariste detyrimet e tyre.

- VKM nr 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar, pika IV-2 ñProcedura e drejtëpërdrejtëò dhe pika V, **nuk** ka të përcaktuar: mënyrën e përllogaritjes së fondit limit
- Si pasojë e procedurave të përzgjedhura si dhe vakumeve ligjore tëVKM nr. 203 datë 26.02.2020, disa procedura rezultuan jo efektive, **duke mos siguruar pajisjet mjekësore e domosdoshme per situatën Covid 19** (sic janë respiratorët), apo duke sjellë dështimin e disa procedurave[5]
- Nga auditimi rezultoi se, Komisioni i Vlerësimit (KV), në dy procedura[6], ka negociuar afatet e lëvrimit të mallit, në kundërshtim me afatet e përcaktuara në dokumentacionin ñFtesë për ofertëò, **duke denatyruar njëkohësisht edhe nevojën për përzgjedhjen e "procedures së drejtpërdrejtë**ò, përzgjedhur kjo nga KV dhe miratuar nga Titullari i autoritetit kontraktor. Përzgjedhja e ñprocedurës së drejtpërdrejtëò, në kushtet kur afatet për lëvrimin e mallit rezultojnë të realizueshme edhe me procedura të tjera prokurimi, ka denatyruar ñkonceptin e emergjencësò ndaj nevojës për materialet për Covid-19.
- Si pasojë e furnzimimit të vonuar dhe/ose mosfurnzimit për kontratën me objekt ñFurnizim vendosje respiratore me dy modalitete per adulte dhe moshe pediatrike per Covid -19ò, kemi konstatuar **të ardhura të munguara** në buxhetin e shtetit nga mosllogaritja e penaliteteve dhe mos mbajtja e sigurimit të kontratës në shuëmn **15,378,960 lekë**
- Si pasojë e furnzimimit të vonuarkemi konstatuar **të ardhura të munguara** në buxhetin e shtetit nga mosllogaritja e penaliteteve në shumën **1,870,231 lekë** për kontratat më objekt: Blerje materiale për mbrojtje personale (MMP) për Covid-19ò; Spostimi i sistemit të dializës nga Pediatria e Specialiteteve tek godina e Spitalit Infektiv (Shërbimi i Alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me Covid-19ò; ñBlerje kite dhe reagent të përshtatshëm për të përdorur në pajisje Maglum 800 Snibe CoLtd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për Covid-19ò; dhe ñBlerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHPò

- Për procedurën e prokurimit me objekt: ñ**Blerje monitor pacienti për masat anti Covid-19"** për të cilin është lidhur kontrata me nr 2587/6, datë 17.06.2020 dhe **vlerë 54,905,000 lekë pa tvsh,**rezultoi se janë trajtuar si devijime të vogla, ndryshime në karakteristika të mallit të cilat në fakt **nuk** janë të tilla referuar Ligji i Prokurimit Publik, duke ndryshuar materialisht specifikimet për monitorët (konkretisht parashikimi në DST: (1) i një **rezulocioni më të lartë** i cili më pas rezulton të jetë pranuar më i vogël, duke u trajtuar si ñdevijim i vogëlò; dhe (2) i **ndërfaqes së integruar të protokollit DIAP,** e cila më pas rezulton të jetë ndryshuar dhe pranuar në HL7, u trajtuar si ñdevijim i vogëlò); si edhe duke shkelur parimin e barazisë, duke i vendosur OE-të në pozita jo të barabarta përgjatë fazës së përgatitjes së ofertave dhe si pasojë edhe gjatë vlerësimit të ofertës.
- Problematika të konstatuara në procedurën e hapur të prokurimit, me objekt ñRikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranëò si vijon:

a.Projekti Teknik është realizuar ngaInstituti i Ndërtimit, si rezultat i bashkëpunimit me SUOGJ ñMbretëresha Geraldinëò (SUOGJ - MG), **dhe jo** nëpërmjet një procesi të hapur të përzgjedhjes në bazë të rregullave të prokurimit publik, duke shmanguar procedurat e prokurimit si dhe duke eliminuar garën dhe transparencën për realizimin e hartimit të projektit teknik

b. Në kushtet kur projekti teknik është hartuar nga Instituti i Ndërtimit (IN), kemi vlerësuar se

[5] ñ*Blerje Barna Anti Covid -19" ndarë në 10 Lote* , me fond limit total 36,812,915 lekë; dhe ñ*Trajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19*ò, me fond limit në vlerën prej 3,144,150 lekë pa tvsh.

[6] ñ*Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19*ò me fond limit 129,727,371 lekë pa tvsh, dhe *Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHP"*e ndarë në 4 Lote, me fond limit në vlerën prej 29,008,273 lekë.

oponenca teknike (potencialisht mendimi ndryshe) nuk duhet të kryhej nga i njëjti institucion pra IN.

c.Pas tërmetit të Nëntorit 2019, kemi konstatuar se, në Akespertizën e datës 19.02.2020, anëtarët e grupit nuk janë shprehur si ka qënë gjendja e godinave para dhe pas termetit dhe për rrjedhojë as për ndryshimet në efektet financiare që mund të ketë pësuar preventivi teknik i hartuar nga vetë IN, kjo në kundërshtim me Aktin Normatin nr.9 datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò neni 34 paragrafi 2.Gjithashtu, konstatuam se anëtaret e grupit që kanë hartuar Aktekspertizën e datës 19.02.2020, janë në konflikt të interesit me detyrat që kanë realizuar, pasi njëkohësisht kanë qenë edhe anëtarë të grupit të hartimit të projektimit Teknik.

d. Procedura e hapur me objekt ñRikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranëò me fond limit në vlerën prej 668,493,718.32 lekë pa tvsh, është fituar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ñA. K.ò shpk & ñB.ISò shpk me vlerë të ofertës fituese rreth 28 % më e ulët se vlera e fondi limit (ofertë anomalisht e ulët) prej 466,395,123.98 lekë pa tvsh. Sa më sipër Në kushtet kur, nga auditimi i zërave të Projektit Teknik rezultuan zëra në vlerën totale prej **149,418,232 leke me analiza çmimesh**, por pa asnjë listë e hollësishme çmimesh për të argumentuar dhe mbështetur vlerën, nën gjykimin e pavaruar të audituesit tregon për fryrje fiktive të fondit limit

e.U konstatua **mbivendosje punimesh** me efekt financiar dëm ekonomik ne shumen **1,331,384 leke**, ne procedurën e hapur me objekt ñRikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranëò

-Konstatuam diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin ñRikonstruksioni i shërbimit të reanimacionit të Spitalit Rajonal Vlorëò, me pasojë **dëm ekonomik** në buxhetin e shtetit **prej 2,349,902 lekë.**

- Konstatuam diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin ñLoti I, Rikonstruksione të QSH-ve në qarqet Tiranë, Durrës, Dibër (viti 2020)ò, me pasojë**dëm ekonomik** në buxhetin e shtetit prej **1,373,684 lekë pa tvsh.**

- Nga auditimi rezultoi se, vlera prej **16,751,138 lekë** e fondeve të akorduara për përballimin e situatës së krijuar nga Covid -19, kanë ndryshuar destinacionin, dhe janë angazhuar për të shlyer detyrime që kanë rrjedhur nga kontrata ose projekte të nisura më parë, nga të cilat: 15,791,138 lekë alokuar për të shlyer detyrime të prapambetura ; dhe 960,000 lekëalokuar për blerje pajisje kompjuterike të planifikuar që në PBA 2020-2022 (përpara situatës së pandemisë.

- Nga auditimi rezultoi se, VKM nr. 753, datë 30.11.2019 ñPër përkrahjen sociale dhe financiare të familjeve të viktimave të tërmetit të datës 26.11.2019ò, e cila parashikon mbështetjen financiare të familjarëve të viktimave të tërmetit të nëntorit 2019, **nuk ka bashkëlidhur listën e familjeve përfituese**, dhe për këtë grupi i auditimit nuk mund të japë siguri të arsyeshme nëse familjet e mbështetura financiarisht janë në fakt ato familje, të cilat kanë humbur të afërmit e tyre nga tërmeti. Sa më sipër thellohet edhe më tej pasi në asnjë rast, kërkesat dhe dokumentet e përcjella nga familjarët e viktimave të tërmetit për përfitimin e ndihmës financiare nuk janë depozituar në protokollin e institucionit, por janë përcjellë dorazi pranë DBMF në MSHMS duke mos siguruar kështu gjurmë mbi kërkesat, dokumentet e dorëzuara dhe kohën e dorëzimit të tyre, në kundërshtim kjo dhe me ligji nr.9154, datë 6.11.2003 ñPër Arkivatò.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare (*Opinion i Kundërt*)

Opinion mbi pasqyrat financiare (i Kundërt[7])

[7] *Sipas rregullores së procedurave të auditimit të KLSH, opinion i kundërt, jepet në ato raste kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mosrespektimit të cilat janë materiale individualisht ose së bashku janë përhapur në llogaritë vjetore apo transaksionet.*

Ne audituam pasqyrat financiare të subjektit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilat përbëhen nga Pozicioni Financiar, Performanca Financiare, Pasqyra e Fluksit të Arkës, Fondet neto, Investimet e Aktivet Afatgjata si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat.
Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të kundërt për llogaritë vjetore të subjektit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2020.

Baza për Opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin *"Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare"*, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10 ñDeklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-tò, si dhe ISSAI 130 ñKodi Etikò, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI 5000 Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare-Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura.
Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të kundërt të auditimit**.
Në përfundim konkludojmë sa vijon:
- Pasqyrat Financiare për vitin 2019 dhe vitin 2020 përfshijnë vetëm "Të drejtat" dhe "Detyrimet" e ish Ministrisë së Shëndetësisë duke mos përfshirë në të, treguesit financiarë të ish Ministrisë së Mbrojtjes Sociale dhe Rinisë, duke sjellë si pasojë jo vetëm mosnjohje dhe moskontabilizim të saktë dhe të plotë të të drejtave dhe detyrimeve të subjektit, por edhe siguri të kufizuar në konfirmimin e pohimit të ekzistencës së tyre.
- Nga auditimi u konstatua se, të gjitha sistemet e IT-së, janë ende pjesë e regjistrit të kontabilitetit të MSHMS. Mes MSHMS dhe AKSHI-t nuk është nënshkruar një marrëveshje ku të përcaktohen përgjegjësitë e ndërsjellta lidhur me këto sisteme.
- Kemi konstatuar mospasqyrim të saktë ne kontabilitet, (konkretisht ne vlerën 0) të makinave që janë në përdorim, duke mbartur risk për mosgjurmim të aktiveve, vecanërisht në raste të humbjes apo vjedhjes së tyre.
- KLSH nuk jep dot siguri të arsyeshme mbi aktivet e MSHMS pasi
a. *Nga analizimi i Regjistri i Aktiveve të MSHMS për vitin 2019, rezulton se në kundërshtim me pikën 26, 28 dhe 30 Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, ai nuk përmban një informacion të plotë mbi aktivet e institucionit,*
b. *Inventarizimi i aseteve të Aparatit të MSHMS është bërë mbi gjendjen fizike të aseteve,* ***pa*** *bërë krahasimin me gjendjen kontabël, duke* ***mos*** *identifikuar dhe analizuar diferenca midis gjendjes fizike dhe asaj kontabël. Nga auditimi u konstatuan diferenca në aktive në vlerën* ***227,612,894 lekë;***
c. *Nga auditimi u konstatua se, në Regjistrin e Aktiveve nuk janë reflektuar ende aktivet e ish-MMRS-së. Përveç tyre, u konstatua edhe aktive të MSHMS-së në vlerën 5,566,024 lekë, të cilat kanë rezultuar nga inventarizimi dhe që nuk janë përfshirë në këtë Regjistër*
d. *Nga auditimi u konstatuan gjithashtu diferenca midis kostos historike të mjeteve të transportit të regjistruar në Regjistrin e Aktiveve (16,829,991 lekë) dhe kostos historike të mjeteve të transportit sipas inventarizimit (45,009,380 lekë*
e. *U konstatuan diferenca midis sistemeve elektronike të regjistruara në Regjistrin e Aktiveve në 269,302,755 lekë dhe vlerës për të cilën është shprehur grupi i inventarizimit (75,435,274 lekë).*
- Për vitin 2020, në raportimin për Thesarin, si dhe në Pasqyrat Financiare të MSHMS, janë njohur detyrime të prapambetura vetëm për largime të padrejta nga puna në vlerën 27,150,000

lekë, ndërsa nga auditimi rezultoi se, në fakt detyrimi i prapambetur për këtë vit ishte të paktën 33,878,384 lekë[8]*, ose 6,728,384 lekë (20%) më shumë detyrime se ato të njohura në Pasqyrat Financiare të MSHMS dhe të raportuara në MFE.*
- MSHMS ka raportuar në MFE detyrime të prapambetura të shlyera në vlerë 9,224,000 lekë, më burim krijimi vendime gjyqësore për largime të padrejta nga puna; ndërsa nga auditimi rezultoi se, ***detyrimet realisht të shlyera janë në vlerën 42,486,262 lekë pra 33,262,262 lekë më shumëose 360% më shumë se ato të raportuara si të shlyera në MFE*** *dhe* ***jo*** *vetëm për vendime gjyqësore për largime të padrejta nga puna,* ***por*** *edhe për vendime të tjera gjyqësore, si p.sh. vendim gjyqësor i Spitalit Gjirokastër, apo vendime gjyqësore për fatura të papaguara nga ish-MMRS.*
- Nga auditimi u konstatuan shpenzime pa efektivitet në buxhetin e shtetit në vlerë 74,521,023 lekë, prej të cilave 23,945,042 në vitin 2019 dhe 50,575,981 në vitin 2020, për likuidimin e vendimeve gjyqësore
- Nga auditimi u konstatua dëm ekonomik ne vlerën 3,695,819 lekë për likuidim e tarifave përmbarimore për vendime gjyqësore të formës së prerë të ish-MMRS prej të cilave, 1,028,079 lekë të paguara në vitin 2019, dhe 2,667,740 lekë të paguara në vitin 2020.
- konstatuam likuidime të shpenzimeve pa dokumentacion justifikues bashkëlidhur, duke shkaktuar *shpenzime pa efektivitet në buxhetin e shtetit në vlerë 1,058,000 lekë.*

Opinion mbi përputhshmërinë (*Opinion i kundërt*[9])

Në bazë të punës së kryer, grupi auditoi përputhshmërinë, mbi zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe respektimin e strukturave organike të miratuara, mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, mbi zbatimin e legjislacionit në lidhje mbi ri-auditimin për realizimin, e procedurave për blerjen e barnave, pajisjeve, materialeve mjekesore për të përballuar situatën e krijuar nga Covid-19 të realizuara në bazë të VKM nr. 203 datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetitò i ndryshuar, realizimin ekzekutimin dhe monitorimin e procedurave të prokurimit publik, etj.
Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e ñBazës për Opinioninò, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kundërt.

<u>Baza për opinionin e përputhshmërinë</u>

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-t). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin *"Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë"*, pjesë e projektraportit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130- Kodi Etik, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 òStandardi i Auditimit të Përputhshmërisëò si dhe në mbështetje të Kodit të Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 27, datë 20.04.208. Dokumentacioni administrativ, procedurat e realizuar sipas VKM nr.203 datë 26.02.2020 dhe procedurat prokuruese, etj, janë përzgjedhur, mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit,

[8] *Themi se "<u>detyrimi ishte të **paktën** 33,878,384 lekë"</u> pasi në këtë vlerë nuk janë përfshirë detyrimet e rrjedha nga vendimet e formës së prere të viteve 2011, 2013 për dy gjyqfitues të larguar padrejtësisht nga puna zj. S.L, dhe z. N. Z., të cilat nuk ishin reflektuar në data bazën e detyrimeve të DBMF, dhe KLSH nuk mundi të përllogariste detyrimet e tyre.*
[9] *Sipas rregullores së procedurave të auditimit të KLSH, opinion i kundërt, jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e majftueshme dhe e plotë, por devijimet e pajtueshmërisë janë materiale dhe të përhapura.*

përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të vendim marrjes nga MSHMS, me kriteret e parashikuara.
Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një nivel të arsyeshëm për dhënien **e opinionit i kundërt**[10]
Në vijim konstatuam sa më poshtë:
- MSHMS, për furnizime me mallra anti Covid, ka vijuar me procedura prokurimi të drejtpërdrejta dhe ***nuk*** *i është referuar Ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, Neni 33, dhe VKM nr. 914, dt. 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar neni 36, "Procedura me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës" pika 2/c,", edhe pse plotësohen të gjitha kushtet një nevoje ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, e që nuk i ngarkohen autoritetit kontraktor.*
- Kontratat, produkte të VKM nr.203, datë 26.02.2020"Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit" i ndryshuar, janë miratuar me VKM respective, duke filluar nga 7 ditë deri në 10 dhjetë ditë më vonë nga data e lidhjes së kontratës ***duke bërë që të humbas "faktori kohë"****, i cili është baza për përdorimin e procedurës që përdoret për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shteti.*
- VKM nr. 203 nuk ka përcaktuar përkufizimin e gjendjes, rrethanave, apo rasteve kur kemi të bëjmë me "interesa thelbësorë të shtetit" por këto rrethana i ka lënë rast pas rasti në vlerësim të autoriteteve kontraktore. Pra, në kushtet kur termi "interesa thelbësorë të shtetit" nuk ka gjetur një rregullim ligjor, ngelet një situatë e paqartë, e pa përkufizuar dhe në vlerësimin subjektiv të çdo autoriteti duke rritur riskun për arbitraritet.
- VKM nr 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar, pika IV-2 "Procedura e drejtëpërdrejtë" dhe pika V, ***nuk*** *ka të përcaktuar: mënyrën e përllogaritjes së fondit limit*
- Si pasojë e procedurave të përzgjedhura si dhe vakumeve ligjore të VKM nr. 203 datë 26.02.2020, *disa procedura rezultuan jo efektive,* ***duke mos siguruar pajisjet mjekësore e domosdoshme per situatën Covid 19*** *(sic janë respiratorët), apo duke sjellë dështimin e disa procedurave*[11]
- Nga auditimi rezultoi se, Komisioni i Vlerësimit (KV), në dy procedura[12]*, ka negociuar afatet e lëvrimit të mallit, në kundërshtim me afatet e përcaktuara në dokumentacionin "Ftesë për ofertë",* ***duke denatyruar njëkohësisht edhe nevojën për përzgjedhjen e "procedures së drejtpërdrejtë****", përzgjedhur kjo nga KV dhe miratuar nga Titullari i autoritetit kontraktor. Përzgjedhja e "procedurës së drejtpërdrejtë", në kushtet kur afatet për lëvrimin e mallit rezultojnë të realizueshme edhe me procedura të tjera prokurimi, ka denatyruar "konceptin e emergjencës" ndaj nevojës për materialet për Covid-19.*
- Si pasojë e furnzimimit të vonuar dhe/ose mosfurnzimit për kontratën me objekt "Furnizim vendosje respiratore me dy modalitete per adulte dhe moshe pediatrike per Covid -19", kemi konstatuar ***të ardhura të munguara*** *në buxhetin e shtetit nga mosllogaritja e penaliteteve dhe mos mbajtja e sigurimit të kontratës në shumën* ***15,378,960 lekë.***
- Si pasojë e furnzimimit të vonuar kemi konstatuar ***të ardhura të munguara*** *në buxhetin e shtetit nga mosllogaritja e penaliteteve në shumën* ***1,870,231 lekë*** *për kontratat më objekt: Blerje kite dhe reagentë për Laboratorin Mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisjen e Existation të firmës Bioner ose ekuivalent; Spostimi i sistemit të dializës*

---

[11] ñ*Blerje Barna Anti Covid -19" ndarë në 10 Lote* , me fond limit total 36,812,915 lekë; dhe ñ*Trajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19*ò, me fond limit në vlerën prej 3,144,150 lekë pa tvsh.
[12]ñ*Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19*ò me fond limit 129,727,371 lekë pa tvsh, dhe *Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHP"*e ndarë në 4 Lote, me fond limit në vlerën prej 29,008,273 lekë.

nga Pediatria e Specialiteteve tek godina e Spitalit Infektiv (Shërbimi i Alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me Covid-19"; "Blerje kite dhe reagent të përshtatshëm për të përdorur në pajisje Maglum 800 Snibe CoLtd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për Covid-19"; dhe "Blerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHP"

*- Për procedurën e prokurimit me objekt: "**Blerje monitor pacienti për masat anti Covid-19"** për të cilin është lidhur kontrata me nr 2587/6, datë 17.06.2020 dhe **vlerë 54,905,000 lekë pa tvsh,** rezultoi se janë trajtuar si devijime të vogla, ndryshime në karakteristika të mallit të cilat në fakt **nuk** janë të tilla referuar Ligji i Prokurimit Publik, duke ndryshuar materialisht specifikimet për monitorët (konkretisht parashikimi në DST: (1) i një **rezulocioni më të lartë** i cili më pas rezulton të jetë pranuar më i vogël, duke u trajtuar si "devijim i vogël"; dhe (2) i **ndërfaqes së integruar të protokollit DIAP,** e cila më pas rezulton të jetë ndryshuar dhe pranuar në HL7, u trajtuar si "devijim i vogël"); si edhe duke shkelur parimin e barazisë, duke i vendosur OE-të në pozita jo të barabarta përgjatë fazës së përgatitjes së ofertave dhe si pasojë edhe gjatë vlerësimit të ofertës.*

- Problematika të konstatuara në procedurën e hapur të prokurimit, me objekt "Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë" si vijon:

a. Projekti Teknik është realizuar nga Instituti i Ndërtimit, si rezultat i bashkëpunimit me SUOGJ ñMbretëresha Geraldinëò (SUOGJ - MG), **dhe jo** nëpërmjet një procesi të hapur të përzgjedhjes në bazë të rregullave të prokurimit publik, duke shmangur procedurat e prokurimit si dhe duke eleminuar garën dhe transparencën për realizimin e hartimit të projektit teknik, për pasojë vlera prej ***13,200,351 lekë*** me tvsh, është menaxhuar jo në përputhshmëri.

b. Në kushtet kur projekti teknik është hartuar nga Instituti i Ndërtimit (IN), kemi vlerësuar se oponenca teknike (potencialisht mendimi ndryshe) nuk duhet të kryhej nga i njëjti institucion pra IN.

c. Pas tërmetit të Nëntorit 2019, kemi konstatuar se, në Aktespertizën e datës 19.02.2020, anëtarët e grupit nuk janë shprehur si ka qenë gjendja e godinave para dhe pas tërmetit dhe për rrjedhojë as për ndryshimet në efektet financiare që mund të ketë pësuar preventivi teknik i hartuar nga vetë IN, kjo në kundërshtim me Aktin Normatin nr.9 datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò neni 34 paragrafi 2. Gjithashtu, konstatuam se anëtarët e grupit që kanë hartuar Aktekspertizën e datës 19.02.2020, janë në konflikt të interesit me detyrat që kanë realizuar, pasi njëkohësisht kanë qenë edhe anëtarë të grupit të hartimit të projektimit Teknik.

d. Procedura e hapur me objekt ñRikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranëò me fond limit në vlerën prej 668,493,718.32 lekë pa tvsh, është fituar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ñA.Kò shpk & ñB-Iò shpk me vlerë të ofertës fituese rreth 28 % më e ulët se vlera e fondi limit (ofertë anomalisht e ulët) prej 466,395,123.98 lekë pa tvsh. Sa më sipër, në kushtet kur, nga auditimi i zërave të Projektit Teknik, rezultuan zëra në vlerën totale prej **149,418,232 leke me analiza çmimesh**, por pa asnjë listë të hollësishme çmimesh për të argumentuar dhe mbështetur vlerën, nën vlerësimin e pavaruar të audituesit tregon për fryrje fiktive të fondit limit

e. U konstatua **mbivendosje punimesh** me efekt financiar dëm ekonomik në shumën **1,331,384 leke**, ne procedurën e hapur me objekt ñ*Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë*ò

-Konstatuam diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikonstruksioni i shërbimit të reanimacionit të Spitalit Rajonal Vlorë", me pasojë **dëm ekonomik** në buxhetin e shtetit **prej 2,349,902 lekë.**

*- Konstatuam diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Loti I, Rikonstruksione të QSH-ve në qarqet Tiranë, Durrës, Dibër (viti 2020)", me pasojë **dëm ekonomik** në buxhetin e shtetit prej **1,373,684 lekë pa tvsh***

*- Nga auditimi rezultoi se, vlera prej **16,751,138 lekë** e fondeve të akorduara për përballimin e situatës së krijuar nga Covid -19, kanë ndryshuar destinacionin, dhe janë angazhuar për të shlyer*

detyrime që kanë rrjedhur nga kontrata ose projekte të nisura më parë, nga të cilat: 15,791,138 lekë alokuar për të shlyer detyrime të prapambetura ; dhe 960,000 lekë alokuar për blerje pajisje kompjuterike të planifikuar që në PBA 2020-2022 (përpara situatës së pandemisë.
- Nga auditimi rezultoi se, VKM nr. 753, datë 30.11.2019 "Për përkrahjen sociale dhe financiare të familjeve të viktimave të tërmetit të datës 26.11.2019", e cila parashikon mbështetjen financiare të familjarëve të viktimave të tërmetit të nëntorit 2019, ***nuk ka bashkëlidhur listën e familjeve përfituese*** *sikurse kjo VKM parashikon, dhe për këtë KLSH nuk mund të japë siguri të arsyeshme nëse familjet e mbështetura financiarisht janë në fakt ato familje, të cilat kanë humbur të afërmit e tyre nga tërmeti. Sa më sipër thellohet edhe më tej pasi në asnjë rast, kërkesat dhe dokumentet e përcjella nga familjarët e viktimave të tërmetit për përfitimin e ndihmës financiare nuk janë depozituar në protokollin e institucionit, por janë përcjellë dorazi pranë DBMF në MSHMS, duke mos siguruar kështu gjurmë mbi kërkesat, dokumentet e dorëzuara dhe kohën e dorëzimit të tyre, në kundërshtim kjo dhe me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat".*

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe njësitë e varësisë së saj, janë përgjegjëse për zbatimin e veprimtarisë në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:
Përgjegjësia jonë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MSHMS si dhe njësisë së varësisë së saj, në lidhje mbi menaxhimin e fondeve buxhetore vjetorë për sigurimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues.
Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.
Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. Hyrja.
Mbështetur në ligjin nr.154/2014 datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHò, në zbatim të Programit të Auditimit nr.359/1 datë 24.04.2020 dhe Programit të ri-Auditimit nr. 121/1 prot, datë 22.01.2021, i ndryshuar me shkresat nr.121/2 prot datë 16.03.2021, nr.121/3 prot datë 18.03.2021, nr.121/4 prot datë 20.04.2021 dhe nr.121/5 prot datë 30.04.2021, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale (MSHMS), nga data 25.01.2021 deri në 21.05.2021, për periudhën e auditimit 01.01.2019 deri në 30.03.2021, u krye auditim Financiar dhe Përputhshmërie, nga grupi i auditimit me përbërje:
1.M. Ll (*përgjegjës grupi*)
2.B. Z anëtar
3.A. K anëtar
4. V. G (*përgjegjës grupi*),
5. E. M anëtar
6. E. K anëtar
7. M. K anëtar
8. K. F anëtar
9. A. B anëtar
10. A.Z anëtar

1) Titulli:
Projektraporti i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2) Marrësi:
Ky Projektraport i adresohet Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj.O.M.

METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT
3) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:
Objektivat specifike të auditimit janë, dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të institucionit, nëse janë paraqitur saktë, në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e realizuar për përballimin e Covid-19, procedurat e prokurimeve dhe shpenzimet vjetore të buxhetit.

Qëllimi i auditimit është, vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, janë në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synim të mirëpërdorimit fondeve të financuara nga Buxheti i Shtetit.

4) Identifikimi i çështjes:
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta, në përputhje me legjislacionin përkatës,në përmbushje të misionit të saj ka për qëllim:
- Zhvillimin dhe monitorimin e politikave, të legjislacionit, të programeve e të veprimtarive që lidhen me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe treguesit shëndetësorë të popullatës;
-Zhvillimin e politikave që synojnë mbrojtjen, promovimin, integrimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies sociale të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë;
- Zhvillimin e politikave për adresimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore, të abuzimit ndaj fëmijëve, grave dhe grupeve të tjera;
- Zhvillimin e politikave dhe të modeleve për ndihmën e shërbimet shoqërore alternative për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike etj.
Gjithashtu, MSHMS e ndodhur në kushtet e një epidemie kombëtare dhe nevojave emergjente që kanë lindur për sigurimin e barnave, materialeve mjekesore, pajisjeve mjekesore, shërbime të ndryshme në pavionet e spitaleve me qëllim përshtatjen për trajtimin e të prekurve me Covid-19 të ndodhur në rrethanat e interesave thelbësore të shtetit ka përdorur VKM nr 203, datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit ò i ndryshuar meVKM nr.242 datë 22.03.2020 ñPër disa shtesa në VKM nr.203 datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësore të shtetitò, janë miratuar me qëllimin për ofrimin blerje/shërbime më të shpejta në kohë, duke krijuar garanci të proporcionalitetit në përputhje më Aktin Normativ të Qeverisë nr.243 datë 24.03.2020 ñPër shpalljen e gjendjes së Fatkeqësisë natyrore dhe Pandemia Botërore shpallur nga

OBSHò.
Komiteti i Përkohshëm për Infeksionin e përhapur nga Koronavirusi (Komiteti Teknik) i ngritur me Urdhër nr.53 datë 31.01.2020, i ndryshuar në kuadër të marrjes së masave në vazhdimësi të vlerësimit të situatës së epidemisë në Republikën e Shqipërisë, me qëllim parandalimin dhe luftimin e infeksionit të përhapur nga COVID-19, ka vlerësuar si të domosdoshme marrjen e një sërë masash për përmbushjen e nevojave me mallra dhe shërbime për të fuqizuar dhe garantuar ofrimin e shërbimit në strukturat shëndetësore spitalore publike konkretisht në QSUNT për Spitalin Covid-1 dhe me pas në QSSHN për Spitalin Covid-2. Më pas nga spitalet përkatëse janë reflektuar nevojat në bazë të kapaciteteve të shtretërve dhe të stafit të shërbimit mjekesor, për përballimin e situatës së krijuar.
Gjithë misioni zhvillohet nëpërmjet financimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit.
Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në Programin e ri-Auditimit nr. 121/1 prot, datë 02.01.2021, i ndryshuar

5) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjëse për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues, zhvillimin e një strategjie të përshtatshme për sistemin shëndetësorpër mbrojtje dhe përkujdesje sociale e shanse të barabartanë Shqipëri,forcimi i sistemit shëndetësor dhe rritjen profesionale të stafit, zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, proceduratpër qarkullim e dokumentacionit,prokurimet duke filluar nga buxhetimi i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet evlerësimit, kontraktuesi, zbatuesii kontratës, procedurat përpagesat dhe auditimin e brendshëm.

6) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:
Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MSHMS-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

7) Kriteret e vlerësimit:
-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
-Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò.
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 ñMbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare."*
- Ligji nr. 9936, datë 26,06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016
-Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò indryshuar.
- Ligji nr.114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publik.ò

-VKM nr 203, datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit òi ndryshuar meVKM nr.242 datë 22.03.2020 ñPër disa shtesa në VKM nr.203 datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësore të shtetitò.
-Aktin Normativ të Qeverisë nr.243 datë 24.03.2020 ñPër shpalljen e gjendjes së Fatkeqësisë natyrore dhe Pandemia Botërore shpallur nga OBSHò.
-Çdo bazë ligjore me të cilën është operuar për vitin 2019 dhe 2020 si dhe aktet juridike që janë në funksion për funksionimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- VKM nr. 248, datë 10.04.1998 ñPër miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyreò, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 ñPër disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998.ò
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publik.ò
- VKM nr.918 datë 29.12.2014 ñPër kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë eletronikeò
- Udhëzim e APP-së nr. 2 datë 27.01.2015 ñPër hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publikò, udhëzim e APP-së nr.2 datë 08.01.2018 ñMbi përdorimin e procedurës me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete eletronikeò i ndryshuar.
-VKM-së nr.160, datë 02.03.2016 ñPër mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike

8)Standardet e Auditimit
-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI (ISSAI)
-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) t ë IFAC
-ISSA 4000-4899 Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë
-ISSAI 400-499 Parimet e Auditit të Përputhshmërisë
- ñLibri Jeshilò i GAO-s, etj
-ISSAI 1000-2999 ñUdhëzues të Auditimit Financiarò
-ISSAI 1300 ñPlanifikimi i auditimit të pasqyrave financiareò

9)Medodat e auditimit
Auditimi ynë përfshin përputhshmërinë e aktivitetit të MSHMS, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, proceduratpër qarkullim e dokumentacionit,proçedurat e realizuara për përballimin e Covid-19, proçedurat eprokurimeve duke filluar nga buxhetimi i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet evlerësimit, kontraktuesi, zbatuesii kontratës, procedurat përpagesat dhe auditimin e brendshëm.
10)Dokumentimi i auditimit
Auditimi financiar dhe i përputhshmërisë, është realizuar në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI) mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e (SAI) si dhe ISSAI 30 Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 ñStandardi i Auditimit të Përputhshmërisëò, ISSAI 1000-2999 ñUdhëzues të Auditimit Financiarò; ISSAI 1300 ñPlanifikimi i auditimit të pasqyrave financiareò; Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së

KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së si dhe Rregullore ñMbi Procedurat e auditimit në KLSHò, miratuar me Vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 , e ndryshuar me Vendimin nr.63 datë 22.06.2020, të Kryetarit të KLSH-së.
Grupi i audituesve, *<u>për të realizuar objektin e auditimit</u>*, për dhënien e opinionit financiar dhe të përputhshmërisë e veprimtarisë së MSHMS, u fokusua mbi zbatimin në mbështetje të kuadri rregullator në fuqi, në lidhje mbi procedurat mbi zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, proçedurat e realizuara për përballimin e Covid-19, proceduratpër qarkullim e dokumentacionit,prokurimet duke filluar nga buxhetimi i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet evlerësimit, kontraktuesi, zbatuesii kontratës, procedurat përpagesat dhe auditimin e brendshëm në zbatim të Ligjit organik të KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, Ligjit 10296, datë 08.07.2010 ñMbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar; Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare."*, Ligji nr. 9936, datë 26,06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016 , Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò indryshuar, Ligji nr.114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publik, VKM nr 203, datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit ò i ndryshuar meVKM nr.242 datë 22.03.2020 ñPër disa shtesa në VKM nr.203 datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësore të shtetitò, Aktin Normativ të Qeverisë nr.243 datë 24.03.2020 ñPër shpalljen e gjendjes së Fatkeqësisë natyrore dhe Pandemia Botërore shpallur nga OBSHò, VKM nr. 248, datë 10.04.1998 ñPër miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyreò, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 ñPër disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998ò, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publik.ò, VKM nr.918 datë 29.12.2014 ñPër kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë eletronikeò, Udhëzim e APP-së nr. 2 datë 27.01.2015 ñPër hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publikò, udhëzim e APP-së nr.2 datë 08.01.2018 ñMbi përdorimin e procedurës me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete eletronikeò i ndryshuar, VKM-së nr.160, datë 02.03.2016 ñPër mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta.
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përputhje me legjislacionin përkatës Kushtetutën e Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative, ligjin nr.9000 datë 30.01.2003 ñPër organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministraveò, ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 ñPër

menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò,ligjin nr.152/2013 ñPër nëpunësin civilò të ndryshuar, ligjin nr.90/2012 ñPër organizimin dhe funksionimin e administratës shtetëroreò, Urdhër i Kryeministrit nr.169 datë 05.10.2017 si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale,organizon veprimtarinë e saj, në përmbushje të misionit.
Gjithë misioni zhvillohet nëpërmjet financimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit.
Kontrolli i Lartë i Shtetit si organi Kushtetues i kontrollit të fondeve buxhetore nga studimi i vlerësimit të riskut në lidhje me menaxhimin e fondeve buxhetore vjetorë të MSHMS për sigurimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues për mbrojtjen shëndetësore dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta, për popullatën e vendit, përfiton fonde të konsiderueshëm nga buxheti i Shtetit. Qëllimi është auditimi i fondeve të buxhetit nëse janë përdorur me eficensë efektivitet dhe ekonomicitet.

III.1. MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT

3.2 Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

Më hollësisht rezultatet e auditimit për këtë çështje paraqiten si më poshtë:
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për Vitin 2019-2020, me kod 1013001, administroi dhe menaxhoi fondet publike sipas shtatë programeve të miratuara, si vijon:

1. Planifikim Menaxhim Administrimi
2. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor
3. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor
4. Shërbime të Shëndetit Publik
5. Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore
6. Përkujdesi Social
7. Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë.

Kodet dhe objektivat e programeve të MSHMS-së 2019-2021 paraqiten në aneksin nr. 1.

- **<u>Vitin 2019</u>**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në vitin 2019, ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore për shtatë programe e konkretisht:
1. Planifikim, Menaxhim dhe Administrim
2. Shërbime të Kujdesit shëndetësor parësor
3. Shërbime të Kujdesit shëndetësor dytësor
4. Shërbime të Shëndetit Publik
5. Shërbimi Kombëtar i Urgjencës
6. Përkujdesi social
7. Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik
Në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 10, datë 28.02.2017 ñPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020ò MSHMS ka dërguar me shkresën nr. 5152/1 prot., datë 31.8.2018, në MF kërkesat buxhetore të fazës së dytë për PBA-në 2018-2020, formularët e propozimit të projekteve të investimeve, kërkesat shtesë të programeve si dhe relacionin mbi hartimin e projekt buxhetit. Me shkresën nr. 8537/1 prot., datë 3.9.2018, janë dërguar në MF kërkesat buxhetore të fazës së dytë për PBA-në 2019-2021si dhe i gjithë dokumentacioni shoqërues.

Tabela: PBA dhe Buxheti sipas programeve të MSHMS 2019 *Në 000/leke*

	PROGRAMI	PBA	BUXHETI 2019	Strukt %	
1	Planifikim, Menaxhim dhe Adm.	433,832	411,470	0.55	
2	*Shërbime të Kujdesit shëndetës paresor*	8,222,433	7,826,804	12.77	
3	*Shërbime të Kujdesit shëndetës dytesor*	24,355,738	25,392,631	41.52	
4	*Shërbime të Shëndetit Publik*	2,999,412	2,889,229	0.29	
5	*Shërbimi Kombëtar i Urgjencës*	380,098	321,298	4.37	
6	*Përkujdesi social*	23,487,114	23,668,114	38.48	
7	*Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik*	1,047,300	1,237,500	2.01	
	Totali	**60,925,927**	**61,747,045**	**100**	

Burimi: MSHMS

Referuar të dhënave të sipërcituara vërehet se planifikimi i fondeve në Project Buxhetin Afatmesëm krahasuar me planifikimin vjetor të buxhetit respektiv për çdo vit kalendarik nuk ka diferenca të theksuara. Në total diferenca ndërmjet planifikimit ne PBA dhe buxhetit për vitin 2019 është + 821,118 mijë lekë. Sipas programevebuxhetore,me Ligjin nr. 99/2018 ñPër buxhetin e vitit 2019ò, Ministrisë i janë planifikuar fonde buxhetore në shumën totale61,747,045lekë. Këto fonde janë shpërndarë sipas shtatë programeve buxhetore. Referuar ligjit nr. 99/2018 ñPër buxhetin e vitit 2019ò, ndryshuar me Aktet Normativ nr. 2 datë 02.10.2019, ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 99/2018 në buxhetin e vitit 2019ò. Shumat e alokuara në fillim të vitit për secilin program buxhetor me ndryshimet përkatëse dhe realizimi, paraqiten si më poshtë:

Tabela 1: Buxheti fillestar ndryshimet, buxheti në fund dhe realizimi 2019 Në 000/leke

	PROGRAMET	Buxheti fillestar 2019	Ndryshimet AN/nr	Buxheti 2019	Realizimi FAKT	%
	a	b	c	d	e	f
1	Planifikim, Menaxhim dhe Adm.	433,832	- 22,362	411,470	337,388	82
2	Shërbime të Kujdesit shëndetës paresor	8,222,433	- 395,629	7,826,804	7,814,460	100
3	Shërbime të Kujdesit shëndetës dytesor	24,355,738	1,036,893	25,392,631	25,400,068	100
4	Shërbime të Shëndetit Publik	2,999,412	- 110,183	2,889,229	2,674,010	92
5	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	380,098	- 58,800	321,298	179,839	56
6	Përkujdesi social	23,487,114	181,000	23,668,114	23,538,756	99
7	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik	1,047,300	190,200	1,237,500	1,228,582	91
	Totali	**60,925,927**	**821,118**	**61,747,045**	**61,173,101**	**99**

Burimi: MSHMS

Gjatë këtij viti, me aktet ligjore e nënligjore, ky buxhet fillestar i planifikuar në vlerën 60,925,927 mijë lekë, është ndryshuar duke u shtuar me vlerën 821,118 mijë lekë. Planifikimi i buxhetit përfundimtar për MSHMS. në vitin 2019 është 61,747,045mijëlekë. Ndryshime në shtesa janë bërë në programin: Shërbime të Kujdesit shëndetësor dytësor në vlerën + 1,036,893 mijë lekë, Përkujdesi social në vlerën 181,000 mijë lekë, Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik në vlerën +190,200 mijë lekë. Shtimi i vlerës fillestare të buxhetit për këto programe është në vlerën 1,408,093mijë lekë.

Ndryshimet në ulje të vlerës fillestare në planifikim janë bërë në programin Planifikim, Menaxhim dhe Administrim në vlerën - 22,362 mijë lekë, Shërbime të Kujdesit shëndetësor parësor në vlerën - 395,629 mijë lekë, Shërbime të Shëndetit Publik në vlerën - 110,183 mijë lekë, Shërbimi Kombëtar i Urgjencës në vlerën - 58,800 mijë lekë. Ulja e vlerës fillestare të buxhetit sipas programeve është në vlerën 586,974 mijë lekë.

Në total shtimi i vlerës fillestare të buxhetit për MSHMS. është në vlerën 821,118mijë lekë.

Në programin ñPlanifikim Menaxhim Administrimiò., buxheti vjetor pas ndryshimeve është në vlerën 411,470 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 337,388 mijë lekë ose 82 %. Në programin, ñShërbime të kujdesit shëndetësor parësorò, buxheti është në vlerën 7,826,804 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 7,814,460 mijë lekë ose 100 %. Në programin, ñShërbimi Shëndetësor

Dytësorò, buxheti është në vlerën1,036,893 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 25,400,068 mijë lekë ose 100 %. Për programin ñShërbime të shëndetit publikò buxheti është në vlerën 2,889,229 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 2,674,010 ose 92 %. Në programin ñShërbimi Kombëtar i Urgjencësò buxheti është në vlerën 321,298 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 179,839 ose 56 %. Në programin ñPërkujdesi social buxhetiò është në vlerën 23,668,114 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 23,538,756 ose 99 %. Në programin ñRehabilitimi i të Përndjekurve Politikò janë planifikuar fonde në vlerën 1,237,500 mijë lekë dhe realizimi është në vlerën 1,228,582 mijë lekë ose 91 %.

Realizimi vjetor i buxhetit është 91 % e fondeve të alokuara, janë alokuar fonde me vlerën 61,747,045 dhe realizuar vlera 61,173,101 mijë lekë.

Rreth 0.55% të totalit të shpenzimeve faktike është përdorur për programin ñPlanifikim Menaxhim Administrimiò. Për programin ñShërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësorò është përdorur 12.77%. Për programin e ñShërbimit Kombëtar të Urgjencësò është përdorur 0.29%. Për programin ñShërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësorò është përdorur po ashtu rreth 41.52%, ndërsa për programin ñShërbime të Shëndetit Publikò është përdorur rreth 4.37% e totalit të fondeve të përdorura. Gjithashtu për programin ñPërkujdesi socialò është përdorur rreth 38.48% e totalit të fondeve, për programin ñRehabilitimi i të Përndjekurve Politikëò është përdorur 2.01% e fondeve.

Buxheti për vitin 2019, sipas artikujve buxhetorë paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2: Realizimi sipas artikujve 2019 Në 000/lekë

Artikulli	EMRI	BUXHETI	REALIZIMI	Ne %
a	b	c	d	C
600	Paga	2,941,472.8	2,723,688.4	92.6
601	Sigurime Shoqërore	514,392.6	453,533.7	88.2
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2,173,656.9	1,861,004.2	85.6
603	Subvencion	0.0	0.0	
604	Transferta Korente të brendëshme	28,760,348.2	28,526,868.4	99.2
605	Transferta Korente të Huaja	378,757.1	373,034.4	98.5
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	23,848,417.5	23,773,479.1	99.7
Nen-Totali	***Shpenzime Korrente***	**58,617,045.0**	**57,711,608.2**	**98.5**
230	Kapitale të Patrupëzuara	66,358.0	53,545.0	80.7
231	Kapitale të Trupëzuara	1,923,642.0	1,809,509.0	94.1
232	Transferta Kapitale	0.0	0.0	
Nën -Totali	**Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm**	**1,990,000.0**	**1,863,054.0**	**93.6**
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.0	0.0	
231	Kapitale të Trupëzuara	1,140,000.0	1,598,439.0	140.2
232	Transferta Kapitale	0.0	0.0	
Nën -Totali	**Shpenzime Kapitale me financim të huaj**	**1,140,000.0**	**1,598,439.0**	**140.2**
TOTALI	**Shpenzime Kapitale**	**3,130,000.0**	**3,461,493.0**	**110.6**
TOTALI	**Korrente dhe Kapitale**	**61,747,045.0**	**61,173,101.2**	**99.1**

Burimi: MSHMS

Realizimi i shpenzimeve korrente sipas programeve paraqitet në tabelën nr. 5

Tabela 3: Realizimi i shpenzimeve korrente 2019 Në 000/lekë

Nr.	Programe	Buxheti 2019	Realizimi	Ne %
a	b	c	d	C
1	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim.	385,920	329,345	85.34%
2	Shërbime të Kujdesit shëndetësor parësor	7,108,371	7,092,960	99.78%
3	Shërbime të Kujdesit shëndetësor dytësor	23,184,097	22,798,542	98.34%
4	Shërbime të Shëndetit Publik	2,873,379	2,664,239	92.72%
5	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	301,200	159,931	53.10%

6	Përkujdesi social	23,526,579	23,438,011	99.62%
7	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik	1,237,500	1,228,582	99.28%
		58,617,045	57,711,608	98.4

Burimi: MSHMS

Referuar të dhënave të tabelës nr. 4 dhe nr. 5 konstatohet se, në realizimin e buxhetit sipas artikujve buxhetorë dhe shpenzimeve korrente sipas programeve përkatëse të MSHMS. nuk ka tejkalim në fondet e planifikuara. Shpenzimet korrente janë realizuar në masën 98.5%, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm 93.6 %, shpenzimet kapitale me financim të huaj 140.2 %, Shpenzimet kapitale gjithsej janë realizuar në masën 110.6 Në total shpenzime korrente dhe kapitale janë realizuar në masën 99.1%. Realizimi i shpenzimeve korrente sipas programeve rezulton në masën 98.4%.

Programi "Planifikim menaxhim administrim"

Objektivat kryesore të këtij programi janë:

- Arritja e 100% e angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare
- Plotësimi 100% i angazhimeve ligjore në fushën e shëndetësisë sipas matricës së projekt-akteve për vitin 2019.

Realizimi i shpenzimeve për 12mujorin e vitit 2019 për këtë program, përbën 0.55% të totalit të shpenzimeve të kësaj ministrie. Krahasuar me planin vjetor sipas zërave kryesore rezulton si më poshtë:

Zëri	Planifikuar *000 lekë*	Realizuar *000 lekë*	%
Shpenzimet e personelit	183,470	158,707	87.34
Shpenzimet e tjera operative	139,442	131,172	85
Shpenzime kapitale	21,970	4,495	31

Për sa i takon produkteve që kanë të bëjnë me shpenzimet kapitale, kemi realizim në masën 31%. Realizimi për periudhën e 12 mujorit te vitit 2019, nuk është në shifrat e duhura, pasi nuk u arrit të realizohej projekti për qendrën e biosimulimit në kuadër të paktit me Universitetin Mjekësor të Tiranës. U arrit të lidhej vetëm kontrata, ndërkohe që sipas kushteve të kontratës pjesa financiare do të mund të realizohej dy muaj pas lidhjes së kontratës. Të njëjtën gjë mund të themi dhe për zërin ñRikonstruksion i ambienteve të MSHMSò, kontrata e të cilit u lidh në fillim të dhjetorit, por nuk mund të realizohej dhe pjesa financiare e tij.

Në këtë program janë realizuar produktet e mëposhtme, ecuria e të cilave krahasuar me planin paraqitet si vijon:

Akte ligjore e nënligjore të miratuara	385,920	329,345	85 %
Pajisje mobilimi, teknologjike dhe kompjuterike	3,745	2,506	67 %
Projekte te mbështetura me kosto lokale	3,580	3,548	99 %
Ambiente te ri konstruktuara	18,225	1,990	11 %

Analiza e artikujve sipas programit buxhetor ñPlanifikim menaxhim administrimò për aparatin e MD paraqitet në tabelën nr. 4

Nga auditimi konstatohet se subjekti ka kryer monitorimin periodik dhe vjetor të buxhetit, të dhënat e të cilave janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

➢ ***<u>Rialokimet 2019, me fokus kryesor Aparatin MSHMS</u>***

Rialokimet për programin 01110, aparati MSHMS paraqiten në aneksin nr. 2

➢ ***Programi 01110.***

- Në zbatim të pikave 54, 62 të Udhëzimit plotësues të MFE-së nr. 1, datë 17.01.2019, ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ò, MSHMS-së i janë alokuar 10,000,000 lekë në artikullin 606, prej të cilave aparatit të MSHMS-së i kanë kaluar **3,188,000 lekë.** Me anë të shkresës nr.

3013/1 datë 28.02.2019 MFE i drejtohet degës së Thesarit dhe MSHMS-së duke dërguar detajimin e fondit të veçantë 2019.

- Me anë të shkresës nr. 5194, datë 31.10.2019, MSHMS-së i është drejtuar MFE-së duke kërkuar transferimin ndërmjet llogarive. Kjo kërkesë ka ardhur për tepricat që kanë rezultuar në llogarinë 600 dhe 601, si dhe nevojës për pagesën e disa detyrimeve të prapambetura kundrejt AKSH-it në llogarinë 602. MFE me anë të shkresës nr. 19865/1, datë 04.11.2019 ka miratuar kërkesën e mësipërme, duke pakësuar llogarinë 600 për vlerën 50,000,000 lekë dhe llogarinë 601 në vlerën 9,000,000 lekë dhe shtuar llogarinë 602 në vlerën **59,000,000** lekë.

➢ ***Programi 01190***

- Në zbatim të pikave 54, 62 të Udhëzimit plotësues të MFE-së nr. 1, datë 17.01.2019, ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ò, MSHMS-së i janë alokuar 200,000 lekë në artikullin 606. Me anë të shkresës nr. 3013/1 datë 28.02.2019 MFE i drejtohet degës së Thesarit dhe MSHMS-së duke dërguar detajimin e fondit të veçantë 2019.
- Me anë të shkresës nr. 2862, datë 23.05.2019, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS-së, i ka kërkuar MFE-së, transferimin nga llogaria 605 tek llogaria 604, në vlerën 3,000,000 lekë, pasi planifikimi është bërë gabimisht në llogarinë 605, por për shkak se këto janë transferta të brendshme duhet të ishte tek llogaria 604. Me anë të shkresës së MFE-së, nr. 9959/1, datë 30.05.2019 ka miratuar transferimin e fondeve si më sipër.
- Me anë të shkresës nr. 4876/3, datë 28.10.2019, S.P i MSHMS-së, i ka kërkuar MFE-së, zbatimin e Aktit normative nr. 2, datë 02.10.2019, duke kërkuar pakësimi i fondeve nga programet 07450 dhe 07460 në total për 189,000,000 lekë, dhe shtimin e tyre tek programi 10430 dhe 01190 në total 309,500,000. Me anë të shkresës së nr 17343/51, dt 21.10.2019 MFE ka miratuar akordimin e fondeve.
- Me shkresën nr. 5965 datë 26.12.2019, S.P i MSHMS-së, në zbatim të aktit normative nr. 11, datë 24.12.2019 ñPër një ndryshim në ligjin e buxheti 99/2018, për buxhetin e vitit 2019ò është bërë rialokim fondesh, duke pakësuar programin 01190 për 10,000,000 lekë dhe shtuar programin 10430 për 370,000,000 lekë.

➢ ***Programi 07220***

- Në zbatim të pikave 54, 62 të Udhëzimit plotësues të MFE-së nr. 1, datë 17.01.2019, ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ò, MSHMS-së i janë alokuar 130,000 lekë në artikullin 606. Me anë të shkresës nr. 3013/1 datë 28.02.2019 MFE i drejtohet degës së Thesarit dhe MSHMS-së duke dërguar detajimin e fondit të veçantë 2019.
- Në zbatim të VKM-së nr. 243, datë 19.04.2019 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 555 datë 11.8.2011 për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e MSHMS dhe njësit mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumësò S. P me atë të shkresës nr. 2465/9, datë 12.06.2019 ka kërkuar akordimin e fondeve në vlerën 656,168,000 lekë, efekti financiar I të cilit do përballohet nga kontigjenca për rritjen e pagave (MFE). Për programin 07220 vlera e akorduar është ***273,540,600 lekë.*** Me anë të shkresës nr. 10569/3 datë 21.06.2019, MFE ka miratuar alokimin e fondeve si mësipër.
- Me VKM 439, datë 26.06.2019, ñPër rishpërndarjen e fondeve buxhetore ndërmjet programeveò, FSDKSH ka kërkuar transferimin e fondeve nga programi 7220 në vlerën 749,300,000 lekë në programin 07330. Shkresat gjenden tek FSDKSH.
- Në zbatim të AN nr.2 dt.02.10.2019 miratuar me nga MFE me nr.17343/90 datë 28.10.2019, është bërë pakësimi i llogarisë i financimit të brendshëm me 40,000,000 lekë dhe rritur financimi i huaj me 120,000,000 lekë.

➢ ***Programi 07330***

- Në zbatim të pikave 54, 62 të Udhëzimit plotësues të MFE-së nr. 1, datë 17.01.2019, ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ò, MSHMS-së i janë alokuar 730,000 lekë në artikullin 606. Me anë të shkresës nr. 3013/1 datë 28.02.2019 MFE i drejtohet degës së Thesarit dhe MSHMS-së duke dërguar detajimin e fondit të veçantë 2019.
- -Në zbatim të VKM-së nr. 243, datë 19.04.2019 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 555 datë 11.8.2011 për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e MSHMS dhe njësit mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumësò S. P me atë të shkresës nr. 2465/9, datë 12.06.2019 ka kërkuar akordimin e fondeve në vlerën 656,168,000 lekë, efekti financiar I të cilit do përballohet nga kontigjenca për rritjen e pagave (MFE). Për programin 07330 vlera e akorduar është ***329,060,800 lekë***. Me anë të shkresës nr. 10569/3 datë 21.06.2019, MFE ka miratuar alokimin e fondeve si mësipër.
- Me VKM 439, datë 26.06.2019, ñPër rishpërndarjen e fondeve buxhetore ndërmjet programeveò, FSDKSH ka kërkuar transferimin e fondeve nga programi 7220 në vlerën ***749,300,000*** lekë në programin 07330. Shkresat gjenden tek FSDKSH.
- Në vijim të kërkesave të institucioneve të varësisë, me anë të shkresës nr. 4613 datë 25.09.2019, S.P. në MSHMS ka miratuar për institucionet e varësisë, duke ju drejtuar Thesarit ndryshimet në, ne programet 07330 dhe 07450 transferimin e fondeve ndërmjet produkteve.
- Në vijim të kërkesave të institucioneve të varësisë, me anë të shkresës nr. 5162/1 datë 14.11.2019, S.P. në MSHMS ka miratuar për institucionet e varësisë duke ju drejtuar Thesarit ndryshimet në programet 07330 dhe 07450 transferimin e fondeve ndërmjet produkteve.
- Në zbatim të AN nr.2 dt.02.10.2019 miratuar me nga MFE me nr.17343/90 datë 28.10.2019 është shtuar Financimi i Brendshëm në vlerën 77802000 lekë dhe financimi i huaj me 120,000,000 lekë.

➢ ***Programi 07450***

- Në zbatim të pikave 54, 62 të Udhëzimit plotësues të MFE-së nr. 1, datë 17.01.2019, ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ò, MSHMS-së i janë alokuar **4,052,000** lekë në artikullin 606. Me anë të shkresës nr. 3013/1 datë 28.02.2019 MFE i drejtohet degës së Thesarit dhe MSHMS-së duke dërguar detajimin e fondit të veçantë 2019.
- Me anë të shkresës nr. 1614 datë 15.03.2019, S.P I MSHMS I ka kërkuar MFE-së, rialokimin e fondeve ndërmjet artikujve për shkak të kursimit prej 50,000,000 lekësh në artikullin 605 (ulur çmimi të vaksinave dhe rënia e kursit të këmbimit) dhe transferimin e tyre në llogarinë 602 për vlerën ***22,500,000 lekë.*** Me anë të shkresës nr. 4529/1, datë 02.04.2019 MFE ka miratuar transferimin e fondit të mësipërm.
- Me anë të shkresës 2741 datë 16.05.2019, S. P I MSHMS-së ka kërkuar transferimin e fondeve nga llogaria 600 në llogarinë 601 për vlerën 6,500,000 lekë. Në shkresë nuk detajohet arsyeja e lëvizjes, por nevoja për këtë transferim ka ardhur në vijim të e-maili të njësisë së varësisë operatorit të kujdesit shëndetësor Shkodër. Me shkresën nr. 9398/1, datë 28.05.2019 MFE ka miratuar transferimin e kërkuar.
- Në zbatim të VKM-së nr. 243, datë 19.04.2019 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 555 datë 11.8.2011 për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e MSHMS dhe njësit mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumësò S. P me atë të shkresës nr. 2465/9, datë 12.06.2019 ka kërkuar akordimin e fondeve në vlerën 656,168,000 lekë, efekti financiar I të cilit do përballohet nga kontigjenca për rritjen e pagave (MFE). Për programin 07450 vlera e

akorduar është **53,566,600** ***lekë***. Me anë të shkresës nr. 10569/3 datë 21.06.2019, MFE ka miratuar alokimin e fondeve si mësipër.

- Me anë të shkresës 3247 datë 17.06.2019, S.P I MSHMS-së i ka kërkuar MFE-së pakësimin e fondit prej 15,064,000 lekë në artikullin 600 dhe transferimin e tij në artikullin 606. Kjo kërkuesë ka ardhur si rezultat i pakësimit të nr. Të punonjësve në institucionet e varësisë në momentin e miratimit të strukturës së OSHKSH, për pagesën e dëmshpërblimin ne formë page për punonjësit që i është zgjidhur kontrata. Me anë të shkresës nr. 11526/1, datë 20.06.2019 MFE ka miratuar transferimin e fondeve.
- Në vijim të shkresave të përcjella nga institucionet e varësisë për shpërblim për dalje në pension, me anë të shkresës nr 259/28, dt 14.10.2019 S.P i MSHMS-së i është drejtuar degës së thesarit dhe institucionet e varësisë duke kërkuar transferimin e fondeve midis produkteve të llogarisë 606, në vlerë 160,000 lekë.
- Me anë të shkresës nr. 4876/3, datë 28.10.2019, S.P i MSHMS-së, i ka kërkuar MFE-së, zbatimin e Aktit normative nr. 2, datë 02.10.2019, duke kërkuar pakësimi i fondeve nga programet 07450 dhe 07460 në total për 189,000,000 lekë, dhe shtimin e tyre tek programi 10430 dhe 01190 në total 309,500,000. Me anë të shkresës së nr. 17343/51, dt. 21.10.2019 MFE ka miratuar akordimin e fondeve.
- Në vijim të shkresave të përcjella nga institucionet e varësisë për shpërblim për dalje në pension, me anë të shkresa nr. 5162/1, dt. 14.11.2019 S.P i MSHMS-së i është drejtuar degës së thesarit dhe institucionet e varësisë duke kërkuar transferimin e fondeve midis produkteve të llogarisë 606, në vlerë 352,000 lekë.
- Në zbatim të AN nr.2 dt.02.10.2019 miratuar me nga MFE me nr.17343/90 datë 28.10.2019, është bërë pakësimi i llogarisë i financimit të brendshëm 37,802,000 lekë.

➢ ***Programi 07460***

- Në zbatim të pikave 54, 62 të Udhëzimit plotësues të MFE-së nr. 1, datë 17.01.2019, ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ò, MSHMS-së i janë alokuar **200,000** lekë në artikullin 606. Me anë të shkresës nr. 3013/1 datë 28.02.2019 MFE i drejtohet degës së Thesarit dhe MSHMS-së duke dërguar detajimin e fondit të veçantë 2019.
- Me anë të shkresës nr. 4876/3, datë 28.10.2019, S.P i MSHMS-së, i ka kërkuar MFE-së, zbatimin e Aktit normative nr. 2, datë 02.10.2019, duke kërkuar pakësimi i fondeve nga programet 07450 dhe 07460 në total për 189,000,000 lekë, dhe shtimin e tyre tek programi 10430 dhe 01190 në total 309,500,000. Me anë të shkresës së nr. 17343/51, dt. 21.10.2019 MFE ka miratuar akordimin e fondeve.

➢ ***Programi 10430***

- Në zbatim të pikave 54, 62 të Udhëzimit plotësues të MFE-së nr. 1, datë 17.01.2019, ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ò, MSHMS-së i janë alokuar **1,500,000** lekë në artikullin 606. Me anë të shkresës nr. 3013/1 datë 28.02.2019 MFE i drejtohet degës së Thesarit dhe MSHMS-së duke dërguar detajimin e fondit të veçantë 2019.
- Me anë të shkresës nr. 485/1, datë 15.02.2019, S. P i MSHMS-së, në vijim të kërkesës së SHSSH pagesë shpërblim vjetërsie pas lirimit nga detyra, drejtuar MFE-së ka kërkuar transferimin e fondeve nga llogaria 600 tek llogaria 606 në vlerën 234,750 lekë. MFE, me anët shkresës nr 2806/1 datë 26.02.2019 ka miratuar alokimin e fondeve të mësipërme.
- Në vijim të memos së grupit të punës ñPër vazhdimësinë e mbështetjes financiare për shërbimet e kujdesit shëndetësore të ofruara në nivel qarku dhe bashkieò, S. P I MSHM-së I është drejtuar sektorit të buxhetit në MSHMS duke kërkuar transferimin e fondeve për 5 qarqe dhe 3 bashki, ndërmjet produkteve të llogarisë 606. S.P i MSHMS me shkresën nr 992/1,

datë20.02.2019 drejtuar degës së thesarit dhe SHSSH ka miratuar transferimet e mësipërme, në vlerën 76,176,377 lekë.

- -Në zbatim të VKM-së nr. 119, datë 13.03.2019 ñNjë shtesë fondi nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit dhe rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve të MASR dhe MSHMSò, miratuar në vitin 2019, S.P I MSHMS-së me shkresën nr. 1655/1, datë 28.03.2019 i ka dërguar kërkesë MFE-së për pakësimin e fondin në llogarinë 606 në vlerën 300,000,000 lekë. Me anë të shkresës nr. 4647/1, datë 04.2019, MFE ka miratuar transferimin e fondeve.
- Me shkresën nr. 1780/1, datë 02.04.2019, në vijim të kërkesës së SHSSH nr. 68/31, datë 26.03.2019, S. P I MSHSM-së, ka dërguar degës së thesarit dhe SHSSH transferimin e fondeve ndërmjet produkteve të llogarisë 602 në vlerën 3,000,000 lekë.
- Në vijim të memos së grupit të punës ñPër vazhdimësinë e mbështetjes financiare për shërbimet e kujdesit shëndetësore të ofruara në nivel qarku dhe bashkieò, S. P I MSHM-së i është drejtuar sektorit të buxhetit në MSHMS duke kërkuar transferimin e fondeve për 1qark, ndërmjet produkteve të llogarisë 606. S.P i MSHMS me shkresën nr. 2601, datë 09.05.2019 drejtuar degës së thesarit dhe SHSSH ka miratuar transferimet e mësipërme, në vlerën 10,069,092 lekë.
- Me anë të shkresës nr. 4614 datë 25.09.2019 S. P I MSHMS-së, pas kërkesës së SHQSH nr. 68/73 datë 17.09.2019, për transferim fondesh ndërmjet institucioneve të përkujdesit social për të mos pasur mosrealizime ndërmjet llogarive 600 dhe 601, në vlerën 180,000 lekë, I ka dërguar degës së thesarit dhe SHSSH-së miratimin e këtij transferimi.
- Me anë të shkresës nr. 4110/8, datë 14.10.2019 S. P i MSHMS-së, në vijim të kërkesës së SHSSH nr. 68/78 datë 02.10.2019, për pagesë shpërblim vjetërsie pas lirimit nga detyra, drejtuar MFE-së ka kërkuar transferimin e fondeve nga llogaria 602 tek llogaria 606 në vlerën 131,000 lekë. MFE, me anë të shkresës nr 1865/1 datë 23.10.2019 ka miratuar alokimin e fondeve të mësipërme.
- Me anë të shkresës nr. 4876/3, datë 28.10.2019, S.P i MSHMS-së, i ka kërkuar MFE-së, zbatimin e Aktit normative nr. 2, datë 02.10.2019, duke kërkuar pakësimi i fondeve nga programet 07450 dhe 07460 në total për 189,000,000 lekë, dhe shtimin e tyre tek programi 10430 dhe 01190 në total 309,500,000. Me anë të shkresës së nr. 17343/51, dt. 21.10.2019 MFE ka miratuar akordimin e fondeve.
- Me shkresën nr. 4110/12, datë 31.10.2019, S.P I MSHMS-së në vijim të shkresës së SHSSH nr. 68/84, datë 28.10.2019 për mungesë të fondit të pagave, detyrime të krijuara rishtazi dhe mungesën e bonusin e bebes, në llogarinë 602, i ka kërkuar MFE-së transferimin e fondeve ndërmjet llogarive 606,600 dhe 602 të këtij programi. Me anë të shkresës nr. 19864/1 datë 04.11.2019, MFE ka miratuar transferimin e mësipërm.
- S.P I MSHMS-së me anë të shkresës nr. 5162/3 datë 14.11.2019 në përgjigje të shkresës 68/93 datë14.11.2019 të SHSSH-së për transferimin e fondeve nga produkti ndihma ekonomike tek bonusi i bebes (pas rakordimeve të kryer me bashkitë ka rezultuar një tepricë në produktin ndihma ekonomike, e cila është kërkuar të kalojë tek produkti bonusi i bebes pasi ka mungesë), i është drejtuar degës së thesarit dhe SHSSH duke miratuar transferimin, për vlerën 102,000,000 lekë.
- Me anë të shkresës 5421, datë 14.11.2019 S. P I MSHMS-së i është drejtuar MFE-së, bazuar në kërkesën për transferim fondesh të SHSSH nr. 68/93 datë 14.11.2019, për financimin nëpërmjet fondit social për projekte të miratuar nga MSHMS për 5 bashki për vlerën 7,000,000 lekë. MFE, me anë të shkresës nr. 20894/1 datë 21.11.2019 ka miratuar

transferimin. S.P i MSHMS-së i është drejtuar Thesarit dhe SHSSH me shkresën 5421/3 datë 03.12.2019 duke dërguar transferimin e fondeve kundrejt 5 bashkive.

- Me shkresën nr. 5965 datë 26.12.2019, S.P i MSHMS-së, në zbatim të Aktit normative nr. 11, datë 24.12.2019 ñPër një ndryshim në ligjin e buxheti 99/2018, për buxhetin e vitit 2019ò është bërë rialokim fondesh, duke pakësuar programin 01190 për 10,000,000 lekë dhe shtuar në programin 10430 për vlerë 370,000,000 lekë në llogarinë 606, pjesa e mbetur e shtesës është përballuar nga fondi i ISSH-së dhe llogaria e personelit. Me anë të shkresës nr. 24107/1, dt. 26.12.2019 MFE ka miratuar akordimin e fondeve.
- Me anë të shkresës nr.68/104 datë 24.12.2019 SHSSH është shprehur se ñPas rakordimit me çdo bashki dhe drejtori rajonale ka rezultuar një tepricë tek NE në shumën 34,500,000 lekë (pa prekur fondet NE për muajin dhjetor). Pas konsultimit me Drejtoritë e Kontrollit NE dhe Pak mendojmë që disa bashki nuk do të arrijnë të shpërndajnë fondet NE të muajit dhjetor pasi nuk kapen dot afatet kohore për marrjen e vendimeve nga Drejtoritë Rajonale SHSSH. Për këtë kërkojmë transferimin e shumës prej 34,500,000 lekë nga NE në PAK. Me anë të shkresës nr. 6006 datë 30.12.2019, S.P i MSHMS-së, në vijim të kërkesës të SHSSH nr. 68/104 datë 24.12.2019 për nevojat e PAK, në zbatim të aktit normative nr. 11, datë 24.12.2019, ka kërkuar pakësimin e ndihmës ekonomike (llogaria 606) në disa bashki në vlerën ***34,500,000 lekë*** dhe shtesën e të njëjtës vlerë për PAK në bashkitë e prekura nga tërmet, në llogarinë 606. Në këtë program, konstatohet një numër i lartë rialokimesh.

Viti 2020

A) Plani buxhetor afatmesëm 2020-2022

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, dhe Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2019 ñPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afat Mesëm 2020-2022ò, me anë të Urdhrit nr. 329, datë 15.04.2019, të Titullarit të MSHMS, shkresa Nr.2141, datë 15.04.2019 është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik. Me në të Urdhrit nr. 333, datë 15.04.2019 të Titullarit të institucionit, shkresa nr. 2168, datë 15.04.2019 është ngritur Ekipi i Menaxhimit të programeve në MSHMS.

Me anë të shkresës nr. 2629/1, datë **02**.09.2019, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i ka përcjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Projekt Buxhetin Afatmesëm 2020-2022, së bashku me dokumentet shoqëruese. Referuar pikës 2/3.2 të Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2019 ñBrenda datës **1** shtator të çdo viti, njësia e qeverisjes qendrore paraqet në ministrinë përgjegjëse për financat projektbuxhetin vjetor dhe atë afatmesëm në përputhje me tavanet e miratuaraò. Pra, projekt buxheti afatmesëm është depozituar pranë MFE-së, në tejkalim të afatit, me **1** ditë.

Planifikimi i PBA-së dhe çelja fillestare për vitin 2020 paraqitet si mëposhtë:

000 lekë

Prog	Viti 2020 PBA 2020-2022				Viti 2020 celja fillestare			Totali
	Totali korente	Shpenzime kapitale		Totali	Totali korente	Shpenzime kapitale		
		Financim I brendshem	Financim I huaj			Financim I brendshem	Financim I huaj	
1110	465,940	18,000		483,940	418,940	4,128		423,068
7220	9,026,320	429,000	158,000	9,613,320	7,636,862	526,276	158,000	8,321,138
7330	22,456,992	1,262,409	852,000	24,571,401	23,702,450	1,306,014	852,000	25,860,464
7450	3,100,428	149,591		3,250,019	2,984,428	23,500		3,007,928
7460	350,000	225,000		575,000	310,000	23,182		333,182
10430	23,830,000	70,000	100,000	24,000,000	23,849,260	37,700	100,000	23,986,960
1190	1,050,000			1,050,000	1,036,000	1,200		1,037,200
Totali MSHMS	***60,279,680***	***2,154,000***	***1,110,000***	***63,543,680***	***59,937,940***	***1,922,000***	***1,110,000***	***62,969,940***

Burimi: MSHMS

Nga tabela e mësipërme rezulton se për vitin 2020, në PBA-në 2020-2022, janë parashikuar ***63,543,680 mijë lekë*** shpenzime në total, prej të cilave ***60,279,680 mijë lekë*** shpenzime korrente dhe***3,264,000 mijë lekë*** shpenzime kapitale. Ndërsa, konstatohet se me ligjin e buxhetin te vitit 2020, këto fonde janë ulur, konkretisht çelja fillestare për vitin 2020 është bërë për shumën 62,969,940 mijë lekë prej të cilave, 59,937,940 mijë lekë shpenzime korrente, 1,922,000 mijë lekë financim i brendshëm dhe 1,110,000 mijë lekë financim i huaj.

B) Çelja fillestare dhe buxheti i korrektuar në fund të vitit paraqitet si mëposhtë:

në 000 lekë

	Viti 2020 celja fillestare			Buxheti I korrektuar (31.12.2020)					
		Shpenzime kapitale				Shpenzime kapitale			
Emërtimi i programit	**Totali korente**	**Financim i brendshem**	**Financim I huaj**	**Total**	**Totali korente**	**Financim i brendshem**	**Financim I huaj**	**Totali**	**% në totalin e buxhetit**
Planifikim Menaxhim Administrim	418,940	4,128		423,068	1,429,545	1,204,128		2,633,673	4%
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	7,636,862	526,276	158,000	8,321,138	7,302,122	450,346	-	7,752,468	11%
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	23,702,450	1,306,014	852,000	25,860,464	24,413,827	1,007,418	950,000	26,371,245	38%
Shërbime të Shëndetit Publik	2,984,428	23,500		3,007,928	2,999,351	3,000		3,002,351	4%
Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore	310,000	23,182		333,182	324,000	23,182		347,182	1%
Përkujdesi Social	23,849,260	37,700	100,000	23,986,960	27,968,935	12,700	40,000	28,021,635	41%
Rehabilitimi i të përndjekurve politike	1,036,000	1,200		1,037,200	1,036,100	1,200		1,037,300	1%
	59,937,940	***1,922,000***	***1,110,000***	***62,969,940***	***65,473,880***	***2,701,974***	***990,000***	**69,165,854**	**100%**

Burimi: MSHMS
Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga auditimi rezultoi se, fondet buxhetore për MSHMS janë çelur me ligjin e buxhetit në shumën 62,969,940 mijë lekë dhe me rishikimet e ndodhura gjatë vitit këto fonde rezultuan në shumën 69,165,854 mijë lekë ose 6,195,914 mijë lekë më shume (rritur buxheti me 10% nga sa çelur fillimisht). Vihet re se, peshën më të madhe në fondet buxhetore të shëndetsisë e zë programi 010430 ñPër përkujdesin Socialò në masën 41%, i cili menaxhohet nga institucioni i varësisë ñShërbimi Social Shtetërorò. Ky program gjithashtu ka shënuar rritjen më të madhe me 4,034,675 mijë lekë nga buxheti fillestar në buxhetin e rishikuar në fund të vitit (ose 65% të total rritjes buxhetore prej 6,195,914 mijë lekë).
Programi tjetër me impakt në rritjen totale buxhetore (rreth 36% ndaj total vlerës së shtuar) , rezultoi programi 01110 ñPër pranfikimin, menaxhimin dhe administriminò, i cili u çel fillimisht në vlerën 423,068 mijë lekë dhe nga ndryshimet gjate vitit rezultoi me rritje në vlerën **2,633,673 mijë lekë** (ose shtuar me 525% nga sa çelur fillimisht).
Më në detaje ndryshimet e ndodhura gjatë vitit dhe plani i korrektuar i buxhetit në nivel programi, paraqitet në vijim në nënpikën ñ*Çelja fillestare dhe rialokimet sipas programeve viti 2020, me fokus kryesor Aparatin MSHMS".*

C) Realizimi i shpenzimeve të buxhetit për 12 mujorin e vitit 2020, paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela: Buxheti faktik sipas programeve *në 000 lekë*

Titulli	**Emri i Programit**	**Buxheti 2020**[13]	**% në totalin e buxhetit**	**Fakti i vitit 2020**	**% në totalin e shpenzimeve**	**% e realizimit e vitit 2020**
01110	Planifikim Menaxhim Administrim	2,633,674	4%	2,188,312	3.2%	83.09
07220	Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	7,752,468	11%	7,702,041	11.4%	99.35

[13] Buxhet në fund, i korrektuar me ndryshimet gjatë vitit.

07330	Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	26,371,245	38%	25,732,181	38.1%	97.58
07450	Shërbime të Shëndetit Publik	3,002,351	4%	2,842,056	4.2%	94.66
07460	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore	347,182	1%	296,051	0.4%	99.62
10430	Përkujdesi Social	28,021,635	41%	27,756,407	41.1%	99.05
01190	Rehabilitimi i të përndjekurve politike	1,037,300	1%	1,033,156	1.5%	99.60
Totali i shpenzimeve		***69,165,855***	***100%***	***67,550,204***	***100%***	***97.73%***

Burimi: MSHMS
Përpunoi: Grupi i auditimit

Në mënyrë të detajuar realizimi i buxhetit për vitin 2020, referuar Raportit të Monitorimit për vitit 2020, publikuar në faqen zyrtare të MSHMSsi dhe në faqen zyrtare të MFE-së[14], paraqitet si mëposhte:

1. Për programin ***01110 Planifikim Menaxhim Administrim***, i cili përfaqëson rreth 3.23% tëtotalit të buxhetit tëMSHMS-së, realizimi i tijraportohet **83.9%.** Realizimi sipas shpenzimeve konstatohet:

- Shpenzime korrente 93.8%
- Shpenzime kapitale **70.41%**

Realizimi i shpenzimeve kapitale në nivel projekti, për këtë program, paraqitet në Aneksin nr.8, të këtij raport përfundimtari.

Investimet për periudhën e 12 mujorit të vitit 2020 në këtë program nuk u realizuan maximalisht pasi, në kuadër të pandemisë COVID-19, MSHMS-së bazuar në VKM 205 dhe VKM nr. 249 date 27.03.2020, iu akordua respektivisht 200,000 mijë lekë dhe 1,000,000 mijë lekë, duke e cuar buxhetin për investimet nga **4,128,000** lekë[15] në **1,204,128,000** lekë. Kjo shifër u detajua në objekte investimi, për të ndihmuar në përballimin e situatës së pandemisë, si vijojnë:

a. Rikonstruksion i pediatrisë infektive në QSUT ï me një vlerë 40 mln lekë, miratuar meVendimin nr. 28, datë 12.06.2020 të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit,. Kontratë e lidhur nr.5280/1, datë 07.12.2020, por u aplikua për leje rindërtimi në Bashkinë Tiranë, e cila e refuzoi për mungesë të disa dokumenteve[16].Fondet për këtë projekt janë çelur me VKM nr. 24, datë 27.03.2020 ñPër detajimin dhe mënyrën e përdorimit të fondit Anticovid-19ò.
b. F.V pajisje mjekësore CT Skaner ï me një vlerë 173 mln lekë, nuk u arrit të lidhej kontrata pasi procedura përfundoi në KPP. [17]

Tabela: Shpenzimet për programin 01110, fakt 2019 krahasuar me planin dhe faktin 2020

Në 000 lekë

[14]WEB site i MFE-së, kategoria ñBuxhetiò, Raporte Monitorimit, viti 2020, për institucionin: Ministria e Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
[15]Çelja fillestare dhe planifikimi në PBA
[16]Referuar Raportit të Monistorimit të MSHMS
[17]Referuar Raportit të Monistorimit të MSHMS.

Llogaritë	Fakt 2019	Plani final 2020	Fakt 2020	% e realizimit 2020
Shpenzime Korrente	*329,344.9*	*1,429,545.8*	*1,340,527.2*	*93.8%*
600	160,100.3	200,000.0	181,528.5	90.8%
601	25,838.6	29,770.0	26,428.7	88.8%
602	134,355.1	1,184,675.8	1,121,186.2	94.6%
605	8,077.3	14,200.0	10,614.0	74.7%
606	973.6	900.0	769.8	85.5%
Shpenzime Kapitale	*8,043.0*	*1,204,128.0*	*847,785.0*	*70.4%*
Financim i brendshme	8,043.0	1,204,128.0	847,785.0	70.4%
230	0.0	7,628.0	7,596.0	99.6%
231	8,043.0	1,196,500.0	840,189.0	70.2%
Financim i huaj	0.0	0.0	0.0	
Total	*337,387.9*	*2,633,673.8*	*2,188,312.2*	*83.1%*

Burimi: MSHMS
Përpunoi: Grupi i auditimit

Për vitin 2019, realizimi shpenzimeve korrente për programin 01110, i cili administrohet kryesisht nga aparati MSHMS ishte në vlerën 329,344.9 mijë lekë. Referuar planit final për vitin 2020, shpenzimit korrente ishin në vlerën 1,429,545.8 mijë lekë, pra 1,100,200.9 mijë lekë më shumë se fakti i vitit 2019. Shtesa e konsiderueshme në shpenzimet korrente e planit final në vitin 2020, krahasuar me realizimin e vitit 2019, ka ardhur kryesisht nga fondet e alokuara për përballimin e situatë së shkaktuar nga covid-19, në vlerën 1,076,105.8 mijë lekë (trajtuar më gjerësisht në shtesat dhe pakësimet e programit 01110). Në nivel llogarish, shtesën më të madhe në vitin 2020 e ka pësuar llogaria 602 ñMallra dhe shërbimeò, në të cilën janë alokuar 1,050,320.7 mijë lekë më shumë fonde krahasuar me faktin e vitit 2019. Ndërsa, realizimi për vitin 2020 rezulton në vlerën 1,340,527.2 mijë lekë, ose rreth 94% e fondeve të alokuara. Buxheti për mallra dhe shërbime për programin i cili administrohet kryeshisht nga MSHMS, rezulton i realizuar në nivelin 94%. Në mënyrë më të detajuar, niveli i realizimit sipas llogarive paraqitet në tabelën e mësipërme, ndërsa sipas produkteve në tabelën më poshtë:

Tabela: Realizimi i buxhetit për shpënzimet korrente 2019-2020, programi 01110

Produktet	Llogaria	Fakt 2019	plani final 2020	Fakt 2020
Shpenzime korrente				
91301AA	600	160,100.3	170,000.0	163,096.8
91301AC			30,000.0	18,431.8
91301AA	601	25,838.6	29,770.0	26,428.7
91301AA	602	134,355.1	138,570.0	128,279.9
91301AB			1,046,105.8	992,906.4
91301AA	605	8,077.3	14,200.0	10,614.0
91301AA	606	973.6	900.0	769.8
Total		***329,344.9***	***1,429,545.8***	***1,340,527.4***

Burimi: MSHMS
Përpunoi: Grupi i auditimit

Shpenzime kapitale për vitin 2019 paraqiten në vlerën 8,043.3 mijë lekë si financim i brendshëm, në llogarinë 231 ñshpenzime kapitale të trupëzuaraò. Gjatë vitit 2020, burimi i financimit ka mbetur i njëjtë për shpenzimet kapitale, ndërsa referuar planit final për ketë vit, ato (shpz. Kapitale) rezultojnë në vlerën 1,204,128 mijë lekë ose 1,196,085 mijë lekë më shumë se buxheti në vitin 2019. Çelja fillestare në vit 2020 për investime është bërë ne vlerën 4,128 mijë lekë, ndërsa si rezultat i situatës së shkaktuar nga Covid-19 janë alokuar edhe 1,200,000 mijë lekë. Realizimi i investimeve për vitin 2020 rezulton ndjeshëm më i lartë se ai në vitin 2019 (839,742 mijë lekë më shumë), ndërsa krahasuar me planin në fund të vitit 2020 realizimi i shpenzimeve

kapitale rezulton në nivelin 70.4%. Vërehet se, për këtë vit llogaria 230 është realizuar rreth 100%, ndëra investimet e trupëzuara janë realizuar në normën 70.2%. %. Në mënyrë më të detajuar, niveli i realizimit në nivel projekti është paraqitur në tabelën mësipër, ndërsa në vijim janë trajtuar projektet të cilat kanë patur ndikimin më të lartë në realizimin e shpenzimeve kapitale në nivelin 70.4% në vitin 2020.

2. Për programin ***07220 Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor*** realizimi është **99.35%.** Realizimi sipas shpenzimeve konstatohet:

- Shpenzime korrente 99.9 %
- Shpenzime kapitale 90%

3. Për programin ***07330 Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor*** realizimi është **97.58%.**Realizimi sipas shpenzimeve konstatohet:
   - Shpenzime korrente 99.1%
   - Shpenzime kapitale **78%**

Në programin spitalor është zëri ñTVSH, detyrim doganor + Kosto Lokaleò me vlerë totale rreth 226,329,330 lekë nga të cilat vlera prej 208,079 mijë lekë i takon TVSH dhe Kosto Lokale për projektin me kredi të CEB për QSUT. Diferenca është për projektin e Global Fund dhe disa projekte për maternitetet. Për këtë zë për 12 mujorin e v. 2020 ka pasur një realizim në **masën 77%** kundrejt planit. Tek financimi i huaj për shërbimin e kujdesit shëndetësor spitalor, ka pasur një realizim më të **ulët** se fakti për projektin ñFuqizimi i përgjigjes kombëtare ndaj HIV/AIDS (Global Fund)ò:

Disbursimi i parashikuar në vlerën 141,000,000 lekë.
Shpenzimi për 12 mujorin e v.2020 në vlerën 63,955,950 lekë

4. Për programin ***07450 Shërbime të Shëndetit Publik*** realizimi është **94.66 %.** Realizimi sipas shpenzimeve konstatohet:
   - Shpenzime korrente 94.7%
   - Shpenzime kapitale **22%**

Për sa i takon shpenzimeve kapitale, realizimi në masën 22% te fondeve, është për shkak se nuk u arritën të realizoheshin procedurat e prokurimit.

5. Për programin ***07460 Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore*** realizimi është në masën 99.62%.
   - Shpenzime korrente 99.8%
   - Shpenzime kapitale 98 %
6. Për programin ***10430 Përkujdesi Social*** realizimi është në masën 99.05%. Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020 për këtë program rezulton si më poshtë:
   - Shpenzime korrente 99.1%
   - Shpenzime kapitale **61%**

   Realizimi i shpenzimeve kapitale për këtë program është 61%, ku për financimin e brendshëm ne masën 77 %, ndërkohë financimi i huaj është në masën 56.5% realizimi.
7. Për programin ***01190 Rehabilitimi i të përndjekurve politike*** është në masën 99.6%. Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020 për këtë program rezulton si më poshtë:
   - Shpenzime korrente 99.6%
   - Shpenzime kapitale 91,64%

Konkluzion:

Nga analizimi i të dhënave të mësipërme konstatohet se, niveli i realizimit të buxhetit të vitit 2020, shfaqet në nivele mbi 94% për 6 programe të MSHMS-së, ndërsa në nivelin 83% për programin 01110 i cili administrohet kryesisht nga MSHMS. Në këtë program (01110), niveli i realizimit shfaqet në nivelin 93.8% për shpenzimet korrente dhe në normë 70.4% në shpenzimet kapitale, pasi për projektin F.V pajisje mjekësore CT Skaner nuk është arritur të lidhet kontrata.

D) Çelja fillestare dhe rialokimet sipas programeve viti 2020, me fokus kryesor Aparatin MSHMS

1. ***Programi 01110*** *Planifikim Menaxhim Administrim:*

a. Levizjet e buxhetit në total për programin

Me anë të shkresës nr. 24325/4, datë 30.12.2019, Ministria e Financës dhe Ekonomisë i ka përcjellë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale detajimin e planit të buxhetit për shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale deri në nivel artikulli dhe produkti.

Në 000 lekë

Programet	*Viti 2020 celja fillestare*			*Totali*	*Viti 2020 I korrektuar (31 Dhjetor 2020)*			*Totali*
		Shpenzime kapitale				*Shpenzime kapitale*		
Planifikim, Administrim, Menaxhim	Totali korente	Financim i brendshëm	Financim i huaj		Totali korente	Financim i brendshëm	Financim i huaj	
	418,940	4,128	-	**423,068**	1,429,545	1,204,128		**2,633,674**

Burimi: MSHMS
Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga tabela e mësipërme vërehet se, programi 01110 i cili administrohet kryesisht nga Aparati i MSHMS, është çelur fillimisht me vlerën 423,968,000 lekë. Me ndryshimet e ndodhura gjatë vitit 2020, të cilat kanë shtuar fondet për shpenzimet korrente dhe ato kapitale në fund të këtij vitit, buxheti për këtë program ka arritur në vlerën **2,633,674,000 lekë,** ose shtuar me 2,210,605 mijë lekë, të zbërthyera si më poshtë:

- Në zbatim të pikave 52, 58 të Udhëzimit plotësues të MFE-së nr. 2, datë 20.01.2020, ñ*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020*ò, MSHMS-së i janë akoluar 10,000,000 lekë në artikullin 606, prej të cilave aparatit të MSHMS-së i kanë kaluar ***900,000 lekë.*** Me anë të shkresës nr. 2852/1, datë 12.02.2020 MFE i drejtohet degës së Thesarit dhe MSHMS-së duke dërguar detajimin e fondit të veçantë 2020.
- Me *VKM-së nr. 205,* datë 09.03.2020, është vendosur shtimi i fondit prej *400,000,000 lekë* për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për infeksionet e shkaktuara nga Covid-19 e ndarë përkatësisht, **200,000,000** lekë në kategorinë shpenzime kapitale dhe ***200,000,000***, lekë shpenzime korrente. Efekti financiar është përballuar nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i akorduar për programin e MSHMS 1110 ñPlanifikimi, Menaxhimi dhe Administrimiò. Më anë të shkresës nr. 5173/4 prot., datë 11.03.2020, MFE-së i është drejtuar Drejtorisë së Thesarit Tiranë, me anë të të cilës është miratuar akordimi i fondeve për MSHMS, në zbatim të VKM-së së sipër përmendur**.**
- Me *VKM nr. 240, datë 21.03.2020* është vendosur shtimi i fondit prej ***46,105,800 lekë***për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për përhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-2019, në kategorinë e shpenzimeve korrente, në programin ñPlanifikimi, Menaxhimi dhe Administrimiò. Efekti financiar është përballuar nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit. Më datë 24.03.2020 është përcjellë shkresa nr. 5803 prot., për Degën e Thesarit me anë të të cilës MFE miraton alokimin e fondeve buxhetore, në zbatim të VKM-së së mësipërme.

- Me anë të *VKM 249, datë 27.03.2020* ñPër detajimin dhe mënyrën e përdorimit të Fondit AntiCovid-19ò, është vendosur që fondi Anti-Covid-19, do të përdoret si me poshtë:
  d) Në masën ***800 milion lekë***, në programin ñPlanifikimi, menaxhimi dhe administrimiò, në kategorinë e shpenzimeve korrente;
  e) Në masën ***1000 milion lekë***, në programin ñPlanifikimi, menaxhimi dhe administrimiò, në kategorinë e shpenzimeve **kapitale.** Me anë të shkresës nr. 6124/1 prot., datë 03.04.2020 dërguar Thesarit, MFE ka miratuar rialokimin e fondeve në zbatim të VKM-së së mësipërme. Efektet financiare do të përballohen nga fondi Anti-Covid i cili është alokuar tek FSDKSH me aktin normative nr. 6, datë 21.03.2020.
- Me *VKM nr.259, datë 27.03.2020*, është vendosur ñDhënia e ndihmës me personel shëndetësor për Republikën e Italisëò, sipas të cilit fondi prej **11,000,000 lekësh** për shpërblimin e personelit shëndetësor është përballuar nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit. Me anë të shkresës nr. 6126/1 prot., datë 08.04.2020 dërguar Thesarit, MFE ka miratuar akordimin e fondeve buxhetore, për shpenzime korrente, në zbatim të VKM-së së mësipërme
- Me anë të *VKM nr. 354, dt. 29.04.2020* ñPër dhënien e ndihmës me personel infermier për Republikën e Italisëò, është vendosur dhënia e shpërblimit për personelin mjekësor me fond ***19,000,000 lekë***, të cilat do të përballoheshin nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit. Në zbatim të këtij vendimi, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS-së, i është drejtuar MFE-së, përkatësisht me shkresat nr. 2166/1, datë 19.05.2020. MFE me shkresë nr. 9226/1, datë 27.05.2020 i është drejtuar Thesarit dhe MSHMS për miratimin dhe çeljen e fondit, për shtesën në programin 01110 të MSHMS-së.
- Me anë të *VKM nr. 926 datë 25.11.2020"Për rishpërndarjen e fondeve në buxhetin e vitit 2020 ndërmjet ministrive dhe institucioneve buxhetore*ò është vendosur që MSHMS-së do të shtohen fondi prej 2,000,000,000 lekësh në llogarinë 606 të programit të ñPërkujdesit socialò. Kjo rishpërndarje ka prekur aparatin e MSHMS-së, në llogarinë 600 duke e pakësuar me ***41,800,000 lekë***. Ndërkohë që pjesa tjetër e fondeve janë marrë nga institucione të varësisë së MSHMS-së si dhe ministrive dhe institucioneve të tjera buxhete, të detajuara në VKM. Sa më sipër është kryer në vijim të shkresës nr. 5032 datë 11.11.2020, me anë të të cilës MSHMS i është drejtuar MFE-së për problematikat që lidhen me mungesën e fondeve në programi e përkujdesit social, specifikisht për pagesën e aftësisë së kufizuar, ndihmës ekonomike dhe bonusin e bebit, për akordimin e fondit të mësipërm.
- *Me aktin normativ nr. 34, datë 16.12.2020 "Për disa ndryshime në ligjin 882019, për buxhetin e vitit 2020*ò, të ndryshuar, është vendosur ndryshimi i buxhetit edhe për MSHMS-së, duke prekur edhe aparatin. Ndryshimet në aparat më specifikisht paraqiten: Është pakësuar llogaria 600 në vlerën ***28,200,000 lekë***, është pakësuar llogaria 601 në vlerën ***10,000,000 lekë***, dhe është shtuar llogaria 602 në vlerën ***13,600,000 lekë***. Me anë të shkresës 5588/1, datë 18.12.2020 MSHMS-së i është drejtuar MFE-së, për transferimin e fondeve në zbatim të aktit normativ. Me anë të shkresës 23412/12, datë 21.12.2020 MFE drejtuar Thesarit dhe MSHMS-së ka miratuar alokimin e fondeve në zbatim të VKM-së së mësiëprme.

Në mënyrë analitike lëvizjet për këtë program paraqiten në Aneksin nr.3, të këtij raport përfundimtari.

b. Detajimi i fondeve të Covid-19 për investime në Aparatin MSHMS

1. Me **VKM-së nr. 205**, datë 09.03.2020, është vendosur shtimi i fondit prej 400,000,000 lekë për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për infeksionet e shkaktuara nga Covid-19 e ndarë përkatësisht, **200,000,000 lekë** në kategorinë shpenzime kapitale dhe 200,000,000, lekë shpenzime korrente. Efekti financiar është përballuar nga fondi rezervë i

buxhetit të shtetit, i akorduar për programin e MSHMS 1110 ñPlanifikimi, Menaxhimi dhe Administrimiò. Më anë të shkresës nr. 5173/4 prot., datë 11.03.2020, MFE-së i është drejtuar Drejtorisë së Thesarit Tiranë, me anë të të cilës është miratuar akordimi i fondeve për MSHMS, në zbatim të VKM-së së sipër përmendur**.**

2. Në Aktin Normativ nr. 6, datë 21.03.2020, në nenin 3 të tij, mbi buxhetin e sigurimeve shëndetësore i cili menaxhohet nga FSDKSH, përcaktohet se: ñ*Fondi anti-Covid-19 prej 2 500 milione leke, detajohet dhe perdoret me vendim te Keshillit te Ministrave, për shpenzime korente dhe kapitale.*ò Në vijim,VKM 249, datë 27.03.2020, e ka detajuar këtë fond jo vetëm për FSDKSH, por edhe për ISHP, Shërbimin Kombëtar të Urgjencës dhe Aparatin MSHMS. Në zbatim të Aktit Normativ nr.6, datë 21.03.2020, **VKM 249**, datë 27.03.2020, ka bërë detajimin e fondit AntiCovid, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si më poshtë:
    a. Në masën 500 milionë lekë, në programin ñShërbimet e kujdesit dytësorò, në kategorinë e shpenzimeve korrente;
    b. Në masën 150 milionë lekë, në programin ñShërbimet e shëndetit publikò, në kategorinë e shpenzimeve korrente;
    c. Në masën 50 milionë lekë, në programin ñShërbimi Kombëtar i Urgjencësò, në kategorinë e shpenzimeve korrente;
    d. Në masën 800 milionë lekë, në programin ñPlanifikimi, menaxhimi dhe administrimiò, në kategorinë e shpenzimeve korrente;
    e. Në masën 1 000 milionë lekë**,** në programin ñPlanifikimi, menaxhimi dhe administrimiò, në kategorinë e shpenzimeve kapitale.

Me anë të shkresës nr.2089 prot., datë 30.04.2020, S.P i MSHMS, me objekt ñKërkesë për çelje të fondit anticovid për shpenzimet kapital në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale për vitin 2020ò, ka përcjellë në MFE detajimin e vlerës 1,000 milion lekë**.**

- F.V monitor për spitalet 102,613,000 lekë
- Pajisjet mjekësore për spitalet 50,000,000 lekë
- Rehabilitimi i shërbimit të Urologjisë dhe Klinikës së Tretë Kirurgjikale për kthimin e tyre në Konvaleshencës dhe Terapi Intensive në QSUT në vlerën 13,717,119 lekë
- Instalimi ajrit dhe oksigjenit në shërbimin urologjik dhe klinikës së tretë, në shërbimet e Alergologjisë dhe Reumatologjisë nëé në vlerën 88,632,660 lekë
- Investime në Kuadër të Covid-19, në shumën, 745,037,221 lekë. Në vijim, me anë të e-mailit zyrtar të datës 20.05.2020, MSHMS ka kërkuar detajimin e mëtejshëm të zërit ñInvestime në kuadër të covid-19ò, përcjellë MFE. Referuar shkresës nr. 7731/1, datë 22.05.2020 ky zë është zbërthyer në 10 projekte me nr. 19AD306 ï 19AD315.

Në vijim me të njëjtën shkresë me nr. 7731/1, datë 22.05.2020, MFE ka miratuar detajimin e gjithë shumës 1,000 milion leke sipas kërkesës së MSHMS, si më poshtë:

- 19AD302 F.V monitorë per spitalet 102,613,000 lekë
- 19AD303 Pajisje mjekësore për spitalet 50,000,000 lekë
- 19AD304 Rehabilitimi i shërbimit të Urologjisë dhe Klinikës së Tretë Kirurgjikale për kthimin e tyre në konvaleshencës dhe Terapi Intensive në QSUT 13,717,119 lekë
- 19AD305 F.V pajisje per linjat e gazrave mjekësore në QSUT, SU ñShefqet Ndroqiò, SUOGJ ñMbretëresha Geraldinëò dhe Spitali i Kavajësò, për përballimin e situatës COVID-19, 88,632,660 lekë.
- 19AD306 Blerje autoambulancash për spitale 300,000,000 lekë
- 19AD307 Rikonstruksion i pediatrisë infektive në QSUT 40,000,000 lekë
- 19AD308 Supervizion për rikonstruksionin e pediatrisë infektive ne QSUT 740,000 lekë
- 19AD309 Kolaudim per rikonstruksionin e pediatrisë infektive ne QSUT 45,333 lekë

- 19AD310 F.V pajisje mobilim për shërbimin e reanimacionit të Spitalit të Vlorës 5,000,000 lekë
- 19AD311 Rikonstruksion i shërbimit të reanimacionit te sp. Vlore 50,000,000 lekë
- 19AD312 Superv për rikonstruksionin e shërbimit të reanimacionit të spt. Vlorë 900,000 lekë
- 19AD313 kolaudim për rikonstruksionin e shërbimit të reanimacionit të sp. Vlorë 50,000 lekë
- 19AD314 TVSH për projektin për furnizimin me pajisje mjekesore të specializuara për mbrojtje/trajtim të covid-19, në kuadër të marrëveshjes grant të BE me 88,560,000 lekë
- 19AD315 F.V pajisje mjekësorë për covid 259,741,888 lekë.

Detajimi i fondeve të Covidit për llogarinë 231, si dhe lëvizjet e këtyre fondeve gjatë vitit 2020 paraqitet në aneksin nr.4.

I) Ndryshimet e buxhetit me shkresën e MFE nr. **12507/47, datë 14.07.2020**
Në vijim të çeljes së vlerës prej 1,000,000 mijë leke, me anë të shkresës nr. 2818, datë 15.06.2020, S.P i MSHMS i ka drejtuar MFE-së kërkesën për transferimin të fondeve covid. Me anë të shkresës Nr.12507/47, datë 14.07.2020 MFE ka miratuar kërkesën e MSHMS duke:
-paksuar projektet: *19AD302 F.V monitorë për spitalet* në vlerën 36,727,000 lekë; *19AD306 Blerje autoambulancash për spitalet* në vlerën 60,000,000 lekë dhe *19AD315 F.V pajisje mjekësore për covid 19* ne vlerën e plotë të këtij projekti 259,741,888 lekë dhe
- duke shtuar: 19AD317 F.*V pajisje mjekësore CT Skaner* 172,935,000 lekë; 19AD318 *F.V pajisje mjekesore Rezonance magnetike MRI* 167,573,888 lekë; *19AD316 Pagese TVSH për pajisjet e furnizuara donacion nga PNUDI ne kuadër te Covid-19* 15,000,000 lekë dhe *18BA301 F.V pajisje elektronike ne kuadër te COVID-19*, **960,000 lekë.**
Nëse do të referoheshim PBA 2020-2022, projekti 18BA301 ka qenë i planifikuar në vlerën 3,000,000 lekë për vitin 2020 si më poshtë:
Planifikimi në PBA i projektit 18BA301

Produkti 1 :	**Pajisje kompiuterike**	**Kodi i Projektit sipas listes se investimeve**	18BA301	
Përshkrimi i Produktit:	Blerje pajsije kompiuterike			
Njësia Matëse	sasi pajisjesh			
	2019 Buxheti	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**	**2022 Parashikimi**
Sasia	50	50	50	50
Kosto totale (në mijë lekë)	3,000	3,000	3,000	3,000
Kosto për njësi (në mijë lekë)	60	60	60	60

Burimi: MSHMS
Përpunoi: Grupi i auditimit

Në vijim me shkresën nr.2169/8 datë 21.02.2020 është miratuar nga MFE çelja e fondeve për vitin 2020, paraqitur në aneksin nr.5 (shkëputur vetëm investimet)/
Sikurse identifikohet edhe nga tabela në aneks, për projektin 18BA301 nuk janë çelur fonde në fillim të vitit.
Në vijim, me shkresën me nr.3160 dt. 02.07.2020 MSHMS bëri kërkesë për transferim fondesh për investime, dhe MFE e miratoi këtë kërkesë me shkresën nr.12638/1, datë 10.07.2020, për lëvizjet e mëposhtme:

Transferimi i fondeve për projektin 18BA301

Emërtimi institucionit	**Kap**	**Programi**	**Llogaria ekonomike**	**Kodi i Degës së Thesarit**	**Kodi i Projektit**	**Emërtimi i Projektit**	**DEBITI v.2020**

PAKESOHET PLANIFIKIM, ADMINISTRIM, MENAXHIMI							**447,600**
PIU Rehabilitimit të Sistemit Shëndetësor	03	01110	2310000	3535	M133696	Kosto Lokale per PIU-n (njesia e zbatimit te projekteve te huaja) per projektin e CEB-it	447,600
SHTOHET PLANIFIKIM, ADMINISTRIM, MENAXHIMI							**447,600**
Aparati i MSHMS	01	01110	2310000	3535	18BA301	Blerje pajisje kompjuterike per stafin e MSHMS	447,600

Burimi: MSHMS
Përpunoi: Grupi i auditimit

Sikurse paraqitet edhe në tabelën e mësipërme, është pakësuar projekti M133696 me 447,600 lekë dhe është shtuar projekti 18BA301 ñBlerje pajisje kompiuterikeò me të njëjtën vlerë. Nga analizimi i realizimit të buxhetit, u konstatua se projekti 18BA301 **është realizuar** në vlerën 1,275,600 lekë prej të cilave 447,600 lekë buxheti i shtetit, dhe **828,000 fondi anticovid**.
Referuar urdhrit të prokurimit nr. 3973.1 dt. 31.08.20, kontrata e lidhur për këtë projekt, me fonde covid, është prokuruar në kuadër të situatës së krijuar nga pandemia.
Nga sa më sipër, ko**nkludojmë se është ndryshuar destinacioneve i fondeve Covid, duke u përdorur për një** projekt të parashikuar që në PBA-në 2020-2022 (pra përpara se të ndodhte pandemia)

II) Ndryshimet e buxhetit me shkresën e MFE nr. **15857/1, datë 21.09.2020**
Nga analiza e buxhetit të akorduar **për përballimin e fatkeqësisë natyrore** konstatohet se, me anë të shkresës nr. 3871, datë 20.08.2020 drejtuar MFE-së, S.P i MSHMS-së ka kërkuar transferimin e fondeve për investime në shëndetësi, sipas të cilës është kërkuar pakësimi i fondeve të parashikuara për projektet:

- ñRehabilitimi i shërbimit të Urologjisë dhe Klinikës së Tretë Kirurgjikale për kthimin e tyre në Konvaleshencës dhe Terapi Intensive në QSUTò në vlerë totale të tij **13,717,119** lekë; dhe
- ñTVSH për projektin për furnizimin me pajisje mjekësore te specializuara per mbrojtje/trajtim te covid-19, ne kuadër te marrëveshjes grant te BE ku përfituesi është MSHMSò në vlerën **2,074,019 lekë**.

Këto fonde referuar relacionit bashkëlidhur shkresës, do të përdoreshin për projektet:

- ñRikonstruksione në disa ambiente të godinës MSHMSò (detyrim i vitit 2019) në vlerën **9,194,988 lekë,**
- ñSupervizim dhe kolaudim për rikonstruksionet e disa godinave të MSHMSò (detyrim i vitit 2019) në **vlerën 96,150 lekë,**
- ñHartim i projekt preventivit të zbatimit për ndërtimin e Qendrës së re të Biosimulimit Klinik dhe edukimit në vazhdim për Universitetin e Mjekësisë tiranë në kuadër të paktit të Universitetitò (detyrim i vitit 2019) **6,500,000 lekë.**

Në vijim, kërkesa e MSHMS për të shlyer me fonde covid, 3 detyrime të prapambetura nga viti 2019 në vlerën 15,791,138 lekë, është miratuar nga MFE.

III) Ndryshimet e buxhetit me shkresën e MFE nr. **12507/47, datë 14.07.2020**
Me anë të shkresës nr. 4584, datë 13.10.2020 MSHMS ka kërkuar transferimin e fondeve të akorduara për përballimin e situatës së covidit. Me anë të shkresës 19111/1, MFE ka miratuar tranferimin e fondeve duke pakësuar ñF.V pajisje per linjat e gazrave mjekësore në QSUT, SU ñShefqet Ndroqiò, SUOGJ ñMbretëresha Geraldinëò dhe Spitali i Kavajësò, për përballimin e situatës COVID-19ò për vlerën 1,060,685 dhe Pagese TVSH për pajisjet e furnizuara donacion nga PNUDI ne kuadër te Covid-19, për vlerën 727,983 lekë dhe është shtuar Rikonstruksion i shërbimit te reaminacionit të Spitalit. Vlore me vlerën 1,788,668 lekë.

Lidhur me projektin 19AD301 ñF.V respiratorë për spitaletò të ndërmarr në zbatim të VKM 205, datë 9.03.2020 (200,000,000 lekë, shpezime kapitale), kontrata e lidhur me TSB me fond limit 129,727,371 lekë pa TVSH, është miratuar me vendim Nr.274, datë 3.4.2020 ñPër Miratimin e Kontratës Me Objekt ñ*Furnizim Vendosje Respiratorë Me Dy Modalitete Për Adult Dhe Moshë Pediatrike Për Covid-19*òò, në zbatim të VKM 203 e cila në nenin VII të saj përcakton se ñ*Kontratat, që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit pas nënshkrimit të tyre, do të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Kontrata do të hyjë në fuqi pas këtij miratimi.*ò

Mbas realizimit të procedurës dhe negocimit të kontratës me operatorin ekonomik ñT.ò shpk, dhe AK të MSHMS është lidhur Kontrata e furnizimit me nr.1365/36, datë 27.03.2020 me vlerë 75,060,000 lekë pa TVSh, e cila ka hyrë në fuqi me miratimin e VKM nr.274, datë 03.04.2020, me afate lëvrimi 20 respiratorë brenda 7 ditëve dhe 34 respiratorë do të lëvrohen për 25 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të kontratës. Nga auditimi u konstatua se me shkresat nr.1803, datë 10.04.2020 dhe nr.1365/39 datë 24.04.2020 nga operatori **ekonomik fitues "T." shpk, është kërkuar zgjatje e afateve të dorëzimit të pajisjeve deri në periudhën maj – qershor, duke e humbur faktorin kohë për** emergjencë. OE deri 10.04.2020 ka dorëzuar vetëm 5 copë. Ndërsa 34 respiratorë që do të lëvroheshin 25 ditë nga dita e hyrjes në fuqi e kontratës, nuk u siguruan, duke sjellë dështimin e kontratës së mësipërme.

Në vijim, në kushtet kur detyrimet kontraktuale nuk u përmbushën nga operatori ñT.ò, ky projekt u realizua me dy operatorë të tjerë në zbatim të Ligjit të Prokurimit Publik, edhe pse VKM Nr.274, datë 3.4.2020 kishte miratuar realizimin e kësaj kontrate me operatorin ñT.ò. Në total pagesat për projektin e respiratorëve paraqiten si më poshtë:

Pagesat për projektin e respiratorëve

FURNITORI	*SHUMA*	*DATA_FURNITORIT*	*DATA_URDHER_SHPENZIMIT*
MSE	34,362,000	28-Oct-20	03-DEC-2020
MSE	34,362,000	13-Nov-20	03-DEC-2020
M.	91,699,200	9-Dec-20	21-DEC-2020
ñT.ò SHPK	8,340,000	8-Apr-20	16-JUL-2020

Burimi: Data baza Thesarit 2020
Përpunoi: Grupi i auditimit

c. Detajimi i donacioneve për të përballuar pandeminë:

Tabela e detajimit të donacioneve për të përballuar pandeminë Covid-19 paraqitet në aneksin nr. 6. Total i donacioneve për vitin 2020 ishte 171,334,670 lekë. Deri në Maj 2021, ishin kontraktuar 162,049,541 lekë, prej të cilave likuiduar 7,988,472 lekë në vitin 2020 dhe me 2,433,069 lekë në vitin 2021.



Pergatiti: Grupi i auditimit te KLSH
Burimi:https://www.financa.gov.al/raporte-monitorimi-nga-ministrite-e-linjes-institucionet-qendrore-2020/



d. Përmbledhje për programin e menaxhuar nga Aparati me fokus fondet Covid:

Detajimi i fondeve të Covidit aparati MSHMS dhe burimi i tyre

Nr.	Akti	Efekti financiar mbulohet		Vlerat	Llogarite
1	VKM 205, datë 9.03.2020 400,000,000	Fondi rezerve	Shpz Korrente	200,000,000	llogaria 602
			Shpz Kapitale	200,000,000	llogaria 213
2	VKM nr. 240, datë 21.03.2020 46,105,800	Fondi rezerve	Shpz Korrente	46,105,800	llogaria 602
3	VKM 249, datë 27.03.2020 1,800,000,000	Fondi Anti-Covid	Shpz Korrente	800,000,000	llogaria 602
			Shpz Kapitale	1,000,000,000	llogaria 213
4	VKM nr.259, datë 27.03.2020 11,000,000	Fondi rezerve	Shpz Korrente	11,000,000	llogaria 600
5	VKM nr. 354, dt.29.04.2020 19,000,000	Fondi rezerve	Shpz Korrente	19,000,000	llogaria 600
6	*VKM nr. 926 datë 25.11.2020* (41,800,000)	Pakësohet buxheti i aparatit MSHMS			llogaria 600

7	*Akti Normativ nr.34 16.12.2020*	Paksohet llogaria 600 e aparatit në vlerën *28,200,000lekë*, Paksohet llogaria 601 e aparatit në vlerën *10,000,000 lekë*, shtohet llogaria 602 e aparatit në vlerën *13,600,000lekë*.	
8	**Donacione**	**171,334,670**	

Burimi: MSHMS
Përpunoi: Grupi i auditimit

Në mënyrë të detajuar VKM-të kryesore të miratuara për përballimin e situatës së krijuar nga Covid-19, dhe kontratat e lidhura në zbatim të tyre paraqiten në aneksin nr.7.

Grafiku në vijim paraqet shpërndarjen e fondeve anti Covid, sipas burimit të krijimit, për llogari të Aparatit të MSHMS:



Pergatiti: Grupi i auditimit të KLSH

Grafiku në vijim paraqet shpërndarjen e fondeve anti- Covid sipas përdorimit:



Pergatiti: Grupi i auditimit të KLSH

Lidhur me Fondin Anti-Covid, në nenin 3 (buxheti i sigurimeve shëndetësore) tëAktit Normativ Nr.6, datë 21.3.2020 është përcaktuar se ky fond ishte në vlerën 2.5 miliard lekë ññ*Fondi anti-Covid-19 prej **2 500 milione** leke, detajohet dhe perdoret me vendim te Keshillit te Ministrave, për shpenzime korente dhe kapitale*ò., ndërkohë që me këtë akt normativ janë akorduar **vetëm** 1,2 miliardë lekë për FSDKSH-në. Në vijim, në zbatim të VKM nr. 249, datë27.03.2020, fondi Anti-Covid prej **2,5** miliardë lekëështë detajuar duke pakësuar buxhetin e FSDKSH për **2.5** milardë lekë dhe duke shtuar:

- **0.5** miliard lekë për FSDKSH,
- **1,8** miliard lekë për Aparatin MSHMS, dhe
- **0.2** miliard lekë për programe që menaxhohen nga ISHP dhe Shërbimin Kombëtar të Urgjencës.

Pra, burimin i krijimit të Fondit AntiCovid në vlerën 2.5 miliardë lekë rezulton se është:

- **1,2** miliardë lekë shtuar me Aktin normativ nr. 6, ndërsa
- **1,3** miliardë lekë buxhet i **sigurimeve shëndetësor.**

Konkluzion:

- Në fillim të vitit 2020, programi 01110 i cili menaxhohet kryesisht nga aparati MSHMS,është çelur me vlerën **423,068,000 lekë**. Në fund të vitit buxheti, pas ndryshimeve të ndodhura gjatë vitit, buxheti për këtë program rezultoi në vlerën **2,633,674,000 lekë**. Në total ky program gjatë vitit 2020 është shtuar me 2,210,605,800lekë, pasi ka pësuar ndryshime me 6 VKM dhe 1 akt normativ si më poshtë[18]**:**

  5VKM kanë shtuar fondet e këtij programi në vlerën **2,276,105,800 lekë**për të përballuar situatën e shkaktuar nga Covid-19,përkatësisht*VKM-së nr. 205,* datë 09.03.2020 shtuar fondi prej *400,000,000 lekë*; *VKM nr. 240, datë 21.03.2020* shtuar fondi prej *46,105,800 lekë; VKM 249, datë 27.03.2020* ññPër detajimin dhe mënyrën e përdorimit të Fondit AntiCovid-19 *shtuar fondi 1,800,000,000 lekë; VKM nr.259, datë 27.03.2020,* shtuar fondi prej 11,000,000 lekësh;*VKM nr. 354, dt. 29.04.2020* shtuar fondi prej *19,000,000 lekë*;

  1 VKM ka pakësuar fondet e këtij programi me **41,800,000 lekë**,përkatësisht*VKM nr. 926 datë 25.11.2020"Për rishpërndarjen e fondeve në buxhetin e vitit 2020 ndërmjet ministrive dhe*

[18]Shtuar në fillim të vitit 900,000 lekë fond i veçantë

*institucioneve buxhetore*ò ; dhe
Akti normativ *nr. 34, datë 16.12.2020 "Për disa ndryshime në ligjin 882019, për buxhetin e vitit 2020*ò ka pakësuar fondin me**24,600,000 lekë**.
Për përballimin e situatës së krijuar nga Covid-19, ka përfituar edhe **171,334,670 lekë donacione.**

Pra në total për përballimin e situatës së shkatuar nga pandemia Covid-19, Aparati MSHMS ka përfituar **2,447,440,470 lekë,** prej të cilave 476,105,800 lekë nga Fondi Rezervë i shtetit, 1,800,000,000 lekë nga Fondi Anti-Covid dhe 171,334,670 lekë donacione.

- Projekti 18BA301 parashikuar në PBA-në 2020-2022 (pra përpara se të ndodhte pandemia) për tu përballuar me buxhet shteti është përballuar me fonde Covid, duke shkaktuar ndryshimin e destinacionit të këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për blerje kompjuterësh.
- Fondet prej ***15,791,138 lekë*** i akorduar në bazë të VKM 249, datë 27.03.2020 *"Për detajimin dhe mënyrën e përdorimit të Fondit AntiCovid-19"* për përballimin e situatës së krijuar nga Covid -19, është përdorur për të shlyer detyrime që kanë rrjedhur nga kontrata të lidhur në vitit 2019, duke denatyruar përdorimin e fondeve.

2. *Programi 01190*

Çelja fillestare dhe buxheti në fund për programin 01190 000 lekë

Programet	Viti 2020 celja fillestare			Totali	Viti 2020 I korrektuar (31 Dhjetor 2020)			Totali
		Shpenzime kapitale				Shpenzime kapitale		
Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë	Totali korente	Financim I brendshem	Financim I huaj		Totali korente	Financim I brendshem	Financim I huaj	
	1,036,000	1,200	-	1,037,300	1,036,100	1,200	-	1,037,300

Burimi: MSHMS
Përpunoi: Grupi i auditimit

- Në zbatim të pikave 52, 58 të Udhëzimit plotësues të MFE-së nr. 2, datë 20.01.2020, ñ*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020*ò, MSHMS-së i në këtë program **100,000 lekë *(fondi i vecantë).*** Me anë të shkresës nr. 2852/1, datë 12.02.2020 MFE i drejtohet degës së Thesarit dhe MSHMS-së duke dërguar detajimin e fondit të veçantë 2020. *Programi 1190 n*uk ka pësura ndryshime gjatë vitit 2020.

3. *Programi 07220*

Çelja fillesatare dhe buxheti në fund 2020 programi 07220 000 lekë

Programet	Viti 2020 celja fillestare			Totali	Viti 2020 I korrektuar (31 Dhjetor 2020)			Totali
		Shpenzime kapitale				Shpenzime kapitale		
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	Totali korente	Financim I brendshem	Financim I huaj		Totali korente	Financim I brendshem	Financim I huaj	
	7,636,862	526,276	158,000	8,321,138	7,302,122	450,346	-	7,752,468

Burimi: MSHMS
Përpunoi: Grupi i auditimit

- Në zbatim të pikave 52, 58 të Udhëzimit plotësues të MFE-së nr. 2, datë 20.01.2020, ñ*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020*ò, MSHMS-së i në këtë program **260,000 lekë** *(fondi i veçante).* Me anë të shkresës nr. 2852/1, datë 12.02.2020 MFE i drejtohet degës së Thesarit dhe MSHMS-së duke dërguar detajimin e fondit të veçantë 2020.
- Me shkresën nr. 2438, dt. 01.04.2020 FSDKSH ka kërkuar MFE transferimin e fondeve mes programeve**.** Me shkresën nr. 6110 datë 02.04.2020 ne zbatim të VKM nr. 261, datë 27.03.2021 ñPër një Rishpërndarje Fondesh në Buxhetin e Vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Socialeò MFE ka kryer transferimin e fondeve mes programeve

07220 (duke e pakësuar) dhe 07330 (duke e shtuar) në vlerën ***450.000.000*** lekë, në zërin e shpenzimeve korrente.

- Me shkresën nr. 4418, dt. 01.10.2020 SP i MSHMS ka kërkuar MFE zbatimin e VKM nr 755, dt 23.09.2020.Me shkresën nr. 8439/1, dt. 08.10.2020 në zbatim të VKM Nr. 755, datë 23.9.2020 ñPër Rishpërndarje Fondesh Buxhetore, Ndërmjet Programeve të Miratuara në Buxhetin e Vitit 2020, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Socialeò MFE ka kryer transferimin e fondeve mes programeve 07220 (duke e shtuar) dhe 07330 (duke e pakësuar) në vlerën ***406.000.000 lekë,*** *në zërin e shpenzimeve korrente*
- Me shkresën nr. 8836/1, dt 22.12.2021 FSDKSH i është drejtuar MFE duke kërkuar zbatimin e VKM nr. 1043, dt. 18.12.2020 ñPër Rishpërndarje Fondesh Buxhetore, Ndërmjet Programeve të Miratuara në Buxhetin e Vitit 2020, Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Socialeò për lëvizjen mes programeve 07220 (duke e pakësuar) dhe 07330 (duke e shtuar) në vlerën ***300.000.000 lekë***. Me shkresën nr. 24075/1, dt. 31.12.2020 MFE ka miratuar transferimin e kërkuar.
- Me shkresën nr. 5588/1, datë 18.12.2021 SP i MSHMS ka kërkuar zbatimin e AN nr. 34 date 16.12.2020 ñPër disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 Për Buxhetin 2020ò, te ndryshuar. Me shkresën nr. 23412/12, dt. 21.12.2020 MFE ka detajuar ndryshimet duke shtuar ne programin 7220 vlerën 9.000.000 lekë, për shpenzimet korrente. Ndërsa, në zbatim të këtij Akti normative është pakësuar në vlerën 75,930,000 lekë financimi i brendshëm dhe në vlerën 158,000,000 lekë financimi I huaj në zërin e shpenzimeve kapitale.

4. Programi 07330

Çelja fillestare dhe buxheti në fund 2020, programi 07330 000 lekë

Programet	Viti 2020 celja fillestare			Totali	Viti 2020 I korrektuar (31 Dhjetor 2020)			Totali
		Shpenzime kapitale				Shpenzime kapitale		
Kujdesi Shëndetësor Spitalor	Totali korente	Financim i brendshëm	Financim i huaj		Totali korente	Financim i brendshëm	Financim i huaj	
	23,702,450	*1,306,014*	*852,000*	***25,860,464***	*24,413,827*	*1,007,418*	*950,000*	***26,371,245***

Burimi: MSHMS
Përpunoi: Grupi i auditimit

- Në zbatim të pikave 52, 58 të Udhëzimit plotësues të MFE-së nr. 2, datë 20.01.2020, ñ*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020*ò, MSHMS-së i në këtë program **1,177,000 lekë***(fondi i veçantë).*Me anë të shkresës nr. 2852/1, datë 12.02.2020 MFE i drejtohet degës së Thesarit dhe MSHMS-së duke dërguar detajimin e fondit të veçantë 2020.
- Me shkresën nr. 1562/1, dt. 24.03.2021 SP i MSHMS ne vijim të shkresës së FSDKSH nr 2329, dt. 24.3.2021, ka kërkuar nga MFE zbatimin e aktit normative nr Nr.6, datë 21.3.2020 ñPër Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr.88/2019, për Buxhetin e Vitit 2020ò. Me shkresën nr. 5800/8, dt. 27.03.2021 MFE ka dërguar transferimin e fondit prej ***1,200,000,000 lekë*** fonde të cilat do të shkojnë për trajtimin e personave të prekur nga COVID-19.
- Me shkresën nr. 162/1, dt. 01.04.2020, SP i MSHMS ka kërkuar MFE zbatimin e VKM nr. 249, dt. 27.03.2020 ñPër një shtesë fondi në buxhetin e vitin 2020, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për infeksionin e shkaktuar nga Covid-19ò. MFE me shkresën nr. 6124/1, dt. 03.04.2020 ka dërguar transferimin e kryer mes programeve, duke pakësuar këtë program në vlerën **2,000,000,000 lekë** në zërin e shpenzimeve korrente.
- Me shkresën nr. 2438, dt. 01.04.2020 FSDKSH ka kërkuar MFE transferimin e fondeve mes programeve. Me shkresën nr. 6110 datë 02.04.2020 ne zbatim të VKM nr. 261, datë

27.03.2021 ñPër një Rishpërndarje Fondesh në Buxhetin e Vitit 2020, Miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë Dhe Mbrojtjes Socialeò MFE ka kryer transferimin e fondeve mes programeve 07220 dhe 07330 (duke u shtuar) në vlerën **450,000,000 lekë** në zërin e shpenzimeve korrent

- Me shkresën nr. 4418, dt. 01.10.2020 SP i MSHMS ka kërkuar MFE zbatimin e VKM nr. 755, dt. 23.09.2020.Me shkresën nr. 8439/1, dt. 08.10.2020 ne zbatim të VKM Nr. 755, datë 23.9.2020 ñPër rishpërndarje fondesh buxhetore, ndërmjet programeve të miratuara në buxhetin e vitit 2020, për ministrinë e shëndetësisë dhe mbrojtjes socialeò MFE ka kryer transferimin e fondeve mes programeve 07220 dhe 07330 (duke u pakësuar) në vlerën **406,000,000 lekë** në zërin e shpenzimeve korrente.
- Me shkresën nr. 3235, dt. 07.07.2020 SP i MSHMS i ka kërkuar MFE zbatimin e AN nr. 28, dt. 2.7.2020 ñPër disa ndryshime në ligjin për buxhetin e vitit 2020ò. Me shkresën nr. 12507/30, datë 08.07.2020 MFE ka dërguar transferimin e fondeve duke shtuar programin 07330 me **1.256.000.000 lekë** në zërin e shpenzimeve korrente. Ndërsa në zbatim të këtij akti normative, është pakësuar **35,700,000** lekë financimi i brendshëm në zërin e shpenzimeve kapitale.
- Me shkresën nr. 5347, dt. 01.12.2020 SP i MSHMS ka kërkuar MFE zbatimin e VKM nr. 926, dt. 25.11.2020 ñPër Rishpërndarje Fondesh Buxhetore, ndërmjet Ministrive dhe institucioneve buxhetoreò. Me shkresën nr. 17533/9, dt. 03.12.2020 MFE ka miratuar dhe dërguar rishpërndarjen e fondeve duke prekur këtë program në llogaritë 600-601 dhe 602 duke e pakësuar në vlerën **190,500,000 lekë** në zërin e shpenzimeve korrente.
- Me shkresën nr. 5588/1, datë 18.12.2021 SP i MSHMS ka kërkuar zbatimin e AN nr. 34 date 16.12.2020 ñPër disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 Për Buxhetin 2020ò, te ndryshuar. Me hkresën nr. 23412/12, dt. 21.12.2020 MFE ka detajuar ndryshimet duke shtuar ne programin 7330 vlerën **100,000,000 lekë** në zërin e shpenzimeve korrente. Në zbatim të këtij akti normative financimi I brendshëm është zvogëluar me **263,596,000** lekë dhe financimi i huaj është paksuar në vlerën **98,000,000 lekë**, në zërin e shpenzimeve kapitale.
- Me shkresën nr. 8836/1, dt. 22.12.2021 FSDKSH i është drejtuar MFE duke kërkuar zbatimin e VKM nr. 1043, dt. 18.12.2020 ñPër Rishpërndarje Fondesh Buxhetore, Ndërmjet Programeve të Miratuara në Buxhetin e Vitit 2020, Për Ministrinë E Shëndetësisë Dhe Mbrojtjes Socialeò për lëvizjen mes programeve 07220 dhe 07330 (shtuar) në vlerën **300,000,000 lekë**, në zërin e shpenzimeve korrente. Me shkresën nr 24075/1, dt 31.12.2020 MFE ka miratuar transferimin e kërkuar.
- Me anë të shkresës nr. nr. 22473, dt. 10.12.2020 MFE ka miratuar akordimin e vlerës **700,000,000** lekë për fondin e veçantë (shpërblime për dalje në pension).

5. *Programi 07450*

Çelja në fillim dhe buxheti në fund të vitit 2020, programi 07450 000 lekë

Programet	Viti 2020 çelja fillestare			Totali	Viti 2020 I korrektuar (31 Dhjetor 2020)			Totali
		Shpenzime kapitale				Shpenzime kapitale		
Shërbime të Shëndetit Publik	Totali korente	Financim i brendshëm	Financim I huaj		Totali korente	Financim i brendshëm	Financim i huaj	
	2,984,428	23,500		**3,007,928**	***2,999,351***	***3,000***	***0***	***3,002,351***

Burimi: MSHMS
Përpunoi: Grupi i auditimit

- Në zbatim të pikave 52, 58 të Udhëzimit plotësues të MFE-së nr. 2, datë 20.01.2020, ñ*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020*ò, MSHMS-së i në këtë program **5,863,000 lekë***(fondi i veçantë)***.** Me anë të shkresës nr. 2852/1, datë 12.02.2020 MFE i drejtohet degës së Thesarit dhe MSHMS-së duke dërguar detajimin e fondit të veçantë 2020.

- Me shkresën nr. 162/1, dt. 01.04.2020, SP i MSHMS ka kërkuar MFE zbatimin e VKM nr. 249, dt. 27.03.2020 ñ*Për një shtesë fondi në buxhetin e vitin 2020, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për infeksionin e shkaktuar nga Covid-19*ò. MFE me shkresën nr. 6124/1, dt. 03.04.2020 ka dërguar transferimin e kryer mes programeve duke shtuar këtë program në vlerën **150,000,000 lekë.**
- Me shkresën nr. 3235, dt. 07.07.2020 SP i MSHMS i ka kërkuar MFE zbatimin e AN nr. 28, dt. 2.7.2020 ñPër disa ndryshime në ligjin për buxhetin e vitit 2020ò. Me shkresën nr 12507/30, datë 08.07.2020 MFE ka dërguar transferimin e fondeve duke pakësimin e financimit të brendshëm me **10,000,000 lekë**, në zërën e shpenzimeve kapitale.
- Me shkresën nr. 5347, dt. 01.12.2020 SP I MSHMS ka kërkuar zbatimin e VKM nr. 926, dt. 25.11.2020 ñPër rishpërndarje fondesh buxhetore, ndërmjet Ministrive dhe institucioneve buxhetoreò. Me shkresën nr. 926, dt. 25.11.2020 MFE ka dërguar transferimin e kërkuar duke pakësuar këtë program në llogaritë 600-601-602 dhe 604 në vlerën **141.000.000 lekë.**
- Në zbatim të AN nr. 34 date 16.12.2020 ñPër disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 Për Buxhetin 2020ò, te ndryshuar, është pakësuar zëri financim i brendshëm, në vlerën **10,500,000 lekë** në këtë program.

6. Programi 07460

Çelja fillestare dhe buxheti në fund 2020, programi 07460 000 lekë

Programet	Viti 2020 çelja fillestare			Totali	Viti 2020 I korrektuar (31 Dhjetor 2020)			Totali
		Shpenzime kapitale				Shpenzime kapitale		
Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore	Totali korente	Financim i brendshëm	Financim i huaj		Totali korente	Financim i brendshëm	Financim i huaj	
	310,000	*23,182*	-	*333,182*	*324,000*	*23,182*	-	*347,182*

Burimi: MSHMS
Përpunoi: Grupi i auditimit

- Në zbatim të pikave 52, 58 të Udhëzimit plotësues të MFE-së nr. 2, datë 20.01.2020, ñ*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020*ò, MSHMS-së i janë alokuar 10,000,000 lekë në artikullin 606, prej të cilave aparatit të MSHMS-së i kanë kaluar ***200,000 lekë.*** Me anë të shkresës nr. 2852/1, datë 12.02.2020 MFE i drejtohet degës së Thesarit dhe MSHMS-së duke dërguar detajimin e fondit të veçantë 2020.
- Me shkresën nr. 3235, dt. 07.07.2020 SP i MSHMS I ka kërkuar MFE zbatimin e AN nr. 28, dt. 2.7.2020 ñPër disa ndryshime në ligjin për buxhetin e vitit 2020. Me shkresën nr. 12507/30, datë 08.07.2020 MFE ka dërguar transferimin e fondeve duke shtuar programin 07460 në llogarinë 600 me **50,000,000 lekë."** Efekti financiar i këtij akti normative ka ardhur nga fondin e kontigjencës për paketën Covid-19.
- Me shkresën nr 5347, dt. 01.12.2020 SP i MSHMS ka kërkuar MFE zbatimin e VKM nr. 926, dt. 25.11.2020 ñPër Rishpërndarje Fondesh Buxhetore, Ndërmjet Ministrive dhe Institucioneve Buxhetoreò. Me shkresën nr. 17533/9, dt. 03.12.2020 MFE ka miratuar dhe dërguar rishpërndarjen e fondeve duke prekur këtë program në llogaritë 600-dhe 602 duke e pakësuar në vlerën **28,800,000 lekë**.

- Në zbatim të Akti normativ nr. 28, dt. 02.07.2020, MFE me shkresën nr. 12507/49, dt. 14.07.2020, MFE ka pakësuar këtë program në zërin e shpenzimeve korrente në vlerën **21,500,000 lekë.**
- Me shkresën nr. 5588/1, datë 18.12.2021 SP i MSHMS ka kërkuar zbatimin e AN nr. 34 date 16.12.2020 ñPër disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 Për Buxhetin 2020ò, te ndryshuar. Me shkresën nr. 23412/12, dt. 21.12.2020 MFE ka detajuar ndryshimet duke shtuar ne programin 07460 në llogarinë 602 vlerën **14,100,000 lekë.**

7. Programi 10430

Çelje fillestare dhe buxheti në fund 2020, program 10430 000 lekë

Programet	Viti 2020 çelja fillestare			Totali	Viti 2020 I korrektuar (31 Dhjetor 2020)			Totali
		Shpenzime kapitale				Shpenzime kapitale		
Përkujdesi Social	Totali korente	Financim i brendshëm	Financim i huaj		Totali korente	Financim i brendshëm	Financim i huaj	
	23,849,260	*37,700*	*100,000*	*23,986,960*	*27,968,935*	*12,700*	*40,000*	*28,021,635*

Burimi: MSHMS
Përpunoi: Grupi i auditimit

- Në zbatim të pikave 52, 58 të Udhëzimit plotësues të MFE-së nr. 2, datë 20.01.2020, ñ*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020*ò, MSHMS-së i janë alokuar 10,000,000 lekë në artikullin 606, prej të cilave aparatit të MSHMS-së i kanë kaluar ***1,500,000 lekë.*** Me anë të shkresës nr. 2852/1, datë 12.02.2020 MFE i drejtohet degës së Thesarit dhe MSHMS-së duke dërguar detajimin e fondit të veçantë 2020.
- Me shkresën nr.1653/1, dt.01.04.2020 SP i MSHMS i ka kërkuar MFE zbatimin e VKM nr.254, dt. 27.3.2020 ñMasat për përfitimin e ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike dhe të pagesës të papunësisëò me anë të të cilës do të dyfishohet Ndihma Ekonomike për 3 muaj në kuadër të pandemisë. ME shkresën nr.6100, dt.02.04.2020 MFE ka dërguar transferimin duke shtuar fondin prej **1,031,655.30 lekë** në llogarinë 606 të programit 10430.
- Me shkresën nr.2386/1, dt.27.05.2020 SP i MSHMS i ka kërkuar MFE zbatimin e VKM nr.371, dt. 6.5.2020 ñPër dhënie shpërblimi për personelin që shërben në institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale publike, që janë në përgjegjësi administrimi të shërbimit social shtetëror dhe të bashkiveò. Me shkresën nr.9701/1, dt.05.06.2020 MFE ka transferuar fondin prej **12,700,000 lekë** në llogarinë 600 të këtij programi.
- Me shkresën nr.3235, dt.07.07.2020 SP i MSHMS i ka kërkuar MFE zbatimin e AN nr. 28, dt. 2.7.2020-Për disa ndryshime në ligjin për buxhetin e vitit 2020. Me shkresën nr.12507/30, datë 08.07.2020 MFE ka dërguar transferimin e fondeve duke shtuar programin 10430 në llogarinë 600 dhe 601 me **51,500,000 lekë.** Efekti financiar i këtij akti normative ka ardhur nga fondin e kontigjencës për paketën Covid-19. Në zbatim të këtij akti normative, është pakësuar Financimi brendshëm i këtij programi në vlerën **15,000,000 lekë.**
- Me shkresën nr.4416, dt.01.10.2020 SP i MSHMS ka kërkuar MFE zbatimin e VKM nr.754, dt.23.09.2020 ñPër një ndryshim në vendimin nr. 371, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, ñPër dhënie shpërblimi për personelin që shërben në institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale publike, që janë në përgjegjësi administrimi të Shërbimit Social Shtetërorò. Me shkresën nr.18428/1, dt.08.10.2020 MFE ka transferuar **20,570,000** lekë në llogarinë 600 të këtij programi.
- Me shkresën nr.5347, dt.01.12.2020 SP i MSHMS ka kërkuar MFE zbatimin e VKM nr.926, dt.25.11.2020 për rishpërndarje fondesh buxhetore, ndërmjet Ministrive dhe institucioneve

buxhetoreò. Me shkresën nr.17533/9, dt.03.12.2020 MFE ka miratuar dhe dërguar rishpërndarjen e fondeve duke prekur këtë program në llogaritë 606 duke e shtuar në vlerën **2,000,000,000** lekë.

- Me shkresën nr.5588/1, datë 18.12.2021 SP i MSHMS ka kërkuar zbatimin e AN nr.34 date 16.12.2020 ñPër disa ndryshime në ligjin nr.88/2019 Për Buxhetin 2020ò, te ndryshuar. Me shkresën nr. 23412/12, dt.21.12.2020 MFE ka detajuar ndryshimet duke shtuar ne programin 10430 në llogarinë 600-601-602-606 vlerën **1,001,500,000 lekë**, në zërin e shpenzimeve korrente. Në zbatim të këtij akti normative është zvogëluar financimi i brendshëm në vlerën **10,000,000 lekë** dhe financimi i huaj në vlerën **60,000,000 lekë**, në zërin e shpenzimeve kapitale.

Konkluzion për vitin 2020:
Është konstatuar gjithashtu se gjatë vitit 2020 ka pasur lëvizje të **shumta** të buxhetit të MSHMS, ku programi 01110 i cili administrohet kryesisht nga Aparati MSHMS, ka ndryshuar me 6 VKM dhe 1 akt normativ, ndërsa në total buxheti i MSHMS është ndryshuar me **3** akte normative dhe **12** VKM.

E) Të ardhura dytësore
1. Gjate vitit 2019 janë krijuar të ardhura për Aparatin e MSHMS në shumen 2 423 338 lekë. Kjo shumë bazuar në legjislacionin në fuqi është derdhur plotësisht në buxhet.
2.Gjatë vitit 2020 të ardhurat e krijuara në shumën **172,044,460 leke** kanë si burim veprimtarinë e Institucionit si licenca, leja importi, etj., në shumën 709,790 lekë dhe donacione në shumen 171,334,670 lekë
-Nga totali i të ardhura te krijuara për vitin 2020 janë derdhur në buxhetin e shtetit **709,790 lekë**.
-Nga te ardhurat për MSHMS në shumen **171 334 670 leke** gjatë vitit 2020 janë përdorur **7,988,472 lekë** . Me anë të shkresave: nr. 3359, datë 13.07.2020; nr. 5020, datë 17.09.2020, nr. 3300, datë 12.10.2020; nr. 5509, datë 14.12.2020, nr. 423, datë 22.01.2021, S.P i MSHMS ka kërkuar rritje të autorizuar buxhetore kundrejt të ardhurave jo buxhetore, për përdorimin e fondeve, sikurse është paraqitura në tabelën në anekse (Detajimi i donacioneve).

F. Vonesa në hedhjen e kontratave në sistem
Në pikë 17, të Udhëzimit nr. 9.1, datë 20.03.2018 përcaktohet **"**Struktura e zbatimit te buxhetit ne varësi te Nëpunësit Zbatues te njësisë respektive regjistron menjëherë në sistemin SIFQ **kontratën** (referencat, vlerën totale te kontratës vlerën e kontratës qe parashikohet të likuidohet gjatë vitit korrent, grafikun e shlyerjes se kontratës, referencat e operatorit ekonomik) ose **urdhrin e prokurimit** për blerjet e vogla sipas rastit. Pas miratimit ne SIFQ nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues i njësisë *brenda **pesë** ditëve pune nga n6nshkrimi i tyr*e, dokumentacioni fizik si me sipër paraqitet ne gjuhen shqipe (ne rastin e kontratave te lidhura ne gjuhë te huaj) bashke me njoftimin përfundimtar zyrtar për shpalljen e fituesit ne strukturën përgjegjëse për thesarin ne dege. Nëpunësi i thesarit kryen kontrollin dokumentar ne prani te përfaqësuesit të njësisë dhe bën te vlefshëm përfundimisht transaksionin në librin e kontabilitetit te SIFQ. *Moszbatimi i afatit te mësipërm mund të shkaktoje vonesa ne likuidimin e pagesës nga sistemi i thesarit. Penalitetet kontraktuale te shkaktuara nga kjo vonese janë ne ngarkim te njësisë respektive"*
Nga auditim rezultoi se është shkelur disiplina buxhetore në 62 nga 64 raste (97%) në kundërshtim me pikën 17, të Udhëzimit nr. 9.1, datë 20.03.2018, pasi kontratat e lidhura janë regjistruar në SIFQ me mbi **5 ditë** vonesë. Në mënyrë analitike ato paraqiten në Aneksin nr.9.
Nga komunikimi me subjekt, grupi të auditimi iu bë me dije se: ñ*Arsyeja e hedhjes me vonese ne sistem sipas praktikes qe ndiqet tek ne është se dokumentacioni për likuidimin e kontratave te lidhura nga institucioni ynë dërgohen pranë sektorit te financës ne momentin kur do te kryhet pagesa (kur ka përfunduar procesi i dorëzimit te mallrave apo shërbimeve),rrjedhimisht që ato*

do te hidhen me vonese në sistem.ò[19]

Konkluzion për vitin 2020
Me anë të VKM-ve nr. 354, datë 29.4.2020; nr.259, datë 27.3.2020; nr.240, datë 21.3.2020; nr. 205, datë9.3.2020 dhe nr. 249, datë 27.3.2020 janë akorduar për MSHMS-në **2,276,105,800 lekë**, me qëllim për të përballuar situatën e krijuar nga Covid-19, deri në 31.12.2020. Si rezultat i akordimit të fondeve më këto VKM, buxheti i MSHMS ka patur një numër të konsiderueshëm rialokimesh. Programi i administruar nga aparati MSHMS është prekur nga 6 VKM kryesore (në zbatim të tyre janë miratuar edhe 22 VKM të tjera) dhe 1 akt normative. Ndërsa në total buxheti i MSHMS është ndryshuar me **3** akte normative dhe **12** VKM kryesore. Donacionet për përballimin e situatës së krijuar nga Pandemia ishin në vlerën donacione në shumen **171,334,670** lekë.
Projekti 18BA301 në vlerën **960,000 lekë**, i parashikuar me fonde covid, sipas tabelës së detajimit të 1 mld lekëve, i hapur me të njëjtin kod projekti të parashikuar në PBA 2020-2022, përmban riskun se ky projekt i cili është planifikuar të realizohet me fondet e buxhetit të shtetit, është realizuar me fonde covid.
Nga auditimi u konstatua se fondet prej ***15,791,138 lekë*** i akorduar në bazë të VKM 249, datë 27.03.2020 ñPër detajimin dhe mënyrën e përdorimit të Fondit AntiCovid-19ò për përballimin e situatës së krijuar nga Covid -19, është përdorur për të shlyer detyrime që kanë rrjedhur nga kontrata të lidhur në vitit 2019, duke shkaktuar **mospërdorimin** e tyre për përballimin e pandemisë.
Gjithashtu u konstatua se është shkelur disiplina buxhetore në **62** nga **64** raste (97%) në kundërshtim me pikën 17, të Udhëzimit nr. 9.1, datë 20.03.2018, pasi kontratat e lidhura janë regjistruar në SIFQ me mbi **5** ditë vonesë.

Viti 2021

A) Plani buxhetor afatmesëm 2021-2023

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, dhe Udhëzimit nr. 9, datë 28.02.2020 ñPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afat Mesëm 2021-2023ò, me anë të Urdhrit nr. 455, datë 04.08.2020, të Titullarit të MSHMS, shkresa Nr.3697, datë 04.08.2020 është ngritur Ekipi i Menaxhimit të programeve për hartimin e projekt buxhetit afatmesëm 2021-2023, në MSHMS. Referuar Aktit Normativ Nr. 17, datë 22.4.2020, ñPër përjashtimin e zbatimit të procedurave dhe të afateve për përgatitjen e projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm për vitin 2020ò, ñ*Përjashtimisht për vitin 2020, si pasojë e situatës epidemike të shkaktuar nga COVID-19, procedurat dhe afatet për përgatitjen e projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të përcaktuara në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nuk zbatohen.*ò
Me anë të shkresës nr. 3585/1, datë **01**.09.2020, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 ñPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afat Mesëmò dhe Udhëzimit plotësues nr. 28, datë 10.07.2020 ñPër përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023ò, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i ka përcjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Projekt Buxhetin Afatmesëm 2021-2023, së bashku me dokumentet shoqëruese. Në zbatim të pikës 2/3.2 të Udhëzimit nr. 9, datë 28.02.2020, sipas të cilës ñBrenda datës **1** shtator të çdo viti, njësia e qeverisjes qendrore paraqet në ministrinë përgjegjëse për financat projektbuxhetin vjetor dhe atë afatmesëm në përputhje me tavanet e miratuaraò, MSHMS e ka përcjellë PBA 2021-2023, brenda afatit të përcaktuar.

PBA dhe çelja fillestare për vitin 2021 paraqitet si mëposhtë:

Në 000 lekë

Programet	Viti 2021 PBA 2021-2023			Totali	Viti 2021 celje fillestare			Totali
	Totali korente	Shpenzime kapitale			Totali korente	Shpenzime kapitale		
		Financim I brendshem	Financim I huaj			Financim i brendshem	Financim I huaj	
01110	376,688	5,000	-	381,688	376,687	5,000		381,687

[19] E-maili i datës 22.04.2021 i DBMF në MSHMS

07220	7,964,000	309,898	158,000	8,431,898	9,164,000	309,898	158,000	9,631,898
07330	25,183,000	2,090,802	852,000	28,125,802	25,910,117	2,090,802	852,000	28,852,919
07450	3,207,740	21,000		3,228,740	3,207,741	21,000		3,228,741
07460	328,100	15,000		343,100	328,100	15,000		343,100
10430	24,549,260	10,000	100,000	24,659,260	27,869,260	10,000	100,000	27,979,260
01190	1,050,000			1,050,000	1,035,000			1,035,000
Totali MSHMS	***62,658,788***	***2,451,700***	***1,110,000***	**66,220,488**	***67,890,905***	***2,451,700***	***1,110,000***	**71,452,605**

Burimi: MSHMS
Përpunoi: Grupi i auditimit

1. Titulli i Gjetjes:	**Rialokime të shpeshta të fondeve të aparatit MSHMS**
Situata:	MSHMS përgajtë vitit 2020, ka menaxhuar 7 programe buxhetore si me poshtë: 1. 01110 ñ*Planifikim Menaxhim Administrim*ò në shumën 2,633,673,800 lekë, i cili ka zënë rreth 4% të totalit të buxhetit vjetor të shëndetësisë 2. 07220 ñ*Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor*ò në shumën 7,752,468,000 lekë, i cili ka zënë rreth 11% të totalit të buxhetit vjetor të shëndetësisë 3. 07330 ñ*Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor*ò në shumën 26,371,245,000 lekë, i cili ka zënë rreth 38% të totalit të buxhetit vjetor të shëndetësisë 4. 07450 ñ*Shërbime të Shëndetit Publik*ò në shumën 3,002,351,000 lekë, i cili ka zënë rreth 4% të totalit të buxhetit vjetor të shëndetësisë 5. 07460 ñ*Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore*ò në shumën 347,182,000 lekë, i cili ka zënë rreth 1% të totalit të buxhetit vjetor të shëndetësisë 6. 10430 ñ*Përkujdesi Social*ò në shumën 28,021,635,000 lekë, i cili ka zënë rreth 41% të totalit të buxhetit vjetor të shëndetësisë 7. 01190 ñ*Rehabilitimi i të përndjekurve politike*ò në shumën 1,037,300,000 lekë, i cili ka zënë rreth 1% të totalit të buxhetit vjetor të shëndetësisë Nga auditimi rezultoi se, fondet buxhetore në total për MSHSM janë çelur me ligjin e buxhetit në shumën 62,969,940 mijë lekë dhe me rishikimet e ndodhura gjatë vitit, këto fonde rezultuan në shumën 69,165,854 mijë lekë në fund të vitit 2020, ose 6,195,914 mijë lekë më shume (ose rritur buxheti me 10%) nga sa është çelur fillimisht. Vihet re se, peshën më të madhe në fondet buxhetore të shëndetsisë e zë programi 010430 ñPër përkujdesin Socialò në masën 41%, i cili menaxhohet nga institucioni i varësisë ñShërbimi Social Shtetërorò. Ky program gjithashtu ka shënuar rritjen më të madhe me 4,034,675 mijë lekë nga buxheti fillestar në buxhetin e rishikuar në fund të vitit (ose 64% të total rritjes buxhetore prej 6,195,914 mijë lekë) Programi tjetër me impakt në rritjen totale buxhetore (rreth 35% ndaj total e buxhetit të shtuar), rezultoi programi 01110 ñ*Për planfikimin, menaxhimin dhe administrimin*ò, i cili u çel fillimisht në vlerën 423,068 mijë dhe nga ndryshimet e ndodhura gjatë vitit rezultoi në fund të vitit 2020 në vlerën 2,633,674, mijë lekë (ose shtuar me 525% nga sa çelur fillimisht). Shtesa në këtë program ka ardhur si rezultat i ndryshimeve të mëposhtme[20]: - **5** VKM kanë shtuar fondet e këtij programi në vlerën **2,276,105 mijë lekë** për të përballuar situatën e shkaktuar nga Covid-19, përkatësisht*VKM-së nr. 205,* datë 09.03.2020 shtuar fondi prej *400,000,000 lekë*; *VKM nr. 240, datë 21.03.2020* shtuar fondi prej *46,105,800 lekë; VKM 249, datë 27.03.2020* ñPër detajimin dhe mënyrën e përdorimit të Fondit AntiCovid-19 *shtuar fondi 1,800,000,000 lekë; VKM nr.259, datë 27.03.2020*, shtuar fondi prej 11,000,000 lekësh;*VKM nr. 354, dt. 29.04.2020* shtuar fondi prej *19,000,000 lekë*; - **1** VKM ka pakësuar fondet e këtij programi me **41,800,000 lekë**, përkatësisht *VKM nr. 926 datë 25.11.2020"Për rishpërndarjen e fondeve në buxhetin e vitit 2020 ndërmjet ministrive dhe institucioneve buxhetore*ò ; dhe - Akti normativ *nr. 34, datë 16.12.2020 "Për disa ndryshime në ligjin 882019, për buxhetin e vitit 2020*ò ka pakësuar fondin me **24,600,000 lekë**. *Për përballimin e situatës së krijuar nga Covid-19, Aparati MSHMS ka përfituar edhe* **171,334,670 lekë donacione.** Pra, në total për përballimin e situatës së shkaktuar nga pandemia Covid-19, Aparati

[20]Shtuar fondi i veçantë (për punonjësit që dalin në pension) në fillim të vitit 900,000 lekë.

	MSHMS ka përfituar **2,447,440,470 lekë,** prej të cilave 476,105,800 lekë nga Fondi Rezervë i shtetit, 1,800,000,000 lekë nga Fondi Anti-Covid dhe 171,334,670 lekë donacione. Në përfundim rezultoi se, gjatë vitit 2020 ka pasur lëvizje të **shumta** të buxhetit të MSHMS, ku programi 01110 i cili administrohet kryesisht nga MSHMS, ka pësuar ndryshime me 6 VKM dhe 1 akt normativ; ndërsa në total buxheti i MSHMS është ndryshuar me **3** akte normative dhe **12** VKM. Në vijim të akordimit të fondeve me VKM-të e mësipërme, buxheti i **Aparatit të MSHMS** ka patur një numër të konsiderueshëm rialokimesh. Gjatë periudhës maj-dhjetor 2020 projektet e çelura për investime në kuadër të përballimit të situatës së shkaktuar nga pandemi Covid 19, kanë ndryshuar 3 herë si më poshtë: - Deri në maj 2020 ishin çelur **15** projekte me qëllim përballimin e gjendjes së krijuar nga Covid-19. Në korrik 2020, **2** prej 15 projekteve u pakësuan pjesërisht, ndërsa **1** (*F.V pajisje mjekesore per covid 19*) prej 15 projekteve, u rialokua plotësisht, duke i shpërndarë këto fonde në 4 projekte të tjera, 3 prej të cilave çeleshin për herë të parë, ndërsa1 (F.V pajisje elektronike) prej tyre ishte projekt i planifikuar për tu realizuar me buxhetin e shtetit përpara se të ndodhte covdi-19 (trajtuar më në detaje në gjetjen nëvijim). - Në shtator 2020, u pakësuan edhe **2** prej 15 projekteve të çelura që maj të 2020**(**1 prej të cilëve u rialokuar plotësisht**).** Këto fonde u përdorën për të shlyer 3 detyrime të prapambetura nga viti 2019 (trajtuar më në detaje në gjetjen në vijim). - Në tetor 2020 u pakësuar pjesërisht **1** prej 15 projekteve të celura në maj 2020 dhe **1** projekt i ri i çelur në shtator 2020 (trajtuar më lart), duke shtuar 1 projekt të ri.
Kriteri:	Ligjin me nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar. VKM nr.249 date 27.03.2020 ñ*Për detajimin dhe mënyrën e përdorimit të fondit ANTICOVID-19*ò Udhëzimit plotësues të MFE-së Nr. 2, datë 20.01.2020, ñ*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020"*
Ndikimi/Efekti:	Rialokimet e shpeshta të buxhetit shkaktojnë një imapkt negativ në treguesit e performancës së zbatimit të buxhetit.
Shkaku:	Rialokimet e shpeshta të buxhetit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi 1:	Në të gjitha rastet në vijim, MSHMS të marrë masat për për kryerjen e një planifikimi sa më efektiv të fondeve në përputhje me objektivat institucionale, duke shmangur rialokimet e shpeshta të buxhetit dhe veçanërisht të projekteve të ndërmarra për të përballuar situatën e shkaktuar nga Covid-19.
Afati i zbatimit:	*Në vijimësi*

2. Titulli i Gjetjes:	**Ndryshimi i destinacionit të fondeve Covid**
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, fondet prej **16,751,138 lekë** akorduar për përballimin e situatës së krijuar nga Covid -19, kanë ndryshuar destinacionin, dhe janë angazhuar për të shlyer detyrime që kanë rrjedhur nga kontrata ose projekte të nisura më parë, nga të cilat: ***15,791,138 lekë*** alokuar për të shlyer detyrime që kanë rrjedhur nga kontrata të mëparshme; dhe ***960,000 lekë*** alokuar për blerje pajisje kompjuterike të planifikuar që në PBA 2020-2022 (përpara situatës së pandemisë), konkretisht*:* *c)* Nga analiza e buxhetit të akorduar për përballimin e fatkeqësisë natyrore konstatohet se, me anë të shkresës nr. 3871, datë 20.08.2020 drejtuar MFE-së, S.P i MSHMS-së ka kërkuar transferimin e fondeve për investime në shëndetësi, sipas të cilës është kërkuar pakësimi i fondeve të parashikuara për projektet: - ñRehabilitimi i shërbimit të Urologjisë dhe Klinikës së Tretë Kirurgjikale për kthimin e tyre në Konvaleshencës dhe Terapi Intensive në QSUTò në vlerë totale të tij 13,717,119 lekë; dhe - ñTVSH për projektin për furnizimin me pajisje mjekësore te specializuara per mbrojtje/trajtim te covid-19, ne kuadër te marrëveshjes grant te BE ku përfituesi është MSHMSò në vlerën 2,074,019 lekë. Këto fonde u përdorën për projektet: - ñRikonstruksione në disa ambiente të godinës MSHMSò (detyrim i vitit 2019)

	në vlerën **9,194,988 lekë,** - ñSupervizim dhe kolaudim për rikonstruksionet e disa godinave të MSHMSò (detyrim i vitit 2019) në vlerën **96,150 lekë,** - ñHartim i projekt preventivit të zbatimit për ndërtimin e Qendrës së re të Biosimulimit Klinik dhe edukimit në vazhdim për Universitetin e Mjekësisë tiranë në kuadër të paktit të Universitetitò (detyrim i vitit 2019) **6,500,000 lekë.** *d)* Me anë të shkresës nr. 2818, datë 15.06.2020, S.P i MSHMS i ka drejtuar MFE-së kërkesën për rialokimin e fondeve covid, duke pakësuar projektet: - *19AD302 F.V monitorë për spitalet* në vlerën 36,727,000 lekë; - *19AD306 Blerje autoambulancash për spitalet* në vlerën 60,000,000 lekë dhe - *19AD315 F.V pajisje mjekësore për covid 19* ne vlerën e plotë të këtij projekti 259,741,888 lekë dhe Këto fonde u alokuar në projektet: - 19AD317 F.*V pajisje mjekësore CT Skaner* 172,935,000 lekë; - 19AD318 *F.V pajisje mjekësore Rezonance magnetike MRI* 167,573,888 lekë; - *19AD316 Pagese TVSH për pajisjet e furnizuara donacion nga PNUDI ne kuadër te Covid-19* 15,000,000 lekë, dhe - ***18BA301*** *F.V pajisje elektronike ne kuadër te COVID-19*, **960,000 lekë.** Nëse do të referoheshim PBA 2020-2022, projekti 18BA301 ka qenë planifikuar më herët për tu realizuar në vitin 2020, pra përpara se të ndodhte pandemia Covid-19
Kriteri:	Ligjin me nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar. VKM nr.249 date 27.03.2020 ñ*Për detajimin dhe mënyrën e përdorimit të fondit ANTICOVID-19*ò Udhëzimit plotësues të MFE-së Nr. 2, datë 20.01.2020, ñ*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020"*
Ndikimi/Efekti:	Ndryshimi i destinacionit të fondeve Covid ka shkaktuar mospërdorimin e tyre për qëllimin për të cilin janë akorduar, përballimin e situatës së shkatuar nga Covid-19.
Shkaku:	Ndryshimi i destinacionit të fondeve Covid
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi 1:	Titullari i MSHMS të marrë masa për të ngritur një grupi të veçantë pune për të analizuar shkaqet dhe nxjerrë përgjegjësitë për ndryshimin e destinacionit të 16,751,138 lekë fonde Covid dhe në vijim, cka ka shkaktuar mospërdorimin e tyre për qëllimin për të cilin janë akorduar, përballimin e situatës së shkaktuar nga Covid-19.
Afati i zbatimit:	Brenda vitit 2021
Rekomandimi 2:	MSHMS, të marrë masat e nevojshme që në asnjë rast në vijim, mos të ndryshojë destinacioni i fondeve, për të siguruar kështu që fondet e saj të përdoren në funksion të qëllimit për të cilin janë akorduar, në përmbushje të nevojave të institucionit.
Afati i zbatimit:	Në vijimësi

III.3. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE

Në bazë të pikës 2 të programit, lidhur me Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave:

➢ ***Misioni dhe qëllimi i MSHMS***

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përputhje me legjislacionin përkatës,në përmbushje të misionit të saj ka për qellim:

- Zhvillimin dhe monitorimin e politikave, të legjislacionit, të programeve e të veprimtarive që lidhen me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe treguesit shëndetësorë të popullatës;
-Zhvillimin e politikave që synojnë mbrojtjen, promovimin, integrimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies sociale të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë;
- Zhvillimin e politikave për adresimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore, të abuzimit ndaj fëmijëve, grave dhe grupeve të tjera;
- Zhvillimin e politikave dhe të modeleve për ndihmën e shërbimet shoqërore alternative për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike.

-Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është e organizuar në drejtori si më poshtë:

1.Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit te Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

- Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Drejtoria e programeve te zhvillimit te shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale;
- Drejtoria e konceptimit dhe fizibilitetit të projekteve të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale;

2. Drejtoria e përgjithshme rregullatore dhe përputhshmërisë për shëndetësinë dhe Mbrojtjen sociale:

- Drejtoria e programimit, standartizimit dhe harmonizimit te kuadrit rregullator;
- Drejtoria e integrimit, koordinimit, marrëveshjeve dhe asistencës;
- Drejtoria e derregullimit, lejeve, licensave dhe monitorimit;

3. Drejtoria e përgjithshme ekonomike dhe shërbimeve mbështetëse:

- Drejtoria e buxhetit dhe menaxhimit financiar;
- Drejtoria e koncesioneve, prokurimeve dhe partneriteteve;
- Drejtoria e mirëadministrimit të burimeve njerezore, aseteve dhe shërbimeve

4. Drejtoria e auditimit te brendshëm.

➢ ***Respektimi i strukturës organike të miratuar.***

Struktura organike e MSHMS është miratuar me anë të urdhrit të Kryeministrit nr. 169, datë 05.10.2017. Numri i punonjësve të MSHMS është 146 veta. Me anë të urdhrit Nr. 174, datë 10.10.2017 është ndryshuar urdhri i mësipërm, i cili ka bërë që numri i punonjësve të MSHMS të jetë **148 veta**. MSHMS funksionon në bazë të Rregullores së Brendshme me urdhër nr.178, datë 22.02.2018, e përditësuar kjo me strukturën e re të MSHMS.

-Në janar te viti 2019 numri i vendeve vakante të punës ishte 15 si dhe numri i punonjësve me kontratë të përkohshme pune ishte 9 punonjës, nga te cilët 3 vende vakante.

U konstatua që:-Në janar të vitit 2020 numri i vendeve vakant të punës ishte 13. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ishte 9 punonjës, nga te cilët 3 vende vakante.

-Aktualisht nga informacionet e marra nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, janë 14 vende vakante.

U konstatua që nga ana e MSHMS, për periudhën objekt auditimi, vazhdimisht është bërë kërkesë në DAP, për vendet e lira të punës. Konkretisht nga Burimete Njerëzore, kërkesat e bëra me email drejtuar DAP-it në datat:

1. Në datën 20 Mars 2020, kërkesë për ôspecialistô në sektorin e Financës.
2. Në datën 29 Gusht 2019, kërkesë për :1) Përgjegjës Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor; 2)Përgjegjës i sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Farmaceutik; 3) Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore.

3.Në datën 19 Shkurt 2020, kërkesë për plotësimin e 10 vendeve vakante.

Përvec sa më sipër, gjatë viteve 2019-2020 në ministri janë punësuar me kontratë një-vjecare si dhe praktikantë në bazë të programit të praktikave të punës të administruar nga Ministria e Arsimit, konkretisht për vitin 2019-2020 5 praktikantë dhe per vitin 2020-2021, 6 praktikantë.

Gjatë periudhës së auditimit, në MSHMS u vu në zbatim urdhëri i Kryeministrit Nr.27, datë

09.02.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në urdhërin nr.169, datë 05.10.2017 për "Miratimin e strukturës dhe organikës të MSHMS", të ndryshuar, i cili ka urdhëruar :

a. Sektori i Programeve të Zhvillimit të Ndihmës Ekonomike - 1 Përgjegjës Sektori dhe 3 Specialistë.

b. Sektori i Programeve të Zhvillimti të aftësive të kufizuara -1 Përgjegjës Sektori dhe 2 Specialistë.

c. Numri i punonjësve në "Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale" bëhet 17 veta dhe numri i punonjësve të " Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale", bëhët 44 veta.

d. Drejtoria e Auditit të Brendshëm - 1 Drejtor dhe 4 Specialistë.

Komisioni I ristrukturimit ka shqyrtuar mundësitë e sistemimit të cdo nëpunësi civil të prekur nga ristrukturimi i MSHMS duke marrë parasysh riorganizimin e ri strukturor dhe ka konstatur se me krijimin e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor në Drejtorinë Qëndrore të tij është krijuar Sektori i Auditimit te Brendshem i cili kryen auditim të sturkturave në varësi të operatorit. Bashkë me konsolidimin e punës se këtij Sektori është zvogëluar ngarkesa e punës në drejtorinë e Auditimit te Brendshëm në Ministri, duke krijuar mundësinë e shkurtimit të dy pozicioneve në këtë drejtori, për të mundësuar riaorganizimin e sektorit te Ndihmës Ekonomike (NE) dhe Personat me Aftesi te Kufizuar (PAK), me qëllim adresimin me eficiencë dhe cilësi të Programeve të Aftesisë së Kufizuar në kushtet e shtrirjes së reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe Ndihmës Ekonomike.

-Vlerësimet e punës.

U morën në shqyrtim vlerësimet e 6-mujorit të parë 2019 dhe vlerësimet e 6-mujorit të parë 2020.

➢ ***Viti 2019***

U konstatua që formularët e vlerësimit janë sipas formatit të miratuar. Rubrikat janë të plotësuara, vlerësimi është kryer dhe firmosur nga nëpunësi raportues, konfirmues dhe autorizues sipas vendimit Nr. 109, datë 26.2.2014 ñPër vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilëò.
Niveli i vlerësimit për nëpunësit civil për 6-mujorin e parë 2019 ishte si me poshtë:

❖ ***Ndryshimet në organikë më 31.12.2019:***

Arsyeja	Nr. i punonjësve
Larguar me dëshirë	8 punonjes
Dalë në pension	1 punonjes
Rekrutuar me konkurs nga DAP	11 punonjes
Pezulluar me kërkesën e punonjësit	1 punonjes
Transferim	nuk ka
Emëruar në pozicion tjetër (*jo ne sherbim civil keshilltar, shofer, sekretar.)*	8 punonjes
Punësuar nga studentët e ekselencës	3 punonjes
Larguar nga shërbimi civil me masë disiplinore	1 punonjes

Burimi:BNJ

*Për vitin 2019 me anë të **VKM Nr. 16, datë 16.01.2019** ñPër përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2019 në njësitë e Qeverisjes Qendroreò janë caktuar **9 punonjës** për aparatin e MSHMS, me pozicion pune **konkretisht 6 operator dhe 3 punonjës arkivi.**

-Në lidhje me punonjësit të cilët janë të punësuar me kontratë të përkohshme, pra nuk janë pjesë e strukturës së MSHMS ndryshimet janë këto:

Arsyeja	Nr. i punonjësve
Emeruar me kontrate te perkohshme 6 ore (me te drejte rinovimi te kontrates)	8 punonjes
Larguar me dëshirë	3 punonjes
Përfundon kontrata e punës	1 punonjes

Burimi:BNJ

➢ ***Viti 2020***

Ndryshimet në organikë më 31.12.2020

Arsyeja	Nr. i punonjësve
Larguar me dëshirë	7 punonjes
Dalë në pension	5 punonjes
Rekrutuar me konkurs nga DAP	10 punonjes
Emerim Gjyqfitues nga DAP	1 punonjes
Pezulluar me kërkesën e punonjësit	3 punonjes
Transferim	4 punonjes
Emëruar në pozicion tjetër (*jo ne sherbim civil keshilltar, shofer, sekretar.)*	14 punonjes
Punësuar nga studentët e ekselencës	Nuk ka
Larguar nga shërbimi civil me masë disiplinore	Nuk ka

Burimi:BNJ

*Për vitin 2020 me anë të **VKM Nr. 47, datë 22.01.2020** ñPër përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2020 në njësitë e Qeverisjes Qendroreò janë caktuar **10 punonjës** për aparatin e MSHMS, me pozicion pune konkretisht **6 operator 1 operator EDRMS dhe 3 punonjës arkivi.**

Në lidhje me punonjësit të cilët janë të punësuar me kontratë të përkohshme, pra nuk janë pjesë e strukturës së MSHMS ndryshimet janë këto:

Arsyeja	Nr. i punonjësve
Emëruar me kontratë të përkohshme 6 orë (me të drejtë rinovimi te kontrates)	9 punonjes
Larguar me dëshirë	2 punonjes
Përfundon kontrata e punës	Nuk ka

Burimi:BNJ

➢ ***Mbi realizimin e fondit të pagave dhe krahasimi me vitet e kaluara***

Për sa i përket përputhshmërisë ligjore në lidhje me pagat e punonjësve nga auditimi me përzgjedhje rastësore i listë pagesave për vitin 2019 dhe 2020 u vu re se përllogaritja e pagave është bërë në përputhje me bazën ligjore në fuqi.

Pasqyra e realizimit të buxhetit për llogarinë 600 "Paga personeli" & llogarinë 601 "Kontribut për sigurimet shoqërore, shëndetësore"

Në lekë...

Nr	Periudha	Llogaria	Plani	Fakti	Realizimi në %	Argument
1	Viti 2019	600	158,000,000	136,557,660	86.4%	Mosrealizimi, rezultat i mosplotë simit të strukturës me punonjës
2		601	25,470,000	22,047,635	86.5%	'-"
1	Viti 2020	600	170,800,000	147,021,273	86.1%	Mosrealizimi, rezultat i mosplotësimit të strukturës me punonjës
2		601	24,870,000	22,364,389	89%	'-"

Burimi:Sektori i Financës.

-Nga auditimi rezultoi se, fondi i pagave për vitin 2019, u realizua në shumën 136,557,660lekë, nga 158,000,000 lekë, që ishte planifikuar, ose realizuar në masën 86.4%. Mosrealizimi i buxhetit të planifikuar ka ardhur si pasojë e mosplotësimit të strukturës me punonjës.

Nga auditimi rezultoi se, fondi i pagave për periudhën 01.01-31.07.2020, u realizua në shumën 14,7021,273lekë, nga 170,800,000 lekë, që ishte planifikuar, ose realizuar në masën 86.1%. Mosrealizimi i buxhetit të planifikuar ka ardhur si pasojë e mosplotësimit të strukturës me punonjës.

-Lidhur me zbatimin e bazës ligjore të pagave, u audituan borderotë e disa periudhave për administratën e MSHMS dhe u konstatua se përgatitja e borderove është mbështetur në listë

prezencat mujore, të plotësuara nga cdo drejtori apo sektor. Listë prezencat mujore për përgatitjen e borderove për punonjësit e institucionit janë bërë në mënyrë të përmbledhur, me numrin e ditëve të punës në muaj te paraqitur nga cdo drejtori apo sektor dhe mbi bazën e verifikimit të prezencës çdo ditë nga Sektori i Burimeve Njerëzore. Listë pagesat dhe përmbledhëset e pagave janë nënshkruar, nga Përgjegjësi i Sektorit Financiar dhe nga Drejtori Ekonomik. Bashkëlidhur janë listë prezencat dhe urdhrat e brendshëm të drejtuesit të institucionit. Listë pagesat e punonjësve dhe ndarja e pagesave është bërë sipas bankave të nivelit të dytë. Çdo veprim u gjet i finalizuar me një pasqyrë përmbledhëse të pagave si dhe me numrin e punonjësve faktik mujor.
Libri i pagave, për periudhën objekt auditimi, është plotësuar për punonjësit që janë në marrëdhënie pune, në të cilin janë shënuar për çdo muaj të gjitha ekstraktet sipas listë pagesave duke filluar nga paga bruto, shtesa e ndalesa deri në pagën neto.

-Referuar situatës përgjatë vitit 2020, krijuar kjo nga pandemia COVID-19, në llogarinë 600 ka patur disa ndryshime lidhur me pagesat që janë bërë kundrejt mjekëve dhe infermierëve, të cilët i dhanë ndihmën e tyre Republikës së Italisë , si personel shëndetësor, bazuar në VKM. nr.259, datë 27.3.2020 ñ për dhënien e ndihmës me personel shëndetësor për Republikën e Italisëò, ku citohet :
1-Shpërblimi i mjekëve dhe infermierëve, që do të ofrojnë shërbim shëndetësor sipas pikës 1, të këtij vendimi, do të jetë në vlerën 3 000 (tre mijë) euro në muaj për mjekët dhe 2500 (dy mijë e pesëqind) euro në muaj për infermierët.
2-Fondi prej 11 000 000 (njëmbëdhjetë milionë) lekësh për shpërblimin e personelit shëndetësor, mjekë dhe infermierë, sipas pikës 2, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.
Është miratuar lista e personelit që ka ofruar shërbimin shëndetësor, me shkresën 1614/1 Prot., datë 27.03.2020, nga Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS, bashkëngjitur kësaj shkrese lista emërore e 30 mjekëve dhe infermierëve, të cilët jane shpërblyer nga MSHMS. Pagesat e mjekëve dhe infermierëve sipas kësaj vkm, janë kryer në muajin maj të vitit 2020, në vlerën totale 8,400,721 lekë, pasqyruar këto pagesa në urdhër-shpenzimet:
1-nr.334 në vlerën 2,205,189 lekë
2-nr.335 në vlerën 3,307,784 lekë
3-nr.336 në vlerën 525,045 lekë
4-nr.337 në vlerën 630,054 lekë
5-nr.338 në vlerën 1,417,622 lekë
6-nr.339 në vlerën 315,027 lekë.
Gjithashtu në mbështetje të vendimit nr.259, datë 27.03.2020 ñ Për dhënien e ndihmës me personel shëndetësor për Republikën e Italisëò, VKM nr.354, datë 29.04.2020 u miratua nga Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS, me shkresën nr. 1614/3, datë 26.04.2020, grupi i dytë i punës që ka ofruar shërbimin shëndetësor në Republikën e Italisëò. Në VKM nr 354, datë 29.04.2020 citohet se:
1-Shpërblimi i infermierëve, që do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë, është 2500 (dy mijë e pesëqind) euro në muaj.
2-Fondi prej 19 000 000 (njëmbëdhjetë milionë) lekësh për shpërblimin e personelit infermierë, që do të ofrojnë shërbim shëndetësor Republikën e Italisë, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.
Bashkëngjitur kësaj shkrese lista emërore e 60 infermierëve, të cilët jane shpërblyer nga MSHMS. Pagesat e infermierëve sipas kësaj vkm, janë kryer në muajin qershor të vitit 2020, në vlerën totale 10,031,076 lekë, pasqyruar këto pagesa në urdhër-shpenzimet :
1-nr.410, në vlerën 2,340,584 lekë.
2-nr.411, në vlerën 3,009,323 lekë
3-nr.412, në vlerën 334,369 lekë,
4-nr.413, në vlerën 501,554 lekë.

5-nr.414, në vlerën 167,185 lekë.
6-nr.415, në vlerën 2,842,138 lekë.
7-nr.416, në vlerën 501,554 lekë.
8-nr.417, në vlerën 334,369 lekë.
Në VKM nr 354, datë 29.04.2020 citohet se:
1-Shpërblimi i infermierëve, që do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë, është 2500 (dy mijë e pesëqind) euro në muaj.
2-Fondi prej 19 000 000 (njëmbëdhjetë milionë) lekësh për shpërblimin e personelit infermierë, që do të ofrojnë shërbim shëndetësor Republikën e Italisë, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.
U konstatua që nga vlera totale e fondit prej 19,000,000 lekë, janë shpërblyer gjithsej në 10,031,076 lekë, pasi ditët e qëndrimit për infermierët kanë qënë 19 ditë, dhe ata janë shpërblyer nga MSHMS vetëm për ditët e qëndrimit në Republikën e Italisë.Nga subjekti është vënë në dizpozicion edhe dokumenationi shoqërues, bashkëlidhur urdhërshërbimi.

*Referuar Procesverbali nr. 5668/1 prot., datë 24.12.2019, rezulton se më datë 24.12.2019 është mbledhur në MSHMS Komisioni i Posatcëm i ngarkuar për shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të lindura pas marrjes së vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në zbatim të ligjit 152/2013ñ*Për nëpunësin civil*ò, i ndryshuar, dhe Urdhërit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike ñ *Për zbatimin e vendimve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit të shërbimit civil*ò.
Përbërja e Komisionit të Posatshëm ishte si më poshtë:
Z. A. K- Sekretar i Përgjithshëm (Kryetar)
Znj. J.D- Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse (Anëtare)
Znj. A. Nj- Drejtor i Drejtorisë së Legjislacionit dhe Shërbimeve Juridike (Anëtare)
Znj. N. L- Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar. (Anëtare)
Z. S. K-Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar. (Anëtare)
Gjithashtu përfaqësues i DAP është autorizuar znj.S.T, në cilësinë e përfaqësuesit vëzhgues,, ndërsa sekretare teknika është caktuar znj.F.Sh.
Ky Komision ka patur në shqyrtim:
a) Shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit të formës së prerë, në favor të kreditorëve gjyqfitues si mëposhtë:
1-Zj. A. Xh
2-Z. D.B
3-Z. H.M
4-Z. I.P
5-Z. K.V
6-Z. M.P
7- Zj.M. C
8-Z. N. I
9-Z. R. Z
10-Z. S. F
11-Z. N. Z
b) Urdhërimet e Gjykatës që përcaktojnë zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, nëpërmjet zgjedhjeve alternative për njësitë debitore, sipas dispozitivit të vendimeve të formës së prerë.
c) Shqyrtimin e mundësive të sistemit të gjyqfituesve në një pozicion të rregullt në shërbimin civil, sipas kritereve të pozicioneve të punës, dhe lategorive përkatëse, brenda Apartait apo institucioneve të varësisë së MSHMS, pjesë e shërbimit civil.

Në përfundim Komisioni ka konkluduar:

a) Për gjyqëfituesen **A. Xh**, pozicioni Specialist në sektorin e Statistikave në Drejtorinë e Monitorimit dhe Vlerësimit, ku ka qenë e emëruar gjyqëfituesja nuk ekziston si pozicion pune. Në bazë të arsimimit, kualifikimeve, eksperiencës së saj në punë nuk plotëson kriteret e veçanta ose të ngjashme të pozicioneve vakante në MSHMS apo në ndonjë insitucion varësie për të njëjtën kategori apo më të ulët.

b) Për gjyqëfituesin **H.M** , pozicioni Drejtor të Shërbimeve Të Brendshme, ku ka qenë i emëruar gjyqëfituesi nuk ekziston si pozicion pune.Në bazë të arsimimit, kualifikimeve, eksperiencës së saj në punë nuk plotëson kriteret e veçanta ose të ngjashme të pozicioneve vakante në MSHMS apo në ndonjë insitucion varësie për të njëjtën kategori apo më të ulët.

c) Për gjyqfituesin **D. B**, pozicioni Drejtor i i Shërbimeve të Brendshme ku ka qenë i emëruar gjyqëfituesi, është i zënë.Në bazë të arsimimit, kualifikimeve, eksperiencës së saj në punë nuk plotëson kriteret e veçanta ose të ngjashme të pozicioneve vakante në MSHMS apo në ndonjë insitucion varësie për të njëjtën kategori apo më të ulët.

d) Për gjyqëfituesin **I. P**, pozicioni Drejtor i Përgjithshëm i Politikave ku ka qenë i emëruar gjyqfituesja është i zënë. Referuar nenit 27 të ligjit nr. 152/2013, nëpunësit civil të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e administratës shtetërore, përbëjnë trupin e nëpunësit të nivelit të lartë drejtues (TND), ku përfshihet edhe pozicionië drejtor i drejtorisë së përgjithshme. Emërimi në këtë pozcion të rregullt të TND, bëhet vetëm me një anëtar të TND, nga DAP-i, sipas kërkesës së titullarit të institucioneve respektive kurse z.P nuk është pjesë e TND. Pra ky komsion nuk mund të vendosi mbi emërin e gjyqfitueses z.P.

e) Për gjyqëfituesin **K.V**, pozicioni Inspektor në Drejtorinë e Auditit, ku ka qenë e emëruar gjyqëfituesi nuk ekziston si pozicion pune. Në bazë të arsimimit, kualifikimeve, eksperiencës së saj në punë nuk plotëson kriteret e veçanta ose të ngjashme të pozicioneve vakante në MSHMS apo në ndonjë insitucion varësie për të njëjtën kategori apo më të ulët.

f) Për gjyqëfituesin **M.P**, pozicioni Inspektor në Drejtorinë e Auditit, ku ka qenë e emëruar gjyqëfituesi nuk ekziston si pozicion pune. Në bazë të arsimimit, kualifikimeve, eksperiencës së saj në punë nuk plotëson kriteret e veçanta ose të ngjashme të pozicioneve vakante në MSHMS apo në ndonjë insitucion varësie për të njëjtën kategori apo më të ulët.

g) Për gjyqëfituesen **M.C**, pozicioni Drejtor i Përgjithshëm ku ka qenë i emëruar gjyqfituesja është i zënë. Referuar nenit 27 të ligjit nr. 152/2013, nëpunësit civil të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e administratës shtetërore, përbëjnë trupin e nëpunësit të nivelit të lartë drejtues (TND), ku përfshihet edhe pozicionië drejtor i drejtorisë së përgjithshme. Emërimi në këtë pozcion të rregullt të TND, bëhet vetëm me një anëtar të TND, nga DAP-i, sipas kërkesës së titullarit të institucioneve respektive kurse zj. C nuk është pjesë e TND. Pra ky komsion nuk mund të vendosi mbi emërin e gjyqfitueses zj. C.

h) Për gjyqëfituesin **N. I**, pozicioni Përgjegjës të Sektorit të Sekretariatit Teknik, ku ka qenë e emëruar gjyqëfituesi nuk ekziston si pozicion pune. Në bazë të arsimimit, kualifikimeve, eksperiencës së saj në punë nuk plotëson kriteret e veçanta ose të ngjashme të pozicioneve vakante në MSHMS apo në ndonjë insitucion varësie për të njëjtën kategori apo më të ulët.

i) Për gjyqëfituesin R. Z, pozicioni Drejtor të Integritetit Europian dhe Projekteve IPA, është i zënë. Në bazë të arsimimit, kualifikimeve, eksperiencës së saj në punë nuk plotëson kriteret e veçanta ose të ngjashme të pozicioneve vakante në MSHMS apo në ndonjë insitucion varësie për të njëjtën kategori apo më të ulët.

j) Për gjyqëfituesin **S.F**, pozicioni Drejtor të Shërbimeve Juridike dhe në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, është i zënë. Në bazë të arsimimit, kualifikimeve, eksperiencës së saj në punë nuk plotëson kriteret e veçanta ose të ngjashme të pozicioneve vakante në MSHMS apo në ndonjë insitucion varësie për të njëjtën kategori apo më të ulët.

k) Për gjyqëfituesin **N.Z**, komisioni shqyrtoi kriteret e përgjithshmee specifike të pozocionit të punës përpara liriit nga detyra të z. Zefi, si dhe pozocionet aktualisht të lira ne Ministrinë e

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, konkludoi se i vetmi pozocion pune, i lirë për të cilin plotëson kriteret e gjyqëfituesit është : Specialist sektori i Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen sociale dhe barazinë gjinore, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mrojtjes Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, MSHMS. Nga ku komisioni në zbatim të Urdhërit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike ñ *Për zbatimin e vendimve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit të shërbimit civil*ò, ka vendosur të njftojë z.Z për pozocionin e ofruar në kuadër të ekzekutimit të vendimit gjyqësor në favor të tij.

*Disa nga gjyqëfituesit, i janë rikthyer marrëdhënieve të punës në MSHMS ose në subjekte të tjera, pas vendimit të formës së prerë, nga ku punonjësit :

1-**M.P**, është emëruar nga DAP me shkresën nr.6355 Prot., datë 15.12.2020 në pozicionin specialist, në Ministrinë e Drejtësisë.

2-**N.Z**, është emëruar nga DAP me datën 03.07.2020, në pozicionin specialist në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mrojtjes Sociale.

Titulli i Gjetjes:	Mos plotësimi i strukturës dhe oragnikës në MSHMS
Situata:	U konstatua që në MSHMS aktualisht janë 14 vende vakante.
Kriteri:	Në kundërshtimme Rregulloren e Brendshme me urdhër nr.178, datë 22.02.2018 si dhe me strukturën e MSHMS bazuar në urdhrin Nr. 174, datë 10.10.2017, ku citohet që numri i punonjësve të MSHMS të jetë **148 veta.**
Ndikimi/Efekti:	Mos plotësimi i vendeve vakante të punonjësve cënon ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të punës si dhe mos fuknsionimi i hierarkisë së vetë institucionit.
Shkaku:	Mos reagimi i DAP për të hapur konkurimin dhe shpalljen e fituesit për vendet aktuale vakante në strukturë të MSHMS.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	MSHMS në bashkëpunim me DAP, të bëjë të mundur plotësimin e vendeve vakante në strukturën e MSHMS.
Afati i zbatimit:	Në vazhdimësi

III.4. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR ADMINISTRIMIN, RUAJTJEN, DOKUMENTIMIN DHE QARKULLIMIN E VLERAVE MATERIALE E MONETARE.

a) Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë.

Pika 35 e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, përcakton: ñ*Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:*

a) Dokumente autorizuese - janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.

b) Dokumente vërtetuese - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.

c) Dokumente të kontabilitetit - janë dokumentet përmbledhëse, ose regjistrat kontabël (libri i madh, librat analitikë, kartelat e aktiveve, etj.) të çdo lloj forme17 , bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese".

Në pikën 36 të këtij Udhëzimi përcaktohet*: "Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë*

mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve."
Referuar pikës 61 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, ñ*Pagesat ndërmjet njësive publike dhe entiteteve të sektorit privat bëhen nëpërmjet sistemit të thesarit direkt në llogarinë bankare të përfituesit. Njësite e qeverisjes së përgjithshme janë të detyruara të procedojnë me kryerjen e pagesës për mbylljen e detyrimeve menjëherë pas marrjes së faturës tatimore nga furnitori dhe të vërtetuar me kryerjen e shërbimit/marrjes në dorëzim të aktiveve në përputhje me kushtet e kontratës. Për moszbatimin e këtij detyrimi zbatohen sanksionet ligjore të përcaktuara në kontratën e lidhur në mes palëve ose në marrëveshjet përkatëse dypalëshe për të cilat mban përgjegjësi nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues i njësisë respektive".*

- ***2019***

Duke qenë se, auditimi i kryer nga Departamentit i Auditimit të Institucioneve Qendrore në MSHMS, i kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr.361/1 prot. datë 29.05.2019, i ndryshuar, për periudhën e auditimit nga data 01.01.2018 deri në 31.07.2019, me afat auditimi nga data 03.06.2019 deri më 10.08.2019 është shtrirë deri në korrik 2019, për këtë vit grupi i auditimit analizoi urdhër shpenzimet e muajve shtator dhe dhjetor 2019.

- ***Shtator 2019***

Në muajin shtator në MSHMS janë kryer 97 veprime me bankë, me vlerë **125,879,911.3 lekë.** Nga analizimi i Urdhër shpenzimeve të kryera gjatë muajt shtator 2019, u konstatua struktura e mëposhtme e shpenzimeve.

Tabela 4: Struktura e shpenzimeve për muajin shtator 2019

Veprimet	*Vlera*	*Nr. i pagesave*
Rikonstruksion i disa qsh-ve në qarqet Tirane, Durrës, Berat, Korçë, Elbasan.	70,138,787	2
Dëmshpërblime për të përndjekur politik	34,150,349.4	19
Paga	8,909,018.0	11
Sigurime	4,399,579.0	1
Çlirim garancie 5%	2,573,714.0	1
Mirëmbajtje dhe riparim automjetesh	1,393,020.0	11
Dieta dhe drekë punë	667,270	13

Burimi: Kontabilizimi i bankës 2019, MSHMS
Përpunoi: Grupi i auditimit

Pjesa tjetër e pagesave të cilat nuk janë paraqitur në tabelën e mësipërme, janë pagesa me vlera të vogla për rimbusime telefoni, pagesa për fatkeqësi, pjesëmarrje në komisione, etj.
Sikurse mund të evidentohet edhe nga tabela e mësipërme peshën kryesore të pagesave e zënë Rikonstruksionet e disa Q.Sh në qarqet e Tiranës, Durrësit, Berat, Korçës dhe Elbasanit. Gjatë muajit shtator 2019 janë bërë 19 pagesa për dëmshpërblime për të përndjekurit politik, me vlerë 34,150,349.4 lekë. Këto pagesa janë bërë përkatësisht me urdhër shpenzimet nr. 697, 698, 700, 701, 702, 703, 704, 705, 706, 707 më datë 09.09.2019, me urdhër shpenzimet nr. 733, 734, 735, 736, 737, 738, 739, më datë 24.09.2019, si dhe me urdhër shpenzimet nr. 765, 766 më datë 30.09.2019. Nga kontrolli i praktikave të pagesave u konstatua se urdhër shpenzimet janë të shoqëruara me kërkesat për likuidim fondesh për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale, dhe kërkesat për transferime fondesh të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shkresat janë të firmosura nga strukturat përgjegjëse dhe përmbajnë numrat e protokollit dhe datat. Pagesat e kryera për pagat dhe sigurimet shoqërore gjatë këtij muaji janë në vlerën 13,308,597 lekë. Nga kontrolli i tyre konstatohet se përgjithësisht janë të rregullta, duke pasur bashkëlidhur dokumentet justifikuese si list-prezenca, raportet mjekësore, etj.
Nga kontrolli i pagesave të kryera gjatë muajit shtator 2019, për mirëmbajtjen e makinave, u identifikuan Urdhër Pagesat nr. 740,741,742,743,744,745,746, 747,748,749 dhe 755 të datës, të datës 24.09.2019, në vlerë totale 1,393,020 lekë. Këto urdhër shpenzime janë të shoqëruara me kontratat e lidhura për kryerjen e këtij shërbimi nr. 1745/5prot, datë 27.03.2019 në vlerën 1091220

lekë (me TVSH), dhe kontratën nr. 1745 prot. Datë 27.06.2019, në vlerën 301 800 lekë (me TVSH).
Bashkëlidhur me urdhër shpenzimet gjendet edhe Marrëveshja Kuadër nr. 2704/14 prot. Datë 28.06.2018, e lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe kontraktuesit, si dhe kërkesa nr. 1745/5 datë 21.06.2019 me objekt ñKërkesë për kontrollin dhe diagnostikimin e automjeteve të MSHMSò, drejtuar kontrakorit. Urdhër shpenzimet janë të shoqëruara me faturat tatimore, akt kontrollin dhe diagnostikimin e bërë nga kontraktuesi (i cili parashikon nevojën për riparimet përkatëse), situacionin e punimeve, procesverbalin e marrjes në dorëzim të mjetit dhe certifikatën e garancisë së punimeve.
Referuar VKM 997, datë 10.12.2010, i ndryshuar ñ*Dërgimi me shërbim i punonjësit autorizohet nga:*
1. Titullari i njësisë shpenzuese, për shërbimet me largësi deri ne 100 km jashtë qendrës se punës.
2. Titullari i institucionit qendror për shërbime ne një largësi mbi 100 km jashtë qendrës se punës.
Në autorizim përcaktohet koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij. Titullar institucioni qendror, ne kuptim te këtij vendimi, janë :a. Për njësite e qeverisjes qendrore: i) për ministrinë dhe çdo institucion te varësisë se saj është Ministri ose i deleguari i tij;é ò
Urdhër shpenzimi nr. 684 datë 03.09.2019, me vlerë ***206,000 lekë***. Bashkëlidhur me këtë urdhër shpenzim gjenden dokumenti i dietave të plotësuara nga tre anëtarëve të cilët kanë qenë në shërbim në qarkun Elbasan, Gjirokastër, Vlorë dhe Berat për të inspektuar përdorimin e fondeve të alokuara nga MSHMS në qendrat e përkujdesit social, si dhe faturat tatimore. Bashkëlidhur me këtë urdhër shpenzim gjendet kërkesa nr. 3487 datë 01.07.2019, e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, sipas të cilës kërkohet miratimi nga ky i fundit për të vijuar me ngritjen e grupit të punës për kryerjen e këtyre inspektimeve. Por, nga kontrolli konstatohet se **nuk** gjendet miratimi nga Sekretari i Përgjithshëm për këtë grup pune të ngritur, si dhe nuk gjendet urdhri i ngritjes së grupit të inspektimit. Bashkëlidhur me Urdhër Shpenzimin gjendet një Aneks, i cili parashikon grupet e punës për secilin qark, por ai nuk është i firmos, apo protokolluar. Sipas Drejtorisë së Financës, miratimi i Sekretarit të Përgjithshëm, identifikohet nëpërmjet firmës së tij mbi kërkesën nr. 3487, datë 01.07.2019, por vërehet se kjo firmë mban datën 27.06.2019, pra më herët se data e protokollimit të shkresës. Në vijim të kërkesës së grupit të auditimit, institucioni vuri në dispozicion urdhrin nr.64, datë 18.01.2018, për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e kërkesave mbi vazhdimësinë e financimeve nga Buxheti i Shtetit për ofrimin e shërbimeve të specializuara të përkujdesit shëndetësorò. Ky urdhër është miratuar përpara kërkesës së nr. 3487 datë 01.07.2019, e cila kërkon miratimin e Sekretarit të Përgjithshëm për ngritjen e grupit të punës për të kryer inspektimet në qarqet Elbasan, Gjirokastrës, Vlorë dhe Berat, si dhe 2 prej anëtarëve të cilët kanë shkuar për inspektim në qarqet e lart përmendura, znj. V. S dhe znj. I.M, nuk janë pjesë e grupit të punës miratuar me Urdhrin nr. 64, datë 18.01.2018. Më tej, u vu në dispozicion edhe një memo e përgatitur nga grupi i punës, për titullarin e Institucionit mbi shqyrtimin e kërkesave të ardhura në MSHMS, e cila është e pa protokolluar dhe pa datë, por në brendësi të saj shkruhet se grupi është mbledhur më datë 17.01.2019, pra përpara kryerjes së shërbimeve në rrethe. Në vijim u vu në dispozicion edhe shkresa nr.3487/1, datë 01.07.2019, e cila sikurse edhe shkresa nr. 3487, datë 01.07.2019, kërkon miratimin e Sekretarit të Përgjithshëm për kryerjen e inspektimeve sipas emrave të propozuar, zj. I. M, zj. A.Ç, zj. M.B dhe zj. V.S. në të cilën propozohet grupi. Urdhër shpenzimi nr. 684, 03.09.2019, me vlerë 206,000 lekë **nuk** ka bashkëlidhur dokumentet justifikuese për kryerjen e tij.

- ***Dhjetor 2019***

Tabela: Struktura e shpenzimeve për muajin dhjetor 2019:

Veprimet	*Vlera*	*Nr. i pagesave*
Rikonstruksion i disa qsh-ve në qarqet Dajti Park 2007, Ndregjoni dhe B-93	96,086,187	4
Blerje paisje mjekesore dhe mobilimi per QSH	25,575,000	2

Blerje pajisje kompjuterike	27,376,618	6
TVSH për projektin Zvicerian dhe Rikonstruksionin e Qendres se Grave	30,576,648	15
Dëmshpërlime për të përndjekur politik	44,988,921	11
Paga	9,426,749	11
Sigurime	4,660,761	1
Preventiv për objekte/zbatim	8,489,708	2
Shpenzime për fatkeqësi dhe ndërhyrje kirurgjikale	30,500,987	32
Dieta dhe drekë punë	1,399,710	12
Shpenzime për vendime gjyqësore "Alb Siguracion" Sha	97,380	1

- Burimi: Kontabilizimi i bankës 2019, MSHMS
- Përpunoi: Grupi i auditimit

Në muajin dhjetor në MSHMS janë kryer 123 veprime me bankë, me vlerë **274,876,951.9 lekë.** Shpenzimet kryesore janë grupuar si më sipër, pjesa tjetër e shpenzimeve janë shpenzime për mirëmbajtje automjetesh, shpenzime për rimbursim telefoni, etj. Nga analizimi konstatohet se Urdhër shpenzimet për këtë muaj rakordon me Thesarin.
Urdhër shpenzimi nr. 986, datë 11.12.2019, me vlerë 97,380 lekë. Bashkëlidhur gjendet vendimi i gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 4020, datë 08.05.2017, e cila ka marr formë të prerë më datë 24.05.2017, sipas të cilës pranohet padia e Shoqërisë ñA-Sò, sh.a., ndaj Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me objekt ñPërmbushja e detyrimeve në vlerën 75,980 lekë që rrjedhë nga kontrata e sigurimit që konsiston në pagimin e primeve të papaguara, si rezultat i lëshimit të kontratave të sigurimit TP, kamatëvonesat sipas penaliteti të sigurimi të kontratës dhe shpenzimet gjyqësore. Bashkëlidhur gjenden gjithashtu korrespondenca zyrtare midis MSHMS dhe shoqërisë së përmbarimit të palës paditëse që prej vitit 2018, ku me njoftimin e MSHMS-se për këtë detyrim ishte përcjellë edhe tarifa përmabrimore, si dhe memo nr. 4872/1 e datës 24.10.2019. Vlera 97,380 lekë përfshinë 75,800 detyrimin e papaguar që rrjedh nga kontrata, **3,400 lekë** shpenzime gjyqësore dhe **15,000** lekë tarifë ekzekutimi e përmbaruesit.

- *Shpenzimet e tërmetit*

VKM nr. 753, datë 30.11.2019, përcakton se: ñ*Secilës prej familjeve të viktimave të tërmetit të datës 26.11.2019, në formën e ndihmës financiare, t'i akordohet shuma prej 1,000,000 lekë. Shpenzimet e varrimit për të gjitha viktimat e tërmetit të datës 26.11.2019 përballohen nga buxheti i shtetit*ò. Sipas kësaj VKM-je, efektet financiare do të përballohen nga buxheti i miratuar i vitit 2019 të MSHMS.
Në vijim të kërkesës së grupit të auditimit, MSHMS bëri me dije, se VKM 753, i datë 30.11.2019 **nuk** ka pasur bashkëlidhur listën emërore të familjeve të viktimave. Nga analizimi kryer nga grupi i auditimit konstatohen pagesat e mëposhtme të paraqitura në aneksin nr.10.
Nga analizimi i të dhënave të përcjella nga MSHMS, konstatohet është paguar ndihmë financiare prej 1,000,000 lekësh të familjeve të 48 viktimave të tërmetit të nëntorit 2019, sipas tabelës bashkëlidhur. Duke qenë se, VKM për shpërblimin e familjeve të viktimave nuk ka patur një listë emërorë bashkëlidhur **nuk** mund të konstatojmë nëse janë mbështetur financiarisht familjarët të gjithë viktimave. Nga lista e viktimave të tërmetit e mbajtur nga DBMF rezulton se për dy viktima H. A dhe I.A, familjarët **nuk** kanë marrë mbështetje financiare pasi referuar përgjigjes së MSHMS, kjo e fundit nuk ka patur kërkesa apo kontakt për familjarët e tyre.
Konstaohet gjithashtu se, janë paguar shpenzimet e varrimit vetëm për **8** familje të cilat kanë patur viktima nga tërmeti i nëntorit 2019, përkatësisht familjet: G, C, C, V, K, C, P, L. Grupi i auditimit kërkoj informacion mbi kërkesat e familjarëve mbi marrjen e mbështetjes financiare dhe shpenzimet e varrimeve.
Referuar e-mailit të datë 27.04.2021 të përcjellë nga arkiv-protokolli i MSHMS-së, **nuk** rezulton të ketë patur kërkesa nga familjarët e viktimave të tërmetit për mbështetjen financiare dhe shpenzimet e varrimit. Në kundërshtim me Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 ñPër Arkivatò ,

ñNormave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë ò (neni 8 dhe 9) dhe Ligjin nr.90/2012 "Për Organizimin Dhe Funksionimin E Administratës Shtetërore" <u>në **asnjë** rast, kërkesat dhe dokumentet e përcjella nga familjarët e viktimave të tërmetit për përfitimin e ndihmës financiare nuk është depozituar në protokollin e institucionit, por është përcjellë dorazi pranë DBMF në MSHMS</u> duke mos siguruar kështu gjurmë mbi kërkesat, dokumentet e dorëzuara dhe kohën e dorëzimit të tyre.

Nga kontrolli i urdhër shpenzimet për kryerjen e pagesave të mësipërm janë konstatuar tre rasteve të cilat nuk kanë bashkëlidhur të gjitha dokumentet justifikuese sikurse përcakton Udhëzimi nr. 30 më specifikisht: Ushp nr.951 dt 02.12.2019 dhe ushp nr.953 dt, 03.12.2019 nuk kishin bashkëlidhur certifikatat e vdekjes së viktimave dhe U.sh. 1040, datë 26.11.2019 i cili nuk ka bashkëlidhur certifikatën familjare e cila vërteton se përfituesja është familjare e viktimës.

Nga kontrolli i urdhër shpenzimeve u konstatua se, në disa raste, p.sh. në rastet e shpenzimet të tërmetit, datat e urdhër shpenzimeve fizike dhe kontabilizimit të bankës 2019, nuk përkojnë me datat e këtyre urdhër shpenzimeve në SIQF. Nëse do të referoheshim ditarit të bankës 2019, MSHMS ka kryer shpenzime (me urdhër shpenzime) deri më datë 16 dhjetor. Ndërsa, nëse do të referoheshim data bazës së marr nga Thesari, ky institucion ka kryer 53 shpenzime (referuar datës së urdhër shpenzimit në SIFQ) gjatë periudhës 17-30 dhjetor 2019<u>. Grupi i auditimit kontrolloi këto urdhër shpenzime, dhe ato gjendeshin, por data e tyre nuk ishte regjistruar saktë në SIFQ.</u>

<u>*Vonesat mbi 30 dite 2019*</u>

Nga analizimi i të dhënave të SIQF, konstatohet se gjatë vitit 2019 ka patur një numër të lartë pagesash të regjistruara më Urdhër shpenzime në Thesar, me vone së 30 ditë nga data e faturës origjinale. Nga analizimi i data bazës së SIFQ, për Aparatin e MSHMS-së, për vitin 2019, konstatohet se nga 1365 pagesa të kryera gjatë këtij viti 2019 deri në 31.12 2020, 221 prej tyre në vlerë119,842,858 lekë, pra <u>**16.2%** e rasteve, janë regjistruar me Urdhër shpenzim nga MSHMS me **mbi** 30 ditë nga data e lëshimit të faturës nga furnitori.</u> Midis tyre evidentohen 7 fatura të vitit 2015 në vlerë 97,836 lekë, 21 fatura të vitit 2016 në vlerë 14,953,552 lekë, 6 fatura të vitit 2017 në vlerë 1,595,422 lekë, 9 fatura nga viti 2018 në vlerë 8,646,343 lekë, 79 fatura të vitit 2018 në vlerë 62,553,853 lekë.

Në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, në nenin 52 përcaktohet se ñ*Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë,* <u>*brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik*</u>ò.

Mos pagesa në kohë e faturave, shkakton premisë që operatorët ekonomikë të kërkojnë kamatëvonesa në favor të tyre, sikurse përcaktohet në nenin 11 të ligjit nr. 48/2014 ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò, ku specifikohet se: ñ<u>*Kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori jo vetëm pagimin në favor të tij të kamatëvonesës për moskryerjen e pagesës në afat, por edhe pagimin e të gjitha shpenzimeve të kryera prej tij për rikthimin e kredisë*</u>*, shpenzime këto të kryera për shkak të pagesës me vonesë, përveç rasteve kur debitori nuk është në faj për vonesën".* Nga sa më sipër, në ato raste kur operatorët ekonomikë do të kërkojnë kamatvonesa për moskryerjen e pagesës në afat, kjo vlerë do të konsiderohet dëm ekonomik, duke dëmtuar përdorimin e fondeve publike. Më hollësisht vonesat janë paraqitur në aneksin nr. 11 bashkëlidhur këtij raporti.

Konkluzion viti 2019:

Nga analiza e Urdhër shpenzimeve për vitit 2019 u konstatuan raste të Urdhër shpenzimeve të cilat **nuk** kanë bashkëlidhur të gjitha dokumentet justifikuese për kryerjen e tyre, si: urdhër shpenzimi nr. nr. 684 datë 03.09.2019, me vlerë 206,000 lekë për dietat e punonjësve, i cili nuk ka bashkëlidhur miratimin dhe Urdhrin e ngritjes së grupit të punës më këta punonjës, Urdhër shpenzimet për fatkeqësitë e Tërmetit të

cilat jo në cdo rast kishin bashkëlidhur certifikatat e vdekjes së viktimave apo certifikatat familjarë për të vërtetuar lidhjen e përfituesit me viktimat etj., në kundërshtim me sa parashikon Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, në pikat 35 dhe 36.

Nga analizimi i Urdhër shpenzimeve për fatkeqësitë e tërmetit të nëntorit 2019 konstatohet është paguar ndihmë financiare prej 1,000,000 lekësh të familjeve të **48** viktimave të tërmetit të nëntorit 2019. Duke qenë se VKM nr. 753, datë 30.11.2019 e cila parashikon mbështetjen financiare të familjeve të viktimave të tërmetit të nëntorit 2019**,** nuk ka bashkëlidhur listën e familjeve përfituese, grupi i auditimit nuk mund të japë siguri të arsyeshme nëse janë mbështetur financiarisht të gjitha familjet të cilat kanë humbur të afërmit e tyre. Shpenzimet e varrimit janë paguar vetëm për **8** familje nga **30** familje (30 familjet janë identifikuar nga pagesat e ndihmës financiare 1,000,000 lekë) të cilat kanë humbur familjarët e tyre nga tërmeti nëntorit 2019, në zbatim të VKM nr. 753, datë 30.11.2019. Në kundërshtim me Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 òPër Arkivatò, ñNormave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë↓(neni 8 dhe 9) dhe Ligjin nr.90/2012 "Për Organizimin Dhe Funksionimin E Administratës Shtetërore" në **asnjë** rast, kërkesat dhe dokumentet e përcjella nga familjarët e viktimave të tërmetit për përfitimin e ndihmës financiare nuk është depozituar në protokollin e institucionit, por është përcjellë dorazi pranë DBMF në MSHMS duke mos siguruar kështu gjurmë mbi kërkesat, dokumentet e dorëzuara dhe kohën e dorëzimit të tyre.

Nga kontrolli i urdhër shpenzimeve u konstatua se, në disa raste datat e urdhër shpenzimeve fizike dhe kontabilizimit të bankës 2019, **nuk** përkojnë me datat e këtyre urdhër shpenzimeve në SIQF (kolona: data e urdhër shpenzimit). Nëse do të referoheshim ditarit të bankës 2019, MSHMS ka kryer shpenzime deri më datë 16 dhjetor 2019. Ndërsa, nëse do të referoheshim data bazës së marr nga Thesari, ky institucion ka kryer **53** shpenzime (referuar datës së urdhër shpenzimit në SIFQ) gjatë periudhës 17-30 dhjetor 2019. Grupi i auditimit kontrolloi këto urdhër shpenzime, dhe ato gjendeshin, por data e tyre nuk ishte regjistruar saktë në SIFQ.

Nga analizimi i data bazës së SIFQ, për Aparatin e MSHMS-së, për vitin 2019, konstatohet se nga 1365 pagesa të kryera gjatë këtij viti 2019 deri në 31.12 2020, 221 prej tyre në vlerë119,842,858 lekë, pra **16.2%** e rasteve, janë regjistruar për tu kryer me Urdhër shpenzim nga MSHMS me mbi **30** ditë nga data e lëshimit të faturës nga furnitori*, në kundërshtim* me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar. Kryerja e pagesave në tejkalim të afateve përmban riskun që kreditorët mund të kërkojnë kamatëvonesa dhe shpenzimet e kryera për rimarrjen e kredisë, duke shkaktuar dëm ekonomik për institucionin.

- ***Viti 2020***

Për vitin 2020 zgjodhi në mënyrë rastësore të analizonte urdhër shpenzimet e muajve të paraqitur në aneksin nr.13. Nga kontrolli u konstatua:

- Urdhër Shpenzimi nr. 450, datë 25.06.2020 për vlerën 9,880,160 lekë, si shpenzimit për vendimet gjyqësore. Ky është një detyrim i ish- MMSR, për mospagim të një fature të lëshuar nga shoqëria ñD.P.Aò, në vitin 2015, për një shërbim të kryer ndaj kësaj ministrie. Bashkëlidhur me këtë Urdhër Shpenzim, gjendet kërkesa për ekzekutimin vullnetar të përmbaruesit e datës 05.04.2018, i cili kërkon, shlyerjen e vlerës totale 9,880,160 lekë, prej të cilave 7 212420 lekë detyrim qe rrjedh nga titulli ekzekutiv, 1,883,281.42 lekë kamatëvonesave, 5000 lekë gjoba 15,000 lekë shpenzime për ekspertin fiskal, dhe **764,459 lekë** tarifë përmbarimore. Në këtë shkresë njoftohet se, nëse kalohet me ekzekutim të detyrueshëm, pagesa përmbarimore do të jetë në ngarkim të MSHMS. Në vijim, gjendet shkresa 18.04.2018 Thesarit dërguar MSHMS-së lidhur me çështjen, duke kërkuar informacion mbi data bazën e vendimeve gjyqësore, grafikun e shlyerjes, parashikimin për

shlyerjen etj. Identifikohet gjithashtu shkresa nr. 15.11.2018, sipas të cilës MSHMS kërkon nga zyra përmbarimore heqjen e sekuestrso konservative të vendosur nga Thesari, dhe shprehet se institucioni do të planifikojë dhe shlyej vlerën e plotë që rrjedh nga ky detyrim brenda vitit 2019. Identifikohet gjithashtu, një kërkesë tjetër e datës 29.08.2019 e shoqërisë ñD. Pò, për pagesën e detyrimit, si dhe një kërkesë tjetër e datës 01.06.2020 me të njëjtin objekt. Pra konstatohet se, më gjithë kërkesat e vazhdueshme të kreditor gjatë periudhës 2018-2020 për shlyerjen e detyrimit, kjo pagesë është shlyer në qershor 2020.

- U kontrollua urdhër- shpenzimi nr.1082 datë 28.12.2020, është realizuar pagesa në vlerën prej ***852,000*** lekë me tvsh, për OE. Ky shpenzim është kryer për hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2017. Referuar kontratës bazë nr. 491/5 datë 12.02.2020, afati për dorëzimin e pasqyrave ishte 15.03.2020. Referuar procesverbalit të marrjes në dorëzim, pasqyrat financiare janë marrë në dorëzim në tetor 2020, Nga auditimi u konstatua se, bashkëlidhur me këtë urdhër shpenzim nuk gjendeshe urdhëri për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të Pasqyrave Financare, si dhe nuk gjendeshe shtyrja e afatit të kontratës. Ndërsa, procesverbali i marrjes në dorëzim është firmosur vetëm nga Drejtori i DBMF, z. K. Ky urdhërshpezim, **nuk** ka bashkëlidhur të gjithë dokumentet justifikuese të nevojshme për kryerjen e tij.

➢ ***Mbi 30 ditë vonesë në shlyerjen e faturave 2020***

Nga analizimi i databazës së SIFQ, Aparatin e MSHMS-së, për vitin 2020, konstatohet se nga 1510 pagesa të kryera gjatë këtij viti, 347 prej tyre në vlerë 874,836,015 lekë, pra **23%** e rasteve, janë regjistruar me Urdhër shpenzim nga MSHMS me **mbi** 30 ditë nga data e lëshimit të faturës nga furnitori. Midis tyre evidentohen 1 faturë e vitit 2017 në vlerë 875,000 lekë, 9 fatura nga viti 2018 në vlerë 8,646,343 lekë, 78 fatura të vitit 2019 në vlerë 120,228,281 lekë dhe 259 fatura të vitit 2020 në vlerë 745,086,391 lekë.

Në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, në nenin 52 përcaktohet se ñ*Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik*ò.

Mos pagesa në kohë e faturave, shkakton premisë që operatorët ekonomikë të kërkojnë kamatëvonesa në favor të tyre, sikurse përcaktohet në nenin 11 të ligjit nr. 48/2014 ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò, ku specifikohet se: ñ*Kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori jo vetëm pagimin në favor të tij të kamatëvonesës për moskryerjen e pagesës në afat, por edhe pagimin e të gjitha shpenzimeve të kryera prej tij për rikthimin e kredisë, shpenzime këto të kryera për shkak të pagesës me vonesë, përveç rasteve kur debitori nuk është në faj për vonesën".* Nga sa më sipër, në ato raste kur operatorët ekonomikë do të kërkojnë kamatëvonesa për moskryerjen e pagesës në afat, kjo vlerë do të konsiderohet dëm ekonomik, duke dëmtuar përdorimin e fondeve publike. Në mënyrë analitike, sa më sipër paraqitet në aneksin nr. 12.

Konkluzion për vitin 2020

Nga analiza e Urdhër shpenzimeve për vitit 2020 u konstatuan raste të Urdhër shpenzimeve të cilat **nuk** kanë bashkëlidhur të gjitha dokumentet justifikuese për kryerjen e tyre, si p.sh. urdhër shpenzimi nr.1082 datë 28.12.2020, në vlerën prej ***852,000*** lekë me TVSh, paguar për OE. për hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2017. nuk gjendeshe shtyrja e afatit të kontratës dhe urdhri për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të produkteve.

Nga analizimi i data bazës së SIFQ, për Aparatin e MSHMS-së, për vitin 2020, konstatohet se nga 1510 pagesa të kryera deri në 31.12 2020**, 347** prej tyre në vlerë **874,836,015** lekë, pra **23%**e rasteve, janë regjistruar për tu kryer me Urdhër shpenzim nga MSHMS me mbi **30** ditë nga data e

lëshimit të faturës nga furnitori*, në kundërshtim* me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar. Kryerja e pagesave në tejkalim të afateve përmban riskun që kreditorët mund të kërkojnë kamatëvonesa dhe shpenzimet e kryera për rimarrjen e kredisë, duke shkaktuar dëm ekonomik për institucionin.

- ***Mbi vendimet gjyqësore për largimet nga puna***

Në tabelën e aneksit nr.14 janë paraqitur gjyqfituesit e larguar në mënyrë të padrejtë nga puna nga ish-Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë apo nga ish-Ministria e Shëndetësisë përpara bashkimit të tyre në MSHMS, pagesat e kryera për ta, si dhe detyrimi i prapambetur për vitet 2019 dhe 2020. Për gjyqfituesit e mëposhtëm, vendimi i gjykatës i formës së prerë, ka përcaktuar rikthimin në vendin e punës dhe kryerjen e pagesës së pagës nga momenti i lirimit nga detyra deri në momentin e rikthimit në detyrë.

1- P. P
2- P. L
3- M. P
4- A. Xh
5- K. V
6- M. C
7- S. F
8- R. Z
9- D. N
10- F. B
11- A.B
12- B. T
13- E. P
14- N. I
15- A. Xh
16- D. B
17- I. P
18- Y. Gj
19- N. Z

- Detyrimet e prapambetura dhe shlyerjet për vitet 2019-2020

Në fillim të vitit 2019, vlera e detyrimeve të prapambetura për çështjet gjyqësore për largime nga puna ishte 40,650,307 lekë. Gjatë vitit 2019 janë shtuar edhe 17,924,726 lekë detyrime të prapmbetura, si rezultat se gjyfituesit të cilët ende nuk janë rikthyer në punë vijojnë të marrin pagën deri në rikthim në detyrë. Pra, detyrimet ndaj tyre lindin për çdo muaj në të cilët ato nuk janë rikthyer në detyrë. Në këtë vit janë paguar gjithësej për vendimet gjyqësore ***24,875,741 lekë***, prej të cilave ***23,862,662 lekë*** detyrim i ardhur nga vendimi i formës së prerë, dhe ***1,013,079 lekë*** tarifë përmbarimore. Detyrimi i papaguar për çështjet gjyqësore për largime të padrejta nga puna, në fund të vitit 2019 konstatohet në vlerën ***34,712,371 lekë***.

Gjatë vitit 2020 janë shtuar **42,529,574** lekë detyrime të prapambetura. Pra, në total për vitin 2020 vlera e detyrimeve të prapambetura rezulton 77,241,945 lekë, prej të cilave janë paguar ***43,363,561 lekë***. Gjatë ketij viti nuk ka patur pagesa për tarifa përmbarimore. Në fund të vitit 2020, detyrimet e prapambetura rezultojnë në vlerën ***33,878,384 lekë***.

Referuar pikës 4 tëUdhëzim nr. 1, datë 04.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesarit *"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit buxhetor, mbajnë database për vendimet gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumat e detyrimeve. Shuma totale e detyrimeve për*

ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjorë e nënligjorë përkatës. Këto parashikime i bëhen të njohura edhe njësisë së qeverisjes së përgjithshme nga e cila varet".
Sipas pikës 5 të këtij udhëzimi *"Ekzekutimi i vendimeve gjyqësor e që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas rradhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësisë shpenzuese, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut. Përmbaruesi i përmbahet grafikut të shyerjes së detyrimit të publikuar.*ò
Në **kundërshtim** me pikën 5 të Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesaritò, MSHMS **nuk** ka publikuar grafikun në faqen ëeb të institucionit grafikun e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.
Nga auditimi u konstatua se, data baza e mbajtur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Mirëmenaxhimit Financiar në zbatim të pikës 4 të Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014, vënë në dispozicion grupi të auditimit, **nuk** përmban shumën e plotë të detyrimeve për largimet nga puna, pasi në të **nuk** janë reflektuar detyrimet e parashikuara nga vendimet e formës së prerë të viteve 2011 dhe 2013 për dy gjyfitues, zj. S. L, dhe z. N.Z. Pra, vlera e detyrimeve të prapambetura për largime nga puna rezulton më e **lartë** se, ajo e regjistruar në data bazën e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, duke përmbajtur riskun e raportimit jo të plotë dhe jo të saktë te tyre në pasqyrat financiare.

- *Raportimi i detyrimeve të prapambetura.*

Në zbatim të Udhëzimit nr. 5 datë 27/02/2014, i ndryshuar, Drejtoria e Financës pranë MSHMS, ka raportuar detyrimet e prapambetura pranë MFE-së.
Për vitin 2019, raportimet 3- mujore të detyrimeve të prapambetura janë kryer nëpërmjet e-mailit zyrtar, midis MSHMS dhe MFE.

- ***3-mujori I-2019***

- Për 3 mujorin e parë 2019, për aparatin e MSHMS janë njohur detyrime të prapambetura si më poshtë:

(2) Emri i Institucionit	(3) Kodi ekonomik i shpenzimit	(4) Emri Furnitorit/ Kreditorit	(5) Shuma e Detyrimit kontratës/ marrëveshjes/ vendim gjyqi, etj. (Lekë)	(6) Detajet e faturës/dokumentit financiar		(8) Arsyeja e krijimit të detyrimit të prapambetur	(9) Pagesat e detyrimeve të prapambetura		
				Data origjinale e faturës	Shuma (Lekë)		Shuma e skedulu ar për tu paguar 3muj.I -2019	Pagesa të kryera 3muj. I -2019	Arsyeja e diferencës
Aparati M.SH.M.S.	6027400	"D.P" shpk	9,880,160	16.02.2018	9,880,160	mungesë fondi			
Aparati M.SH.M.S.	6027400	A. Xh	2,088,125	24.05.2011	2,088,125	mungesë fondi	-	-	
Aparati M.SH.M.S.	6027400	D.N	3,764,760	02.10.2018	3,764,760	mungesë fondi	-	-	
Aparati M.SH.M.S.	6027400	"H.K"	398,800	29.03.20	398,800	mungesë fondi	-	-	

				18					
Aparati M.SH.M.S.	6027400	F. B	5,809,100	30.06.2017	5,809,100	mungesë fondi	3,000,000	3,000,000	

Burimi: Raportimet e detyrimeve të prapambetura MSHMS

Konstatohet se: Vlera e detyrimeve të prapambetura të raportuara në 3- mujorin e parë të vitit 2019 rezulton 21,940,945 lekë, prej të cilave, janë njohur detyrime të prapambetura për çështje gjyqësore për largime të padrejta nga puna, vetëm për **3** ish-punonjës, përkatësisht znj. A. Xh, znj. D.N, znj. F.B, për vlerën **11,661,985 lekë**.
Nëse do të referoheshim, data bazës së mbajtur nga DBMF detyrimet për largimet nga puna në fillim të vitit 2019 rezultojnë në vlerën ***40,650,307 lekë, për 12 gjyqfitues.*** Në memot e vëna në dispozicion grupit të auditimit, u konstatua shkresa nr. 5479/1, datë 08.10.2018 që Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore i ka përcjellë Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar kërkesën e përmbaruesit për ekzekutimin e vendimit dhe shlyerjen e detyrimeve për Z. P i cili **nuk** rezulton i raportuar në këtë 3-mujor.
Referuar raportimit për MFE, gjatë 3- mujorit të parë 2019 (tabela e mësipërme), rezulton se është shlyer një pjesë e detyrimit për Znj. F.B, në vlerën **3,000,000 lekë.** Ndërkohë që, referuar të dhënave të Thesarit, me Urdhër shpenzimin nr. 165, datë 07.03.2019, është shlyer pagesa për vendimin gjyqësor i cili ka marr formë të prerë në vitin 2015, për Z. A.B në vlerën **680,588 lekë**, e cila **nuk** është reflektuar në të dhënat e raportuara Thesarit.

Konkluzion:
Pra, nga sa më sipër konkludojmë se, në raportimi për 3-mujorin e parë të vitit 2019 për detyrimet e prapambetura për largimet e padrejta nga puna, për aparatin e MSHMS, **nuk** paraqet vlerën e plotë të detyrimeve të prapambetura, si dhe nuk jep një paraqitje të saktë mbi shlyerjen e tyre.

- ***3 mujori II-2019 (progresiv)***

(2) Emri i Institucionit	(3) Kodi ekonomik i shpenzimit	(4) Emri Furnitorit/ Kreditorit	(5) Shuma e Detyrimit kontratës/ marrëveshjes/ vendim gjyqi, etj. (Lekë)	(6) Detajet e faturës/dokumentit financiar		(9) Pagesat e detyrimeve të prapambetura			
				Data origjinale e faturës	Shuma (Lekë)		Shuma e skedulu ar për tu paguar 6muj.I - 2019	Pagesa të kryera 6muj. I - 2019	Arsyeja e diferencës
Aparati M.SH.M.S.	6027400	"D P" shpk	9,880,160	16.02.2018	9,880,160	mungesë fondi			
Aparati M.SH.M.S.	6027400	A Xh	2,848,125	24.05.2011	2,848,125	mungesë fondi	-	-	
Aparati M.SH.M.S.	6027400	D N	4,304,760	02.10.2018	4,304,760	mungesë fondi	-	-	
Aparati M.SH.M.S.	6027400	"H K"	398,800	29.03.2018	398,800	mungesë fondi	-	-	
Aparati	6027400	F.B	6,699,100			mungesë			mungesë fondi

M.SH.M.S.				30.06.2017	6,699,100	fondi	6,000,000	3,000,000	

Burimi: Raportimet e detyrimeve të prapambetura MSHMS

Tabela e mësipërme paraqet detyrimet për çështjet gjyqësore dhe shlyerjet e tyre, deri më 30.06.2019. Referuar tabelës së mësipërme, sërish detyrimet e prapambetura për çështjet gjyqësore për largime të padrejta nga puna, janë njohur vetëm për **3** punonjës, sikurse edhe në 3-mujorin e parë të këtij viti.

Ndërsa, rezulton se MSHMS ka patur informacion për detyrimet e gjyqfituesve të mëposhtëm, pasi ato rezultojnë të regjistruar nga Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore në DAP. Si dhe, me e-mailin e datës **25.04.2019** Sektori i Ankesave në MSHMS, i ka përcjellë DBMF listën e gjyfituesve, detyrimet financiare ndaj të cilëve nuk janë shlyer. Nga të dhënat e përcjella për grupin e auditimit rezultojnë të regjistruar në DAP në muajin Prill 2019 gjyqfituesit e mëposhtëm. Grupi i auditimit, në bazë të dhënave të përcjella nga DBMF ka përllogaritur në mënyrë të përafërt detyrimet e papaguara për gjyfituesit e larguar nga puna, që duhet të ishin raportuar në 3- mujorin e II 2019, si mëposhtë:

- Z. E. P. Detyrimi për të cilin në fund të 6-mujorit të oarë 2019, kishte arritur në vlerën: detyrimi në fillim të vitit 2019 1,034,400 lekë + detyrimi i shtuar gjatë 6-muajve të parë të vitit 2019 517, 200 lekë (Paga bruto 86,200 lekë/muaj *6 muaj) = **1,551,600 lekë**.
- Z. K.V. Vlera e detyrimit të shtuar gjatë 6-mujorit të parë 2019, **436,080 lekë** (Paga bruto 72,680lekë/muaj *6 muaj)
- Z. M.P. Vlera e detyrimit në fund të 6-mujorit të parë 2019, **468,000 lekë** (Paga bruto 78,000 lekë/muaj *6 muaj).
- Znj. M.C. Detyrimi në fillim të vitit 2019 1,647,840 lekë + detyrimi i shtuar gjatë 6-muajve të parë të vitit 2019 823,920 lekë (Paga bruto 137,320 * 6 muaj) = **2,471,760 lekë.**
- Z. N. I Detyrimi në fillim të vitit 2019 1,572,800 lekë + detyrimi i shtuar gjatë 6-muajve të parë të vitit 2019, 589,800 lekë (Paga bruto 98,300 lekë/ muaj* 6 muaj) **2,162,600 lekë.**
- Z. R. Z. Detyrimi në fillim të vitit 2019 1,279,950 lekë + detyrimi i shtuar gjatë 6-muajve të parë të vitit 2019 667,800 lekë (paga bruto 111,300 lekë/muaj *6 muaj) = **1,947,750 lekë.**
- Z. S. F. Detyrimi në fillim të vitit 6,733,650 lekë +detyrimi i shtuar gjatë 6-muajve të parë të vitit 2019 667,800 lekë (paga bruto 111,300 lekë/muaj *6 muaj) = **7,401,450 lekë.**
- Z. P. P. Detyrimi i shtuar gjatë 6-mujorti të parë të vitit 2019 është **667,800** lekë (paga bruto 111,300 lekë/muaj *6 muaj).
- Znj. A. Xh. Detyrimi i shtuar gjatë 6-mujorti të parë të vitit 2019 është **447,840 lekë** (paga bruto 74,640 lekë/muaj *6 muaj).
- Pra, në raportimin mbi detyrimet e papaguara për gjyqfituesit e larguar nga puna nuk janë përfshirë detyrimet për të paktën **10** kreditor të tjerë (gjyfituesit e listuar më lartë, sëbashku me Z. I. P, i cili nuk ishte raportuar as në 3-mujorin e parë 2019, detyrimi për të cilin kishte arritur vlerën **5,746,440** lekë), përafërsisht në vlerën **22,853,480 lekë.**

Grupi i auditimit nuk mundi të përllogariste, detyrimet financiare të gjyfituesve N.Z, dhe S.L, pasi **nuk** dispononte të gjitha të dhënat e nevojshme.

Gjatë këtij 3-mujori, nga detyrimet për çështje gjyqësore për largimet e padrejta nga puna, rezultojnë të jenë shlyer vetëm **3,000,000 lekë**, për znj. F. B, raportuar që në 3- mujorin e parë.

Konkluzion:

Pra, nga sa më sipër konkludojmë se, raportimi për 3-mujorin e dytë të vitit 2019 mbi detyrimet e prapambetura për largimet e padrejta nga puna, për aparatin e MSHMS, **nuk** paraqet vlerën e plotë të tyre. Pasi, në raportimin mbi detyrimet e papaguara për gjyqfituesit e larguar nga puna **nuk** janë përfshirë detyrimet për të paktën **10** kreditor të tjerë, përafërsisht në vlerën **22,853,480 lekë.**

➢ ***3- mujori I III- 2019 (progresiv)***

(2) Emri i Institucionit	(3) Kodi ekonomik i shpenzimit	(4) Emri Furnitorit/ Kreditorit	(5) Shuma e Detyrimit kontratës/ marrëveshjes/ vendim gjyqi, etj. (Lekë)	(6) Detajet e faturës/dokumentit financiar		(9) Pagesat e detyrimeve të prapambetura			
				Data origjinale e faturës	Shuma (Lekë)		Shuma e skeduluar për tu paguar 9 muj.- 2019	Pagesa të kryera 9 muj.- 2019	Arsyeja e diferencës
Aparati M.SH.M.S.	6027400	Detyrime për V. Gjyqës. (për largime nga puna)	34,799,000	v. 2017 - 2018	34,799,000	mungesë fondi	26,299,000	26,299,000	

Burimi: Raportimet e detyrimeve të prapambetura MSHMS

Nga tabela e mësipërme e raportuar në MFE për detyrimet e prapambetur në MSHMS, rezulton se **nuk** është respektuar formati sipas të cilit duhet të bëhet raportimi i këtyre detyrimeve, pasi kreditorët **nuk** janë raportuar në mënyrë analitike, në kundërshtim Udhëzimi nr. 1, datë 17.01.2019 ñPër për zbatimin e buxhetit viti 2019ò, i cili përcakton formatin e raportimit të detyrimeve të prapambetura. Për shkak se ky format raportim **nuk** është respektuar, për grupin e auditimit është e pamundur të identifikohet se, detyrimet e cilëve kreditorë janë raportuar në MFE në 3-mujorin e III të vitit 2019. Shuma e raportuar si detyrimi shlyer për gjyqfituesit e larguar nga puna gjatë vitit 2019 është **26,299,000** lekë.

Nga analizimi i të dhënave të përcjella nga Drejtoria e Buxhetit dhe Mirëadministrimit Financiar, rezulton se deri në 30.09.2019 janë kryer pagesa, si më poshtë:

	Emer mbiemer	*Vendimi*	*detyrimi ne fillim 2019*	*shtuar 2019*	*Urdhër shpenzimi (vendimi)*	*pagesa sipas vendimit*	*Urdhër shpenzimi (tarif përmbarimore)*	*tarif përmbarimore*	*Total*
1.	A.B	22.05.2015	680,588	-	07.03.2019	680,588			
2.	P.P	12.02.2014	-	1,335,600.00	04.07.2019	604,386	751, 24.09.2019		
3.	P. L	27.09.2012	-	245,642.00	04.07.2019	245,642			
4.	M. P	21.02.2014	-	936,000.00	04.07.2019	430,560			
5.	A. Xh	05.02.2015	-	895,680.00	04.07.2019	413,021			
6.	R.Z	16.04.2018	1,279,950.00	1,335,600.00	04.07.2019	573,868			
7	D. N	28.06.2018	4,719,000.00	936,000.00	04.07.2019	1,760,070			
8.	F. B	22.05.2015	7,692,774.00	1,488,924.00	09.04.2019/ 04.07.2019	4,172,601			
9.	L. T	04.04.2019	200,660.00		04.07.2019	200,660			
10.	N. I	24.05.2011	1,572,800.00	1,179,600.00	04.07.2019	1,308,527			
11.	A. Xh	24.05.2011	2,088,125.00	1,392,000.00	04.07.2019	1,176,635		64,950	
12.	D.B	06.05.2014		1,647,840.00	04.07.2019	1,156,154			
13.	Y. Gj		8,075,000.00		28.08.2019	8,075,000			
	Total					***20,797,712***		***64,950***	***20,862,662***

Burimi: Raportimet e detyrimeve të prapambetura MSHMS

Nga sa më sipër rezulton se, vlera e detyrimeve gjyqësore për largimet nga puna të shlyera gjatë 9-mujorit të parë, rezulton në vlerën ***20,862,662 lekë.*** Pra, konstatohet se janë shlyer më **pak** detyrime për vendime gjyqësore për largime nga puna, se ato të raportuara.

Konkluzion: Mosrespektimi i formatit të përcaktuar për raportimin e detyrimeve të prapambetura

në 3 mujorin e III-2019, nuk siguron gjurmimin në mënyrë analitike të tyre, si dhe nuk ofron transparencë lidhur me detyrimet e lindura, të njohura dhe të shlyera. *Detyrimet* për vendimet gjyqësore për largime nga puna, të *shlyera* deri në 30.09.2019 rezultojnë më **të ulëta** se, ato të raportuara në MFE.

➢ ***3- mujori IV- 2019 (progresiv)***

(2) Emri i Institucionit	(3) Kodi ekonomik i shpenzimit	(4) Emri Furnitorit / Kreditorit	(5) Shuma e Detyrimit kontratës/ marrëveshjes / vendim gjyqi, etj. (Lekë)	(6) Detajet e faturës/dokumentit financiar		(8) Arsyeja e krijimit të detyrimit të prapambetur	(9) Pagesat e detyrimeve të prapambetura		
				Data origjinale e faturës	Shuma (Lekë)		Shuma e skeduluar për tu paguar në v.2019	Pagesa të kryera në v.2019	Arsyeja e diferencës
Aparati M.SH.M.S.	6027400	Detyrime për V. Gjyqës. (për largime nga puna)	49,700,000	v. 2017 - 2018	49,700,000	mungesë fondi	26,299,000	26,299,000	

Burimi: Raportimet e detyrimeve të prapambetura MSHMS

Në tabelën e mësipërme, paraqitet raportimi i kryer nga MSHMS në MFE lidhur me detyrimet e prapambetura. Edhe në këtë tremujor, sikurse ai i mëparshmi, detyrimet e prapambetura **nuk** janë raportuar sipas formatit të përcaktuar duke mos siguruar kështu gjurmë për ndjekjen e detyrimeve në mënyrë analitike, të lindura deri në këtë periudhë, si dhe duke mos siguruar transparencë. Gjatë 3-mujorit të katërt të vitit 2019, **nuk** janë kryer pagesa për të shlyer detyrime për gjyqfituesit e larguar nga puna, por janë paguar 2 tarifa përmbarimore në vlera, 413,804 lekë dhe 534,325 lekë.

Vërehet se, vlera e detyrimeve të prapambetura për vendimeve gjyqësore për largime të padrejta nga puna, është raportuar **49,700,000 lekë**. Nga komunikimi me stafin përgjegjës, kjo vlerë përfaqëson shumën e detyrimeve në fillim të vitit 2019. Referuar tabelës përmbledhëse, të përgatitur për grupin e auditimit nga Drejtoria e Buxheti dhe Mirëadministrimit Financiar, në fillim të vitit 2019 detyrimet për largimet nga puna rezultojnë *40,650,307 lekë*, vlera në total për këto detyrime në vitit 2019 rezulton *58,575,033 lekë* (prej të cilave 40,650,307 vlera në fillim të viti 2019 dhe 17,924,726 lekë të shtuara gjatë vitit), ndërsa vlera e detyrimeve për largimet të padrejta nga puna në fund 2019 rezulton ***34,712,371 lekë***.

Në fund të vitit 2019, MSHMS ka raportuar në MFE detyrime të prapambetura vetëm për për vendimeve gjyqësore për largime të padrejta nga puna, në vlerën **49,700,000 lekë**. Nga të data baza e mbajtur nga DBMF, vënë në dispozicion grupit të auditimit, detyrimet në fund të vitit 2019 për largimet nga puna kanë qenë 34,712,371 lekë. Ndërsa, identifikohet edhe vendimi i formës së prerë i datës 08.10.2018, për çështjen gjyqësore të Spitalit të Gjirokastrës lekë, në të cilën ka qenë palë MSHMS, me vlerë detyrimi 24,471,250 lekë shlyer gjatë vitit 2020. Nëse ky detyrim do tô shtohej atij për çështjet gjyqësore për largime nga puna, vlera e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2019, e raportuar në MFE, duhet të ishte të paktën **59,183,621** lekë. Nga urdhër shpenzimet e kontrolluara nga grupi i auditimit identifikohet edhe detyrimi ndaj shoqërisë ñD. Pò, për një fatur të pashlyer prej vitin 2015, e cila është shlyer në datë 25.06.2020 për vlerën **9,880,160** lekë. Pra, detyrimet e papaguara në fund të vitit 2019 do të ishin jo vetëm për largime të padrejta nga puna, dhe do të ishin të paktën **69,063,781 lekë**. Ndërsa, nuk është njohur as detyrimi për dy gjyfituesit e vitit 2011 dhe 2013, trajtuar më gjerësisht në hyrje të këtij trajtimi.

Në kushtet kur nuk është zbatuar formati i shtojcës 3 për raportimin e detyrimeve është e **paqartë** cfarë përfaqëson vlera 49,700,000 e raportuar si detyrim për gjyqfituesit e larguar nga puna. Vlera e detyrimit të papaguar për aparatin e MSHMS-së, në fund të vitit 2019 është raportuar në MFE, më e **ulët** se vlera e detyrimit e parashikuar në vendimet gjyqësore të pa ekzekutuara për këtë vit.

Ndërsa gjithashtu vlera e raportuar si e shlyer, **nuk** rakordon me vlerën e shlyer për këto detyrime referuar të dhënave të vëna në dispozicion grupi të auditimit nga DBMF (trajtuar më gjerësisht në 3 mujorin e III 2019).

➢ *Thyerja e rregullit të pagesave 2020*

Tabela: Thyerja e radhës së pagesave për vitin 2019

	Gjyqfituesi				*2019*			
Nr.	*Emer mbiemer*	*Detyrimi ne fillim te vitit 2019*	*Detyrim i shtuar gjate vitit 2019*	*U.SH*	*Shlyer vlera e vendimit*	*Shlyer vlera e permbarusit*	*pa paguar ne fund te vitit 2019*	*Vendimi*
1	P.P	-	1,335,600	04.07.2019	604,386	-	731,214	V.173, 12.02.2014
2	P.L	-	245,642	04.07.2019	245,642	-	-	V.19, 27.09.2012
3	M.P	-	936,000	04.07.2019	430,560	-	505,440	V.279, 21.02.2014
4	A. Xh	-	895,680	04.07.2019	413,021	413,804	482,659	V. 185, 05.02.2015
5	K. V	-	872,160	-		-	872,160	V. 430 04.03.2015
6	M. C	1,647,840	1,647,840	-		534,325	3,295,680	V.415, 03.03.2016
7	S. F	6,733,650	1,335,600	-		-	8,069,250	V.3725, 09.10.2014
8	R. Z	1,279,950	1,335,600	04.07.2019	573,868	-	2,041,682	V.1357, 16.04.2018
9	D.N	4,719,000	936,000	04.07.2019	1,760,070	-	3,894,930	V.2681, 28.06.2018
10	F.B	7,692,774	1,488,924	09.04.2019/ 04.07.2019	7,172,601		2,009,097	V.3085, 30.06.2017
11	A. B	680,588	-	07.03.2019	680,588		-	V.1136, 22.05.2015
12	L. T	200,660		04.07.2019	200,660		-	V. 1051, 04.04.2019
13	E. P	1,034,400	1,034,400	-	-		2,068,800	V.2255, 01.12.2010
14	N. I	1,572,800	1,179,600	04.07.2019	1,308,527		1,443,873	V. 32, 02.03.2012
15	A. Xh	2,088,125	1,392,000	04.07.2019/ 24.09.2019	1,241,585	64,950	2,238,540	v. 48, 24.05.2011
16	D.B		1,647,840	04.07.2019	1,156,154		491,686	V.1472, 06.05.2014
17	I.P	4,925,520	1,641,840	-	-	-	6,567,360	V. 504, 10.03.2016
18	Y. Gj	8,075,000		28.08.2019	8,075,000	-	-	
	Total	***40,650,307***	***17,924,726***		***23,862,662***	***1,013,079***	***34,712,371***	

Burimi: DBMF dhe Sektori i Ankesave Administrative MSHMS
Përpunoi: Grupi i auditimit

Referuar pikës 8.3 të Udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014, i ndryshuar,detyrimet e papaguara ñ*renditen sipas parimit të kohës së krijimit të detyrimit financiar, duke filluar nga detyrimet më të vjetra tek ato më të reja, sipas datave origjinale të faturave apo dokumenteve justifikues*ò. Ndërsa, pika 27 e Udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014, i ndryshuar përcakton: *"Pagesat e detyrimeve të prapambetura do të bëhen duke respektuar radhën sipas klasifikimit të detyrimeve të prapambetura në paragrafin 8 të këtij udhëzimi*ò.

Nga tablea e mësipërme identifikohet se, për të paktën **4** gjyfitues në **18** gjithsej, të raportuara nga MSHMS për grupin e auditimit, është thyer rregulli i pagesave i cili përcakton se, detyrimet që lindin të parat, paguhen të para. Duke marrë në konsideratë dhe dy gjyfituesit me vendime të formës së prerë të vitit 2011 dhe 2013 (znj. L dhe z .Z), të cilët **nuk** kanë marrë pagesa gjatë

viteve 2019-2020, atëherë konstatohet se është thyer radha e pagesave për të paktën **6** gjyfitues në **20** gjithsej, pra në ***30%*** të rasteve.
Në mënyrë më të detajuar:
- Z. I. P, vendimi i 10.03.2016, me detyrim në fillim të vitit 2019 në vlerën *4,925,520* lekë dhe detyrim të shtuar gjatë vitit 2019 në vlerën *1,641,840* lekë, **nuk** ka marrë pagesë gjatë vitit 2019. Nga vlera e detyrimit që rezulton për Z. P në fillim të vitit 2019 konstatohet se, mosha e këtij detyrimi është të paktën **3**- vjecare[21]. Ndërsa, konstatohen pagesa të kryera gjatë vitit 2019, për të shlyer detyrime më të vona, si të viteve 2018, 2019.
- Z. S.F, vendim i 09.10.2014, me detyrim në fillim të vitit 2019 në vlerën *6,733,650 lekë*, dhe detyrim të shtuar gjatë vitit në vlerën *1,335,600 lekë*, **nuk** ka marr pagesë gjatë vitit 2019. Nga vlera e detyrimit total në fillim të vitit 2019 për gjyqfituesin në fjalë rezulton se, mosha e këtij detyrimi është të paktën **5**-vjecare. Ndërsa, gjatë vitit 2019 janë shlyer gjyqfitues me vendime më të vona, apo për të cilat janë shlyer detyrimet ndër vite dhe nuk ka pasur detyrime në fillim të vitit 2019, por vetëm të shtuara gjatë vitit 2019.
- Z. E. P, vendim i 01.12.2010, me detyrim në fillim të vitit 2019 në vlerën *1,034,400 lekë* dhe detyrim të shtuar gjatë vitit 2019 në vlerën *1,034,400 lekë***nuk** ka marr pagesë gjatë vitit 2019. Sikurse mund të identifikohet edhe nga tabela e mësipërme, konstatohet se gjatë vitit 2019 janë shlyer vendime më të vona në kohë dhe që nuk kanë patur detyrime të mbartura nga vitit 2018 (sepse janë shlyer ndër vite) por, të lindura gjatë vitit 2019.
- Znj. M. C, me vendim i 03.03.2016, me detyrim në fillim të vitit 2019 në vlerën *1,647,840 lekë,* dhe detyrim të shtuar gjatë vitit 2019 në vlerën *1,647,840 lekë*, nuk ka marr asnjë pagesë në vitin 2019. Ndërsa, konstatohen pagesa për të shlyer detyrime më të vona, të cilat janë shtuar gjatë vitit 2019.
- Z. N. Z, me vendim të 05.12.2013, detyrimi nuk ishte përllogaritur për të pasi ai nuk rezultonte në listën e debitorëve të mbajtur nga DBMF, **nuk ka** marrë asnjë pagesë gjat periudhës 2019-2020.
- Znj. S. L me 30.05.2011,detyrimi nuk ishte përllogaritur për të pasi ai nuk rezultonte në listën e debitorëve të mbajtur nga DBMF**, nuk** ka marrë asnjë pagesë gjat periudhës 2019-2020.

Konkluzion për vitin 2019
Nga analizimi i raportimeve **tre-**mujore për vitin 2019, si dhe nga analizimi i urdhër shpenzimeve, rezulton se, detyrimet e prapambetura për largimet e padrejta nga puna për aparatin e MSHMS, **nuk** janë raportuar në vlerën e saktë në MFEnë **asnjë** prej raportimeve të këtij viti, pasi në çdo rast janë raportuar më pak detyrime seç realisht rezultonin.
Konstatohet se, është thyer rregulli i pagesave në të paktën **6** nga **20** raste (**30%**) , pasi nuk janë shlyer të parat ato detyrime që kanë lindur të parat.
2 nga **4 r**aportimet (50% të rasteve) e detyrimeve të prapambetura gjatë këtij viti **nuk** janë bërë sipas formatit të përcaktuar, duke **mos** siguruar mundësinë për të gjurmuar në mënyrë analitike detyrimet e lindura dhe të shlyera, si dhe duke **mos** siguruar transparencë.
Mos identifikimi i të gjithë detyrimeve të papaguara për çështjet gjyqësore për largime nga puna, **nuk** ka siguruar një raportim të plotë dhe të saktë të tyre në MFE, si dhe përmban riskun për **mos** identifikimin e plotë dhe të saktë të tyre në pasqyrat financiare të aparatit.

Viti 2020

[21] Detyrimi në fillim të vitit 4,925,520 lekë. Referuar të dhënave të vëna në dispozcion nga Drejtoria e Buxhetit dhe Mirëadministrimit financiar në MSHSM, paga bruto vjetore për Z.P rezulton 136,820 lekë/muaj*12 muaj= 1,641,840 lekë. Vjetërsia minimale e detyrimit: 4,925,520 lekë (detyrim gjithësej në fillim 2019)/1,641,840 lekë (detyrim vjetor)= 3 vjet.

- Për 3-mujorin e parë 2020, Drejtoria e Financës në MSHMS ka kryer raportimin e detyrimeve të prapambetura në MFE, vetëm sipas shtojcës 3/1, si më poshtë.:

	Periudha / Kategoria	Pagesa të planifikuara për periudhën Janar-Mars	Pagesa të planifikuara për periudhën Prill-Qershor	Pagesa të planifikuara për periudhën Korrik-Shtator	Pagesa të planifikuara për periudhën Tetor-Dhjetor
3	**Detyrime të prapambetura për Vendime Gjyqësore:**	**29,002**	**2,755**	**16,635**	**76,935**
	Detyrime për Vend. Gjyq. Aparati MSHMS	24,000	-	15,000	

Burimi: Raportimet e detyrimeve të prapambetura MSHMS

Si rezultat se raportimi, **nuk** kryer është sipas shtojcës 3 të Udhëzimit plotësues nr.2, datë 20.01.2020 ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020ò, në të cilën të reflektoheshin në mënyrë analitike detyrimet e prapambetura, por është raportuar vetëm planifikimi i pagesave të detyrimeve (shtojca 3/1), **nuk** është e mundur të identifikohet nëpërmjet këtij raportimi, stoku i detyrimeve të prapambetura deri në 31.03.2020. Pavarësisht, planifikimit të raportuar për pagesa në periudhën Janar-Mars 2020, është kryer vetëm një pagesë për shlyerjen e detyrimeve për z. Y. Gj, me urdhër shpenzimin nr. 135 datë 04.03.2020, në vlerën ***2,464,064 lekë.***

- Për 3- mujorin e dytë 2020, si rezultat se vendi ishte i mbyllur për shkak të Pandemisë Covid-19, nuk është kryer raportimi i detyrimeve të prapambetura.
- Për 3-mujorin e tretë 2020 është kryer raportimi i detyrimeve të prapambetura si mposhtë:

(3) Kodi ekonomik i shpenzimit	(4) Emri Furnitorit/ Kreditorit	(5) Shuma e Detyrimit kontratës/ marrëveshjes/ vendim gjyqi, etj. (Lekë)	(6) Detajet e faturës/dokumentit financiar		(9) Pagesat e detyrimeve të prapambetura		
			Data origjinale e faturës	Shuma (Lekë)	Shuma e skeduluar për tu paguar në v.2020	Pagesa të kryera në v.2020	Arsyeja e diferencës
6027400	Detyrime për V. Gjyqës. (për largime nga puna)	27,177,000	v. 2017 - 2018	27,177,000	18,488,000	9,224,000	

Burimi: Raportimet e detyrimeve të prapambetura MSHMS

Konstatohet se, edhe në raportimet e tremujorit të tretë të vitit 2020, detyrimet e prapambetura **nuk** janë raportuar në mënyrë analitike sikurse përcakton Udhëzimi nr. 2, datë 20.01.2020. Në total, për 3 mujorin e tretë të vitit 2020, janë raportuar si detyrime të prapambetura nga vendimet gjyqësore për largime nga puna **27,177,000 lekë**, ndërsa pagesat në vlerë **9,224,000 lekë**. Si rezultat se, raportimi nuk është kryer sipas shtojcës së përcaktuar në Udhëzimin nr. 2, 10.01.2020, nuk është e mundur të identifikohet se detyrimet e cilit gjyqfitues janë raportuar në këtë muaj.

Pagesat e raportuara të kryera për shlyerjen e detyrimeve të mësipërme, **nuk** përkojnë me pagesat e përcjella nga Drejtoria e Financës për grupin e auditimit si të kryera për proceset gjyqësore të largimit me pa të drejtë nga puna ***32,606,102*** *lekë*, deri në këtë periudhë. Referuar të dhënave të përcjella nga Drejtoria e Financës, për grupin e auditimit, gjatë kësaj periudhe janë bërë pagesat e mëposhtme:

Nr. USh	Data	Emërtimi	Vlera
135	04.03.2020	Pagese me vendim gjyqësor Y.Gj	2,464,064
105	22.04.2020	Pagese me vendim gjyqësor P.P	604,386
106	22.04.2020	Pagese me vendim gjyqësor M.P	552,360
107	22.04.2020	Pagese me vendim gjyqësor A. Xh	413,021
108	22.04.2020	Pagese me vendim gjyqësor D. N	430,560
109	22.04.2020	Pagese me vendim gjyqësor R. Z	647,712

110	22.04.2020	Pagese me vendim gjyqësor N. I	490,694
111	22.04.2020	Pagese me vendim gjyqësor D. B	674,423
113	22.04.2020	Pagese me vendim gjyqësor K. V	402,790
115	22.04.2020	Pagese me vendim gjyqësor S.F	714,632
356	26.05.2020	Pagese me vendim gjyqësor M. C	740,210
405	10.06.2020	Shpenzime për vendim gjyqësor për spitalin e Gjirokastrës	24,471,250
		Total	***32,606,102***

Burimi: Raportimet e detyrimeve të prapambetura dhe kontabilizimi i bankës 2020, MSHMS

Nëse në pagesat e kryera për detyrimet nga vendimet gjyqësore, do të shtonim dhe atë të kryer me Urdhër Shpenzimi nr. 450, datë 25.06.2020 për vlerën 9,880,160 lekë, për detyrimin ndaj shoqërisë D. P ò atëherë konstatohet se, pagesat e kryera për detyrimet e prapambetura **nuk** kanë qenë vetëm për vendime gjyqësore për largime nga pune, por edhe për fatura të mbetura nga vitet e kaluara,duke e çuar shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në vlerën ***42,486,262 lekë, nga 9,224,000 lekë*** *të raportuara.*

Konkluzion:

Si rezultat se, raportimi **nuk** është kryer sipas shtojcës së përcaktuar në Udhëzimin nr. 2, 10.01.2020, **nuk** është e mundur të identifikohen detyrimet specifike të secilit gjyq fitues deri në këtë periudhë, duke **mos** siguruar mundësinë për ndjekjen e shlyerjes së tyre në mënyrë analitike, si dhe duke **mos** siguruar transparencë.

Pagesat e kryera për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të cilat rrjedhin nga vendimet gjyqësore, nuk janë kryer vetëm për vendimi gjyqësore për largime nga puna sikurse është raportuar në MFE, po edhe për vendim te tjera gjyqësore. Detyrimet realisht të shlyera janë në vlerën ***42,486,262 lekë*** rezultojnë më të larta se ato të raportuara si të shlyera në MFE në vlerën ***9,224,000 lekë.***

- *3-mujori i IV 2020*

Duke qenë se në dhjetor 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka nxjerrë Urdhrin nr. 37, datë 06.10.2020, në vijim mënyra e raportimit të detyrimeve të prapambetura ka ndryshuar. Referuar pikës III.1, të këtij Udhëzimi ñ*Në zbatim të legjislacionit në fuqi strukturat përgjegjëse për financat e njësisë shpenzuese të qeverisjes vendore paraqet menjëherë në strukturën përgjegjëse për Thesarin në degë detyrimet e prapambetura (për të cilat nuk ka fonde disponibël për të kryer regjistrimin në SIFQ dhe pagesën në aftin e miratuar) nëpërmjet dokumentit "Urdhër regjistrim i detyrimeve të prapambetura" (URDP), formati i të cilit paraqitet në Tabelën 4 në Aneksin 2 bashkëlidhur këtij Udhëzimi. URDP të këtë bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin justifikues*ò.

Pra, referuar udhëzimit të mësipërm, pas hyrjes në fuqi të tij, MSHMS duket të kishte përcjellë pranë Thesarit të gjitha Urdhër regjistrimet për kreditorët, së bashku me dokumentet justifikuese. Megjithatë, referuar shkresave të vëna në dispozicion grupit të auditimit, raportimi i **parë** sipas formatit të ri për detyrimet e prapambetura të vitit 2020 është bërë, me shkresën rn 662, datë 03.02.2021, në Drejtorinë e Thesarit. Bashkëlidhur më këtë shkresë është dërguar një tabelë, e cila paraqet në mënyrë **sintetike** vlerën e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore, në shumën 27,150,000 lekë. Bashkëlidhur më këtë shkresë **nuk** janë përcjellë urdhër regjistrimet e detyrimeve, apo dokumentet justifikuese.

Në vijim të kërkesës së grupit të auditimit, DBMF vuri në dispozicion, dosjen e përgatitur me URDP, të cilat nuk ishin dërguar në Thesar, por ishin përgatitur për vet institucionin. Në këtë dosje u identifikua Urdhër regjistrimi nr. 1178, datë 31.12.2020, mbi detyrimet e prapambetura për vendimet gjyqësore, në vlerën ***27,150,000*** lekë. Ky urdhër regjistrim ishte përgatitur sërish në mënyrë sintetike, pra **nuk** ishin hartuar URDP për çdo gjyq fitues, si dhe nuk kishte bashkëlidhur dokumentet justifikuese, duke bërë të pamundur identifikimin se detyrimet e cilit gjyq fitues ishin njohur, si të tilla.

Nga të dhënat e përcjella për grupin e auditimit nga DBMF në MSHMS, në 31.12.2020, rezultojnë ***33,878,384 lekë***detyrime të prapambetura për largimet nga puna. Pra në raportimin për Thesarin, si dhe në Pasqyrat Financiare të vitit 2020, janë njohur të paktën **6,728,384** lekë[22] më pak detyrime për vitin 2020 për gjyqfituesit e larguar nga puna, ose rreth 20% më pak se vlera që duhet të raportohej. Referuar edhe të dhënave të SQIF për vitin 2020, detyrimet e prapambetura për vendimet gjyqësore rezultojnë në vlerën **27,150,000** lekë.

Konkluzion: Detyrimet e papaguara për gjyq fituesit e larguara nga puna deri në 31.12.2020, ***nuk*** janë përgatitur sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimit nr.2, datë 20.01.2020, si dhe ***nuk*** janë paraqitur në vlerën e plotë dhe të saktë të tyre, në raportimet e përcjella në Thesar, duke mos reflektuar në mënyrë të saktë vlerën e tyre edhe në pasqyrat financiare të MSHMS për vitin 2020.

➢ *Thyerja e rregullit të pagesave 2020*

Gjatë vitit 2020, janë bërë pagesat e mëposhtme:

Nr. USh	Data	Emërtimi	Vlera	Vendimi
135	04.03.2020	Pagese me vendim gjyqësor Y. Gj[23]	2464064	V 57065/5, datë 08.12.2016
105	22.04.2020	Pagese me vendim gjyqësor P.P	604386	V.173, 12.02.2014
106	22.04.2020	Pagese me vendim gjyqësor M.P	552360	V.279, 21.02.2014
107	22.04.2020	Pagese me vendim gjyqësor A. Xh	413021	V. 185, 05.02.2015
108	22.04.2020	Pagese me vendim gjyqësor D. N	430560	V.2681, 28.06.2018
109	22.04.2020	Pagese me vendim gjyqësor R. Z	647712	V.1357, 16.04.2018
110	22.04.2020	Pagese me vendim gjyqësor N. I	490694	V. 32, 02.03.2012
111	22.04.2020	Pagese me vendim gjyqësor D. B	674423	V.1472, 06.05.2014
113	22.04.2020	Pagese me vendim gjyqësor K.V	402790	V. 430 04.03.2015
115	22.04.2020	Pagese me vendim gjyqësor S.F	714632	V.3725, 09.10.2014
356	26.05.2020	Pagese me vendim gjyqësor M. C	740210	V.415, 03.03.2016
1041	28.12.2020	Pagese me vendime gjyqësor e P. P	379240	V.173, 12.02.2014
1042	28.12.2020	Pagesa me vendime gjyqësor M.P	861121	V.279, 21.02.2014
1043	28.12.2020	Pagesa me vendime gjyqësor A.Xh	826042	V. 185, 05.02.2015
1044	28.12.2020	Pagesa me vendime gjyqësor K.V	805579	V. 430 04.03.2015
1045	28.12.2020	Pagesa me vendime gjyqësor S.F	1191054	V.3725, 09.10.2014
1046	28.12.2020	Pagesa me vendime gjyqësor R.Z	1187472	V.1357, 16.04.2018
1047	28.12.2020	Pagesa me vendime gjyqësor N.I	1226736	V. 32, 02.03.2012
1048	28.12.2020	Pagesa me vendime gjyqësor D.N	1148160	V.2681, 28.06.2018
1051	28.12.2020	Pagesa me vendime gjyqësor D.B	1156154	V.1472, 06.05.2014
1079	28.12.2020	Pagese për vendime gjyqësor e M. C	1110316	V.415, 03.03.2016
1080	28.12.2020	Pagese për vendime gjyqësor e F. B	1143030	V.3085, 30.06.2017
1081	28.12.2020	Pagese për vendime gjyqësor e A. Xh	1078578	v. 48, 24.05.2011

Burimi: DBMF dhe Sektori i Ankesave Administrative MSHMS
Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga tabela e mësipërme identifikohet se:

- Janë kryer pagesa të tjera, përpara një detyrimi më të hershëm sikurse është ai për znj. A Xh, vendimi i të cilës i përket vitit 2011. Nga tabela e përcjellë nga Drejtoria e Financës, rezulton se gjyq fitues të cilët kanë pasur detyrime të shtuar gjatë vitit 2019 dhe 2020, dhe nuk kanë pasur detyrime të më mëparshëm. Ato kanë marr pagesa në një datë më të hershme se A. Xh e cila përveç detyrimeve të shtuara për të gjatë viteve 2019-2020, rezulton detyrim edhe më i hershëm.
- Për z. I.P, vendimi i vitit 10.03.2016, më detyrim në fillim të vitit 2019 në vlerën 4,925,520 lekë, detyrim të shtuar gjatë vitit 2019 në vlerën 1,641,840 lekë, dhe detyrim të shtuar gjatë vitit 2020 në vlerën 1,641,840 lekë **nuk** ka marrë asnjë pagesë as gjatë vitit 2020. Sikurse

[22] Në këtë vlerë nuk janë përfshirë detyrimet e parashikuara në vendimet e dy gjyqfituesve të cilët nuk ishin reflektuar në databazën e DBMF.
[23] Me vendim të Gjykatës Europiane të të drejtave të Njeriut

mund të identifikohet edhe nga tabela e mësipërme gjatë vitit 2020 janë shlyer gjyq fitues me vendime më të vona se ai për Z. P, dhe që nuk kanë pasur detyrime të mbartura përpara vitit 2019.

- Për z. E. P, vendim i viti 01.12.2010, me detyrim në fillim të vitit 2019 në vlerën 1,034,400 lekë, detyrim të shtuar gjatë vitit 2019 në vlerën 1,034,400 lekë dhe detyrim të shtuar gjatë vitit 2020 në vlerën 1,034,400 lekë, **nuk** ka marr asnjë pagesë as gjatë vitit 2020. Sikurse mund të identifikohet edhe nga tabela e mësipërme, gjatë vitit 2020, janë shlyer gjyq fitues me vendime më të vona se ai për z. P, dhe qe nuk kanë pasur detyrime të mbartura përpara vitit 2019.
- - Z. N.Z, me vendim të 05.12.2013, detyrimi nuk ishte përllogaritur për të pasi ai nuk rezultonte në listën e debitorëve të mbajtur nga DBMF, **nuk ka** marrë asnjë pagesë gjatë periudhës 2019-2020.
- Z. S.L me 30.05.2011,detyrimi nuk ishte përllogaritur për të pasi ai nuk rezultonte në listën e debitorëve të mbajtur nga DBMF**, nuk** ka marrë asnjë pagesë gjatë periudhës 2019-2020.

Konkluzion: Gjatë vitit 2020, është thyer rregulli i pagesave sipas të cilit duhet të shlyhen të parat, detyrimet që lindin të parat. Në **19** gjyq fitues të cilët rezultonin më detyrime të prapambetura në vitin 2020, në **5** raste është thyer radha e pagesës, pra në 17.6% të rasteve. Ndërsa këtu, **nuk** është janë marrë në analizë detyrimi i parashikuar në vendimet e formës së prere të dy gjyq fituesve të viteve 2011 dhe 2013 (trajtuar më gjerësisht në hyrje të këtij trajtimi), të cilët nuk ishin reflektuar në data bazën e DBMF.

Konkluzion për vitin 2020

Nga analizimi i raportimeve **tre-**mujore për vitin 2020, si dhe nga analizimi i urdhër shpenzimeve, rezulton se, detyrimet e prapambetura për largimet e padrejta nga puna për aparatin e MSHMS, **nuk** janë raportuar në formatin e duhur (Udhëzimi nr.2, datë 20.01.2020 dhe Udhëzimi nr.37, datë 06.10.2020) në MFE, apo në Thesar, në **asnjë** prej raportimeve të këtij viti, duke **mos** siguruar mundësinë për të gjurmuar në mënyrë analitike detyrimet e lindura dhe të shlyera, si dhe duke **mos** siguruar transparencë.

U konstatua se, data baza e mbajtur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Mirëmenaxhimit Financiar në zbatim të pikës 4 të Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014, vënë në dispozicion grupi të auditimit, **nuk** përmban shumën e plotë të detyrimeve për largimet nga puna, pasi në të **nuk**janë reflektuar detyrimet e parashikuara nga vendimet e formës së prerë të viteve 2011 dhe 2013 për dy gjyq fitues, znj. S. L, dhe z. N. Z.

Në raportimin për Thesarin, si dhe në Pasqyrat Financiare të MSHMS, janë njohur të paktën **6,728,384** lekë[24] më **pak** detyrime për vitin 2020 për gjyq fituesit e larguar nga puna, ose rreth 20% më pak se vlera që duhet të raportohej. Konstatohet se, është thyer rregulli i pagesave në të paktën **5** nga **19 (26%)** të raste sipas të cilit, duhet të shlyhen të parat ato detyrime të cilat lindin të parat. Sa më sipër, **nuk** ka rezultuar në vlerësimin e detyrime të papaguara dhe raportimin e tyre në mënyrë të saktë dhe të plotë, sikurse përcaktohet në VKM nr.50, datë 05.02.2014 ñPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimitò, të ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua gjithashtu se, janë raportuar detyrime të prapambetura dhe shlyerje e tyre vetëm për vendime gjyqësore për largime të padrejta nga puna, ndërsa nga kontrolli i urdhër shpenzimeve u identifikua se detyrimet e prapambetura të MSHMS **nuk** kanë rrjedhur vetëm nga vendimet gjyqësore për largime të padrejta nga puna, por edhe vendime të tjera gjyqësore. Pagesat e kryera për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të cilat rrjedhin nga vendimet gjyqësore, nuk janë kryer vetëm për vendimi gjyqësore për largime nga puna sikurse është

[24] Në këtë vlerë nuk janë përfshirë detyrimet e parashikuara në vendimet e dy gjyqfituesve të cilët nuk ishin reflektuar në databazën e DBMF.

raportuar në MFE, po edhe për vendim te tjera gjyqësore. Detyrimet realisht të shlyera (nga vendimet gjyqësore) janë në vlerën ***42,486,262 lekë*** dhe rezultojnë më të larta, se ato të raportuara në MFE si të shlyera në vlerën ***9,224,000 lekë.***
Mos identifikimi i të gjithë detyrimeve të papaguara për çështjet gjyqësore për largime nga puna, nuk ka siguruar një raportim të plotë dhe të saktë të tyre në MFE dhe Thesar për vitin 2020, si dhe përmban riskun për **mos** identifikimin e plotë dhe të saktë të tyre në pasqyrat financiare të aparatit.
Konstatohet gjithashtu se, në **kundërshtim** me pikën 5 të Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesaritò, MSHMS **nuk** ka publikuar grafikun në faqen ëeb të institucionit grafikun e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.

b) Saktësia dhe rregullariteti i veprimeve të kryera në magazinë.
Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, grupi i auditimit kërkoi informacion lidhur me magazinën e Aparatit të MSHMS. Dokumentimi i veprimeve në magazine bëhet nëpërmjet prerjes së fletë-hyrjeve dhe flet-daljeve për materiale të hyra apo të dala nga magazina. Lëvizjet e kryera nga magazina nga personi përgjegjës material (Magazinieri) mbahen në librin e magazinës që shërben për rakordim me të dhënat e kontabilitetit të mbajtura nga sektori i Financës. Daljet e materialeve nga magazina bëhen sipas kërkesave të punonjësve të Aparatit të shoqëruara me urdhër dorëzimin bashkëngjitur të nënshkruar nga Sektori Shërbimeve të Brendshme.
Konkretisht nga kontabilizimi i hyrjeve për vitin 2019 llogaria 312 ñMaterialeò rezulton me një shumë 12,147,781 lekë që tregon vlerën e materialeve e mallrave të bëra hyrje në magazinë si kancelari, tonera, karburant etj. Artikuj të kësaj natyre, kurse llogaria 218 ñInventar ekonomikò në shumen 1,151,400 lekë reflekton hyrjen në magazinë të pajisjeve te blera për aparatin e Ministrisë si orendi zyrash apo pajisje kompjuterike. Nga kontabilizimi i daljeve për vitin 2019 pakësimi i llogarive 312 ñMaterialeò në shumen 12,661,122 lekë; llogaria 218 ñInventar ekonomikò në shumën 1 355 454 lekë dhe llogaria 215 ñMjete transportiò në shumën 2,566,570 lekë reflekton lëvizjen e aktiveve nga magazina në përdorim të personelit ose kalim nga aparati në institucione të tjera të vartësisë.
Për vitin 2020 nga kontabilizimi i hyrjeve llogaria 312 ñMaterialeò rezulton me një shumë prej 11,160,132 lekë që tregon vlerën e materialeve e mallrave të bëra hyrje në magazinë si kancelari, tonera, karburant etj., kurse llogaria 218 ñInventar ekonomikò në shumën 828 000 lekë reflekton hyrjen në magazinë të pajisjeve të blera për aparatin e Ministrisë si orendi zyrash apo pajisje kompjuterike, llogaria 215 ñMjete transportiò në shumen 229,806,720 lekë pasqyron bërjen hyrje te Autoambulancave të blera nga Aparati që do tu jepen institucioneve të varësisë.
Nga kontabilizimi i daljeve për vitin 2020 prekja e llogarive 312ñMaterialeò në shumën 11 492 099 leke; llogaria 218 ñInventar ekonomikò në shumën 928,200 lekë pasqyron lëvizjen e aktiveve nga magazina drejt personelit për shërbimet e nevojshme qe ai ka, kurse llogaria 215 ñMjete transportiò në shumën 185,122,080 leke reflekton kalimin e aktiveve (Autoambulancave) nga Aparati i MSHMS në institucionet e varësisë.

c) Inventarizimi i pronës shtetërore
- *Regjistri i Aktiveve 2019*

Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*ò, i ndryshuar, në kapitullin III ñ*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i tyre*ò, pika 26 e tij, përcakton ñ*Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël* *<u>të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim</u>*, *përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar".*
Pika 28 e këtij Udhëzimi përcakton ñ*Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet*

afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare, si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital."

Pika 30 e këtij Udhëzimi përcakton ñ*Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër, si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës se aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia."*

- Regjistri i aktiveve **nuk** përmbush kërkesat minimale:

Nga analizimi i Regjistri i Aktiveve të MSHMS për vitin 2019, rezulton se në **kundërshtim** me pikën 26, 28 dhe 30 Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, ai nuk përmban një informacion të plotë mbi aktivet e institucionit, pasi në të **nuk** është reflektuar data e hyrjes apo marrjes në dorëzim, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes apo data e daljes nga pronësia, etj. Në Regjistrin e Aktiveve për vitit 2019, vlera e automjeteve është paraqitur në total dhe **jo** në mënyrë analitike për secilin automjet. Në të njëjtën mënyrë, edhe amortizimi i akumuluar është paraqitur në total për të gjitha aktivet dhe **jo** në mënyrë analitike, duke rezultuar në fund në një vlerë amortizimi të akumuluar më e lartë se vlera e aktivit, dhe vlerë kontabël të mbetur të aktivit 0, edhe pse rezultojnë makina me vit prodhimi 2016. Megjithatë, nga kontrolli i Urdhër Shpenzimeve për muajin shtator 2019, rezulton se janë kryer shpenzime për mirëmbajtjen e makinave, me specifikisht Urdhër Shpenzimet nr. 740,741,742,743,744,745,746, 747,748,749 dhe 755 të datës, të datës 24.09.2019, në vlerë totale ***1,393,020 lekë,*** të cilat **nuk** rezultojnë të evidentuara në Regjistrin e Aktiveve për këtë vit.

- *Inventarizimi 2019*

Referuar nenit 73 të Udhëzimit nr.30 dt.27.12.2011, të ndryshuar, ñ*Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar, si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efiçiencë të tyre"* Sipas nenit 74 të këtij Udhëzimi *"Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës."*

Në nenin 81 të Udhëzimit nr.30.27.12.2011, të ndryshuar përcaktohet se: *"Inventarizimi kryhet nga një komision i posaçëm që krijohet me urdhër të titullarit të njësisë publike ose nëpunësit autorizues të çdo niveli të njësisë publike. Lista e aktiveve për inventarizim hartohet nga nëpunësi zbatues në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë*ò.

Në dosjen e përcjellë nga Ministria e Shëndetësi dhe Mbrojtjes Sociale mbi procesin e inventarizimit të kryer për vitin 2019, gjendet Urdhri nr. 30, datë 22.01.2020, me nr. prot. 367, datë 22.01.2020, i Sekretarit të Përgjithshëm (nëpunësi autorizues), me anë të të cilit është urdhëruar:

1. Ngritja e komisionit për inventarizimin e pasurisë, inventarit ekonomik në zyra dhe magazinë, si dhe mjeteve të transportit të Aparatit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. Komisioni të jetë i përbërë nga:
    - M. Sh (Kryetare e komisionit)
    - R. S
    - E. H
3. Inventarizimi të kryhet për periudhën nga data 01.01.2019 deri më 31.12.2019. Afati i kryerjes së inventarizimit do të jetë data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri, deri më datë 15.02.2020.

4. Në përfundim të procesit të inventarizimit, komisioni të hartojë dokumentacionin përkatës si dhe raportin lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me procesin e inventarizimit.

*- Inventarizimi **nuk** ka nisur nga lista e aktiveve për inventarizim, e cila duhet të hartohej nga të dhënat kontabël:*

Në ***kundërshtim*** me neni 81 të Udhëzimit nr.30.27.12.2011, në dosje **nuk** gjendet lista e aktiveve për inventarizim e cila duhet të hartohej nga nëpunësi zbatues, Z. S.K, në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë.

Në relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit në përfundim të procesit të inventarizimit për vitin 2019, shkresa me nr. prot. 367/1, datë 20.02.2020, është përcaktuar se ñInventarizimi i aseteve të Aparatit të MSHMS është bërë mbi gjendjen fizike të aseteve, **pa** bërë krahasimin me gjendjen kontabël pasi akoma **nuk** është pasqyruar në kontabilitet gjendja e aseteve të ish-MMSRò.

Duke qenë se, inventarizimi i aseteve të Aparatit të MSHMS është bërë mbi gjendjen fizike të aseteve, **pa** bërë krahasimin me gjendjen kontabël, nuk **kanë** rezultuar diferenca, duke **mos** siguruar një pamje të qartë të diferencave që ekzistojnë midis aktiveve të regjistruara në kontabilitet, me ato fizikisht gjendje në aparatin MSHMS.

Referuar nenit 83 të Udhëzimit nr.30. dt.27.12.2011, të ndryshuar, ñPara fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletëhyrjes dhe fletëdaljeve nëpërmjet një proces verbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit materialò. Në zbatim të këtij neni, është mbajtur proces verbali i datës 23.01.2020, midis komisionit të vlerësimit dhe Përgjegjësit material. Sipas këtij procesverbali, të mbajtur në magazinën e Aparatit të MSHMS:

-Është mbyllur blloku i Fletë-Hyrjeve me numrin 30, datë 30.12.2019

Është mbyllur blloku i Fletë daljeve me numrin 282, datë 31.12.2019

- Është marrë deklarata për dakortësinë e kryerjes së inventarizimit.

Në dosje, bashkëlidhur procesverbalit të mësipërm gjendet edhe deklarata e dakortësisë së përgjegjësit material, znj. A.H me detyre magaziniere.

Sipas pikës c) të nenit 85 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, të ndryshuar ñ*Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësim paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues*".

Në zbatim të kësaj pike, në përfundim të procesit të inventarizimit për vitin 2019, komisioni i vlerësimit ka përgatitur relacionin nr. prot. 367/1, datë 20.02.2020. Sipas këtij relacioni, komisioni i vlerësimit ka bërë verifikimin fizik të aktiveve që kanë në përdorim punonjësit si dhe atë të magazinës së aparatit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duke hartuar procesverbale rast pas rasti, në sasi, çmim dhe vlerë.

Në përfundim, referuar relacionit, grupi ka hartuar:

1. Inventarin për asetet në përdorim nga punonjësit e aparatit të Ministrisë dhe përmbledhësen e tyre bashkëlidhur relacionit ku pasqyrohet edhe vlera e aseteve.
2. Inventarin e magazinës me të gjithë artikujt duke u shprehur në sasi, çmim e vlerë bashkëlidhur relacionit.

- *Mungesa në dosje e procesverbalit për aktive në vlerë 31,732,191 lekë që duhet të inventarizoheshin edhe në vitin 2019.*

Në dosjen e inventarizimit të vitit 2019,***nuk*** gjendej procesverbali i mbajtur për inventarizimin e kryer gjatë këtij viti, për *Pajisje zyra kati I*, në vlerën 31,732,191 lekë. Në këtë dosje gjendej procesverbali i inventarizimit të kryer për këto pajisje me këtë vlerë, nga grupi i inventarizimit të vitit 2018. Procesverbali i mbajtur për inventarizimin e kryer në vitin 2018 për këtë zë, ishte

firmosur edhe nga grupi i inventarizimit të vitit 2019.
Pasi grupi i auditimit kërkoi informacion, mbi arsyen e mos përgatitjes së këtij procesverbali dhe në përfundim të procesit të inventarizimi për vitin 2019, grupi i inventarizimit i vitit 2019, përcolli një tjetër procesverbal për këto aktive, me po të njëjtën vlerë dhe format si ai i vitit 2018, por këtë herë të firmosur vetëm nga grupi i punës së vitit 2019.
Duke qenë se procesverbali për inventarizimin e kryer në vitin 2019, për aktivet në katin e parë në vlerën 31,732,191 lekë, nuk ishte pjesë e dosjes së inventarizimit të këtij viti, si dhe për shkak se procesverbalet nuk janë të protokolluar, situata e përshkruar më lart, nuk ofron siguri që këto aktive me vlerë 31,732,191 lekë janë inventarizuar edhe gjatë procesit të inventarizimit të kryer për vitit 2019.

- *Mungesa në dosje e procesverbaleve të mbajtura për makinat e inventarizuara*

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve të kryera gjatë vitit 2019, rezultuan shpenzime mirëmbajtje për makinat në pronësi dhe administrim të MSHMS. Në dosjen e inventarizimit të vitit 2019, nuk u gjendën procesverbalet e mbajtura për makinat e inventarizuara. Në vijim të kërkesës së grupit të auditimit, u vendosën në dispozicion procesverbalit e makinave të inventarizuara. Më poshtë paraqiten të dhënat, referuar këtyre procesverbaleve.

Mjeti	*Targa*	*Viti prodhimit*	*Çmimi*	*Sasia*
Hyndai Tucson	*TR4112R*	*2008*	*2,566,570*	*1*
W Jeta	*TR 8535N*	*2007*	*2,714,000*	*1*
Wolkswagen Passat	*AA358VF*	*2007*	*2,345,060*	*1*
Wolkswagen Phaeton	*AA434DU*	*2005*	*3,976,800*	*1*
Wolkswagen Touarag	*AA154XY*	*2007*	*7,020,000*	*1*
Toyoto Ptius	*AA358PN*	*2016*	*5,006,418*	*1*
Toyota RAV 4	*AA496PK*	*2016*	*5,102,269*	*1*
Toyota Hillux	*TR2108 T*	*1989*	*1,376,833*	*1*
Motorri				
Jashtë përdorimit				
Wolkswagen Bora	*TR0231Z*	*2000*	*2,324,000*	*1*
Benc Mercedes	*TR4005I*	*1993*	*2,270,000*	*1*
Benc Mercedes	*AA55OZ*	*2000*	*10,307,430*	*1*

Burimi: MSHMS
Përpunoi: Grupi auditimit

- *Mungesa e një raporti përmbledhës në të cilin të paraqitet vlera totale e aktiveve të inventarizuara*

Nga analizimi i dosjes së inventarizimit rezultoi se, grupi i punës së inventarizimit ka hartuar vetëm një përmbledhëse bashkëlidhur me relacionin, në të cilin janë paraqitur aktivet në përdorim të punonjësve dhe një magazine, që i përkasin klasave të llogarisë 214 dhe 218.Aktivet e inventarizuara që i përkasin klasave të tjera të aktiveve **nuk** janë përfshirë në këtë përmbledhëse.
Nga krahasimi i procesverbaleve të mbajtura rast pas rasti, me përmbledhësen e aktiveve bashkëlidhur relacionit rezultonin, se në dokumentin përmbledhës **nuk** ishin reflektuar edhe dy magazina të tjera (MSh. MS), një listë aktivesh të katit të parë (të cilat nga komisioni i vlerësimit të vitit 2018 ishin propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi, por që nuk ishin nxjerrë jashtë përdorimit dhe vijonin të ishin në MSHMS), si dhe automjetet.
Pasi grupi i auditimit kërkoi informacion përse këto aktive nuk ishin përfshirë në përmbledhësen bashkëlidhur relacionit të përgatitur nga grupi i auditimit, grupi i inventarizimit 2019 përcolli një tjetër përmbledhëse me këto zëra të përfshirë në të, të firmosur nga grupi i inventarizimit. Në tabelën e mëposhtme paraqitet diferenca në vlerë e aktiveve të paraqitura në procesverbalin bashkëlidhur relacionit, dhe procesverbalit të dytë të përcjellë për grupin e auditimit, pas

identifikimit të disa procesverbaleve që nuk ishin përfshirë në përmbledhësen bashkëlidhur relacionit.

	Vlera totale (lekë)	Vlera MSH (lekë)	Vlera MS (lekë)
Përmbledhësja bashkëlidhur relacionit	140,614,845	96,791,355	43,823,511.50
Përmbledhësja e dytë vënë në dispozicion pas kërkesës së G.A	184,598,532	102,357,379	82,241,154
Diferenca	***43,983,687***	***5,566,024***	***38,417,643***
Magazina MS	6,685,452		6,685,452
Magazina MSH	5,566,044	5,566,044	
Pajisje zyra kati I	31,732,191		31,732,191

Burimi: MSHMS
Përpunoi: Grupi auditimit

Në Regjistrin e Aktiveve për vitin 2019, referuar komunikimeve me subjektin, janë reflektuar vetëm aktivet e ish- Ministrisë së Shëndetësisë, dhe ato paraqiten si mposhtë në mënyrë të përmbledhur:

Nr.	***Përshkrimi i aktivit***	***Specifikime***	***Klasifikimi Ekonomik***	***Vlera e aktivit e pa amortizuar.***	***Vlera kontabël e aktivit***
1	Aktive te qëndrueshme te patrupëzuara	Aktive te qendr te patr	230	23,275,659	0
2	Ndërtesa	Ndërtesa	212	162,041,249	120,983,324
3	Mjete transporti	Mjete transporti	215	16,829,991	0
4	Shuma	Faxe	218	57,500	20,241
5	Shuma	Fotokopje	218	2,936,731	1,757,390
6	Shuma	Kompjuter	218	13,043,311	4,057,631
7	Shuma	UPSA	214	747,070	324,331
8	Shuma	Telefon	214	7,401,160	2697949
9	Shuma	Te tjera paisje	214	593,901	89,706
10	Shuma	Skaner	218	444,449	337,488
11	Shuma	Paisje informatike	214	14,878,620	5,668,463
12	Shuma	Orendi zyre	218	15,108,387	7,962,882
13	Shuma	Pajise audovizuale	214	631,233	193,923
14	Shuma	pajise qe sig energji	214	1,403,866	855,066
15	Shuma	printer	218	2,096,323	1,194,677
16	Shuma	Te tjera pajisje	218	37,450,162	21,810,975
17	Shuma	Te tjera paisje	218	269,302,755	198,560,352
18		***Totali i aktiveve***		***568,242,365***	***366,514,396***

Burimi: MSHMS
Përpunoi: Grupi auditimit

Pra, nga sa më sipër konstatohet se vlera e aktiveve të MSHMS, e regjistruar në Regjistrin e Aktiveve 2019 **nuk** rakordon me vlerën e inventarëve që rezultoi nga procesi i inventarizimit fizik të vitit 2019. Sipas Regjistrit të Aktiveve, vlera e aktiveve për vitin 2019 është ***568,242,365* lekë**, ndërsa vlera e aktiveve sipas procesit të inventarizimit është **184,598,532 lekë**, prej të cilave *102,357,379 lekë* aktive të MSH dhe *82,241,154 lekë* aktive të ish-MS.Nga informacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, në përmbledhëse bashkëlidhur relacionit janë paraqitur vetëm llogarit 218 dhe 214. Në vijim të kësaj, nëse do të analizonim vetëm llogarit 218 dhe 214, nga tabela e mësipërme konstatohet se totali i llogarisë 218 (vlera e pa amortizuar) është ***340,439,618 lekë*** ndërsa, totali i llogarisë 214 është **25,655,850*lekë***, pra në total, llogaritë 218 dhe 214 janë në vlerën ***366,095,468 lekë.*** Ndërsa referuar përmbledhëses, bashkëlidhur relacionit, vlera e inventarizuar e llogarisë 218 dhe 214 paraqitet në vlerën ***96,791,355 lekë***.

Referuar e-mailit[25] të përcjellë nga subjekti:

[25] E-maili zyrtari datës 11.04.2021, drejtuar grupi të auditimit.

ñ*Në përmbledhësen e aktiveve sipas klasifikimit ekonomik të MSHMS për vitin 2019 janë paraqitur llogaria 230; 212; 215; 214; 218 që i përkasin vetëm aktiveve të trashëguara nga ish-Ministria e Shëndetësisë plus shtesat dhe pakësimet e kryera gjate vitit 2018, 2019.*
Në lidhje me llogaritë 214; 218 (të Regjistrit të Aktiveve) nga numri rendor 4 deri në nr.16 shuma e tyre është e barabartë me 96 792 711 lekë. Këto aktive janë në përdorim nga punonjësit e Aparatit MSHMS dhe përbëjnë inventarin e zyrave të trashëguara nga MSH plus shtesat e pakësimet gjatë vitit 2018,2019. Përmbledhësja e Inventarëve që përmban aktive nga këto dy llogari të vitit 2019 dhe që i përkasin Aparatit të ish-Ministrisë së Shëndetësisë është 96,791,335 leke, me një diferencë me gjendjen në regjistër prej 1,376 leke (diference për tu sistemuar gjatë vitit 2020).
*Kurse përmbledhësja e inventarëve për aktivet e ish-MMSR viti 2019 është në shumën 43,823,511 lekë, por që nuk është përfshirë në Regjistrin e Aktiveve për vitin 2019. Hartimi i një regjistri aktivesh të përbashkët të dy ish ministrive MSH e MMSR do të bëhet mbas hartimit te pasqyrave Financiare të ish-MMSR për vitin 2017. Shuma e llogarisë 218 "Të tjera pajisje " përbëhet nga sisteme (E-receta, nënshkrimi elektronik, EHR) në përdorim nga AKSHI por që akoma janë në pronësi të MSHMS.*ò

Pra konstatohet se, në regjistrin e Aktiveve në llogarinë 218 "Të tjera pajisje ", rezultojnë të regjistrua edhe ***269,302,755 lekë*** sisteme elektronike, të cilat **nuk** janë pjesë e përmbledhëses bashkëlidhur relacionit. Lidhur me këto sisteme, në relacionin e përgatitur në përfundim të inventarizimit, grupi është shprehur **vetëm** për një pjesë të tyre ñEvidentohet se, në zbatim të kontratës nr.4285, datë 02.12.2015 nëpërmjet MMSR dhe AKSHI disa pajisje e sisteme në vlerë prej ***75,435,274 lekë*** janë marrë nga MMRS dhe ndodhen tek AKSHIò.

Konstatohet gjithashtu se, në Regjistrin e aktiveve ***nuk*** është përfshirë vlera **5,566,024 lekë e** inventarizuar gjatë vitit 2019 në kundërshtim me pikën 28 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i cili përcakton se*: "Regjistri i aktiveve të një njësie,* duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare, si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapita*l.*òSubjekti bëri me dije se, vlera 5,566,024 lekë është llogari 312 dhe kjo llogari nuk përfshihet në Regjistrin e Aktiveve të MSHMS, kjo llogari rakordohet me lëvizjet e magazinës.

Ndërsa konstatohen diferenca midis vlerës së pa amortizuar të mjeteve të transportit të regjistruar në Regjistrin e Aktiveve dhe vlerëssë pa amortizuar të mjeteve të transportit sipas inventarizimit. Referuar procesverbaleve të inventarizimit, mjetet e transportit janë në vlerën 45,009,380 lekë (një pjesë e mjeteve të transportit janë të ish-MMRS), ndërsa vlera e tyre në Regjistrin e Aktiveve është 16,829,991 lekë.

Megjithëse ka diferenca midis aktiveve të regjistruara në Regjistrin e Aktiveve të vitit 2019 dhe aktive të cilat rezultojnë fizikisht sipas procesit të inventarizimit të vitit 2019, ato **nuk** janë analizuar në detaje dhe nuk janë evidentuar shkaqet e këtyre diferencave në raportin e përgatitur nga grupi i inventarizimit.

Regjistri i aktive të vitit 2019, nuk paraqet vlerën e drejtë të aktiveve të MSHMS, pasi në të **nuk** janë reflektuar aktivet e ish-MMRS, të cilat referuar inventarizimit të kryer për vitin 2019, vlera e këtyre aktiveve vetëm për llogaritë 214 dhe 218 është në vlerën **43,823,511.5 lekë**. Nëse do të përfshinim dhe aktivet e klasave të tjera, kjo vlerë do të rezultonte **82,241,154.** Kjo është shkaktuar, pasi ende **nuk** ishin hartuar pasqyrave Financiare të ish-MMSR për vitin 2017.

Referuar përgjigjes nëpërmjet e-mailit të DBMF në MSHMS, në Regjistrin e Aktiveve në zërin ñ*Të tjera pajisje*ò, në vlerë ***269,302,755 lekë***, rezultojnë sisteme (E-receta, nënshkrimi elektronik,

EHR) në përdorim nga AKSHI, **por** që akoma janë në pronësi të MSHMS. VKM nr. 673 datë 02.12.2017, i ndryshuar, përcakton si kufij kohor datën 30.09.2018 për kalimin nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t ñ*Institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave duhet të dorëzojnë pranë AKSHI-t 1 (një) kopje të dokumentacionit të plotë të çdo sistemi dhe infrastrukture TIK ekzistuese dhe kodin e burimit. Sistemet dhe infrastruktura TIK ekzistuese kalojnë nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse brenda datës 30 shtator 2018*ò. Paraqitja e këtyre sistemeve, në Regjistrin e Aktiveve të vitit 2019, **nuk** paraqet në mënyrë të saktë dhe të drejtë pasurinë e MSHMS.

- *Nxjerrja jashtë përdorim e aktiveve jo funksionale*

Referuar dokumenteve të dosjes, komisioni i vlerësimit në çdo procesverbal të mbajtur për gjendjen e inventarëve ka paraqitur edhe aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi. Në total, referuar procesverbaleve komisioni i vlerësimit ka vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimi**, 7,288,457** lekë aktive. Përveç tyre, sikurse e trajtuam edhe më lartë, rezulton se komisioni i vlerësimit për vitin 2019, ka firmosur procesverbalin që komisioni i inventarizimit i vitit 2018 ka propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi të aktiveve, për 324 artikuj me një vlerë **31,732,191** lekë. Komisioni është shprehur në relacioni e përgatitur se, ñ*gjatë inventarizimit është konstatuar se ka shumë asete në përdorim jo nga personeli që nuk janë në gjendje të mirë ose nuk funksionojnë fare, nj një konstatim të tillë e ka bërë edhe komisioni i inventarizimit për vitin 2018, për 324 artikuj me një vlerë 31,732,191 lekë."* Pra, në total komisioni i inventarizimit i vitit 2019 është shprehur për nxjerrje jashtë përdorim të **39,020,648** lekë aktive.

Në përfundim, komisioni është shprehur se në zbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, të ndryshuar, duhet të ngrihet komision vlerësimi dhe nxjerrje jashtë përdorimi të këtyre aseteve.

Grupi i auditimit të KLSH, i cili ka zhvilluar auditimin financiar dhe të përputhshmërisë në MSHMS përgjatë 03.06.2019 deri më 10.08.2019, për periudhën në auditim 01.01.2018 deri në 31.07.2019, për shkak të problematikave të konstatuara ka rekomanduar ñ*Në kushtet e mungesës së një regjistri të plotë të aktiveve, MSHMS të mos procedojë me etapat e tjera të vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve*ò. Në vijim të këtij rekomandimi, në kushtet kur ende Regjistri i Aktiveve të institucionit nuk është i plotë, pasi ende në të **nuk** janë reflektuar aktivet e ministrisë së bashkuar në 2017, MSHMS nuk ka vijuar me vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve.

Konkluzion për Regjistrin e Aktiveve dhe Inventarizimin 2019:

Nga analizimi i Regjistri i Aktiveve të MSHMS për vitin 2019, rezulton se në **kundërshtim** me pikën 26, 28 dhe 30 Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, ai **nuk** përmbush kërkesat minimale që të duhet të plotësoj një regjistër aktivesh, pasi në të **nuk** është reflektuar data e hyrjes apo marrjes në dorëzim, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes apo data e daljes nga pronësia, etj. Nga auditimi u konstatua se, në Regjistrin e Aktiveve **nuk** janë reflektuar ende aktivet e ish-MMRS-së. Përveç tyre, u konstatua edhe aktive të MSHMS-së në vlerën **5,566,024 lekë**, të cilat kanë rezultuar nga inventarizimi por **nuk** janë përfshirë në këtë Regjistër, në kundërshtim më pikën 28 të Udhëzimit të mësipërm.

Duke qenë se, inventarizimi i aseteve të Aparatit të MSHMS është bërë mbi gjendjen fizike të aseteve, pa bërë krahasimin me gjendjen kontabël, pasi në këtë të fundit janë regjistruar vetëm asetet e ish-MSH, **nuk** kanë rezultuar diferenca midis gjendjes fizike dhe asaj kontabël, duke mos siguar një pamje të qartë të diferencave që ekzistojnë midis aktiveve të regjistruara në kontabilitet, me ato fizikisht gjendje në aparatin MSHMS. P.sh. grupi i auditimit konstatoi diferenca midis sistemeve elektronike të regjistruara në Regjistrin e Aktiveve në total (269,302,755 lekë) dhe vlerës për të cilën është shprehur grupi i inventarizimit (75,435,274 lekë). Nga audimi u konstatuan diferenca midis vlerës së pa amortizuar të mjeteve të transportit të regjistruar në Regjistrin e Aktiveve dhe vlerës së pa amortizuar të mjeteve të transportit sipas inventarizimit.

Nga auditimi konstatohet se, në dokumentin përmbledhës bashkëlidhur relacionit përfundimtar, përgatitur nga Komisioni në fund të procesit të inventarizimit për vitin 2019, **nuk** janë reflektuar aktivet me vlerë 43,983,687 lekë, si dhe makinat në përdorim dhe ato jashtë përdorimit, të cilat rezultojnë të inventarizuara referuar procesverbaleve, duke mos përmbushur kështu kërkesat Udhëzimit nr. 30, për përgatitjen e një raporti të plotë mbi aktivet e inventarizuara fizikisht.

Aktivet e inventarizuara fizikisht janë dokumentuar vetëm nëpërmjet procesverbaleve të mbajtura me punonjësit me përgjegjësi materiale. Këto procesverbale, **nuk** kanë datë, **nuk** janë të protokolluar, dhe shpesh herë janë të firmosur vetëm nga Komisioni i Inventarizimit dhe jo nga punonjësi/t me përgjegjësi materiale. Procesverbalet **nuk** kanë numra rendor. Më relacionit përfundimtar të përgatitur nga Komisioni i Inventarizimit nuk janë përcaktuar saktësisht, sa procesverbale janë përgatitur, sa ishte numri totali i aktiveve të inventarizuara fizikisht, apo vlera totale e tyre, si dhe përmbledhësja nuk përkon me vlerën totale të aktiveve të inventarizuara sipas procesverbaleve. Dosja e inventarizimit **nuk** ishte e inventarizuar dhe disa procesverbale mungonin në të dhe u vunë në dispozicion pas kërkesës së grupit të auditimit.

Situata e mësipërme, **nuk** ofron siguri mbi vlerën totale të aktiveve gjendje në aparatin e MSHMS, duke mos i shërbyer këtu qëllimit për të cilin është kryer procesi i inventarizimit fizik.

1. Titulli i Gjetjes:	***Raportim jo i saktë dhe i plotë i vlerës dhe llojit të detyrimeve të prapambetur dhe atyre të shlyera***
Situata 1.1:	- *Raportim jo i saktë i vlerës së detyrimeve të prapambetur dhe llojit të detyrimeve te prapambetura:* Në vitin 2019 nga MSHMS janë njohur detyrime të prapambetura në vlerën **49,700,000 lekë** me burim krijimi ñvendime gjyqësore për largime te padrejta nga punaò. Nga verifikimi i grupit të auditimit rezulton se, faktikisht vlera e detyrimeve te prapambetura në fund të vitin 2019 ishte të paktën **69,063,781lekë**[26], ose *19,363,781 lekë* (39%) më shumë se detyrimi i raportuar në MFE për këtë vit. Gjithashtu rezultoi se, detyrimi i prapambetur në vlerën 69,063,781 lekë ishte **jo** vetëm për vendime gjyqësore për largime të padrejta nga puna, **por** edhe për vendime të tjera gjyqësore, më hollësisht: - 34,712,371 lekë, detyrime për largime të padrejta nga puna; - 24,471,250 lekë detyrim i lindur nga 1 çështje gjyqësorë e Spitalit Gjirokastër; dhe - 9,880,160 lekë detyrim i lindur nga vendime gjyqësore për mospagim në kohë të faturave ndaj kreditorëve nga ish-MMRS. Për vitin 2020, në raportimin për Thesarin, si dhe në Pasqyrat Financiare të MSHMS, janë njohur detyrime të prapambetura vetëm për largime të padrejta nga puna në vlerën **27,150,000 lekë.** Nga auditimi rezultoi se, në fakt detyrimi i prapambetur për këtë vit ishte të paktën **33,878,384 lekë**[27], ose *6,728,384 lekë* (20%) më shumë detyrime se ato të njohura në Pasqyrat Financiare të MSHMS dhe të raportuara në MFE. Nga auditimi u konstatua se, databaza e mbajtur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Mirëmenaxhimit Financiar në zbatim të pikës 4 të Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014, vënë në dispozicion grupi të auditimit**, nuk**përmban shumën e plotë të detyrimeve për largimet nga puna, pasi në të nuk janë reflektuar detyrimet e parashikuara nga vendimet e formës së prerë të viteve 2011 dhe 2013 për **dy** gjyfitues, znj. S.L, dhe z. N.Z. Në këto kushte, grupi i auditimit nuk ka mundur të përllogarisë detyrimin e prapambetur për këta 2 tatimpagues. - *Raportim jo i saktë vlerës së detyrimeve (të prapambetura) të shlyera, dhe llojit të detyrimeve të shlyera:* Për vitin 2020, pagesat e kryera për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të cilat rrjedhin nga vendimet gjyqësore, nuk janë kryer **vetëm** për vendime gjyqësore për largime nga puna sikurse është raportuar në MFE, por edhe për vendim të tjera gjyqësore. MSHMS ka raportuar në MFE detyrime të prapambetura të shlyera në vlerë **9,224,000 lekë,** më burim krijimi vendime gjyqësore për largime të padrejta nga puna. Nga auditimi rezultoi se, detyrimet realisht të shlyera janë në vlerën **42,486,262 lekë**, ose 33,262,262 lekë (360%) më shumë se ato të raportuara si të shlyera në MFE dhe **jo** vetëm për vendime gjyqësore për largime të padrejta nga puna, **por** edhe për vendime të

[26] Themi se ñdetyrimi ishte të **paktën** 69,063,781 lekëò pasi në këtë vlerë nuk janë përfshirë detyrimet e rrjedha nga vendimet e formës së prere të viteve 2011, 2013 për dy gjyqfitues të larguar padrejtësisht nga puna znj. S. L, dhe z. N.Z, të cilat nuk ishin reflektuar në data bazën e detyrimeve të DBMF, dhe grupi i auditimit nuk mundi të përllogariste detyrimet e tyre.

[27] Themi se ñdetyrimi ishte të **paktën** 33,878,384 lekëò pasi në këtë vlerë nuk janë përfshirë detyrimet e rrjedha nga vendimet e formës së prere të viteve 2011, 2013 për dy gjyqfitues të larguar padrejtësisht nga puna znj. S. L, dhe z. N.Z, të cilat nuk ishin reflektuar në data bazën e detyrimeve të DBMF, dhe grupi i auditimit nuk mundi të përllogariste detyrimet e tyre.

	tjera gjyqësore, si p.sh. vendim gjyqësor i Spitalit Gjirokastër, apo vendime gjyqësore për fatura të papaguara nga ish-MMRS
1.2 Titulli i Gjetjes:	***Mangësi në formatin e raportimit të detyrimeve të prapambetura***
Situata 3.2:	Për vitin 2019**, 2** nga **4 r**aportimet (50% të rasteve) e detyrimeve të prapambetura gjatë këtij viti **nuk**janë bërë sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimi plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 ñPër për zbatimin e buxhetit viti 2019. Në kundërshtim me këtë udhëzim, detyrimet e prapambetura **nuk** janë raportuar në MFE, në mënyrë analitike sipas kreditorëve dhe sipas burimit të krijimit të tyre. Nga analizimi i raportimeve tre-mujore për vitin 2020 konstatohet se, detyrimet e prapambetura për largimet e padrejta nga puna për aparatin e MSHMS,**nuk** janë raportuar në formatin e duhur (Udhëzimi nr. 2, datë 20.01.2020 dhe Udhëzimi nr. 37, datë 06.10.2020) në MFE, apo në Thesar, në **asnjë** prej raportimeve të këtij viti. Në kundërshtim me këto udhëzim, detyrimet e prapambetura **nuk** janë raportuar në mënyrë analitike sipas kreditorëve dhe sipas burimit të krijimit të tyre. Kjo situatë **nuk** siguron transparencë mbi detyrimet e prapambetura, burimin e krijimit, si dhe shlyerjen e tyre . Sa më sipër, nuk ka rezultuar në vlerësimin e detyrime të papaguara dhe raportimin e tyre në mënyrë të saktë dhe të plotë, sikurse përcaktohet në VKM nr.50, datë 05.02.2014 ñPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimitò, të ndryshuar.
Kriteri:	Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesaritò, pika 4. VKM nr.50, datë 05.02.2014 ñPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimitò, të ndryshuar. Udhëzimi nr. 1, datë 17.01.2019 ñ*Për zbatimin e buxhetit viti 2019*ò. Udhëzimit plotësues të MFE-së Nr. 2, datë 20.01.2020, ñ*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020".* Urdhrin nr. 37, datë 06.10.2020 të MFE ñ*Për monitorimin dhe publikimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të qeverisjes së përgjithshme".*
Ndikimi/Efekti:	Mos identifikimi i të gjithë detyrimeve të papaguara për çështjet gjyqësore për largime nga puna në databazën e detyrimeve të prapambetura të DMF në MSHSM dhe mos respektimi i formatit të përcaktuar për raportimin e tyre sipas udhëzimeve të MFE-së, nuk ka siguruar një raportim të plotë dhe të saktë të tyre në MFE dhe Thesar, cka përmban riskun e **mos** paraqitjes së plotë dhe të saktë të tyre në pasqyrat financiare të MSHMS-së. Ky risk është materializuar në vitin 2020, pasi në pasqyrat financiare të MSHMS detyrimet e prapambetura janë paraqitur më të ulëta se detyrimet që institucioni kishte realisht. Sa më sipër përmban gjithashtu edhe riskun e krijimit të penaliteteve, të cilat përbëjnë dëm për buxhetin e shtetit.
Shkaku:	Mos identifikimi dhe mosnjohja në mënyrë të plotë dhe të saktë e detyrimeve të prapambetura dhe shlyerjes së tyre nga MSHMS. Mos respektimi i formateve të përcaktuara për raportimin e detyrimeve të prapambetura.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim 1.1:	MSHMS të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar raportimin në MFE, Thesar dhe në vijim në pasqyrat financare të MSHMS, të detyrimeve të prapambetura dhe shlyerjen e tyre, në mënyrë të plotë, të saktë, të vërtetë dhe sipas formateve të diktuara nga Udhëzimet e MFE-së, me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, të cilat mund të shkaktojnë efekte negative në buxhetin e shtetit
Rekomandimi 1.2	DBMF në MSHMS të ndërmarrë masat e nevojshme për paraqitjen e plotë dhe të saktë të gjyqfituesve të larguar në mënyrë të padrejta nga puna, si dhe detyrimet ndaj tyre në bazën e të dhënave që kjo drejtori administron për këtë qëllim
Afati I zbatimit:	***Menjëherë dhe në vijimësi***

2. Titulli i Gjetjes:	***Thyerje e radhës së pagesave dhe mungesë transparence mbi planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.***
Situata:	Nga auditimi u konstatua thyerje e radhës së pagesave në 30% të rasteve në vitin 2019 dhe 26% të rasteve në vitin 2020, si dhe mungesë transparence mbi planifikimin e shlyerjeve të detyrimeve të prapambetura. Më hollësisht: Për vitin 2019, është thyer rregulli i pagesave në të paktën 6 nga 20 raste (30%) , pasi

	nuk janë shlyer të parat ato detyrime që kanë lindur të parat. Për vitin 2020, është thyer rregulli i pagesave në të paktën 5 nga 19 (26%) të raste sipas të cilit, duhet të shlyhen të parat ato detyrime të cilat lindin të parat. Për të dy vitet, konstatohen dy gjyqfituesit me vendime të formës së prerë të viteve 2011 dhe 2013 (znj. L dhe z. Z), të cilët nuk kanë marrë pagesa gjatë viteve 2019-2020, ndërsa gjatë kësaj periudhe janë shlyer detyrime të rrjedha nga vendime të formës së prerë të viteve 2018-2019. Kontatohet gjithashtu se, në kundërshtim me pikën 5 të Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesaritò, MSHMS nuk ka publikuar në faqen ëeb të institucionit grafikun e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura. Mospublikimi i grafikut të pagesave, nuk ofron transparencë mbi radhën e pagesave të planifikuara për tô shlyer
Kriteri:	Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 ñ*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesaritò.* Udhëzimi nr. 5/1 datë 21.05.2014 për ò*Shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò.*
Ndikimi/Efekti:	Mos respektimi i rregullit të shlyerjes së pagesave sipas të cilit shlyhen të parat ato detyrime që lindin të parat, ka shkaktuar që detyrime të cilat janë më të vona në kohë, të jenë shlyer përpara detyrimeve më të hershme, duke rritur riskun për për dëme ekonomike të rrjedhura nga mosrespektimi i radhës së pagesave. Mospublikimi i grafikut të pagesave, nuk ofron transparencë mbi radhën e pagesave të planifikuara për tô shlyer.
Shkaku:	Thyerja e rregullit të pagesave dhe mospublikimi i grafikut të shlyerjes.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nëpunësi Autorizes dhe Nëpunësi Zbatues në MSHMS, të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të planifikuar dhe shlyer detyrimet e prapambetura duke respektuar parimin FIFO (detyrimet që lindin të parat shlyhen të parat), si dhe të publikojë në faqen ëeb të institucionit grafikun e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, me qëllim shmangien e penaliteteve që përbëjnë dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.
Afati I zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

3. Titulli i Gjetjes:	***Shkelje e disiplinës buxhetore në regjistrimin e shpenzimeve dhe në regjistrimin e kontratave në SIFQ***
Situata:	Nga auditimi është konstatuar shkelje e disiplinës buxhetore për kryerjen e shpenzimeve mbi 30 ditë vonesë (në 16.2% të rasteve në vitin 2019 dhe 23% të rasteve në vitin 2020) dhe në regjistrimin e kontratave në SIFQ mbi 5 ditë vonesë (97% e rasteve në vitin 2020). Më hollësisht: Nga analiza e databazës së SIFQ, për Aparatin e MSHMS-së, **për vitin 2019**, konstatohet se nga 1365 pagesa të kryera gjatë këtij viti 2019 deri në 31.12 2020, 221 prej tyre në vlerë119,842,858 lekë, pra 16.2% e rasteve, janë regjistruar për tu kryer me Urdhër-shpenzim nga MSHMS me mbi 30 ditë nga data e lëshimit të faturës nga furnitori, *në kundërshtim* me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar. Nga analizimi i data bazës së SIFQ, për Aparatin e MSHMS-së, **për vitin 2020**, konstatohet se nga 1510 pagesa të kryera deri në 31.12 2020**,** 347 prej tyre në vlerë 874,836,015 lekë, pra 23% e rasteve, janë regjistruar për tu kryer me Urdhër-shpenzim nga MSHMS me mbi 30 ditë nga data e lëshimit të faturës nga furnitori, *në kundërshtim* me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar. Kryerja e pagesave në tejkalim të afateve përmban riskun që kreditorët mund të kërkojnë kamatëvonesa dhe shpenzimet e kryera për rimarrjen e kredisë, duke shkaktuar dëm ekonomik për institucionin. Gjithashtu u konstatua se është shkelur disiplina buxhetore në **62** nga **64** raste (97%) në kundërshtim me pikën 17, të Udhëzimit nr. 9.1, datë 20.03.2018, pasi kontratat e lidhura nga MSHMS në vitin 2020, janë regjistruar në SIFQ me mbi **5** ditë vonesë. Moszbatimi i afatit për regjistrimin e kontratave në SIFQ përmban riskun e penalieteve, të cilat do të shkaktonin dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e*

	*Shqipërisë*ò i ndryshuar, neni 52 Udhëzimit nr. 9.1, datë 20.03.2018 ñ*Për procedurat e zbatimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes së përgjithshme që përdorin SIFQ*", pika 17.
Ndikimi/Efekti:	Kryerja e pagesave në tejkalim të afateve përmban riskun që kreditorët të kërkojnë kamatëvonesa dhe shlyerje të shpenzimeve të kryera për rimarrjen e kredisë, duke shkaktuar dëm ekonomik. Moszbatimi i afatit për regjistrimin e kontratave në SIFQ përmban riskun e penalieteve të cilat do të shkaktonin dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.
Shkaku:	Regjistrimi në SIFQ i urdhrave për kryerjen e shpenzimeve më vonë se afati i parashikuar ligjor. Regjistrimi në SIFQ i kontratave të nënshkruara, më vonë se afati i parashikuar ligjor.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	- Për të gjitha rastet në vijim, Nëpunësi Zbatues në MSHMS të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar përgatitjen e urdhër-shpenzimeve dhe depozitimin e tyre pranë thesarit, brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të faturës së furnitorit, me qëllim shmangien e penaliteteve të mundshme si pasojë e vonesave, me efekte negative në buxhetin e shtetit.; - Nëpunësi Zbatues në MSHMS të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar regjistrimin e kontratave brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i tyre, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore në funksion të menaxhimit të detyrimeve të prapambetura.
Afati I zbatimit:	Në vijimësi

4. Titulli i Gjetjes:	***Mangësi në protokollimin e kërkesave dhe dokumentacionit mbështetës lidhur me fatkeqësinë e tërmetit te nëntorit 2019***
Situata:	Nga analizimi i Urdhër-shpenzimeve u konstatua se, në zbatim të VKM 753, datë 30.11.2019 ñ*Për përkrahjen sociale dhe financiare të familjeve të viktimave të tërmetit të datës 26.11.2019" MSHMS ka* paguar ndihmë financiare prej 1,000,000 lekësh/për familje, për familjet e 48 viktimave të tërmetit të nëntorit 2019, <u>në total 30,000,000 për 30 familje</u>. Referuar VKM-së së mësipërme, mbështetja financiarë është dhënë në bazë të familjeve të viktimave<u>, pra 1,000,000 lekë për secilën familje që ka pasur viktima, dhe jo për secilën viktimë të familjes</u>. Nga auditimi rezultoi se, VKM nr. 753, datë 30.11.2019 e cila parashikon mbështetjen financiare të familjarëve të viktimave të tërmetit të nëntorit 2019, <u>nuk ka bashkëlidhur listën e familjeve përfituese, dhe për këtë grupi i auditimit nuk mund të japë siguri të arsyeshme nëse familjet e mbështetura financiarisht janë në fakt të ato familje, të cilat kanë humbur të afërmit e tyre nga tërmeti</u>. Shpenzimet e varrimit janë paguar vetëm për 8 familje nga 30 familje në total 3,540,467 lekë. (30 familjet janë identifikuar nga pagesat e ndihmës financiare 1,000,000 lekë), të cilat kanë humbur familjarët e tyre nga tërmeti nëntorit 2019. Nga auditimi rezultoi se, në asnjë rast, kërkesat dhe dokumentet e përcjella nga familjarët e viktimave të tërmetit për përfitimin e ndihmës financiare nuk janë depozituar në protokollin e institucionit, por janë përcjellë dorazi pranë DBMF në MSHMS duke mos siguruar kështu gjurmë mbi kërkesat, dokumentet e dorëzuara dhe kohën e dorëzimit të tyr, në kundërshtim kjo dhe me Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 ñPër Arkivatò, ñNormave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë (neni 8 dhe 9) dhe Ligjin nr.90/2012 "Për Organizimin Dhe Funksionimin E Administratës Shtetërore".
Kriteri:	Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 ñPër Arkivatò, ñNormave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisëò, neni 8 dhe 9. Ligjin nr.90/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore".
Ndikimi/Efekti:	Mos protokolli i kërkesave të paraqitura në MSHMS, por kalimi i tyre dorazi në drejtoritë përkatëse, nuk siguron gjurmë mbi kërkesat e ardhura në institucion, dokumentacionin e dorëzuar, kohën e dorëzimit, etj. duke mos ofruar siguri mbi trajtimin e tyre në përputhje me kuadrin ligjorë dhe rregullator.
Shkaku:	Mos zbatimi i Ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 ñPër Arkivatò, ñNormave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Për te gjitha rastet në vijim, me qëllim respektimin e rregullave të parashikuara për

	ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, dhe shmangien e riskut të tjetërsimit të pasurisë natyrore/ humbjen e tyre, etj., nga MSHMS të merren masat që çdo kërkesë e publikut të kalojë nëpërmjet protokollit të institucionit dhe të ketë të gjithë elementët e nevojshëm sipas normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor
Afati I zbatimit:	Në vijimësi

5. Titulli i Gjetjes:	***Pasaktësi të konstatuara në regjistrimin e urdhër shpenzimeve në SIFQ***
Situata:	Nga auditimi janë konstatuar pasaktësi në regjistrimin e Urdhër-shpenzimeve në SIFQ. Pika 1 e udhëzimit të MFE, nr. 21920, datë 02.12.2019, përcakton ñFaturat e datuara brenda vitit 2019, do të paraqiten pranë degëve të Thesarit deri më datë 15.12.2019.ò Nga kontrolli i urdhër-shpenzimeve u konstatua se, në disa raste datat e urdhër-shpenzimeve fizike dhe kontabilizimit të bankës 2019, **nuk** përkojnë me datat e këtyre urdhër-shpenzimeve në SIQF (kolona: data e urdhër-shpenzimit). Nëse do tõ referoheshim ditarit të bankës 2019, MSHM nuk ka kryer shpenzime gjatë periudhës 17-30 dhjetor të vitit 2019. Ndërsa, nëse do tõ referoheshim data bazës së marrë nga Thesari, ky institucion ka kryer **53** shpenzime (referuar datës së urdhër-shpenzimit në SIFQ) gjatë periudhës 17-30 dhjetor 2019 në vlerën 133,570,674 lekë. Grupi i auditimit kontrolloi këto urdhër-shpenzime, nga ku rezultoi se datat në to janë sipas ditarëve të MSHMS-së, dhe jo sipas SIFQ, duke ngritur dyshime mbi saktësinë e dokumentacionit që i është vënë në dispozicion grupit të auditimit. Fakti se, sipas urdhër-shpenzimeve fizike MSHMS ka kryer veprime me bankën deri në 16 dhjetor 2019, ndërsa sipas sistemit SIFQ ky institucion ka 53 veprime pas kësaj date deri në 30 dhjetor 2019, **nuk** ofron siguri mbi periudhën kur këto shpenzime janë kryer realisht dhe nëse janë në përputhje me Udhëzimin nr. 21920, datë 02.12.2019 të MFE-së.
Kriteri:	VKM 352, datë 11.05.2016 ñPër krijimin e bazës së të dhënave të sistemit informatikë financiar të qeverisë, SIFQò, pika 8/C. Udhëzimit i MFE, nr. 21920, datë 02.12.2019 ñMbi prioritetin e pagesave në kushtet e gjendjes së shpallur të fatkeqësisë natyroreò.
Ndikimi/Efekti:	Fakti se, sipas urdhër-shpenzimeve fizike MSHMS ka kryer veprime me bankën deri në 16 dhjetor 2019, ndërsa sipas sistemit SIFQ ky institucion ka **53** veprime pas kësaj date deri në 30 dhjetor 2019, nuk ofron siguri mbi periudhën kur këto shpenzime janë kryer realisht dhe nëse janë në përputhje me Udhëzimin nr. 21920, datë 02.12.2019 të MFE-së.
Shkaku:	Diferenca që ekziston midis kontabilizimit të bankës 2019 në MSHMS, dhe urdhër shpenzimeve të regjistruara në SIFQ.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Për te gjitha rastet në vijim, Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues në MSHMS të ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar koherencë midis urdhër-shpenzimeve fizike të regjistruara në kontabilitetin e bankës të institucionit dhe atyre të regjistruara në SIFQ, me qëllim ofrimin e sigurisë së arsyeshme, lidhur me shpenzimet e kryera.
Afati I zbatimit:	Në vijimësi

6. Titulli i Gjetjes:	***Mangësi në Regjistrin e Aktiveve dhe procesin e inventarizimit të vitit 2019***
Situata:	*Regjistri i aktiveve dhe diferencat me invetarizimin fizik:* - Nga analizimi i Regjistri i Aktiveve të MSHMS për vitin 2019, rezulton se në kundërshtim me pikën 26, 28 dhe 30 Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, ai nuk përmban një informacion të plotë mbi aktivet e institucionit, pasi në të nuk është reflektuar data e hyrjes apo marrjes në dorëzim, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes apo data e daljes nga pronësia, etj. - Inventarizimi i aseteve të Aparatit të MSHMS është bërë mbi gjendjen fizike të aseteve, **pa** bërë krahasimin me gjendjen kontabël, duke **mos** identifikuar dhe analizuar diferenca midis gjendjes fizike dhe asaj kontabël. Nga auditimi u konstatuan diferenca në aktive në vlerën **227,612,894 lekë,** më hollësisht: 1. Nga auditimi u konstatua se, në Regjistrin e Aktiveve **nuk** janë reflektuar ende

	aktivet e ish-MMRS-së. Përveç tyre, u konstatua edhe aktive të MSHMS-së në vlerën **5,566,024 lekë**, të cilat kanë rezultuar nga inventarizimi dhe që nuk janë përfshirë në këtë Regjistër, në kundërshtim më pikën 28 të Udhëzimit të mësipërm. 2. Nga auditimi u konstatuan gjithashtu diferenca midis kostos historike të mjeteve të transportit të regjistruar në Regjistrin e Aktiveve (16,829,991 lekë) dhe kostos historike të mjeteve të transportit sipas inventarizimit (45,009,380 lekë). Pra, rezultojnë **28,179,389 lekë** më shumëmjete transportit fizikisht (kosto historike), se kosto historike e regjistruar në kontabilitet. 3. U konstatuan diferenca midis sistemeve elektronike të regjistruara në Regjistrin e Aktiveve në 269,302,755 lekë dhe vlerës për të cilën është shprehur grupi i inventarizimit (75,435,274 lekë). Pra, rezultojnë **193,867,481** lekë më shumë sistemet elektronike të regjistruara në kontabilitet, se vlera sipas kontrollit fizik. *Procesi i invetarizimit fizik:* - Inventarizimi i aseteve të Aparatit të MSHMS është bërë mbi gjendjen fizike të aseteve, **pa** bërë krahasimin me gjendjen kontabël, sikurse parashikon Udhëzimi 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar. Në këto kushte **nuk** janë identifikuar diferenca midis gjendjes fizike dhe asaj kontabël. (diferencat midis gjendjes fizike dhe asaj kontabël, të evidentuara nga grupi i auditimit janë trajtuar më lartë) - Në dokumentin përmbledhës bashkëlidhur relacionit përfundimtar, përgatitur nga Komisioni në fund të procesit të inventarizimit për vitin 2019, **nuk** janë reflektuar aktivet me vlerë 43,983,687 lekë, si dhe makinat në përdorim dhe ato jashtë përdorimit, të cilat rezultojnë të inventarizuara referuar procesverbaleve, duke **mos** përmbushur kështu kërkesat e Udhëzimit nr. 30, për përgatitjen e një raporti të plotë mbi aktivet e inventarizuara fizikisht. Në relacionit përfundimtar të përgatitur nga Komisioni i Inventarizimit nuk janë përcaktuar saktësisht, sa procesverbale janë përgatitur, sa ishte numri totali i aktiveve të inventarizuara fizikisht, apo vlera totale e tyre, si dhe përmbledhësja nuk përkon me vlerën totale të aktiveve të inventarizuara sipas procesverbaleve. - Aktivet e inventarizuara fizikisht janë dokumentuar vetëm nëpërmjet procesverbaleve të mbajtura me punonjësit me përgjegjësi materiale,. Këto procesverbale, nuk kanë datë, nuk janë të protokolluar, dhe shpesh herë janë të firmosur vetëm nga Komisioni i Inventarizimit dhe jo nga punonjësi/t me përgjegjësi materiale në kundërshtim me sa përcakton Udhëzimi nr. 30. Procesverbalet nuk kanë numra rendor. - Dosja e inventarizimit nuk ishte e inventarizuar dhe disa procesverbale mungonin në të dhe u vunë në dispozicion pas kërkesës së grupit të auditimit. Kjo situatë përmban riskun që aktivet e institucionit të humbasin, keqpërdoren, etj. P.sh. mungesa e raportit të plotë të inventarizimit, apo mungesa e numrave rendor të procesverbaleve të inventarizimit, etj. nuk siguron ruajtjen efektive të mjeteve të transportit (procesverbali i të cilave nuk ishte në dosje, por u vu në dispozicion pas kërkesë së grupit të auditimit), në kushtet kur në regjistrin e aktiveve ato nuk janë të detajuara dhe janë paraqitur me vlerën kontabël 0.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*ò, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Situata e mësipërme, **nuk** ofron siguri mbi vlerën totale të aktiveve gjendje në aparatin e MSHMS, duke mos i shërbyer këtu qëllimit për të cilin është kryer procesi i inventarizimit fizik.
Shkaku:	Mos respektimi i kërkesave të Udhëzimit 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, në hartimin e regjistrit të aktiveve dhe në realizimin e procesit të inventarizimit për vitin 2019
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime 1.1:	Titullari i MSHMS të marrë masa për të ngritur një grup të veçantë punë për të identifikuar, analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për diferencat e konstatuara në aktive midis gjendjes fizike dhe asaj kontabël, me qëllim shmangien e risqeve të humbjes apo tjetërsimit të tyre dhe për të siguruar paraqitjen e drejtë të pasurisë së institucionit në Regjistrin e aktiveve dhe pasqyrat financiare të MSHMS
Afati I zbatimit:	***Brenda datës 31.12.2020***
Rekomandime 1.2:	Në të gjitha rastet në vijim, Nëpunësi Zbatues i MSHMS-së të marri masat e

	nevojshme për tõ vënë në dispozicion grupeve të inventarizimit listën e aktiveve për tu inventarizuar bazuar në të dhënat kontabël, me qëllim që në përfundim të procesit të inventarizimit të identifikohen, analizohen dhe adresohen diferencave midis gjendjes kontabël dhe asaj fizike të aktiveve të institucionit.
Afati I zbatimit:	***Në vijimësi, në çdo proces inventarizimi***
Rekomandime 1.3:	MSHMS të ndërmarrë masat e nevojshme, që në përfundim të çdo procesi inventarizimi të aktiveve të institucionit të hartohet një raport i plotë, si dhe procesverbalet e mbajtura gjatë procesit të jenë me numra rendor, dhe të firmosur nga të gjithë personat me përgjegjësi materiale, për të siguruar që ky procesi i inventarizimit tõ shërbejë qëllimit për të cilin kryhet.
Afati I zbatimit:	***Në vijimësi, në çdo proces inventarizimi***
Rekomandime 1.3:	DBMF në MSHMS të ndërmarrë masat e nevojshme që në Regjistrin e Aktiveve të paraqiten në mënyrë të plotë dhe të saktë aktivet afatgjata, aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare, në pronësi dhe në përdorim të MSHMS, mbështetur në rezultatet e procesit të inventarizimit, me qëllim ruajtjen e tyre dhe paraqitjen e drejtë të pasurisë së këtij institucionit.
Afati I zbatimit:	***Me përfundimin e procesit të inventarizimit 2021 dhe në vijimësi***

7. Titulli i Gjetjes:	***Shpenzime pa efektivitet në buxhetin e shtetit në vlerë 1,058,000 lekë nga likuidimi i shpenzimeve nga MSHMS***
Situata:	Nga auditimi i likuidimit te shpenzimeve nga MSHMS u konstatuan problematika në urdhër shpenzimet, dhe dokumentacionet justifikuese bashkëlidhur tyre, në bazë të të cilave janë kryer pagesat, duke shkaktuar kështu përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerë 1,058,000 lekë prej të cilave 206,000 lekë në vitin 2019 dhe 852,000 lekë në vitin 2020. Me hollësisht: -Nga auditimi u konstatua se në urdhër shpenzimi nr. 684, 03.09.2019, me vlerë 206,000 lekë për likuidimin e pagesave për dieta për një inspektim të kryer nga punonjësit e MSHMS,nuk ka bashkëlidhur dokumentet justifikuese për kryerjen e tij (miratimin dhe urdhrin e ngritjes së grupit të punës për këta punonjës). Bashkëlidhur gjendet relacioni i përgatitur në përfundim të inspektimit. -U konstatua urdhër shpenzimi nr.1082 datë 28.12.2020, është realizuar pagesa në vlerën prej 852,000 lekë me TVSh, për OE. Referuar kontratës bazë nr. 491/5 datë 12.02.2020, afati për dorëzimin e pasqyrave ishte 15.03.2020. Referuar procesverbalit të marrjes në dorëzim, pasqyrat financiare janë marrë në dorëzim në tetor 2020. Nga auditimi u konstatua se, bashkëlidhur me këtë Urdhër-shpenzim nuk gjendeshe Urdhri për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të Pasqyrave Financiare, si dhe nuk gjendeshe shtyrja e afatit të kontratës.
Kriteri:	VKM 997, datë 10.12.2010 ñ*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit*ò, pika 2. Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 të MFE ñ*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*ò i ndryshuar, pika 35 dhe 36.
Ndikimi/Efekti:	Kryerja e shpenzimeve në mungesë të dokumentacionit justifikues, nuk ka siguruar përdorimin me eficiencë të fondeve.
Shkaku:	Moszbatimi i kuadrit ligjor
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues në MSHMS, të marrin masat e nevojshme që në cdo rast në vijim, për likuidimin e urdhër shpenzimeve të mbështeten në dokumentacionin e nevojshëm vërtetues, si dhe këto të fundit tõ bashkëlidhen në çdo rast urdhër shpenzimeve, me qellim shmangien e efekteve financiare për buxhetin e shtetit.
Afati I zbatimit:	Në vijimësi

8. Titulli i Gjetjes:	***Shpenzime pa efektivitet në buxhetin e shtetit në vlerë 74,521,023 lekë për likuidim e vendimeve gjyqësore***
Situata:	Nga auditimi u konstatuan shpenzime pa efektivitet në buxhetin e shtetit në vlerë

	74,521,023 lekë, prej të cilave **23,945,042** në vitin 2019 dhe **50,575,981** në vitin 2020, për likuidimin e vendimeve gjyqësore. -Në vitin 2019 janë paguar gjithsej për vendimet gjyqësore për rikthimin largime të padrejta nga puna të punonjësve nga ish-MMRS në vlerën 23,862,662 lekëpër 15 raste në vitin 2019 dhe në vlerën 43,363,561 lekë për 16 raste për vitin 2020, detyrime të ardhura nga ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë përbën shpenzime pa efektivitet për buxhetin e shtetit. Nga auditimi i urdhër-shpenzimeve u konstatuan pagesa për vendime gjyqësore të formës së prerë, jo vetëm për largime të padrejta nga puna po edhe për çështje gjyqësore me kompani sigurimesh dhe për vonesa në shlyerjen e furnitorëve nga ish-MMRSnë vlerën 7,294,800 lekë, prej të cilave 82,380 lekë në vitin 2019 dhe 7,212,420 lekë në vitin 2020. Më hollësisht: -Urdhër shpenzimi nr. 986, datë 11.12.2019, me vlerë 97,380 lekë. Bashkëlidhur gjendet vendimi i gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 4020, datë 08.05.2017, e cila ka marr formë të prerë më datë 24.05.2017, sipas të cilës pranohet padia e Shoqërisë ñA-Sò, sh.a., ndaj ish-MMRS, me objekt ñPërmbushja e detyrimeve në vlerën 75,980 lekë që rrjedhë nga kontrata e sigurimit që konsiston në pagimin e primeve të papaguara, si rezultat i lëshimit të kontratave të sigurimit TP, kamatvonesat sipas penaliteti të sigurimi të kontratës dhe shpenzimet gjyqësore. Vlera 97,380 lekë përfshinë detyrimin e papaguar që rrjedh nga kontrata 78,980 lekë, 3,400 lekë shpenzime gjyqësore dhe 15,000 lekë tarifë ekzekutimi e përmbaruesit. -U konstatua Urdhër-Shpenzimi nr. 450, datë 25.06.2020 për vlerën 9,880,160 lekë, si shpenzimit për vendimet gjyqësore. Ky është një detyrim i ish- MMSR, për mospagim të një fature të lëshuar nga shoqëria ñDPò, në vitin 2015, për një shërbim të kryer ndaj kësaj ministrie. Bashkëlidhur me këtë Urdhër Shpenzim, gjendet kërkesa për ekzekutim nga përmbaruesi, e datës 05.04.2018, i cili kërkon, shlyerjen e vlerës totale 9,880,160 lekë, prej të cilave 7,212,420 lekë detyrim qe rrjedh nga titulli ekzekutiv, 1,883,281 lekë kamatëvonesave, 5000 lekë gjoba, 15,000 lekë shpenzime për ekspertin fiskal, dhe 764,459 lekë tarifë përmbarimore.
Kriteri:	VKM nr.50, datë 05.02.2014 ñ*Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit"* Udhëzimi nr. 5/1 datë 21.05.2014 për òShlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò. Ligjit nr. 48/2014 ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò.
Ndikimi/Efekti:	Largimi i padrejtë nga puna i punonjësve nga ish-MMRS, ka shkaktuar një shpenzim jo efektiv në buxhetin e shtetit 67,226,223. Vendimet gjyqësore të formës së prerë, për detyrime ndaj kreditorëve të tjerë të ish-MMRS kanë shkaktuar një shpenzim jo efektiv në buxhetin e shtetit në vlerën 7,294,800 lekë.
Shkaku:	Largime të padrejta nga puna dhe mos përmbushje e detyrimeve ndaj kreditorëve nga ish-MMRS.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	MSHMS të ndërmarrë masat e nevojshme për krijimin e Komisionit të Posacëm, me vëzhgues një përfaqësues nga DAP, me qëllim shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit të formës së prerë (duke konsideruar këtu edhe ristrukturimin e nëntorit 2017), si dhe shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të gjyqfituesve në një pozicion të rregullt në shërbimin civil (sipas rastit) sipas kritereve të pozicionit të punës, dhe kategorisë përkatëse brenda institucionit apo njësive të varësisë, duke ndjekur të gjithë hapat e nevojshëm që parashikon Urdhri nr. 5151, datë 28.10.2015 ñPër zbatimin e vendimeve gjyqësore te formës së prerë, nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civilò, me qëllim shmangien/minimizimin e efekteve negative në buxhetin e shtetit.
Afati I zbatimit:	Menjëherë

9. Titulli i Gjetjes:	***Dëm ekonomik ne vlerën 3,695,819 lekë për likuidim e tarifave përmbarimore për vendime gjyqësore të formës së prerë.***
Situata:	Nga auditimi u konstatua dëm ekonomik ne vlerën **3,695,819 lekë** për likuidim e tarifave përmbarimore për vendime gjyqësore të formës së prerë të ish-MMRS prej

	të cilave, **1,028,079 lekë** të paguara në vitin 2019, dhe **2,667,740 lekë** të paguara në vitin 2020. Më hollësisht: Në vitin 2019, në 3 raste nga 15, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për largime të padrejta nga puna, të kryer nëpërmjet firmave përmbarimore, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën *1,013,079 lekë* për likuidimin e tarifave përmbarimore, dhe një rast për cështje gjyqësore me shoqëri sigurimesh në vlerën *15,000 lekë*: – Vendimi gjyqësorë për gjyqfituesin i cili ka marr formë të prerë në 05.02.2015, A. Xh, tarifa përmbarimore në vlerën 413,804 lekë; – Vendimi gjyqësorë për gjyqfituesin M. C. tarifa, i cili ka marr formë të prerë në 03.03.2016, përmbarimore në vlerën 534,325 lekë; – Vendimi gjyqësorë për gjyqfituesin A. Xh. tarifa, i cili ka marr formë të prerë 24.05.201, tarifa përmbarimore në vlerën 64,950 lekë; – Vendimi i gjykatës i cila ka marr formë të prerë më datë 24.05.2017 me gjyqfitues shoqërinë ñA-Sò, tarifa përmbarimore në vlerën 15,000 lekë, shlyer me urdhër shpenzimin nr. 986, datë 11.12.2019. Në vitin 2020, vendim gjyqësor i shoqëruar me gjoba, kamatvonesa dhe tarifa përmbarimore në vlerën *2,667,740 lekë*: – Vendimi i gjykatës me gjyqfitues shoqëria ñD Pò për një detyrim të vitit 2015 të ish MMRS-në, është shoqëruar me 1,883,281 lekë kamatëvonesave, 5000 lekë gjoba, 15,000 lekë shpenzime për ekspertin fiskal, dhe 764,459 lekë tarifë përmbarimore, shlyer me urdhër shpenzimin nr. 450, datë 25.06.2020.
Kriteri:	VKM nr.50, datë 05.02.2014 ñPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimitò Udhezimi nr 5/1 datë 21.05.2014 për ò*Shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*ò. Ligjit nr. 48/2014 ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò.
Ndikimi/Efekti:	Mos shlyerja në kohë e detyrimeve financiare të rrjedha nga vendimet gjyqësore të formës së prerë nga ish-MMRS, ka shkaktuar 3,695,819 lekë dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.
Shkaku:	Mos shlyerja në kohë e detyrimeve financiare të rrjedha nga vendimet gjyqësore të formës së prerë nga ish MMRS, në vijim nga MSHMS, ka shkaktuar 3,695,819 lekë dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Pasi të jenë ezauruar të gjitha hapat ligjore, për mundësinë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë (referuar kërkesave të Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 ñPër zbatimin e vendimeve gjyqësore te formës së prerë, nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civilò), strukturat përkatëse në MSHMS, për të gjitha rastet në vijim, të marrin masat e nevojshme për të shlyer në kohë detyrimeve financiare që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prere, me qëllim shmangen e gjobave, kamatvonesave dhe tarifave përmbarimore të cilat përbëjnë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.
Afati I zbatimit:	Në vijimësi

III.5. AUDITIMI I LLOGARIVE VJETORE TË ADMINISTRATËS SË INSTITUCIONIT

Pasqyrat Financiare të Aparatit te MSHMS të **Vitit 2019** janë vazhdim i atyre të vitit 2018 vetëm për MSH pasi ish-MMSR për vitin 2017, nuk ka bërë nga ana e saj pasqyrimin e aktivitetit financiar deri ne daljen e VKM nr.508 dt.13.09.2017 (të ardhura & shpenzime, aktivet & pasivet, flukseve monetare, ndryshimet në aktive neto/fondet neto, investimeve dhe burimet e tyre, organika me nr e punonjësve dhe fondi i pagave, pyetësorin dhe shënimet shpjeguese). ***Pra ish-MMSR nuk ka hartuar Pasqyrat Financiare për vitin 2017***. Kjo situate është konstatuar edhe nga Grupi i mëparshëm i Audititmit KLSH për të cilën janë lënë rekomandime si dhe statusi aktual vazhdon të jetë i njëjti. Kjo ka sjellë si pasojë jo vetëm *mos kontabilizim të detajuar të*

AAGJM, por edhe vështirësi në konfirmimin e ekzistencës së tyre fizike; mos *njohje dhe mos kontabilizim të debitorë–kreditorëve të ish-MMSR*; *likujdime të detyrimeve të pallogaritura paraprakisht si dhe shpenzime të paplanifikuara (të pajustifikuara) në PBA*. Pra vazhdon të jemi në të n jëjtat kushte ku nuk është zbatuar VKM nr.508 dt.13.09.2017 "Për përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale"; VKM nr.717, datë 01.12.2017 ñPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Socialeònë pikën 2 citohet: ñ*Të gjitha aktivet e qëndrueshme dhe aktivet qarkulluese, që janë në inventarin e personelit të ish Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë që bëhet pjesë e strukturës aktuale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i kalojnë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*ò.

a. Auditimi i Bilancit Kontabël dhe Plotësimi i Pasqyrave Financiare përkatëse:
Për hartimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2019 për Aparatin e Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale, janë respektuar rregullat dhe kriteret e përcaktuara në:
- VKM nr.248 dt.10.04.1998 "Për miratimin e Planit Kontabël Publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qëndrore, lokale dhe njësive që varen prej tyre" I ndryshuar
- Në Udhëzimin e MFE nr.28 dt.24.12.2014 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014" .
- Udhëzimit nr.8 dt.09.03.2018 të MFE "Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme"- Bilanci i vitit 2019 (me të gjitha pasqyrat financiare përkatëse) është hartuar dhe depozituar më datë 19.02.2020 brenda afatit ligjor, i miratuar edhe nga Dega e Thesarit Tiranë me nr.prot.1662 datë 30.03.2020. Pasqyrat Financiare të Bilancit janë sigluar nga Nënpunësi i Parë Zbatues i Autorizuar (Drejtori i Sektorit të Financës) dhe nga hartuesi i tyre Shef i Sektorit të Financës, bazuar në Nenin 42 të Ligjit 9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisëò. Pasqyrat e llogaridhënies vjetore kanë të plotësuara pasqyrat si vijon: Pasqyra e Pozicionit Financiar(Formati 1), Pasqyra e Performancës Financiare (Formati 2), Pasqyra e Flukseve Monetare(Formati 3), Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivet Neto/Fondet Neto (Formati 4), Pasqyra Investimet dhe Burimet e Financimit (Formati 6), Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Formati 7/a dhe 7/b), Pasqyra Numri i Punonjësve dhe Fondi i Pagave (Format 8) si dhe pasqyrat dhe anekset përkatëse mbi shpenzimet e të ardhurat e ushtrimit, investimet sipas Pyetësori dhe Shënime Shpjeguese (Formati 5). Veprimet janë mbartur nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Përgatitja e të dhënave për Pasqyrat Financiare të vitit 2019 është bërë duke kryer paraprakisht rregjistrimin në mënyrë kronologjike sipas natyrës të të gjitha veprimeve financiare të realizuara nga Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale gjatë vitit, rakordimi i llogarive analitike me ato sintetike si dhe përmbledhja në centralizator.

b. Llogaritë e të Ardhurave dhe Shpenzimeve
- Në Pasqyrën e Performanca Financiare Grupimi A – Format 2 janë të pasqyruara të Ardhurat e Institucionit të realizuara në vitin 2019. Ato janë të ndara në 7 Kategori (sipas zërave përkatës), ku paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Në lekë

Nr. rresh	Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	VITI USHTRIMOR 2019	VITI I MEPARSHEM 2018
1	A	TE ARDHURAT	1,503,875,264	1,345,947,609
2	*70*	*I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET*	0	0
3	700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	0	0

4	7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
5	7001	Tatim mbi Fitimin		
6	7002	Tatim mbi Biznesin e vogel		
7	*7009*	*Te tjera Tatime mbi te ardhurat*		
8	**702**	**2.Tatimi mbi Pasurine**	**0**	**0**
9	7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme		
10	7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshe		
11	7029	Te tjera tatime mbi Pasurine		
12	**703**	**3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit**	**0**	**0**
13	7030	Tatim mbi vleren e shtuar(TVSH)		
14	7031	Akciza		
15	7032	Takse mbi sherbimet specifike		
16	7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie		
17	7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie		
18	**704**	**4.Takse mbi tregtine dhe transaksionet nderkombtare**	**0**	**0**
19	7040	Takse doganore per mallrat e importit		
20	7041	Takse doganore per mallrat e eksportit		
21	7042	Tarife sherbimi doganor e kaliposte		
22	7049	Te tjera taksa mbi tregtine e transaksionet nderkombtare		
23	**705**	**5.Takse e rruges**		
24	**708**	**6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare**		
25	**709**	**7.Gjoba e Kamat vonesa**		
26	***75***	***II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE***	**0**	**0**
27	750	NGA TE PUNESUARIT		
28	751	NGA PUNEDHENESI		
29	752	NGA TE VETPUNESUARIT		
30	753	NGA FERMERET		
31	754	NGA SIGURIMET VULLNETARE		
32	755	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHOQERORE		
33	756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHENDETESORE		
34	***71***	***III.TE ARDHURA JO TATIMORE***	**2,739,815**	**24,951,362**
35	**710**	**1.Nga ndermarrjet dhe pronesia**	**0**	**0**
36	7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare		
37	7101	Nga Ndermarrjet publike financiare		
38	7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia		
39	**711**	**2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare**	**0**	**0**
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore		
41	7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh		
42	7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		
43	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve		
44	7114	Te ardhura nga biletat		
45	7115	Gjoba, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime		
46	7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
47	**719**	**3.Te tjera te ardhura jo tatimore**	**316,477**	
48	***76***	***IV.TE ARDHURA FINANCIARE***	**0**	**0**
49	760	Nga interesat e huadhenies se brendshme		
50	761	Nga interesat e huadhenies se Huaj		
51	765	Nga interesat e depozitave		

52	766	Nga kembimet valutore		
53	*72*	***V.GRANTE KORENTE***	**1,501,135,449**	**1,320,996,247**
54	**720**	**1.Grant korent I Brendshem**	**1,501,135,449**	**1,320,996,247**
55	7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	1,484,446,618	1,307,761,567
56	7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)		
57	7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH		
58	7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		
59	7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale		
60	7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
61	7206	Financim I pritshem nga buxheti	16,688,831	13,234,680
62	7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)		
63	7209	Te tjera grante korente te brendshme		
64	**721**	**2.Grant korent I Huaj**	**0**	**0**
65		Nga Qeveri te Huaja		
66		Nga Organizata Nderkombetare		
67		***VI.TE ARDHURA TE TJERA***	0	0
68	781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi		
69	782	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatshkurtra		
70	783	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatgjata		
71	784	Rimarrje Shumash per shpenzime te viteve ardhshme		
72	787	Terheqje nga seksioni I investimeve		
73	*73*	***VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE***		

Burimi: MSHMS

Duke iu referuar tabelës vërejmë se **Llog.71** që përfaqëson të ardhurat e MSHMS në vlerën 2,739,815 lekë, në krahasim me vitin 2018 janë ulur me 22,211,547 lekë (viti 2018) i përket vetëm MSH). Këto janë siguruar nga **Kat.lll -"Të Ardhura Jo Tatimore"** në vlerën 2,739,815 lekë (nga verifikimi i Akt Rakordimit të të Ardhurave në Thesar 2019 u konstatua vlera 2,423,338.40 lekë me një diferencë prej 316,477 lekë trashëguar nga vitit 2018) ose 2 % të të ardhurave që përkon me **Llog.686** të Pasivit ; si dhe **Kat.V- "Grante Korente**" në vlerën 1,501,135,449 lekë ose 98 % të të ardhurave.

Llog.72 "Grante Korente" ka një vlerë prej 1,501,135,449 lekësh me një shtesë prej 1,801,392,252 leke më të madhe nga viti i kaluar, kjo për faktin se në vitin 2018 është institucion i ristrukturuar nga bashkimi i dy ministrive (MSh & MMSR).

-Duke iu referuar kësaj Pasqyre , **Grupimit B SHPENZIMET** , të ndara sipas zërave :

Llog.600 "*Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli*" në vlerën 136,814,336 lekë ose 9 % të totalit të shpenzimeve;

Llog.601 "*Kontribute për sig. Shoqërore e shëndetësore*" në vlerën 22,224,440 lekë ose 1.5 % të totalit të shpenzimeve;

Llog.602 "*Blerje Mallra dhe shërbime të tjera*" në vlerën 134,193,154 lekë ose 8.9% të totalit të shpenzimeve; Ka diferenca të konsiderueshme në vlera tek disa prej llogarive si:

Llog.6027- ñShpenzime detyrime për kompesime legaleò ka një rritje prej **37,210,741** lekë si rezultat i pagesave të punonjësve të larguar nga puna fituar me vendim gjyqi;

Log.6024ï ñShpenzime Udhëtimiò rritje prej 1,840,391 lekë si pasojë e zgjerimit të Fushës së përgjegjësive të MSHMS,

Llog.6029 ñShpenzime të tjera operative një rritje në vlerën 1,589,524 lekë etj. ndërsa **Llog.6021** ñMateriale dhe sherbime specialeñ,

Llog.6023 ñShërbime transportiñ **&**

Llog.6025 ñShërbime për mirëmbajtje të zakonshmeò kanë vlera shumë më të vogla se viti 2018.

Kateg. V- TRANSFERIME KORENTE në vlerën 1,207,903,519 lekë ose 80.3 % të totalit të

shpenzimeve, ku pjesën më të madhe e zë
Llog.606 -ñ*Transferta për buxhete familjare eindividët*ò në vlerën 1,199,826,204 lekë ose 98.7 % të tij dhe
Llog.605 -"*Transferime korenteme jashtë*" në vlerën 8,077,315 lekë ose 1.3%;
Llog.63 **"***Ndryshimi i gjendjeve të inventarit***"** në vlerën 513,341 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve.(vihet re një dif e madhe nga viti i kaluar pasi vlera e Llog.63 në vitin paraardhës është vetëm e MSH, ndërsa për 2018 kjo vlerë pasqyron atë të institucionit të ri pas ristrukturimit: me blerje, transferime kapitale jashtë sistemit dhe nxjerrje jashtë përdorimit). **Llog.686 "Shuma të Parashikuara për Aktivet Financiare**ò nuk përputhet në vlerë (22,739,815) me **Llog.711** e Kat.III TË ARDHURA JO TATIMORE.

Në lekë

Nr. rresh	Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	VITI USHTRIMOR 2019	VITI I MEPARSHEM 2018
74	**B**	**SHPENZIMET**	**1,504,072,128**	**1,324,951,438**
75	**600**	**I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE**	**136,814,336**	**133,255,278**
76	6001	Paga, personel I perhershem	136,814,336	133,255,278
77	6002	Paga personel I Perkohshem		
78	6003	Shperblime		
79	6009	Shpenzime te tjera per personelin		
80	**601**	**II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE**	**22,224,440**	**20,907,824**
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	22,224,440	20,907,824
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore		
83	**602**	**III.BLERJE MALLRA E SHERBIME**	**134,193,154**	**152,096,498**
84	602	Mallra dhe sherbime te tjera	134,139,154	
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	12,590,589	7,222,289
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale	1,580,840	7,009,253
87	6022	Sherbime nga te trete	20,117,325	21,457,417
88	6023	Shpenzime transporti	1,606,445	4,397,776
89	6024	Shpenzime udhetimi	12,320,546	10,480,155
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	25,663,730	81,788,877
91	6026	Shpenzime per qeramarrje	70,000	0
92	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	55,419,698	18,208,957
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	0	
94	6029	Shpenzime te tjera operative	4,823,981	1,531,774
95	**603**	**IV.SUBVECIONE**	**0**	**0**
96	6030	Subvecione per diference cmimi		
97	6031	Subvecione per te nxitur punesimin		
98	6032	Subvecione per te mbuluar humbjet		
99	6033	Subvecione per sipermarrjet individuale		
100	6039	Subvecione te tjera		
101		**V.TRANSFERIME KORENTE**	**1,207,903,519**	**1,016,207,933**
102	**604**	**1.Transferime korente te brendshme**	**0**	**0**
103	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	0	
104	6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
105	6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetsore		
106	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		

107	**605**	**2.Transferime korente me jashte**	**8,077,315**	**13,148,597**
108	6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare	8,077,315	13,148,597
109	6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
110	6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurese te huaja		
111	6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
112	**606**	**3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe**	**1,199,826,204**	**1,003,059,336**
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	1,199,826,204	1,003,059,336
115		**VI.SHPENZIME FINANCIARE**	**0**	**0**
116	**65**	**1.Shpenzime Financiare te brendshme**	**0**	**0**
117	650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte		
118	651	Interesa per huamarrje te tj. Brendshme		
119	652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise		
120	656	Shpenz.nga kembimet valutore		
121	**66**	**2.Shpenzime Financiare te jashtme**	**0**	**0**
122	660	Interesa per huamarrje nga Qeveri.te Huaja		
123	661	Interesa per financime nga Institucionet.nderkomb		
124	662	Interesa per huamarrje te tjera jashtme		
125		**VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA**	**2,423,338**	**24,951,362**
126	681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit		
127	682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashte perdorimit e te shitura		
128	683	Shuma te parashikuara te shfrytezimit		
129	686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare	2,423,338	24,951,362
130	**63**	**VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT**	513,341	2,483,905
131		**IX.SHPENZIME TE TJERA**		
132	**85**	**TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES**	**-196,864**	**20,996,171**
		(Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)		

Burimi: MSHMS

Nga auditimi rezultoi se formatet e miratuara nga Ministria e Financave janë zbatuar.

Ndryshimi i gjendjes së inventarit në Grupimin B është i barabartë me diferencën e Klasës 3 në Aktiv të Bilancit.

Nga grupi i auditimit u bë rakordimi i shpenzimeve të Pasqyrës së Performancës Financiare me thesarin ku konstatohet se:

- Vlerat e paraqitura në pasqyrën financiare me vlerat e paraqitura në Akt rakordimin me Degën e Thesarit Tiranë ñ*Mallra dhe shërbime te tjera*ò, sipas Planit limit 139,442,000 lekë, bilancit në vlerën 134,193,154 lekë, ndërsa Akt rakordimit me Degën e Thesarit vlera është 131,171,977 lekë, ku diferenca prej 78.354.760 lekë janë detyrime të periudhës, por që ky detyrim do të paguhet në periudhën e ardhshme ushtrimore.

-ñ*Paga, shpërblime e të tjera personeli*ò sipas bilancit paraqiten në vlerën 133,255,278 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 137,238,829 lekë, ku diferenca prej 3,454,650 lekë vjen si rezultat diferencës së pagës dhjetor 2019 me atë të dhjetor 2018.

Në thesar në muajin janar të vitit 2020 kanë kaluar pagat e dhjetor 2019, ndërsa në pasqyrë vlera e Paga, përfitime të punonjësve është totali për periudhën Janar-Dhjetor 2019, ku vlera e pagave Dhjetor 2019 kalon në thesar në janar të 2020. I njëjti fenomen ndodh dhe me Llog. 601 ò*Kontrib.të sig.shoq.e shëndetsò*. Duke analizuar pasqyrën e situacioneve konstatuam se pagesat e faturave të papaguara të vitit 2018 dhe likujduar në 2019 janë pasqyruar të ndara sipas artikujve (602, 231) përkatës, si më poshtë:

Pasqyra krahasuese si më poshtë:

Në lekë

Nr. Llog	Shpenzimet e ushtrimit	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	**I. Shpenzime Korrente**	**1,501,135,449**	**1,497,680,779**	**3,454,650**
600	Paga përfitime të punonjësve	136,814,336	136,557,660	256,676
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	22,224,440	22,047,644	176,796
602	Mallra dhe shërbime te tjera	134,193,154	131,171,977	3,021,177
605	Transferta korente me jashtë	8,077,315	8,077,315	0
606	Transferta për buxh. familjare e individë	1,199,826,204	1,199,826,203	0

Në Grupimin A të Ardhurat te Pasqyra Format 2 -Llog. 720 në vlerën 1,501,135,449 lekë nga ku financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2019 (*grant*) në shumën 1,484,446,618 lekë dhe financimi i pritshëm nga buxheti i shtetit i në vlerën 16,668,831 lekë.
Të ardhurat tatimore e jo tatimore janë pasqyruar në Formatin 2 në vlerën 2,739,815 lekë dhe sipas

Në lekë

48	**72**	**IV. Grante Korrente (a+b)**	**1,501,135,449**	**1,320,996,247**
49	**720**	**a) Grant I brendshëm**	**1,501,135,449**	**1,320,996,247**
50	7200	Nga buxheti për NJQP (Qendrore)	1,484,446,618	1,307,761,567
51	7206	Financimi I pritshëm nga buxheti	16,688,831	13,234,680
52	**721**	**b) Grante korrent I jashtem**	**0**	0

Në lekë

34	**71**	**III. TE ARDHUTRA JO TATIMORE(a+b+c)**	**2,739,815**	**24,951,362**
35	710	a) Nga ndërmarrjet dhe pronësia	0	0
36	711	b) Shërbime administ. e ardhura sekondare	0	0
37	719	c) Te tjera te ardhura jo tatimore	316,477	

-Në Pasqyrën Formati 2 "Të Ardhurat Jo Tatimore", përfaqësojnë të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve, të ardhura nga licencat për shoqëritë private, korrigjim nga vitet e kaluara etj.

Në lekë

Klasifikimi	Pershkrimi	Shuma e Arkëtuar	Pjesë e institucionit	Rritje e autorizuar	Derdhur ne buxhet	Mbetur për tu trashëguar
711 3099	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve	629,000	0	0	629,000	0
711 1021	Te ardhura nga licensat per shoqeri private	30,000	0	0	30,000	0
711 5499	Te tjera gjoba	140,000	0	0	140,000	0
778 0100	Korigjime nga vitet e kaluara	1,624,338.40	0	0	1,624,338.40	0
	Shuma	**2,423,338.40**	**0**	**0**	**2,423,338.40**	**0**

Vlera e pasqyruar tek Akt Rakordimi i të Ardhurave në Thesar ka një diferencë prej 316,477 lekë me vlerën e pasqyruar në Pasqyrën Format 2, e cila përfaqëson vlerën e trashëguar nga viti 2018 (kjo vlerë i përket Llog.719).

c. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Bilanci kontabël i **vitit 2019** (llogaria vjetore 2019) për MSHMS është përpiluar nga Sektori i Financës dhe miratuar nga Drejtori i Drejtorisë së Financës. Kopje e gjithë pasqyrave financiare

është dërguar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 1662, datë 30.03.2020. Nga Dega e Thesarit Tiranë është bërë edhe vulosja e bilancit dhe formateve të pasqyrave financiare; Relacioni shpjegues ka cilësuar qartë se ***Llogaritë vjetore të vitit 2019 i përkasin vetëm Aparatit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe jo MSHMS, çka nuk është zbatuar VKM nr.508 dt.13.09.2017, me justifikimin e mos shoqërimit të saj me Udhëzime përkatëse për ta zbatuar si nga ana strukturore dhe proceduriale, ashtu edhe ajo financiare (kontabilitetit).*** Këto pasqyra duhet të përfaqësonin pasqyrim të plotë dhe tërësor të aktivitetit ekonomiko-financiar të të gjithë treguesve kontabël për të dy ministritë respektive pas bashkimit në një Njësi të vetme buxhetore. Mos hartimi i pasqyrave financiare të vitit 2017 për ish-MMSR ka sjellë pasoja në mos rregjistrimin dhe mos kontabilizimin e të gjitha Aktiveve të ish-MMSR sipas ligjeve dhe rregullave kontabël të pranuara. ***Nga Grupi i Auditimit u konstatua se pasqyrat financiare të ish-MMSR 2017 nuk janë mbyllur***. Pra për vitin 2017 nuk ka Pasqyra Financiare me tregues kontabël të përbashkët,të institucionit të ri pas ristrukturimit (MSH & MMSR). Këto Pasqyra kanë tregues kontabël që i përkasin vetëm ish-MSH dhe panvarësisht kësaj *Dega e Thesarit Tiranë i njeh, i miraton dhe i vulos këto pasqyra*. Pasqyrimi kontabël i MSHMS për vitin 2019 është i përbërë nga pasqyrat financiare sipas formateve të miratuara nga Ministria e Financave si dhe është respektuar afati i dorëzimit të tij në thesar.
Përmbledhja e llogarive vjetore për vitin 2019 dhe krahasimi me periudhat e mëparshme.

Tabela: Aktivi - Pasqyra e Pozicionit Financiar për vitin 2019

Në lekë

Referenca e Logarive	E M E R T I MI	Ushtrimi i Mbyllur 2019	Ushtrimi Paraardhes 2018
A	**A K T I V E T**	**1,631,646,696**	**1,336,216,384**
	I.Aktivet Afat shkurtra	**160,788,639**	**234,945,094**
	1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre	**27,313,444**	**18,512,266**
531	Mjete monetare ne Arke		
512,56	Mjete monetare ne Banke		
520	Disponibilitete ne Thesar	27,313,444	18,512,266
50	Letra me vlere		
532	Vlera te tjera		
54	Akreditiva dhe paradhenie		
59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
	2.Gjendje Inventari qarkullues	**7,878,552**	**8,391,893**
31	Materiale	5,566,237	6,079,578
32	Inventar I imet	2,312,315	2,312,315
33	Prodhim nre proces		
34	Produkte		
35	Mallra		
36	Kafshe ne rritje e majmeri		
37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
	3.Llogari te Arketushme	**126,346,643**	**208,040,935**
411	Kliente e llogari te ngjashme		
423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	2,985,036	2,652,736
431	Tatim e Taksa		
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Fatkeqësi natyrore qe mbulohen nga shteti		
435	Sigurime Shoqerore		

436	Sigurime Shendetësore		
437,438,	Organizma te tjere shteterore		
44	Institucione te tjera publike		
465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
468	Debitore te ndryshem	26,256,378	26,256,378
4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	97,105,229	179,131,821
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	**0**	**0**
409	Parapagime		
473	Llogari e pritjes te mardhenieve me Thesarin		
477	Diferenca konvertimi aktive		
481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
	II.Aktivet Afat gjata	**1,470,858,058**	**1,101,271,290**
20	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**0**	**0**
201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
202	Studime dhe kerkime	0	
203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
21	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**1,470,858,058**	**1,101,271,290**
210	Toka, Troje, Terrene		
211	Pyje, Plantacione		
212	Ndertesa e Konstruksione	120,983,324	125,257,046
213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	10,845,807	13,557,259
215	Mjete Transporti	0	0
216	Rezerva Shteterore		
217	Kafshe pune e prodhimi		
218	Inventar ekonomik	234,683,891	291,214,297
24	Aktive afatgjata te demtuara		
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata	1,104,345,036	671,242,689
25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**
25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
	4.Investime	**0**	**0**
230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		0
231	Per Aktive Afatgjata materiale		

Grupimi A-AKTIVET, përfaqëson shumën: *Aktivet Afatshkurtra* (Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre, Gjendje Inventari qarkullues, Llogari te Arkëtueshme dhe Të tjera aktive afatshkurtra)me *Aktivet Afatgjata* (Aktive Afatgjata jo materiale, Aktive Afatgjata materiale, Aktive Afatgjata Financiare dhe Investime) .

Nga të dhënat përmbledhëse të *Aktivit për vitin ushtrimor 2019*, rezulton se totali i Aktivit me 31.12.20189 ka vlerën **1,632,396,697 lekë** dhe se në krahasim me vitin 2018 është **296,180,312 lekë** më shumë.

"Aktivet Afatgjata"(AAGJJM, AAGJM dhe AAGJF) në vlerën 1,470,858,058 lekë zënë 90% të vlerës totale të aktivit.

Aktivet Qarkulluese zënë 9.8% të vlerës totale.

Aktivet Afatgjata në krahasim me vitin 2018, janë rritur në vlerën 369,586,767 lekë, ndërsa Aktivet Qarkulluese janë ulur në vlerën 73,406,455 lekë.

Auditimi i Aktiveve Afatgjata:
a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:
- Aktivet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit;
- janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte
- është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme;
- informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe e korrekte.
b. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:
Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet e qëndrueshme;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.
- U verifikua rregullshmëria e procedurës së kalimeve kapitale të AAGJM (godina e MSH, mjeteve të transportit) si dhe e atyre për jashtë përdorimit.

c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e Aktiveve Afatgjata:
1. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:
- Aktivet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Aktivet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostos së tyre të prodhimit.
- Aktivet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes. (UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 ñ*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar)*.

Në mënyrë analitike llogaritë financiare të aktivit të pasqyrës financiare paraqiten si më poshtë vijon:
1.Aktivet Afatgjata
-Llog.212"Ndërtime e konstruksione**",** paraqitet në fund të vitit 2019 në vlerën prej 120,983,324 lekë, ku është shtuar vlera prej 1,989,130 lekë. Nga auditimi i kësaj llogarie dhe patur parasysh faktin e mirëditur nga të dy palët(MSHMS dhe KLSH) që nuk është hartuar Bilanc i vitit 2017 për ish-MMS. Nga Grupi i Auditimit u konstatua se Kontabilizimi i saj nuk ***është bërë sipas procedurave të përcaktuara qartë në Udhëzimin 30 dt.27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" pika 5,6,7 dhe 26_60, por është bërë referuarvlerës së kësaj llogarie në pasqyrënfinanciare të Aktiv-Pasivit të vitit 2015 për ish-MMSR***, që duhej t'i referohej vlerës së pasqyruar në Bilancin e vitit 2016 (bilanci i fundit). U kërkua sqarim për këtë veprim kontabël Institucionit (edhe me e mail) dhe u kthye kjo përgjigje: *Bilanci I vitit 2016 eshte **pa vulën e thesarit***. Iu kërkua sqarim për këtë veprim kontabël dhe nga ana e Institucionit (edhe me e mail) u dha kjo përgjigje: *<në lidhje me verifikimin e bërë nga grupi Auditimin qëndron fakti që si vlerë të godinës ish MMSR është marrë ajo e vitit 2015.*
Pra ish-MMSR NUK KA PASQYRIM TË AKTIVITETIT FINANCIAR PER 2 VITE: Pasqyrat Financiare të vitit 2016 nuk janë miratuar nga Dega e Thesarit; Për vitin 2017 nuk janë

hartuar dhe nuk janë dorëzuar Pasqyra Financiare. (Trajtuar edhe nga grupi i auditimit të mëpërparshëm.
Ky fakt ka sjellë mungesën e dokumentacionit kontabël, dosjeve fizike dhe pamundësi në administrimin e kujdesshëm të aktiveve dhe pasiveve në pasqyrat respektive të institucioneve, dhe për pasojë planifikime të paqarta për shpenzime apo dhe investime mbi to.
-Llog. 214 ñInstalime Teknike makineri, pajisjeò, paraqitet në fund të vitit 2019 në vlerën 10,845,807 lekë e cila nuk ka lëvizje dhe duke e krahasuar me inventarin e vitit 2018 ka një vlerë më të vogël prej 2,711,452 lekë e cila përbën amortizimin e akumuluar.
- Llog.215 ñMjete Transportiò, paraqitet në fund të vitit 2019 në vlerën 0 lekë, Mjete transporti referuar formatit 7/a ka një shtësë në shumën 899,500 lekë si dhe pakësim në shumën 11,561,570 lekë. Diferencë e cila vjen nga një automjet i cili ka kaluar pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave.
Referuar amoritizimit te makinave, nga materiali i marre nga sektori i finances, rezuton se ne total jane te konatibilizuara 8 makina nga ku 2 jane vlerësuar per tu nxjerr jashte perdorimit, por procesi i nxjerrjes se jashtperdorimit nuk është kryer e ku si rezultat mbeten 6 makina në përdorim, me vlere kontabel 0.

Referuar inventarit te kryer nga MSHMS per vitin 2020, me urdhrin Nr.30, nr.367 prot datë 20.01.2020 miratuar nga titullari i institucionit ñ*Ngritjen e komisionit për invetarizimin e pasurisë*ò, komisioni i grupit ka kryer ndër të tjera edhe invetarizimin e mjeteve te transportit te aparatit të MSHMS, ku kanë rezultuar, ***12 makinë në total,*** ku ***9 prej tyre jane në përdorim***, një eshte i llojit motorr dhe ***3 prej tyre janë vleresuar si jashtë përdorimit të cilat ndodhen në ruajtje tek ISHSH***, por nuk ka perfunduar procesi i nxjerrjes së tyre jasht përdorimit.
Pas kryqezimit te vleres kontabel, me vleren e inventarit te kryes nga MSHMS konsatojme se, ne kontabilitet jane të regjistruara vetem 4 prej makinave të cilat marrin dhe shërbim nga kontrata e mirmbajtjes se makinave të sipërpërmendur, por 5 makina te cilat janë në përdorim dhe marrin shqërbim nuk janë të kontabilizuara, si dhe 3 prej tyre të cilat jane vlerësuar për tu nxjerr jasht përdorimit, por nuk ka perfunduar procesi per nxjerjen e tyre.
Permbledhur ne mënyrë tabelare si më posjtë vijon:

Nr.	**Tipi**	**Marka**	**Targa**	**Viti i prodhimit**	**2019**
1	Hyndai	Hyndai Tucson	TR 41 12R	2008	Regjitrsuar ne kontabilitet
2	Wolkswagen	W Jeta	TR 8535 N	2007	Regjitrsuar ne kontabilitet
3	Toyota	Toyota Prius	AA 358 PN	2016	Regjitrsuar ne kontabilitet
4	Wolkswagen	Phaeton	AA434DU	2005	***Pa regjitruar ne kontabilitet***
5	Wolkswagen	Touareg	AA154XJ (Ish TR0151Z)	2007	***Pa regjitruar ne kontabilitet***
6	Wolskwagen	Pasat	AA358VF	2007	***Pa regjitruar ne kontabilitet***
7	Toyota	Raë 4	AA496PK	2016	***Pa regjitruar ne kontabilitet***
8	Toyota	Hilux	TR2108T	1989	Regjitrsuar ne kontabilitet
9	Motor	Loncin	TR174E	2006	***Pa regjitruar ne kontabilitet***

Per 9 makina të cilat jane në përdorim, për vitin 2019 i është kryer sherbim mirembajte referuar Marrëveshjes kuadër nr.4352/13 prot. Datë 01.11.2019 në një vlerë totale prej 1,071,000 lekë. Si rezultat i përdorimit të makinave si dhe sherbimeve te kryera për mirembajtjen e tyre, ***vlera 0 lekë e kontabilizuar për llog.215 nuk është e sakte***.

Titullai i institucionit duhet të marrë masa për të ngritur një grup pune për rivlerësimin e këtyre

makinave dhe pas rivlerësimit të tyre te behet regjistrimi i rregullur ne kontabilitet referuar Udhëzimit nr 30. Datë 27.122011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik" i ndryshuar si dhe udhëzimit nr, 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të NJQP".

- Llog.218 "Inventar ekonomikò, paraqitet në vlerën prej 234,683,891 lekë dhe sipas inventarit 31.12.2019, vlera e kësaj llogarie ka pësuar rritje në këto vlera: 3,255,418 lekë blerje pajisje kompjuterike e printera per MSHMS; 1,598,398 lekë; 1,657,020 lekë blerje paisje e orendi zyre;
si dhe pakësimet gjatë vitit në vlerën prej 1,355,454 lekë (pakësime e përberë nga paisje komjuterike në shumën 471,203 lekë të cilat i kanë kaluar Operatorit të Shërbimit dhe 884,251 lekë orendi zyre të cilat i kanë kaluar 4 instituvioneve vartësie).
- **Llog.28 "Caktime**ñ, paraqitet në AKTIVE në vlerën 1,470,858,056 lekë dhe në krahasim nga viti paraardhës ka një rritje prej 433,102,347 lekë. Kjo llogari përbëhet nga shuma 671,242,689 e cila i përket vitin 2018 si dhe shtesat gjatë vitit 2019 të detajuara si më poshtë vijon:
-supervizimi i rikonstruksionit të 67 qëndrave shëndetësore nga viti 2018 në shumën 826,617 lekë
-supervizimi i rikonstruksioit të qëndrave shëndetësore në disa qytete/njesi për vitin 2019 në shumën 603,498 lekë.
-Rikonstruksion shtëpia e të moshuarve Shkodër faza II në shkumën 19,633,540 lekë
-supervizion per rikonstruksionin e shtepia e të moshuarve shkodër faza II në shumën 626,460 lekë
-rikonstruksion i disa QSH ne vitin 2018 në shumën 14,070,049 lekë
-rikonstruksion i QSH për vitin 2019 në shumën 298,643,581 lekë
-Projekt preventiva zbatimi për godinat spitalore në vlerën 34,272,000 lekë
-TVSH për projektin e Zvicerian në shumën 46,371,770 lekë
-TVSH për rokonstruksionin e QSH nga Gjysme hëna e kuqe ne shumën 1,478,426 lekë
-TVSH për rikonstruksionin e qendres se Grave të Trafikuara ne Linze në shumën 2.000.000 lekë
-Kolaudimi për rikonstruksion i QSH-ve në tirane, durrës në shumën 144,918 lekë
-Rishikim i projektpreventivave (T. shpk) në shumën 6,059,280 lekë
-Projektpreventivi për objekte të shërbimit parësor në vlerën 8,372,108 lekë.

2.Aktivet Afatshkurtra
- Llog.520 "Disponibilitete në Thesar" janë pasqyruar të ardhurat që institucioni trashëgon në shumën prej 27,313,444 lekë, e përbërë nga shuma e pjesës së garnacisë punimesh dhe llogaria 316&478 nga teprica nga projekti UNICEF dhe projekti i informatizimit Sistemi Infomracionit në QSUT.
- Llog.423 "Personeli, paradhënie, deficite gjobaò është në vlerën prej 2,985,036 lekë dhe përfaqëson detyrimet e personelit lënë si rekomandim nga KLSH dhe Auditi i Brendshëm. Kjo llogari përbehet nga detyrimet që kanë 24 persona ish punonjës të aparatit të ish MSH, por në momentin e detyrmit kanë qënë të larguar nga institucioni. Kjo llogari mbart detyrime nga viti 1998.
- Llog.468 "Debitorë të ndryshëm"është në vlerën 26,256,378 lekë dhe përfaqëson detyrimet që i kanë institucionit (21 debitorë), të lëna me rekomandim nga KLSH, Subjekteve që kanë kryer punime në ish-MSH por janë të konstatuara nga auditet e kryera pas mbylljes së mardhenieve kontraktule me këto subjekte. Edhe këto detyrime janë të hershme, por situata për to është: 6 (gjashtë) debitorë janë mjaftuar vetëm me njoftimin e bërë qysh në vitin e krijimit të detyrimit dhe 15 prej tyre janë në proces gjyqësor. Këto janë të detajuara në mënyrë analitike në partitarët e llogarisë. *Kjo llogari përmban vetëm debitorët ndaj ish-MSH.*Nuk janë marrë masa për të ndjekur hapat ligjorë apo të ndërtohen strategji për arkëtimin e tyre, situatë e trashëguar po njësoj që nga vitit 2018.
- Llog. 4342 ñTë tjera operacione me shtetinò, në vlerë prej 97,105,229 lekë ku paga e sigurime të

personelit për tu paguar në Janar të vitit 2019, detyrimet për tu paguar për sigurimet shoqërore e shëndetësore, shpenzime për vendimet gjyqësore, pra janë shpenzime të vitit 2019 që do të paguhen në vitin 2020. Janë burime financimi për detyrimet afatshkurtër gjendje (kryesisht të muajit Dhjetor) që sipas Ligjit të Buxhetit mbulohen nga buxheti i vitit pasardhës; si dhe fatura të papaguara nga Banka por të kaluara nga Thesari ditët e fundit të vitit 2019. Vlera e Llog.4342 është 20,026,592 lekë më e vogël se viti 2018.

*Nga Ministria, së bashku me njësitë e varësisë, në bashkëpunim dhe me Ministrinë e Financave të merren masa për të siguruar arkëtimin e debitorëve të trashëguar me vite dhe të krijuar rishtazi. Për debitorët pa shpresë arkëtimi të riverifikojë dhe evidentojë realisht statusin apo mundësinë për arkëtim të detyrimit në favor të buxhetit të shtetit dhe vetëm pas miratimit nga Ministria e Financave për "**Debitorët pa shpresë arkëtimi**", të bëjë parashkrimin e tyre dhe sistemimin në kontabilitet.*

Grupimi B - PASIVET

Tabela: Pasivi i Pasqyrës Financiare për vitin 2019

B	PASIVET (DETYRIMET)	Viti 2019	Viti 2018
	I.Pasivet Afat shkurtra	**153,343,609**	**229,244,724**
	1. Llogari te Pagushme	**153,343,609**	**229,244,724**
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	3,732,216	1,331,922
42	Detyrime ndaj personelit	9,390,795	8,651,378
16,17,18	Hua Afat shkurtra		
460	Huadhenes		
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	1,006,393	947,681
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
435	Sigurime Shoqerore	1,952,643	1,228,927
436	Sigurime Shendetsore	1,689,084	1,074,772
437,438,	Organizma te tjere shteterore		
44	Institucione te tjera publike		
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	26,996,967	18,195,789
467	Kreditore te ndryshem	79,334,098	165,897,141
4341	Operacione me shtetin(detyrime	29,241,414	31,917,114
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	**0**	**0**
419	Kreditore, Parapagime		
475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
478	Diferenca konvertimi pasive		
480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se ttitullit		
	II.Pasivet Afat Gjata	**0**	**0**
Klase 4	Llogari te pagushme		
16.17,18	Huate Afat gjata		
	Provigjonet afatgjata		
Klasa 4	Te tjera		
C	**AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)**	**1,479,053,087**	**1,106,971,660**
D	**FONDI I KONSOLIDUAR :**	**1,479,053,087**	**1,106,971,660**
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	**374,904,915**	414,732,800
12	Rezultatet e mbartura		

85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	**-196,864**	20,996,171
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta te investimeve		
15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime		
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmne	1,104,345,036	671,242,689
106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim		
109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
	Te Tjera		
E	**TOTALI I PASIVEVE(B+C)**	**1,632,396,696**	**1,336,216,384**

Nga të dhënat përmbledhëse të Pasivit të Pasqyrës Financiare rezulton se totali i pasivit me 31.12.2019, paraqitet me vlerën 1,632,396,696 lekë, ku me C-ñAKTIVET NETO/FONDETò janë në vlerën 1,479,053,087 lekë e njëjtë në vlerë me D- ñFONDI I KONSOLIDUARò dhe zënë respektivisht 90.6% të vlerës totale të pasivit ndërsa B-ñDETYRIMETò janë në vlerën 153,343,610 lekë e njëjtë në vlerë me ñPasivet Afatshkurtraò zënë rreth 9.4 %.

- Llog. 401"Furnitorë e llogari të lidhura me tëò, në vlerën 3,732,216 lekë në Pasqyrën Financiare Format 1 përfaqëson detyrimet ndaj furnitorëve vlerë e cila përbëhet nga detyrime të trashëguara nga viti 2016 prej 1,009,660 lekë dhe 2,982,214 lekë detyrime të krijuara gjatë vitit 2019 si dhe fatura të sjella në fund të vitit 2019.

- **Llog 42"Detyrime ndaj Personelit"** në vlerën 9,390,795 lekë , përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2019; shuma 1,006,393 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2019 të cilat likuidohen në Janar të vitit 2020 me fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2020.

- **Llog.435 & 436"Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore**ñ përfaqëson kontributet e sigurimit shoqëror në shumën 1,952,643 lekë dhe sigurimit shëndetësor në shumën 1,689,084 lekë të muajit Dhjetor 2019,të cilat likuidohen në muajin Janar 2020 me fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2020.

- **Llog.466 "Kreditore për mjete në ruajtje"** është në vlerën 26,996,967 lekë. Kjo llogari mbart në vetvete ngurtësimin 5% si garanci punimesh për Rikonstruksionet e kryera që institucioni e ndal në momentin e likuidimit të situacioneve si dhe clirimit të kësaj garancie mbas periudhës së mbarimit të afatit të sigurimit të punimeve.

Gjendje në Kredi me 31.12.2018 për 5% e ngurtësimit të ngarancisë është në vlerën 18,195,789 lekë.

Kreditimi vitit 2019 përbëhet nga 5% garanci në vlerën 16,616,813 lekë për: Rikonstruksionin e Qendrave Shëndetësore, Spitalit Traumës dhe Shtëpisë së Moshuarve Shkodër etj

Debitimi gjatë vitit 2019 është çlirim garancie për 4 subjekte për, Rikonstruksion I pjesshem I godines se MMSR, Cliri I 5% në vlerën 1,929,838 lekë, Rikons I ambienteve ekzistuese dhe shtese ambjentesh te reja ne SU- Kredi Italiane, Clirimi I 5% në vlerën 2,650,085 (A. C shpk), Rikons I ambienteve ekzistuese dhe shtese ambjentesh te reja ne SU- Kredi Italiane, Clirimi I 5% në vlerën 661,997 (A.C shpk), Clirim Garancie 5% Rikonstruksion I amb.eksistuese dhe shtese ambjentesh te reja-kredi italiane (K) në vlerën 2,573,714 lekë, në një total prej 7,815,635 lekë.

- **Llog.4341 "Te tjera operacione me shtetin (kreditor)**ò në shumën prej 29,241,414 lekë. Analiza financiare e këtyre llogarive është e detajuar më lart tek llogaritë e Aktivit.

	Llog.	**Vlera / leke**
Llogaria 4341 Operacione me shtetin (detyrime)		**29,241,414**
Kundraparti		
Debitorë	423	2,985,036
Debitorë të ndryshëm	468	26,256,378
	Total	**29,241,414**

-**Llog.467 ”Kreditore të ndryshëm** (kreditorë për investime)ñ në shumën prej 79,334,098 lekë janë fatura shpenzimesh të krijuara në fund viti nga dt.21.12.2019 deri në dt.28.12.2019, të cilat janë shpenzime të kaluara me thesar dhe të pakaluara nga banka (apo të kaluara në banke në ciin 2020).Këto janë kryesisht: TVSH projektesh, pagesa të Vendimeve gjyqësore, dieta shërbimesh, pagesa licensash, paga dhjetor, dëmshpërblim i të përndjekurve, etj që nga financa është regjistruar si shpenzim i periudhës së ardhshme për faktin se do të paguhen në vitin 2020.

Rakordimet e Pasqyrave Financiare:
Auditimi u bë me zgjedhje për këto llogari, formate e pasqyra financiare:
- Auditimi për **barazimin e vlerës totale** të Pasivit me Aktivin:
-Totali i aktiveve **A** është i barabartë me totalin e pasiveve **E(B+C)** të bilancit kontabël (*Format1*), në shumën 1,632,396,697 lekë.
Në pasiv të bilancit janë paraqitur me **C** ñ***Aktivet Neto/Fondet***” të institucionit që arrijnë në vlerën **1,479,053,087** lekë, e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së Aktivit të bilancit**A** ï 1,632,396,697 lekë dhe grupeve **B** ñ*Detyrimeve*ò ï 153,343,610 lekë.
- Tek Pasqyra e Performancës Financiare (*Format 2*) Vlera e Grupimit Aò Të Ardhuarat" *është i barabartë me totalin* Vlera e Grupimit B òShpenzimetò dhe vlera e Llog.85 (-196,864 lekë).
- Llog.85 ñRezultati i veprimtarisë së Vitit Ushtrimor*”* në *Formatin 2* është në vlerën -196,864 lekë e njëjtë në vlerë **me Llog.85** ñRezultati i Veprimtarisë Ushtrimoreò në Grupimin D te Pasqyra e Pozicionit Financiar (*Format1).*
- Llog. 63 ñNdryshim i gjendjeve të inventarit*”*, evidentuar në Pasqyrën *Format 2* për 513,341lekë në fund të vitit 2019, rakordon me ndryshimin e gjendjes së magazinës dhe është sa diferenca e klasës 3 ñGjendja e Inventarit Qarkulluesònë aktivin e bilancit. *Pra,* janë të barabarta që të dyja me vlerën prej 513,341 lekë**.**

- Pasqyra e Flukseve Monetare Formati 3.
Nga auditimi rezulton se ñAkordimi i Fondeve Buxhetore për Shpenzime korrenteò,Vlerat në lekë e Arkëtimeve është e njëjtë me vlerat respektive të llogarive në Pasqyrën Format 1 për vitin 2019 në vlerën 1,540,620,000 lekë& realizimi është në vlerën 1,497,680,799 lekë; ñAkordim Fonde Buxhetore për shpenzime Kapitaleò për vitin 2019 është në vlerën 523,804,021 lekë dhe realizimi i tij është 483,808,143 lekë.
òTransferime në Buxhet të Fondeve të pa përdoruraò në vlerën prej 82,935,079 lekë;
Rezulton me Rritje të vlerës monetare në shumën 8,701,178 lekë;
Teprica në fillim të vitit 2019 është e njëjtë në vlerë me atë të mbylljes së vitit 2018 në shumën prej 18,512,266 lekë;
Teprica e Likuiditeteve të vitit 2019 është 27,313,444 lekë e njëjtë në vlerë me Llog.520 ñDisponibilitete në Thesarò te Pasqyra Format 1.
- Pasqyra e Ndryshimeve të Aktiveve Neto Format 4.
Totali i Fondeve sipas Pasqyrës Format 4 është i barabartë me totalin e Fondeve në Pasqyrën Format 1.
- Pasqyra e Investimeve dhe Burimet e Financimit Format 6.
Nga Grupi i Auditimit u bënë verifikimet:Llog.105 e F6 është e barabartë me Llog.105 në F1;
Llog.106 e F6 është e barabartë me Llog.106 në F1;
Llog.111 e F6 është e barabartë me Llog.111 në F1;
Llog.115 e F6 është e barabartë me Llog.115 në F1;
Llog.12 e F6 është e barabartë me Llog.12 në F1;
Llog.16+17 e F6 është e barabartë me Llog.16+17 në F1;
Llog.230 & Llog.231 e F6 janë të barabarta me Llog.230 & Llog.231 në F1;
Llog.25/26 e F6 është e barabartë me Llog.25/26 në F1.

- Pasqyra Pyetësor dhe Shënime Shpjeguese Format 5.
Kjo pasqyrë është plotësuar pjesërisht duke mos e përmbushur qëllimin e saj. Plotësimi i të gjitha posteve të kësaj pasqyre do të sillte një lehtësi në verifikimin e cdo llogarie dhe dhënien e opinionit mbi saktësinë, plotësinë dhe qartësinë e pasqyrave financiare.

Per vitin 2020 "Auditimi i llogarive vjetore"
Pasqyrat Financiare të Aparatit te MSHMS të ***Vitit 2020 janë vazhdim i atyre të vitit 2019 vetëm për Ministrine e Shëndetësisë.***
Me shkresen nr.491/5 datë 12.02.2020 është lidhur kontrata midis Shoqërisë ñS.... Audititimi sh.p.k si dhe MSHMS me objekt:
1.Hartimi i pasqyrave financiare (Bilanci i ish MMSR për periudhën 01.01.2017-30.11.2017 të shoqëruar me relacionet shpjeguese dhe pyetesorin.
2.Akt rakordimi me thesarin për shpenzime dhe të ardhurat për periudhën 01.01.2017-30.11.2017.
3.Kontabilizimet për veprimet e bankes, pagat e sigurime, arkes ne valute, të ardhurat, magazines.
4.Analiza per llogarite aktiveve fikse dhe qarkulluese
5.Inventaret fizik te rakorduara me invetaret kontabel per periudhën 01.01.2017-30.11.2017 për magazinen dhe aktivet (mjete transporti, paisjet dhe sistemet infomatike).
Me procesverbalin mbajtur me datë 19.10.2020 ñMbi dorëzimin e dokumentacionit për bilancin e hartuar të ish MMSRò është dorzuar dokumenatacioni sipas objektit të kontarates të sipërpërmendur, firmosur nga Drejtori i Finances së MSHMS dhe OE e cila është likiduar me urdher shpenzimin nur.1082 datë 28.12.2020, në vlerën 852,000 lekë.
Me shkresën nr.1320 prot datë 09.03.2021 është derguar në thesar bilanci i ish MMSR miratuar nga Sekretari i Përgjithshem dhe i cili është vulosur dhe miratuar nga thesari me nr.1620 prot datë 11.03.2021.
Grupi i auditimit konatatoi se edhe pse per shkak te pandemise, bilanci nuk është mbyllur në afatin e përcaktuar në kontarte, por ne saj te nje marreveshje është dorezuar me datë 19.10.2020, MSHMS e ka derguar për miratim ne thesar e datë 09.03.2021, 5 muaj me vonesë.
Drejtori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar (N.Z), i ka nisur emailin si me poshte Degës së Thesarit, ne lidhje me pasyrat financiare:

From: Saimir Kadiu
Sent: Friday, March 19, 2021 12:32 PM
To: Elmira Feto
Cc: Gelardina Prodani; Joana Duro; Skender Carciu
Subject: Pasqyrat Financiare per Vitin 2017, per ish Ministrine e Mireqenies Sociale dhe Rinise, Grupi 25.

Përshëndetje

Me shkrese nr. 1320 date 09.03.2021 "Dergim i pasqyrave financiare per Vitin 2017", nga Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale jane derguar prane Deges se Thesarit Tirane, **Pasqyrat Financiare per Vitin 2017, per ish Ministrine e Mireqenies Sociale dhe Rinise, Grupi 25**.

Nga ristrukturimi i institucioneve qendrore (Ministrive) ish MMSR eshte shperbere ne tre pjese te cilat jane perthithur nga **Ministria e Financave dhe Ekonomise, nga Ministria e Arsimit,Sportit dhe Rinise dhe nga Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale**, per rrjedhoje edhe te drejtat dhe detyrimet sipas pasqyrave Financiare duhet te perthithen nga tre institucionet.

Per sa me larte ju lutemi konfirmoni pranimin e pasqyrave financiare per ish MMSR per vitin 2017 dhe njeherazi sugjerimin dhe ndihmesen tuaj per perthithjen e te drejtave dhe detyrimeve sipas aktivitetit qe te treja ministrite perfaqesojne.

SAIMIR KADIU MSc.
DREJTOR
Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar

Nga ku pergjigja e Deges së Thesarit është si më poshtë vijon:

From: Elmira Feto
Sent: Tuesday, March 23, 2021 10:47 AM
To: Mimoza Peco <Mimoza.Peco@financa.gov.al>; Roza Naumi <Roza.Naumi@financa.gov.al>; Mirela Bimo <Mirela.Bimo@arsimi.gov.al>; Alketa Brace <Alketa.Brace@financa.gov.al>
Cc: Saimir Kadiu <Saimir.Kadiu@shendetesia.gov.al>; Entela Milo <Entela.Milo@financa.gov.al>; Anita Mestani <Anita.Mestani@financa.gov.al>
Subject: Fw: Pasqyrat Financiare per Vitin 2017, per ish Ministrine e Mireqenies Sociale dhe Rinise, Grupi 25.

Pershendetje !

Per sa me poshte nje konfirmim nese ju keni pasqyruar ne bilancet tuaj te drejtat dhe detyrimet sispa programeve qe kini mare nga Ministria e Punes dhe ceshtje sociale .

Pas konfirmimit tuaj Dega e thesarit do te beje sistemimin e te dhenave per MPCS .

Faleminderit

Pas komunikimit me shefin e sektorit te finanices deri ne fazen e terrenit te auditimit, nga MSHMS ***akoma nuk eshte marre asnje masë në lidhje me ndarjen e te drejtave dhe detyrimeve*** midis subjekteve të cilat janë përthithur pas ristrukturimit si, MFE, MASR dhe MSHMS.

Pra konkludojme së edhe për vitin 2020, edhe pse dejuro bilanci i ish MMSR u mbyll duke u miratuar nga dega e thesarit, ne bilancin e 2020 te MSHMS vazhdon te jete ne te njejtat kushte ku nuk janë reflektuar aktivet si dhe detyrmet e ish-MMRS duke ***sjellë si pasojë jo vetëm mos kontabilizim të detajuar të AAGJM, por edhe vështirësi në konfirmimin e ekzistencës së tyre fizike; mos njohje dhe mos kontabilizim të debitorë–kreditorëve të ish-MMSR; likujdime të detyrimeve të pallogaritura paraprakisht si dhe shpenzime të paplanifikuara (të pajustifikuara) në PBA. Pra jemi ne te njejtat kushte te cilat e kane fillesen që në pasqyrat e viti 2018 të MSHMS ku, pasqyrat financiare nuk pasqyrojne nje gjendje rale te Aktiveve dhe te Drejtat si dhe Detyrimet e MSHMS pas ribashkimit të tyre. Vazhdon te mbetemi ne situaten ku pasqyrat fnanciare te MSHMS edhe per vitin 2020 kane të kontabilizuara vetem Aktivet e ish-Ministrisë së Shëndetësisë si dhe disa prej detyrimeve te ish-MMSR.***

Nga ana e MSHMS duhet të merren në mënyrë urgjente masa, për bashkëpunimin me dy ministritë e tjera ku saktësisht Ministria e Finances dhe Ekonomisë, me Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për ndarjen e të drejtave dhe detyrimeve sipas bilancit të hartuar dhe miratuar nga thesari te ish-MMSR, cka ky bashkepunim do te sjelli pasqyrimin ***real, të plotë, të qartë të aktivitetit ekonomiko-financiar të Ministrisë së Shëndetësisë e Mirëqënies Sociale si një Institucion i vetëm buxhetor.***

a. Auditimi i Bilancit Kontabël dhe Plotësimi i Pasqyrave Financiare përkatëse:
Për hartimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2020 për Aparatin e Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale, janë respektuar rregullat dhe kriteret e përcaktuara në:
- VKM nr.248 dt.10.04.1998 "Për miratimin e Planit Kontabël Publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qëndrore, lokale dhe njësive që varen prej tyre" I ndryshuar
- Udhëzimit nr.8 dt.09.03.2018 të MFE ",Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme"
- Bilanci i vitit 2020 (me të gjitha pasqyrat financiare përkatëse) është hartuar dhe depozituar më datë 29.03.2021 brenda afatit ligjor, i miratuar edhe nga Dega e Thesarit Tiranë me nr.prot.2194 datë 21.03.2021. Pasqyrat Financiare të Bilancit janë sigluar nga Nënpunësi i Parë Zbatues i Autorizuar (Drejtori i Sektorit të Financës) dhe nga hartuesi i tyre Shef i Sektorit të Financës, bazuar në Nenin 42 të Ligjit 9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisëò. Pasqyrat e llogaridhënies vjetore kanë të plotësuara pasqyrat si vijon: Pasqyra e Pozicionit Financiar(Formati 1), Pasqyra e Performancës Financiare (Formati 2), Pasqyra e Flukseve Monetare(Formati 3), Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivet Neto/Fondet Neto (Formati 4), Pasqyra Investimet dhe Burimet e Financimit (Formati 6), Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Formati 7/a dhe 7/b), Pasqyra Numri i Punonjësve dhe Fondi i Pagave (Format 8) si dhe pasqyrat dhe anekset përkatëse mbi shpenzimet e të ardhurat e ushtrimit,

investimet sipas Pyetësori dhe Shënime Shpjeguese (Formati 5). Veprimet janë mbartur nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Përgatitja e të dhënave për Pasqyrat Financiare të vitit 2020 është bërë duke kryer paraprakisht rregjistrimin në mënyrë kronologjike sipas natyrës të të gjitha veprimeve financiare të realizuara nga Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale gjatë vitit, rakordimi i llogarive analitike me ato sintetike si dhe përmbledhja në centralizator.

b. Llogaritë e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

- Në Pasqyrën e Performanca Financiare Grupimi A – Format 2 janë të pasqyruara të Ardhurat e Institucionit të realizuara në vitin 2020**. Ato janë të ndara në 7 Kategori (sipas zërave përkatës), ku paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:**

Në lekë

Nr.	Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	VITI 2020	VITI 2019
1	**A**	**TE ARDHURAT**	**2,480,087,940**	**1,503,875,264**
2	70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	0	0
3	700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	0	0
4	7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
5	7001	Tatim mbi Fitimin		
6	7002	Tatim mbi Biznesin e vogel		
7	7009	Te tjera Tatime mbi te ardhurat		
8	702	2.Tatimi mbi Pasurine	0	0
9	7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme		
10	7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshe		
11	7029	Te tjera tatime mbi Pasurine		
12	703	3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit	0	0
13	7030	Tatim mbi vleren e shtuar(TVSH)		
14	7031	Akciza		
15	7032	Takse mbi sherbimet specifike		
16	7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie		
17	7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie		
18	704	4.Takse mbi tregtine dhe transaksionet nderkombtare	0	0
19	7040	Takse doganore per mallrat e importit		
20	7041	Takse doganore per mallrat e eksportit		
21	7042	Tarife sherbimi doganor e kaliposte		
22	7049	Te tjera taksa mbi tregtine e transaksionet nderkombtare		
23	705	5.Takse e rruges		
24	708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare		
25	709	7.Gjoba e Kamat vonesa		
26	**75**	**II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE**	**0**	**0**
27	750	NGA TE PUNESUARIT		
28	751	NGA PUNEDHENESI		
29	752	NGA TE VETPUNESUARIT		
30	753	NGA FERMERET		
31	754	NGA SIGURIMET VULLNETARE		
32	755	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHOQERORE		
33	756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHENDETESORE		

34	**71**	**III.TE ARDHURA JO TATIMORE**	**172,044,460**	**2,739,815**
35	710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	0	0
36	7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare		
37	7101	Nga Ndermarrjet publike financiare		
38	7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia		
39	711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	0	0
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore		
41	7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh		
42	7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		
43	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve		
44	7114	Te ardhura nga biletat		
45	7115	Gjoba, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime		
46	7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
47	719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore		316,477
48	**76**	**IV.TE ARDHURA FINANCIARE**	**0**	**0**
49	760	Nga interesat e huadhenies se brendshme		
50	761	Nga interesat e huadhenies se Huaj		
51	765	Nga interesat e depozitave		
52	766	Nga kembimet valutore		
53	**72**	**V.GRANTE KORENTE**	**2,308,043,480**	**1,501,135,449**
54	720	1.Grant korent I Brendshem	2,308,043,480	1,501,135,449
55	7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	2,292,176,256	1,484,446,618
56	7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)		
57	7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH		
58	7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		
59	7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale		
60	7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
61	7206	Financim I pritshem nga buxheti	15,867,224	16,688,831
62	7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)		
63	7209	Te tjera grante korente te brendshme		
64	721	2.Grant korent I Huaj	0	0
65		Nga Qeveri te Huaja		
66		Nga Organizata Nderkombetare		
67		**VI.TE ARDHURA TE TJERA**	**0**	**0**
68	781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi		
69	782	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatshkurtra		
70	783	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatgjata		
71	784	Rimarrje Shumash per shpenzime te viteve ardhshme		
72	787	Terheqje nga seksioni I investimeve		
73	73	VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE		

Burimi: MSHMS

Duke iu referuar tabelës vërejmë se **Llog.71** që përfaqëson të ardhurat e MSHMS në vlerën 2,480,087,940 lekë, në krahasim me vitin 2019 janë ngitur me 976,212,676 lekë (viti 2019) i përket vetëm MSH). Këto janë siguruar nga **Kat.lll -"Të Ardhura Jo Tatimore"** në vlerën 172,044,460 lekë (nga verifikimi i Akt Rakordimit të të Ardhurave në Thesar 2020 rakordon vlera e siperpermendur); si dhe **Kat.V- "Grante Korente**" në vlerën 2,308,043,480 lekë ose 98 % të të ardhurave.

Llog.72 "Grante Korente" për vitin 2020, rezultoi me një vlerë prej 2,308,043,480 lekësh (ose shtuar me 806,908,031 leke nga viti 2019), shtesë kjo e mbartur që prej vitit 2018, si pasojë e ristrukturimit të institucionit (bashkimi i dy ministrive (MSh & MMSR).
-Duke iu referuar kësaj Pasqyre ,

Në lekë

Nr.	Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	Viti 2020	Viti 2019
74	**B**	**SHPENZIMET**	**2,315,155,582**	**1,504,072,128**
75	**600**	**I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE**	**156,399,491**	**136,814,336**
76	6001	Paga, personel I perhershem	156,399,491	136,814,336
77	6002	Paga personel I Perkohshem		
78	6003	Shperblime		
79	6009	Shpenzime te tjera per personelin		
80	**601**	**II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE**	**22,260,345**	**22,224,440**
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	22,260,345	22,224,440
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore		
83	**602**	**III.BLERJE MALLRA E SHERBIME**	**1,117,998,710**	**134,193,154**
84	602	Mallra dhe sherbime te tjera		
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	274,893,067	12,590,589
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale	691,484,545	1,580,840
87	6022	Sherbime nga te trete	26,712,537	20,117,325
88	6023	Shpenzime transporti	684,518	1,606,445
89	6024	Shpenzime udhetimi	6,695,980	12,320,546
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	48,127,573	25,663,730
91	6026	Shpenzime per qeramarrje	0	70,000
92	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	50,311,395	55,419,698
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua		
94	6029	Shpenzime te tjera operative	19,089,095	4,823,981
95	**603**	**IV.SUBVECIONE**	**0**	**0**
96	6030	Subvecione per diference cmimi		
97	6031	Subvecione per te nxitur punesimin		
98	6032	Subvecione per te mbuluar humbjet		
99	6033	Subvecione per sipermarrjet individuale		
100	6039	Subvecione te tjera		
101		**V.TRANSFERIME KORENTE**	**1,010,900,598**	**1,207,903,519**
102	**604**	**1.Transferime korente te brendshme**	**0**	**0**
103	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	0	
104	6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
105	6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetsore		
106	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		
107	**605**	**2.Transferime korente me jashte**	**10,614,032**	**8,077,315**
108	6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare	10,614,032	8,077,315
109	6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
110	6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurese te huaja		
111	6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
112	**606**	**3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe**	**1,000,286,566**	**1,199,826,204**
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	1,000,286,566	1,199,826,204

115		**VI.SHPENZIME FINANCIARE**	**0**	**0**
116	**65**	**1.Shpenzime Financiare te brendshme**	**0**	**0**
117	650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte		
118	651	Interesa per huamarrje te tj. Brendshme		
119	652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise		
120	656	Shpenz.nga kembimet valutore		
121	**66**	**2.Shpenzime Financiare te jashtme**	**0**	**0**
122	660	Interesa per huamarrje nga Qeveri.te Huaja		
123	661	Interesa per financime nga Institucionet.nderkomb		
124	662	Interesa per huamarrje te tjera jashtme		
125		**VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA**	**0**	**2,423,338**
126	681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit		
127	682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashte perdorimit e te shitura		
128	683	Shuma te parashikuara te shfrytezimit		
129	686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare		2,423,338
130	**63**	**VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT**	331,967	513,341
131		**IX.SHPENZIME TE TJERA**	**7,264,472**	
132	**85**	**TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES**	**164,932,358**	**-196,864**
		(Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)		

Burimi: Aparati MSHMS

Grupimit B SHPENZIMET , të ndara sipas zërave :

Llog.600 "*Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli*" në vlerën 156,399,491 lekë ose 9 % të totalit të shpenzimeve;

Llog.601 "*Kontribute për sig. Shoqërore e shëndetësore*" në vlerën 22,260,345 lekë ose 1.5 % të totalit të shpenzimeve;

Llog.602 "*Blerje Mallra dhe shërbime të tjera*" në vlerën 1,117,998,710 lekë ose 8.9% të totalit të shpenzimeve; Kjo llogari përmban shpenzimet për aparatin e MSHMS si dhe për shpenzime për Covid-19. Keto shpenzime janë kryer për aparatin e e MSHMS në vlerën 124,948,437 lekë; shpenzime për COVID-19 në vlerën 999,906,357 lekë si dhe shpenzime të cilat janë përdorur nga të ardhurat në vlerën 724,000 lekë.

Ka diferenca të konsiderueshme në vlera tek disa prej llogarive si:

Llog.6020- ñMateriale zyre të pergjitshmeò ka një rritje prej **262,303,478** lekë si rezultat i blerje se materialeve zyre te ndryshme per nevojat e institucionit si dhe blerje per covid-19;

Llog.6021 ñMateriale dhe sherbime specialeñ, ka një rritje ne vlerën 689,903,705 lekë, si rezultat i blerjeve materiale dhe shërbime speciale si dhe blerje për covidin.

Llog.6022 ñShërbime nga te treteñ, një rritje ne vlerën, 6,595,212 lekë.

Llog.6029 ñShpenzime të tjera operative një rritje në vlerën 14,265,114 lekë.

Llog.6025 ñShërbime për mirëmbajtje të zakonshmeò ka një rritje ne vlerën 22,463,843 lekë.

Log.6024ï ñShpenzime Udhëtimiò ka një ulje prej 5,624,566 lekë.

Llog.6023 ñShërbime transportiñ ka një ulje në vlerën 921,927 lekë krahasuar me vitin 2019

Llog.6026 ñShpenzime për qeramarrjeò një ulje në vlerën 70,000 lekë etj, pasi nuk ka më kontrata qeraje. Ndërsa

Llog.6027 ñShpenzime për detyrime për kompesime legaleò një ulje në vlerën 5,108,303 lekë etj.

Kateg. V- TRANSFERIME KORENTE në vlerën 1,010,900,598 lekë ose 80.3 % të totalit të shpenzimeve, ku pjesën më të madhe e zë

Llog.606 -ñ*Transferta për buxhete familjare eindividët*ò në vlerën 1,000,286,566 lekë ose 98.7 %

të tij e cila përbëhet nga ndihma ekonomike të dhëna për rast fatkeqësie ose ndihma familjarë ne vlerën 769,800 lekë të dhëna për aparatin si dhe nga vlera 999,516,765.8 lekë shpërblim për ish të përndjekurit politik.
Llog.605 -"*Transferime korenteme jashtë*" në vlerën 10,614,032 lekë ose 1.3%;
Llog.63 "*Ndryshimi i gjendjeve të inventarit***"** në vlerën 331,967 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve.
Llog.686 "Shuma të Parashikuara për Aktivet Financiareò në vlerën 0 lekë përputhet me **Llog.711** e Kat.III TË ARDHURA JO TATIMORE.

Nga auditimi rezultoi se formatet e miratuara nga Ministria e Financave janë zbatuar.
Ndryshimi i gjendjes së inventarit në Grupimin B është i barabartë me diferencën e Klasës 3 në Aktiv të Bilancit.
Nga grupi i auditimit u bë rakordimi i shpenzimeve të Pasqyrës së Performancës Financiare me thesarin ku konstatohet se:
- Vlerat e paraqitura në pasqyrën financiare me vlerat e paraqitura në Akt rakordimin me Degën e Thesarit Tiranë ñ*Mallra dhe shërbime te tjera*ò, sipas bilancit në vlerën 1,117,998,710 lekë, ndërsa Akt rakordimit me Degën e Thesarit vlera është 1,118,578,794lekë, ku diferenca prej 580,084 lekë janë detyrime të periudhës, por që ky detyrim do të paguhet në periudhën e ardhshme ushtrimore.
-ñ*Paga, shpërblime e të tjera personeli*ò sipas bilancit paraqiten në vlerën 156,399,582lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 157,021,283lekë, ku diferenca prej 621,701lekë vjen si rezultat diferencës së pagës dhjetor 2020 me atë të janar 2021.
Në thesar në muajin janar të vitit 2021 kanë kaluar pagat e dhjetor 2020, ndërsa në pasqyrë vlera e Paga, përfitime të punonjësve është totali për periudhën Janar-Dhjetor 2020, ku vlera e pagave Dhjetor 2020 kalon në thesar në janar të 2021. I njëjti fenomen ndodh dhe me Llog. 601 ò*Kontrib.të sig.shoq.e shëndets*ò.

Pasqyra krahasuese si më poshtë:

Në lekë

Nr. Llog	Shpenzimet e ushtrimit, 2020	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	**I. Shpenzime Korrente**	**2,315,155,582**	**2,308,865,087**	**6,290,495**
600	Paga përfitime të punonjësve	156,399,582	157,021,283	621,701
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	22,260,345	22,364,389	104,044
602	Mallra dhe shërbime te tjera	1,117,998,710	1,118,578,794	580,084
605	Transferta korente me jashtë	10,614,032	10,614,032	0
606	Transferta për buxh. familjare e individë	1,000,286,556	1,000,286,589	33

Në Grupimin A të Ardhurat te Pasqyra Format 2 -Llog. 720 financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2020 (*grant*) në shumën 2,292,176,256 lekë dhe financimi i pritshëm nga buxheti i shtetit i në vlerën 15,867,224 lekë.
Të ardhurat tatimore e jo tatimore janë pasqyruar në Formatin 2 në vlerën 172,044,460 lekë

Në lekë

48	**72**	**IV. Grante Korrente (a+b)**	**2,308,043,480**	**1,501,135,449**
49	**720**	**a) Grant I brendshëm**	**2,308,043,480**	**1,501,135,449**
50	7200	Nga buxheti për NJQP (Qendrore)	2,292,176,256	1,484,446,618
51	7206	Financimi I pritshëm nga buxheti	15,867,224	13,234,680
52	**721**	**b) Grante korrent I jashtem**	**0**	0

Në lekë

34	**71**	**III. TE ARDHUTRA JO TATIMORE(a+b+c)**	**172,044,460**	**2,739,815**

35	710	a) Nga ndërmarrjet dhe pronësia	0	0
36	711	b) Shërbime administ. e ardhura sekondare	0	0
37	719	c) Te tjera te ardhura jo tatimore	0	316,477

-Në Pasqyrën Formati 2 "Të Ardhurat Jo Tatimore", përfaqësojnë të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve, të ardhura nga licencat për shoqëritë private, korrigjim nga vitet e kaluara etj.

Në lekë

Klasifikimi	Pershkrimi	Te ardhura progresive	Pjesë e institucionit	Rritje e autorizuar	Derdhur ne buxhet	Mbetur për tu trashëguar
711 3099	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve	558,000	0	0	558,000	0
711 1021	Te ardhura nga licensat per shoqeri private	10,000	0	0	10,000	0
778 0100	Korigjime nga vitet e kaluara	125,000	0	0	125,000	0
7109600	Qera ambienti	16,790			16,790	0
7207011	Sponzorizime nga subjekte shteterore,private	101,202,670	101,202,670	100,00,000	0	1,202,670
7207013	Sponzorizime nga subjekte shteterore,private	69,408,000	69,408,000	5,645,413	0	63,762,587
7207014		724,000	724,000	724,000	0	0
	Shuma	**172,044,460**	**171,334,670**	**106,369,413**	**709,790**	**64,965,257**

- Shuma **709,790** leke jane te ardhura te realizuara nga aktiviteti I institucionit si leje importi barnash mjekesore,licensa ,arketim per penalitete etj.
- Shuma **171,334,670** leke jane donacioni nga organizma e institucione ne kuadrin e luftes ndaj **Covit 19 te** cilat perdoren nga institucioni dhe trashegohen.

Nga kjo shume jane perdorur gjithësej gjat vitit 2020, **7,988,472** leke , konkretisht **7,264,742** per pagese TVSh per paije mjekesore per Covid 19, kurse **724,000** donacion nga Ambasada Gjermane jane perdorur per trajnim personeli per perdorimin e paisjeve mjekesore.

Vlera e pasqyruar tek Akt Rakordimi i të Ardhurave në thesar rakordon me vlerën e pasqyruar në Pasqyrën Format 2, llog.71 ñte ardhura jo tatimoreò në vlerën 172,044,460 lekë.

c. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Bilanci kontabël i **vitit 2020** për MSHMS është përpiluar nga Sektori i Financës dhe miratuar nga Drejtori i Drejtorisë së Financës. Kopje e gjithë pasqyrave financiare është dërguar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 1606, datë 29.03.2021. Nga Dega e Thesarit Tiranë është bërë edhe vulosja e bilancit dhe formateve të pasqyrave financiare; Relacioni shpjegues ka cilësuar qartë se ***Llogaritë vjetore të vitit 2020 i përkasin vetëm Aparatit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe jo MSHMS***, **çka nuk është zbatuar VKM nr.508 dt.13.09.2017, me justifikimin e mos shoqërimit të saj me Udhëzime përkatëse për ta zbatuar si nga ana strukturore dhe proceduriale, ashtu edhe ajo financiare (kontabilitetit)**. Pasqyrimi kontabël i MSHMS për vitin 2020 është i përbërë nga pasqyrat financiare sipas formateve të miratuara nga Ministria e Financave si dhe është respektuar afati i dorëzimit të tij në thesar.

Përmbledhja e llogarive vjetore për vitin 2020 dhe krahasimi me periudhat e mëparshme.

Tabela: Aktivi - Pasqyra e Pozicionit Financiar për vitin 2020

Në lekë

Nr. Resht	Referenca	E M E R T I M I	Viti 2020	Viti 2019

	Logarive			
1	**A**	**A K T I V E T**	**3,103,126,660**	**1,632,396,697**
2		**I.Aktivet Afat shkurtra**	**868,411,370**	**161,538,639**
3		**1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre**	**198,148,440**	**27,313,444**
4	531	Mjrete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjrete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	198,148,440	27,313,444
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		**2.Gjendje Inventari qarkullues**	**7,546,585**	**7,878,552**
12	31	Materiale	5,234,270	5,566,237
13	32	Inventar I imet	2,312,315	2,312,315
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		**3.Llogari te Arketushme**	**662,716,344**	**126,346,643**
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	2,851,636	2,985,036
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetsore		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitore te ndryshem	26,256,378	26,256,378
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	633,608,329.874	97,105,229
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
36		**4.Te tjera aktive afatshkurtra**	**0**	**0**
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
42		**II.Aktivet Afat gjata**	**2,234,715,290**	**1,470,858,058**
43	**20**	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**13,853,025**	**0**
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	13,853,025	
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	**21**	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**2,220,862,265**	**1,470,858,058**

48	210	Toka, Troje, Terene		
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndertesa e Konstruksione	122,421,259	120,983,324
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
52	214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	8,676,646	10,845,807
53	215	Mjete Transporti	0	0
54	216	Rezerva Shteterore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	188,825,720	234,683,891
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata	1,900,938,641	1,104,345,036
59	25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		**4.Investime**	**0**	**0**
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		0
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale		

Grupimi A – AKTIVET , përfaqëson shumën: *Aktivet Afatshkurtra* (Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre, Gjendje Inventari qarkullues, Llogari te Arkëtueshme dhe Të tjera aktive afatshkurtra)me *Aktivet Afatgjata* (Aktive Afatgjata jo materiale, Aktive Afatgjata materiale, Aktive Afatgjata Financiare dhe Investime) .
Nga të dhënat përmbledhëse të *Aktivit për vitin ushtrimor 2020*, rezulton se totali i Aktivit me 31.12.2021 ka vlerën **3,103,126,660 lekë** dhe se në krahasim me vitin 2019 është **1,470,729,963lekë** më shumë;
"Aktivet Afatgjata"(AAGJJM, AAGJM dhe AAGJF) në vlerën 2,234,715,290 lekë zënë 72% të vlerës totale të aktivit;
Aktivet Qarkulluese zënë 9.8% të vlerës totale.
Aktivet Afatgjata në krahasim me vitin 2019, janë rritur në vlerën 369,586,767 lekë, ndërsa Aktivet Qarkulluese janë ulur në vlerën 73,406,455 lekë.

<u>Auditimi i Aktiveve Afatgjata</u>:
a. <u>Objektivat e auditimit</u> të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:
- Aktivet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit;
- janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte
- është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme;
- informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe e korrekte.
b. <u>Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:</u>
Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet e qëndrueshme;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi

kontabël.
- U verifikua rregullshmëria e procedurës së kalimeve kapitale të AAGJM (godina e MSH, mjeteve të transportit) si dhe e atyre për jashtë përdorimit.
c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e Aktiveve Afatgjata:
1. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:
- Aktivet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Aktivet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostos së tyre të prodhimit.
- Aktivet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes. (UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 ñ*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar)*.

Në mënyrë analitike llogaritë financiare të aktivit të pasqyrës financiare paraqiten si më poshtë vijon:

1.Aktivet Afatgjata

-Llog.212"Ndërtime e konstruksione**",** paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën prej 122,421,259 lekë, ku është shtuar vlera prej 7,487,101 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me rikonstruksionin e godinës.

-Llog. 214 ñInstalime Teknike makineri, pajisjeò, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën 8,676,646 lekë e cila nuk ka lëvizje dhe duke e krahasuar me inventarin e vitit 2019 ka një vlerë më të vogël prej 2,169,161 lekë e cila përbën amortizimin e akumuluar.

- Llog.215 ñMjete Transportiò, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën 0 lekë, Mjete transporti referuar formatit 7/a ka një pakësim në shumën 2,566,570 lekë si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimit te një makine.

Edhe per vitin 2020 vazhdojme te mbetemi në të njëjtat konstatime si për vitin 2019, kur nuk jane të regjitstruara të gjitha makinat të clat janë në përdorim nga MSHMS si dhe referuar marreveshjes kuader marin shërbim mirembajtje.

Referuar sektorit te administrimit të aseteve dhe sherbimeve të përgjitshme kanë rezultuar, 12 makin në total, ku 9 prej tyre jane në përdorim, një eshte i llojit motorr dhe 3 prej tyre janë vleresuar si jashtpërdorimit të cilat ndodhen në ruajtje tek ISHSH.

Nga auditimi u konstatua se për 9 makina të cilat jane në pronësi të MSHMS si dhe në përdorim, për vitin 2020 i është kryer sherbim mirembajte referuar Marrëveshjes kuadër (dy vjecare) nr.4352/13 prot. Datë 01.11.2019 në një vlerë totale prej 500,000 lekë. Si rezultat i përdorimit të makinave si dhe sherbimeve te kryera për mirembajtjen e tyre, ***vlera 0 lekë e kontabilizuar për llog.215 nuk është e sakte***. Titullai i institucionit duhet të marrë masa për të ngritur një grup pune për rivlerësimin e këtyre makinave dhe pas rivlerësimit të tyre te behet regjistrimi i rregullur ne kontabilitet referuar Udhëzimit nr 30. Datë 27.122011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik*ò i ndryshuar si dhe udhëzimit nr, 8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të NJQPò.

- Llog.218 "Inventar ekonomikò, paraqitet në vlerën prej 188,825,720 lekë dhe ku për vitin 2020 është shtuar vlera 1,275,600 lekë si rezultat i blerjes së një paisje për Aparatin e MSHMS.

Në Llog.218 ñInventari Ekonomikò janë regjistruar edhe Sistemet që janë në funksion të MSHMS.

Pasqyra e sistemeve per Ministrine e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale-Viti 2020
(Per kalim kapital tek AKSHI)

Nr	Per Ish Ministrinë e Shëndetësisë
1	Projekti Shendetesia Elektronike (HER)
2	Ngritja e sistemit E-Presciption për shërbimin Shëndetësor (receta elektronike)
3	Ngritja e sistemit te menaxhimit te stafit dhe aseteve mjekesore per sisitemin e mjekesise

4	Sistemi on-line I raportimit te informacionit shendetesor dhe monitorimit te indikatoreve te performances se sistemit shendetesor
5	Implimentimi nenshkrimit elektronik per qytetaret dhe profesionistet e shendetesise
6	Sistemi informatik te regjistrimit dhe kontrollin e barnave (Ardhur nga QKK Barnave)
	Per Ish MMSR
1	Sistemi per personat me aftesi te kufizuar PAK
2	Sistemi ndihmes ekonomike (Sherbimit social)

Nga këto 8 Sisteme aktive në MSHMS, 6 (gjashtë) i përkasin ish-MSH dhe janë në Inventarin e MSHMS, ndërsa 2 (dy) Sistemet e ish-MMSR nuk janë marrë në dorëzim në kundërshtim meVKM nr.507 dt.13.09.2017, VKM nr.717 dt.01.12.2017 pika 2 si dhe Urdhërit nr.833 dt.06.12.2018 (nxjerrë nga vet institucioni).

Pasqyra e Sistemeve për Ministrinë e Shëndetesise & Mbrojtjes Sociale
(Per kalim kapital tek AKSHI)

Nr	Per Ish Ministrine e Shëndetësisë	Vlera Fillestare
1	Ngritja e sistemit te menaxhimit te stafit dhe aseteve mjekesore per sisitemin e mjekesise	9,976,080
2	**Sistemi informatik te regjistrimit dhe kontrollin e barnave (Ardhur nga QKK Barnave)**	**21,830,544**
3	Sistemi on-line I raportimit te informacionit shëndetesor dhe monitorimit të indikatorëve te performancës së sistemit shëndetësor	36,847,800
4	Projekti Shendetësia Elektronike (HER)	232,179,683
5	**Ngritja e sistemit E-Presciption per sherbimin Shendetesor (receta elektronike)**	**416,131,188**
6	Implimentimi nenshkrimit elektronik per qytetaret dhe profesionistet e shendetesise	117,072,000
	TOTALI	**834,037,295**

Pra 6 (gjashtë) sistemet e ish-MSH kanë një vlerë fillestare në Total prej 834,037,295 lekë. Sipas Procesverbalit mbajtur në dt.08.12.2018 bazuar mbi shkresën nr.6933/1 dt.07.12.2018 drejtuar AKSHI-t me objekt òPër rialokimin e infrastrukturës ekzistuese nga godina e vjetër e ish-MSH, pranë Datacenterit Qeveritarò, palët konfirmojnë 2(dy) Sisteme:òSistemi informatik i rregjistrimit të barnaveò AAGJM i MSHMS (ish-MSH) dhe ñKontrolli Shëndetësor bazë për shtetasit nga moshan 35 deri më 70 vjecò(AAFGJM i MFE por i hostuar fizikisht në ambientet e ish-MSH) **janë HostuarFizikisht** pranë Datacenterit Qeveritar-AKSHI. Për këtë procedurë nuk është është zbatuar òUdhëzimi nr 30 dt.27.12.2011òPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publikò për crregjistrimin e tyre nga Rregjistri i Inventarit dhe nga Kontabiliteti. Vlera e mirembajtjes për vitin 2019 dhe 2020, është 56,889,493 vetëm për SLA E-prescription për shërbimin shëndetësorò.
Referuar urdhrit nr.776 datë 09.11.2019 ñMbi ngritjen e komisionit për kalimin kapital të sistemeve te infrastrukturës TIK nga MSHMS tek AKSHI, miratuar nga sekretari i Përgjithshëm, eshte ngritur grupi i punës ku referuar Relacioni shpjegues drejtuar Titullarit të Intitucionit me numer protokolli nr.841 datë 11.02.2021 komisioni ka njoftuar se është mbajtur procesverbali për rialokimin e paisjeve midis MSHMS dhe AKSHIT për kalimin e tre sistemeve, ku saktesisht
1.Sistemi i Burimeve Njerezore
2.Sistemi i regjistrimit të barnave
3.Sistemi i regjistrave elektronik të Shëndetësisë.
Nga auditimi u konstatua se palët nuk kanë rënë në marrëveshje duke sjellur për pasojë mos crregjistrimin e tyre nga regjistri i inventarit të kontabilitetit të MSHMS, duke ngelur në te njëjtën situate prej vitesh.
MSHMS ne bashkëpunim me AKSHI-n, duhet të marrë masa të menjëhershme ku në zbatim të VKM nr.673, datë 22.11.2017 ñPër riorganizimin e AKSHITò të bëje kalimin e kapitalit për llogari të AKSHIT, duke sjell kështu një pasqyrim real të gjendes së invetarit, për llog. (218).

Dy Sistemet e ish-MMSR (renditur si më poshtë) nuk janë marrë në dorëzim nga MSHMS duke mos zbatuar VKM NR.717 dt.01.12.2017 për ñMiratimin e Listës së Inventarit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore, të cilat i kalojnë Përgjegjësi Administrimi Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Socialeò si dhe pikën 2 ñTë gjitha Aktivet e Qëndrueshme dhe Aktivet Qarkulluese, që janë në inventarin e personelit të ish-MMSR që bëhen pjesë e strukturës aktuale të MSHMS, i kalojnë MSHMSò, si dhe Urdhërin e Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS së nr.833 dt.06.12.2018.

Nr	**Per Ish Ministrinë e Mbrojtjes Sociale e Rininë**	**Vlera Fillestare**
1	Sistemi për Personat me Aftësi të Kufizuara PAK	62,030,134
2	Sistemi I Ndihmës Ekonomike (sherbimi social)	13,405,140
	TOTALI	**75,435,274**

Këto dy Sisteme të ish-MMSR në Vlerë financiare prej 75,435,274 lekë në total (nuk janë marrë në dorëzim) nuk janë rregjistruar dhe kontabilizuar në Rregjistrin e Aktiveve të MSHMS, por në 2019-2020 nuk ka shërbim mirëmbajtje të tyre.

- **Llog.28 "Caktime**ñ, paraqitet në AKTIVE në vlerën 1,900,938,641 lekë dhe në krahasim nga viti paraardhës ka një rritje në vlerën 796.5 milion lekë Kjo llogari paraqet investimet për të tretët por që janë likuiduar nga aparati i MSHMS, në shumën **1**,900,938,641 përbërë nga vlera e llog.28 në fund të vitit 2019 në shumën 1,104,345,036 lekë si dhe nga shtesat prej 552,898,790 lekë investime të likuiduara nga buxheti i shtetit gjatë vitit 2020 si dhe gjendja në shumën 243,694,815 lekë donacione për COVID-19. Shtesat prej 552,898,790 lekë,të likuiduara nga buxheti i shtetit gjatë vitit 2020, përbëhen nga:
- Llogaria 231 ne vlerën 504,972,760 lekë për rikonstruksionin e 105 qendrave shendetësore në qarqet e vendit; rikonstruksion i shërbimit të reaminacionit për Spitalin Vlorë; dhe celja e letër kredisë për blerjen e rezonances magnetike.
- Nga llogaria 233 TVSH ne shumën 3,241,390 lekë për TVSH për projektin e Rikonstruksionin e Qendrave së Grave të Trafikuara; TVSH për ndërtimin e QSH nga fondacioni Gjysëm Hëna e Kuqe.
- Nga llog. 404 ñFurnitorë për paisjeò në shumën 44,684,640 lekë, për blerje autoambulanca për QSUT, e cila nuk ka sjelle konfirmim për bërje hyrj të tyre.

2.Aktivet Afatshkurtra

- Llog.520 "Disponibilitete në Thesar" janë pasqyruar të ardhurat në shumën 198,148,440 lekë e cila përbëhët nga të ardhurat të cilat ka trashëguar deri në fund të vitit në vlerën 190,659,642 lekë duke mbledhur të ardhurat te cilat vjnë nga llog.466 ngurtësim garancie në vlërën 20,377,083 lekë duke zbritur clirimin e garancisë në vlerën 12,888,285 lekë.

- Llog.423 "Personeli, paradhënie, deficite gjobaò është në vlerën prej 2,851,636lekë dhe përfaqëson detyrimet e personelit lënë si rekomandim nga KLSH dhe Auditi i Brendshëm. Kjo llogari përbehet nga detyrimet që kanë 24 persona ish punonjës të aparatit të ish MSH, por në momentin e detyrmit kanë qënë të larguar nga institucioni. Kjo llogari mbart detyrime nga viti 1998.

- Llog.468 "Debitorë të ndryshëm"është në vlerën 26,256,378 lekë dhe përfaqëson detyrimet që i kanë institucionit (21 debitorë), të lëna me rekomandim nga KLSH, Subjekteve që kanë kryer punime në ish-MSH por janë të konstatuara nga auditet e kryera pas mbylljes së mardhenieve kontraktule me këto subjekte. Edhe këto detyrime janë të hershme, por situata për to është: 6 (gjashtë) debitorë janë mjaftuar vetëm me njoftimin e bërë qysh në vitin e krijimit të detyrimit dhe 15 prej tyre janë në proces gjyqësor. Këto janë të detajuara në mënyrë analitike në partitarët e llogarisë. *Kjo llogari përmban vetëm debitorët ndaj ish-MSH.*Nuk janë marrë masa për të ndjekur

hapat ligjorë apo të ndërtohen strategji për arkëtimin e tyre, situatë e trashëguar po njësoj që nga vitit 2018.

- Llog. 4342 "Të tjera operacione me shtetin", në vlerë prej 633,608,329.874 lekë lekë ku Janë burime financimi për detyrimet afatshkurtër gjendje (kryesisht të muajit Dhjetor) që sipas Ligjit të Buxhetit mbulohen nga buxheti i vitit pasardhës; si dhe fatura të papaguara nga Banka por të kaluara nga Thesari ditët e fundit të vitit 2020. Vlera e Llog.4342 është 536,503,101 lekë më e larte se viti 2019.

Kjo llogari përbëhet nga Kunderpartitë e llogarive në pasiv të bilancit ku e përmbledhur ne menyre tabelare është si më poshtë vijon:

Kundraparti e llogarive ne pasiv te bilancit	
Llogaria 401 furnitore	2,554,145
-Llog 421 Paga personeli	8,924,416
-Llog 431 Tatim page	946,328
Llogaria 435 sig shoq	1,848,599
Llogaria 436 sig shendet	1,593,736
Llog 467 kred te ndryshem	617,741,106
Llog 4342 gj 31.12.2020	**633,608,330**
Shifra ne bilanc	**633,608,330**

*Nga Ministria, së bashku me njësitë e varësisë, në bashkëpunim dhe me Ministrinë e Financave të merren masa për të siguruar arkëtimin e debitorëve të trashëguar me vite dhe të krijuar rishtazi. Për debitorët pa shpresë arkëtimi të riverifikojë dhe evidentojë realisht statusin apo mundësinë për arkëtim të detyrimit në favor të buxhetit të shtetit dhe vetëm pas miratimit nga Ministria e Financave për "**Debitorët pa shpresë arkëtimi**", të bëjë parashkrimin e tyre dhe sistemimin në kontabilitet.*

Grupimi B - PASIVET

Tabela: ***Pasivi i Pasqyrës Financiare për vitin 2020***

Ref.Llog	**EMERTIMI**	**Viti 2020**	**Viti 2019**
B	**PASIVET(DETYRIMET)**	**697,518,586**	**153,343,610**
	I.Pasivet Afat shkurtra	**697,518,586**	**153,343,610**
	1. Llogari te Pagushme	697,518,586	153,343,610
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	2,554,145	3,732,216
42	Detyrime ndaj personelit	8,924,416	9,390,795
16,17,18	Hua Afat shkurtra		
460	Huadhenes		
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	946,328	1,006,393
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
435	Sigurime Shoqerore	1,848,599	1,952,643
436	Sigurime Shendetsore	1,593,736	1,689,084
437,438,	Organizma te tjere shteterore		
44	Institucione te tjera publike		

45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	34,802,242	26,996,967
467	Kreditore te ndryshem	617,741,106	79,334,098
4341	Operacione me shtetin(detyrime	29,108,014	29,241,414
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
419	Kreditore, Parapagime		
475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
478	Diferenca konvertimi pasive		
480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se ttitullit		
	II.Pasivet Afat Gjata	0	0
Klase 4	Llogari te pagushme		
16.17,18	Huate Afat gjata		
	Provigjonet afatgjata		
Klasa 4	Te tjera		
C	**AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)**	**2,405,608,073**	**1,479,053,087**
D	**FONDI I KONSOLIDUAR :**	**2,405,608,073**	**1,479,053,087**
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	339,737,075	374,904,915
12	Rezultatet e mbartura		
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	164,932,358	-196,864
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta te investimeve		
15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime		
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmne	1,900,938,641	1,104,345,036
106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim		
109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
	Te Tjera		
E	**TOTALI I PASIVEVE(B+C)**	**3,103,126,660**	**1,632,396,697**

Nga të dhënat përmbledhëse të Pasivit të Pasqyrës Financiare rezulton se totali i pasivit me 31.12.2020, paraqitet me vlerën 3,103,126,660 lekë, ku me C-ñAKTIVET NETO/FONDETò janë në vlerën 2,405,608,073 lekë e njëjtë në vlerë me D- ñFONDI I KONSOLIDUARò dhe zënë respektivisht 77.5% të vlerës totale të pasivit ndërsa B-ñDETYRIMETò janë në vlerën 697,518,586 lekë e njëjtë në vlerë me ñPasivet Afatshkurtraò zënë rreth 22.5%.

- Llog. 401"Furnitorë e llogari të lidhura me tëò, në vlerën 2,554,145 lekë në Pasqyrën Financiare Format 1 përfaqëson detyrimet ndaj furnitorëve vlerë e cila përbëhet nga detyrime të trashëguara nga viti 2019 prej 1,009,660 lekë dhe pjesa e mbetur detyrime të krijuara gjatë vitit 2020 si dhe fatura të sjella në fund të vitit 2020.

- **Llog 42"Detyrime ndaj Personelit"** në vlerën 8,924,416 lekë , përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2019; shuma 946,328 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2019 të cilat likuidohen në Janar të vitit 2020 me fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2020.

- **Llog.435 & 436"Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore**ñ përfaqëson kontributet e sigurimit shoqëror në shumën 1,848,599 lekë dhe sigurimit shëndetësor në shumën 1,593,736 lekë të muajit Dhjetor 2019,të cilat likuidohen në muajin Janar 2020 me fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2020.

- **Llog.466 "Kreditore për mjete në ruajtje"** është në vlerën 34,802,242 lekë.

Kjo llogari mbart në vetvete ngurtësimin 5% si garanci punimesh për Rikonstruksionet e kryera që institucioni e ndal në momentin e likuidimit të situacioneve si dhe clirimit të kësaj garancie mbas periudhës së mbarimit të afatit të sigurimit të punimeve.
Gjendje në Kredi me 31.12.2020 për 5% e ngurtësimit të ngarancisë është në vlerën 20,377,083.45 lekë ku institucioni e ndal në momëntin e likuidimit të te sitacioneve si dhe clirimi i garancisë për e cila kryhet mbas mbarimit të të afatit të sigurimit të punimeve është 12,888,285 lekë.
Gjendja në fillim të vitin përbëhet nga shuma 26,996,967 lekë.
Pra, në total në fund të periudhës 31.12.2020 kjo llogari shkon në shumën 34,485,765 lekë, ku diferenca e shifrës me rakoridimin ne bilanc përbën shumën e të ardhurave të trashëguara në vlërën 316,477 lekë nga viti 2019.
- **Llog.4341 "Te tjera operacione me shtetin (kreditor)**ò në shumën prej 29,108,014 lekë. Analiza financiare këtyre llogarive në kundërparti është e detajuar më lart tek llogaritë respektive të Aktivit.

Në lekë

	Llog.	Vlera / leke
Llogaria 4341 Operacione me shtetin (detyrime)		**29,108,014**
Kundraparti		
Llogaria 423 ,429 personel paradhenie deficite gjoba	423/429	2,851,636
Debitorë të ndryshëm	468	26,256,378
	Total	**29,108,014**

-Llog.467 "Kreditore të ndryshëm në shumën prej 617,741,106 lekë e cila është e përbere nga shuma 557,677,511 lekë shpenzime të kuluara në thesar në vitin 2020 kurse në banke në vitin 2021 si dhe nga shuma 60,063,595 lekë detyrime të lindura gjatë vitit 2020 po të palikuiduara. Pas deklarimit në thesar ne lidhje me detyrmiet e prapambetura, ne sektorin e finances është shtuar dhe fatura në vlerën 299,868 lekë për shërbimin kameramani, ku rakordon dhe me diferencen e deklarimit ne thesar dhe regjistrimit në bilanc.
Te ndara sipas zërave, detyrimet e pramapambetura janë si më posjhtë vijon:

Llogaria ekonomike	Pershkrimi	Shuma / leke
4864100	Vendime gjyqesore	27,150,000
4864200	Sherbime	225,696
4864300	Mirembajtje	222,648
4864400	Investime	1,672,572
4864500	Rimbursim I TVSH	2,348,408
4864900	Te tjera	28,744,139
Totali		**60,363,463**

Rakordimet e Pasqyrave Financiare:
Auditimi u bë me zgjedhje për këto llogari, formate e pasqyra financiare:
- Auditimi për **barazimin e vlerës totale** të Pasivit me Aktivin:
-Totali i aktiveve **A** është i barabartë me totalin e pasiveve **E(B+C)** të bilancit kontabël (*Format1*), në shumën 1,632,396,697 lekë.
Në pasiv të bilancit janë paraqitur me **C** ñ***Aktivet Neto/Fondet***" të institucionit që arrijnë në vlerën **2,405,608,073** lekë, e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së Aktivit të bilancit**A** ï 868,411,370 lekë dhe grupeve **B** ñ*Detyrimeve*ò ï 697,518,586 lekë.
- Tek Pasqyra e Performancës Financiare (*Format 2*) Vlera e Grupimit Aò Të Ardhuarat" *është i barabartë me totalin* Vlera e Grupimit B òShpenzimetò dhe vlera e Llog.85 (164,935,358 lekë).

- Llog.85 ñRezultati i veprimtarisë së Vitit Ushtrimor*"* në *Formatin 2* është në vlerën 164,932,358 lekë e njëjtë në vlerë **me Llog.85** ñRezultati i Veprimtarisë Ushtrimoreò në Grupimin D te Pasqyra e Pozicionit Financiar (*Format1).*
- Llog. 63 ñNdryshim i gjendjeve të inventarit*"*, evidentuar në Pasqyrën *Format 2* për 331,967lekë në fund të vitit 2019, rakordon me ndryshimin e gjendjes së magazinës dhe është sa diferenca e klasës 3 ñGjendja e Inventarit Qarkulluesònë aktivin e bilancit. *Pra,* janë të barabarta që të dyja me vlerën prej 331,967 lekë**.**
- Pasqyra e Flukseve Monetare Formati 3.
Nga auditimi rezulton se ñAkordimi i Fondeve Buxhetore për Shpenzime korrenteò,Vlerat në lekë e Arkëtimeve është e njëjtë me vlerat respektive të llogarive në Pasqyrën Format 1 për vitin 2020 në vlerën 2,389,345,800 lekë& realizimi është në vlerën 2,308,865,087 lekë; ñAkordim Fonde Buxhetore për shpenzime Kapitaleò për vitin 2020 është në vlerën 1,669,448,354 lekë dhe realizimi i tij është 1,267,062,578 lekë.
òTransferime në Buxhet të Fondeve të pa përdoruraò në vlerën prej 490,854,958 lekë;
Rezulton me Rritje të vlerës monetare në shumën 8170,834,996 lekë;
Teprica në fillim të vitit 2020 është e njëjtë në vlerë me atë të mbylljes së vitit 2019 në shumën prej 27,313,440 lekë;
Teprica e Likuiditeteve të vitit 2019 është 198,148,440 lekë e njëjtë në vlerë me Llog.520 ñDisponibilitete në Thesarò te Pasqyra Format 1.
- Pasqyra e Ndryshimeve të Aktiveve Neto Format 4.
Totali i Fondeve sipas Pasqyrës Format 4 është i barabartë me totalin e Fondeve në Pasqyrën Format 1.
- Pasqyra e Investimeve dhe Burimet e Financimit Format 6.
Nga Grupi i Audititmit u bënë verifikimet:Llog.105 e F6 është e barabartë me Llog.105 në F1;
Llog.106 e F6 është e barabartë me Llog.106 në F1;
Llog.111 e F6 është e barabartë me Llog.111 në F1;
Llog.115 e F6 është e barabartë me Llog.115 në F1;
Llog.12 e F6 është e barabartë me Llog.12 në F1;
Llog.16+17 e F6 është e barabartë me Llog.16+17 në F1;
Llog.230 & Llog.231 e F6 janë të barabarta me Llog.230 & Llog.231 në F1;
Llog.25/26 e F6 është e barabartë me Llog.25/26 në F1.
- Pasqyra Pyetësor dhe Shënime Shpjeguese Format 5.
Kjo pasqyrë është plotësuar pjesërisht duke mos e përmbushur qëllimin e saj. Plotësimi i të gjitha posteve të kësaj pasqyre do të sillte një lehtësi në verifikimin e cdo llogarie dhe dhënien e opinionit mbi saktësinë, plotësinë dhe qartësinë e pasqyrave financiare.

1. Titulli i Gjetjes	**Transferimi i sistemeve tek AKSHI**
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, të gjitha sistemet e IT-së, janë ende pjesë e regjistrit të kontabilitetit të MSHMS. Mes MSHMs dhe AKSHI-t nuk është nënshkruar një marrëveshje ku të përcaktohen përgjegjësitë e ndërsjellta lidhur me këto sisteme. Referuar urdhrit nr.776 datë 09.11.2019 ñMbi ngritjen e komisionit për kalimin kapital të sistemeve te infrastrukturës TIK nga MSHMS tek AKSHI, miratuar nga sekretari i Përgjithshëm, është ngritur grupi i punës ku referuar Relacioni shpjegues drejtuar Titullarit të Intitucionit me numër protokolli nr.841, datë 11.02.2021, komisioni ka njoftuar se është mbajtur procesverbali për mundësinë e rialokimit të paisjeve nga MSHMS te AKSHI-t për kalimin e tre sistemeve: 1.Sistemi i Burimeve Njerëzore 2.Sistemi i regjistrimit të barnave 3.Sistemi i regjistrave elektronik të Shëndetësisë. Në përfundim konstatuam se, ***palët nuk kanë arritur në marrëveshje*** duke sjellë për pasojë mos çregjistrimin e tyre nga regjistri i inventarit të kontabilitetit të MSHMS,

	duke ngelur në te njëjtën situate prej vitesh.
Kriteri:	Ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN VKM, nr. 673, datë 22.11.2017, ñPër Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionitò, e ndryshuar. Udhëzimi Nr.30 datë 27.12.2011 *"PËR MENAXHIMIN E AKTIVEVE NË NJËSITË E SEKTORIT PUBLIK"*
Ndikimi	Qëllimi kryesor i shkresave zyrtare është faktimi i veprimeve që do të kryhen, ndaj të vepruarit në këtë formë riskon mirëfunksionimin e proceseve të punës. Dalja e sistemeve nga ambientet e ish MSH pa gjurmë shkresore, lë hapësira për abuzim nga personat që kanë kryer këtë proces, nuk jep garanci dhe riskon kryerjen transferimit sipas detyrimeve ligjore.
Shkaku	Kjo situatë ka ardhur si pasojë e mos respektimit të detyrimeve ligjore nga komisioni të ngritur të kryej transferimin e sistemeve.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi	MSHMS ne bashkëpunim me AKSHI-n, duhet të marrë masa të menjëhershme për të kryer kalimin e kapitalit për llogari të AKSHI-t, për të pasqyruar saktë dhe drejtë gjendjen e invetarit, për llog. (218)., në pasqyrat financiare të MSHMS. Institucioni gjithashtu të marrë masa për transferimin e sistemeve në përputhje me detyrimet ligjore, me qëllim gjurmimin e këtij procesi si dhe mirëfunksionimin e proceseve të punës që lidhen dhe ndikohen nga këto sisteme, duke minimizuar risqet për abuzime..
Afati i zbatimit:	Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:	**Mbi Pasqyrat Financiare Vjetore**
Situata:	Pasqyrat Financiare për vitin 2019 dhe vitin 2020 përfshijnë vetëm ñTë drejtatò dhe ñDetyrimetò e ish Ministrisë së Shëndetësisë duke mos përfshirë në të, treguesit financiarë të ish Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, duke ***sjellë si pasojë jo vetëm mosnjohje dhe moskontabilizim të saktë dhe të plotë të të drejtave dhe detyrimeve të subjketit, si dhe siguri të kufizuar në konfirmimin e pohimit të ekzistencës së tyre,*** duke bërë një pasqyrim të mangët dhe jo real të bilancit kontabël. MSHMS në vitin 2020 ka lidhur kontratën me shoqërinë ñS.....ò, me objekt realizimin dhe akt rakordimet me thesarin, për pasqyrat financiare për ish MMSR, me nr. 491/5 prot.date 12.02.2020. Bilanci i MMSR-së, për periudhën 01.01 ï 30.11.2017, ka përfunduar nga studio, dhe është dorëzuar në MSHMS me procesverbalin datë 19.10.2020; Gjithashtu është përcjellë në Thesar me shkresën nr.1320, datë 09.03.2021. Nga auditimi rezultoi se, edhe pse ndodhemi përpara faktit të pasjes së një bilanci për ish-MMSR, nga MSHMS nuk është marrë asnjë masë për të ndarë te drejtat dhe detyrimet e MMSR, mes tre institucioneve (Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) , të cilat pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 508, date 13.09.2017 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Socialeò përthithën programet e MMSR-së.
Kriteri:	-Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, të ndryshuar, -VKM nr.508 dt.13.09.2017 ñ*Mbi përcaktimin e fushës se përgjegjësisë shteterore te Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale*ò. -Shkresa nr.12615 dt.15.09.2017 e MFE ñ*Mbi zbatimi e buxhetit te vitit 2017 pas ndryshimit të Qerverise*ò pika 1 citonò*Ministritë e Linjës. Entiteti në SIFQ i të cilave nën Qeverine e re do të pushojë se ekzistuari, si Gr.25 MMSR, nga dt.14 shtator ndërpresin cdo veprim për zbatimin e buxhetit".* -Shkresa nr.12885 dt.21.09.2017 te MFE ñ*Autorizim mbi zbatimin e buxhetit te vitit 2017 sipas programeve*ò pika 3 citon ò*Autorizohet MSHMS (Gr.13), për përdorimin e fondeve buxhetore të programeve Planifikim, Menaxhim e Administrim; Perkujdesi Social; Përfshirja Sociale dhe Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik".*

	-Aktin Normativ nr.3 dt.06.11.2017 nën administrimin e MSHMS apo njësive të saj të varësisë, kaluan 4 programet buxhetore. (Gr.25) - VKM nr.717 dt.01.12.2017 ñPër miratimin e listës së Inventarit të pronave të Paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi të MSHMSò pika 2 citon ñ*Te gjitha aktivet e qëndrueshme dhe qarkulluese , që janë në inventarin e personelit të ish□MMSR që bëhet pjesë e strukturës aktuale të MSHMS, i kalojnë MSHMS".*
Ndikimi/Efekti:	Risk për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit. Mos pasqyrim i saktë i treguesve financiarë dhe evidencave shtetërore.
Shkaku:	Mungesa e përfshirjes së treguesve financiare të ish ï MMSR.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Nga ana e MSHMS duhet të merren masa në mënyrë ***urgjente***, për bashkëpunimin me dy ministritë e tjera : Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për ndarjen e të drejtave dhe detyrimeve sipas bilancit të hartuar dhe miratuar nga thesari te ish-MMSR, me qëllim pasqyrimin ***real, të plotë, të qartë të aktivitetit ekonomiko-financiar të Ministrisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale si një Institucion i vetëm buxhetor.*** Gjithashtu pas përfundimit të ndarjes së të ñTë drejtaveò dhe ñDetyrimeveò, MSHMS të marrë masa në inkorporimin e tyre si dhe kontabilizimin e plotë, të cilat në kushtet aktuale krijojnë jo vetëm risk për ruajtjen dhe mirëadministrimin e tyre por denatyrojnë gjithashtu treguesit financiarë të shtetit.
Afati i zbatimit:	Brenda datës 28.02.2022

3. Gjetje nga auditimi:	**Mbi rivlerësimin e Aktiveve te MSHMS**
Situata:	Referuar inventarit te kryer nga MSHMS per vitin 2020, me urdhrin Nr.30, nr.367 prot datë 20.01.2020 miratuar nga titullari i institucionit ñ*Ngritjen e komisionit për invetarizimin e pasurisë*ò, komisioni i grupit ka kryer ndër të tjera edhe inventarizimin e mjeteve te transportit te aparatit të MSHMS, ku kanë rezultuar, *12 makina në total,* ku *9 prej tyre janë në përdorim*, një është i llojit motor dhe *3 prej tyre janë vlerësuar si jashtpërdorimit të cilat ndodhen në ruajtje tek Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor*, por nuk ka përfunduar procesi i nxjerrjes së tyre jashtë përdorimit. Pas kryqëzimit te vlerës kontabël, me vlerën e inventarit te kryes nga MSHMS konstatojmë se: - ne kontabilitet janë të regjistruara vetëm 4 prej makinave me vlerë kontabël 0 (zero) të cilat vijojnë të marrin shërbime referuar kontratës së mirëmbajtjes se makinave, - 5 makina te cilat janë në përdorim nga MSHMS dhe marrin shërbime, por nuk janë të kontabilizuara, - 3 makina, të cilat sipas realcionit të inventarizimit janë vlerësuar për tôu nxjerrë jashtë përdorimit, por ky procesi nuk ka përfunduar duke u tejzgjatur.
Kriteri:	-Pika 109, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Mospasqyrim i saktë ne kontabilitet, ne vlerën 0 i artikullit i cili është në përdorim. Risk për mosgjurmim të aktiveve, vecanërisht në raste të humbjes apo vjedhjes së tyre.
Shkaku:	Mungesa e rivlerësimit të aktivit në përdorim
Rëndësia:	E Mesëm
Rekomandimi:	-Nepunësi Autorizues (NA) të marrë masa për ngritjen e një komisioni me ekspertë të fushave, për artikujt respective - automjete, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të tyre, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi i vlerës së aktivit. -Mbi bazën e aktivit të rivlerësuar, institucioni të rrealizojë regjistrimet e vlerës së tyre në kontabilitet. -NA te marrë masa për ngritjen e grupit të punës për të nisur dhe përfunduar procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit të automjeteve që rezultojnë si të tilla nga komisioni i inventarizimit, nëpërmjet shitjes si material mbeturine apo asgjësimit përfundimtar, duke ndjekur të gjitha procedurat sikundër kërkon Udhëzimi nr. 30, date 27.12.2012 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar.
Afati i zbatimit:	Menjëherë

III.6. PROKURIMET E FONDEVE PUBLIKE

Informacion i përgjithshëm për vitin 2019

Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2019 në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë zhvilluar në total 22 procedura prokurimi me vlerë totale kontrate prej 46,896,588 lekë pa tvsh.

Grupi i auditimit, në bazë të regjistrit të realizimit të prokurimeve në MSHMS, përzgjodhi procedurat të cilat janë realizuar mbas periudhës 31.07.2019, për arsye se, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), për periudhën e auditimit 01.01.2018 deri në 31.07.2019,është realizuar auditim i mëparshëm, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.122, datë 09.10.2019 të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr.361/9 prot datë 10.10.2019.

Sa më sipër, grupi i auditimit auditoi 3 procedura, nga të cilat: 2 procedura kërkesë për propozim me objekt ñMirembajtje dhe riparim të automjeteve të MSHMSò dhe ñRikonstruksion i ambjenteve të MSHMSò , të dyja me vlerë kontrate prej 9,258,180 lekë pa tvsh si dhe 1 procedurë e hapur me objekt ñBlerje barna dhe materiali konsumi për Qëndrat Shëndetësoreòme vlerë kontrate prej 35,309,776.00 lekë pa tvsh, Procedura e hapur e mësipërme, nuk u auditua nga grupi i mëparshëm, pasi publikimi i kontratës së saj është bërë me datë 25.04.2019, për rrjedhojë , kjo procedurë ishte në proces realizimi dhe nuk u auditua nga grupi në mëparshëm, paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Nr	Lloji i procedurës 2019 Për periudhën 01.08.2019-31.12.2019	Zhvilluar		Audituar		Audituar në %	
		Nr. i rasteve	Vlera kontrate në lekë pa tvsh	Nr. i rasteve	Vlera në lekë pa tvsh	% numër	% vlerë
1	Me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit	-	-	-	-	-	-
2	Blerje me vlerë të vogël+ bileta	19	2,328,632.0	-	-	-	-
3	Kërkesë për propozim	2	9,258,180.0	2	9,258,180	100%	100%
4	E Hapur / Marrëveshje Kuadër	1	35,309,776.0	1	35,309,776	100%	100%
TOTALI		**22**	**46,896,588**	**3**	**44,567,956.0**		

Burimi:MSHMS, përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH

Sa më sipër, u konstatua se:

1. Procedura e hapur me objekt ñBlerje barna dhe materiali konsumi për Qëndrat Shëndetësoreò, rezultoi që *është realizuar dhe monitoruar në përputhje* me bazën ligjoreligjit nr.9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikñ i ndryshuar, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar.

2.Procedura kërkesë për propozim ñMirembajtje dhe riparim të automjeteve të MSHMSò rezultoi që *është realizuar dhe monitoruar* në përputhje me bazën ligjore ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikñ i ndryshuar, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar.

3.Procedura me objekt **"Rikonstruksione në disa ambiente të godines së MSHMS"**, rezultoi me disa problematika të cilat po i paraqesim si më poshtë vijon:

Të dhënat e përgjithshme:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Rikonstruksione në disa ambiente të godines së MSHMS**".**		
1. Urdhër Prokurimi nr. 685, datë 08.10.2019 **Njësinë e prokurimit**	3. Argumentimi i fondit limit është përcjell me shkresën me nr.4650 , datë 27.09.2029 nga titullari i AK.	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** , i ngritur në bazë të urdhër nr. 685/1, datë 08.10.2019

A.A E. L V. Dh **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** ñKërkes për propozim / Prokurim me mjete elektronike / Punë Publike ò	Dokumentacioni përmban projektin , preventivin e zbatimit , specifikimet teknike, analizate cmimeve dhe grafikun e punimeve.	1.S. K kryetar 2.Ing. V. H anëtar 3.Ing. E.H anetar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 7.662.490 lekë .	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** A.... SHPK me vlerë oferte 5,712,917 lekë pa tvsh.	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 1,949,573 lekë pa tvsh. .
8. Data e hapjes së tenderit Data 15.10.2019	**9.Burimi Financimit nga** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomike** pjesëmarrës 1- K.... shpk me vlerë oferte 5,996,679,100 lekë pa tvsh. 2- D-P... shpk me vlerë oferte 6,519,245 lekë pa tvsh. 3- E...-V.. , nuk ka paraqitur ofertë 4- Sh... me vlerë oferte 6,247,693 lekë pa tvsh. 5-A.... SHPK me vlerë oferte 5,712,917 lekë pa tvsh. 6- E..... me vlerë oferte 5,692,803 lekë pa tvsh. 7- E-S, nuk ka paraqitur ofertë 8- L.. K.... me vlerë oferte 6,046,803 lekë pa tvsh. 9- D...-A.. me vlerë oferte 6,679,720 lekë pa tvsh. 10- A.. K..., nuk ka paraqitur ofertë
11. Ankimime Pranë AK- Nga OE D...-AL me Nr.4805 /3 date12.11.2019	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK ï Kthyer me shkresen me Nr.4805 / 5 date18.11.2019	**13. Përgjigje** Ankesës nga KKP ï nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr.4805/10 , datë 05.12.20219 me operatorin fitues ñA..ñ Shpk me vlerë te pritshme 5,712,917 lekë pa tvsh .	**15. Monitorimi i urdher shpenzimeve:** Kontrata është likujduar me USH nr.799 datë 22.10.2020. Detyrimet janë shlyer përtej afatit 30 ditor që është detyrimi ligjor për kryerjen e pagesave, në kundërshtim me ligjin nr. 48/2014 ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò, neni 7 dhe në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 52.	

Nga auditimi i dosjes fizike të prokurimit dhe sistemit të prokurimeve elektronike në app.gov.al me REF-39528-10-15-2019 u konstatua se:

1.Nga auditimi u konstatua, se Marrëveshja midis OE A... sh.p.k dhe K.... sh.p.k me nr. Rep 4980 Datë 25.10.2019 , ka përshkruar vetëm % e bashkëpunimit të OE pa e përshkruar me elementët konkretë të punimeve të cilët marrin përsipër të kryej secili prej tyre, duke mos përcaktuar përqindjen e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 74 pika 2 ku shprehet se,*"Para*

dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen nëbashkimin eoperatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi."

KVO e ngritur me Urdhër nr.685/1 datë 08.10.2019 me përbërje (S.K, ing.V.H dhe E. H), duhej të konsideronte një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në bazë të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar.

2.Nga auditimi, u konstatua se, në DST pika 2.3.7 nga autoriteti kontraktor i MSHMS është kërkuar të jenë dy punonjës të punësuar me profil shërbimi për punime duralumini .

OE ñA sh.p.kò shpallur fitues nga KVO, nuk nuk e ka plotësuar këtë kriter të pikës 2.3.7 të DST, pasi në listëpagesat për periudhën Qershor-Gusht 2019 me kodin 7119.06 (punëtor duralumini) rezultoi vetëm një punonjës i punësuar me profil shërbimi për punime duralumini.

KVO e ngritur me Urdhër nr.685/1 datë 08.10.2019 me përbërje (S.K, ing.V.H dhe E. H), duhej të konsideronte një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në bazë të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar.

Për sa më sipër, OE fitues nuk i kanë plotësuar kriteret e mësipërme dhe shpallja fitues, është bërë në mënyrë të padrejtë në mospërputhshmëri me DST, duke vënë në diskutim cilësinë e procedurave të prokurimeve të financuara nga fondet buxhetore si dhe marrjen e rikonstruksionit të ambjenteve të MSHMS, për rrjedhoje ***vlera prej 5,712,917 lekë pa tvsh, është shpenzuar pa ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.***

3.Gjithashtu, nga titullari i AK, është vendosur si kryetar në komisionin e vlerësimit të ofertave, nënpunës zbatues z.S.K, kjo në kundërshtim me rregullat e LPP, në kundërshtim VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar neni 56, ku citohet se ñ*Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar*ò.

Në lidhje mbi problematikat e konstatuara, **nga grupi i audituesve u mbajt Aktkonstatimi nr.9 datë 30.04.2021 me nr.415/15 prot të MSHMS,** për cilën është observuar nga ana e KVO me përbërje (S.K, ing.V.H dhe E. H) si dhe nga titullari i AK zj.G.P, me shkresa nr.415/23 prot, datë 04.05.2021 të MSHMS si dhe me observimet nga MSHMS në lidhje mbi Projekt raportin e përcjellë nga KLSH me shkresë nr.121/10 prot datë 03.09.2021, të cilat kanë ardhur më datë 14.10.2021 jashtë afatit kohor të parashikuar në ligjin 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò neni 26 dhe 29, me shkresë nr.415/47 prot të MSHMS dhe me nr.121/11 prot datë 14.10.2021 të KLSH.

Sa më sipër, audituesit e KLSH , i ri vlerësuan dhe observimet e dyta, të cilat nuk kanë paraqitur dokumentacion shtesë apo argumentim ligjor shtesë në lidhje mbi problematikën e konstatuar, për këtë qëllim, audituesit shprehen me të njëjtin qëndrim, si vijon:

Pretendimi i subjektit:
1.Në faqen nr.2 paragrafi i dytë shprehen se, bashkimi i operatorëve ekonomikë të shpallur fitues në procedurën ñRikonstruksione në disa ambiente të godinës së MSHMSò A.. shpk dhe K... shpk me Prokurë me nr.Rep 4980 datë 25.10.2019, kanë përcaktuar % e bashkëpunimit që do të kenë në rast të shpalljes fitues në këtë procedurë.
Në dokumentacionin e ngarkuar në SEP është dokumenti Preventiv-pdf.
Në këtë dokument janë përcaktuar në mënyrë të detajuar ndarja e puneve sipas të gjitha zërave të kërkar në preventiv.
Përkatësisht, operatori ekonomik K.... i cili merr përsipër 10% e punimeve, sipas preventivit.
2.Në faqen nr.3, shprehen se, OE A.... shpk ka paraqitur në SEP dokumentin Punonjësit-A.shpk , konkretisht:
1.L.T me profesion specialist duralumini vërtetuar me çertifikatën n.003SC032 dhe me rinovimin e kontratës lidhur më datë 08.01.2019.
2.E.D me profesion specialist duralumini vërtetuar me çertifikatën n.001SC032 dhe me rinovimin e kontratës lidhur më datë 08.01.2019.
3.Në faqen 4, shprehen se, KVO ngritur me Urdhër nr.685/1 datë 08.10.2019, nuk përcakton apo legjitimon anëtarët e grupit. KVO ka si detyrë të zbatojë urdhrin dhe të bëjë vlerësimin e procedurës dhe të zbatojë me përpikmëri ligjin e prokurimit publik.
Vendosja e z.K në KVO nuk është në kushtet e konfliktit të interesit dhe nuk ka asnjë bazë ligjore që ta pengojë këtë gjë.
Qëndrimi i grupit të auditimit.
1.Nga auditimi u konstatua, se Marrëveshja midis OE A... sh.p.k dhe K... sh.p.k me nr. Rep 4980 Datë 25.10.2019 , ka përshkruar vetëm % e bashkëpunimit të OE pa e përshkruar me elementët konkretë të punimeve të cilët marrin përsipër të kryej secili prej tyre, duke mos përcaktuar përqindjen e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 74 pika 2 ku shprehet se,*"Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen nëbashkimin eoperatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi."*
Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.
2.Nga auditimi, u konstatua se, në DST pika 2.3.7 nga autoriteti kontraktor i MSHMS është kërkuar të jenë dy punonjës të punësuar me profil shërbimi për punime duralumini .
OE ñA... sh.p.kò shpallur fitues nga KVO, nuk nuk e ka plotësuar këtë kriter të pikës 2.3.7 të DST, pasi në listëpagesat për periudhën Qershor-Gusht 2019 pasi me kodin 7119.06 (punëtor drualumini) rezultoi vetëm një punonjës i punësuar me profil shërbimi për punime duralumini.
Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.
3.z.K është në pozicionin e nëpunësit zbatues, dhe vendosja në KVO nuk është në kushtet e konfliktit të interesit dhe nuk ka asnjë bazë ligjore që ta pengojë këtë gjë. **Për sa më sipër ky observacion merret në konsideratë.**

Titulli i Gjetjes:	Mbi auditimin e përputhshmërisë së procedurës , me objekt **"**Rikonstruksione në disa ambiente të godines së MSHMS**"**
Situata :	Nga auditimi i procedurës me objekt ñRikonstruksione në disa ambiente të godines së MSHMSò realizuar në vitin 2019, nga MSHMS, në bazë të dosjes fizike të prokurimit dhe sistemit të prokurimeve elektronike në app.gov.al me REF-39528-10-15-2019 u konstatua se, **-** Marrëveshja midis OE A.. sh.p.k dhe K.... sh.p.k me nr. Rep 4980 datë 25.10.2019, ka përshkruar vetëm % e bashkëpunimit të OE pa e përshkruar me elementët konkretë të punimeve të cilët marrin përsipër të kryej secili prej tyre, duke mos përcaktuar përqindjen e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 74 pika 2.

	2.Nga auditimi, u konstatua se, në DST pika 2.3.7 nga autoriteti kontraktor i MSHMS është kërkuar të jenë dy punonjës të punësuar me profil shërbimi për punime duralumini. OE ñA.... sh.p.kò shpallur fitues nga KVO, nuk e ka plotësuar këtë kriter të pikës 2.3.7 të DST, pasi në listëpagesat për periudhën Qershor-Gusht 2019 me kodin 7119.06 (punëtor duralumini) rezultoi vetëm një punonjës i punësuar, me profil shërbimi për punime duralumini.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publicò i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, neni 66 dhe DST.
Ndikimi/Efekti:	BOE fitues OE A... sh.p.k dhe K..... sh.p.k, nuk i kanë plotësuar kriteret e mësipërme dhe shpallja fitues, është bërë në mospërputhshmëri me DST, duke vënë në diskutim cilësinë e procedurës së prokurimit, për rrjedhoje vlera prej 5,712,917 lekë pa tvsh, përbën risqe të shpenzimeve pa ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet, të fondeve buxhetore.
Shkaku:	KVO e ngritur me Urdhër nr.685/1 datë 08.10.2019, duhej të konsideronte një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në bazë të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar.
Rëndësia:	I Lartë
Rekomandim	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale, në cilësinë e autoritetit kontraktues, të marrë masa, për ngritjen e grupit të punës, për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet si dhe për nxjerrjen e përgjegjësive, në lidhje me mangësitë e konstatuara në procedurën e mësipërme, me qëllim marrjen e masave për një menaxhim me efektivitet, ekonomicitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore, dhe shmangien e risqeve financiare në disfavor të Buxhetit të Shtetit.

Mbi ri-auditimin për zbatimin për procedurat e realizuara në bazë të VKM nr 203, datë 26.02.2020 "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit " i ndryshuar me VKM nr.242 datë 22.03.2020 "Për disa shtesa në VKM nr.203 datë 26.02.2020 "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësore të shtetit", realizuar në vitin 2020.

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 121/1 prot, datë 21.01.2021 i ndryshuar, u ri-audituan procedurat të realizuara në bazë të VKM nr 203, datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit òi ndryshuar,duke konstatuar se, gjatë muajit mars-prill të 2020 nga MSHMS, e ndodhur në kushtet Pandemisë Covid-19 dhe epidemisë kombëtare , për plotësimin e nevojave emergjente që kanë lindur për sigurimin e barnave, materialeve mjekesore, pajisjeve mjekesore, shërbime të ndryshme në pavionet e spitaleve me qëllim përshtatjen për trajtimin e të prekurve me Covid-19 të ndodhur në rrethanat e interesave thelbësore të shtetit **ka përdorur** VKM 203/2020 i ndryshuar, duke realizuar **7 procedura të drejtëpërdrejtë (ndarë në Lote)** përcaktuar në pikën IV.2, për të siguruar mallrat dhe shërbimet e nevojshme për shkak të procedurave të diktuara nga interesa thelbësore të shtetit dhe kohës së shkurtër të zhvillimit të procedurave.
Për 7 Procedurat ,vlera totale e fondit limit është 520,832,755.0 lekë pa tvsh, ndërsa vlera e kontratave është në vlerën prej 419,542,982.0 lekë pa tvsh. Grupi i auditimit i ka audituar në masën 100%, dmth 7 procedurat, të paraqituar në Aneksin nr.15.

Informacion i përgjithshëm
Grupi i audituesve të KLSH-së, për të realizuar objektin e auditimit, *u fokusua*, në zbatimin e:
-VKM nr 203, datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit ò i ndryshuar me VKM nr.242 datë 22.03.2020 ñPër disa shtesa

në VKM nr.203 datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësore të shtetitò, janë miratuar me qëllimin për ofrimin blerje/shërbime më të shpejta në kohë, duke krijuar garanci të proporcionalitetit në përputhje me Aktin Normativ të Qeverisë nr.243 datë 24.03.2020 ñPër shpalljen e gjendjes së Fatkeqësisë natyrore dhe Pandemia Botërore shpallur nga OBSHò.

Nisur nga auditimi i procedurave të mëposhtme, të realizuara në mbështetje të VKM 203/2020 u konstatuan disa mangësi, të cilat do të trajtohen më gjerësisht në vijim:

Këshilli i Ministrave në kushtet e emergjencës prej pandemisë Covid-19, gjatë periudhës mars ï prill 2020 për parandalimin e saj ka nxjerrë disa akte nën ligjore ndër to edhe VKM nr 203, datë 26.02.2020 ñ*Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit*ò. Sipas kësaj VKM, çdo kontratë që do të lidhen në zbatim të saj do të miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Mirëpo konstatohet se përmbajtja e kësaj VKM, nuk i ka shërbyer situatave emergjente për lehtësimin dhe eliminimin e kësaj fatkeqësie natyrore, pasi përmbajtja e saj ka krijuar disa hapësira në lidhje me, zgjatjen e afateve kohore të furnizimit të medikamente, materiale mjekësor apo shërbimeve shëndetësorë, me llogaritjet në mënyrë apriori apo subjektive të vlerave të këtyre kontratave; me mënyrën subjektive dhe klienteliste të përzgjedhjes së operatorëve furnizues; me formalizma për monitorimin e zbatimit të kontratave, etj.

Kështu në zbatim të kësaj VKM, autoriteti kontraktor (MSHMS) gjatë periudhës së pandemisë ka realizuar 7 (shtatë) procedura prokurimi, nga auditimi i të cilave u konstatuan disa anomali në lidhje me furnizimin dhe shërbimet emergjente të diktuara nga pandemia, si më poshtë:

(I)-Sipas VKM nr 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar pika VII (Miratimi i Kontratës) thuhet se:

1.Kontratat, që diktohen nga interesat thëlbësore të shtetit pas nënshkrimit të tyre, do të miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Kontrata do të hyjë në fuqi pas këtij miratimi. Ky kusht do të jetë i specifikuar edhe në kontratën e nënshkruar ndërmjet palëve dhe në dokumentet e procedurës garuese.

2.Në rastet kur kontrata nuk miratohet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga Këshilli i Ministrave, atëherë procedura do të quhet e anuluar.

Nga auditimi u konstatua se, kontratat produkte të VKM nr.203, datë 26.02.2020 i ndryshuar, janë miratuar nga 7 ditë deri në 10 dhjetë ditë më vonë, nga dita kur është lidhur kontrata nga AK me operatorin ekonomik fitues, duke çeduar me*"faktorin kohë*ò në kushtet e emergjencës prej pandemisë Covid 19.

Për sa më sipër, u konstatua, miratimi me VKM-ve respektive:

1-Procedura ñBlerje Barna Anti Covid -19ò ndarë në 10 Lote , me fond limit total 36,812,915 lekë.

Loti 5-Oseltamivir (Tamiflu) është lidhur kontrata me nr.1573/28, datë 06.04.2020, miratuar VKM nr.314, datë 18.04.2020.

Loti 8-Omeprazol është lidhur kontrata me nr.1573/31, datë 07.04.2020, miratuar me VKM nr.313, datë 18.04.2020.

Loti 9-Propofol, është lidhur kontrata me nr.1573/30, datë 06.04.2020, miratuar me VKM nr.320, datë 18.04.2020.

Loti10-Beclomethasone+salbutamol është lidhur kontrata me nr.1573/32 datë 07.04.2020, miratuar me VKM nr.315, datë 18.04.2020.

2-Procedura ñFurnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19ò me fond limit 129,727,371 lekë pa tvsh.

Është lidhur Kontrata e furnizimit me nr.1365/36 datë 27.03.2020, miratuar me VKM nr.274, datë 03.04.2020.

3-Procedura ñBlerje Materiale Për Mbrojtje Personale Për Covid -19ò me fond limit prej 307,844,333lekë pa tvsh.
Është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1366/18, datë 18.03.2020, miratuar me VKM nr.241 datë 21.03.2020.
4-Procedura ñBlerje kite dhe reagent dhe evadim mbetje anti COVID-19ò, ndarë me 2 Lote.
-Loti I ñBlerje kite dhe reagentë për Laboratorin Mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisjen e Existation të firmës Bioner ose ekuivalentò, është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1574/13, datë 30.03.2020, miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020.
-Loti II ñTrajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19, është lidhur kontrata me nr.1574/12, datë 30.03.2020 , miratuar me VKM nr.273, datë 03.04.2020.
5-Procedura ñFurnizim me produkte letre një përdorimëshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjenike për pacientët me Covid-19 dhe personelin mjekësor.”
Është lidhur Kontrata e furnizimit me nr.1575/18, datë 07.04.2020, miratuar me VKM nr.323 datë 18.04.2020.
6-Procedura ñSpostimi i sistemit të dializës nga Pediatria e Specialiteteve tek godina e Spitalit Infektiv(Shërbimi i Alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me Covid-19òështë
lidhur kontrata nr.1575/19, datë 07.04.2020 , miratuar me VKM nr.323 datë 18.04.2020.
7-Procedura ñBlerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPòe ndarë në 4 Lote
-Loti I ñBlerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò është lidhur kontrata me nr.1776/11 datë 14.04.2020 , miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020.
-Loti i II ñBlerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò, është lidhur kontrata me nr.1776/13, datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.316, datë 18.04.2020.
Loti i III ñBlerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò, është lidhur kontrata me nr.1776/12, datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.317, datë 18.04.2020.
VKM nr.203, datë 26.02.2020 ñProcedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetitò i ndryshuar, **nuk** ka të përcaktuar për procedurën e drejtëpërdrejtë, afatin kohor minimal të miratimit të kontratës nga Këshilli i Ministrave, në proporcion me emergjencën e situatës Covid 19. Vendosja e **pikave 1 dhe 2, Kreu VII “Miratimi i Kontratës”, ku**parashikohet se nëse kontrata nuk miratohet për 90 ditë, ajo anullohet, lë hapësirë që Këshilli i Ministrave, të mund të shtyjë miratimin deri në 90 ditë nga data e lidhjes së kontratës, duke cënuar kështu kriterin e ñemergjencësò, pasi situata e Covid-19 kërkonte zgjidhje të shpejtë. Kështu, në ftesat për ofertë që MSHMS, ka kërkuar pranë OE që barnat/pajisjet,materiale laboratori etj të siguroheshin për disa ditë, këtyre ditëve i është shtuar dhe koha që ka marrë KM për miratimin, ndonëse situata pandemike, kërkonte sigurimin sa më shpejtë të shërbimeve, barnave, pajisjeve, etj në funksion të përballimit të situatës, që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit.
(II)-Komisioni i Vlerësimit ka negociuar afatet e kontratës në kundërshtim me afatet e kërkuara në dokumentin ñFtesë për Oferteò, konkretisht si më poshtë vijon:
II.a Nga auditimi i procedurës ñ*Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19*ò me fond limit 129,727,371 lekë pa tvsh, nga KV me përbërje

(M.Xh, Kryetare dhe J.D, F.B, J.J dhe S.K, anëtarë), ku në datën 25.03.2020 janë negociuar kushtet e kontratës me OE fitues ñT.. ò shpk, në lidhje me afatet e lëvrimit, n*ë kundërshtim me afatet e përcaktuara në dokumentin "Ftesë për ofertë", konkretisht* fillimisht është kërkuar dhe ofertuar që lëvrimi për 54 respiratorë të bëhet në total për 10 ditë, ndërsa kontrata ka ndryshuar këtë kriter duke ndryshuar në: 20 respiratorë të lëvrohen për 7 ditë nga hyrja në fuqi e kontratës,ndërsa 34 respiratorë të lëvrohen për 25 ditë nga miratimi i kontratës me VKM, duke denatyruar *procedurën e përzgjedhur, e cila ka për qëllim përgjigjien emergjente ndaj situatës së pandemisë.*

Të dhëna për tenderin	Kom. i Vler. të Ofertave	Grupi i Zbatimit të Kontratës
a	b	c
-Urdhër. nr. 154, datë 10.03.2020 -Fondi limit pa tvsh 129,723 mijë lekë -Proc. e Prok. VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 (*e drejtpërdrejtë*) -Data e zhvillimit të tenderit 18.03.2020 -Firma fituese ñT....ò *sh.p.k* -Data e lidhjes së kontratës 27..03.2020 -Vlera e kontrat. 75,060 mijë lekë pa tvsh -Diferenca nga fondi limit 54, 663 mijë lekë.	M. Xh, Kryetar J. D, Anëtar F. B, Anëtar J. J, Anëtar S. K, Anëtar	L.P, N. C, L. A.

Sipas vendimit të Komisionit të Vlerësimit nr. 1365/31, dt. 23.03.2020 kanë paraqitur ofertat për konkurrim 11 operatorë nga të cilët është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori ñ*T*.....ò shpk me pikë totale 74.8 dhe ofertën në vlerën 75,060,000 lekë pa tvsh me të cilin është lidhur kontrata nr. 1365/36, datë 27.03.2020 miratuar me VKM nr. 274, dt. 03.04.2020 ñPër miratimin e kontratës me objekt ñ*Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adulte dhe moshë pediatrike për COVID-1*9ò.

Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit ë sjella nga operatori kontraktues rezultoi:

Me urdhrin nr. 152, dt. 09.03.2020 ñ*Për miratimin e rrethanave të gjendjes në kushtet thelbësore të shtetit*ò Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS ka urdhëruar ñ*miratimin e rrethanave të gjendjes në kushtet e interesave thelbësore të shtetit dhe domosdoshmërinë e aplikimit të procedurave të përcaktuara në Vendimin e këshillit të Ministrave nr. 203, dt. 26.02.2020 "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit", sipas tekstit bashkëngjitur këtij urdhri".*

Komiteti Teknik me shkresën pa datë *"Rrethanat e gjendjes në kushte të interesave thelbësore të shtetit"* ka vlerësuar se *situata aktuale prek interesat thelbësore të shtetit pasi rrezikohet shëndeti i popullatës në Republikën e Shqipërisë nga infeksioni i shkaktuar nga Covid-19* ***vlerësim i cili është jashtë kompetencave dhe detyrave të miratuara*** me urdhrin nr. 53, dt. 31.01.2020 ñ*Për ngritjen e komitetit të përkohshëm për infeksionin e përhapur nga coronavirusi i ri*ò i cili përbëhet nga 12 anëtarë.

Ky komision ka për detyrë:

a. Të përgatisë dokumentacionin dhe të monitorojë procesin e verifikimit për rastet e mundshme të përhapjes së infeksionit të coronavirusit i ri.
b. Të rishikojë dhe monitorojë aktivitete verifikuese në nivel kombëtar bazuar në procedurat standarte operacionale dhe rekomandimet e OBSH-së.
c. Të përgatisë raportet kombëtare për zyrën rajonale të OBSH-së.
d. Të nxisë strukturat shëndetësore, Institutin e Shëndetit Publik, si dhe struktura të tjera lokalë dhe qendrore për zbatimin e planeve dhe urdhëresave për të monitoruar progresin kundrejt qëllimeve të eliminimit të përhapjes së infeksionit të coronavirus i ri.

e. Të përgatisë planet e veprimit për dokumentimin dhe verifikimin duke përcaktuar përgjegjësitë, produktet burimet dhe afatet kohore të aktivitetit në bashkëpunim me departamentin e epidemologjisë dhe kontrollin e sëmundjeve infektive në ISHP.
f. Të raportojë tek Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes Sociale për të gjitha çështjet dokumentet dhe vendimet e mara në mbledhjet e Komitetit.
g. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik, për zbatimin e këtij urdhri.

Urdhri i mësipërm nuk është në përputhje me VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 *"Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit", pika II, Fusha e zbatimit; përcaktohet se: "..... Përpara fillimit të aplikimit të kësaj procedure**, rast pas rasti**, titullari i autoritetit kontraktor me urdhër miraton rrethanat e gjendjes në kushtet e interesave thelbësorë të shtetit dhe domosdoshmërinë e aplikimit të saj".*

Gjykojmë se autoriteti konraktor në rastin e përhapjes së infeksionit COVID-19 në përcaktimin e procedurës duhej ti ishte referuar Ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò i ndryshuar, Neni33 ñ*Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit*ò pika 2/c ñ***kur për arsye të nevojës ekstreme të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara nga autoriteti kontraktor*** .....ò, d, ñ*për blerje, që mundësojnë prokurimin e mallrave për një kohë lëvrimi shumë të shkurtër, ose për një rast veçanërisht të leverdishëm, që paraqitet në një kohë shumë të shkurtër dhe me një çmim, dukshëm, më të ulët se çmimet normale të tregut dhe në përputhje me kriteret e parashikuara në rregullat e prokurimit publik"* dhe VKM nr. 914, dt. 29.12.2014 ñP*ër miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar neni 36, "Procedura me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës" pika 2/c," Në rastin e një nevoje ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, që nuk i ngarkohen autoritetit kontraktor. Në këtë rast, duhet të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme: - Shkaktimi i një ngjarjeje të paparashikuar; - Autoriteti kontraktor nuk ka përgjegjësi për ngjarjen; - Ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshëm të një komuniteti të gjerë;* pika 3, ñ*Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 60 të këtyre rregullave, duhet të paraqesë arsyet e përdorimit të kësaj procedure. 4, 6, pika 7,* ñ*Në rastin e procedurës së prokurimit me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, afatet kohore parashikohen nga vetë autoriteti kontraktor, në varësi të objektit të prokurimit dhe rrethanave".*

Sa më lartë për aplikimin e procedurës *"Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit"* gjykojmë duke patur parasysh Urdhrin nr.133, datë 08.03.2020 ñ*Për kufizimin e lëvizjes së shoqëruesve dhe ose familjarëve të pacientëve nëpër spitale*ò, urdhrit 135/1 datë 09.03.23020 ñ*Për mbylljen e veprimtarisë çerdheve, për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-19",* Urdhrit nr 135, datë 09.03.2020 ñ*Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së COVID-19*ò, *vendimin e Komitetit Teknik nr. 566/3, dt. 06.03.2020 për domosdoshmërinë e krijimit të stokut për Mjetet Mbrojtëse Personale.*

Nga Komitetit Teknik është marrë Vendimi i nr. 566/3, dt. 06.03.2020 për krijimin e stokut për Mjete Mbrojtëse Personale për përdorim nga kategoritë si Inspektorati Shëndetësor, Epidemiologë, Mjekë të Urgjencës Mjekësore, Mjekë të Klinikës, infermierë, sanitarë dhe personel laboratori.

4. Sigurimi i 54 respiratorëve me dy modalitete për adulte dhe moshë pediatrike.

Me Urdhrin nr. 153, dt. 10.03.2020 *në cilësinë e nëpunësit autorizues* znj. G. P i ka deleguar kompetencat për zbatimin e detyrave të parashikuara nga VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 ñ*Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit*ò znj. M. Xh (*Ky delegim është shfuqizuar me shkresën nr. 153/1, dt. 25.03.2020).*

Nga Sekretari i Përgjithshëm me Urdhrin nr. 151, dt. 09.03.2020 për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt ñ*Blerje materiale për mbrojtje personale (MMP) për Covid-19*ò dhe ñ*Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete*

*për adulte dhe moshë pediatrie për Covid-19*ò, i kërkohet grupit të punës të bazohet në pikën 1 të vendimit të Komitetit Teknik nr. 566/3, dt. 06.03.2020. Gjithashtu i kërkohet grupit të punës që gjatë hartimit të specifikimeve teknike duhet të mbështetet në dispozitat e Ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò i ndryshuar, VKM nr. 914, dt. 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik* i ndryshuar kur sipas Nenit6 të këtij ligji ñ*Ky ligj nuk zbatohet në përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike, në rast se zbatimi i tyre kërkon masa të veçanta sigurie, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi, ose në rast se një gjë e tillë diktohet nga interesat thelbësorë të shtetit.*

Në zbatim të urdhrit të mësipërm grupi i punës me shkresën nr. 1351/1, dt. 10.03.2020 ka paraqitur relacionin ku theksohet se ñ..... *Për hartimin e specifikeve grupi i punës iu referua udhëzuesve të hartuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, për mbrojtjen ndaj COVID-19, publikuar në faqen zyrtare të saj"*. Bashkëngjitur janë lista e Mjeteve Mbrojtëse Personale me specifikimet teknike përkatëse.

Sekretari i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhrin nr. 154, dt. 10.03.2020 për ñ*Ngritjen e komisionit të vlerësimit për marrjen, shqyrtimin, vlerësimin e ofertave nga kandidatet dhe ofertuesit dhe lidhjen e kontratës për procedurën me objekt "Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adulte dhe moshë pediatrike për COVId-19".* Në zbatim të VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 ñ*Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit*ò.

Komisioni:

M. Xh - *Kryetare, Drejtore e Përgjithshme e Politikave dhe zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale,*

J. D ï *Anëtar, Drejtore e përgjithshme Ekonomike dhe shërbimeve mbështetëse,*

F. B ï *anëtar, Drejtore e politikave dhe strategjive të zhvillimit të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale.*

J. J- *Anëtar, Drejtore e Koncesioneve, PPP dhe Prokurimeve,*

S. K ï *Anëtar, Drejtor i buxhetit dhe menaxhimit financiar.*

Komisioni i mësipërm me procesverbalin nr. 1365/12, dt. 17.03.2020 ka argumentuar fondin limit të nevojshëm për lidhjen e kontratës për *"Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adulte dhe moshë pediatrike për COVID-19*ò. ñ*Komisioni i vlerësimit bazuar në vlerësimin e ofertave të marra për efekt të vlerësimit të tregut konstaton se fondi limit nga testimi i tregut rezultoi 129,727,371 lekë mbështetur në mesatarizimin e çmimeve të ofruara*ò.

Në urdhrin nr. 154, dt. 10.03.2020 përcaktohet se komisioni i vlerësimit ka për detyrë: ñ..... *marrjen, shqyrtimin, vlerësimin e ofertave nga kandidatet dhe ofertuesit dhe lidhjen e kontratës për procedurën me objekt 'Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adulte dhe moshë pediatrike për COVId-19".* ***(Në asnjë rast nuk i është kërkuar përcaktimi i fondit limit).***

Me VKM Nr. 205, Datë 9.3.2020 ñ*Për një shtesë fondi në buxhetin e vitin 2020, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për infeksionin e shkaktuar nga covid-19*ò Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në programin ñ*Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi*ò, i shtohet fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për infeksionin e shkaktuar nga COVID-19.

Në VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 ñ*Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit*ò, kreu IV.2 Procedura e drejtpërdrejtë. Pika 2 ñ*Autoriteti kontraktor hyn në marrëdhënie dhe kërkon propozim nga kandidati/tët e mundshëm të identifikuara për ofrimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve si dhe negocion për kushtet e kontratës*ò. Kreu V. Pika 3/b ñ*Mbas miratimit nga titullari i autoritetit kontraktor të procedurës, në varësi të procedurës së përzgjedhur, të hartojë dokumentacionin "Ftesë për ofertë", për propozim kandidatëve të mundshëm me qëllim përgatitjen prej tyre të ofertave".*

Në këtë rast referuar pikës 2 kreu IV dhe Pikës 3/b kreu V, Komisioni i Vlerësimit me marrjen e ofertave duhet të kishte filluar procedurën e shqyrtimit, vlerësimit të ofertave nga ofertuesit.

Duke patur parasysh se në ftesat për dhënie oferte nr. 1365/2, 4, 5 është cilësuar **shënimi**: ñ*Mbështetur në situatën emergjente në të cilën ndodhemi dhe domosdoshmërinë e madhe të këtyre pajisjeve, ju sqarojmë se koha e lëvrimit të të gjithë sasisë së artikullit pjesë e kësaj procedure është* ***brenda 7 (Shtatë) ditëve nga lidhja e kontratës***ò kërkesë e cila **është në përputhje** me VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 ñ*Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit*ò IV.2 procedura e drejtpërdrejtë: pika 1. ñ*Autoriteti kontraktor zgjedh procedurën e drejtpërdrejtë në kushtet e një nevoje urgjente ..... dhe koha në dispozicion për zgjidhjen e nevojës urgjente nuk është e mjaftueshme për zhvillimin normal të procedurave të tjera, të parashikuara në këtë vendim*ò dhe pika 2. ..... ñ*Dokumentet për këtë lloj procedure duhet të përmbajnë një përshkrim të qartë për objektin e kontratës, për cilësinë, për sasinë, për kushtet ose për kohën e kërkuar për dorëzim dhe/ose kërkesa të tjera në përputhje me objektin konkret*ò .

Ofertat e paraqitura:

Nr	Operatori	Çmimi pa tvsh	Sasia	Vlera pa tvsh	Koha e lëvrimit
1	H..&L... shpk	2,026,085	54	109,405,890	E gjithë sasia për 4 javë.
2	S.... M	1,657,665	54	89,513,910	Për 7 javë për të gjithë sasinë ose e negociueshme për sasi të pjesshme.
3	F.... shpk	1,356,000	54	73,224,000	5 copë brenda 7 ditëve, 28 brenda 4 javëve, 21 copë brenda dy muajve.
	F..... shpk	3,000,000	54	162,000,000	20 copë brenda 4-5 javëve, 34 copë brenda 8 javësh.
	F..... shpk.	1,900,000	54	102,600,000	20 copë brenda 7 ditëve, 34 brenda 25 ditë.
4	M..... shpk	3,093,750	54	167,062,500	3 muaj
5	**T.....shpk**	**1,070,000**	**54**	**57,780,000**	**7 deri 15 ditë**
6	B..... shpk	1,390,000	54	75,060,000	Korrik 2020
	B..... shpk	2,070,000	54	111,780,000	10 copë në prill, 44 copë në maj
7	F.... N... shpk	2,960,000	54	159,840,000	Nga Kina për 5 deri 10 ditë, nga SHBA për 20 deri 40 ditë
8	E..... shpk	4,464,000	54	241,056,000	Ska afate lëvrimi
9	M.....	2,000,000	54	108,000,000	6 deri 8 javë
10	O... D.... shpk	3.060.000	54	165,240,000	20copë deri 20 mars, 34 copë deri 28 mars.
11	B... E... shpk	3,585,572	54	193,620,888	28 ditë

Fondi limit pa TVSH është përcaktuar në vlerën 129,727,371 lekë kur ndërkohë nga Komisioni i vlerësimit mund të kishte filluar procedura e vlerësimit të ofertave.

Me shkresën dt. 13.03.2020 operatori ñT.ò SHPK në përgjigje të shkresës nr. 1365/4, dt. 12.03.2020 të MSHMS ftesë për dhënie oferte ka paraqitur ofertën ñ*Çmimi për furnizimin dhe montimin e 54 copë respiratorë është* ***57,780,000*** *lekë (pesëdhjeteshtatëmilione shtatëqindetetëdhjemijë) ose 1,070,000 lekë/copa (Pa TVSH)"* oferta më e ulët e paraqitur.

Me shkresën nr. 1365/8, dt. 14.03.2020 kryetare e komisionit znj. M.Xh të vlerësimit i është drejtuar Titullarit të autoritetit kontraktor (Miratuar) për miratim të propozimit për përdorim të procedurës së drejtpërdrejtë për procedurën ñ*Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adulte dhe moshë pediatrike për COVID-19"* por *nuk janë përcaktuar dhe miratuar rrethanat e gjendjes në kushtet e interesave thelbësorë të shtetit*, kjo sipas përcaktimit të VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 *"Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit", pika II, Fusha e zbatimit; përcaktohet se: "..... Përpara fillimit të aplikimit të kësaj procedure,* ***rast pas rasti****, titullari i autoritetit kontraktor me urdhër miraton rrethanat e gjendjes në kushtet e interesave thelbësorë të shtetit dhe domosdoshmërinë e aplikimit të saj".*

Nga Komisioni i Vlerësimit janë hartuar seti i dokumenteve të tenderit ku është përcaktuar fondi limit prej 129,727,371 lekë pa tvsh, lloji i procedurës, kriteret e përgjithshme, kriteret e veçanta të kualifikimit, specifikimet teknike, sasia dhe grafiku i lëvrimit:

1-Respiratorë me dy modalitete për adulte dhe moshë pediatrike copë 54 me afat lëvrimi jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga lidhja e kontratës. Kur në ftesat për dhënie oferte është përcaktuar afati i lëvrimit jo më vonë se 7 (shtatë) ditë.

Deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike,
Deklarata mbi konfliktin e interesave,
Deklarata mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme,
Deklarata mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës.

Nga autoriteti kontraktor janë dërguar ftesa për oferta operatorëve ku bashkëngjitur kanë setin e dokumenteve të tenderit gjithsej 12 operatorë:

H...&L.... shpk
S... M....
F.... shpk
M.... shpk
T.....shpk
B..... shpk
F.... N... shpk
E..... shpk
M..... shpk
O.... D..... shpk
B.... E..... shpk
S..... shpk

Sipas procesverbalit të datës 18.03.2020 mbajtur nga komisioni i vlerësimit rezulton se në datën 18.03.2020 pranë zyrës së protokollit janë dorëzuar 11 zarfa të operatorëve ekonomikë si më poshtë:

H....&L.... shpk
F..... shpk
M.... shpk
T.....shpk
F..... N... shpk
E..... shpk
M..... shpk
O.... D.... shpk
B.... E... shpk
S..... shpk
M... S.... E.... shpk

Sipas procesverbalit të datës 19.03.2020 nga Komisioni i Vlerësimit ka bërë vlerësimin e ofertave sipas pikëve për vlerën e ofertës, koha e lëvrimit.

Sipas Vendimit të komisionit të vlerësimit nr. 1365/31 dt. 23.03.2020 në vend të parë është *riklasifikuar* operatori ñ**T.”** shpk me pikë totale 74.8 dhe ofertën **75,060,000** lekë pa tvsh. me afat lëvrimi 20 respiratorë do të lëvrohen për 7 ditë nga hyrja në fuqi e kontratës dhe 34 respiratorë do të lëvrohen për 25 ditë nga dita e hyrjes në fuqi e kontratës.

Ky operator me shkresën dt. 13.03.2020 në përgjigje të ftesës për dhënie oferte për sasinë prej 54 respiratorë ka ofruar çmimin 1,070,000 lekë për/copë me vlerën gjithsej 57,780,000 lekë me afat lëvrimi 7 deri 15 ditë, ku ndërkohë Komisioni i Vlerësimit mund të kishte filluar procedurën e vlerësimit të ofertave. Diferenca midis dy ofertave është (75,060,000 ï 57,780,000 = **17,280,000** lekë.)

Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor znj. G.P. ka dalë urdhri nr. 195, dt. 24.03.2020 për Negocimin e kontratës me objekt ñ*Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për covid-19*ò ku urdhërohet Komisioni i Vlerësimit ..... *të fillojë negocimin e*

*kontratës me kandidatin e shpallur fitues operatori ekonomik "T." SHPK*ò.
Gjithashtu me shkresën nr. 1365/35, dt. 24.03.2020 nga Autoriteti Kontraktor znj. G.P njoftohet për negocim kontrate operatori ñT.ò SHPKò ñ.... *Në mbështetje të kreut VI, pika 15, 16 të VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit" e ndryshuar duke qenë se jeni oferta fituese, njoftoheni të paraqiteni pranë MSHMS më datën 25.03.2020 <u>për të vijuar me negocimin e kushteve të kontratës</u> që do të lidhet ndërmjet jush dhe MSHMS".*
Nga Komisioni i vlerësimit në datën 25.03.2020 është negociuar kontrata ñ*Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adulte dhe moshë pediatrike për COVID-19"*, me operatorin fitues ku parashtrimit të kërkesës: ñ..... *për të negociuar në lidhje me afatet e lëvrimit pasi në dokumentet e tenderit afati i kërkuar është 54 respiratorë për 10 ditë* ....ò përfundimisht palët janë dakordësuar për afatet e lëvrimit nga 10 ditë që ishin kërkuar në dokumentet standarte në afatet e ofertuar nga operatori ñT.ò shpk. me afat lëvrimi 20 respiratorë do të lëvrohen për 7 ditë nga hyrja në fuqi e kontratës dhe 34 respiratorë do të lëvrohen për 25 ditë nga dita e hyrjes në fuqi e kontratës.
<u>Sa më lart nga KV është negociuar në kundërshtim me afatet e përcaktuara në dokumentet standarde. Nga Komisioni i vlerësimit duhej të negociohej vetëm sasia e cila plotësonte afatet e përcaktuara në dokumentet standarte pra vetëm sasia prej 20 respiratorë e cila do furnizohet sipas ofertës për 7 ditë në vlerën 20 x 1,390,000 lekë = 27,800,000 lekë. Për këtë sasi duhej të fillonte negocimi dhe duhej të lidhej kontrata.</u>
<u>Negocimi për sasinë e furnizuar me afate për 25 ditë denatyron procedurën e përzgjedhur me shkresën nr. 1365/8, dt. 14.03.2020 nga kryetare e komisionit të vlerësimit znj. M. Xh drejtuar Titullarit të autoritetit kontraktor (Miratuar) për miratim të propozimit për përdorim të</u> ***<u>procedurës së drejtpërdrejtë</u>*** *<u>për procedurën "Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adulte dhe moshë pediatrike për COVID-19"</u>*
"Operatori ekonomik "T." shpk shpreh gatishmërinë të respektojë afatet e lëvrimit të ofertuara në tender dhe për të cilat është vlerësuar me pikëzim edhe sipas kriterit të kohës së lëvrimit. Për shkak të situatës në nivel botëror dhe rajonal, në kushtet e pandemisë shkurtimi i afateve të lëvrimit është i pamundur".
"Komisioni Vlerësimit në përfundim pranon negocimin e ofruar nga ana juaj si operator ekonomik dhe përfundimisht propozojnë të vijojmë me nënshkrimin e kontratës me vlerën prej 75,060,000 lekë pa TVSH".
<u>Nga Komisioni i vlerësimit gjatë procesit të negocimit nuk është bërë objekt negocimi oferta e paraqitur nga ky operator në vlerën 57,780,000 lekë në përgjigje të ftesës për dhënie oferte nr. 1365/4, dt. 12.03.2020</u>
Nga autoriteti kontraktor MSHMS përfaqësuar nga G.P dhe operatori ñT.ò SHPK është lidhur kontrata e furnizimit nr.1365/36, dt. 27.03.2020 me objekt ñ*Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adulte dhe moshë pediatrike për COVID-19*ò me vlerën 75,060,000 lekë pa tvsh me afat lëvrimi 20 respiratorë do të lëvrohen për 7 ditë nga hyrja në fuqi e kontratës dhe 34 respiratorë do të lëvrohen për 25 ditë nga dita e hyrjes në fuqi e kontratës. Neni 15 ñ*Kohëzgjatja e kësaj kontrate është 25 (Njëzetepesë) ditë nga momenti i miratimit të kësaj kontrate nga Këshilli i Ministrave*ò. *<u>Kontrata duhej të lidhej vetëm për sasinë 20 respiratorë e cila do furnizohet sipas ofertës për 7 ditë në vlerën 20 x 1,390,000 lekë = 27,800,000 lekë.</u>*
Kontrata e mësipërme është miratuar me VKM nr. 274, dt. 03.04.2020 ñPër miratimin e kontratës me objekt ñ*Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adulte dhe moshë pediatrike për COVID-1*9ò.
Bashkëngjitur këtij vendimi është relacioni i Ministrit O. M për projektvendimin për miratimin e kontratës me objekt ñ*Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për Covid-19"* ku relatohet*; Qëllimi i projektvendimit, vlerësimi, argumentimi, Vlerësimi i ligjshmërisë, kushtetutshmërisë, harmonizimit me legjislacionin, vlerësimi i shkallës së*

përafrimit me legjislacionin europian, përmbledhja shpjeguese e përmbajtjes, personat dhe organet që ngarkohen për zbatimin e yij, Personat dhe institucionet që kanë kontribuar dhe raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore.
Mbas kërkesave të MSHMS për tu shprehur janë dërguar mendimet për projektvendimin nga institucionet:
- Agjencia e Prokurimit Publik me shkresën 2398/1, dt. 07.04.2020 ku shprehet parimisht dakord përsa ka kompetencë.
- Ministria e Drejtësisë me shkresën pa datë ku ndër të tjera shprehet se ..... si akt nënligjor me karakter individual nuk mund të trajtohet nga Ministria e Drejtësisë.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë ku shprehet pa vërejtje për sa kohë që shpenzimet e nevojshme do të përballohen brenda buxhetit të miratuar për MSHMS për vitin 2020.
Në zbatim të nenit 18 ñ*Ndjekja e kontratës*ò, ñ*Ndjekja e kontratës do t'i ngarkohet një grupi pune që do të ngrihet me urdhër të titullarit të autoritetit Kontraktor të cilët do të raportojnë tek Titullari i Autoritetit kontraktor* <u>*për realizimin e kontratës në sasi, kohë dhe cilësi, deri në përfundimin e saj*</u>ò me urdhrin nr. 230, dt. 03.04.2020 të znj. G.P është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës së furnizimit nr. 1365/36, dt. 27.03.2020 me objekt ñ*Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adulte dhe moshë pediatrike për COVID-1*9ò i përbërë nga L.P, N.Ç, L.A.
Ku nga grupi i punës kërkohet:

- Grupi i punës në varësi të kërkesave që kanë institucionet spitalore për respiratorë me dy modalitetet, duhet të hartojë një plan shpërndarje në bashkëpunim me titullarin e Autoritetit Kontraktor dhe t`ja komunikojë atë operatorit ekonomik ñT.ò SHPK.
- Grupi i punës ka për detyrë ndjekjen e zbatimin e kontratës koordinimin e procesit të shpërndarjes së respiratorëve në institucionet përfituese dhe të raportojë te titullari i Autoritetit kontraktor për realizimin në tërësi të kontratës dhe në veçanti për sasinë e lëvruar si dhe zbatimin e grafikut të lëvrimitò.
- Grupi i punës duhet të mbledhë nga institucionet përfituese, procesverbalin e marrjes në dorëzim dhe fletëhyrjen e magazinës së institucionit përkatës për çdo lëvrim që do të realizohet nga operatori ekonomik ñT.ò SHPK të cilat do ti dorëzohen sektorit të financës me shkresë shoqëruese.

Me urdhër nr. 214, 31.03.2020 Titullari i Autoritetit Kontraktor znj. G. P, ka urdhëruar:

- institucionet spitalore që do të furnizohen me respiratorë me dy modalitete të ngrenë grupet e marrjes në dorëzim të respiratorëve që do të dorëzohen nga Operatori ekonomik ñT.ò shpk i shpallur fitues.
- Grupet e punës të ngritura në zbatim të kontratës së furnizimit nr. 1365/36, dt. 27.03.2020 duhet të hartojnë procesverbalin e marrjes në dorëzim ku të jetë e evidentuar sasia dhe vlera e mallit të marrë në dorëzim i cili të jetë i firmosur nga të tre anëtarët e grupit të punës.
- Pas marrjes në dorëzim duhet të dorëzohet pranë MSHMS procesverbalit i marjes në dorëzim si dhe fletën e hyrjes në magazinën e institucionit përfitues, origjinale ose fotokopje të njehsuara me vulën e institucionit përfitues.
- Ngarkohen me ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri institucionet spitalore që do të jenë përfituese konform grafikëve të furnizimit të cilat do t`ju komunikohen rast pas rasti me email në adresat zyrtare në vartësi të nevojave respektive të çdo institucioni spitalor.

II.b Nga auditimi i procedurës *"Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHP"*e ndarë në 4 Lote, me fond limit në vlerën prej 29,008,273 lekë, nga KV me përbërje (J. J, S.N, E.H, J.S dhe E.A) janë negociuar kushtet e kontratës në lidhje me afatin e levrimit, duke u lënëfurnizimi për të gjithë sasinë e mallit,në mënyrë variabël nga 7 ditë deri në 55 ditë, nga 7 ditë

që ishte kërkuar në dokumentin ñFtesë për ofertëò sipas shkresës nr. 1621/2, datë 05.04.2021. Negocimi I afateve nga KV, duke i zgjatur ato përtej afateve të kërkuara, nuk justifikojnë*procedurën e përzgjedhur, e cila ka për qëllim përgjigjien emergjente ndaj situatës së pandemisë.*

II.c Nga auditimi i procedures ñ*Blerje Materiale Për Mbrojtje Personale Për Covid -19"* me fond limit prej 307,844,333lekë pa tvsh, nga Komisioni i Vlerësimit (me përbërje: M.Xh, J.D, F. B, J. J dhe S.K) në dokumentacionin ñFtesë për ofertëò është kërkuar që, jo më pak se 15% e sasisë së artikujve nga 1-9 të lëvrohen brenda 7 ditëve nga miratimi i kontratës me VKM, 75% e sasisë së artikujve nga 1-9 të lëvrohen sipas kërkesë së AK, por jo më vonë se 6 javë nga miratimi i kontratës me VKM., ndërsa për artikullin 10 (tampon laboratory) e gjithë sasia të lëvrohet jo më vonë se 8 javë nga miratimi i kontratës me VKM.

Pra, në këtë rast nga KV vetëm 15% e sasisë së kërkuar është në përmbushje të nevojës emergjentë brenda 7 ditëve, ndërsa pjesa prej 75% nuk na rezulton të jetë në këto kushte. Nëse do të krahasonim afatin e parashikuar me afatet që dikton Ligji per Prokurimin Publik, për paraqitjen e ofertave në ñProcedurën e hapurò kërkon jo më pak se 52 ditë, ndërsa për ñProcedurën me negocimò afati minimal është 15 ditë, pra dukshëm më pak se 6 jave deri në 8 javë (56 ditë). Përdorimi i VKM nr.203 nga MSHMS, synon realizimin në kohë sa më të shpejtë të barnave, pajisje dhe shërbimeve mjekesore, si reagim për përballimin e situatave që diktohen nga interest thelbësore të shtetit. Përzgjedhja e procedurës së drejtpërdrejtë, në kushtet kur afatet për lëvrimit e mallit rezultojnë të realizueshme edhe me procedura të tjera prokurimi, ka denatyruar ñemergjencënò e nevojës për materialet për mbrojtje personale Covid-19. Vendosja e afateve të till aka humbur konceptin e emergjencës, në kushtet kur nga prokurimi I drejtpërdrejte në fakt është përfituar vetëm 15% e nëvojës ekstreme.

Pra, KV (me përbërje: M.Xh, Kryetar dhe anëtarë: J.D, F. B, J.J dhe S. K) ka negociuar në kundërshtim me afatet e përcaktuara në dokumentacionin ñFtesë për ofertëò me argumentimin e nevojës për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit .

(**III)**-VKM nr 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar, pika IV-2(Procedura e drejtëpërdrejtë) dhe pika V, nuk ka të përcaktuar: mënyrën e përllogaritjes së fondit limit dhe ku duhet mbështetur ky fond (cmimet e botuara nga INSTAT, cmime tregu, cmime ndërkombëtare, cmime të kontratave të ngjashme, etj); natyrën e vendosjes së kritereve dhe mënyrën e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të ftuar nga AK.

Kështu nga ana e Komisionit të Vlerësimit, në mungesë të sa më sipër, gjatë realizimit të procedurave janë ñhuazuar mënyra dhe rregullatò sipas ligjit të prokurimit publik.

Si pasojë e sa më sipër, nga MSHMS, është kërkuar disa here asistencë nëpërmjet kërkesave on-line në Agjencisë e Prokurimit Publik, e cila shprehet se, në bazë të nenit 6 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimit publikò i ndryshuar: *"Ky ligj nuk zbatohet në përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike, në rast se zbatimi i tyre kërkon masa të veçanta sigurie, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi ose në rast se një gjë e tillë diktohet nga interesat thelbësore të shtetit.*

Si pasojë e këtyre mospërcaktimeve, në disa procedura kemi dështime të tyre, si vijon:

a-Nga auditimi i procedurës *"Blerje Barna Anti Covid -19" ndarë në 10 Lote* , me fond limit total 36,812,915 lekë, konkretisht *Loti 1* me objekt ñ *Blerje barna Hidroksichlorokinë 200 mg tableta"* me fond limt në vlerën prej 457,385.00 lekë dhe *Loti 4* me objekt ñ*Blerje barna Lopinavir/ritonavir*ò me fond limit në vlerën prej 179,458.00 lekë, kanë dështuar me argumentimin për shkak të mos pjesëmarrjes së OE.

Nga auditimi u konstatua se me shkresë nr.1573/3 prot. datë 29.03.2020 të MSHMS, Komisioni i Vlerësimit (me përbërje M. K, B.H, M.K, N.A dhe J.S) i është drejtuar operatorëve ekonomikë, ñR.. P..ò shpk, ñI...ò shpk, ñE....ò shpk, ñL... P...òshpk dhe ñD... P..ò shpk, për testim tregu për 11 barnat, por nga auditimi u konstatua se, jo për të gjithë barnat ka pasur oferta çmimesh të

argumentuar qartësisht, ndonëse KV shprehet se ñ*Komisioni për nxjerrjen e fondit limit u mbështet në mesatarizimin e çmimeve dhe ka përcaktuar si fond limit pa tvsh vlerën prej 36,812,915 lekë*...ò më konkretisht:

-Në këtë procedurë ishte planifikuar të realizohej dhe blerja për barin Remdesivir, por OE të përzgjedhur nga MSHMS, nuk kanë kthyer përgjigje, për pasojë Remdesivir nuk është futur në procedurë, ndonëse sipas OBSH, Remdesivir është pjesë e trajtimit të Covid-19 si dhe nga auditimi u konstatua se,bari Remdesivir (sasia 980 Flakon/Ampula) në momentin e hartimit të dokumentave të procedurës nuk ishte i regjistruar dhe asnjë OE nuk ishte i pajisur me leje importi nga MSHMS.

-Gjithashtu sipas procesverbalit nr.1573/4, datë 29.03.2020 për barin (Hidroksichlorokinë, Chlorochine phosphate, Ribavirin, Lopinavir/ritonavir), nga auditimi, u konstatua se ishin pa status rregjistrimi nga MSHMS si dhe operatorët ekonomikë të përzgjedhur nga KV, në momentin e përllogaritjes së fondit limit nuk kishin leje importi për këto barna, për rrjedhojë **nga ana e KV (**me përbërje (M.K, B.H, M.K, N. A dhe J.S) **nuk del e qartë se cilave çmimeve iu është referuar Komisioni i Vlerësimit për përllogaritjen e fondit limit.**

Kështu, nga KV është cituar se bari Hidroksichlorokinë është i pajisur me leje importi për 2020, sipas PV nr.1573/5 datë 29.03.2020, por nga auditimi i Autorizimeve Importi për barnat të paregjistruara, për vitin 2020 lëshuar nga MSHMS, u konstatua se për barin, (Hidroksichlorokinë Autorizimi nr.55, është marrë më datë 03.07.2020, pra katër muaj më pas, nga OE ñE..ò me çmim 17.8 Euro për kuti), ndërsa vlera e përllogaritur nga KV jepet me tableta. Ndërsa për barin (Lopinavir/ritonavir),grupi i auditimit, iu referua Autorizimeve Importi për barnat të paregjistruara, për vitin 2019 lëshuar nga MSHMS për QSUNT me nr.80 datë 26.08.2019, forma/doza paketimi 200mg/50 mg Box x120 dhe Box x 30, me cmime për kuti 60.80 USD & 32.88 USD për kuti) ndërsa për procedurën është kërkuar Shurup 60 ml/8-mg +20 mg.

Pra, për këto dy raste nuk del e qartë përllogaritja e fondit limit nga KV.(*Trajtuar më hollësisht në pikën 2*)

b-Nga auditimi i procedurës për Loti II me objekt ñ*Trajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19*ò, me fond limit në vlerën prej 3,144,150 lekë pa tvsh, KV me përbërje (J.J, S.N, E.H, J.S dhe E.A) për përllogaritjen e fondit limit është bazuar në vlerësimin e **bërë nga QSUT** sipas shkresës nr.1387/4 prot datë 17.03.2020, me periudhë shërbimi për 3 muaj. Nga auditimi u konstatua se, në përllogaritjen e fondit limit për mbetjet ku përfshihen (veshje njëpërdorimshe, mbetje konsumi ushqimi, age, ampula, shishe serumi qelq/plastike, sistem perfuzioni, etj), është përllogaritur në vlerë prej **510 lekë pa tvsh**, vlerë e cila nuk është e kostuar duke e ndarë specifikisht në këto elementë (shpenzime transporti,trajtim/Incenerimi,ambalazhim& materiale, punëtoria, landfilli, kosto operative,etj).

Grupi i auditimit, duke bërë përdorur metodën krahasimore, kryqëzoi të dhënat me punën audituese të grupit të auditimit të KLSH-së paralel pranë QSUNT, nga ku u evidentua se, për vazhdimin e kësaj kontrate, nga AK i QSUNT është tenderuar në bazë të ligjit të prokurimit publik për vazhdimësi të këtij shërbimi dhe i njëjti OE, ñE R.ò shpk, me vlerë të costuar për njësi prej **336 lekë pa tvsh** (ose 174 leke/njësi më pak nga sa përllogaritur nga KV në MSHMS).

Sa më sipër, në të dyja rastet kemi të njëjtin shërbim, por me me vlera për njësi të ndryshme, pasi sipas VKM nr.203, datë 26.02.2020 ñProcedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetitò i ndryshuar, **nuk** përcaktohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit duke lënë shteg për interpretime të ndryshme nga AK, e duke e justifikuar si situatë e panjohur më parë. Konstatuam se, KV është munduar të gjejë ñmënyra alternative përllogaritjejeò, të cilat në fakt janë të njëjta duke iu referuar procedurave normale të prokurimit publik. Nga KV, kjo ñpërllogaritjeò **nuk** është e shoqëruar me dokumentacion referuar çmimeve, të cilat mund të siguroheshin nga negocimet e drejtëpërdrejta me operatorë ekonomikë të cilët operonin në tregun

shqiptarë ose ndërkombëtarë, të cilët jepnin garanci për të siguruar në kohë artikujt e domosdoshëm për përballimin e situatës së krijuar nga Covid -19.

(III)Në VKM nr. 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar, **nuk** është parashikuar elementi i monitorimit të ekzekutimit të kontratave të përftuara. Nga auditimi u konstatua se, vetëm në procedurën ñFurnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19ò, është ngritur grupi monitorimit; ndërsa në procedurat e tjera nuk është ngritur grupi i monitorimit.

Nga MSHMS, është mjaftuar vetëm me ngritjen e komisioneve të marrjes në dorëzim të mallit, barnave, shërbimeve etj, pranë Qendrave Unisversitare Spitalore ñNënë Terezaò dhe ñShefqet Ndroqiò, si pasojë, rezultoi se ka munguar gjurma e kontrollit, nuk rezultojnë informacione përmbledhëse për përputhshmërinë, korrektësinë financiare dhe cilësinë e zbatimit të kontratës në mënyrë të vazhdueshme, për të parë efektivitetin, eficiencën dhe ekonomicitetin, e fondeve të siguruara nga Buxheti i Shtetit.

(IV)-Nga auditimi dhe studimi i VKM nr 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar, nisur nga teknika legjislative, duhet të rishikohet baza ligjore e përdorur për nxjerrjen e këtij vendimi, me qëllim përcaktimin e dispozitave që, në kuptimin e nenit 118 të Kushtetutës, autorizojnë nxjerrjen e këtij akti nënligjor nga Këshilli i Ministrave, çështjet që duhen rregulluar si dhe parimet në bazë të të cilave nxirret ky akt.

Neni 118

1.Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë.

2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.

3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t'ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër.

(V) Nga auditimi dhe studimi i VKM nr. 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar, konkretisht sipas VKM nr.242 datë 22.03.2020 ñPër disa shtesa në VKM nr.203 datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësore të shtetitò, pika 2 shprehet se ñ*Për procedurën e drejtëpërdrejtë, të përcaktuar në nënndarjen IV.1, të kreut IV, të këtij vendimi,* ***nuk*** *zbatohet dispozita e parashikuar për procedurën e ankimit*.ò. Mos parashikimi i këtij kriteri, mbart risqe pasi OE nuk mund ta ushtrojnë të drejtën e ankimimit, nëse i lind nevoja.

(VI) Gjithashtu nga auditimi ekzekutimit të kontratave u konstatua se, detyrimet nga MSHMS, janë shlyer përtej afatit 30 ditor që është detyrimi ligjor për kryerjen e pagesave, **në kundërshtim** me ligjin nr. 48/2014 ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò, ku në nenin 7 lidhur me afatin e pagesave për autoritetet publike, përcaktohet se ñ*<u>Në veprimet juridike tregtare, në të cilat debitori është autoritet publik</u>, pas mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit nga debitori, sipas nenit 463 të Kodit Civil, dhe: a) kur kreditori i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij, sipas ligjit dhe kontratës; b) kur kreditori nuk është paguar, me përjashtim të rastit kur vonesa nuk ka ardhur për faj të debitorit; c) kur nga kontrata apo nga ndonjë dispozitë tjetër ligjore nuk mund të përcaktohet ndonjë afat a datë për kryerjen e pagesës, <u>afati i pagesës nuk duhet të jetë më i gjatë se: i) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes nga ana e debitorit të faturës ose të një kërkesëpagese të njëvlershme</u>; ii) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve, kur nuk është e qartë data e marrjes së faturës ose kërkesë pagesës së njëvlershme*ò dhe **në kundërshtim** me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, ku në nenin 52 përcaktohet se ñ*Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, <u>brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik</u>*ò

Në lidhje mbi problematikat e konstatuara, nga grupi i audituesve u mbajt Akt-konstatimi nr.6 datë

30.04.2021 me nr.415/19 prot të MSHMS, të cilët kanë observuar me shkresë nr.415/28 prot, datë 07.05.2021 të MSHMS. Kanë observuar përfaqësuesit e MSHMS, si vijon :S.K, J.J, A.P, J.D, M.Xh, F.B, J.S, E.H, S.N, E.L, N.A, E.K, E.A, M.K, B.H dhe M.K si dhe me observimet nga MSHMS në lidhje mbi Projekt raportin e përcjellë nga KLSH me shkresë nr.121/10 prot datë 03.09.2021, të cilat kanë ardhur më datë 14.10.2021 jashtë afatit kohor të parashikuar në ligjin 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò neni 26 dhe 29 me shkresë nr.415/47 prot të MSHMS dhe me nr.121/11 prot datë 14.10.2021 të KLSH.
Sa më sipër, audituesit e KLSH, i ri vlerësuan dhe observimet e dyta, të cilat nuk kanë paraqitur dokumentacion shtesë apo argumentim ligjor shtesë në lidhje mbi problematikën e konstatuar, për këtë qëllim, audituesit shprehen me të njëjtin qëndrim, si vijon:

Grupi i auditimit pasi i shqyrtoiobservimet e paraqitura, mban këtë qëndrim si më poshtë vijon.

Pretendimi i subjektit:
1.Kontratat janë miratuar me VKM në kohë rekord duke patur parasysh kohën proceduriale që parashikon miratimi i nje VKM.
Konkretisht afatet variojne nga 3 ï 12 dite gjë e cila është në përputhjë të plotë me parashikimet e VKM nr 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar pika VII (Miratimi i Kontratës) pika 2 thuhet se:
2 Në rastet kur kontrata nuk miratohet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga Këshilli i Ministrave, atëherë procedura do të quhet e anulluar."
2.Konstatimi i kryer nga KLSH-ja lidhur me negociatat e afateve e lëvrimit të kërkuara nga AK në ftesën për ofertë, nuk qendron pasi sipas ketyre ftesave, atatet e levrimit jane vendosur si elemente per vleresimin e ofertave duke iu dhene nje peshe te caktuar ne qellim vleresimin e ofertes ekonomikisht me te favorshme dhe ne intervale kohore maksimale dhe minimale.
Afatet e levrimit jane percaktuar ne kontratat e miratuara me VKM ne perputhje me ofertat e OE te shpallura si oferta te suksesshem dhe ne asnje dokument nuk rezulton të jene negociuar këto afate qoftë nga KV qofte nga AK, ndaj ky konstatim është i pa bazuar në dokumente dhe nuk qëndron.
lidhje me pikën ñaò Qëllimi kryesor i komisionit ka qënë sigurimi në kohë i respiratorëve me qellim furnizimin e spitaleve me keto aparatura jeteshpetuese, por deshirojme te thekesojme se nje detaj i rendesishem i percaktuar ne VKM nr. 203, dt. 26.02.2020, ñPer procedurat qe perdoren per lidhjen e kontratave qe diktohen nga interesa thelbesore te shtetitò, i ndryshuar., eshte fakti qe vleresimi nuk behet me cmim por me pikezim e pikerisht komisioni ka vleresuar duke ju permbajtur parimit te barazise dhe i ka trajtuar ne menyre te barabarte te gjithe ofertuesit e për këtë arsye nuk ka bere skualifikimin e asnjerit prej ofertuesve të paraqitur në, por ka bere pikezimin sipas peshave te vendosura *per cmim dhe per afat levrimi.*
Gjithashtu sqarojmë një detaj shumë të rëndësishëm që është i përcaktuar në VKM nr. 203, dt. 26.02.2020, ñPer procedurat qe perdoren per lidhjen e kontratave qe diktohen nga interesa thelbesore te shtetitò, konkretisht hapësira për negocimin ndërmjet operatorëve të paraqitur, e pikërisht Komisioni i Vlerësimit këtë gjë ka realizuar ka negociuar jo vetëm për cmimin por edhe për afatet e paraqitura në ofertën e cdo operatori.
KLSH ka arsyetur ne kushte normale duke evidentuar faktin e realizimit të procedurës duke ju përmbajtur strik afatit të lëvrimit të vendosur por nuk ka arsyetuar aspak kushtet e një mbylljeje globale të të gjithë tregut dhe ku rëndësia më e madhe ishte përmbyllja e një negociazte të sukseshme me afatin më të përafërt me atë të përcaktuar në procedurë.
3.Komisioni i Vlerësimit i ngritur për procedurën me objekt ñBlerje Materiale Për Mbrojtje Personale Për Covid -19ò, gjatë gjithë punës së vetë ju referua Vendimit te Komitetit Teknik ku shprehet domosdoshmeria e sigurimit te mjeteve mbrojtese por edhe krijimi i nje stoku per siguri.Duke ju referuar përcaktimeve të bëra në VKM nr. 203, dt. 26.02.2020, ñPer procedurat qe perdoren per lidhjen e kontratave qe diktohen nga interesa thelbesore te shtetitò, komisioni analizoi me përpikmëri të gjitha kushtet në të cilat ndodhej dhe përdori procedurën me negocim kjo për arsye të afateve më të shkrutëra dhe emergjencës që kishte për sigurimin e mjeteve mbrojtëse. Duke parë sasitë e mëdha që kërkoheshin, si dhe informacionin e marrë nga gjendja e tregut global , Komisioni vleresoi qe te krijonte disa fasha te levrimit me qellim sigurimin e nje sasie imediate prenda 7 diteve dhe pjesen tjeter te vendoste nje afat pak me te gjate pasi ai do te ishte per stokun, por nga ana tjeter benefitet e vendosjes se ketyre afateve jane:
Ulja e cmimit pasi i lejon operatoreve mundesi per te siguruar oferta me te uleta;
Sigurimi ne nje kontrate te vetme e nje sasie te konsiderueshme duke ngjallur interes per ofertuesin;
Sa më sipër, lidhur me konstatimin e KLSH-se per humbje te kushteve te emergjences vlerësojmë se nuk qëndron pasi sqarojmë dhe vëmë ne dukje se gjendja e fatkeqesise natyrore zgjati deri me date 23.06.2020,

dhe nderkohe ende edhe sot qe flasim vazhdojme te jemi ne gjendjen e pandemise boterore. Një tjetër fakt i rëndësishëm është se që KLSH të arrijë në konkluzionin se ka humbur gjendja e emergjencës duhet të ketë të gjitha faktet shkresore dhe të mbështetura në prova dhe ne akte ligjore që të provojë se MSHSM nuk ka përmbushur nevojat me materiale mbrojtese.
Ndërkohë që MSHSM provon se kontrata e lidhur per proceduren me objekt ñBlerje materiale për mbrojte personale (MMP) për COVID-19ò, rezultoi nje procedure e suksesshme e realizuar 100% brenda te gjitha kushteve dhe afateve te percaktuara, pa shkaktuar asnjë vonesë dhe duke mos lënë spitalet pa plotësim nevojash.Për sa më sipër cituam ky pretendim nuk qëndron.
4.Mbi auditimin e procedures ñ*Blerje Barna Anti Covid -19" ndare ne 10 lote*, per lotin 1 dhe 4 respektive ñPer blerjen e barit Hydroxychloroquine dhe Lopinavir/ritonavir ne forme dozen 80 mg + 20 mg / 60 mlò, per menyren e perllogaritjes se fondit limit per keto dy barna ju bejm me dije se:
Sipas VKM nr 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar, nuk ka parashikime sesi duhet te kryhet përllogaritja dhe hartimi i fondit limit pra nuk ka dispozitë që përcakton se duhet përdorur apo jo një analizë e qartë kostosh. Dy procedurat e identifikuara me metodën krahasimore nga grupi i auditit janë dy procedura të ndryshme prokurimi, të kryera në momente të ndryshme në kohë gjatë kohëzgjatjes së pandemisë dhe lockdoën-it nga AK të ndryshme prandaj krahasimi midis tyre nuk qëndron.
5.Për te gjitha kontratat e lidhura jane deleguar kompetencat e monitorimit te kontratave prane institucioneve perfituese si institucione qe marrin ne dorezim mallin.
<u>Qëndrimi i grupit të auditimit.</u>
1. VKM nr. 203, dt. 26.02.2020,shprehet se, ñ*Në rastet kur kontrata nuk miratohet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga Këshilli i Ministrave, atëherë procedura do të quhet e anulluar* ñ, pra kontratat respektive sipas VKM-së 203, nëse nuk miratohen për 90 ditë, duke të anullohen, duke lënë hapësirë që Këshilli i Ministrave, mund ti miratojë kur të mundet brenda 90 ditëve, duke humbur sensin e kohës , pasi për situatën e Covid-19 që kërkonte zgjidhje të shpejtë. Kështu, në ftesat për ofertë që MSHMS, ka kërkuar pranë OE që barnat/pajisjet,materiale laboratori etj të sigurohesh për disa ditë, këtyre ditëve i është shtuar dhe koha që ka marrë KM për miratimin, ndonëse situata pandemike , kërkonte të siguroheshin sa më shpejt shërbimet, barnat, pajisjet e cdo gjë në funksion të përballimit të situatës, që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit **2**.Sipas VKM nr 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar,nuk është parashikuar elementi i monitorimit të ekzekutimit të kontratave të përftuara , kështu, nga auditimi u konstatua se, vetëm në procedurën ñFurnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19ò, është ngritur grupi monitorimit ndërsa në procedurat e tjera nuk është ngritur grupi i monitorimit.
Nga MSHMS, është mjaftuar vetëm me ngritjen e komisioneve të marrjes në dorëzim të mallit, barnave,shërbimeve etj, pranë Qëndrave Unisversitare Spitalore ñNënë Terezaò dhe ñShefqet Ndroqiò, si pasojë, rezultoi se ka munguar gjurma e auditimit, që lidhet me përgatitjen e informacionit përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës në mënyrë të vazhdueshme.
3.Grupi i auditimit të KLSH, nuk ka arritur në asnjë konkluzion që ka ñhumbur gjëndja e emergjencësò, pasi tashmë (blerja e barnave/Covid, pajisjet mbrojtese Covid, pajisje Covid, shërbimeCovid) nuk realizohem sipas VKM nr. 203, dt. 26.02.2020, ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbesore te shtetitò i ndryshuar, por në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik.
4.Grupi i audituesve, ka konstatuar se VKM nr. 203, nuk ka përcaktuar rregulla, për mënyrën se si do të realizoheshin, segmentet e procedurës, kjo ka sjellë që AK, nuk ka ndjekur të njëjtën mënyrë psh në hartimin e fondit limit.
Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Titulli i Gjetjes:	Ndryshime dhe përmirësime ligjorë përVKM nr. 203, dt. 26.02.2020, ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetitò i ndryshuar, pasi vendi Shqipëria mund të përballet në situata të tjera që diktohen nga interesa shtetërore.
Situata :	Këshilli i Ministrave, në kushtet e emergjencës prej pandemisë Covid-19, gjatë periudhës mars ï prill 2020 për parandalimin e saj, ka nxjerrë disa akte nën ligjore, ndër to edhe VKM nr. 203, datë 26.02.2020 ñ*Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit*ò. Sipas kësaj VKM, çdo kontratë që do të lidhet në zbatim të saj, do të miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Nga auditimi konstatohet se, përmbajtja e kësaj VKM, nuk i ka shërbyer situatave emergjente për lehtësimin e pasojave nga fatkeqësia natyrore, pasi përmbajtja e saj ka krijuar disa hapësira në lidhje me, zgjatjen e afateve kohore të furnizimit të medikamente, materiale mjekësore apo shërbimeve shëndetësorë, me llogaritjet në mënyrë apriori apo subjektive të vlerave të këtyre kontratave, me mënyrën subjektive dhe klienteliste të përzgjedhjes së operatorëve furnizues, me

formalizma për monitorimin e zbatimit të kontratave, etj.
Kështu, në zbatim të VKM nr. 203, datë 26.02.2020, autoriteti kontraktor (MSHMS) gjatë periudhës së pandemisë ka realizuar 7 (shtatë) procedura prokurimi, nga auditimi i të cilave u konstatuan disa anomali, në lidhje me furnizimin dhe shërbimet emergjente të diktuara nga pandemia, si më poshtë:
Gjithashtu kemi konstatuar se:
(I) Sipas VKM nr 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar pika VII (Miratimi i Kontratës) thuhet se: ñ*1.Kontratat, që diktohen nga interesat thëlbësore të shtetit pas nënshkrimit të tyre, do të miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Kontrata do të hyjë në fuqi pas këtij miratimi. Ky kusht do të jetë i specifikuar edhe në kontratën e nënshkruar ndërmjet palëve dhe në dokumentet e procedurës garuese; dhe*
2.Në rastet kur kontrata nuk miratohet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga Këshilli i Ministrave, atëherë procedura do të quhet e anuluar."
Nga auditimi u konstatua se, kontratat, produkte të VKM nr.203, datë 26.02.2020 janë miratuar me VKM respective, duke filluar nga 7 ditë deri në 10 dhjetë ditë më vonë nga data e lidhjes së kontratës duke bërë që të çedojë *"faktori kohë*ò, në kushtet e emergjencës prej pandemisë Covid 19. Për sa më sipër, u konstatua, miratimi me VKM-të respektive:
1-Procedura ñBlerje Barna Anti Covid -19ò ndarë në 10 Lote, me fond limit total 36,812,915 lekë.
Loti 5-Oseltamivir(Tamiflu) është lidhur kontrata me nr.1573/28, datë 06.04.2020, miratuar VKM nr.314, datë 18.04.2020 (12 ditë më vonë)
Loti 8-Omeprazol është lidhur kontrata me nr.1573/31, datë 07.04.2020, miratuar me VKM nr.313, datë 18.04.2020 (11 ditë më vonë).
Loti 9-Propofol, është lidhur kontrata me nr.1573/30, datë 06.04.2020, miratuar me VKM nr.320, datë 18.04.2020 (12 ditë më vonë).
Loti10-Beclomethasone+salbutamol është lidhur kontrata me nr.1573/32 datë 07.04.2020, miratuar me VKM nr.315, datë 18.04.2020 (11 ditë më vonë).
2-Procedura ñFurnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19ò me fond limit 129,727,371 lekë pa tvsh.
Është lidhur Kontrata e furnizimit me nr.1365/36 datë 27.03.2020, miratuar me VKM nr.274, datë 03.04.2020 (7 ditë më vonë).
3-Procedura ñBlerje Materiale Për Mbrojtje Personale Për Covid -19ò me fond limit prej 307,844,333lekë pa tvsh.
Është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1366/18, datë 18.03.2020, miratuar me VKM nr.241 datë 21.03.2020 (11 ditë më vonë).
4-Procedura ñBlerje kite dhe reagent dhe evadim mbetje anti COVID-19ò, ndarë me 2 Lote.
-Loti I ñBlerje kite dhe reagentë për Laboratorin Mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisjen e Existation të firmës Bioner ose ekuivalentò, është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1574/13, datë 30.03.2020, miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020.
-Loti II ñTrajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19, është lidhur kontrata me nr.1574/12, datë 30.03.2020 , miratuar me VKM nr.273, datë 03.04.2020.
5-Procedura ñFurnizim me produkte letre një përdorimëshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjenike për pacientët me Covid-19 dhe personelin mjekësor.*"*
Është lidhur Kontrata e furnizimit me nr.1575/18, datë 07.04.2020, miratuar me VKM nr.323 datë 18.04.2020.
6-Procedura ñSpostimi i sistemit të dializës nga Pediatria e Specialiteteve tek godina e Spitalit Infektiv(Shërbimi i Alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me Covid-19òështë
lidhur kontrata nr.1575/19, datë 07.04.2020 , miratuar me VKM nr.323 datë 18.04.2020.
7-Procedura ñBlerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPòe ndarë në 4 Lote
-Loti I ñBlerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent ekuivalent

	në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò është lidhur kontrata me nr.1776/11 datë 14.04.2020 , miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020. -Loti i II ñBlerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò, është lidhur kontrata me nr.1776/13, datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.316, datë 18.04.2020. Loti i III ñBlerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò, është lidhur kontrata me nr.1776/12, datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.317, datë 18.04.2020. Pra, sipas VKM-së 203 për (Procedurën e drejtëpërdrejtë), nëse nuk miratohen për 90 ditë kontrata, duke të anullohen, duke lënë hapësirë që Këshilli i Ministrave, mund tõ miratojë kur të mundet brenda 90 ditëve, duke humbur sensin e kohës, pasi situata e Covid-19 kërkonte zgjidhje të shpejtë. Është, në ftesat për ofertë që MSHMS, ka kërkuar pranë OE që barnat/pajisjet,materiale laboratori etj të siguroheshin për disa ditë, këtyre ditëve i është shtuar dhe koha që ka marrë KM për miratimin, ndonëse situata pandemike, kërkonte të siguroheshin sa më shpejt shërbimet, barnat, pajisjet e çdo gjë në funksion të përballimit të situatës, që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit. **(II)** VKM nr 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar, pika IV-2 ñProcedura e drejtëpërdrejtëò dhe pika V, **nuk** ka të përcaktuar; mënyrën e përllogaritjes së fondit limit dhe ku duhet mbështetur ky fond si, çmimet e botuara nga INSTAT, çmimet e tregut, çmimet ndërkombëtare, çmimet e kontratave të ngjashme, etj; natyrën e vendosjes së kritereve dhe mënyrën e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të ftuar nga AK. Si pasojë e mungesës së sa më sipër, MSHMS, disa herë ka kërkuar edhe asistencë nëpërmjet kërkesave on-line në Agjencisë e Prokurimit Publik, e cila me arsyetimin shprehet se, në bazë të nenit 6 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimit publikò i ndryshuar, *"Ky ligj nuk zbatohet në përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike, në rast se zbatimi i tyre kërkon masa të veçanta sigurie, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi ose në rast se një gjë e tillë diktohet nga interesat thelbësore të shtetit,* për rrjedhojë nuk është shprehur në asnjë rast të kërkuar, për asistencë për VKM nr 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar. Si pasojë e mospërcaktimeve të mësipërme, kanë dështuar disa procedura, si vijon: **a-**Nga auditimi i procedurës *"Blerje Barna Anti Covid -19" ndarë në 10 Lote* , me fond limit total 36,812,915 lekë, konkretisht *Loti 1* me objekt ñ *Blerje barna Hidroksichlorokinë 200 mg tableta"* me fond limt në vlerën prej 457,385.00 lekë dhe *Loti 4* me objekt ñ*Blerje barna Lopinavir/ritonavir*ò me fond limit në vlerën prej 179,458.00 lekë, kanë dështuar me argumentimin për shkak të mos pjesëmarrjes së OE. Nga auditimi u konstatua se, me shkresë nr.1573/3 prot datë 29.03.2020 të MSHMS, Komisioni i Vlerësimit, i është drejtuar operatorëve ekonomikë, ñR...P...ò shpk, ñI...ò shpk, ñE...ò shpk, ñL... P...òshpk dhe ñD.. P...ò shpk, për testim tregu për 11 barnat, por nga auditimi u konstatua se, jo për të gjithë barnat ka pasur oferta çmimesh të argumentuar qartësisht, ndonëse KV shprehet se ñ*Komisioni për nxjerrjen e fondit limit u mbështet në mesatarizimin e çmimeve dhe ka përcaktuar si fond limit pa tvsh vlerën prej 36,812,915 lekë*...ò më konkretisht: -Në këtë procedurë ishte planifikuar të realizohej dhe blerja për barin Remdesivir, por OE të përzgjedhur nga MSHMS, nuk kanë kthyer përgjigje, për pasojë Remdesivir nuk është futur në procedurë, ndonëse sipas OBSH, Remdesivir është pjesë e trajtimit të Covid-19 si dhe nga auditimi u konstatua se, bari Remdesivir (sasia 980 Flakon/Ampula) në momentin e hartimit të dokumentave të procedurës nuk ishte i regjistruar dhe asnjë OE nuk ishte i pajisur me leje importi nga MSHMS. -Gjithashtu sipas procesverbalit nr.1573/4, datë 29.03.2020 për barnat: Hidroksichlorokinë, Chlorochine phosphate, Ribavirin, Lopinavir/ritonavir, nga auditimi, u konstatua se ishin pa status rregjistrimi nga MSHMS; si dhe operatorët ekonomikë të përzgjedhur nga KV, në momentin e përllogaritjes së fondit limit nuk

kishin leje importi për këto barna, për rrjedhojë nga ana e KV nuk del e qartë se cilave çmimeve u janë referuar për përllogaritjen e fondit limit.
Kështu, nga KV është cituar për barin, Hidroksichlorokinë është e pajisur me leje importi për 2020 sipas PV nr.1573/5 datë 29.03.2020, por nga auditimi i Autorizimeve Importi për barnat të paregjistruara, për vitin 2020 lëshuar nga MSHMS, u konstatua se për barin Hidroksichlorokinë, Autorizimi nr.55 është marrë më datë 03.07.2020, pra katër muaj më pas. Ndërsa për barin Lopinavir/ritonavir, KLSH, iu referua Autorizimeve Importi për barnat të paregjistruara, për vitin 2019 lëshuar nga MSHMS për QSUNT me nr.80 datë 26.08.2019, forma/doza paketimi 200mg/50 mg Box x120 dhe Box x 30, ndërsa për procedurën është kërkuar Shurup 60 ml/8-mg +20 mg, të cilat nuk përkojnë me të njëjtin çmim. Pra, për këto dy raste nuk del e qartë përllogaritja e fondit limit nga KV.
b- Nga auditimi i procedurës për Loti II me objekt ñ*Trajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19*ò, me fond limit në vlerën prej 3,144,150 lekë pa tvsh, KV për përllogaritjen e fondit limit është bazuar në vlerësimin e bërë nga QSUT sipas shkresës nr.1387/4 prot datë 17.03.2020, me periudhë shërbimi për 3 muaj. Nga auditimi u konstatua se, në përllogaritjen e fondit limit për mbetjet ku përfshihen: veshje një përdorimshe, mbetje konsumi ushqimi, age, ampula, shishe serumi qelq/plastike, sistem perfuzioni, etj, është përllogaritur në vlerë prej **510 lekë pa tvsh**, vlerë e cila **nuk** është e kostuar duke u ndarë në elementë si: shpenzime transporti, trajtimi/Incenerimi, ambalazhim & materiale, punëtoria, landfilli, kosto operative, etj.
KLSH, kryqëzoi të dhënat me punën e grupit të auditimit të KLSH-së paralel pranë QSUNT, nga ku u evidentua se, për vazhdimin e kësaj kontrate, nga AK i QSUNT është tenderuar në bazë të ligjit të prokurimit publik për vazhdimësi të këtij shërbimi dhe i njëjti OE, ñE... R...òshpk, me vlerë të kostuar për njësi prej **336 lekë pa tvsh** (ose 174 leke/njësi më pak nga sa përllogaritur nga KV në MSHMS).
Sa më sipër, në të dyja rastet kemi të njëjtin shërbim, por me me vlera për njësi të ndryshme, pasi sipas VKM nr.203, datë 26.02.2020 ñProcedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetitò i ndryshuar, **nuk** përcaktohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit duke lënë shteg për interpretime të ndryshme nga AK, e duke e justifikuar si situatë e panjohur më parë.
Nisur nga sa më sipër, konstatuam se, KV ka gjetur ñmënyra alternative përllogaritjejeò, të cilat në fakt janë të njëjta duke iu referuar procedurave normale të prokurimit publik, por nga KV, kjo ñpërllogaritjeò **nuk** është e shoqëruar me dokumentacion referuar çmimeve.
(III) Sipas VKM nr. 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar, **nuk** është parashikuar elementi i monitorimit të ekzekutimit të kontratave të përftuara, kështu, nga auditimi u konstatua se, vetëm në procedurën ñFurnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19ò, është ngritur grupi monitorimit ndërsa në procedurat e tjera nuk është ngritur asnjë grup i tillë.
MSHMS, është mjaftuar vetëm me ngritjen e komisioneve të marrjes në dorëzim të mallit, barnave,shërbimeve etj. Si pasojë, ka munguar gjurma e auditimit për këto procese dhe nuk rezultojnë të jenë përgatitur informacione përmbledhës për përputhshmërinë, korrektësinë financiare dhe cilësinë e zbatimit të kontratës në mënyrë të vazhdueshme, për të parë efektivitetin, eficiencën dhe ekonomicitetin, e përdorimit të fondeve të siguruara nga Buxheti i Shtetit.
(IV) a. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 118 pika 2 të parashikon se: ñ*Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte"*.
b. Neni 6 i Ligjit të Prokurimit Publik (*ku është mbështetur KM për nxjerrjen e kësaj VKM*) nuk autorizon nxjerrjen e një Akti Normativ të Veçantë për kontratat sekrete, kontratat që kërkojnë masa të veçanta sigurie dhe kontratat që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit.
c. VKM nr. 203 nuk ka përcaktuar përkufizimin e gjendjes, rrethanave, apo rasteve kur kemi të bëjmë me ñ*interesa thelbësorë të shtetit*ò por këto rrethana i ka lënë rast pas rasti në vlerësim të autoriteteve kontraktore; Pra, në kushtet kur termi ñ*interesa thelbësorë të shtetit*ò nuk ka gjetur një rregullim ligjor, ngelet një situatë abstrakte e pa përkufizuar dhe në vlerësimin subjektiv të çdo autoriteti duke rritur riskun për

	arbitraritet. **(V)** Nga auditimi dhe studimi i VKM nr. 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar, konkretisht sipas VKM nr.242 datë 22.03.2020 ñPër disa shtesa në VKM nr.203 datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësore të shtetitò, pika 2 shprehet se ñ*Për procedurën e drejtëpërdrejtë, të përcaktuar në nënndarjen IV.1, të kreut IV, të këtij vendimi,* ***nuk zbatohen dispozitat e parashikuara për procedurën e ankimit***.ò. Mos parashikimi i këtij kriteri, mbart risqe pasi OE nuk mund ta ushtrojnë të drejtën e ankimimit, nëse i lind nevoja.
Kriteri:	VKM nr. 203, dt. 26.02.2020, ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetitò i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	- në disa raste dështime të procedurave dhe të kontratave -në disa raste nuk janë siguruar në kohë barnat, pajisjet dhe shërbimet, për përballimin e situatës Covid-19 - fond limit I pambështetur -raste kur nuk është kryer monitorimi I zbatimit të kontratave
Shkaku:	**1.** AK nuk i është referuar LPP për përzgjedhjen e procedurave në rsatin e një nevoje ekstreme të shkaktuara nga ngjarje të paparashikuara. **2.** Vakumet që ka VKM nr. 203, dt. 26.02.2020, ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetitòi ndryshuar si: - Vendosja e pikave 1 dhe 2, Kreu VII ñMiratimi i Kontratësò, kuparashikohet se nëse kontrata nuk miratohet për 90 ditë, ajo anullohet, lë hapësirë që Këshilli i Ministrave, të mund të shtyjë miratimin deri në 90 ditë nga data e lidhjes së kontratës, duke cënuar kështu kriterin e ñemergjencësò, pasi situata e Covid-19 kërkonte zgjidhje të shpejtë. - mungon parashikimi I mënyrës së përllogaritjes së fondit limit - mungon parashikimi mbi monitorimin e zbatimit të kontratave
Rëndësia:	I Lartë
Rekomandimi	Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masat për të propozuar ndryshimet e nevojshme në VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetitò: **Rekomandim 1:** Në mënyrë që kjo VKMK tõ shërbejë situatave emrgjente për kontrata që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit, në të duhet që afatet e parashikuara për miratimin ekontratave nga KM, të jenë nëproporcion me emergjencën e situatës dhe jo ndryshe. **Rekomandim 2:** Në VKM duhet të përcaktohet qartë mënyra e përllogaritjes së fondit limit dhe ku duhet të mbështetet autoriteti kontraktor për llogaritjen e tij (si psh: *çmimet e botuara nga INSTAT, çmimet e tregut, çmimet e kontratave të ngjashme, çmimet ndërkombëtare ,….etj*). **Rekomandim 3:** Në VKM të parashikohen rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave si një element i rëndësishëm i kontrollit të mirëmenaxhimit të fondeve publike, për qëllimet e parashikuara në këtë VKM. **Rekomandim 4**: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si ministria përgjegjëse të marrë masa që në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, nisur nga teknika legjislative, të rishikojë bazën ligjore të përdorur për nxjerrjen e këtij vendimi, me qëllim përcaktimin e dispozitave që, në kuptimin e nenit 118 të Kushtetutës, autorizojnë nxjerrjen e këtij akti nënligjor nga Këshilli i Ministrave, çështjet që duhen rregulluar si dhe parimet në bazë të të cilave nxirret ky akt. Në VKM të përcaktohet përkufizimi i gjendjes, rrethanave, apo rasteve kur kemi të bëjmë me ñ*interesa thelbësorë të shtetit*ò duke mos i lënë këto rrethana në vlerësim të autoriteteve kontraktore. Përkufizimi ñ*interesa thelbësorë të shtetit*ò duhet të përjashtojë situatat për furnizime në situata emergjencash dhe fatkeqësish, të cilat gjykojmë se Ligji nr. 9643/2016 ñ*Për prokurimin publik*ò i ka të rregulluar me nenin 33 ñ*Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit*ò mjaftueshëm për të garantuar kontraktime dhe prokurime të shpejta, eficente, inteligjente dhe proporcionale me interesat thelbësore të shtetit dhe përputhen me Aktin Normativ të Qeverisë Për Shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore dhe Pandemia Botërore shpallur nga OBSH. **Rekomandim 5:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si ministria përgjegjëse të marrë masa që të propozojë vendosjen e një pike të veçantë 13/1, në të cilën të parashikohet përfshirja e të drejtës së ankimimit në procedurën e

	drejtëpërdrejtë; gjithashtu në përputhje edhe me parashikimet të Kodit të Procedurës Administrative neni 129, për të shmangur çdo paqartësi gjatë zbatimit të vendimit, të parashikohet e drejta e ankimit të drejtëpërdrejtë në gjykatën kompetente
Afati i zbatimit:	Menjëherë

2. Titulli i Gjetjes:	Komisioni i Vlerësimit, ka negociuar afatet e lëvrimit të mallit, në kundërshtim me afatet e përcaktuara në dokumentacionin ñFtesë për ofertëò, duke denatyruar nevojen emergjente për mallra/shërbime, te diktuar nga Covid 19
Situata :	Nga auditimi rezultoi se, Komisioni i Vlerësimit (KV), ka negociuar afatet e lëvrimit të mallit, në kundërshtim me afatet e përcaktuara në dokumentacionin ñFtesë për ofertëò, duke denatyruar njëkohësisht edhe nevojën për përzgjedhjen e ñprocedures së drejtpërdrejtëò, përzgjedhur kjo nga KV dhe miratuar nga Titullari i autoritetit kontraktor, për procedurat si vijon: **a-**Nga auditimi i procedurës ñ*Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19*ò me fond limit 129,727,371 lekë pa tvsh, rezultoi se, nga Komisioni i Vlerësimit, më datë 25.03.2020 sipas Ftesë për Ofertë, është parashikuar si afat lëvrimi për 54 respiratorë afati 10 ditor. Në vijim është lidhur kontrata e furnizimit nr.1365/36, dt. 27.03.2020 me objekt ñ*Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adulte dhe moshë pediatrike për COVID-19*ò me vlerën 75,060,000 lekë pa tvsh me afat lëvrimi 20 respiratorë do të lëvrohen për 7 ditë nga hyrja në fuqi e kontratës dhe 34 respiratorë do të lëvrohen për 25 ditë nga dita e hyrjes në fuqi e kontratës (pra 25 ditë nga miratimi i kontratës me VKM nr.274, datë 03.04.2020). Në përfundim konkludojmë se, KV ka tejkaluar kompetencat e veta, duke negociuar afatet në kontrata, në kundërshtim me afatet e përcaktuara në dokumentacionin ñFtesë për ofertëò me argumentimin e nevojës për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit (procedurë kjo e cila ka dështuar, pasi në përfundim u siguruan vetëm 5 respiratorë). **b-** Nga auditimi i procedurës *"Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHP"*e ndarë në 4 Lote, me fond limit në vlerën prej 29,008,273 lekë, nga KV janë negociuar kushtet e kontratës në lidhje me afatin e levrimit, duke u lënë furnizimi për të gjithë sasinë e mallit,në mënyrë variabël nga 7 ditë deri në 55 ditë, nga 7 ditë që ishte kërkuar fillimisht në dokumentin ñFtesë për ofertëò sipas shkresës nr. 1621/2, datë 05.04.2021. Negocimi i afateve nga KV, duke i zgjatur ato përtej afateve të kërkuara, gjithashtu nuk justifikon *procedurën e përzgjedhur, e cila ka për qëllim përgjigjen emergjente ndaj situatës së pandemisë*. **c-**Nga auditimi i procedures ñBlerje Materiale Për Mbrojtje Personale Për Covid -19ò me fond limit prej 307,844,333 lekë pa tvsh, nga Komisioni i Vlerësimit në dokumentacionin ñFtesë për ofertëò është kërkuar që, jo më pak se 15% e sasisë së artikujve nga 1-9 të lëvrohen brenda 7 ditëve nga miratimi i kontratës me VKM-në përkatës, 75% e sasisë së artikujve nga 1-9 të lëvrohen sipas kërkesë së AK, por jo më vonë se 6 javë nga miratimi i kontratës me VKM, ndërsa për artikullin 10 (tampon laboratory) e gjithë sasia të lëvrohet jo më vonë se 8 javë nga miratimi i kontratës me VKM. Pra, në këtë rast nga KV vetëm 15% e sasisë së kërkuar është në përmbushje të nevojës emergjentë brenda 7 ditëve, ndërsa pjesa prej 75% nuk na rezulton të jetë në këto kushte. Nëse do të krahasonim afatin e parashikuar me afatet që dikton Ligji per Prokurimin Publik, për paraqitjen e ofertave në ñProcedurën e hapurò kërkon jo më pak se 52 ditë, ndërsa për ñProcedurën me negocimò afati minimal është 15 ditë, pra dukshëm më pak se 6 jave deri në 8 javë (56 ditë). Përdorimi i VKM nr.203 nga MSHMS, synon realizimin në kohë sa më të shpejtë të barnave, pajisjeve dhe shërbimeve mjekesore, si reagim për përballimin e situatave që diktohen nga interesat thelbësore të shtetit. Në këtë rast, vendosja e afateve të tilla ka humbur konceptin e emergjencës, në kushtet kur nga prokurimi i drejtpërdrejte në fakt është

	përfituar vetëm 15% e nëvojës ekstreme Përzgjedhja e ñprocedurës së drejtpërdrejtëò, në kushtet kur afatet për lëvrimin e mallit rezultojnë të realizueshme edhe me procedura të tjera prokurimi, ka denatyruar ñkonceptin e emergjencësò ndaj nevojës për materialet për Covid-19. Autoriteti konraktor në rastin e këtij prokurimi, në përcaktimin e procedurës **nuk** i është referuar Ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò i ndryshuar, Neni 33 pika 2/c ñ*kur për arsye të nevojës ekstreme të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara nga autoriteti kontraktor* .....ò, d, ñ*për blerje, që mundësojnë prokurimin e mallrave për një kohë lëvrimi shumë të shkurtër, ose për një rast veçanërisht të leverdishëm, që paraqitet në një kohë shumë të shkurtër dhe me një çmim, dukshëm, më të ulët se çmimet normale të tregut dhe në përputhje me kriteret e parashikuara në rregullat e prokurimit publik"; si* dhe VKM nr. 914, dt. 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar neni 36, pika 2/c, ku parashikohet se në rastin e një nevoje ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, që nuk i ngarkohen autoritetit kontraktor, duhet të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme: - Shkaktimi i një ngjarjeje të paparashikuar; - Autoriteti kontraktor nuk ka përgjegjësi për ngjarjen; -Ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshëm të një komuniteti të gjerë;* pika 3, ñ*Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 60 të këtyre rregullave, duhet të paraqesë arsyet e përdorimit të kësaj procedure. 4, 6, pika 7,* ñ*Në rastin e procedurës së prokurimit me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, afatet kohore parashikohen nga vetë autoriteti kontraktor, në varësi të objektit të prokurimit dhe rrethanave".* Sa më lartë për aplikimin e procedurës *"Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit"* gjykojmë bazuar në Urdhrin nr.133, datë 08.03.2020 ñ*Për kufizimin e lëvizjes së shoqëruesve dhe ose familjarëve të pacientëve nëpër spitale*ò, urdhrin 135/1 datë 09.03.23020 ñ*Për mbylljen e veprimtarisë çerdheve, për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-19",* Urdhrin nr 135, datë 09.03.2020 ñ*Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së COVID-19*ò, vendimin e Komitetit Teknik nr. 566/3, dt. 06.03.2020 *"Për domosdoshmërinë e krijimit të stokut për Mjetet Mbrojtëse Personale".*
Kriteri:	Dokumenti ñFtesë për ofertëò; Ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò i ndryshuar; VKM nr 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Përzgjedhja e ñprocedurës së drejtpërdrejtëò, në kushtet kur afatet për lëvrimin e mallit rezultojnë të realizueshme edhe me procedura të tjera prokurimi, ka denatyruar ñkonceptin e emergjencësò ndaj nevojës për materialet për Covid-19.
Shkaku:	Komisioni i Vlerësimit, ka negociuar afatet e lëvrimit të mallit, në kundërshtim me afatet e përcaktuara në dokumentacionin ñFtesë për ofertëò.
Rekomandimi:	-Nga Komisionet e Vlerësimit, përgjatë negocimit dhe hartimit të kontratave të furnizimit, të merren parasysh afatet e përcaktuara në dokumentet standarde, dhe që përmbushin nevojat emergjente, në funksion të procedurës së përzgjedhur, parashikuar nga VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 *"Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit".* **-** Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Titullari i Autoritetit kontraktor të merren masat që për rastet e nevojave ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, kur ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshëm të një komuniteti të gjerë, për blerje, që mundësojnë prokurimin e mallrave për një kohë lëvrimi shumë të shkurtër, (*afatet kohore parashikohen nga vetë autoriteti kontraktor, në varësi të objektit të prokurimit dhe rrethanave)*në përputhje me kriteret e parashikuara në rregullat e prokurimit publik autoriteti kontraktor të përzgjedhë procedurën parashikuar nga Ligji nr. 9643, dt. 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò i ndryshuar, Neni 33 ñ*Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit"*
Afati	Në vijimësi

Në vijim po paraqesim ne menyrë të detajuar rezultatet e auditimit për 7 procedurat e prokurimit të kryera me ñprocedurë të drejtpërdrejtëò:

1-Auditimi i zbatimit për procedurën "Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19".

a-Nga auditimi i zbatimit të kontratave, në lidhje për procedurën ñ*Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19*ò me fond limit 129,727,371 lekë pa tvsh u konstatua se:
-Mbas realizimit të procedurës dhe negocimit të kontratës me operatorin ekonomik ñT.ò shpk, dhe AK të MSHMS është lidhur Kontrata e furnizimit me nr.1365/36, datë 27.03.2020 me vlerë **75,060,000 lekë pa tvsh,** e cila ka hyrë në fuqi me miratimin e VKM nr.274, datë 03.04.2020, me afate lëvrimi 20 respiratorë brenda 7 ditëve dhe 34 respiratorë do të lëvrohen për 25 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të kontratës.
-Me shkresën nr.1365/38, datë 03.04.2020 është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me përbërje(L. P, N. C dhe L.A.)
-Nga monitorimi i kësaj kontratë, kanë ardhur vetëm 5 respiratorë, të cilët janë dërguar në Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò SUSHN, në cilësinë e Spitalit ñCovid 2ò, ku më Urdhër të titullarit të SUSHN është ngritur Komisioni për pritjen e mallit për pajisjet mjekësore respiratore, i cili ka mbajtur PV në datën 04.04.2020 duke u shprehur se janë marrë në ruajtje 5 respiratorë.
-MSHMS me shkresën nr.1782, datë 09.04.2020, i është drejtuar SUSHN në lidhje me marrjen në dorëzim të pajisjeve mjekësore, dhe është kërkuar që pas instalimit dhe vënies në punë të hartohet një procesverbal dhe të bëhet kontabilizimi, dokumentacioni të dërgohet në MSHMS.
-MSHMS me shkresën nr.1365/40, datë 27.04.2020, ka vendosur transferimin e 5 respiratorëve nga Spitali Shefqet Ndroqi, për në Qëndrën Spitalore Universitare ñ Nënë Terezaò QSUNT.
Komisioni i pritjes së mallit në Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò ka mbajtur procesverbali në datën 30.04.2020 mbi dorëzimin e pesë pajisjeve respiratorë, në drejtim të QSUNT. Nga auditimi u konstatua se, respiratorët <u>nuk u përdorën nga Spitali Universitar Shefqet Ndroqi dhe qëndruan fizikisht aty për gati 1 muaj.</u>
-Nga auditimi konstatohet se <u>përgjatë një muaji që respiratorët ndejtën në spitalin ñShefqet Ndroqiò nuk ka asnjë dokumentacion</u> ku të jetë bërë kontabilizimi, e për pasojë nuk është dërguar asnjë dokumentacion në MSHMS. Nga grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, ngritur me shkresën nr.1365/38, datë 03.04.2020, nuk janë të reflektuara arsyet e mos përdorimit të tyre, , duke rezultuar se ka munguar gjurma e auditimit, që lidhet me përgatitjen e informacionit përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës në mënyrë të vazhdueshme.
-Me shkresën nr.578/303, datë 08.05.2020, nga Qendra Spitalore Universitare ñNënë Terezaò është dërguar një kopje e relacionit të kolaudimit të pajisjeve **mjekësore në formë dhurimi** , që në këtë rast, kalimi nga SUSHN në QSUT, është quajtur donacion, ku sipas shkresës nr. 578/302, datë 07.05.2020 ñRelacion për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të pajisjeve mjekësore në formë donacioniò, nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e titullarit nr. 9, date 10.01.2020, ndër të tjera shkruhet: ñ*,,komisioni kreu kontrollin e sasisë, funksionimi, instalimin dhe vënien në punë të 5 respiratorëve*ò, por komisioni nuk shprehet nëse specifikimet teknike janë të njëjta me ato të parashikuara në kontratë.
-Nga auditimi u konstatua se, me shkresat nr.1803, datë 10.04.2020 dhe nr.1365/39 datë 24.04.2020 nga operatori ekonomik fitues ñT.ò shpk, është kërkuar zgjatje e afateve të dorëzimit të pajisjeve deri në periudhën majï qershor (për shkak të mbylljes të transportit ajror, tokësor dhe detar), duke ceduar kështu kriteri i ñemergjencësò për këtë artikull
OE deri 10.04.2020 ka dorëzuar ***<u>vetëm 5 copë,</u>*** nga 20 copë që duhet të dorëzonte brenda 7 ditëve, ndërsa 34 respiratorë do të lëvroheshin brenda 25 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e kontratës, ku as këto nuk mundën të siguroheshin, duke sjellë gjithashtu edhe dështimin e kontratës së mësipërme.

Grupi i auditimit, pas kontrolleve të cilësisë në KLSH, si dhe në bazë të evidencave të auditimit si: kontratat respektive, proces verbalet dhe faturat tatimore të dorëzimit të mallit/pajisje/shërbimit, rishqyrtoi edhe njëherë dhe rivlerësoi detyrimin kontraktor në lidhje mbi ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò dhe me ñSigurimin e kontratësò, në lidhje me furnzimin me respiratorë sipas kontratës nr. 1365/36, datë 27.03.2020, si më poshtë:

a. Në zbatim tënenit 10 të kontratës nr. 1365/36, datë 27.03.2020 parashikohet se: **"**Kontraktuesi, **kur nuk realizon ketë kontratë brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000** të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratësô
Grupi i auditimit, verifikoi edhe njëëherë evidencat e auditimit si: kontratën përkatëse, proces verbalet dhe faturave tatimore të dorëzimit të mallit/pajisje/ shërbim për secilën kontratë, dhe më pas rivlerësoi dhe rillogariti detyrimin kontraktor në lidhje mbi ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò sipas nenit 10 të kontratës nr. 1365/36, datë 27.03.2020.

Nga auditimi rezultoi se OE ñT.ò shpk, deri më 10.04.2020 ka dorëzuar ***vetëm 5 copë respiratorë ,*** nga 20 copë që duhet të dorëzonte për 7 ditë, ndërsa 34 respiratorë duhej të lëvroheshin brenda 25 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e kontratës (nga data 03.04.2021). Vlera e një respiratori është 1,390,000 lekë pa tvsh ose 1,668,000 lekë me tvsh.
-Nga 20 copë resperator, 5 janë sjellë brenda afatit, ndërsa 15 copë respiratorë rezultojnë të padorëzuar në tejkalim të afatit 7 ditor. Për këtë furnizim të padorëzuar OE-së duhet tôi përllogariten dhe mbahen shuma prej 700,560 lekë me tvsh ((15 resperatorë x 1,668,000) x 0.004 x 7 ditë=**700,560 lekë me tvsh**.)
- Gjithashtu 34 copë respiratorë **nuk** u dorëzuan fare, duke mos respektuar as afatin e parashikuar në kontratë prej 25 ditesh. Për këtë furnzim të padorëzuar OE-së duhet tôi përllogariten dhe mbahet shuma prej 5,671,200 lekë me tvsh ((34 respirator x 1,668,000) x 0,004 x 25 ditë = **5,671,200 lekë me tvsh**)
Pra. në total për mosrealizimin e afateve dhe mos dorëzimin e 49 respiratorëve, kontraktuesi duhet të paguajë 4/1000 të vlerës **së mbetur pa u zbatuar**, nga çmimi total i kontratës, në vlerën totale **prej 6, 371,760 lekë me tvsh,** e cila nga auditimi rezultoi si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.
b. Gjithashtu, **në zbatim të nenit 16 (Sigurimi i Kontratës), të Kontratës Furnizim nr.1365/36, datë 27.03.2020** ñ *Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë AK garancinë e sigurimit të kontratës, 10% të vlerës së kontratës me tvsh në shumën prej 9,007,200 (nëntë milion e shtatë mijë e dyqind) lekë. Kontrata të sigurohet deri në përfundimi të kontratës. Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet AK si kompesim për çdo humbje të rezultuar nga **dështimi i kontraktorit** në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës. Garancia e sigurimit të kontratës do t'i kthehet Kontraktuesit pas përfundimit të kohëzgjatjes së kontratës*ò.
-Nga auditimi u konstatua se, nga OE ñT.ò shpk, është paraqitur Formulari i Sigurimit të Kontratës nga Kompania e Sigurimeve ñE.ò me Nr. Serial 070350260029567, datë 27.03.2020, midis të tjera thuhet se ñ..*Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e Ministria e Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, vlerën e siguruar, brenda 15 ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmënde mospërbushjen e kushteve të kontratës."*
Nisur nga këto rrethana e kushte, MSHMS si pasojë e mosplotësimit të detyrimit kontraktor nga OE si dhe në zbatim të neni 16 (Sigurimi i Kontratës), me shkresat nr.1365/43 , datë 27.05.2020; nr.1782/1, datë 16.06.2020 dhe nr.633, datë 03.02.2021, është kërkuar nga Kompania e Sigurimeve ñEurosigò dhe për dijeni OE fitues ñT.ò shpk, për shkak të mospërmbushjes së së kushteve të kontratës, transferimin në llogarinë e MSHMS të vlerës prej 10% të kontratës.

Nga auditimi u konstatua se, deri në momentin e hartimit të këtij materiali nga Kompania e Sigurimeve ñEurosigò , nuk është depozituar vlera e garancisë së kontratës si dhe nga MSHMS nuk është ndërmarrë asnjë veprim ligjor duke shkuar në gjykatë administrative për arkëtimin e kësaj vlerë, e cila mund të sjellë risk ekonomik në disfavor të Buxhetit të Shtetit, ***në vlerën prej 9,007,200 (nëntë milion e shtatë mijë e dyqind) lekë si e ardhur e munguar.***
Grupi i auditimit, konstaton se, në mungesë të shprehjes së VKM nr.203, datë 26.02.2020 ñProcedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetitò i ndryshuar për mënyrën e sigurimit të kontratës si dhe nga eksperiencat e ndodhura bazuar në procedurat e prokurimit publik, sigurimi i kontratës nuk është bërë në formën e një depozite pranë Banke e nivelit të dytë, por është bërë shoqëri sigurimi.
Gjithashtu, në bazë të disa prej auditimeve të KLSH-së është konstatuar se, pothuajse në asnjë rast kërkesat e autoritetit kontraktues për të konfiskuar sigurimin e kontratës, nuk kanë gjetur bashkëpunim me shoqëritë e sigurimit dhe si pasojë çështjet kanë shkuar në gjykatë, të cilat në mjaft raste janë zvarritur pambarimisht, duke mos bërë të mundur arkëtimin e shumave në favor të Buxhetit e Shtetit.

Në përfundim, rezultoi se furnizimi me respiratorë, u realizua nga dy OE të tjera konkretisht Mé shpk dhe Mé . shpk (referuar faturave te likuidimit date 28.10.2020 (Mé shpk), date 13.11.2020 (Mé shpk) dhe date 09.10.2020 (Mé shpk). Edhe pse planifikuar per nevoja emergjente, kjo procedure në fakt dështoi të ofronte në kohë këtë pajisje kaq të rëndësishme/jetesore në kushtet e pandemisë Covid19.
Në lidhje mbi observimet dërguar nga MSHMS në lidhje mbi Projektraportin e përcjellë nga KLSH me shkresë nr.121/10 prot datë 03.09.2021, të cilat kanë ardhur më datë 14.10.2021 jashtë afatit kohor të parashikuar në ligjin 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit neni 26 dhe 29ô me shkresë nr.415/47 prot të MSHMS dhe me nr.121/11 prot datë 14.10.2021 të KLSH, ju bëjmë me dije:
Mbi observimet për procedurën ñ*Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19*ò, grupi i auditimit vlerën e sigurimit të kontratës me vlerë 9,007,200 lekë me tvsh,e ka përllogaritur në 10% e vlerës së kontratës me vlerë prej 90,072,000 lekë me tvsh, e shprehur në Kontratën e Furnizimit nr,1365/36 datë 27.03.2020 neni 3 (vlera e kontratës). Kjo vlerë e sigurimit të kontratës duhej të sigurohej që në momentin e lidhjes së kontratës dhe për më tepër, që ñT.ò shpk nuk e siguroi dot mallin në kohë, ndonëse që në krye të fillimit të procedurës situate ishte në kushte të emergjencës kombëtare për shkak të Covid-19. Për këtë qëllim nga MSHMS, duhej të ishin ndërmarrë masa dhe rruget administrative ose/ dhe ligjore, për të sigurimin e vlerës së kontratës.
Sa më sipër, audituesit e KLSH , i ri vlerësuan dhe observimet e dyta, të cilat nuk kanë paraqitur dokumentacion shtesë apo argumentim ligjor shtesë në lidhje mbi problematikën e konstatuar, për këtë qëllim, audituesit shprehen me të njëjtin qëndrim, si vijon:

Pretendimi i subjektit:
Mbi auditimin e zbatimit për procedurën ñFurnizim vendosje respiratore me dy modalitete për adulte dhe moshë pediatrike për COVID-19ò.
Referuar kontratës së lidhur me operatorin T....ñFurnizim vendosje respiratore me dy modalitete per adulte dhe moshe pediatrike per Covid -19ò sqarojme se:
Operatori dorezoi brenda afatit te kontrates pese respiratore me dy modalitete per adulte dhe moshe pediatrike per Covid -19.
Spitali Shefqet Ndroqi ka hartuar urdherin e brendshëm nr. 93 datë 01.04.2020 për ñNgritjen e Komisionit të pritjes së mallit për pajisjet mjekësore respiratoreò.
Me datë 04.04.2020 Komisioni i pritjes së mallit, ne Spitalin Shefqet Ndroqi, ka marre në ruajtje deri ne kontabilizimin e tyre pesë pajisje Respiratore Lyra X2 të lëvruara me numra serie NS: GB3S000360, GB3S000340, GB3S000328, GB3S000335, GB3S000370 sipas faturës dhe katalogut dërguar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
Duke konsideruar qe vendi ndodhej ne mes te nje pandemie te paprecendente, shperndarja e respiratoreve vendosej

nga emergjencat dhe fluksi i pacienteve ne spitalet e ndryshme COVID.
Duke vleresuar kete nevoje, me kerkese te QSUT ñNene Terezaò, si spital Covid 1, u vendos qe per perballimin e situates respiratoret te trasferohen ne QSUT ñNene Terezaò, ku dhe u kontabilizuan dhe asistojne pacientet normalisht.
- Mbështetur në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, Neni 24 Sigurimi i kontratës *"Sigurimi i kontratës garanton autoritetin kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. Para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së saj. Sigurimi i kontratës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari."*
Ju informojme se MSHMS ne zbatim te kontrates ka kerkuar me dy shkresa zyrtare mbajtjen e sigurimit te kontrates per moszbatimin e kontrates me operatorin T....
Meqenese nga kompania ñE.ò Shpk nuk eshte depozituar vlera e sigurimit te kontrates, MSHMS po ndermerr hapa per te kerkuar vleren e sigurimit te gjykates ne rruge gjyqesore.
Qëndrimi i grupit të auditimit:
-Nga auditimi u konstatua se, nga OE ñT.ò shpk, është paraqitur Formulari i Sigurimit të Kontratës nga Kompania e Sigurimeve ñE.ò me Nr. Serial 070350260029567, datë 27.03.2020, midis të tjera thuhet se ñ..*Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e Ministria e Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, vlerën e siguruar, brenda 15 ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmënde mospërbushjen e kushteve të kontratës."*
Nisur nga këto rrethana e kushte, MSHMS si pasojë e mosplotësimit të detyrimit kontraktor nga OE si dhe në zbatim të neni 16 (Sigurimi i Kontratës), me shkresat nr.1365/43 , datë 27.05.2020; nr.1782/1, datë 16.06.2020 dhe nr.633, datë 03.02.2021, është kërkuar nga Kompania e Sigurimeve ñEurosigò dhe për dijeni OE fitues ñT.ò shpk, për shkak të mospërmbushjes së së kushteve të kontratës, transferimin në llogarinë e MSHMS të vlerës prej 10% të kontratës.
Nga auditimi u konstatua se, deri në momentin e hartimit të këtij materiali nga Kompania e Sigurimeve ñE....ò , nuk është depozituar vlera e garancisë së kontratës si dhe nga MSHMS nuk është ndërmarrë asnjë veprim ligjor duke shkuar në gjykatë administrative për arkëtimin e kësaj vlerë, e cila mund të sjellë risk ekonomik në disfavor të Buxhetit të Shtetit, ***në vlerënprej 9,007,200 (nëntë milion e shtatë mijë e dyqind) lekë si e ardhur e munguar***
Në observacion nuk është paraqitur asnjë dokument justifikues bashkëlidhur
Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

3. Titulli i Gjetjes:	Mos përllogaritje penalitetesh për dorëzim të vonuar si dhe mos mbajtja e sigurimit të kontratës, për kontratën e lidhur me operatorin T...ñFurnizim vendosje respiratore me dy modalitete per adulte dhe moshe pediatrike per Covid -19ò
Situata :	Nga auditimi u konstatua se, me VKM nr.274, datë 03.04.2020, mes MSHMS dhe operatorit ekonomik ñT....ò, është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1365/36, datë 27.03.2020, me vlerë kontrate 75,060,000 leke pa tvsh ose 90,072,000 me tvsh me objekt ñFurnizim vendosje respiratore me dy modalitete per adulte dhe moshe pediatrike per Covid -19ò, me afate lëvrimi: 20 respiratorë brenda 7 ditëve dhe 34 brenda 25 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të kontratës (datë 03.04.2020). -Nga MSHMS vetëm për kontratën ñFurnizim vendosje respiratore me dy modalitete per adulte dhe moshe pediatrike per Covid -19ò, është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës , në bazë të shkresës nr.1365/38, datë 03.04.2020, i cili ka raportuar vetëm dorëzimin e 5 respiratorëve të cilët janë dërguar në Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò SUSHN, në cilësinë Spitali ñCovid 2ò, ku më Urdhër të titullarit të SUSHN është ngritur Komisioni për pritjen e mallit për pajisjet mjekësore respiratore, kjo në bazë të PV në datën 04.04.2020 ,duke u shprehur se janë marrë në ruajtje 5 respiratorë. -MSHMS me shkresën nr.1782, datë 09.04.2020, i është drejtuar SUSHN në lidhje me marrjen në dorëzim të pajisjeve mjekësore, është kërkuar që pas instalimit dhe vënies në punë të hartohet një procesverbal dhe të bëhet kontabilizimi, dokumentacioni të dërgohet në MSHMS. -MSHMS me shkresën nr.1365/40, datë 27.04.2020, është vendosur transferimi i 5 respiratorëve nga Spitali Shefqet Ndroqi për në Qëndrën Spitalore Universitare ñ Nënë Terezaò QSUNT. Komisioni i pritjes së mallit në Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò është mbajtur procesverbali në datën 30.04.2020 mbi dorëzimin e pesë pajisjeve respiratorë, në drejtim të QSUNT. Nga auditimi u konstatua se, respiratorët nuk u përdorën nga

Spitali Universitar Shefqet Ndroqi, ndërsa qëndruan fizikisht për gati 1 muaj në këtë spital.

-Nga auditimi konstatohet se përgjatë një muaji që respiratorët qëndruan në spitalin Shefqet Ndroqi, në MSHMS nuk është dërguar asnjë dokumentacion mbi marrjen në dorëzim të tyre. Si pasojë, arsyet e mospërdorimit të tyre nga ky spital **nuk** reflektohen nga grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, ngritur me shkresë nr.1365/38, datë 03.04.2020, duke rezultuar se ka munguar gjurma e auditimit, që lidhet me përgatitjen e informacionit përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës në mënyrë të vazhdueshme.

-Me shkresën nr.578/303, datë 08.05.2020, nga Qendra Spitalore Universitare ñNënë Terezaò është dërguar një kopje e relacionit të kolaudimit të pajisjeve mjekësore në formë dhurimi , dhe kalimi nga SUSHN në QSUT, është trajtuar si donacion.

- Nga auditimi u konstatua se, me shkresat nr.1803, datë 10.04.2020 dhe nr.1365/39 datë 24.04.2020 nga operatori ekonomik fitues T.... shpk, është kërkuar zgjatje e afateve të dorëzimit të pajisjeve deri në periudhën maj ï qershor (për shkak të mbylljes të transportit ajror, tokësor dhe detar), duke ceduar kështu kriteri i ñemergjencësò. Pavarësisht kësaj, AK nuk rezultoi të ketë marrë ndonjë veprim administrativ- juridik për amendimin e kësaj kontrate.

- Nga auditimi rezultoi se, OE deri më 10.04.2020 ka dorëzuar ***vetëm 5 copë,*** nga 20 copë që duhet të dorëzonte brenda 7 ditëve, ndërsa 34 respiratorë do të lëvroheshin brenda 25 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e kontratës, ku as këto nuk mundën të siguroheshin, duke sjellë gjithashtu edhe dështimin e kontratës së mësipërme. Grupi i auditimit, pas kontrolleve të cilësisë në KLSH, si dhe në bazë të evidencave të auditimit si: kontratat respektive, proces verbalet dhe faturat tatimore të dorëzimit të mallit/pajisje/shërbimit, rishqyrtoi edhe njëherë dhe rivlerësoi detyrimin kontraktor në lidhje mbi ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò dhe me ñSigurimin e kontratësò, në lidhje me furnzimin me respiratorë sipas kontratës nr. 1365/36, datë 27.03.2020, si më poshtë:

a. Në zbatim të nenit 10 të kontratës nr. 1365/36, datë 27.03.2020 parashikohet se: **"**Kontraktuesi, **kur nuk realizon ketë kontratë Brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000** të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratësô

Grupi i auditimit, verifikoi edhe njëëherë evidencat e auditimit si: kontratën përkatëse, proces verbalet dhe faturave tatimore të dorëzimit të mallit/pajisje/ shërbim për secilën kontratë, dhe më pas rivlerësoi dhe rillogariti detyrimin kontraktor në lidhje mbi ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò sipas nenit 10 të kontratës nr. 1365/36, datë 27.03.2020. Nga auditimi rezultoi se:

- OE ñT.....shpkò, deri më 10.04.2020 ka dorëzuar ***vetëm 5 copë respiratorë ,*** nga 20 copë që duhet të dorëzonte për 7 ditë, ndërsa 15 copë respiratorë rezultojnë të padorëzuar në tejkalim të afatit 7 ditor (vlera e një respiratori është 1,390,000 lekë pa tvsh ose 1,668,000 lekë me tvsh). Për këtë furnizim të padorëzuar OE-së duhet tõ përllogariten dhe mbahen shuma prej 700,560 lekë me tvsh ((15 resperatorë x 1,668,000) x 0.004 x 7 ditë=**700,560 lekë me tvsh**.)

- Gjithashtu 34 copë respiratorë **nuk** u dorëzuan fare, duke mos respektuar as afatin e parashikuar në kontratë prej 25 ditesh. Për këtë furnzim të padorëzuar OE-së duhet tõ përllogariten dhe mbahet shuma prej 5,671,200 lekë me tvsh ((34 respirator x 1,668,000) x 0,004 x 25 ditë = **5,671,200 lekë me tvsh**)

Pra. në total, për mosrealizimin e afateve dhe mos dorëzimin e 49 respiratorëve, kontraktuesi duhet të paguajë 4/1000 të vlerës **së mbetur pa u zbatuar**, nga çmimi total i kontratës, në vlerën totale **prej 6, 371,760 lekë me tvsh,** e cila nga auditimi rezultoi si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

b. Gjithashtu, **në zbatim të nenit 16 (Sigurimi i Kontratës), të Kontratës Furnizim nr.1365/36, datë 27.03.2020** ñ *Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë AK garancinë e sigurimit të kontratës, 10% të vlerës së kontratës me tvsh në shumën prej 9,007,200 (nëntë milion e shtatë mijë e dyqind) lekë. Kontrata të sigurohet deri në përfundimi të kontratës. Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet AK si kompesim për çdo humbje të rezultuar nga **dështimi i kontraktorit** në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës. Garancia e sigurimit të kontratës do t'i kthehet Kontraktuesit pas*

	*përfundimit të kohëzgjatjes së kontratës*ò. -Nga auditimi u konstatua se, nga OE ñT.ò shpk, është paraqitur Formulari i Sigurimit të Kontratës nga Kompania e Sigurimeve ñE....ò me Nr. Serial 070350260029567, datë 27.03.2020, midis të tjera thuhet se ñ.*Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e Ministria e Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, vlerën e siguruar, brenda 15 ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmënde mospërbushjen e kushteve të kontratës."* Nisur nga këto rrethana e kushte, MSHMS si pasojë e mosplotësimit të detyrimit kontraktor nga OE si dhe në zbatim të neni 16 (Sigurimi i Kontratës), me shkresat nr.1365/43 , datë 27.05.2020; nr.1782/1, datë 16.06.2020 dhe nr.633, datë 03.02.2021, është kërkuar nga Kompania e Sigurimeve ñE....ò dhe për dijeni OE fitues ñT.ò shpk, për shkak të mospërmbushjes së së kushteve të kontratës, transferimin në llogarinë e MSHMS të vlerës prej 10% të kontratës. Nga auditimi u konstatua se, deri në momentin e hartimit të këtij materiali nga Kompania e Sigurimeve ñE...ò , nuk është depozituar vlera e garancisë së kontratës si dhe nga MSHMS nuk është ndërmarrë asnjë veprim ligjor duke shkuar në gjykatë administrative për arkëtimin e kësaj vlerë, e cila mund të sjellë risk ekonomik në disfavor të Buxhetit të Shtetit, ***në vlerënprej 9,007,200 (nëntë milion e shtatë mijë e dyqind) lekë si e ardhur e munguar.*** Në përfundim, rezultoi se furnizimi me respiratorë, u realizua nga dy OE të tjera konkretisht Mé shpk dhe Mé shpk (referuar faturave te likuidimit date 28.10.2020 (Mé . shpk), date 13.11.2020 (MSE shpk) dhe date 09.10.2020 (Mé shpk). Edhe pse planifikuar per nevoja emergjente, kjo procedure në fakt dështoi të ofronte në kohë këtë pajisje kaq të rëndësishme/jetesore në kushtet e pandemisë Covid19
Kriteri:	VKM nr. 203, dt. 26.02.2020, ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetitò i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Nisur nga këto rrethana e kushte, MSHMS si pasojë e mosplotësimit të detyrimit kontraktor nga OE si dhe në zbatim të neni 16 (Sigurimi i Kontratës), me shkresat nr.1365/43 , datë 27.05.2020; nr.1782/1, datë 16.06.2020 dhe nr.633, datë 03.02.2021, është kërkuar nga Kompania e Sigurimeve ñE...ò dhe për dijeni OE fitues ñT...ò shpk, për shkak të mospërmbushjes së së kushteve të kontratës, transferimin në llogarinë e MSHMS të vlerës prej 10% të kontratës.
Shkaku:	Procedura e përzgjedhur rezultoi e pasukseshme Nga auditimi u konstatua se, deri në momentin e hartimit të këtij materiali nga Kompania e Sigurimeve ñE....ò , nuk është depozituar vlera e garancisë së kontratës si dhe nga MSHMS nuk është ndërmarrë asnjë veprim ligjor duke shkuar në gjykatë administrative për arkëtimin e kësaj vlerë, e cila mund të sjellë risk ekonomik në disfavor të Buxhetit të Shtetit, në vlerën prej 9,007,200 lekë si e ardhur e munguar. Gjithashtu, penaliteti për 49 respiratorë është vlera prej 6, 371,760 lekë me tvsh si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit. Pra në total, operatori ekonomik ñT....òshpk, si pasojë e mosplotësimit të detyrimit kontraktor kontrata e furnizimit me nr.1365/36, datë 27.03.2020, miratuar me VKM nr.274, është krijuar vlera prej 15,378,960 lekë si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.
Rëndësia:	I Lartë
Rekomandimi	**1.**Nga MSHMS të merren masa për arkëtimin e penaliteteve të krijuara si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor, duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, konkretisht nga operatori ekonomik ñT...ò shpk, në vlerën prej 6, 371,760 lekë me tvsh, për mosrealizimin e afateve dhe mos dorëzimin në kohë të 49 respiratorëve. **2.** MSHMS, MSHMS, të ngrejnë grup pune të veçantë, për analizimin e shkaqeve dhe arsyeve, të mos arkëtimit të vlerës prej **9,007,200.00** lekë, si pasojë e mos konfiskimit të sigurimit të kontratës në favor të MSHMS si dhe te kërkojë arkëtimin e vlerës së mësipërme në favor të Buxhetit e Shtetit, duke ndjekur të gjithë rrugët ligjore.
Afati i zbatimit:	Menjëherë

2.Auditimi i procedurës "Blerje Barna Anti Covid -19" ndarë në 10 Lote , me fond limit total 36,812,915 lekë,realizuar në bazë të VKM nr.203, datë 26.02.2020 "Procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit", paraqitur në aneksin nr. 16

-Në bazë të relacionit me nr 1573/1, datë 26.03.2020, komisioni i vlerësimit për marrjen, shqyrtimin, vlerësimin e ofertave nga kandidatët dhe ofertuesit dhe lidhjen e kontratave ka konstatuar se:
Komisioni ka arsyetuar se të ndodhur në kushtet e një nevoje urgjente për këto objekte , në kushtet e rrethanave të jashtëzakonshme të fatkeqësisë natyrore , në kushtet kur koha nuk është e mjaftueshme për zhvillimin normal të procedurave ka propozuar miratimin *e **procedurës së drejtëpërdrejtë** në zbatim të pikës IV.2 të Kreut IV të vendimit të Këshillit të Ministravë Nr.203, datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit" i ndryshuar* për lidhjen e kontratave për objektin ñBlerje barna kundër Coronavirus COVID-19 ndarë në lote (1 bar një lot)ò.
Me shkresën nr.1573/2, datë 26.03.2020 është miratuar procedura e prokurimit ñProcedurë e drejtëpërdrejtëò nga titullari i autoritetit kontraktor.
Me procesverbalin nr.1573/4, datë 29.03.2020 nga **Komisioni i Vlerësimit për marrjen, shqyrtimin, vlerësimin e ofertave nga kandidatët dhe ofertuesit për lidhjen e kontratave** është mbajtur procesverbali për argumentimin e fondit limit të nevojshëm për lidhjen e kontratës për blerje barna anti Covid-19 dhe dokumentave standarte të tenderit.
Nga auditimi konstatohet se në procesverbal **nuk** është argumentuar e plotë vlera e fondit limit pasi janë shprehur vetëm me një fjali ñ*Komisioni për nxjerrjen e fondit limit u mbështet në mesatarizimin e çmimeve dhe ka përcaktuar si fond limit pa tvsh vlerën prej 36,812,915 lekë...*ò

Tabelë me barnat e kërkuara, për përballimin e Covid-19

Nr	Lot/Principi aktiv	Formedoza	Njesia	Sasia totale	Fondi limit
1	Loti 1 - Hidroksichlorokine	200 mg	Tablete	20	457,385
2	Loti 2 - Chlorochine phosphate	250 mg	Tablete	5.7	396,322
3	Loti 3 - Ribavirin	200 mg	Tablete/kapsule	100	10,733
4	Loti 4 - Lopinavir/ritonavir	80mg+20mg	Flakon	100	179,458
5	Loti 5 - Oseltamivir (Tamiflu)	75 mg	Tablete	6	885,636
6	Loti 6 - Tocilizumab	400 mg/ 20 ml	Flakon	200	12,532,790
7	Loti 7 - Omeprazol	20 mg	Kapsula	6.6	161,080
8	Loti 8 - Omeprazol	40 mg/vial	Flakon	20.35	9,683,782
9	Loti 9 - Propofol	10 mg/ml - 50ml	Flakon	22	11,992,345
10	Loti 10 - Beclomethasone +salbutamol	80 mcg+1600 mcg	Flakon	10	513,384
SHUMA					36,812,915

Nga auditimi i dosjes fizike në bazë të procesverbalit të KV nr.1573/5 datë 29.03.2020, i ngritur me Urdhër nr.199 datë 24.03.2020 ñPër ngritjen e Komisionit të Vlerësimit për marrjen, shqyrtimin, vlerësimin e ofertave nga kanditatët dhe ofertuesit dhe lidhjen e kontratës për procedurën me objekt ñBlerje barna anti Covid-19ò si dhe shkresat ñOfertë për testim treguò përkatësisht me nr.1573/3 prot, datë 29.03.2020 , janë drejtuar R... P..., I...,E... shpk, L... P... dhe D... P...., Krahas barnave të tjera dhe për barin Remdesivir (sasia 980 Flakon/Ampula), për të cilin nuk pati oferta, pasi ky bar nuk është i regjistruar dhe nuk është i pajisur me leje importi, për pasojë bari Remdesivir, nuk është përfshirë në këtë procedurë, ndonëse sipas OBSH, Remdisivir është pjesë e trajtimit të Covid-19.
Gjithashtu sipas procesverbalit nr.1573/4, datë 29.03.2020 dhe tabelës së mëposhtme me barnat e kërkuara, (Hidroksichlorokinë, Chlorochine phosphate, Ribavirin, Lopinavir/ritonavir), nga auditimi, u konstatua se **nuk** kishin status rregjistrimi nga MSHMS si dhe operatorët ekonomikë të përzgjedhur nga KV, në momentin e përllogaritjes së fondit limit **nuk** kishin leje importi për këto

barna, për rrjedhojë nga ana e KV nuk del e qartë se cilave çmimeve janë referuar për përllogaritjen e fondit limit.
Për më sipër, nga KV është cituar për barin, *Hidroksichlorokinë është e pajisur me leje importi për 2020,* në bazë të PV nr.1573/5 datë 29.03.2020, por nga auditimi i Autorizimeve Importi për barnat të paregjistruara, për vitin 2020 lëshuar nga MSHMS, rezultoi se, për barin Hidroksichlorokinë Autorizim nr. 55 është marrë më datë 03.07.2020, pra katër muaj më pas, nga OE ñE....ò; çmimi për këtë bar është 17.8 Euro për kuti (që i takon rreth 2,154 leke/kuti[28], ose 108 leke per tablete, dhe jo 22,869 leke sikundër paraqitet te Fondi limit); ndërsa vlera e përllogaritur nga KV sipas tabelës më sipër jepet për tableta duke rezultuar në diferenca të mëdha, të paargumentuara.
Ndërsa për barin (Lopinavir/ritonavir), grupi i auditimit, iu referua Autorizimeve të Importit për barnat të paregjistruara, për vitin 2019 lëshuar nga MSHMS për QSUNT me nr.80 datë 26.08.2019, forma/doza paketimi 200mg/50 mg Box x120 dhe Box x 30, me cmime për kuti 60.80 USD & 32.88 USD për kuti) ndërsa për procedurën është kërkuar Shurup 60 ml/8-mg +20 mg.
Pra, të paktën për këto dy raste për të cilat grupi i auditimit mori çmime reference, nuk del e qartë përllogaritja e fondit limit nga KV.
Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, në bazë të VKM nr.645 datë 01.10.2014 ñPër ngritjen dhe mënyrën e funksionit të komisionit të çmimit të barnaveò i ndryshuar me VKM nr.668 datë 10.10.2019, ka vendosur që, MSHMS, njofton, nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare, të gjithë mbajtësit e autorizimit të tregtimit të barit në Shqipëri, për deklarimin e çmimeve ñCIFò në euro ose dollarë, për barnat e importit dhe çmimet ñEXWò (ex-work) në lekë, për barnat e fabrikuara në vend, ku Drejtoria Farmaceutike, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, bën shpalljen, në faqen zyrtare të ministrisë. Deri në momentin që është hartuar materiali, publikimi nuk është realizuar.
Me shkresën nr.1573/6, datë 30.03.2020 u është dërguar ftesë për të marrë pjesë në këtë prokurim 7 operatorëve ekonomik, përkatësisht: R...P..., M... sh.p.k, M..., D... P..., E... shpk,I..., L... P....
Nga auditimi rezultoi se KV nuk ka argumentuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë për të siguruar këto barna të kërkuara nga Komiteti Teknik i Ekspertëve, mangësi kjo e VKM nr.203, datë 26.02.2020 ñProcedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetitò i ndryshuar, por meqënëse në thelb trajtohen si procedurë prokurimi, gjykojmë se nga AK duhet të ishte argumentuar përzgjedhja e tyre.
Është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave për procedurën e drejpërdrejtë me nr.1573/11, datë 31.03.2020. Sipas Komisionit të Vlerësimit janë paraqitur 4 operatorë për 6 lote; për 4 lote të tjera nuk është paraqitur asnjë ofertë, për rrjedhojë këto Lote janë anulluar, ndonëse PV i KV-së nr. 1573/5 datë 29.03.2020, lë të kuptohet se barnat e kërkuara, përjashto Remdisivir, gjendeshin në territorin shqiptar, pavarësisht se mund të mos ishte gjithë sasia e kërkuar, për përballimin e situatës nga Covid-19. Ofertat ekonomike për barnat anti-covid, paraqiten në aneksin nr. 17.
-Sipas procesverbalit është skualifikuar operatori L... P... për Lotin e dytë pasi nuk ka vetëdeklaruar origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese, dhe janë kualifikuar operatorët e tjerë.
Është negociuar me operatorët me procesverbalet: nr.1573/23, datë 06.04.2020 me Operatorin M...., Nr.1573/24, datë 06.04.2020 me Operatorin M...., Nr. 1573/25 me Operatorin R... P....
-Me operatorin R... P... është negociuar për një sasi më të vogël të Lotit 9-Propofol, pasi operatori disponon vetëm 3% të mallit. Sasia do të jetë 660 flakona me vlerë 359,766 lekë pa tvsh.
Janë lidhur kontratat e furnizimit me operatorët:
-Lot 3-Ribavirin është lidhur kontrata me nr.1573/29, datë 06.04.2020 me operatorin R...P..., me vlerë 10,700 lekë pa tvsh, me afat lëvrimi 50% e sasisë jo më vonë se 7 ditë dhe 50% e sasisë jo më vonë se 14 ditë.Me Vendimin nr.318, datë 18.04.2020 të Këshillit të Ministrave është miratuar kontrata me objekt Lot 3-Ribavirin.

[28]Kursi I kembimit për efekt llogaritjeje ALL/Eur 121

(2) Nga auditimi i procedurave të realizuara në bazë të VKM nr.203, datë 26.02.2020 ñProcedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetitò i ndryshuar, konstatohet se Ministria e Drejtësisë, nuk është shprehur në lidhje të VKM respektive, kjo në mbështetje të ligjit nr.9000 datë 30.01.2003 ñPër organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministraveò neni 28 shkronja (c), pasi këto akte janë me karakter individual, të cilat rregullojnë një marrëdhënie konkrete si dhe bazuar në ligjin nr.9000/2003 neni 24 paragrafi 2, në të cilin parashikohet se ñ*në çdo rast projektaktet, përveç atyre me karakter individual, i dërgohen për mendim Ministrit të Drejtësisë, i cili shprehet për ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes së tyre*ò, për rrjedhojë nuk mund të trajtohen nga Ministria e Drejtësisë.
(3) Agjencia e Prokurimit Publik (APP) në lidhje me miratimin e projektakteve, si produkt i procedurave të realizuara në bazë të VKM nr.203, datë 26.02.2020 ñProcedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetitò i ndryshuar, në disa raste është shprehur parimisht dakort përsa ka kompetencë dhe në disa raste nuk ka bërë asnjë koment, me arsyetimin si vijon ñ*APP konstaton se, projektvendimi mbështetet në nenin 6 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimit publik" i ndryshuar (në vijim "LPP"), si dhe në pikën 1 të kreut VII të VKM nr.203, datë 26.02.2020 "Procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit" i ndryshuar. Neni 6 i LPP parashikon se "Ky ligj nuk zbatohet në përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike, në rast se zbatimi i tyre kërkon masa të veçanta sigurie, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi ose në rast se një gjë e tillë diktohet nga interesat thelbësore të shtetit*ò.
(4) Ministria e Financave dhe Ekonomisë është shprehur pa koment për sa kohë fondet buxhetore të parashikuara janë brenda buxhetit të miratuar për MSHMS.
Të gjitha,shkresat kanë ardhur me vulë elektronike për shkak të pandemisë.
Për sa më sipër, u konstatua, miratimi me VKM respektive, për Lotet e realizuar dhe shpallur fitues me operatorin ekonomik përkatës.
-Lot 5-Oseltamivir(Tamiflu) është lidhur kontrata me nr.1573/28, datë 06.04.2020me operatorin Rejsi Pharma, me vlerë 885,000 lekë pa tvsh, me afat lëvrimi 50% e sasisë jo më vonë se 7 ditë dhe 50% e sasisë jo më vonë se 14 ditë. Me Vendimin e KM nr.314, datë 18.04.2020 është miratuar kontrata me objekt Lot 5-Oseltamivir(Tamiflu).
-Lot 8-Omeprazol është lidhur kontrata me nr.1573/31, datë 07.04.2020me operatorin MeghaPharma, me vlerë 9,666,250 lekë pa tvsh, me afat lëvrimi 44% e sasisë jo më vonë se 7 ditë dhe 56% e sasisë jo më vonë se 14 ditë. Me Vendimin e KM nr.313, datë 18.04.2020 është miratuar kontrata me objekt Lot 8-Omeprazol.
-Lot 9-Propofol, është lidhur kontrata me nr.1573/30, datë 06.04.2020me operatorin Rejsi Pharma, me vlerë 359,766 lekë pa tvsh, me afat lëvrimi 50% e sasisë jo më vonë se 7 ditë dhe 50% e sasisë jo më vonë se 14 ditë. Me Vendimin e KM nr.320, datë 18.04.2020 është miratuar kontrata me objekt Lot 9-Propofol.
-Lot 10-Beclomethasone+salbutamol është lidhur kontrata me nr.1573/32, datë 07.04.2020me operatorin Medicamenta, me vlerë 513,000 lekë pa tvsh, me afat lëvrimi 50% e sasisë jo më vonë se 7 ditë dhe 50% e sasisë jo më vonë se 14 ditë. Me Vendimin e KM nr.315, datë 18.04.2020 është miratuar kontrata me objekt Lot 10-Beclomethasone+salbutamol.

3-Mbi auditimin e procedurës me objekt "Blerje Materiale Për Mbrojtje Personale Për Covid -19"me fond limit prej 307,844,333 lekë pa tvsh.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe ,moshë pediatrike për COVID-19"

Lloji i Procedurës së Prokurimit : Procedurë e drejtëpërdrejtë në zbatim të VKM Nr.203, datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetitò i ndryshuar	Me urdhrin nr.151, datë 09.03.2020 është ngritur grupi i punës për përcaktimet e specifikimeve teknike grupi përbëhet nga : 1. L.P, 2. S. N. 3. N. C.	Me urdhrin nr.155, datë 10.03.2020 është ngritur komisioni i vlerësimit për marrjen, shqyrtimin, vlerësimin e ofertave nga kandidatët dhe ofertuesit dhe lidhjen e kontratës për procedurën e prokurimit, komisioni përbëhet nga: 1. M. Xh, 2. J. D, 3. F B, 4. J.J 5. S. K.
5.Fondi Limit (pa tvsh) 307,844,333 lekë pa tvsh	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** BOE E.. shpk dhe F.. N.. shpk, me vlerë kontrate 288,421,500 lekë	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 19,422,833
8. Data e hapjes së tenderit Data 16.03.2020	**9.Burimi Financimit nga** Buxheti i Shtetit	**Ofertat ekonomike** BOE E... shpk dhe F.. N.. shpk, me vlerë kontrate 288,421,500 lekë
11. Ankimime Nuk ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK ï nuk ka	**13. Përgjigje** Ankesës nga KKP ï nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1366/18, datë 18.03.2020 midis Ministrisë së Shëndetësië dhe BOE E.. shpk dhe F.. N.. shpk, me vlerë kontrate 288,421,500 lekë pa tvsh dhe me afat lëvrimi 15% e sasisë së artikujve do të lëvrohet brenda 7 ditëve, 75 jo më vonë se 6 javë dhe tamonat jo më vonë se 8 javë nga lidhja e kontartës		

-Me urdhrin nr.151, datë 09.03.2020 është ngritur grupi i punës për përcaktimet e specifikimeve teknike për procedurat e prokurimit ñBlerje materiale për mbrojtje personale për Covid-19ò dhe ñFurnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për Covid-19ò, grupi përbëhet nga : L. P, S. N. dhe N. C.
-Me urdhrin nr.152, datë 09.03.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm janë miratuar rrethanat e gjendjes në kushtet e interesave thelbësore të shtetit dhe domosdoshmërinë e aplikimit të procedurës së përcaktuar ne VKM nr. 203, datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetitò.
- Me Urdhrin me nr.153, datë 10.03.2020, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, znj.G.P ka deleguar znj.M.Xh., Drejtore e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kompetencat, në cilësinë e nëpunësit autorizues për zbatimin e detyrave të parashikuara në VKM nr 203, datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetitò për dy procedura prokurimi me objekt ñBlerje materiale për mbrojtje personale për Covid-19ò dhe ñFurnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për Covid-19ò.
-Me urdhrin nr.155, datë 10.03.2020 është ngritur komisioni i vlerësimit për marrjen, shqyrtimin, vlerësimin e ofertave nga kandidatët dhe ofertuesit dhe lidhjen e kontratës për procedurën e prokurimit, komisioni përbëhet nga: M. Xh, J. D, F. B, J. J dhe S. K. Komisioni ka arsyetuar se të ndodhur në kushtet e një nevoje urgjente për këto objekte, në kushtet e rrethanave të jashtëzakonshme të fatkeqësisë natyrore, në kushtet kur koha nuk është e mjaftueshme për zhvillimin normal të procedurave ka propozuar miratimin *e **procedurës së drejtëpërdrejtë** në zbatim të pikës IV.2 të Kreut IV të vendimit të Këshillit të Ministravë Nr.203, datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit" i ndryshuar*. Me shkresën nr.1366/5, datë 14.03.2020 është miratuar procedura e

drejtpërdrejtë e zhvillimit të procedurës së prokurimit ñBlerje materiale për mbrojtje personale për COVID-19ò.
Për llogaritjen e fondit limit i janë dërguar ftesa për testim tregu me shkresat nr.1366/2, datë 11.03.2020, 5 operatorëve për të cilët nga Komisioni thuhet se u është dërguar ftesë për tesim tregu operatorëve të cilët kanë fushën e veprimtarisë së tyre aktivitet të ngjashëm me procedurën që po realizohet.

1. O...D....
2. B.... A.... shpk
3. M.... shpk
4. E.... shpk
5. F.... N... A...

Nga auditimi u konstatua se **mungojnë** ofertat e paraqitura nga operatorët që u është dërguar ftesë, dhe në dosje është vetëm procesverbali i mbajtur nga komisioni mbi ofertat e paraqitura, por jo ofertat fizike.
Është mbajtur procesverbali mbi paraqitjen dhe vlerësimin e ofertave ku konstatohet se u është dërguar ftesë për pjesëmarrje 3 operatorëve dhe është paraqitur 1 bashkim operatorësh, i cili janë vlerësuar në bazë të dokumentacionit të sjellë dhe sipas peshës specifike të secilit kriter .
Operatorët që kanë paraqitur oferta , koha e lëvrimit dhe tabela e pikëve nga KVO janë në tabelën më poshtë:

Nr	Operatorët	Vlera e ofertës	Afati i lëvrimit	Pikët e vlerësuara	
1	BOE F.. N.. dhe E...	307,171,500 lekë pa tvsh	15% e sasisë së artikujve do të lëvrohet brenda 7 ditëve, 75 jo më vonë se 6 javë dhe tamponat jo më vonë se 8 javë nga lidhja e kontartës	100 pikë	1

Me shkresën nr.1366/12, datë 17.03.2020 është miratuar raporti përmbledhës i procedurës, ku është shpallur fitues bashkimi i operatorëve F... N.. dhe E.... shpk.
Është ngritur Urdhri nr.187, datë 18.03.2020 për negocimin e kontratës me objekt ñBlerje materiale për mbrojtje personale (MMP) për Covid-19ò.
Është mbajtur relacioni i negocimit të kontratës ku është rënë dakort që afatet e lëvrimit të përmbushen me përpikmëri, së dyti është negociuar për çmimin e ofertës ku është rënë dakort për uljen e çmimit në vlerën 288,421,500 lekë pa tvsh.
Është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1366/18, datë 18.03.2020 midis Ministrisë së Shëndetësië dhe BOE ñE.... shpk & F... N... shpkò, me vlerë kontrate 288,421,500 lekë pa tvsh dhe me afat lëvrimi 15% e sasisë së artikujve do të lëvrohet brenda 7 ditëve, 75% jo më vonë se 6 javë; Për artikullin 10 (tamponë laboratori) e gjithë sasia të lëvrohet jo më vonë se 8 javë nga lidhja e kontratës.*Vendosja e afateve të tilla e humbet konceptin e emergjencës, kur në fakt nga ky prokurim i drejtpërdrejtë AK ka siguruar vetëm 15% të sasisë së kërkuar për përmbushjen e nevojës emergjente.*
Me Vendimin nr.241, datë 21.03.2020 të Këshillit të Ministrave është miratuar kontrata me objekt ñBlerje materiale për mbrojtjen personale për Covid-19ò.
Nga auditimi konstatohet se Ministria e Drejtësisë nuk është shprehur për këtë kontratë pasi e kanë konsideruar si projekt-akt me karakter individual. APP është shprehur se në situata të tilla të interesit thelbësore të shtetit nuk ndiqen procedurat e prokurimit sipas LPP. Ministria e Financave dhe Ekonomisë është shprehur pa koment për sa kohë fondet buxhetore të parashikuara janë brenda buxhetit të miratuar për MSHMS. Shkresat kanë ardhur me vulë elektronike për shkak të pandemisë.

4.Mbi auditimin e procedurës me objekt "Blerje Kite dhe reagentë, Evadim mbetje anti Covid-19"

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "*Blerje Kite dhe reagentë, Evadim mbetje anti Covid-19*"		
Lloji i Procedurës së Prokurimit : Procedurë e drejtëpërdrejtë në zbatim të VKM Nr.203, datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetitò i ndryshuar	Me urdhrin nr.	Me urdhrin nr.200, datë 24.03.2020 është ngritur komisioni i vlerësimit për marrjen, shqyrtimin, vlerësimin e ofertave nga kandidatët dhe ofertuesit dhe lidhjen e kontratës për procedurën e prokurimit, komisioni përbëhet nga: 1. J.J 2. S.N 3. E.H 4. J. S 5. E. A
5.Fondi Limit (pa tvsh) Loti i I ñBlerje kite dhe reagentë për Laboratorin Mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisjen e Existation të firmës Bioneer ose ekuivalentò, 9,433,333 lekë pa tvsh. Loti i II ñTrajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me COVID-19 3,144,150 lekë pa tvsh.	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** -Për Lotin e parë ñBlerje kite dhe reagentë për Laboratorin Mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisjen e Existation të firmës Bioneer ose ekuivalentò, O... D.... shpk me vlerë 8,500,000 lekë pa tvsh -Për Lotin e dytë ñTrajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me COVID-19, për një periudhë deri në tre muajò E.. R...shpk me vlerë 2,959,200 lekë pa tvsh.	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** -Loti i I ï 933,333 lekë pa tvsh -Loti i II ï 184,950 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit Data 23.03.2020	**9.Burimi Financimit nga** Buxheti i Shtetit	
11. Ankimime-Nuk ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK ï nuk ka	**13. Përgjigje** Ankesës nga KKP ï Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
15.Komisioni i marrjes në dorëzim: V. P S.L J. S E. Q. M. M	**14. Lidhja e kontratës** Për lotin e parë ñBlerje kite dhe reagentë për Laboratorin Mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisjen e Existation të firmës Bioneer ose ekuivalentò është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1574/13, datë 30.03.2020 midis Ministrisë së Shëndetësië dhe O... D.... shpk, me vlerë kontrate 8,500,000 lekë pa tvsh dhe me afat lëvrimi 2 orë nga momenti i konfirmimit të pranimit nga Autoriteti Përfitues,. Është paguar me USH nr.596 datë 12.08.2020, 2020 detyrimet janë shlyer përtej afatit 30 ditor që është detyrimi ligjor. Për lotin e dytë ñTrajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me COVID-19, është lidhur kontrata me nr.1574/12, datë 30.03.2020 midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe E... R... shpk me vlerë 2,959,200 lekë pa tvsh me afat lëvrimi 3 muaj nga data e miratimit të kësaj kontrate me VKM. Me shkresën nr.1574/14, datë 05.04.2020 janë dërguar për zbatim kontratat në Qendrën Spitalore Universitare ñNënë Terezaò.	

Është miratuar Urdhri me nr.197, , datë 24.03.2020, i Titullarit të Autoritetit Kontraktor ñPër miratimin e rrethanave të gjendjes në kushte thelbësore të shtetitò, për domosdoshmërinë e aplikimit të procedurës së përcaktuar me VKM nr.203 datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetitò .
Është miratuar Vendimi nr.1563, datë 24.03.2020 i Komitetit Teknik i ngritur me Urdhër Ministri nr.53, datë 31.01.2020 lidhur me planin e masave të marra gjatë shpërthimit epidemik të koronavirusit të ri COVID-19, ku mbështetur në planin e masave të marra ndaj shpërthimit epidemik të koronavirusit të ri, rekomandimeve të OBSH, Komiteti Teknik ka vlerësuar të

domosdoshëm krijimin e stokut për mallra anti COVID-19 dhe përshtatjen e disa ambienteve të spitaleve QSUT, SUOGJ dhe SUSM për hospitalizimin e pacientëve të prekur me COVID-19.
Mbeshtetur në VKM nr. 203, date 26.02.2020, me urdhrin nr. 200, datë 24.03.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm, është ngritur komisioni i vlerësimit për marrjen, shqyrtimin, vlerësimin e ofertave nga kandidatët dhe ofertuesit dhe lidhjen e kontratës për blerje kite dhe reagentë , evadim mbetje anti covid-19, komisioni përbëhet nga: J.J, drejtore e Drejtorisë së Koncensioneve, S.N, përgjegjëse e sektorit të Standarteve dhe Administrimit të Shërbimit Spitalor dhe Shërbimeve Sociale, E.H, specialist i sektorit të Rregullimit të Tregut Farmaceutik dhe Pajisjeve Mjekësore, J. S, specialist i sektorit të Programeve të zhvillimit të shëndetit publik dhe parësor, E. A përgjegjës i sektorit të koordinimit dhe integrimit.

Komisioni i Vlerësimit është ngritur **në kundërshtim** me VKM nr.203 datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetitò, kreu V , pika 2 ku parashikohet se ñ Komisioni i Vlerësimit kryesohet nga Nëpunësi Autorizues dhe ka në përbërje të tij nëpunës të nivelit të lartë dhe të mesëm të autoritetit kontraktor.....ò.

Me shkresën nr.1387/4, datë 17.03.2020, është bërë argumentimi i fondit limit nga grupi i punës i ngritur me urdhër nr. 84 prot, datë 13.03.2020 në Qendrën Spitalore Universitare ñNënë Terezaò.Llogaritja e fondit limit u bë për tre muaj duke u bazuar në testimin e tregut . Për Lotin e parë ñTrajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me COVID-19, për një periudhë deri në tre muajò fondi limit është në vlerën 3,144,150 lekë pa tvsh.
Me shkresën nr.1388/7, datë 18.03.2020, është bërë argumentimi i fondit limit nga grupi i punës i ngritur me urdhër nr. 87 prot, datë 13.03.2020 në Qendrën Spitalore Universitare ñNënë Terezaò. Llogaritja e fondit limit u bë duke u bazuar në testimin e tregut. Për Lotin e dytë ñBlerje kite dhe reagentë për Laboratorin Mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tû përdorur për pajisjen e Existation të firmës Bioneer ose ekuivalentò, fondi limit është në vlerën 9,433,333 lekë pa tvsh.
Komisioni ka arsyetuar se të ndodhur në kushtet e një nevoje urgjente për këto objekte , në kushtet e rrethanave të jashtëzakonshme të fatkeqësisë natyrore, në kushtet kur koha nuk është e mjaftueshme për zhvillimin normal të procedurave ka propozuar miratimin *e **procedurës së drejtëpërdrejtë** në zbatim të pikës IV.2 të Kreut IV të vendimit të Këshillit të Ministravë Nr.203, datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit" i ndryshuar*. Me shkresën nr.1574/1, datë 26.03.2020 është miratuar procedura e drejtpërdrejtë e zhvillimit të procedurës së prokurimit ñBlerje Kite dhe reagentë, Evadim mbetje anti COVID-19ò.
Me shkresën nr.1574/2 ñKërkesë për propozimeò u është dërguar ftesë operatorëve si më poshtë:
Për lotin e parë Blerje kite: O... D... dhe E... shpk.
Për lotin e dytë E.. R... dhe V.A.L.E R....

Nga auditimi konstatohet se nga Komisioni **nuk** është dhënë asnjë shpjegim përse janë përzgjedhur këta operatorë për pjesëmarrje në prokurim, pasi dhe në VKM *Nr.203, datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit"nuk shpjegohen hapat që duhet të ndjeki operatori për përzgjedhjen e operatorëve që do të marrin pjesë në prokurim. Nga auditimi konstatohet se në dosje mungojnë dokumentat standarte të tenderit.*

Është mbajtur procesverbali me nr.1574/6, datë 27.03.2020 nga Komisioni i Vlerësimit, mbi vlerësimin e Ofertave të paraqitura për procedurën e drejtëpërdrejtë me objekt ñBlerje Kite dhe Reagentë, Evadim Mbetje Anti Covid-19ò, ku janë paraqitur si më poshtë:
Për Lotin e parë ñBlerje kite dhe reagentë për Laboratorin Mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisjen e Existation të firmës Bioneer ose ekuivalentò,është paraqitur një operator O... D....shpk me vlerë 8,500,000 lekë pa tvsh

Për Lotin e dytë ñTrajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me COVID-19, për një periudhë deri në tre muajò është paraqitur një operator E...R.... me vlerë 2,959,200 lekë pa tvsh.
Me shkresën nr.1574/5, datë 27.03.2020 janë shpallur fitues dy operatorë : O... D... shpk dhe operatori E.. R... shpk.
Me shkresën nr.1574/9, datë 30.03.2020, është ngritur Urdhri me nr.209, datë 30.03.2020 mbi negocimin e kontratave me objekt ñBlerje Kite dhe Reagentë, Evadim Mbetje Anti Covid -19 ndarë në lote ò.
Janë mbajtur dy procesverbale mbi negocimin e kontratave përkatësisht, ku kanë rënë dakort për zbatimin e afateve të lëvrimit dhe respektimit të kontratës.
Është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1574/13, datë 30.03.2020 midis Ministrisë së Shëndetësië dhe O... D.... shpk, me vlerë kontrate 8,500,000 lekë pa tvsh dhe me afat lëvrimi 2 orë nga momenti i konfirmimit të pranimit nga Autoriteti Përfitues, për lotin e parë ñBlerje kite dhe reagentë për Laboratorin Mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisjen e Existation të firmës Bioneer ose ekuivalentò.
Me Vendimin nr.322, datë 18.04.2020 të Këshillit të Ministrave është miratuar kontrata me objekt ñBlerje materiale për mbrojtjen personale për Covid-19ò.
Nga auditimi konstatohet se Ministria e Drejtësisë **nuk** është shprehur për këtë kontratë pasi e kanë konsideruar si projekt-akt me karakter individual.
APP është shprehur se në situata të tilla të interesit thelbësore të shtetit nuk ndiqen procedurat e prokurimit sipas LPP.
Ministria e Financave dhe Ekonomisë është shprehur pa koment për sa kohë fondet buxhetore të parashikuara janë brenda buxhetit të miratuar për MSHMS. Shkresat kanë ardhur me vulë elektronike për shkak të pandemisë.

Për lotin e dytë ñTrajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me COVID-19, është lidhur kontrata me nr.1574/12, datë 30.03.2020 midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe E... R... shpk me vlerë 2,959,200 lekë pa tvsh me afat lëvrimi 3 muaj nga data e miratimit të kësaj kontrate me VKM. Me shkresën nr.1574/14, datë 05.04.2020 janë dërguar për zbatim kontratat në Qendrën Spitalore Universitare ñNënë Terezaò.
Me Vendimin nr.273, datë 03.04.2020 të Këshillit të Ministrave është miratuar kontrata me objekt ñBlerje materiale për mbrojtjen personale për Covid-19ò.
Nga auditimi konstatohet se Ministria e Drejtësisë **nuk** është shprehur për këtë kontratë pasi e kanë konsideruar si projektakt me karakter individual.
APP është shprehur se në situata të tilla të interesit thelbësore të shtetit nuk ndiqen procedurat e prokurimit sipas LPP.
Ministria e Financave dhe Ekonomisë është shprehur pa koment për sa kohë fondet buxhetore të parashikuara janë brenda buxhetit të miratuar për MSHMS. Shkresat kanë ardhur me vulë elektronike për shkak të pandemisë.

- Me procesverbalin e negocimit mbajtur më datë 30.03.2020, parashtrohet kërkesa për të qëndruar korrekt në zbatimin e afateve të lëvrimit të marra përsipër nga ana e tyre. Operatorët ekonomik, shprehin gatishmërinë për të përmbushur me përpikmëri afatet e lëvrimit, pasi ndodhemi në një situatë që është emergjencë botërore. Me raportin përfundimtar miratohet procedura e prokurimit nga titullari i Autoritetit Kontraktor.

1. Me procesverbalin datë 22.04.2020, në prani të komisionit të ngritur me Urdhër të brendshëm nr. 119 datë 06.04.2020, A.L, M.H dhe I. V të QSUNT dhe Administratorin e OE ñE.. R...ò, për sasitë e mbetjeve të rrezikshme të tërhequra nga shërbimet ku marrin trajtim pacientët e infektuar me COVID-19. Me faturën tatimore nr. 57 datë 22.04.2020, realizohet shërbim trajtimi mbetjeve.
Kontrata me nr. ***1574/13 datë 30.03.2020***, me objekt ñ*Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik*

*për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisje e Existation te firmës Bioneer ose ekuivalent*ò midis O.E. ñD.ò dhe Autoriteti Kontraktor Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me afat lëvrimi i të gjithë mallit brenda **2 orëve** nga momenti i konfirmimit të pranimit nga Autoriteti përfaqësues Qendra Spitalore Universitare ñNënë Terezaò Tiranë. Në kushtet e veçanta të kontratës citohen dokumentet shoqëruese të mallit i cili do të shoqërohet me faturën e shitjes së mallit të lëvruar si faturë tatimore. Kontrata do të sigurohet në masën 10% të vlerës së kontratës me TVSH, deri në përfundimin e kohëzgjatjes së kontratës. Në **nenin 22** ñForca Madhoreò të kushteve të përgjithshme të kontratës citohen si më poshtë:

22.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësimin nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së forcës madhore.

22.2 Për qëllimet e këtij neni ñForcë Madhoreò do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e AK qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo transiti.

22.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë AK. Me përjashtim kur AK jep direktiva të ndryshme, kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Tek shtesat dhe ndryshimet në Kushtet e veçanta të kontratës citohet se palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë element të kontratës që do të ndryshojë mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit. Asnjë amendament tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, të referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga përfaqësuesit e autorizuar të të dy palëve.

Në **nenin 23** të KPK ñ*Vonesa në zbatimin dhe zgjatjen e Afatit*ò përcaktohet si më poshtë:

23.1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

23.2. Me përjashtim të rasteve kur Autoriteti Përgjegjës është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Përgjegjës ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në dorëzimin e Mallrave brenda periudhës së zbatimit të specifikuar në kontratë.

23.3. Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë Kontraktuesin me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

23.4. Autoriteti Kontraktor pranon zgjatjen e afatit në rastin e Forcës Madhore.

23.5. Autoriteti Kontraktor mund pranojë zgjatjen e afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë me përpikmëri Autoritetin Përgjegjës me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Përgjegjës duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Përgjegjës është dakord me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Përgjegjës dhe Kontraktuesi.

Në **nenin 24** të KPK ñ*Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar"* përcaktohet si më poshtë:

24.1. Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore ***4/1000 të vlerës*** koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Me shkresën nr. 578/268 prot. datë 22.04.2020 të Qendrës Spitalore Universitare ñNënë Terezaò drejtuar MSHMS, dërgohet dokumentacioni i akteve origjinale të marrjes në dorëzim me nr.

578/258 datë 16.04.2020.
Me shkresën nr. 39/22 prot datë 21.04.2020 të Drejtorisë së Shërbimit farmaceutik, drejtuar MSHMS dhe O.E, kontrata me nr. Prot. 578/258 datë 16.04.2020 me kompaninë ñO... D....ò me fetë hyrje nr. 16643.
Akti i Kolaudimit dhe marrjes në dorëzim është mbajtur më datë 16.04.2020 në Depon qendrore të Shërbimit farmaceutik për pritjen dhe kolaudimin e materialeve mjekësore të furnizuara nga OES Distrimed me faturë tatimore nr. 284347281 datë 16.04.2020. Komisioni mbasi kontrolloi kitet mjekësore të furnizuar sipas dokumentit, konstaton se ato janë në zbatim të kontratës 1574/ 13 datë 30.03.2020. Mbi bazën e aktit të kolaudimit Depo Qendrore të administrojë dokumentacionin e magazinës si dhe kryerjen e veprimeve përkatëse me kontraktuesin. Komisioni i marrjes në dorëzim përbëhet nga V. P, S. L, J. S, E. Q dhe M.M.
Sa më sipër, ñO... D...ò, nuk ka njoftuar apo nuk disponohet asnjë dokumentacion shkresor apo amendim kontrate, mbi vonesat e dorëzimit të mallrave prej 17 ditësh.
Sipas **nenit 24** ñ*Likuidimi i dëmeve për dorëzim të vonuar*ò ñkontraktuesi kur nuk realizon këtë kontratë brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzim të vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratësò. Sipas kontratës për **2 orë** do të furnizoheshin 20 kite ñ*AccuPower Sars – Cov -2 real time PCR",* me vlerën 10,200,000 lekë me tvsh.
Në lidhje mbi observimet dërguar nga MSHMS në lidhje mbi Projekt raportin e përcjellë nga KLSH me shkresë nr.121/10 prot datë 03.09.2021, të cilat kanë ardhur më datë 14.10.2021 jashtë afatit kohor të parashikuar në ligjin 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit neni 26 dhe 29ô me shkresë nr.415/47 prot të MSHMS dhe me nr.121/11 prot datë 14.10.2021 të KLSH, ju bëjmë me dije:
Mbi procedurën me objekt ñ*Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisje e Existation te firmës Bioneer ose ekuivalent*ò,në Projekt raportin, nga grupi i auditimit është bërë lapsus mbi vlerën e penalitetit, për të cilën e ripamë dhe i qëndrojmë vlerës prej 693,600 lekë me tvsh, paraqitur dhe në Aktkonstatimit nr.14 të datës 30.04.2021.
Ndërsa në lidhje mbi penalitetet si pasojë e dorëzimit me vonesë të mallit/ shërbimit/ ilaçeve, në mosplotësim të detyrimit kontraktor, për kontratat e tjera të paraqitura në projekt raport, audituesit e KLSH , i ri vlerësuan dhe observimet e dyta, të cilat nuk kanë paraqitur dokumentacion shtesë apo argumentim ligjor shtesë në lidhje mbi problematikën e konstatuar, për këtë qëllim, audituesit shprehen me të njëjtin qëndrim.
Zbatimi i kontratës:
Në përfundim rezultoi se, në lidhje me procedurën Kontrata me nr. ***1574/13 datë 30.03.2020***, me objekt ñ*Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisje e Existation te firmës Bioneer ose ekuivalent*ò, miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020, me vlerë kontrate 10,200, 000lekë me tvsh, është lidhur midis AK dhe O...ñD...ò shpk, i cili i ka ka dorëzuar 20 kite *"AccurPower Sars –Cov – 2 real time PCR"* 17 ditë me vonesë, për të cilin nuk u konstatua njoftim apo ndonjë dokumentacion shkresor, mbi vonesat e dorëzimit të mallrave. Kështu në bazë të detyrimit kontraktor neni 24 ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò ku parashikohet se ñ*Kontraktuesi, kur nuk realizon ketë kontratë Brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratë*s.ô
Sa më sipër, për vonesat e dorëzimit të mallit me 17 dite, nga data 30.03.2020 deri në 16.04.2020, penaliteti i llogaritur për dorëzim të vonuar është10,200,000 x 0,004 x17 ditë = **693,600 lekë me tvsh,** si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

Vecanërisht, në lidhje me përllogaritjen e penaliteteve, për problematikat e konstatuara, nga

*grupi i audituesve u mbajt Aktkonstatimi nr.14 datë 30.04.2021 me nr.415/20 prot të MSHMS,**mbi** të cilin MSHMS ka observuar me shkresa nr.415/26 prot, datë 07.05.2021 të MSHMS. Por,ky project raport pasi kaloi etapat e kontrollit të cilësisë, si edhe mbështetur mbi kontratat respektive , proces verbalet dhe faturat tatimore të dorëzimit të mallit/pajisje/shërbim për secilën kontratë, rivlerësoi detyrimin kontraktor në lidhje mbi "Likujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuar" duke konstatuar ndryshime në vlera të cilat paraqiten të përfunduara në këtë raport përfundimtar auditimi.*

5.Mbi auditimin e procedurës me objekt LOT I "Frunizim me produkte letre një përdorimëshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjenike për pacientët me COVID-19 dhe personelin mjekësor"

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Furnizim me produkte letre një përdorimëshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjenike për pacientët me COVID-19 dhe personelin mjekësor"		
Lloji i Procedurës së Prokurimit : Procedurë e drejtëpërdrejtë në zbatim të VKM Nr.203, datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetitò i ndryshuar		Me urdhrin nr.201, datë 24.03.2020 është ngritur komisioni i vlerësimit për marrjen, shqyrtimin, vlerësimin e ofertave nga kandidatët dhe ofertuesit dhe lidhjen e kontratës për procedurën e prokurimit, komisioni përbëhet nga: 1. F. B 2. J. J 3. V. Dh 4. E. K 5. E. A
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1,832,544 lekë pa tvsh	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** E.... shpk me vlerë oferte 1,779,030 lekë pa tvsh.	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 53,514 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit Data 02.04.2020	**9.Burimi Financimit nga** Buxheti i Shtetit	
11. Ankimime-Nuk ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK ï nuk ka	**13. Përgjigje** Ankesës nga KKP ï Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
15.Komisioni i marrjes në dorëzim:	**14. Lidhja e kontratës** Është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1575/18, datë 07.04.2020 midis Ministrisë së Shëndetësië dhe E.... 2010 shpk, me vlerë kontrate 1,779,030 lekë pa tvsh dhe me afat lëvrimi 30% brenda 24 orëve dhe pjesa tjetër brenda 3 muajve nga data e miratimit të kontratës me VKM. Me Vendimin nr.321, datë 18.04.2020 të Këshillit të Ministrave është miratuar kontrata me objekt ñBlerje materiale për mbrojtjen personale për Covid-19ò.	

Është miratuar Urdhri me nr.197, , datë 24.03.2020, i Titullarit të Autoritetit Kontraktor ñPër miratimin e rrethanave të gjendjes në kushte thelbësore të shtetitò, për domosdoshmërinë e aplikimit të procedurës së përcaktuar me VKM nr.203 datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetitò .
Është miratuar Vendimi nr.1563, datë 24.03.2020 i Komitetit Teknik i ngritur me Urdhër Ministri nr.53, datë 31.01.2020 lidhur me planin e masave të marra gjatë shpërthimit epidemik të koronavirusit të ri COVID-19, ku mbështetur në planin e masave të marra ndaj shpërthimit epidemik të koronavirusit të ri, rekomandimeve të OBSH, Komiteti Teknik ka vlerësuar të

domosdoshëm krijimin e stokut për mallra anti COVID-19 dhe përshtatjen e disa ambienteve të spitaleve QSUT, SUOGJ dhe SUSM për hospitalizimin e pacientëve të prekur me COVID-19.
Me urdhrin nr.201, datë 24.03.2020 është ngritur komisioni i vlerësimit për marrjen, shqyrtimin, vlerësimin e ofertave nga kandidatët dhe ofertuesit dhe lidhjen e kontratës për ñFurnizim me produkte letre një përdorimëshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjenike për pacientët me COVID-19 dhe personelin mjekësor*"*me përbërje: F.B,J.J,V.Dh, E. K, E. A.
Me shkresën nr.1480, datë 17.03.2020,dhe shkresën nr.1480/1, datë 19.03.2020 është bërë argumentimi i fondit limit dhe specifikimet teknike në Qendrën Spitalore Universitare ñNënë Terezaò.Llogaritja e fondit limit u bë duke u bazuar në testimin e tregut .
Komisioni ka arsyetuar se të ndodhur në kushtet e një nevoje urgjente për këto objekte , në kushtet e rrethanave të jashtëzakonshme të fatkeqësisë natyrore , në kushtet kur koha nuk është e mjaftueshme për zhvillimin normal të procedurave ka propozuar miratimin *e **procedurës së drejtëpërdrejtë** në zbatim të pikës IV.2 të Kreut IV të vendimit të Këshillit të Ministravë Nr.203, datë 26.02.2020* ñ*Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit" i ndryshuar*. Me shkresën nr.1575/1, datë 26.03.2020 është miratuar procedura e drejtpërdrejtë e zhvillimit të procedurës së prokurimit ñFurnizim me produkte letre një përdorimëshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjenike për pacientët me COVID-19 dhe personelin mjekësor*".*
Me ftesat për ofertë me nr.1575/8, datë 01.04.2020, Ak ka ftuar të paraqesin ofertat e tyre OE : E... shpk, A... shpk dhe M... D... shpk.
Nga auditimi konstatohet se nga Komisioni nuk është dhënë asnjë shpjegim pse janë përzgjedhur këta operatorë për pjesëmarrje në prokurim, pasi dhe në VKM *Nr.203, datë 26.02.2020* ñ*Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit"nuk shpjegohen hapat që duhet të ndjeki operatori për përzgjedhjen e operatorëve që do të marrin pjesë në prokurim.*
Nga auditimi konstatohet se në dosje mungojnë dokumentat standarte të tenderit.
Është mbajtur procesverbali datë 02.04.2020 nga Komisioni i Vlerësimit, mbi vlerësimin e Ofertave të paraqitura për procedurën e drejtëpërdrejtë me objekt ñFurnizim me produkte letre një përdorimëshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjenike për pacientët me COVID-19 dhe personelin mjekësor*"*, ku është*paraqitur vetëm një operator:
E. shpk me vlerë oferte 1,779,030 lekë pa tvsh.
Me shkresën nr.1575/12, datë 03.04.2020 është shpallur fitues operatori E.... 2... shpk .
Me shkresën nr.1575/15, datë 04.04.2020, është ngritur Urdhri me nr.237, datë 04.04.2020 mbi negocimin e kontratave me objekt ñFurnizim me produkte letre një përdorimëshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjenike për pacientët me COVID-19 dhe personelin mjekësor*".*
Është mbajtur procesverbali mbi negocimin e kontratës me nr.1575/17, datë 06.04.2020 , ku kanë rënë dakort për zbatimin e afateve të lëvrimit dhe respektimit të kontratës.
Është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1575/18, datë 07.04.2020 midis Ministrisë së Shëndetësië dhe E.... 2.... shpk, me vlerë kontrate 1,779,030 lekë pa tvsh dhe me afat lëvrimi 30% brenda 24 orëve dhe pjesa tjetër brenda 3 muajve nga data e miratimit të kontratës me VKM.
Me Vendimin nr.321, datë 18.04.2020 të Këshillit të Ministrave është miratuar kontrata me objekt ñBlerje materiale për mbrojtjen personale për Covid-19ò.
Nga auditimi konstatohet se Ministria e Drejtësisë nuk është shprehur për këtë kontratë pasi e kanë konsideruar si projektakt me karakter individual. APP është shprehur se në situata të tilla të interesit thelbësore të shtetit nuk ndiqen procedurat e prokurimit sipas LPP. Ministria e Financave dhe Ekonomisë është shprehur pa koment për sa kohë fondet buxhetore të parashikuara janë brenda buxhetit të miratuar për MSHMS. Shkresat kanë ardhur me vulë elektronike për shkak të pandemisë.
Me Vendimin nr.273, datë 03.04.2020 të Këshillit të Ministrave është miratuar kontrata me objekt ñBlerje materiale për mbrojtjen personale për Covid-19ò.

Nga auditimi konstatohet se Ministria e Drejtësisë nuk është shprehur për këtë kontratë pasi e kanë konsideruar si projektakt me karakter individual. APP është shprehur se në situata të tilla të interesit thelbësore të shtetit nuk ndiqen procedurat e prokurimit sipas LPP. Ministria e Financave dhe Ekonomisë është shprehur pa koment për sa kohë fondet buxhetore të parashikuara janë brenda buxhetit të miratuar për MSHMS. Shkresat kanë ardhur me vulë elektronike për shkak të pandemisë.

6. Mbi auditimin e procedurës me objekt LOT I "Spostimi i sistemit të dializës nga Pediatria e Specialiteteve tek godina e Spitalit Infektiv(Shërbimi i Alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me COVID-19)"

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Spostimi i sistemit të dializës nga Pediatria e Specialiteteve tek godina e Spitalit Infektiv(Shërbimi i Alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me COVID-19)"		
Lloji i Procedurës së Prokurimit : Procedurë e drejtëpërdrejtë në zbatim të VKM Nr.203, datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetitò i ndryshuar		Me urdhrin nr.201, datë 24.03.2020 është ngritur komisioni i vlerësimit për marrjen, shqyrtimin, vlerësimin e ofertave nga kandidatët dhe ofertuesit dhe lidhjen e kontratës për procedurën e prokurimit, komisioni përbëhet nga: 1. F.B 2. J. J 3. V. Dh 4. E. K 5. E. A
5.Fondi Limit (pa tvsh) 875,000 lekë pa tvsh	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** T... shpk me vlerë oferte 850,000 lekë pa tvsh.	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 25,000 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit Data 02.04.2020	**9.Burimi Financimit nga** Buxheti i Shtetit	
11. Ankimime-Nuk ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK ï nuk ka	**13. Përgjigje** Ankesës nga KKP ï Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
15.Komisioni i marrjes në dorëzim:	**14. Lidhja e kontratës** Është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1575/19, datë 07.04.2020 midis Ministrisë së Shëndetësië dhe T... shpk, me vlerë kontrate 850,000 lekë pa tvsh dhe me afat lëvrimi brenda 24 orëve nga data e miratimit të kontratës me VKM.	

Me urdhrin nr. 197, dt. 24.03.2020 ñ*Për miratimin e rrethanave të gjendjes në kushtet thelbësore të shtetit*ò, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS ka urdhëruar ñ*miratimin e rrethanave të gjendjes në kushtet e interesave thelbësore të shtetit dhe domosdoshmërinë e aplikimit të procedurave të përcaktuara në Vendimin e këshillit të Ministrave nr. 203, dt. 26.02.2020 "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit",* sipas tekstit bashkëngjitur këtij urdhri.

Nga Komitetit Teknik, i ngritur me Urdhër Ministri nr.53, datë 31.01.2020, është miratuar Vendimi nr.1563, datë 24.03.2020, lidhur me planin e masave të marra gjatë shpërthimit epidemik të koronavirusit të ri COVID-19, ku mbështetur në planin e masave të marra ndaj shpërthimit epidemik të koronavirusit të ri dhe rekomandimeve të OBSH, Komiteti Teknik ka vlerësuar të domosdoshëm krijimin e stokut për mallra anti COVID-19 dhe përshtatjen e disa ambienteve të

spitaleve QSUT, SUOGJ dhe SUSM për hospitalizimin e pacientëve të prekur me COVID-19, sipas kërkesave të disa spitaleve, ndër të tjera për:
5. *Spostimin e sistemit të dializës nga pediatria e specialiteteve tek godina e spitalit Infektiv (shërbimi i alergologjisë dhe reumatologjisë për pacientët dializantë të prekur me Covid-19) në QSUT.*
Me urdhrin nr.201, datë 24.03.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm, është ngritur komisioni i vlerësimit për marrjen, shqyrtimin, vlerësimin e ofertave nga kandidatët dhe ofertuesit dhe lidhjen e kontratës për ñSpostimi i sistemit të dializës nga Pediatria e Specialiteteve tek godina e Spitalit Infektiv (Shërbimi i Alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me COVID-19)*”* me përbërje: F. B, J. J, V. Dh, E. K, E. A.
Me shkresën nr. 1480, datë 17.03.2020, dhe shkresën nr.1480/1, datë 19.03.2020 është bërë argumentimi i fondit limit dhe specifikimet teknike në Qendrën Spitalore Universitare ñNënë Terezaò. Llogaritja e fondit limit u bë duke u bazuar në testimin e tregut.
Komisioni ka arsyetuar se të ndodhur në kushtet e një nevoje urgjente për këto objekte , në kushtet e rrethanave të jashtëzakonshme të fatkeqësisë natyrore , në kushtet kur koha nuk është e mjaftueshme për zhvillimin normal të procedurave ka propozuar miratimin *e **procedurës së drejtëpërdrejtë** në zbatim të pikës IV.2 të Kreut IV të vendimit të Këshillit të Ministravë Nr.203, datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit” i ndryshuar*. Në vijim, është miratuar procedura e drejtpërdrejtë e prokurimit, sipas shkresës nr. 1575/1, dt. 24.03.2020 ku, kryetare e komisionit të vlerësimit znj. F. B i është drejtuar Titullarit të autoritetit kontraktor (Miratuar) për miratim të propozimit për përdorim të procedurës së drejtpërdrejtë për procedurën ñ*për blerje produkte letre anti covid-19 si dhe spostimin e dializës nga pediatria e specialiteteve tek godina e spitalit infektiv (shërbimi i alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me Covid-19)” ndarë në dy lote ku si relacion shoqërues ka një material të Komitetit teknik dhe* <u>*relacionin e komisionit ku arsyeton se:*</u>

a. *Jemi në kushtet e një nevoje urgjente për furnizim me mallra dhe shërbime,.....*
b. *Jemi në kushtet e rrethanave të jashtëzakonshme të fatkeësisë natyrore e cila është jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor (miratuar me VKM nr. 243, dt. 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”)*
c. *Si pasojë e nevojave emergjente, koha në dispozicion nuk është e mjaftueshme për zhvillimin normal të procedurave të tjera .....*

Pra si mbas arsyetimeve të mësipërme të KV autoriteti kontraktor në përcaktimin e procedurës duhej tii ishte referuar Ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò i ndryshuar, Neni 33 ñ*Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit*ò

Është miratuar procedura e drejtpërdrejtë e zhvillimit të procedurës së prokurimit ñFurnizim me produkte letre një përdorimëshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjenike për pacientët me COVID-19 dhe personelin mjekësor*”.*
Me ftesat për ofertë me nr.1575/4, datë 31.03.2020, Ak ka ftuar të paraqesin ofertat e tyre OE: F... shpk, M... shpk, T... shpk.
Nga auditimi konstatohet se nga Komisioni **nuk** është dhënë asnjë shpjegim pse janë përzgjedhur këta operatorë për pjesëmarrje në prokurim, pasi dhe në VKM *Nr.203, datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit”nuk shpjegohen hapat që duhet të ndjeki operatori për përzgjedhjen e operatorëve që do të marrin pjesë në prokurim. Nga auditimi konstatohet se në dosje mungojnë dokumentat standarte të tenderit.*
Është mbajtur procesverbali datë 02.04.2020 nga Komisioni i Vlerësimit, mbi vlerësimin e Ofertave të paraqitura për procedurën e drejtëpërdrejtë, me objekt ñFurnizim me produkte letre një

përdorimëshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjenike për pacientët me COVID-19 dhe personelin mjekësor*”*, ku janë paraqitur operatoret:
F...shpk me vlerë oferte 875,000 lekë pa tvsh.
T.... shpk me vlerë oferte 850,000 lekë pa tvsh.
Me shkresën nr.1575/7, datë 01.04.2020 është shpallur fitues operatori T. shpk me vlerë oferte 850,000 lekë pa tvsh, si operatori me vlerë më të ulët.
Me shkresën nr.1575/15, datë 04.04.2020, është ngritur Urdhri me nr.237, datë 04.04.2020 mbi negocimin e kontratave me objekt ñFurnizim me produkte letre një përdorimëshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjenike për pacientët me COVID-19 dhe personelin mjekësor*”*.
Është mbajtur procesverbali mbi negocimin e kontratës me nr.1575/16, datë 06.04.2020 , ku kanë rënë dakort për zbatimin e afateve të lëvrimit dhe respektimit të kontratës.
Është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1575/19, datë 07.04.2020 midis Ministrisë së Shëndetësië dhe T.... shpk, me vlerë kontrate 850,000 lekë pa tvsh dhe me afat lëvrimi brenda 24 orëve nga data e miratimit të kontratës me VKM.
Me Vendimin nr.323, datë 18.04.2020 të Këshillit të Ministrave është miratuar kontrata me objekt ñBlerje materiale për mbrojtjen personale për Covid-19ò.
Nga auditimi konstatohet se Ministria e Drejtësisë nuk është shprehur për këtë kontratë pasi e kanë konsideruar si projektakt me karakter individual. APP është shprehur se në situata të tilla të interesit thelbësore të shtetit nuk ndiqen procedurat e prokurimit sipas LPP. Ministria e Financave dhe Ekonomisë është shprehur pa koment për sa kohë fondet buxhetore të parashikuara janë brenda buxhetit të miratuar për MSHMS. Shkresat kanë ardhur me vulë elektronike për shkak të pandemisë.

Zbatimi i kontratës:
Nga zbatimi i kontratës, në lidhje për procedurën ñ*Spostimi i sistemit të dializës nga Pediatria e Specialiteteve tek godina e Spitalit Infektiv (Shërbimi i Alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me Covid-19*ò është lidhur kontrata nr.1575/19, datë 07.04.2020 miratuar me VKM nr.323 datë 18.04.2020, me vlerë kontrate 850,000 lekë pa tvsh ose 1,020,000 lekë me tvsh. Ky shërbim dhe furnizimi duhej bërë brenda 24 orëve, ndërkohë që ka ardhur më datë 22.04.2020, dmth 2 ditë me vonesë (Nga Qendra Spitalore universitare, është dërguar proces verbali nr. Dt. 22.04.2020 i mbajtur nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 57/1, dt. 21.04.2020 ku vërteton kryerjen e punimeve (Cinstalim, transporti, instalimi) ..... Këto punime u kryen respektivisht sipas kushteve të kontratës si dhe detyrimit vtë të gjitha palëve. Fatura tatimore nr. 4055, dt. 22.04.2020 për 850,000 lekë pa tvsh ose 1,020,000 lekë me tvsh.)
Për rrjedhojë në zbatim të detyrimit kontraktor neni. 24 ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò ku parashikohet se ñ*Kontraktuesi, kur nuk realizon ketë kontratë Brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratë*s.ô AK duhet të kishte përllogaritur dhe ndalur penalitetin për dorëzimin e vonuar nga operatori ñT...ò shpk është (1,020,000x0,0,004 x2 ditë =**8,160 lekë me tvsh**, vlerë kjo e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

7.Mbi auditimin e procedurës me objekt “Blerje Kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHP*”e ndarë në 4 Lote, me fond limit 28,614 mijë lekë, paraqitur në aneksin nr.18.*
Me urdhrin nr. 197, dt. 24.03.2020 ñ*Për miratimin e rrethanave të gjendjes në kushtet thelbësore të shtetit*ò Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS ka urdhëruar ñ*miratimin e rrethanave të gjendjes në kushtet e interesave thelbësore të shtetit dhe domosdoshmërinë e aplikimit të procedurave të*

përcaktuara në Vendimin e këshillit të Ministrave nr. 203, dt. 26.02.2020 "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit", sipas tekstit bashkëngjitur këtij urdhri*".* Komiteti Teknik me shkresën pa datë *"Rrethanat e gjendjes në kushte të interesave thelbësore të shtetit"* ka vlerësuar se *"..... nisur nga fakti se situata e epidemisë në vend është e njëjtë madje edhe më e rënduar , nisur nga fakti që është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore me VKM nr. 243, dt. 24.03.2020, Komiteti ka hartuar rrethanat e përgjithshme të gjendjes të përgjithshme të gjendjes në kushtet e interesave thelbësore të shtetit të cilat miratohen nëpërmjet këtij urdhri dhe vendos rast pas rasti për nevojat që dalin për të kryer procedura kontraktimi nga ana e ministrisë për mallra punë dhe shërbime gjatë gjithë kohës së gjendjes së pandemisë ku interesi thelbësor i shtetit është mbrojtja e popullatës nga përhapja e infeksionit Covid-19*ò, ***vlerësim i cili është jashtë kompetencave dhe detyrave të miratuara*** me urdhrin nr. 53, dt. 31.01.2020 ñ*Për ngritjen e komitetit të përkohshëm për infeksionin e përhapur nga coronavirusi i ri*ò i cili përbëhet nga 12 anëtarë.

<u>*Ky komision ka për detyrë*</u>:

a. Të përgatisë dokumentacionin dhe të monitorojë procesin e verifikimit për rastet e mundshme të përhapjes së infeksionit të coronavirusit i ri.
b. Të rishikojë dhe monitorojë aktivitete verifikuese në nivel kombëtar bazuar në procedurat standarte operacionale dhe rekomandimet e OBSH-së.
c. Të përgatisë raportet kombëtare për zyrën rajonale të OBSH-së.
d. Të nxisë strukturat shëndetësore, Institutin e Shëndetit Publik, si dhe struktura të tjera lokalë dhe qendrore për zbatimin e planeve dhe urdhëresave për të monitoruar progresin kundrejt qëllimeve të eliminimit të përhapjes së infeksionit të coronavirus i ri.
e. Të përgatisë planet e veprimit për dokumentimin dhe verifikimin duke përcaktuar përgjegjësitë, produktet burimet dhe afatet kohore të aktivitetit në bashkëpunim me departamentin e epidemologjisë dhe kontrollin e sëmundjeve infektive në ISHP.
f. Të raportojë tek Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes Sociale për të gjitha çështjet dokumentet dhe vendimet e mara në mbledhjet e Komitetit.
g. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik, për zbatimin e këtij urdhri.

Urdhri i mësipërm nuk është në përputhje me VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 *"Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit", pika II, Fusha e zbatimit; përcaktohet se: "..... Përpara fillimit të aplikimit të kësaj procedure**, <u>rast pas rasti</u>**, titullari i autoritetit kontraktor me urdhër miraton rrethanat e gjendjes në kushtet e interesave thelbësorë të shtetit dhe domosdoshmërinë e aplikimit të saj".*

Gjykojmë se autoriteti konraktor në rastin e përhapjes së infeksionit COVID-19 *dhe gjendja e fatkeqësisë natyrore* në përcaktimin e procedurës duhej ti ishte referuar Ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò i ndryshuar, Neni33 ñ*Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit*ò pika 2/c ñ***<u>kur për arsye të nevojës ekstreme të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara nga autoriteti kontraktor</u>***.....ò, (*VKM nr. 243, dt. 24.03.2020"Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore"),* d, ñ*për blerje, që mundësojnë prokurimin e mallrave për një kohë lëvrimi shumë të shkurtër, ose për një rast veçanërisht të leverdishëm, që paraqitet në një kohë shumë të shkurtër dhe me një çmim, dukshëm, më të ulët se çmimet normale të tregut dhe në përputhje me kriteret e parashikuara në rregullat e prokurimit publik"* dhe VKM nr. 914, dt. 29.12.2014 ñP*ër miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar neni 36, "Procedura me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës" pika 2/c," Në rastin e <u>një nevoje ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara</u>, që nuk i ngarkohen autoritetit kontraktor. Në këtë rast, duhet të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme: - Shkaktimi i një ngjarjeje të paparashikuar; - Autoriteti kontraktor nuk ka përgjegjësi për ngjarjen; - Ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshëm të një komuniteti të gjerë;* <u>pika 3</u>, ñ*Urdhri për prokurim, siç parashikohet*

në nenin 60 të këtyre rregullave, duhet të paraqesë arsyet e përdorimit të kësaj procedure. 4, 6, pika 7, ñ*Në rastin e procedurës së prokurimit me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, afatet kohore parashikohen nga vetë autoriteti kontraktor, në varësi të objektit të prokurimit dhe rrethanave".*
Sa më lartë për aplikimin e procedurës *"Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit"* gjykojmë duke patur parasysh Urdhrin nr.133, datë 08.03.2020 ñ*Për kufizimin e lëvizjes së shoqëruesve dhe ose familjarëve të pacientëve nëpër spitale*ò, urdhrit 135/1 datë 09.03.23020 ñ*Për mbylljen e veprimtarisë çerdheve, për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-19",* Urdhrit nr 135, datë 09.03.2020 ñ*Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së COVID-19*ò, *vendimin e Komitetit Teknik nr. 566/3, dt. 06.03.2020 për domosdoshmërinë e krijimit të stokut për Mjetet Mbrojtëse Personale.*

Nga Komitetit Teknik është marrë Vendimi i nr. 1635, dt. 29.03.2020 për sigurimin **në mënyrë sa më të shpejtë** nga MSHMS të mallrave dhe shërbimeve/punëve, sipas kërkesave të disa spitaleve për:
1. *Kite, reagente, MMP dhe materiale konsumi për laboratorë, për ISHP, sipas kërkesës dhe blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën serologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 Snibe Co. LTD ose ekuivalent në QSUT, sipas kërkesave"* .
Me VKM Nr. 205, Datë 9.3.2020 ñ*Për një shtesë fondi në buxhetin e vitin 2020, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për infeksionin e shkaktuar nga covid-19*ò Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në programin ñ*Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi*ò, i shtohet fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për infeksionin e shkaktuar nga COVID-19.

Me shkresën 1776/1, dt. 08.04.2020 **Komisioni i vlerësimit ka përcaktuar dhe miratuar nga titullari procedurën "*E drejtpërdrejtë*"** (mungon si dokument) që do përdoret në funksion të VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 *"Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit",* kreu V, pika *3. Komisioni i Vlerësimit ka këto detyra specifike:*
a) të përcaktojë procedurën që duhet ndjekur për realizimin e kontratës dhe ta paraqesë për miratim te titullari i autoritetit kontraktor.

Me shkresën nr.1621/1, datë 03.04.2020 është ngritur Urdhri me nr.229 për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit, për procedurën e prokurimit me përbërje: A. A, I. H dhe N. A. Komisioni ka hartuar vetëm fondin limit për materialet e emrgjencës për sektorin e virologjisë ISHP për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID, ndërsa specifikimet teknike dhe fondi limit për kitet janë marrë nga QSUT me shkresën nr.1388/8, datë 19.03.2020
Me urdhrin nr.252, datë 08.04.2020 është ngritur komisioni i vlerësimit për marrjen, shqyrtimin, vlerësimin e ofertave nga kandidatët dhe ofertuesit dhe lidhjen e kontratës për ñBlerje Kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò me përbërje: J. D, L.Sh, A. A, N. A dhe E.K.

Nga autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1776/2, dt. 09.04.2020 janë dërguar kërkesa për propozime ku ftohen për të paraqitur oferta, 6 operatorë për: ñ*Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën serologjike, të përshtatshme për pajisjen Maglum 800 Snibe CO LTD ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për Covid-19 në ISHP,* ku bashkëngjitur kanë setin e dokumenteve të tenderit:

Informacioni i përgjithshëm

Formulari i ofertës ekonomike për 4 lote.
Specifikimet teknike
Deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike,
Deklarata mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme,

*Koha e zbatimit të kontratës nga 10 ditë deri 55 ditë afati maksimal kur me shkresat nr. 1621/2, dt. 05.04.2020 autoriteti kontraktor u ka kërkuar 6 subjekteve (*O... D..., B... A..,K... shpk, Al M..., B... A.... dhe G... shpk), *sipas dokumentit "Ftesë dhënie ofertë" se "Mbështetur në situatën emergjente në të cilën ndodhemi dhe domosdoshmërinë e madhe të këtyre artikujve ju sqarojmë se koha e lëvrimit të të gjithë sasisë së artikujve pjesë e kësaj procedure është brenda 7 (Shtatë) ditëve nga dita e lidhjes së kontratës".*

Ndryshimi i afateve në kërkesat për propozime **nga 7 ditë deri 55 ditë** është në kontradiktë me përcaktimin nga Autoriteti kontraktorpër emergjnecën e situatës*: "Mbështetur në situatën emergjente në të cilën ndodhemi dhe domosdoshmërinë e madhe të këtyre artikujve ....."; si dhe* në kontradiktë edhe me shkresën nr. 1480/1, dt. 19.03.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUNT, për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike, ku ndër të tjera kërkohet *"..... ju lutemi merrni masa të menjëhershme për prokurimin e mallrave të lartpërmendur pasi QSUNT ndodhet në kushtet e një emergjence ekstreme dhe nevoja është shumë urgjente".*

Në këto kushte, gjykojmë se, vendosja e afateve **nga 7 ditë deri 55 ditë**është në kundërshtim me VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 *"Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shteti",* **dhe nukjustifikon aplikimin e procedurës së drejtpërdrejtë**.

Procedura e Prokurimit është ndarë në katër lote:
Loti i I : Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent me fond limit 3,523,333 lekë pa tvsh.
Loti i II : Blerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHP me fond limit 21,796,800 lekë pa tvsh, dhe shumatore çmimi për njësi 8,569 lekë pa tvsh.
Loti i III : Blerje materiale konsumi laboratorike për ISHP me fond limit 3,294,000 dhe shumatore çmimi për njësi 22,652 lekë pa tvsh.
Loti i IV : Blerje materiale konsumi ndihmëse laboratorike për ISHP me fond 394,140 lekë pa tvsh dhe shumatore çmimi për njësi 75,651 lekë pa tvsh.

Është mbajtur procesverbali datë 10.04.2020 nga Komisioni i Vlerësimit, mbi vlerësimin e Ofertave të paraqitura për procedurën e drejtëpërdrejtë me objekt ñBlerje Kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò janë paraqitur operatorët si më poshtë :
Loti i I : Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent është paraqitur operatori G... shpk me vlerë oferte 3,523,333 lekë pa tvsh.
Loti i II : Blerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHP janë paraqitur operatorët B.A. shpk me vlerë oferte 21,725,500 lekë pa tvsh dhe afat maksimal 55 ditë dhe operatori K.... shpk me vlerë oferte 15,488,000 lekë pa tvsh dhe afat 5-44 ditë.
Loti i III : Blerje materiale konsumi laboratorike për ISHP është paraqitur operatori K.... shpk me vlerë 3,165,600 lekë pa tvsh dhe afat 44 ditë (i ndryshëm sipas artikujve).
Loti i IV : Blerje materiale konsumi ndihmëse laboratorike për ISHP , nuk u paraqit asnjë ofertues.
Pas shqyrtimit të dokumentacionit komisioni vendosi :
Për Lotin e I të kualifikojë operatorin G... shpk .

Për lotin e dytë vendosi të kualifikojë operatorin B... A... dhe të skualifikojë operatorin K... shpk pasi dokumentacioni i ofruar nuk ishte në përputhje me specifikimet teknike.
Për lotin e III vendosi të kualifikojë operatorin K.... shpk.
Me shkresën nr.1776/7, datë 10.04.2020 janë shpallur fituesit e kësaj procedure.
Me shkresën nr.1776/8, datë 13.04.2020, është ngritur Urdhri me nr.257, datë 13.04.2020 mbi negocimin e kontratave për Lotin 1,2,3 me objekt ñBlerje Kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò
Është mbajtur relacioni mbi negocimin e kontratave me nr.1776/10, datë 14.04.2020 , ku është rënë dakort <u>për zbatimin e afateve të lëvrimit që operatorët kanë deklaruar</u> dhe respektimit të kontratës.
Janë lidhur kontratat si më poshtë:
Loti i I : Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent është lidhur kontrata me nr.1776/11, datë 14.04.2020 midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorit G.... shpk me vlerë 3,512,000 lekë pa tvsh , afati i lëvrimit duhet të bëhet sipas afateve të përcaktuara në dokumentin ñFormulari i ofertës ekonomikeò.
Loti i II : Blerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHP është lidhur kontrata me nr.1776/13, datë 14.04.2020 midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorit B.... A... shpk me vlerë 21,725,500 lekë pa tvsh , afati i lëvrimit duhet të bëhet sipas afateve të përcaktuara në dokumentin ñFormulari i ofertës ekonomikeò.
Loti i III : Blerje materiale konsumi laboratorike për ISHP është lidhur kontrata me nr.1776/12, datë 14.04.2020 midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorit krijon shpk me vlerë 3,165,600 lekë pa tvsh, afati i lëvrimit duhet të bëhet sipas afateve të përcaktuara në dokumentin ñFormulari i ofertës ekonomikeò.
Nga auditimi konstatohet se as në kontratë nuk janë vendosur afatet e lëvrimit të kontratës.

Me Vendimin nr.322, datë 18.04.2020 të Këshillit të Ministrave është miratuar kontrata me objekt LOTI i I ñBlerje Kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò, me OE **"G..."** SHPK ,me vlerën 3,512,000 lekë pa tvsh dhe *afat lëvrimi 5 ditë nga lidhja e kontratës (Ky afat nuk është në kontratë por citohet sipas ofertës ekonomike.*
Nga auditimi konstatohet se Ministria e Drejtësisë nuk është shprehur për këtë kontratë pasi e kanë konsideruar si projektakt me karakter individual.
APP është shprehur se në situata të tilla të interesit thelbësore të shtetit nuk ndiqen procedurat e prokurimit sipas LPP.
Ministria e Financave dhe Ekonomisë është shprehur pa koment për sa kohë fondet buxhetore të parashikuara janë brenda buxhetit të miratuar për MSHMS. Shkresat kanë ardhur me vulë elektronike për shkak të pandemisë.

- Me Vendimin nr.316, datë 18.04.2020 të Këshillit të Ministrave është miratuar kontrata me objekt LOTI i II ñBlerje Kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò, me OE ñ**B... A...**ò SHPK, me vlerën 21,725,500 lekë pa TVSH me afat maksimal 55 ditë. *(Ky afat **nuk** është në kontratë por citohet sipas ofertës ekonomike)*

Nga auditimi konstatohet se Ministria e Drejtësisë nuk është shprehur për këtë kontratë pasi e kanë konsideruar si projektakt me karakter individual. APP është shprehur se në situata të tilla të interesit thelbësore të shtetit nuk ndiqen procedurat e prokurimit sipas LPP. Ministria e Financave

dhe Ekonomisë është shprehur pa koment për sa kohë fondet buxhetore të parashikuara janë brenda buxhetit të miratuar për MSHMS. Shkresat kanë ardhur me vulë elektronike për shkak të pandemisë.

- Me Vendimin nr.317, datë 18.04.2020 të Këshillit të Ministrave është miratuar kontrata me objekt LOTI i III ñBlerje Kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò, me OE **"K..."** SHPK, me vlerën 3,165,000 lekë pa TVSH me afat maksimal 44 ditë (i ndryshueshëm sipas artikujve). *(Ky afat nuk është në kontratë por citohet sipas ofertës ekonomike).*

Nga auditimi konstatohet se Ministria e Drejtësisë nuk është shprehur për këtë kontratë pasi e kanë konsideruar si projektakt me karakter individual. APP është shprehur se në situata të tilla të interesit thelbësore të shtetit nuk ndiqen procedurat e prokurimit sipas LPP. Ministria e Financave dhe Ekonomisë është shprehur pa koment për sa kohë fondet buxhetore të parashikuara janë brenda buxhetit të miratuar për MSHMS. Shkresat kanë ardhur me vulë elektronike për shkak të pandemisë.

<u>Zbatimi i kontratës:</u>

a- Nga zbatimi i kontratës, në lidhje për procedurën **Loti I** ñ*Blerje kite dhe reagent të përshtatshëm për të përdorur në pajisje Maglum 800 Snibe CoLtd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për Covid-19*ò është lidhur kontrata lidhur kontrata me nr.1776/11 datë 14.04.2020 , miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020, me vlerë kontrate3,512,000 lekë pa tvsh ose <u>4,214,400 lekë me tvsh.</u> Në detyrim kontraktor neni 2 dhe sipas ofertës nga operatori ekonomik ñG....òshpk, 50 kite duhet të lëvroheshin për 5 ditë nga hyrja në fuqi e kontratës. Nga auditimi u konstatua se, 6 kite me vlerë prej 252,864 lekë janë sjellë më datë 30.05.2020, pra 36 ditë me vonesë (24.04.2020 deri në 30.05.2020).Sipas faturës tatimore të shitjes nr.2202 datë 24.04.2020 në vlerën prej 3,301,280 lekë pa tvsh ose 3,961,536 lekë me tvsh.

Kështu në bazë të detyrimit kontraktor neni 24 ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuaròku parashikohet se ñ*Kontraktuesi, kur nuk realizon ketë kontratë Brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës*.ô, dëmi i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñG....òshpk do të ishtë: 25% x 4,214,400) x 0,004 x 36 ditë = **151,718 lekë me tvsh,** vlerë kjo e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

b-Nga zbatimi i kontratës, në lidhje me procedurën **Loti 2** ñ*Blerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHP*ò është lidhur kontrata e furnizimit nr.1776/13 datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.316 datë 18.04.2020, <u>me vlerë kontrate 21,725,500</u> lekë pa tvsh ose 26,070,600 lekë me tvsh.

b-1)Në detyrimin kontraktor neni 2 dhe sipas formularit të ofertës nga operatori ekonomik ñB... A....òshpk ku parashikohen afatet e lëvrimit, sasia prej 3000 reaksione në vlerë prej 2,340,000 lekë me tvsh, nuk është sjellë ditën kur hyn në fuqi kontrata, por ka ardhur 5 ditë me vonë(18.04.2020-23.04.2020) si dhe sasia prej 100 shishe në vlerë prej 102,000 lekë me tvsh nuk është sjellë në datë 18.04.2020, por më datë 23.04.2020.

Në bazë të nenit 24 të kontratës, ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò, parashikohet se ñ*Kontraktuesi, kur nuk realizon ketë kontratë Brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës*.ô Nga AK duhet të përllogaritet dhe ndalet penaliteti për dorëzim të vonuar nga OE ñB... A....òshpk në

vlerë prej (26,070,600 x 25%) x 0,004 x 5 ditë = **130,353 lekë me tvsh**), vlerë kjo e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

b-2)Për artikujt nga 1 deri në tre, sipas formularit të ofertës do të levroheshin 5 kuti për secilën përmasë, 500 rack për secilin artikull brenda 30 ditëve që i përket data 18.05.2020, të cilët kanë ardhur më datë 30.05.2020, dmth 12 ditë me vonesë, (500 rack x 1925 lekë pa tvsh=1,155,000 lekë me tvsh x 3 artikuj = 3,465,000 lekë me tvsh vlerë e pa lëvruar.
Në bazë të nenit 24 të kontratës, penaliteti i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñB... A...ò shpk është e baravlefshme në vlerë prej (26,070,600 x 0.25) x 0.004 x12 ditë = **312,847 lekë me tvsh,** vlerë kjo e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

b-3) Për artikullin 4 në sasinë prej 3000 sipas formularit të ofertës do të levroheshin brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës, që i përket data 08.05.2020, të cilët kanë ardhur më datë 30.05.2020, dmth 22 ditë me vonesë, (3000 reaksione x490 lekë pa tvsh = 1,764,000 lekë me tvsh, vlera e palëvruar.
Në bazë të nenit 24 të kontratës (Likujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuar) shprehet se ñ*Kontraktuesi, kur nuk realizon ketë kontratë brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratë*s.ò.
Sa më sipër, penaliteti i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñB... A...òshpk është e baravlefshme në vlerë prej (26,070,600 x 0.25) x 0.004 x22 ditë = **573,553 lekë me tvsh**, si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit.
Pra, operatori ekonomik ñB... A...òshpk, për dorëzimin e e vonuar nga detyrimi kontraktor me nr.1776/13 datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.316 datë 18.04.2020, duhet të paguar nga vlera e sigurimit të kontratës, penalitetin total në vlerë prej **1,016,753 lekë me tvsh,** si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

Në lidhje mbi problematikat e konstatuara, nga grupi i audituesve u mbajt Aktkonstatimi nr.14 datë 30.04.2021 me nr.415/20 prot të MSHMS, mbi të cilin MSHMS ka observuar me shkresa nr.415/26 prot, datë 07.05.2021 të MSHMS. Në vijim, pasi materiali kaloi hallkat e kontrollit të cilësisë, grupi i auditimit, rillogariti penalitetete, në bazë të kontratave respective, proces verbaleve dhe faturave tatimore të dorëzimit të mallit/pajisje/ shërbim për secilën kontratë, rivlerësoi detyrimin kontraktor në lidhje mbi "Likujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuar", vlerat finale të të cilit paraqiten në këtë project raport auditimi.
Në lidhje mbi observimet dërguar nga MSHMS në lidhje mbi projektraportin e përcjellë nga KLSH me shkresë nr.121/10 prot datë 03.09.2021, të cilat kanë ardhur më datë 14.10.2021 jashtë afatit kohor të parashikuar në ligjin 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit neni 26 dhe 29ô me shkresë nr.415/47 prot të MSHMS dhe me nr.121/11 prot datë 14.10.2021 të KLSH, ju bëjmë me dije:
Mbi procedurën me objekt ñ*Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për t'u përdorur për pajisje e Existation te firmës Bioneer ose ekuivalent*ò,në Projekt raportin, nga grupi i auditimit është bërë lapsus mbi vlerën e penalitetit, për të cilën e ripamë dhe i qëndrojmë vlerës prej 693,600 lekë me tvsh, paraqitur dhe në Aktkonstatimit nr.14 të datës 30.04.2021.
Sa më sipër, audituesit e KLSH , i ri vlerësuan dhe observimet e dyta, të cilat nuk kanë paraqitur dokumentacion shtesë apo argumentim ligjor shtesë në lidhje mbi problematikën e konstatuar, për këtë qëllim, audituesit shprehen me të njëjtin qëndrim, si vijon:

Pretendimi i subjektit:
Mbi auditimin e procedurave, në zbatim të detyrimit kontraktor mbi penalitetin e llogaritur për dorëzimin e

vonuar.
Ne Kapitullin VII, te VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit", është percaktuar:
VII. MIRATIMI I KONTRATËS
1. Kontratat, që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit pas nënshkrimit të tyre, do të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Kontrata do të hyjë në fuqi pas këtij miratimi. Ky kusht do të jetë i specifikuar edhe në kontratën e nënshkruar ndërmjet palëve dhe në dokumentet e procedurës garuese
Kontrata Nr.1575/19 Prot., date 07.04.2020, per Lot II: ñSpostimin e dializës nga pediatria e specialiteteve tek godina e spitalit infektiv (shërbimi i alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me Covid-19ò, e lidhur mes AK dhe OE T....Shpk, eshte miratuar me VKM nr. 323, Dt. 18.04.2020.
Publikimi i kesaj VKM eshte bere ne Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr. 69, Datë. 21/04/2020, si me poshte:
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.323, datë 18.4.2020, Për miratimin e kontratës për lotin 2 me objekt:
"Spostimi i sistemit të dializës nga pediatria e specialiteteve tek godina e spitalit infektiv (shërbimi i alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me COVID-19)".
Ku percaktohet se : Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
Kjo tregon se realizimi i kontrates nuk mund te behej para dates 21.04.2020, kur eshte publikuar VKM per miratimin e kesaj kontrate.
Sikurse thekson KLSH, QSUT, autoriteti i caktuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës, bazuar në publikimin e VKM ne Fletoren Zyrtare, ka nxjerrë urdhërin nr. 57/1, dt. 21.04.2020, për emërimin e komisionit për ndjekjen e realizimit të kontratës dhe marrjen në dorzim të shërbimit.
Proces verbali i mbajtur dt. 22.04.2020, nga komisioni i ngritur me Urdhrin nr. 57/1, dt. 21.04.2020, ku vërteton kryerjen e punimeve respektivisht sipas kushteve të kontratës, verteton se sherbimi eshte kryer brenda afatit 24 ore, te percaktuar ne Ftesen per Oferte dhe në Kontrate.
Sa me siper pretendimi per vonesen dy ditore te realizimit te sherbimit dhe llogaritja e demit ekonomik per vonesen e realizimit te kontrates, nuk qendron.
Bashkelidhur observacionit, kopje te dokumentave:
- Urdher Nr. 197, date 24.03.2020, ñPer miratimin e rrethanave te gjendjes ne kushtet e interesave thelbesore te shtetitò
- Vendim i Komitetit Teknik Nr 1569 Prot., date 24.03.2020,
- Miratim i procedures së drejtperdrejte Nr.1575/1, date 24.03.2020
c-Nga auditimi i zbatimit të kontratës, në lidhje me procedurën *Loti 2 "Blerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHP"* është lidhur kontrata e furnizimit Nr.1776/13 Prot., datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.316 datë 18.04.2020.
d-1)Në detyrimin kontraktor neni 2 dhe sipas formularit të ofertës nga operatori ekonomik ñB... A...ò shpk, sasia prej 3000 reaksione në vlerë prej 2,340,000 lekë me tvsh, nuk është sjellë ditën kur hyn në fuqi kontrata, por ka ardhur 5 ditë më vonë (18.04.2020 - 23.04.2020) si dhe sasia prej 100 shishe në vlerë prej 102,000 lekë me tvsh nuk është sjellë në datë 18.04.2020, por me datë 23.04.2020.
Në bazë të nenit 24 të kontratës, dëmi i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñB... A....ò shpk është e baravlefshme në vlerë prej (2,442,000 x 0,005 x 5 ditë =48,840 lekë me tvsh).
OBSERVACION II/d/1 :
OE B.... A.... shpk ka lidhur kontratën më datën 18.04.2020 , me nr 1776/13 duke theksuar se *OE jane vene ne dijeni me daljen e VKM-se ne fletoren zyrtare nr.61 te dt 21.04.2020*).
Sqarojmë se afati e kontratës kanë qënë të ndryshme për artikuj të ndryshë, Afati maximal 55 ditor mbaron më dt.11.06.2020, ndërsa afati 30 ditor mbaron më datën 18/05/2021 *dhe jo sic pretendon KLSH se afati i mbarimit të kontratës janë 30 ditore mbaron në datën 08/05/2020 (në pikën c-3, fq 4)*
c-2) Për artikujt nga 1 deri në 3 sipas formularit të ofertës do të lëvroheshin 5 kuti për secilën përmasë, 500 rack për secilin artikull brenda 30 ditëve që i përket data 18.05.2020, të cilët kanë ardhur me datë 30.05.2020, dmth 12 ditë me vonesë, (500 rack x 1925 lekë pa tvsh = 1,155,000 lekë me tvsh x 3 artikuj = 3,465,000 lekë me tvsh vlerë e pa lëvruar).
Në bazë të nenit 24 të kontratës, dëmi i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñB... A...ò shpk është e baravlefshme në vlere prej (3,465,000 x 0.004 x 12 ditë = 166,320 lekë me tvsh).
OBSERVACION II/c/2 :
ñPër artikullin 1-3ò të formularit të ofertës qe jane majat me permasa te ndryshme sqarojme se afati i levrimit i deklaruar ne OE eshte shprehur

- 50 kuti për seicilen permase (500 rack) brenda 30 diteve
- Pjesa e mbetur brenda 55 diteve nga lidhja e kontrates

Sipas deklarimit të OE Afati 30 ditor mbaron me dt 18.05.2020 , (*edhe pse OE jane vene ne dijeni me daljen e VKM-se ne fletoren zyrtare nr.61 te dt 21.04.2020*),

Ne faturen tatimore me faturen e shoqërimit me nr 1014971 nr. 84227048 dhe nr 2221 fat datë 13.05.2020 jane faturuar keto 3 artikuj si me poshte:

1. Artikulli (Maja mikropipete 1000 εl.....) 900 rack
2. Artikulli (Maja mikropipete 200 εl.....) 50 rack
3. Artikulli (Maja mikropipete 20 εl.....) 1800 rack

Për sa më sipër artikulli i pare dhe i tretë është faturuar brenda afatit,(*dmth me shumë se 500 rack)*, kjo sipas fatures nr.serie te fatures së shoqërimit 10104971 dhe nr. seri te fatures tatimore me nr 84227048 me nr 2221dt 13.05.2020, FH e ISHP me nr 26 shoqeruar me proces verbalet perkatese)

Artikulli i 2 për diferencen 450 rack pjesë e sasië 500 rack, eshte faturuar me daten 21.05.2020 me faturen nr.84227048 serie, Flete hyrja e ISHP-së me nr.30 shoqeruar me proces verbalet perkatëse , do të thotë që vetëm 4 ditë me vonesë (450 rack *1925 lekë/rack*4ditë*0.004)= 13 860 leke (pa TVSH) dhe 16 632 leke me TVSH.

Pjesa e tjeter dhe e fundit e majave eshte sipas fatures me dt. 05.06.2020 (e cila ploteson afatet e levrimit brenda 55 diteve) me nr.serie 84227084 dhe fletehyrjes me nr.35. perkatese te ISHP-se, shoqeruar me proces verbalet perkatese, e cila është dërguar në MSHMS me shkresën nr 507/9 datë 12.06.2020 (qe do te thote brenda 55 diteve nga lidhja e kontrates.

c-3) Për artikujt nga 4 në sasinë prej 3000 sipas formularit të ofertës do të lëvroheshin brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës që i përket data 08.05.2020, të cilët kanë ardhur me datë 30.05.2020, dmth 22 ditë me vonesë, (3000 reaksione x490 lekë pa tvsh = 1,764,000 lekë me tvsh, vlerë e palëvruar.

Në bazë të nenit 24 të kontratës, dëmi i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñB... A...ò shpk është e baravlefshme në vlerë prej (1,764,000 x 0.004 x22 ditë= 155,232 lekë me tvsh).

Pra, operatori ekonomik ñB... A...ò shpk, për dorëzimin e vonuar nga detyrimi kontraktor me nr.1776/13 datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.316 datë 18.04.2020, duhet paguar nga vlera e sigurimit të kontratës, dëmin total në vlerë prej 370,392 lekë me tvsh.

OBSERVACION II/c/3 :

Për artikullin 4 te ofertes (Kit me reagente per kryerjen e teknikes molekulare sasiore one-step real time RT-PCR) , sipas deklarimit të OE afati i levrimit ishte deklaruar

- 3000 reaksione brenda 20 ditëve nga lidhja e kontrates
- 4000 reaksione brenda 45 diteve nga lidhja e kontrates
- 4000 reaksione brenda 55 diteve nga lidhja e kontrates

Na faturen tatimore me nr serie. 84227048 datë 13.05.2020 dhe sipas FH se ISHP-se dhe proces verbale marrje ne dorezim eshte faturuar artikulli 4 ne sasi te plote 11 000 reaksione, sipas FH me nr 26 datë 13.05.2020.

Afati 20 ditor i kontrates mbaron me daten 08.05.2020, e cila do të thotë se vonesa per artikullin e katërt 3000 reaksione (pjese e 11000 reaksioneve) është vetëm 5 ditë (3000 reak*490lekë/reax*5ditë*0.004) =29 400 leke pa TVSH dhe 35 280 lekë me TVSH

Pretendimi i KLSH-së është i gabuar sepse pershkruan afat 30 ditore duke vendosur ditën 08/05/2020 për mbarimin e 30 ditëshit , e cila është e pamundur kur kontrata është lidhur më datën 18/04/2020. Theksojmë se Fatura tatimore mban datën 13/05/2020 me nr serie 84227048 dhe jo datën 30/05/2020 sic pretendon KLSH. OE-B. A. shpk nuk ka asnje faturë tatimore më datën 13/05/2020 për këtë kontratë.

Në përfundim për sa më sipër llogaritjet në Akt konstatim (fq 3 dhe 4) jane kryer totalisht gabim, dhe janë jo të drejta.

PAVARESISHT SA ME LART:

Lidhur me demet për dorezimin e vonuar dhe permbushjen e detyrimeve kontraktore sqarojme se Kushtet e Pergjithshme te Kontratave dhe Kodi Civil i RSH i cili eshte edhe baze ligjore e kontratave te lidhura me OE te dale nga keto procedura.

Sa me lart konstatimi i KLSH nuk eshte ligjerisht I bazuar dhe rrezikon shpenzime te metejshme gjyqesore per AK ne kushtet kur OE kane operuar te ndodhur ne kushtet e Forces Madhore.

d- Nga auditimi i zbatimit të kontratës, në lidhje me procedurën ñBlerje materiale për mbrojtje personale (MMP) për Covid-19ò është lidhur kontrata e furnizimit me Nr. 1366/18 Prot., datë 18.03.2020, miratuar me VKM nr.241 datë 21.03.2020.

Operatori ekonomik ñO.. Dé .ò shpk 20 kite ñAccurPower Sars - Cov - 2 real time PCRò me vlerë mbi 25% të vlerës së kontratës e ka dorëzuar 17 ditë me vonesë, për të cilin nuk u konstatua njoftim apo ndonjë dokumentacion shkresor, mbi vonesat e dorëzimit të mallrave. Kështu në bazë të detyrimit kontraktor neni 24 (nga data 30.03.2020 deri në 16.04.2020) , dëmi i llogaritur për dorëzim të vonuar është (10,200,000 x 0,004 x17 ditë = 693,600 lekë me tvsh).

OBSERVACION II/d :

Lidhur me konstatimin e kryer nga KLSH-ja, rezulton se i referohet procedurës me objekt Loti I ñBlerje kite dhe reagentë, Evadim mbetje anti COVID-19ò dhe jo ñBlerje materiale për mbrojtje personale (MMP) për Covid-19ò.

Ne Kapitullin VII, te VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit", është percaktuar:

VII. MIRATIMI I KONTRATËS.....
Kontrata Nr.1574/13 Prot., date 30.03.2020, per: ñBlerje kite dhe reagentë, Evadim mbetje anti COVID-19ò ndarë në dy lote, e lidhur mes AK dhe OE O.. D... Shpk, eshte miratuar me VKM nr. 272, Dt. 3.04.2020, publikuar në Fletoren Zyrtare nr, 59 datë 03.04.2020 (bashkëlidhur), ku përcaktohet:
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.272 datë 3.4.2020, Për miratimin e kontratës për lotin 1 me objekt:
"Blerje Kite për Laboratorin Mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për paisjen e Existation të Firmës Bioneer ose ekuivalent" për QSUT-në.
Ku percaktohet se: Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
Kjo tregon se realizimi i kontrates nuk mund te behej para dates 03.04.2020, kur eshte publikuar VKM per miratimin e kesaj kontrate.
Sikurse thekson KLSH, QSUT autoriteti i caktuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës, bazuar në publikimin e VKM ne Fletoren Zyrtare, ka nxjerre urdherin per emerimin e komisionit per ndjekjen e realizimit te kontrates dhe marrjen ne dorzim.
Proces verbali i mbajtur dt. 16.04.2020, ku vërtetohet pritja dhe kolaudimi i materialeve mjekësore të furnizuara nga ñO.... D...ò , sipas kushteve të kontratës.
Sa me siper pretendimi per vonesen 17 ditore te realizimit te sherbimit dhe llogaritja e demit ekonomik per vonesen e realizimit te kontrates, nuk qendron. Afati menjëherë (brenda 2 orëve) i kontrates mbaron me daten 03.04.2020, e cila do të thotë se vonesa per dorëzimin e kiteve është vetëm 13 ditë (10,200,000 x 0.004 x 13 ditë = 530,400 lekë me TVSH).
Ne perfundim per sa me siper llogaritjet ne Akt konstatim (fq 4) jane kryer gabim.
PAVARESISHT SA ME LART:
Lidhur me demet për dorezimin e vonuar dhe permbushjen e detyrimeve kontraktore sqarojme se Kushtet e Pergjithshme te Kontratave dhe Kodi Civil i RSH i cili eshte edhe baze ligjore e kontratave te lidhura me OE te dale nga keto procedura .
Sa me lart konstatimi i KLSH nuk eshte ligjerisht i bazuar dhe rrezikon shpenzime te metejshme gjyqesore per AK ne kushtet kur OE kane operuar te ndodhur ne kushtet e Forces Madhore.
Gjithashtu sqarojme se afatet e levrimit fillojne nga e data e miratimit me VKM te kontratave dhe jo nga data e firmosjes se tyre prej paleve pasi kontratat megjithese te firmosura jane NUL nese nuk miratohen me VKM ne perputhje me VKM 203/2020 te ndryshuar.
Qëndrimi i grupit të auditimit:
Nga auditimi konstatohet se :
Ne Kapitullin VII, te VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit", është percaktuar:

1. Kontratat, që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit pas nënshkrimit të tyre, do të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Kontrata do të hyjë në fuqi pas këtij miratimi. Ky kusht do të jetë i specifikuar edhe në kontratën e nënshkruar ndërmjet palëve dhe në dokumentet e procedurës garuese.

Pra kontratat hynë në fuqi pas këtij miratimi sikur është parashikuar ne VKM dhe jo kur publikohen në fletoren zyrtare siç pretendon subjekti.
- Nga auditimi i zbatimit të kontratës, në lidhje për procedurën ñ*Spostimi i sistemit të dializës nga Pediatria e Nga rishikimii penaliteteve për pjesën e ri-auditimi të zbatimit të kontratave të përfituara nga realizimi i procedurave sipas sipas VKM nr 203, datë 26.02.2020 "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit "* i ndryshuar, u kostatuan se:
a- Nga zbatimi i kontratës, në lidhje për procedurën ñSpostimi i sistemit të dializës nga Pediatria e Specialiteteve tek godina e Spitalit Infektiv (Shërbimi i Alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me Covid-19òështë lidhur kontrata nr.1575/19, datë 07.04.2020 miratuar me VKM nr.323 datë 18.04.2020, me vlerë kontrate 850,000 lekë pa tvsh ose 1,020,000 lekë me tvsh. Ky shërbim dhe furnizimi duhej bërë brenda 24 orëve, i cili ka ardhur më datë 22.04.2020, dmth 2 ditë me vonesë, për rrjedhojë në zbatim të detyrimit kontraktor neni.24, penaliteti i llogaritur për dorëzimin e vonuar nga operatori ñT....ò shpk është (1,020,000x0,0,004 x2 ditë =8,160 lekë me tvsh.)
b- Nga zbatimi i kontratës, në lidhje për procedurën Loti I ñBlerje kite dhe reagent të përshtatshëm për të përdorur në pajisje Maglum 800 Snibe CoLtd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për Covid-19ò është lidhur kontrata lidhur kontrata me nr.1776/11 datë 14.04.2020 , miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020, me vlerë kontrate 3,301,280 lekë pa tvsh ose 3,961,536 lekë me tvsh. Në detyrim kontraktor neni 2 dhe sipas ofertës nga operatori ekonomik ñG...òshpk, 50 kite do të lëvrohen për 5 ditë nga hyrja në fuqi e kontratës. Nga auditimi u konstatua se, 6 kite me vlerë prej 252,864 lekë janë sjellë më datë 30.05.2020, pra 36 ditë me vonesë (24.04.2020 deri në 30.05. 2020). Sipas faturës tatimore e shitjes nr.2202 datë 24.04.2020 në vlerën prej 3,301,280 lekë pa tvsh ose 3,961,536 lekë me tvsh.
Kështu në bazë të detyrimit kontraktor neni 24, dëmi i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñG...òshpk , 25% x 3,961,536= 990,384
Penaliteti (990,384 x 0,004 x36 ditë = 142,615 lekë me tvsh.)

c-Nga zbatimi i kontratës, në lidhje me procedurën Loti 2 ñBlerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHPò është lidhur kontrata e furnizimit nr.1776/13 datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.316 datë 18.04.2020, me vlerë kontrate 21,725,500 lekë pa tvsh ose 26,070,600 lekë me tvsh.
c-1)Në detyrimin kontraktor neni 2 dhe sipas formularit të ofertës nga operatori ekonomik ñB... A...òshpk, sasia prej 3000 reaksione në vlerë prej 2,340,000 lekë me tvsh, nuk është sjellë ditën kur hyn në fuqi kontrata, por ka ardhur 5 ditë me vonë(18.04.2020- 23.04.2020) si dhe sasia prej 100 shishe në vlerë prej 102,000 lekë me tvsh nuk është sjellë në datë 18.04.2020, por më datë 23.04.2020.
Në bazë të nenit 24 të kontratës, dëmi i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñB... A..òshpk është e baravlefshme në vlerë prej (2,442,000 x 0,005 x 5 ditë =48,840 lekë me tvsh).
c-2)Për artikujt nga 1 deri në tre sipas formularit të ofertës do të levroheshin 5 kuti përr secilën përmasë, 500 rack për secilin artikull brenda 30 ditëve që i përket data 18.05.2020, të cilët kanë ardhur më datë 30.05.2020, dmth 12 ditë me vonesë, (500 rack x 1925 lekë pa tvsh=1,155,000 lekë me tvsh x 3 artikuj = 3,465,000 lekë me tvsh vlerë e pa lëvruar.
Në bazë të nenit 24 të kontratës, dëmi i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñB.. A...òshpk është e baravlefshme në vlerë prej (3,465,000 x 0.004 x12 ditë = 166,320 lekë me tvsh).
c-3) Për artikujt nga 4 në sasinë prej 3000 sipas formularit të ofertës do të levroheshin brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës që i përket data 08.05.2020, të cilët kanë ardhur më datë 30.05.2020, dmth 22 ditë me vonesë, (3000 reaksione x490 lekë pa tvsh = 1,764,000 lekë me tvsh, vler a e palëvruar.
Në bazë të nenit 24 të kontratës, dëmi i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñB... A...òshpk është e baravlefshme në vlerë prej (1,764,000 x 0.004 x22 ditë = 155,232 lekë me tvsh).
Pra, operatori ekonomik ñB... A....òshpk, për dorëzimin e e vonuar nga detyrimi kontraktor me nr.1776/13 datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.316 datë 18.04.2020, duhet të paguar nga vlera e sigurimit të kontratës, dëmin total në vlerë prej 370,392 lekë me tvsh.
Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.
d- Në përfundim të procedurës ñ*Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisje e Existation të firmës Bioneer ose ekuvalent*ò është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1574/13, datë 30.03.2020, miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020, me vlerë kontrate 10,200, 000lekë me tvsh.
Rezultoi se, operatori ekonomik ñO.... D.....ò shpk ka dorëzuar 20 kite *"AccurPower Sars –Cov – 2 real time PCR"* 17 ditë me vonesë, për të cilin nuk u konstatua njoftim apo ndonjë dokumentacion shkresor, mbi vonesat e dorëzimit të mallrave. Kështu në bazë të detyrimit kontraktor neni 24 ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò ku parashikohet se ñ*Kontraktuesi, kur nuk realizon ketë kontratë Brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratë*s.ô
Sa më sipër, për vonesat e dorëzimit të mallit me 17 dite, nga data 30.03.2020 deri në 16.04.2020, penaliteti i llogaritur për dorëzim të vonuar është (10,200,00 lekë me tvsh x 0,004 x17 ditë = **693,600 lekë me tvsh,** si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.
Për sa më sipër ky observacion merret në konsideratë.
Pra në total , për kontratat e mësipërme kemi vlerën *prej 1,870,231 lekë me* tvsh të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit, si pasojë e mosplotësimeve të detyrimeve kontraktore.

4. Titulli i Gjetjes:	Mbi mos llogaritjen e penaliteteve për dorëzim te vonuar te mallit, për kontrata që kanë lidhje me Covid-19, në vlerën *prej 1,870,231 lekë me* tvsh si të ardhura të munguar anë buxhetin e shtetit
Situata :	**a-** Në përfundim të procedurës ñ*Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisje e Existation të firmës Bioneer ose ekuvalent*ò është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1574/13, datë 30.03.2020, miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020, me vlerë kontrate 10,200, 000lekë me tvsh. Rezultoi se, operatori ekonomik ñO.. D...ò shpk ka dorëzuar 20 kite *"AccurPower Sars –Cov – 2 real time PCR"* 17 ditë me vonesë, për të cilin nuk u konstatua njoftim apo ndonjë dokumentacion shkresor, mbi vonesat e dorëzimit të mallrave. Kështu në bazë të detyrimit kontraktor neni 24 ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò ku parashikohet se ñ*Kontraktuesi, kur nuk realizon ketë kontratë brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratë*s.ô

Sa më sipër, për vonesat e dorëzimit të mallit me 17 dite, nga data 30.03.2020 deri në 16.04.2020, penaliteti i llogaritur për dorëzim të vonuar është (10,200,00 lekë me tvsh x 0,004 x17 ditë = **693,600 lekë me tvsh,** si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

b-Nga zbatimi i kontratës, në lidhje për procedurën ñ***Spostimi i sistemit të dializës nga Pediatria e Specialiteteve tek godina e Spitalit Infektiv*** *(Shërbimi i Alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me Covid-19*ò është lidhur kontrata nr.1575/19, datë 07.04.2020 miratuar me VKM nr.323 datë 18.04.2020, me vlerë kontrate 850,000 lekë pa tvsh ose 1,020,000 lekë me tvsh. Ky shërbim dhe furnizimi duhej bërë brenda 24 orëve, ndërkohë që ka ardhur më datë 22.04.2020, dmth 2 ditë me vonesë (Nga Qendra Spitalore universitare, është dërguar proces verbali nr. Dt. 22.04.2020 i mbajtur nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 57/1, dt. 21.04.2020 ku vërteton kryerjen e punimeve (Cinstalim, transporti, instalimi) ..... Këto punime u kryen respektivisht sipas kushteve të kontratës si dhe detyrimit vtë të gjitha palëve. Fatura tatimore nr. 4055, dt. 22.04.2020 për 850,000 lekë pa tvsh ose 1,020,000 lekë me tvsh.)

Për rrjedhojë në zbatim të detyrimit kontraktor neni. 24 ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò ku parashikohet se ñ*Kontraktuesi, kur nuk realizon ketë kontratë Brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratë*s.ô AK duhet të kishte përllogaritur dhe ndalur penalitetin për dorëzimin e vonuar nga operatori ñT....ò shpk është (1,020,000x0,0,004 x2 ditë =**8,160 lekë me tvsh**, vlerë kjo e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

c-Nga zbatimi i kontratës, në lidhje për procedurën **Loti I** ñ*Blerje kite dhe reagent të përshtatshëm për të përdorur në pajisje Maglum 800 Snibe CoLtd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për Covid-19*ò është lidhur kontrata lidhur kontrata me nr.1776/11 datë 14.04.2020 , miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020, me vlerë kontrate3,512,000 lekë pa tvsh ose 4,214,400 lekë me tvsh. Në detyrim kontraktor neni 2 dhe sipas ofertës nga operatori ekonomik ñG...òshpk, 50 kite duhet të lëvroheshin për 5 ditë nga hyrja në fuqi e kontratës. Nga auditimi u konstatua se, 6 kite me vlerë prej 252,864 lekë janë sjellë më datë 30.05.2020, pra 36 ditë me vonesë (24.04.2020 deri në 30.05.2020). Sipas faturës tatimore të shitjes nr.2202 datë 24.04.2020 në vlerën prej 3,301,280 lekë pa tvsh ose 3,961,536 lekë me tvsh.

Kështu në bazë të detyrimit kontraktor neni 24 ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò ku parashikohet se ñ*Kontraktuesi, kur nuk realizon ketë kontratë Brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratë*s.ô dëmi i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñG...òshpk do të ishtë: (25% x 4,214,400) x 0,004 x 36 ditë = **151,718 lekë me tvsh,** vlerë kjo e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit

d -Nga zbatimi i kontratës, në lidhje me procedurën **Loti 2** ñ*Blerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHP*ò është lidhur kontrata e furnizimit nr.1776/13 datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.316 datë 18.04.2020, me vlerë kontrate 21,725,500 lekë pa tvsh ose 26,070,600 lekë me tvsh.

d.1) Në detyrimin kontraktor neni 2 dhe sipas formularit të ofertës nga operatori ekonomik ñB... A...òshpk ku parashikohen afatet e lëvrimit, sasia prej 3000 reaksione në vlerë prej 2,340,000 lekë me tvsh, nuk është sjellë ditën kur hyn në fuqi kontrata, por ka ardhur 5 ditë me vonë(18.04.2020- 23.04.2020) si dhe sasia prej 100 shishe në vlerë prej 102,000 lekë me tvsh nuk është sjellë në datë 18.04.2020, por më datë 23.04.2020.

Në bazë të nenit 24 të kontratës, ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò, parashikohet se ñ*Kontraktuesi, kur nuk realizon ketë kontratë Brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratë*s.ô Nga AK duhet të përllogaritet dhe ndalet penaliteti për dorëzim të vonuar nga OE ñB... A....ò shpk në

	vlerë prej (26,070,600 x 25%) x 0,004 x 5 ditë = **130,353 lekë me tvsh**), vlerë kjo e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit. **d.2)** Për artikujt nga 1 deri në tre, sipas formularit të ofertës do të levroheshin 5 kuti për secilën përmasë, 500 rack për secilin artikull brenda 30 ditëve që i përket data 18.05.2020, të cilët kanë ardhur më datë 30.05.2020, dmth 12 ditë me vonesë, (500 rack x 1925 lekë pa tvsh=1,155,000 lekë me tvsh x 3 artikuj = 3,465,000 lekë me tvsh vlerë e pa lëvruar. Në bazë të nenit 24 të kontratës, penaliteti i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñB... A....òshpk është e baravlefshme në vlerë prej (26,070,600 x 0.25) x 0.004 x12 ditë = **312,847 lekë me tvsh),** vlerë kjo e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit. **d.3)** Për artikullin 4 në sasinë prej 3000 sipas formularit të ofertës do të levroheshin brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës, që i përket data 08.05.2020, të cilët kanë ardhur më datë 30.05.2020, dmth 22 ditë me vonesë, (3000 reaksione x490 lekë pa tvsh = 1,764,000 lekë me tvsh, vlera e palëvruar. Në bazë të nenit 24 të kontratës (Likujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuar) shprehet se ñ*Kontraktuesi, kur nuk realizon ketë kontratë Brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratë*s.ò. Sa më sipër, penaliteti i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñB... A....òshpk është e baravlefshme në vlerë prej (26,070,600 x 0.25) x 0.004 x22 ditë = **573,553 lekë me tvsh**, si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit. <u>Pra,</u> operatori ekonomik ñB...A...òshpk, për dorëzimin e e vonuar nga detyrimi kontraktor me nr.1776/13 datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.316 datë 18.04.2020, duhet të paguar nga vlera e sigurimit të kontratës, penalitetin total në vlerë prej **<u>1,016,753 lekë me tvsh,</u>** <u>si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.</u>
Kriteri	VKM nr. 203, dt. 26.02.2020, ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetitò i ndryshuar, kontratat respektive me: nr.kontrata nr.1575/19, datë 07.04.2020 miratuar me VKM nr.323 datë 18.04.2020; kontrata nr.1776/11 datë 14.04.2020 miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020; kontrata e furnizimit nr.1776/13 datë 14.04.2020 miratuar me VKM nr.316 datë 18.04.2020; kontrata e furnizimit me nr.1366/18, datë 18.03.2020 miratuar me VKM nr.241 datë 21.03.2020; kontrata e furnizimit me nr.1365/36, datë 27.03.2020 miratuar me VKM nr.274, datë 03.04.2020, neni respektiv ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò ñ*Kontraktuesi, kur nuk realizon ketë kontratë Brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratë*sô
Ndikimi/Efekti:	-Mosdorëzim në kohë i mallit të kërkuar, në kushte emergjence/rrezik per pasoja në shëndetin publik -Të ardhura të munguara në buxhet
Shkaku:	Mungesa e monitorimit të kontratave: Sipas VKM nr. 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar, nuk është parashikuar elementi i monitorimit të ekzekutimit të kontratave të përftuara , si dhe nga MSHMS, është mjaftuar vetëm me ngritjen e komisioneve të marrjes në dorëzim të mallit, barnave,shërbimeve etj, pranë Qëndrave Unisversitare Spitalore ñNënë Terezaò dhe ñShefqet Ndroqiò, si pasojë, rezultoi se ka munguar gjurma e kontrollit, nuk rezultojnë informacione përmbledhës për përputhsmërinë, korrektësinë financiare dhe cilësinë e zbatimit të kontratës në mënyrë të vazhdueshme, për të parë efektivitetin, eficiencën dhe ekonomicitetin, e fondeve të siguruara nga Buxheti i Shtetit
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi	Nga MSHMS të merren masat dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore, në t ëgjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e penaliteteve të përllogaritura si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor për dorëzimin në kohë të mallit, të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj

	buxhetit të shtetit, për arkëtimin e vlerave si vijon: -Për procedurën ññ*Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisje e Existation të firmës Bioneer ose ekuvalent*ò, nga ñO... D...ò shpk , vlera prej **693,600 lekë me tvsh;** -Për kontratën ñSpostimi i sistemit të dializës nga Pediatria e Specialiteteve tek godina e Spitalit Infektiv (Shërbimi i Alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me Covid-19ò, nga OE T...ò shpk vlera perj **8,160 lekë** me tvsh; -Për procedurën Loti I ñ*Blerje kite dhe reagent të përshtatshëm për të përdorur në pajisje Maglum 800 Snibe CoLtd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për Covid-19*ò, nga OE -ñG.òshpk , vlera prej **151,718 lekë me tvsh;** Për procedurën Loti 2 ñ*Blerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHP*ò, nga OE ñB... A....ò shpk, vlera prej prej **1,016,753 lekë me tvsh.**

Informacion i përgjithshëm në lidhje mbi prokurimet e realizuara gjatë vitit 2020

Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2020 në Ministrinë e Shëndetësisë janë zhvilluar **në total 31 procedura me vlerë kontrate prej 1,986,217,294 lekë pa tvsh**; grupi auditimit ka audituar **7 procedura** tenderimi **me vlerë kontrate prej 890,871,169 lekë pa tvsh ose 45% të vlerës totale** të prokuruar për vitin 2020, duke i përzgjedhur bazuar në vlerën e lartë të prokuruar dhe në bazë të llojit, duke u fokusuar në |procedura negocim pa shpallje ï mbulim 65%) pasi këto procedura parashikohen të kryhen në situata emergjente dhe si të tilla mbartin përherë risqe, pasi realizohen në kushte të afateve tejet të shkurtra. Sa më sipër paraqitur në tabelën si vijon:

Nr.	Lloji i procedurës 2020	Zhvilluar		Audituar		Audituar në %	
		Nr. i rasteve	Vlera në lekë pa tvsh	Nr. i rasteve	Vlera në lekë pa tvsh	% numër	% vlerë
1	Me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit	5	392,705,000	3	253,730,000	0.60	65%
2	Blerje me vlerë të vogël	14	6,175,712	1	710,000	0.07	11%
3	Kërkesë për propozim	1	4,201,157	-	-	-	-
4	E Hapur	11	1,583,135,423	3	636,431,169	0.27	40%
TOTALI		**31**	**1,986,217,292**	**7**	**890,871,169**	**23%**	**45%**

Përgatiti:Grupi i auditimit të KLSH

- Krahas vlerës së mësipërme, përvitin 2020, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, janë audituar 2 marrëveshje kuadër të zhvilluara me procedurë të hapur me vlerë të pritshme 141,117,418, të cilat nuk paraqiten në regjistrin e realizimeve, për rrjedhojë nuk është paraqitur vlera në tabelën e mësipërme.

-Gjithashtu u auditua dhe llogaritja e fondit limit të procedurës ñBlerje Autoambulancaò në vlerën 196,371,000 lekë pa tvsh , procedurë e cila ishte realizuar nga ABP, për rrjedhojë nuk është paraqitur vlera në tabelën e mësipërme.

Më poshtë po paraqesim procedurat të cilat janë audituar, si vijon:

1-Procedura: ñBlerje tamponë nazofaringalëò me fond limit 31,920,000 lekë pa tvsh, ñNegocim pa shpallje paraprake të njoftimitò.

2- Procedura ñF.V pajisje mjekësore dhe mobilimi për qendrat shëndetësore që do të rikonstruktohen gjatë vitit 2020-2021ò, me fond limit 53,471,360.86 lekë pa tvsh, ñ Procedurë e hapurò.

3- Procedura ñBlerje artikuj për masa mbrojtëse personale (MMP)për përballimin e situatës emergjente COVID-19 nga strukturat shëndetësore publikeò me fond limit prej 199,965,000 lekë pa tvsh ,ñNegocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratësò.(Në proces auditimi zbatimi i kontratës).
4- Procedura ñBlerje monitor pacienti për masat anti Covid-19ò, me fond limit 85,510,265, ñMe negocim pa shpallje paraprake të njoftimitò.
5-Procedura e hapur me objekt ñRikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranëò me fond limit në vlerën prej 668,493,718.32 lekë pa tvsh.
6.Procedurë e hapur ñBlerje barna dhe materiale mjekimi për qëndrat Shëndetësore me shërbim në zonat turistike dhe në zonat veriore të cilat bllokohen gjatë dimritò me vlerë te fondit limit prej 87,646,057.00 lekë pa tvsh.
7.Llogaritja e fondit limit dhe lidhja e kontratës me objektin ñBlerje autoambulanceò me fond limit 196,371,000 lekë pa tvsh, realizuar si procedurë nga Agjencia e Blerjeve të përqëndruara në Ministrinë e Brendshme.
8. Auditimi i procedurës së hapur me objekt ñF.V pajisje mjekësore- Rezonancë magnetike (MRI)ò me fond limit në vlerën prej 144,349,418 lekë pa tvsh, realizuar në korrik 2020
9.Procedurë e hapur ñKite dhe materiale konsumi për realizimin testimit për Sars-Cov me metodën RT-PCR kompatibël me aparaturën e Cobasò me fond limit në vlerën prej 198,612,678.00 lekë pa tvsh.
10.Procedrë e hapur ñF.V linjë e gazrave mjekesore për spitalet rajonaleò me vlerë të fondit limit prej 57,684,110.00 lekë pa tvsh.
Me vlerë prej 343,942,845 lekë pa tvsh.

1.Auditimii procedures së prokurimit "Blerje monitor pacienti për masat anti Covid-19", realizuar nga MSHMS në vitin 2020.

Grupi i audituesve të KLSH-së, për të realizuar objektin e auditimit, *u fokusua*, në zbatimin akteve ligjore dhe nënligjore, në lidhje mbi, procesin e realizimin e procedurave të prokurimit për periudhën e auditimit, sipas ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikñ i ndryshuar, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar, në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menazhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò si dhe çdo akti juridike që është në fuqi në lidhje mbi kontratat e prokurimit.

Të dhënat e përgjithshme të procedurës.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : ñ*Blerje monitor pacienti për masat anti Covid-19"*		
Urdhri i Prokurimit me nr.359, datë 06.06.2020, **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** ñMe negocim pa shpallje paraprake të njoftimitò	Njësi prokurimi 1. A. P, 2. E .L 3. L. P	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**, Me shkresën nr.2587 /1, datë 01.06.2020 , Urdhër nr.359/1, datë 01.06.2020 me përbërje: 1. F.B, 2. O.Dh. 3. O. A..
5.Fondi Limit (pa tvsh) 85,510,265	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** O.. D... shpk me ofertë ekonomike 54,905,000 lekë pa tvsh.	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 30,605,265 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit Data	**9.Burimi Financimit nga** Buxheti i Shtetit	**10. Operatoret Ekonomike** O.. D... shpk me ofertë ekonomike 54,905,000 lekë pa tvsh.

03.06.2020		
11. Ankimime Pranë AK- nuk ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK ï nuk ka	**13. Përgjigje** Ankesës nga KKP ï nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës -Është lidhur kontrata me nr.2587/6, datë 17.06.2020 me operatorin fitues O.. D... me vlerë 54,905,000 lekë pa tvsh me afat lëvrimi brenda 7 ditëve nga lidhja e kontratës.	**15. Monitorimi dhe ekzekutimi i kontratës:** Me shkresën nr.2587/9, datë 26.06.2020, është ngitur Urdhri me nr.382, datë 26.06.2020 ñPër caktimin e koordinatorit për mbikqyrjen e kontratës së furnizimit nr.2587/6, datë 17.06.2020, L. P.ò. Pagesat janë realizuar në bazë të USH nr.532 datë 15.07.2020, USH nr.533 datë 15.07.2020 dhe USH.534/1 datë 15.07.2020.	

1.1 Mbi auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike, përcaktimi i procedurës dhe përzgjedhja e operatorëve ekonomikë.

-Nga auditimi u konstatua se, përllogaritja e fondit limit specifikimet teknike dhe sasitë janë përcjellë nga institucionet përfituese sipas shkresave, QSUT me nr.1403/1, datë 17.03.2020, SU ñShefqet Ndroqiò me nr.34/21, datë 31.03.2020 dhe SUOGJ ñMbretëresha Geraldinëò me nr.296, datë 27.03.2020.

-Nga auditimi konstatohet se, llogaritja e fondit limit është bërë sipas përllogaritjes të bërë nga QSUT dhe sasive të kërkuara nga të tre spitalet, llogaritja e fondit limit është bërë në bazë të ofertave të marra në treg, dhe është në vlerën 85,510,265 lekë pa tvsh.

-Nga MSHMS, titullari i AK ka miratuar Urdhrin e Prokurimit nr.359, datë 06.06.2020,me njësi prokurimi me përbërje (A.P , E. L dhe L.P) të cilët kanë argumentuar përdorimin e llojit të procedurës së prokurimit ñNegocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratësò, për arsyet si vijon:

a)Shkaktimi i një ngjarje të paparashikuar si përhapja e shpërthimit epidemik të koronavirusit të ri COVID-19, ngjarje e paparashikuar nga AK si dhe shpallja e fatkeqësisë natyrore.

b)AK nuk ka përgjegjësi për ngjarjen, e cila mund të dëmtojë interesat e përgjithshëm të një komuniteti të gjerë, për pasojë nuk mund ndiqen procedurat standarte mbi ose nën kufirin e ulët monetar.

Sa më sipër, në mbështetje të bazës ligjore dhe nënligjore, respektivisht, të ligjit nr. ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin Publikô i ndryshuar neni 33/2/c dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregulave të prokurimit publicò i ndryshuar, neni 36, Udhëzimi i APP-së nr.02, datë 08.01.2018, pika 10/c, MSHMS ka realizuar procedurën e mësipërme.

-Gjithashtu, titullari i AK, me shkresën nr.2587 /1, datë 01.06.2020, ka miratuar Urdhër nr.359/1, datë 01.06.2020 për emërimin e Komisonit të Vlerësimit të Ofertave me përbërje(F. B, O. Dh. dhe O. A.)

-Në bazë të PV, të njësisë së prokurimit, janë përzgjedhur tre OE për të marrë pjesë si operatorë që kanë pasur kontrata të mëparshme të sukseshme me MSHMS, konkretisht O.. D.. shpk, M.. shpk dhe B.. E, të cilëve u janë dërguar ftesë për pjesëmarrje, kjo në përputhje me VKM nr.914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregulave të prokurimit publicò i ndryshuar, neni 36 pika 4.

Artikujt që do prokurohen dhe sasitë janë si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Specifikime	Sasia
1	Monitor pacienti	Monitor pacienti për matjen e parametrave bazike vitale NIPB, SPO2, 3/5CH EKG e temperaturë . Për fëmijë e të rritur, me bateri të inkorporuar, me fisha dhe sensorë të përfshirë	215
2	Monitor pacienti multiparametrik	Monitor pacienti multiparametrik për matjen e parametrave bazike vitale 3/5CH EKG SPO2NIPB, IBP , temperaturë dhe EtCo2 . Për fëmijë e të rritur, me bateri të inkorporuar, me fisha dhe sensorë të përfshirë	50
3	Fishë me sensor për matjen	Fishë me sensor për matjen SPO2 për të rritur	535

	SPO2 për të rritur		
4	Fishë me sensor për matjen SPO2 pediatrik	Fishë me sensor për matjen SPO2 pediatrik	105
5	Fishë me manshetë tensioni	Fishë me manshetë tensioni	550
6	Trolley për monitor pacienti	Trolley për monitor pacienti	220
7	Letër printeri termik	Letër printeri termik	400

1.2 Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

-Nga auditimi u konstatua se, sipas procesverbalit të mbajtur nga KVO në datën 08.06.2020, është paraqitur *vetëm* një operator O.. D.. shpk, me ofertë ekonomike 54,905,000 lekë pa tvsh, ku midis të tjerave është konstatuar se, operatori ekonomik ñO.. D...ò shpk, ka paraqitur monitor me specifike teknike, ñpër artikullin nr.2ò OE , duke deklaruar në formularin e ofertës, se pajisjet do të ofrohen nga kompania prodhuese Biolight, modeli Q5 dhe Zondan ZD 120 E. Konstatuam se, këto modele kanë *rezolucion 800*600***dhe jo *1024*768*,** siç është kërkuar në specifikimet teknike në DST.Sa më sipër, KVO ka vendosur ta konsiderojë këtë si devijim të vogël, duke u shprehur që nuk ndikon në funksionet klinike të monitorit.

-Gjithashtu këto modele *nuk kanë ndërfaqe të integruar protokolli HL7* ***dhe jo DIAP*** siç është kërkuar në specifikimet teknike. KVO ka vendosur ta konsiderojë këtë si devijim të vogël,duke i shprehur që nuk ndikon në funksionet klinike të monitorit.

-Sipas Raportit Përmbledhës me nr.2587/4, datë 09.06.2020 është shpallur fitues operatori O. D. shpk me vlerë oferte 54,905,000 lekë pa tvsh.

Lidhja dhe zbatimi i kontratës

-Është lidhur kontrata me nr.2587/6, datë 17.06.2020 me operatorin fitues O.. D... me vlerë 54,905,000 lekë pa tvsh me afat lëvrimi brenda 7 ditëve nga lidhja e kontratës.

-Nga auditimi i kontratës nr.2587/6 datë 17.06.2020 në Aneksin nr.2 Specifikimet teknike, **nuk** janë reflektuar devijimet e vogla në specifikimet teknike të monitorëve, për të cilat KVO është shprehur në PV datë 08.06.2020, **por janë lënë specifikimet e paraqitura në DST.**

Përgjegjësi e hartuesit të kontratës, në këtë rast është njësia e prokurimit. **Kontrata është lidhur në kundërshtim me specifikimet teknike mbi të cilat ka fituar operatori.**

-Me shkresën nr.2587/7, datë 19.06.2020, është dërguar për zbatim kontrata me objekt ñBlerje monitorë pacienti për masat anti COVID-19ò, autoriteteve përfituese: Qendrës Spitalore Universitare ñNënë Terezaò, SU ñShefqet Ndroqiò dhe SUOGJ ñMbretëresha Geraldinëò.

-Me shkresën nr.2587/9, datë 26.06.2020, titullari i AK ka miratuar Urdhri me nr.382, datë 26.06.2020 ñPër caktimin e koordinatorit për mbikqyrjen e kontratës së furnizimit nr.2587/6, datë 17.06.2020ò, znj.L.P e cila është përgjegjëse për monitorimin e kontratës .

Me anë të emaileve të datës 08.07.2020, znj.P., koordinatorja për mbikqyrjen e kontratës i ka kërkuar spitaleve përfituese të këtij prokurimi Procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallit, ku është konstatuar se, lista e pajisjeve, prodhuesi, modeli, numri i serisë, sasitë përkatëse, dokumentin e hyrjes në magazinë, janë marrë në zbatim të kontratës dmth sipas DST, dhe jo sipas specifikimeve të sjella nga O.. D... shpk, për të cilat KVO i ka quajtur devijime të vogla.

Materialet e mësipërme janë dërguar në MSHMS pa shkresa përcjellëse.

Gjithashtu, janë mbajtur procesverbalet e dorëzimit në datën 23.06.2020 ku janë shënuar lista e pajisjeve , prodhuesi, modeli, numri i serisë dhe sasitë përkatëse dhe fletë Hyrjet në magazinë.

Sipas Urdhrit me nr.382, datë 26.06.2020 ñPër caktimin e koordinatorit për mbikqyrjen e kontratës së furnizimit nr.2587/6, datë 17.06.2020ò, koordinatori për mbikqyrjen e kontratës **nuk** ka përgatitur raportin përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës.

Si përfundim, pajisjet monitorë janë marrë në dorëzim në kundërshtim me kontratën e nënshkruar. Zëri ñMonitor Pacienti multiparametrikò në sasinë 50 copë në vlerën 18,250,000 lekë pa tvsh është marrë në kundërshtim me specifikimet teknike sipas kontratës me nr.2587/6, datë 17.06.2020 ñBlerje monitorë pacienti për masat anti COVID-19ò, duke vendosur në diskutim cilësinë e

produkteve për rrjedhojë vlera prej **18,250,000 lekë pa tvsh** ***janë shpenzuar, pa ekonomicitet, pa eficiencë dhe pa efektivitet, të financuara nga Buxheti i Shtetit.***

Në lidhje mbi problematikat e konstatuara, nga grupi i audituesve u mbajt Aktkonstatimi nr.7 datë 30.04.2021 me nr.415/11 prot të MSHMS, të cilët kanë observuar me shkresa nr.415/27 prot, datë 07.05.2021 të MSHMS si dhe observimet dërguar nga MSHMS në lidhje mbi Projekt raportin e përcjellë nga KLSH me shkresë nr.121/10 prot datë 03.09.2021, të cilat kanë ardhur më datë 14.10.2021 jashtë afatit kohor të parashikuar në ligjin 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò neni 26 dhe 29 me shkresë nr.415/47 prot të MSHMS dhe me nr.121/11 prot datë 14.10.2021 të KLSH.
Sa më sipër, audituesit e KLSH , i ri vlerësuan dhe observimet e dyta, të cilat nuk kanë paraqitur dokumentacion shtesë apo argumentim ligjor shtesë në lidhje mbi problematikën e konstatuar, për këtë qëllim, audituesit shprehen me të njëjtin qëndrim, si vijon:

Pretendimi i subjektit:
Referuar kontratës së lidhur me OE OES Distrimed me nr.2587/6 Prot., datë 17.06.2020 sqarojnë se:
Referuar pikës I. Objekti, Çmimi dhe Vlera e Kontratës së kontratës së sipërcituar:
ñObjekti i kontratës është ñBlerje monitorë pacienti per masat anti Covid -19ò të specifikuara në Aneksin Nr.1 te Kontratësò.
Aneksi Nr. 1 i kontratës, (sic e gjeni bashkelidhur ketij observacioni) është oferta e OE OES Distrimed, ofertë me të cilën është kualifikuar nga KVO dhe më pas shpallur fitues nga AK.
Duke qene se kemi te bejme me nje kontrate shitje për te cilat zbatohen dispozitat e Kodit Civil, sic percaktohet dhe nga pika 1.2 e nenit 1 i pikes II.Kushtet e pergjithshme te kontrates:
ñDispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për këtë kontratë. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.ò
Referuar nenit 705 të Kodit Civil ñKontrata e shitjes ka për objekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte kundrejt pagimit të një çmimi.ò
Sic verehet lehtesisht, sendi konkret objekt i kontrates eshte malli i ofruar nga OE OES Distrimed sipas aneksit 1 te kontrates (shiko nenin me lart), dhe jo nje përmbledhje e pergjithshme specifikimesh te dhena ne DST, te cilat nuk identifikojne nje send te caktuar.
Gjithashtu ne piken 2.10 te kontrates se lidhur me OE OES Distrimed, percaktohet ne menyre specifikike se ñObjekt i kontratësò do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet në Lidhje me to që Kontraktuesi do të sigurojë, sipas kushteve të kontratës.
Pra sic percakton dhe vete kontrata, objekt i saj eshte malli qe do te sigurohet nga kontraktuesi, mall i cili i permbahet ofertes për te cilen ai eshte shpallur fitues, pra nje send qartesisht i identifikueshem dhe jo abstrakt.
Pjese perberese e kontrates sic percaktohet ne fq. 2 te saj, jane:
Kushtet e Pergjithshme te Kontrates; Kushtet e Vecanta te Kontrates; DST me aneksin përkates REF-59549-06-01-2020; Oferta dhe dokumentacioni i paraqitur nga kontraktuesi ; Formulari i Sigurimit te Kontrates
Sic verehet qartesisht i gjithe dokumentacioni i paraqitur nga kontraktuesi se bashku me oferten eshte pjese perberese e kontrates dhe i eshte percjelle intitucioneve perfituese me qellim marrjen ne dorezim te mallit . (sipas dokumentacionit bashkelidhur) Ankesi 2 te cilit i referohet KLSH eshte pjese e DST dhe eshte pjese integrale e kontrates por ne asnje nen te kontrates nuk parashikohet qe malli duhet te merret sipas ketyre specifikimeve, pra sipas Aneksit 2, pasi ato jane specifikime teknike te pergjithshme te cilat jane pjese e DST dhe asnje mall konkret nuk mund te identifikohet me to ne menyre analitike.
Sa me lart konstatimi i KLSH se Kontrata është lidhur në kundërshtim me specifikimet teknike, mbi të cilat ka fituar operatori, nuk ka interpretim juridik, ndaj nuk qendron.
Me Urdher nr. 382 datë 24.06.2020, « Për caktimin e koordinatorit për mbikqyrjen e kontratës së furnizimit nr. Prot 2587/6, datë 17.06.2020 me objekt « Blerje monitorë pacienti për masat anti Covid -19 ».
Me anë të emaileve të datës 08.07.2020, znj. P., koordinatorja për mbikqyrjen e kontrates i drejtohet spitaleve perfituese dhe i kerkon qe ne zbatim te kontrates Nr. 2587/6 date 17.06.2020 me objekt " Blerje monitore pacienti per masat anti Covid-19", ti dergohen zyrtarisht me shkrese percjellese:
1. Proces verbali i marrjes ne dorezim nga komisioni i ngritur per kete qellim ku te rezultoje lista e pajisjeve, prodhuesi, modeli, numri i serise, sasite perkatese. Komisioni duhet te verifikoje dhe pasqyroje ne proces verbal qe pajisjet jane instaluar testuar, funksionojne normalisht etj, sipas kushteve te kontrates.
2. Dokumenti i berjes hyrje ne magazinen e institucionit.
Bashkelidhur emailet e derguara.

Kërkesa i referohet zbatimit te kontratës dërguar nga Ministria e Shëndetësisë. Sikurse u sqarua gjeresisht ne piken 1 te ketij Akt Konstatimi, objekti i kontrates eshte malli qe do te sigurohet nga kontraktuesi, mall i cili i permbahet ofertes për te cilen ai eshte shpallur fitues, pra nje send qartesisht i identifikueshem dhe jo abstrakt. ndersa DST nuk ka prodhues, model dhe numer serie.
Malli i marrë në dorëzim i referohet saktësisht modeleve të ofertuara nga OES Distrimed pjesë e oferës së tij teknike e shpallur fituese. (Bashkelidhur dokumenti provues).
Pajisjet dhe aksesorët e tyre, janë instaluar, inspektuar dhe eshte testuar funksionimi normal i tyre siç rezulton nga proces verbalet e firmosura dhe fletehyrjet derguara me shkresë përcjellëse (bashkelidhur) konkretisht:

1. Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik « Mbretëresha Geraldinë» me shkresë përcjellëse Nr. 563 Prot., datë 13.07.2020, protokolluar ne Ministrine e Shendetesise me nr. 2578/prot., date 13.07.2020.
2. Spitali Universitar « Shefqet Ndroqi » me shkresë përcjellëse Nr. 34/57 Prot., datë 10.07.2020, protokolluar ne Ministrine e Shendetesise me nr. 2578/prot., date 13.07.2020.
3. Qendra Spitalore « Nënë Tereza » me shkresë përcjellëse Nr. 1394/8 Prot., datë 13.07.2020, protokolluar ne Ministrine e Shendetesise me nr. 2578/prot., date 15.07.2020.

Në zbatim të Urdhërit të sipërcituar, pika 5, eshte pergatitur dhe dorëzuar Sekretarit të Përgjithshëm Raporti përmbledhës mbi zbatimin e kontratës (bashkelidhur).
Bashkëlidhur gjeni dokumentacionin e Autoriteteve përfituese Qendra Spitalore « Nënë Tereza », spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik « Mbretëresha Geraldinë», Spitali Universitar « Shefqet Ndroqi » :
shkresat percjellese ; proces verbalet e mbajtura nga komisionet e posatshme të ngritura pranë çdo institucioni ; fletëhyrjet në magazinat respektive në përputhje me kontratën.
Sa me lart, konstatimi i KLSH se ñlista e pajisjeve, prodhuesi, modeli, numri i serise, sasite perkatese dokumenti i hyrjes ne magazine jane marre ne zbatim te kontrates dmth sipas DST dhe jo sipas specifikimeve te sjella nga OES Distrimedò, dhe se ñmungon raporti dhe shkresat percjelleseò nuk qendron**.**

<u>Qëndrimi i grupit të auditimit:</u>

-Kontrata nr.2587/6, datë 17.06.2020 me operatorin fitues O.. D... me vlerë 54,905,000 lekë pa tvsh, është produkt i procedurës prokuruese sipas ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, duke përcaktuar dhe kriteret e specifikimet teknike paraqitur në DST, të kërkuara nga shërbimet spitalore, e për pasojë pajisjet monitorë janë marrë në dorëzim në kundërshtim me kontratën e nënshkruar, konkretisht (Zëri Monitor Pacienti Multiparametrik) në sasinë 50 copë me vlerë 18,250,000 lekë pa tvsh, duke vendosur në diskutim cilësinë e produkteve për rrjedhojë vlera prej 18,250,000 lekë pa tvsh është shpenzuar, pa ekonomicitet, pa eficiencë dhe pa efektivitet, të financuara nga Buxheti i Shtetit (Konkretisht modelet e paraqitura në formularin e ofertës, në fakt: (1) kanë rezolucionin 800*600 dhe jo 1024*768, sikundër është kërkuar në specifikimet teknike në DST(pra me rezolucion më të ulët nga sa kërkuar në DST); dhe (2) nuk kanë ndërfaqe të integruar protokolli HL7 dhe jo DIAP si kundër është kërkuar në specifikimet teknike), për punonjësit:
-Nga auditimi i kontratës nr.2587/6 datë 17.06.2020 në Aneksin nr.2 ñSpecifikimet teknikeò, nuk janë reflektuar ñdevijimet e vogla në specifikimet teknike të monitorëveò, për të cilat KVO është shprehur në PV datë 08.06.2020, por janë lënë specifikimet sikundër paraqiten në DST
-Me anë të emaileve të datës 08.07.2020, znj.P, koordinatorja për mbikqyrjen e kontratës i ka kërkuar spitaleve përfituese të këtij prokurimi Procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallit, ku është konstatuar se, lista e pajisjeve, prodhuesi, modeli, numri i serisë, sasitë përkatëse, dokumentin e hyrjes në magazinë, janë marrë në zbatim të kontratës dmth sipas DST, dhe jo sipas specifikimeve të sjella nga O.. D... shpk, për të cilat KVO i ka quajtur devijime të vogla. Materialet e mësipërme janë dërguar në MSHMS pa shkresa përcjellëse.
Gjithashtu, janë mbajtur procesverbalet e dorëzimit në datën 23.06.2020 ku janë shënuar lista e pajisjeve , prodhuesi, modeli, numri i serisë dhe sasitë përkatëse dhe fletë Hyrjet në magazinë.
Sipas Urdhrit me nr.382, datë 26.06.2020 ñPër caktimin e koordinatorit për mbikqyrjen e kontratës së furnizimit nr.2587/6, datë 17.06.2020ò, koordinatori për mbikqyrjen e kontratës **nuk** ka përgatitur raportin përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës.
Si përfundim, pajisjet monitorë janë marrë në dorëzim në kundërshtim me kontratën e nënshkruar . Zëri Monitor Pacienti multiparametrik në sasinë 50 copë në vlerën 18,250,000 lekë pa tvsh është marrë në kundërshtim me specifikimet teknike sipas kontratës me nr.2587/6, datë 17.06.2020 ñBlerje monitorë pacienti për masat anti COVID-19ò, duke vendosur në diskutim cilësinë e produkteve për rrjedhojë vlera prej **18,250,000 lekë pa tvsh** ***<u>janë shpenzuar, pa ekonomicitet, pa eficiencë dhe pa efektivitet, të financuara nga Buxheti i Shtetit.</u>***
Në observacion nuk është paraqitur asnjë dokument justifikues bashkëlidhur.
Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

5. Titulli i Gjetjes:	Auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: *"Blerje monitor pacienti për masat anti Covid-19".*
Situata 1:	Nga auditimi i procedurës së prokurimit **"**Blerje monitor pacienti për masat anti

	Covid-19ò, realizuar nga MSHMS, të zhvilluar në vitin 2020. Titullari i MSHMS ka miratuar Urdhrin e Prokurimit nr. 359, datë 06.06.2020, me njësi prokurimi me përbërje: A.P, E. L dhe L.P, të cilët kanë argumentuar përdorimin e llojit të procedurës së prokurimit ñNegocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratësò. Gjithashtu, titullari i AK, me shkresën nr. 2587 /1, datë 01.06.2020, ka miratuar Urdhër nr.359/1, datë 01.06.2020 për emërimin e Komisonit të Vlerësimit të Ofertave me përbërje: F. B, O.Dh dhe O. A. Në bazë të PV, të njësisë së prokurimit, janë përzgjedhur tre OE për të marrë pjesë si operatorë që kanë pasur kontrata të mëparshme të sukseshme me MSHMS, konkretisht O.. D shpk, M... shpk dhe B.. E.., të cilëve u janë dërguar ftesë për pjesëmarrje, kjo në përputhje me VKM nr.914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregulave të prokurimit publicò i ndryshuar, neni 36 pika 4. Nga auditimi u konstatua se, sipas procesverbalit të mbajtur nga KVO në datën 08.06.2020, është paraqitur *vetëm* një operator O.. D.. shpk, me ofertë ekonomike 54,905,000 lekë pa tvsh (ose 30,605,265, lekë më pak nga fondi limit), ku midis të tjerave është konstatuar se, operatori ekonomik ñO.. D...ò shpk. Nga verifikimi qe bëri KLSH rezultoi se, modelet e paraqitura në formularin e ofertës, në fakt: (1) kanë *rezolucionin 800*600* dhe jo *1024*768***,** sikundër është kërkuar në specifikimet teknike në DST(**pra me rezolucion më të ulët nga sa kërkuar në DST**).; dhe (2) *nuk kanë ndërfaqe të integruar protokolli HL7 dhe jo DIAP*sikundër është kërkuar në specifikimet teknike. Pamvarësisht sa më sipër, KVO ka vendosur ta pranojë këtë ofertë duke e konsideruar shmangien nga ky kriter si devijim të vogël, dhe që nuk ndikon në funksionet klinike të monitorit. Në fakt, devijime te vogla, në kuptimin që i njeh Ligji i Prokurimit Publik jane devijimet qe nuk ndryshojne materialisht ose nuk i kalojne specifikimet, kushtet, termat dhe kerkesat e tjera ose gabimet e shtypit apo pakujdesite dhe qe mund te korrigjohen pa ndryshuar thelbësisht karakteristikat dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në DST, ndërkohë që konstatojmë se elementet e ndryshuar tek malli i kërkuar ï monitorë, lidhen direkt me karakteristikat e produktit të kërkuar në DST (kjo gjithashtu është arsyeja dhe pse është vlerësuar që këto specifikime teknike (dhe jo të tjera) të hartuara nga institucionet përfituese - QSUT me shkresën nr.1403/1, datë 17.03.2020, SU ñShefqet Ndroqiò me nr.34/21, datë 31.03.2020 dhe SUOGJ ñMbretëresha Geraldinëò me nr.296, datë 27.03.2020) të kërkohen në DST). - Në vijim. operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumente duhet te refuzohen si te papranueshme, ne mbeshtetje edhe te pikes 3, te nenit 66 te VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, ne te cilen percaktohet se komisioni verifikon dhe vlereson ofertat e dorezuara, duke kualifikuar vetem ato oferta, qe perrnbushin kriteret per kualifikim, te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Nisur nga sa më sipër, duke kualifikuar një ofertë që nuk i plotëson të gjitha karakteristikat sipas DST, KVO ka vepruar në kundërshtim me piken 3, te nenit 66 te VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, ne te cilen percaktohet se komisioni verifikon dhe vlereson ofertat e dorezuara, duke kualifikuar vetem ato oferta, qe permbushin kriteret per kualifikim, te percaktuara ne dokumentet e tenderi. -Gjithashtu nje ndër parimet kryesore te zhvillimit te procedures se prokurimit eshte ai barazise ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve, parashikuar nga neni 2, i Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", te ndryshuar. Zbatimi i parimit te transparences, barazise dhe mos diskriminimit jane garancite kryesore ndaj ofertuesve qe ofron kuadri ligjor ne fuqi. Keto parime, nder te tjera nenkuptojne se operatoret ekonomike duhet te jene ne nje pozicion barazie, si kur pergatisin ofertat e tyre ashtu dhe kur këto oferta vleresohen. Në rastin konkret, parashikimi në DST: (1) i një **rezulocioni më të lartë** i cili më pas rezulton të jetë pranuar më i vogël, për OE fitues duke u trajtuar si ñdevijim i vogëlò; dhe (2) i **ndërfaqes së integruar të protokollit DIAP,** e cila më pas rezulton të jetë ndryshuar dhe pranuar në HL7, për OE fitues duke u trajtuar si ñdevijim i vogëlò,tregon se KVO ka shkelur parimin e barazisë, duke i vendosur OE-të në pozita jo të barabarta përgjatë fazës së përgatitjes së ofertave dhe si pasojë edhe gjatë vlerësimit të ofertës.

	Vlerësimi i ofertave referuar kritereve të tjera të kualifikimit të cilat nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 55 pika 2 e LPP-së, por cënon gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar në nenin 2 të Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", te ndryshuar, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. Në vijim të sa më sipër, nga auditimi , rezultoi se Njësia e Prokurimit me anëtarë A.P, E.L dhe L.P nuk kanë reflektuar në Aneksin nr.2, devijimet e vogla për monitorët, të miratuara nga KVO sipas proces-verbalit të datës 08.06.2020, por i kanë lënë specifikimet teknike të pandryshuara sikundër ishin në DST. Me shkresën nr.2587/7, datë 19.06.2020, është dërguar për zbatim kontrata me objekt ñBlerje monitorë pacienti për masat anti COVID-19ò autoriteteve përfituese: Qendrës Spitalore Universitare ñNënë Terezaò, SU ñShefqet Ndroqiò dhe SUOGJ ñMbretëresha Geraldinëò. -Me shkresën nr.2587/9, datë 26.06.2020, titullari i AK ka miratuar Urdhrin me nr. 382, datë 26.06.2020 ñPër caktimin e koordinatorit për mbikqyrjen e kontratës së furnizimit nr.2587/6, datë 17.06.2020ò, znj.L.P e cila është përgjegjëse për monitorimin e kontratës . Me anë të emaileve të datës 08.07.2020, znj.P., koordinatorja për mbikqyrjen e kontratës i ka kërkuar spitaleve përfituese të këtij prokurimi Procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallit, ku është konstatuar se, lista e pajisjeve, prodhuesi, modeli, numri i serisë, sasitë përkatëse, dokumentin e hyrjes në magazinë, janë marrë në zbatim të kontratës (pjese integrale e së cilës janë edhe DST, edhe oferta e OE-së). Materialet e mësipërme janë dërguar në MSHMS pa shkresa përcjellëse. Në observacionet e dërguara nga MSHMS, në KLSH, konfirmohet, shoqëruar me evidencat përkatëse se, malli i marrë në dorëzim i referohet saktësisht modeleve të ofertuara nga O... D..., pjesë e ofertës së tij teknike e shpallur fituese, dhe jo DST. Nga auditimi rezultoi se, koordinatori për mbikqyrjen e kontratës nuk ka përgatitur raportin përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me Urdhrin me nr.382, datë 26.06.2020 ñPër caktimin e koordinatorit për mbikqyrjen e kontratës së furnizimit nr.2587/6, datë 17.06.2020ò. Si përfundim, pajisjet monitorë janë marrë në dorëzim në kundërshtim me kontratën e nënshkruar. Zëri Monitor Pacienti multiparametrik në sasinë 50 copë në vlerën 18,250,000 lekë pa tvsh është marrë në kundërshtim me specifikimet teknike sipas kontratës me nr.2587/6, datë 17.06.2020 ñBlerje monitorë pacienti për masat anti COVID-19ò, duke vendosur në diskutim cilësinë e produkteve për rrjedhojë vlera prej **18,250,000 lekë pa tvsh** ***janë shpenzuar, pa ekonomicitet, pa eficiencë dhe pa efektivitet, të financuara nga Buxheti i Shtetit.***
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikñ, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar,
Ndikimi/Efekti:	Procedura në shkelje të kuadrit ligjor në fuqi; **KVO duhet ta kishte skualifikuar OE ;** Risqe të përdorimit pa efektivitet, pa ekonomicitet dhe pa efiçencë të fondeve buxhetore për sasinë 50 monitorë multiparametrik në vlerën prej **18,250,000 lekë pa tvsh**
Shkaku:	Lidhja e kontratës pa reflektuar devijimet e konstatuara nga KVO, si dhe marrja në dorëzim e e monitorëve në mospërputhje me specifikimet teknike sipas kontratës nr.2587/6, datë 17.06.2020.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi	Për të gjitha rastet në vijim, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të veprojnë në përputhje me parimet transparences, barazise dhe mos diskriminimit përgjatë zhvillimit të procedurave të tenderave në MSHMS, me qëllim vendosjen e operatorëve ekonomikë në kushte barazie si përgjatë fazës së përgatitjes së ofertave, ashtu dhe gjatë vlerësimit të tyre. Gjithashtu KVO-të, në cdo rast, të vleresojë si oferta te vlefshme, me devijime të vogla vetëm rastet kur këto devijime janë të argumentuara se **nuk ndryshojne thelbesisht** karakteristikat e percaktuara ne dokumentet e tenderit, në përputhje me sa dikton kuadri ligjor në fuqi, konkretisht KVO të konsiderojnë si oferta te vlefshme rastet kur oferta:

	a) permban devijime te vogla, te cilat materialisht nuk ndryshojne ose devijojne kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentet e tenderit; dhe b) oferta permban gabime apo lapsuse, te cilat mund te korrigjohen pa prekur perrnbajtjen e ofertes.
Afati i zbatimit:	Në vijimësi

2. Mbi auditimin e realizimit të procedurës prokuruese me objekt <u>"Rikonstruksion i godinave të Maternitetit "Mbretëresha Geraldinë" dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë"</u> realizuar në vitin 2020, nga MSHMS.

Grupi i audituesve të KLSH-së, për të realizuar objektin e auditimit, *<u>u fokusua</u>*, në zbatimin akteve ligjore dhe nënligjore, në lidhje mbi, procesin e realizimin e procedurave të prokurimit për periudhën e auditimit, në mbështetje të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikñ i ndryshuar, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinòi ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menazhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò , të ligjit nr.27 datë 17.05.2018 ñPër trashëgimine Kulturore dhe Muzetëò, të VKM nr.26 datë 15.01.2020 ñPër kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuaraò,të Aktit Normativ nr.9 datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, të ligjit nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, të VKM nr.354 datë 11.05.2016 ñPër miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projekte, mbikqyrje dhe kolaudimò , të VKM- në nr.514 datë 15.08.2007 ñPër informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.òi ndryshuar me VKM 629 datë 15.07.2015, të ligjit nr.7582 datë 13.07.1992 ñPër ndërmarrjet shtetëroreò i ndryshuar si dhe çdo akti juridike që është në fuqi në lidhje mbi kontratat e prokurimit.

2.1 Nga auditimi u konstatua se, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) ka realizuar procedurën e hapur me objekt ñ*Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë*ò me fond limit në vlerën prej **668,493,718.32 lekë** pa tvsh, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të cilit i është deleguar procedura e prokurimit, nga autoritetit kontraktor Spitali Universitar Obsetrik-Gjinekologjik (SUOGJ) ñMbretëresha Geraldinaò në referim shkresës nr.243 prot. datë 05.03.2020, me objekt kërkesën që realizimi i procedurës, të bëhet nga MSHMS, meqënëse SUOGJ ñMbreteresha Geraldinaò, *<u>nuk disponon kapacitetet e duhura për të kryer zhvillimin e procedurës së prokurimit publik.</u>*

Në bazë të VKM nr.325 datë 23.06.2000, SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò është institucion i varësisë i MSHMS.

Kështu, MSHMS, në mbështetje të LPP dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar neni 2 pika 2.1, ku citohet se ñ*2.1Nëse një ose disa autoritete kontraktore kanë nevojë të prokurojnë mall/punë ose shërbim, ata mund të bien dakort të delegojnë të drejtën e kryerjes së procedurës së prokurimit një autoriteti tjetër kontraktor për shkak të kapaciteteve që ky i fundit ka në fushën e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor, të cilit i është deleguar e drejta e prokurimit, <u>është plotësisht përgjegjës për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, që nga njoftimi i kontratës deri te publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit</u>, ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga vetë autoriteti/et kontraktorë/e përfitues/e"* si dhe në zbatim të ligjit nr.9643 datë 21.11.206 ñPër prokurimin publikòtë ndryshuar, neni 33 të Kreut IV të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò të ndryshuar, ka miratuar Urdhër Prokurimi nr.443 datë 27.07.2020 me shkresë nr.3581 datë

27.07.2020 si dhe ka publikuar në SPE app.gov.al procedurën e prokurimit me REF-67482-07-31-2020 , Njoftim e kontratës me shkresë nr.3581/2 datë 30.07.2020.

2.2 Burimi i financimit për këtë investim është Buxheti i Shtetit (financim disa vjecar) miratuar me shkresat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.2169/8 prot datë 21.02.2020 dhe nr.1250/47 prot datë 14.07.2020, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, me lendë për dakortësinë e vlerës së investimit.
2.3 Nga auditimi u konstatua se, vlera e fondit limit prej 668,493,718.32 lekë pa tvsh, **nuk** është përllogaritur nga MSHMS apo njësia e prokurimit me përbërje (A.P, E.L dhe Ing.D. K) pasi në proces-verbalin e datës 31.07.2020 shprehen se :
ñ*I gjithë dokumentacioni i nevojshëm për realizimin e kësaj procedure është përcjellë nga SUOGJ "Mbretëresha Geraldine" me shkresat nr.4/2 prot datë 10.02.2020 me lëndë "Dërgim informacioni", dhe "Dërgim preventive punimesh" me shkresë nr.363 prot datë 30.04.2020*..ò
-Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm në dosje fizike ï teknike të procedurës, u konstatua se, Preventivi i objektit ñ*Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë* ò, është i firmosur dhe i vulosur në çdo faqe *vetëm* nga Ing.A. H në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Ndërtimit, dhe jo nga Preventivuesit për të gjitha llojet e projekteve teknike, ku preventive përkatës shoqërohet me vulë elektronike,liçencë profesionale dhe me Deklaratë të përgjegjësisë profesionale në bazë të ligjit nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar.
-Nga auditimi i dokumentacionit në dosjet fizike ï teknike të procedurës, u konstatua se, nga SUOGJñMbretëresha Geraldineò me shkresë nr.364 prot, datë 30.04.2020 është përcjellë Oponenca teknike të objektit ñ*Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë* ò pranë MSHMS.Oponenca teknike është realizuar po nga Instituti i Ndërtimit (i cili gjithashtu ka bere edhe projektin), në bazë të kërkesës së SUOGJ ñMbretëresha Geraldinëò me shkresë nr.1066/2 datë 25.11.2019, produkti i së cilës është dërguar me shkresë nr.597/3 prot datë 10.01.2020 në SUOGJ ñMbretëresha Geraldinëò.
Grupi i Oponencës: Ing.Konst I.P
Ark.Xh.E
Ing.Hidroteknik I. Sh.
Ing.M. M
Fimosur nga Ing. M. Sh (shefe e sektorit të Oponencave) dhe Ing. V. P (Drejtore Drejtorie) në Institutin e Ndërtimit, të cilët në përfundim janë shprehur se ñ*Nga studimi i materialeve të vëna ne dispozicion, për projektin e zbatimit të objektit "Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë", konkludohet se Projekti është hartuar konform kushteve teknike të projektimit.*ò
Nga auditimi u konstatua se, Oponenca Teknike është e firmosur dhe vulosur Ing.A. H në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Ndërtimit, ne kushte te konfliktit të interesit, pasi ka miratuar oponencen e nje projekti te bere nga vete ai.

-Gjithashtu, nga auditimi në materialin e Oponencës Teknike të përgatitur nga IN, u konstatua se:
Investitor: Spitali Universitar Obsetrik-Gjinekologjik
Konsulent: Instituti i Ndërtimit
Grupi i Projektimit
Projekti arkitektonik: Ark.E.F.
Ark.E. D. (Punonjës në IN)
Projekti Konstruktiv: *Ing.A. H. (Drejtor i Përgjithshëm)*
Projekti Elektrik: *Ing.D. M. (Punonjës në IN)*
Projekti Hidroteknik: Ing.A. K.
Ing.A. Z

Në faqen 29 të Oponencës Teknike, pika 5 (Preventivi), shprehen se: ñ*Preventivi për objektin "Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat, Tiranë është hartuar nga Instituti i Ndërtimit, me vlerë totale prej 802.192,461.98 lekë me tvsh*ò

Grupit të auditimit, deri në momentin e hartimit të këtij materiali, nuk iu vunë në dispozicion dokumentacioni ligjor, teknik dhe financiar nga SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò, mbi mënyrën se si është përcaktuar Instituti i Ndërtimit në rolin e konsulentit dhe hartuesit të projektit teknik.

-Procedurat për përcaktimin e studios së projektimit, realizohet në mbështetje të ligjit nr.9643 datë 21.11.206 ñPër prokurimin publicòtë ndryshuar, neni 34/1 ñShërbim konsulencëò, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publicò të ndryshuar, neni 37. Në kushtet kur SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò, është institucion publik i cili që në vitin 1937 ka pasur funksione të shërbimit gjenekologjik; është Qendër Universitare Spitalor Obsetrik-Gjenokologjik; është godinë e Trashëgiminisë Kulturore; është godinë që lejen e ndërtimit ia miraton Këshilli Kombëtar i Territorit, dhe për rrjedhojë, nga AK SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò, si njësi e varësisë së MSHMS, procedura duhet të prokurohej, nëpërmjet një gare transparente, nxitëse për pjesëmarrje të operatorëve ekonomik që kanë objekt fushën e hartimit të projektimit, nxitëse për konkurencë profesionale, në mënyrë të tillë që të sigurohet mirëpërdorimi i fondeve publike.
Qëllimi i procedurës është realizimi i Projektit Teknik (projekti i arkitekturës, projekti konstruktiv, projekti hidrosanitar, projekti elektrik, projekti i instalimeve mekanike (ngroje ftohje, sistemi O_2) projekti i MKZ etj. Projektit teknik shoqërohet me preventivat përkatës sipas llojit të projekteve teknike dhe përcakton vlerën e realizimit të objektit.
-Në bazë të VKM nr.354 datë 11.05.2016 ñPër miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territory, projekte, mbikqyrje dhe kolaudimò, i cili shërben për llogaritjen e pagesave për të gjitha shërbimet e planifikimit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit, të kryera nga arkitektët dhe inxhinierët (porosimarrës), të financuara me fonde publike, grupi i auditimit në bazë të vlerës *totale prej 802.192,461.98 lekë me tvsh ose vlera e fondit limit prej* 668,493,718.32 lekë pa tvsh, për objektin *"Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë"* e hartuar nga Instituti i Ndërtimit dhe e prokuruar nga MSHMS, përllogariti se minimumi i vlerës së projektimit është 23,148,100.23 lekë pa tvsh dhe maximum i vlerës së projektimit është 25,917,280.13 lekë pa tvsh, duke llogaritur të gjitha fazat *si vijon:*

FAZA I: Analiza e detyrës së projektimit /termat e referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit;
FAZA II: Projektideja paraprake dhe projekti i restaurimit;
FAZA III: Projektideja përfundimtare;
FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së zhvillimit dhe të ndërtimit;
FAZA V: Projekti i zbatimit;
FAZA VI: Preventivi përfundimtar;
FAZA VII: Përgatitja e dokumentacionin për procedurë tenderimi;
FAZA VIII: Mbikëqyrje;
FAZA IX: Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar për kolaudim.

Grupi i auditimit, deri në momentin e hartimit të këtij materiali, nuk iu vunë në dispozicion dokumentacioni ligjor, teknik dhe financiar nga SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò, mbi mënyrën se si është manaxhuar vlera e projektimit.

2.4 Nga auditimi i dokumentacionit, të përcjellë nga SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò me shkresë nr.4/2 prot datë 10.02.2020 në MSHMS, u konstatua se:

-*Në datën 30.11.2019 nga Instituti i Ndërtimit* është mbajtur AktKonstatimi mbi verifikimin në terren të subjekteve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, i firmosur dhe vulosur nga drejtori i Përgjithshëm Ing.A. H., me grup inspektimi me përbërje (Ing.A. H., ing. A. C , ing. G. Ç dhe ark. E. D), duke përshkruar si vijon: ñ*Çarje të mureve të urës lidhëse midis dy objekteve të maternitetit. Rënie të suvasë dhe plasaritje në disa nga muret e godinave të tjera. Objekti ka dëmë të larta në strukturë…Të bllokohet aktiviteti . Të merren masa.*ò

Nga auditimi u konstatua se, (Ing.A.H, dhe ark. E.D) janë në konflikt të interesit me detyrat që kanë realizuar, pasi janë anëtarë të grupit të projektimit.

-Në datën 19.02.2020 nga Instituti i Ndërtimit është hartuar Aktekspertiza mbi inspektimin në terren objekt ndërtimi, dërguar në SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaòme shkresë nr.207/1 datë 24.01.2020, ndërsa SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò këtë ekspertizë e ka përcjellë në MSHMS me shkresë nr.207/1 datë 25.02.2020. Grupi i inspektimi me përbërje (Ing.A.H , Ing.A. Ç).

Nga auditimi i Aktekspertizës së datës 19.02.2020, u konstatua se, aktekspertiza e thelluar përmban *masat për rikonstruksion dhe përforcimi i Godinës së Obstetrikës, ndërsa për Godinën e Neonatoligjisë paraqitet më e vështirë, e për pasojë riparimi dhe përforcimi i strukturës është joeficient për tu riparuar*, ndërsa në lidhje mbi **vlerën financiare** për këto ndërhyrje **nuk** është pasqyruar, kjo në kundërshtim me VKM nr.26 datë 15.01.2020 ñPër kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuaraò dhe në kundërshtim me Aktin Normatin nr.9 datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò neni 34 paragrafi 2, ku në mungesë të detyrës së Projektimit nga SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò, e cila shpreh funksionet e godinave që do të projektohen dhe rikonstruktohet, **nuk** ka mundur të bëje krahasimin si ka qënë gjendja e godinave para dhe pas termetit dhe për rrjedhojë dhe ndryshimet që mund të ketë pësuar preventivi respektiv.

Gjithashtu, dhe në këtë rast nga anëtaret e grupit Aktekspertizës së datës 19.02.2020, janë në konflikt të interest me detyrat që kanë realizuar.

2.5 Nga auditimi u konstatua se, Ministria e Kulturës (Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale), me Vendim nr.29 datë 22.01.2020, ka miratuar projektin ñ*Rikonstruksion i godina të Maternitetit Mbretëresha Geraldina"* në mbështetje të ligjit nr.27 datë 17.05.2018 ñPër trashëgimine Kulturore dhe Muzetëò neni 38 pika 2, duke e përcjellë me shkresë nr.501/1 prot datë 07.02.2020 në MSHMS në cilësinë e subjektit aplikues, hartuar nga subjekti i licensuar për restaurim z.O.Z (Nga auditimi z.Z nuk është pjesë e grupit të projektimit).

2.6 Nga auditimi i Preventivit të prokuruar nga MSHMS i hartuar nga Instituti i Ndërtimit, duke iu referuar vetëm disa zërave më vlerë të lartë, u konstatua se:

Nr.	Nr.Manuali	Lloji i punimeve	Vlera/Lekë
		d.Punime murature (Godina e Re)	
1	An	F.V Mur me tulla qeramike me spesor 25 cm, me dimesione 25x25cm, me peshe mbi 500kg/m^3, lidhje llacM.150.Minimumi dy breza lidhës në lartësi, me beton M.200, me 4 fije çeliku të vjaskuar,O8mm, me stafa çeliku të vjaskuar O8mm, çdo 25 cm, të lidhura me kolonat B/A me fije çeliku të parashikuara në armaturën e kolonës. Lidhje e perimetrit të muratuarës me konstruksionin me fije çeliku 08mm, çdo dy rreshta tulle	3,370,320.00
2	An	F.V.Mur me teknologji të thatë me spensor125mm, me dopio panel gipsi me peshë 17.5kg/m^2, fiksuar me vida të përshtatshme në konstruksion metalik me dimension profile 70mm, me llamarinë të kthyer 0.6mm të galvanizuar.Mbushje zëizoluese me panele lesh guri, me spensor 40 mm dhe dëndësi 40kg/m^3.mbushje fugatuare me stuko Knauf dhe rrjete plastike. Izolim zhurmash 60db	3,049,921.00
3	An	F.V.Mur me teknologji të thatë me spensor150mm, me dopio panel	173,795.01

		gipsi me peshë 17.5kg/m^2, fiksuar me vida të përshtatshme në konstruksion metalik me dimension profile 100mm, me llamarinë të kthyer 0.6mm të galvanizuar.Mbushje zëizoluese me panele lesh guri, me spensor 80 mm dhe dëndësi 40kg/m^3.mbushje fugatuare me stuko Knauf dhe rrjete plastike. Izolim zhurmash 72db	
4	An	F.V.Veshje nga dy krahët me mur me teknologji të thatë me spensor të variushëm. Dopio panel gipsi me peshë 17.5kg/m^2, fiksuar me vida të përshtatshme në konstruksion metalik me dimension profile 70mm, me llamarinë të kthyer 0.6mm të galvanizuar. Mbushje fugatuare me stuko Knauf dhe rrjete plastike. Izolim zhurmash 60db	506,093.40
		Shuma d	**7,100,129.41**
		c.Punime shtresash	
7	An	F.V.dysheme industrial me bikomponent, autoniveluese.mbulueshmëria 0.2-0.3kg/m^2, me spencer 5-7mm.materiali sipërfaqësor rezistues ndaj shkrirjes, abrazionit dhe me përmbajtje antibakteriale, në finiturë mat, ngjyra për tu përcaktuar në vend	24,139,500.00
		Shuma c	**24,139,500.00**
		j.Punime izolimi themele dhe tarace	
1	An	F.V Termo dhe hidroizolim i pllakës së themelit dhe katit nëntokë. Primer, termoizolim me polesterol ekspans me spensor 80mm. Hidroizolim me dy shtresa guajne bituminoze, gjeotekstil, shtresë mbrojtëse.	33,900,000.00
2	An	F.V.Shtresa tarace, ku përfshihet hapësira ajrimi me teknologji ñIgluò në PVC të përforcuar.Shtresë betoni me zgarë metalike, termoizolim me poliuretan ekspans me dëndësi 35kg/m^{3}dhe spensor 80 mm.shtresë e varfër me pjerrësi.Hidroizolimi me dy duar guanje bituminoze,shtrese mbrojtesi,shtrim me pllaka gres porcelanat dim 20x20 me spesor 11mm,ngjitje me kollë+bojake.	20,289,204.00
		Shuma j	**54,189,204.00**
		Godina ekzistuese b.Punime murature	
1	An	F.V Mur me tulla qeramike me spesor 25 cm, me dimesione 20x25x25cm, me peshe mbi 500kg/m^3, lidhje llacM.150.Minimumi dy breza lidhës në lartësi, me beton M.200, me 4 fije çeliku të vjaskuar, O8mm, me stafa çeliku të vjaskuar O8mm, çdo 25 cm, të lidhura me kolonat B/A me fije çeliku të parashikuara në armaturën e kolonës. Lidhje e perimetrit të muratuarës me konstruksionin me fije çelikuO8mm, çdo dy rreshta tulle	711,028.80
2	An	F.V Mur me tulla qeramike me spesor 12 cm, me dimesione 12x25x25cm, me peshe mbi 500kg/m^3, lidhje llacM.150.Minimumi dy breza lidhës në lartësi, me beton M.200, me 4 fije çeliku të vjaskuar,O8mm, me stafa çeliku të vjaskuar O8mm, çdo 25 cm, të lidhura me kolonat B/A me fije çeliku të parashikuara në armaturën e kolonës. Lidhje e perimetrit të muratuarës me konstruksionin me fije çelikuO8mm, çdo dy rreshta tulle	108,100,00
3	An	F.V.Mur me teknologji të thatë me spensor125mm, me dopio panel gipsi me peshë 17.5kg/m^2, fiksuar me vida të përshtatshme në konstruksion metalik me dimension profile 70mm, me llamarinë të kthyer 0.6mm të galvanizuar.Mbushje zëizoluese me panele lesh guri, me spensor 40 mm dhe dëndësi 40kg/m^3.mbushje fugatuare me stuko Knauf dhe rrjete plastike. Izolim zhurmash 60db	659,555.20
4	An	F.V.Mur me teknologji të thatë me spensor150mm, me dopio panel gipsi me peshë 17.5kg/m^2, fiksuar me vida të përshtatshme në konstruksion metalik me dimension profile 100mm, me llamarinë të kthyer 0.6mm të galvanizuar.Mbushje zëizoluese me panele lesh guri, me spensor 80 mm dhe dëndësi 40kg/m^3.mbushje fugatuare	83,474.78

		me stuko Knauf dhe rrjete plastike. Izolim zhurmash 72db	
		Shuma b	**1,562,158.78**
		c.Punime shtresash	
6	An	F.V.Dysheme industrial me bikomponent, autoniveluese.mbulueshmëria 0.2-0.3kg/m^2, me spencer 5-7mm.materiali sipërfaqësor rezistues ndaj shkrirjes, abrazionit dhe me përmbajtje antibakteriale, në finiturë mat, ngjyra për tu përcaktuar në vend.	9,333,940.00
		Shuma c	**9,333,940.00**
		g.Punime fasade	
1	An	F.V system kapote me spesor total 100mm.material termoizolues polietileni me peshë 35kg/m^3,pershi aksesorë montimi me shtresë përfundimtare grafiata strukturore me dimesion 3 mm me boje të intergruar.	4,433,300.00
		Shuma g	**4,433,300.00**
		h.punime izolim tarace	
1	An	F.V.Shtresa tarace, ku përfshihet hapësira ajrimi me teknologji ñIgluò në PVC të përforcuar.Shtresë betoni me zgarë metalike, termoizolim me poliuretan ekspans me dëndësi 35kg/m^{3}dhe spensor 80 mm.shtresë e varfër me pjerrësi.Hidroizolimi me dy duar guanje bituminoze,shtrese mbrojtesi,shtrim me pllaka gres porcelanat dim 20x20 me spesor 11mm,ngjitje me kollë+bojake.	9,300,000.00
		Shuma h	**9,300,000.00**
13	An	**e.Punime shtresash**	
		FV shtrim i sallës operative me PVC antibacterialò	**39,360,000**
		Totali	**149,418,232.0**

Sa më sipër, mungojnë analizat e cmimeve për punimet ndërtimore, për godinën e re dhe godinën ekzistuese,*zërat e mësipërm janë me analizë çmimi, por bashkëlidhur **nuk** u evidentua një listë e hollësishme çmimesh me analizë të detajuar të çmimit ku futet (vlera e mallit/pajisja +pagesa e sigurimeve shoqërore+pagesa e puntorisë+ transport, etj)*, kjo në kundërshtim me VKM- në nr.514 datë 15.08.2007 ñPër informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.òi ndryshuar me VKM 629 datë 15.07.2015.
Në llogaritjen e kostove për punimet ndërtimore, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, **nuk** u gjet asnjë përllogaritje e çmimeve apo studim tregut sipas VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò Kreu VII, neni 59, ñPërllogaritja e vlerës limit të kontratësò pika 2, ku përcaktohet se në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet tõ referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);***ose/dhe*** a) Çmimet e tregut; ose/dhe b) Çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe ç) Çmimet ndërkombëtare, të botuara.
Zërat e mësipërme përbëjnë rrisqe potenciale për rritje apo fryrje fiktive të vlerës së kontratës të sjella nga Instituti i Ndërtimit si projektues i objektit dhe konkretisht vlera prej **149,418,232.0 lekë nuk është e argumentuar.**

Për sa më sipër, nga grupi i audtimit me përbërje ing. auditues, konstatoi si vijon:
1. Nga auditimi i preventivit të punimeve, rezulton se në kapitullin ñPunime izolimi themele dhe tarraceò, është vendosur një zë pune kompleks, me emërtimin dhe çmimin, si më poshtë:

"F.V Termo dhe hidroizolim i pllakës së themelit dhe katit nëntokë. Primer, termoizolim me polesterol ekspans me spensor 80mm. Hidroizolim me dy shtresa guajne bituminoze, gjeotekstil,

shtresë mbrojtëse", me çmimin 30,000 lekë/m², me vlerë totale 33,900,000 lekë pa TVSH (1130 m² x 30,000 lekë/m²).

Nisur nga mungesa e analizës së çmimit në dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe nga verifikimi i këti zëri pune, rezulton se nënzërat e tyre, si: primer, termoizolim me polesterol ekspans me spensor 80 mm, Hidroizolim me dy shtresa guajne bituminoze, gjeotekstil, shtresë mbrojtëseò, janë zëra që mund të gjenden të njëjtë (ose të ngjashëm) në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi dhe nga rillogaritja e çmimit të ri, rezulton si më poshtë:

Nr.	*Nr. An*	*Emërtimi*	*Njësia*	*Çmimi*
1	*2.197*	*Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama*	*m²*	*1,232*
3	*2.95/a*	*Panel dopio per mure betoni t=20cm, polisterol t=10+10 cm, densitet = 30kg/m³ (zë i ngjashëm)*	*m²*	*16,269*
4	*2.423/a*	*Shtrese avullizoluese gjeotekstil*	*m²*	*190*
		Totale		*17,691*

Nisur nga sa sipër, çmimi i këtij zëri pune është rritur me 12,309 lekë/m², ose në totalin e preventivit 13,909,170 lekë pa TVSH (12309 lekë/m² x 1130 m²).

2. Për zërin e punës nr. 13 të kapitullit ñe. Punime shtresashò me përshkrimin ñFV shtrim i sallës operative me PVC antibacterialò, me çmim njësi 4920 lekë/m², me vlerë 39,360,000 lekë (8000 m² x 4920 lekë/m²), në mungesë të analizës së çmimit në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe nga kërkimi i bërë në internet për çmimin e këtij materiali në linkun https://www.made-in-china.com/products-search/hot-china-products/Pvc_Flooring_For_Hospital.html, rezultoi se çmimi i materialit PVC antibacterial për spitalet, varion nga 5-15 USD/m² (ose 505 ï 1545 lekë/m²).

Nga sa sipër, duke shtuar edhe nënzërat e tjerë të analizës së kostos (punëtori, transport dhe makineri), përsëri ekziston rreziku i rritjes së pajustifikuar të çmimit njësi të këtij zëri pune. Analiza e çmimit me testimin e tregut për nënzërin ñmaterialò, do të jepte një vlerësim objektiv për çmimin e këtij zëri pune.

Nga auditimi i preventivit të punimeve, rezulton që çmimet e një pjese të konsiderueshme të zërave ndërtimorë, si për ndërtimin e godinës së re, ashtu edhe në rikonstruksionin e godinës ekzistuese, janë bërë me analiza çmimesh. Kështu, në godinën e re, kapitulli ñd. Punime muratureò, zëri ñFV shtrim i sallës operative me PVC antibacterialò, Kapitulli ñj. Punime izolimi themele e tarraceò, etj, janë bërë pothuajse me analiza çmimesh, duke emërtuar zëra pune komplekse që nuk gjenden me emërtim të njëjtë në manualin e çmimeve dhe të ndryshme nga ato të paraqitura në specifikimet teknike. Vlera e zërave të mësipërm shkon rreth **149,418,232.0 lekë.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM Nr. 629, datë 15.7.2015, ñPër miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyreò dhe ngarkon me përgjegjësi hartuesit e projektpreventivit.

2.7 Nga auditimi i zërave dhe kapitujve të punimeve elektrike konstatohen **kode dhe seri e produkteve** të prodhuesit **"Schneider".** Produket e përcaktuara i përkatësisht kuadrot, automatet, instrumentat, panelet, siguresat, reletë, etj. Veprimi i përcaktimit të prodhuesit bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar ñPër prokurimin publikò neni 23 ñSpecifikimet teknikeò, pika 2, ku është shprehur se, ñ*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur*

në prokurimin publik. Pika 5. ñ*Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët ose "ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime*ò, si dhe nga përcaktimi i kodeve dhe seri i produkuteve të prodhuesit ñSchneiderò bën të mundur orientimin në drejtim të operatorëve ekonomikë .
Veprim që ngarkon me përgjegjësi Institutin e Ndërtimit, Ing. Elek. D. M.

2.8 Nga auditimi i Preventivit të hartuar nga Instituti i Ndërtimit, në Kapitullin e kuadrove elektrike (këtu futen 1.1 derinë 1.34) në lidhje me Zëri ñ*F.V Morseta, kanalina plastike, zbara bakri, kabllo dhe të gjithë aksesorët e nevojshme për montim, përfshi kolaudimin, testim dhe komisionim*ò, konstatohet se është zë pune i mbivendosur strukturës së preventivit të hartuar nga IN, në kundërshtim me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 ñ*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*ñ, pasi Zëri ñ*F.V Morseta, kanalina plastike, zbara bakri, kabllo dhe të gjithë aksesorët e nevojshme për montim, përfshi kolaudimin, testim dhe komisionim*ò është përshkruar në zërat e tjerë të veçuar sipas kapitujve të punimeve elektrike kuadri kryesor, janë zërat për F.V Furnizim vendosje për kapak, automat, siguresa, instrumenta etj.
Sa më sipër, për Kapitulli i kuadrove eletrikë (1.1-1.34)zëri ñ*F.V Morseta, kanalina plastike, zbara bakri, kabllo dhe të gjithë aksesorët e nevojshme për montim, përfshi kolaudimin, testim dhe komisionim*ò në **vlerën prej 1,176,000 lekë pa tvsh përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit, pasi është i mbivendosur në punimet elektrike për zërat përkatës, duke sjellë fryrje të zërave të punës dhe rritje fiktive e vlerës së kontratës, në përfitim të sipërmarrësit.
Gjithashtu,II.Kapitulli Punime elektrike /1.2 Kanalina Metalike dhe III.Kapitulli Punime Mekanike, u konstatuan 3 zëra pa vendosur sasinë, me vlerë prej **155,384.3 lekë pa tvsh përbën dëm ekonomik**ndaj buxhetit të shtetit, duke sjellë rritje fiktive e vlerës së kontratës, si vijon:

Nr	Nr.Manuali	Lloji i punimeve	Njësia	sasia	çmimi	Vlera/lekë
		1.2 Kanalina Metalike				
21	An E-1.2.21	F.V materiale të tjera plotësuese(profile, stafa,aksesor për këndet variabël, elementë tokëzues, kapak për aksesor	copë	0	1,820,070	91,004
		III.Punime Mekanike (H/Sanitare,HVAC, Linja e gazrave, MKZ, etj)				
2	4.3	F.V Konstruksione metalike të thjeshta	ton	0	136,050.0	20,407.6
3	4.34	F.V Tubo Ventilimi me kthim buzësh,kendëdrejtë,Ll.zinguar	ton	0	174,863.5	43,972.7
		Shuma				**155,384.3**

Veprim që ngarkon me përgjegjësi Institutin e Ndërtimit, Ing. Elek. D. M.
Në total **vlera prej 1,331,384.3 pa tvsh përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit, pasi janë të mbivendosur në punimet elektrike, mekanike për zërat përkatës, duke sjellë fryrje të zërave të punës dhe rritje fiktive e vlerës së kontratës, në përfitim të sipërmarrësit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka realizuar asnjë kontroll mbi procedurat ligjore të hartimit të projekteve teknike dhe për cmimet e hartuara, në preventivin përkatës.

2.9Procedura e realizuar nga MSHMS procedurë e hapur me objekt ñRikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranëò me fond limit në vlerën prej

668,493,718.32 lekë pa tvsh, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, është fituar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ñA.. K..ò shpk & ñB..-I..òshpk, me vlerë ofertë fituese prej 466,395,123.98 lekë pa tvsh, **28 % më e ulët se fondi limit (Ofertë anomalisht e ulët), tregon për fryrje fiktive të përllogaritjes së fondit limit, dmth të preventivave të hartuara nga IN.**
gjatë shqyrtimit të ofertave nga KVO nga SEP me REF -67482-07-31-2020, BOE ñA..K..òsh.p.k dhe B..-I... shpk ka paraqitur ofertë anomalisht të ulur me vlerë prej 446,395,123.98 lekë pa tvsh.
KVO në kërkesën drejtuar BOE ñA... K...òsh.p.k dhe B...-I... shpk me nr.3581/30 prot datë 28.09.2020 të MSHMS, si dhe paraqitur në formë eletronike ne SEP të app.gov.al, duke kërkuar në zbatim të nenit 56 të LPP, sqarime lidhur me justifikimin e çmimit të ofertës paraqitur nga OE për këtë procedurë prokurimi për arsye se rezulton anomalisht e ulët si dhe informacionin e kërkuar duhet të dorëzohet me shkrim nëpërmjet mesazhit në sistemin elektronik të prokurimit brenda datës 30.09.2020 ora 16:30.
Kështu në përgjigje , BOE ñA... K....òsh.p.k dhe B...-I... shpk, me shkresë nr.1741prot datë 30.09.2020, ka paraqitur argumentimin mbi ofertën ekonomike anomalisht të ulët/objekti ñRikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldinë dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranëò duke paraqitur arsyetimin në përmbushje të katër kushteve kumulative të kërkuar nga ligj LPP, në drejtim të argumentimit të ofertës ekonomike, si më poshtë vijon:
Në lidhje me parashikimet e nenit 56 pika ñaò në drejtimin të argumentimit
1-Eksperiencën e shoqërive, duke siguruar që, kostoja mesatare e prodhimit të produkteve dhe shërbimeve të ulët.
2-Realizimi i këtyre volumeve të punimeve kërkon gjithashtu blerjen e volumeve shumë të mëdha të produkteve e shërbimeve në treg.
3-Uljen e shpenzimeve plotësuese në max 3-4%, një nga zërat e rëndësishëm të kostos i cili në kompanitë e ndërtimit në përgjithësi, llogaritet në 6-8% të shpenzimeve kryesore.
4-A.. K... disponon shumë mjete dhe makineri për punime të ndryshme.
5-A.. K... ka në përbërje të saj edhe shumë reparte Prodhimi
6-Kompania ka kapacitete financiare likuide të konsiderueshme për të lidhur kontrata të favorshme, gjithashtu, për të përftuar çmimet më të ulta në treg shpesh bën dhe parapagime.
Në lidhje me parashikimet e nenit 56 pika ñbò në drejtimin të argumentimit Zgjidhjet teknike të Ofruara dhe /ose ndonjë Kusht Favorizues të Jashtëzakonshëm
-BOE ka zbërthyer me kujdes të gjitha kërkesat e projektit, për të gjitha fazat.
-BOE ka kapacitete që të realizojë prodhimin me qark të mbyllur brenda kompanisë.
-Posedimi i kapaciteteve teknike, makinerive dhe pajisjeve bashkëkohore është një kusht i shtuar për realizimin me sukses maksimal të këtij objekti.
Në lidhje me parashikimet e nenit 56 pika ñcò Origjinalitetin e Punëve, Mallrave apo të Shërbimeve, të propozuara :
-BOE jep garancinë max në përdorimin e materialeve dhe të pajisjeve origjinale, të markave të njohura ndërkombtarisht , si dhe janë distributor zyrtarë të KNAUF, duke marrë përsipër përdorimin e materialeve e pajisjeve origjinale në përputhje me specifikimet teknike.
-Origjinaliteti i punimeve vërtetohet me CVe kompanisë si dhe të kompanive që bashkëpunojnë.
Në lidhje me parashikemet e nenit 56 pika ñçò në drejtim të argumentimit zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi,
-hartimi i Planit Operativ të Sigurisë (POS), bëhet Vlerësimi i rrezikut dhe Plani për menaxhimin e mergjencave dhe të evakuimit të punonjësve.
Një tjetër element argumentues është se, ka të provuar eksperiencën e tij të ngjajshme.

Pra sa më sipër, në bazë të argumentimeve të dhëna nga BOE ñA... K...òsh.p.k dhe B..-I.. shpk, është në përmbushje të katër kushteve kumulative të kërkuar nga ligj LPP në drejtim të argumentimit të ofertës ekonomike, për rrjedhoje është konsideruar e qartë nga KVO, për

vazhdimin e procedurës tenderuese, duke e shpallur fitues BOE ñA.. K...òsh.p.k dhe B...-I... shpk

***Sa më sipër, u konstatua se*:**
i) Nga SUOGJ ñMbetëresha Geraldinaò e cila pavarësisht se është institucion varësie i MSHMS është njësi shpenzuese e veçantë dhe si Autoritet Kontraktor, është vetë autoriteti përgjegjës për administrimin e fondeve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit të nevojave të tyre, duhej të realizonte procedurën ñShërbim konsulenteò për përcaktimin e studios së Projektimit për objektin *"Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë* nëpërmjet një gare transparentë, nxitëse për pjesëmarrje të operatorëve ekonomik që kanë object fushën e hartimit të projektimit, nxitëse për konkurencë profesionale, në mënyrë të tillë që të sigurohet mirëpërdorimi i fondeve publike.
ii) Instituti i Ndërtimit ka realizuar hartimin e Projektit Teknik, në kundërshtim me ligjin nr.9643 datë 21.11.206 ñPër prokurimin publikò të ndryshuar, neni 1, neni 2 pika b ,neni 34/1 ñShërbim konsulencëò të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publicò të ndryshuar, neni 37, me ligjin nr.7582 datë 13.07.1992 ñPër ndërmarrjet shtetëroreò i ndryshuar, neni 5.
iii) Nga Instituti i Ndërtimit është realizuar Oponenca teknike për objektin *"Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë",* me kërkesë të SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò të ndryshuar, neni 37 (Shërbimi i konsulencës) pika 3 /b, me ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar.
iv) Nga Instituti i Ndërtimit është realizuar Aktekspertiza i datës 30.11.2019 mbi verifikimin në terren të subjekteve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe Aktekspertiza e thelluar datës 19.02.2020, duke mos reflektuar vlerën financiare për këto ndërhyrje mbas termetit, kjo në kundërshtim me Aktin Normatin nr.9 datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore neni 34 paragrafi 2 dhe në kundërshtim VKM nr.26 datë 15.01.2020 ñpër kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara.ò

Shënim: *Deri në momentin e hartimit të Aktkonstatimit, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni/informacioni i kërkuar pranë njësisë së varësisë të MSHMSH, SUOGJ "Mbretëresha Geraldina", duke u bërë pengesë për realizimin e Programit të Auditimit nr. 121/1 prot, datë 22.01.2021.*
Kërkesat janë është bërë në këto forma komunikimi:
- në mënyrë verbale Drejtorisë së Prokurimeve dhe Koncesioneve,
- në mënyrë eletronike nga Drejtori i Përgjithshëm J. D, si person kontakti mbi ecurinë e auditimit që po realizon grupi i audituesve të KLSH;
- me anë të shkresës me nr.415/5 prot datë 13.04.2021 (protokolluar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nga grupi i auditimit).
- Aktkonstatimi nr.1 datë 15.04.2021, (protokolluar në MSHMS me nr.415/6 datë 15.04.2021).

Në vijim, kanë ardhur observacione nga SUOGJ, mbi aktin e konstatimit, ku ndër të tjera citohet se akti i konsttaimit nr. 1 datë 15.04.2021, (protokolluar në MSHMS me nr.415/6 datë 15.04.2021) nuk I është vënë në dispozicion në kohë subjektit
Dokumentacioni i sipër kërkuar , iu vu në dispozicion grupit të auditimit ,nga SUOGJ-MG me shkresë nr.379/1 prot datë 04.05.2021, duke konstatuar se :
1.Shkresa nr.304 prot datë 09.04.2021 e SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò drejtuar Institutit të Ndërtimit (IN) ku shprehen se ñInstituti i Ndërtimit ka kryer projektin për objektin ñRikonstruksioni i godinave të Maternitetit ñMbretëresha Geraldina dhe ndërtimi i Ri 3 katò.Nga

ky fakt ju ka lindur detyrimi për të bërë aplikimin për procedurat e lejeve në Agjencinë e Zhvillimit të Territorit AZHT.
Me anë të shkresës me nr.2831/2 në datë 30.12.2020 ne jemi njohur nga AZHT për vendimin nr.11 datë 03.12.2020 për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin ñRikonstruksioni i godinave të Maternitetit ñMbretëresha Geraldina dhe ndërtimi i Ri 3 katò.
Ndërkohë nuk jemi njohur me pajisjen apo jo të Lejes së Zhvillimi. Për sa më sipër, jeni të lutur të na jepni një shpjegim juridik mbi pajisjen apo aplikimin nga ana juaj për leje zhvillimi mbi këtë objekt.ò
2.Shkresa nr.685/1 prot datë 16.04.2021 nga IN, sqaron se , në bazë të VKM nr.408 datë 13.05.2015 ñPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò neni 9 pika 5 si dhe neni 11 pika b,c dhe ç, në rastin e Rikonstruksionit të godinave të Maternitetit ñMbretëresha Geraldina dhe ndërtimi i Ri 3 katò, nuk është e nevojshme leja e zhvillimit për pajisjen me leje ndërtimore. (Grupi i auditimit e merr në konsideratë, këtë shpjegim juridik).
3.Shkresa nr.477 prot datë 25.04.2019 (pra disa muaj përpara tërmetit të nëntorit 2019) nga SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò i është drejtuar IN si dhe është venë në dijeni Ministri i MSHMS, me objekt ñ*Kërkesë për konsulencë teknike ligjore në fushën e ndërtimit"* duke përshkruar me një informacion të përgjithshëm që, ñ*Institucioni SUOGJ "Mbretëresha Geraldina" shtrihet në një sipërfaqe totale prej 7195.4 m^2 dhe përbëhet nga 10 godina me sipërfaqe totale nën objekt prej 2735.9 m^2, me sipërfaqe totale ndërtimore prej 7483 m^2...*
Më datë 24.04.2019, ora 23.20 në katin e parë të godinës4 –Obstetrika, dhoma nr.07 pati një shëmbje te suvatimit të tavanit së bashku me faqen e fundit të tullës CAP të ndërkatit, në një sipërfaqe rreth 8.0m^2.
*Kjo godinëështë ndërtuar në vitet 1936-1938 dhe deri tani nuk i është nënshtruar asnjë Rikonstruksioni konstruktiv. Kërkojmë nga ana juaj ekspertizën tekniko-ligjore për vlerësimin konstruktiv të godinës, për marrjen e garancive teknike për vazhdimin apo jo të shfrytëzimit të godinës. Realizimi i kërkesës së mësipërme kërkohet që të kryhet sa më urgjent, sepse nga vrojtimi i hollësishëm vizual të ambjenteve të godinës vërehen hubje nivelimi në dysheme si dhe plasaritje në tavan*e.ò
4.Nga pjesë të shkëputura nga ñRaport mbi inspektimin në terren të objekteve spitalore, në SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò nga IN, i cili nuk ka datë shprehen se:
ñ**Konkluzionet** *Grupi i punës të Institutit të Ndërtimit shpreh mendimet teknike të mëposhtme në lidhje me vlerësimin e kërkuar;*
1.Objekti paraqet Rrezikshmëri të lartë për Shfrytëzim normal të aktivitetit për të cilin ai është ndërtuar.
2.Nuk mund të sigurohet apo të garantohet, mospërsëritja e rastit të datës 4 Prill (lëkundje sizmike) ose të tjera ngjarje madhore.

Rekomandimet
1.Të merren masa të menjëhershme për evadimin dhe lehtësimin e peshave në strukturë.
2.Pas daljes së provave të bëhet analiza pushover e objektit në qëndrueshmëri.
3.Të hartohet Ekspertiza përfundimtare e cila do të evidentojë gjithë problematikën e ndodhur në objekt, si dhe do të përcaktojë shkallën e Amortizimit, Vlerësimin teknik konstruktiv të objekteve spitalore, si dhe dhënien e Garancive teknike adekuate, për vazhdimin ose jo të shfrytëzimit të Objekteve.
4.Të shikohet mundësia e Evadimit të personelit &kryerjes së aktivitetit në këto ambiente deri në daljen e Rezultateve tëEkspertizës përfundimtare.
*5.**Pas përfundimit të Ekspertizës të kryhet Projekti &Preventivat për rehabilitimin e tij.**"*
Grupi i punës me përbërje (Ing.A. Ç, Ing.I.Sh dhe Ark.J. K) miratuar nga Dr. Përgjithshëm in. A.H.

5.Nga ñA... & G.. 2..ò është paraqitur ñRaport shërbim, realizim i analizave laboratorike të soletave të ndërkatit dhe të tarracës, Godina Obstetrikeò në Maj 2019, duke paraqitur **"Konkluzione –Rekomandime**
a)Nga investigimi vizual i objektit rezulton që Objektiështë ndërtim i vjetër i cili mendohet te jëtë realizuar gjatë viteve '30-40 pa ndërhyrje të konsiderueshme në pjesët t e strukturës (janë shtuar ashensorët).
b)Objekti është realizuar me mure mbajtëse.
c)Soletat janë realizuar me traveta. Këto të fundit janë të vendosura në hapësirën midis tullave të letesuara të soletave.
d)tullat paraqiten në përmasa 30 cm në gjërësi dhe 15 cm në lartësi, me 3 bira dhe gjysmëkanale cilindrike anësore ku janë shtrirë shufrat e hekurit të soletës duke krijuar në këtë mënyrë travetat b/a.
e)Vihen re plasaritje e lehtë e suvasë së tavanit në disa dhoma. Nga vrojtimet vizuale nuk mund të përcaktohet nëse plasaritja ka ndodhur vetëm në suva apo edhe në pjesën përbërëse të soletës.
f)Rezistenca në shtypje mesatare e betonit të soletave e përcaktuar me metodën pa shkatërrim me Sklerometër në testet e kryera rezulton afërsisht 20.6N/mm2.
g)Armatura e hekurit, sidomos në pjesët e ekspozuara ku ka ndodhur shëmbja shtesa mbrojtëse e betonit nuk është realizuar në mënyrë korrekte, ka pësuar dëmtime serioze nga korrodimi."

6.Shkresa nr.480 prot datë 26.04.2019 nga SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Emergjencave Civile, ku shprehen se ñ.. *Në SUOGJ "Mbretëresha Geraldina" në datë 24.04.2019 rreth orës 23:00, në një ambjentet e ndërtesës Godina Obstetrike, ka patur renie suvaje, tavani si pasojë e dy termeteve të rena brenda 24 orëve të fundit para se të ndodhte ngjarja. Ju bëjmë me dije se kjo ngjarje nuk ka patur pasoja të dëmtimit të jetës së njëriut, por vetëm dëme materiale. Për sa më sipër, kërkojmë të na asistoni me ekspertizë teknike- juridike.*ò (Nga dokumentacioni vënë në dispozicion nga SUOGJ, Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile nuk ka paraqitur asnjëshkresë kthim përgjigjie).

7.Shkresa nr.160/5 prot datë 28.06.2019 nga Instituti i Ndërtimit (Drejtori i Përgjithshëm A.H) drejtuar Drejtorit të SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò me lëndë ñHartim Kontrateò shprehet se ñ*Referuar korrespondencës midis dy Institucioneve tona, duke filluar me tuajën me nr.477 prot datë 25.04.2019 "Kërkesë për konsulencë tekniko-ligjore në fushën e ndërtimit" në kushtet e emergjencës, po ju dërgojmë bashkëngjitur kësaj shkrese përcjellëse: Kontratën midis dy institucioneve tona me objekt "Hartimin e projekt preventivit të zbatimit të objektit "Rikonstruksion i pjesshëm i spitalit Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldina" si dhe ndërtimi i dy godinave të reja" në katër kopje. Në momentin e firmosjes nga ana juaj tre kopje të kontratës të dërgohen pranë IN.*
Ndërkohë që likujdimi i vlerës së kontratës do të bëhët nga ana juaj, *për Institutin e Ndërtimit, në momentin e alokimit të fondeve përkatësë nga buxhetit i Shtetit*ò.

8.Kontrata nr.477/10 prot datë 28.06.2019 e lidhur midis SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò dhe ñInstituti i Ndërtimitò mbi ñ*Hartimin e projekt preventiv i zbatimit të objektit "Rikonstruksion i pjesshëm e spitalit Obstetrik Gjinelogjik "Mbretëresha Geraldina" si dhe ndërtimi i dy godinave të reja",* me vlerë të kontratës sipas neni 2 (Çmimi i kontratës) prej ***5,487,357 lekë me tvsh*** si dhe sipas neni 5 pika 6 shprehet se ñI porosituri Instituti i Ndërtimit duhet të paraqesë tek porositësi sipas detyrës së projektimit këto dokumenta :
-Projekti Konstruktiv
-Projekti arkitektonik
-projekti eletrik
-Projekti hidro-sanitar

-Projekti i mbrojtjes nga zjarri
-Projekti HVAC
Kjo kontratë është firmosur nga titullarët e dy institucioneve E.D dhe A.H, ku në neni 9 (legjislacioni bazë) ñ*Ligji i aplikueshëm do të jetë Legjislacioni Shqiptar",* gjithashtu në pjesën hyrëse tëKontratës nr.477/10 prot datë 28.06.2019 shprehet se *"Në mbështetje të Kreut VII, nenit 850 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Urdhërit nr.225 datë 29.06.2004 "Për krijimin e IN" pika 2, VKM nr.354 datë 11.05.2006 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikqyerje dhe kolaudim" shkresës me nr.477 prot datë 25.04.2019 të SUOGJ "Mretëresha Geraldina" lidhet kjo kontratë sot më datë 28.06.2019 për hartimin e preventivit, projekt zbatimi të objektit "Rikonstruksion i pjesshëm i spitalit Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldina" si dhe ndërtimi i dy godinave të reja."*
Nga auditimi u konstatua se deri në dorëzimin e këtij raport përfundimtari, nga SUOGJ-MG nuk është paraqitur Urdhër-shpenzimi në lidhje me vlerën e kontratës prej 5,487,357 lekë me tvsh.

10. Shkresa nr.1066 prot datë 19.11.2019 nga SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò drejtuar IN me objekt ñKërkesë për bashkëpunimò duke u shprehur se: ñ*Referuar, Projektit të kryer nga ana juaj për "Rikonstruksion i godinës së vjetër të Neonatologjisë dhe obstetrikës dhe ndërtim godinës së re në SUOGJ "Mbretëresha Geraldina", ligjërisht para procedurës së prokurimit duhet bërë oponenca teknike e project-preventivit.*
Në vijim të email-it të dërguar nga MSHMS, mëqënëse projekti është bërë nga ana juaj, oponenca lidhur me projektin nuk mund të bëhët po nga ju, pasi përbën konflik interesi. Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj se si duhet të procedojmë për hapat e mëtejshëm."

11. Shkresa nr.560/1prot datë 19.11.2019 nga Instituti i Ndërtimit (Drejtori i Përgjithshëm i IN) drejtuar SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò shprehen se *"...IN është institucion publik në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ka si objekt të punës së saj, referuar Urdhërit të Ministrit nr.225/2004 "Për krijimin e Institutit të ndërtimit" kryerjen e veprimtarisë kërkimore shkencore,aplikative zhvillimore studimore dhe projektuese në fushën e ndërtimit si dhe kryerje e veprimtarisë shkencore e teknologjisë për të tretë të tilla si oponenca, ekspertiza, kurse kualifikimi, vlerësime konformiteti dhe kontrolle për produktet e ndërtimit që lidhen me sigurinë e jetës.*
Referuar strukturës së IN-së, specialistët teknik të IN që merren me hartimin e projekteve ndërtimore janë pjesë e Drejtorisë së Konformitetit akt akt ekspertiza dhe projekteve. Ndërkohë që specialistët që hartojnë oponenca teknike të projekteve ndërtimore janë pjesë përbërëse të Drejtorisë së rregullave teknike dhe oponencave. Pra specialistët teknik që merren me hartimin e projekteve ndërtimore, nuk marrin pjesë në hartimin e oponencave teknike.
Nga IN janë kryer si projekte dhe oponenca teknike për të njëjtin objekt të kërkuara nga institucione të tjera shtetërore.
*Pra referuar dhe bazës ligjore në fuqi, ju duhet të paraqiteni pranë Institutit të Ndërtimit për kryerjen e oponencës teknike për projektin "Rikonstruksion i godinësë së vjetër të Neonatoligjisë dhe Obstetrikës dhe ndërtimin e godinës së SUOGJ.*ò

12. Shkresa Akt Konstatimi datë 30.11.2019 realizuar nga IN për SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò.

13. Shkresa nr.2563 prot. datë 05.12.2019 nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) drejtuar SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò, ku thuhet se ñ*Në kuadër të gjëndjes së jashtëzakonshme, për shkak të fatkeqësisë natyrore si termeti i datës 26.11.2019 dhe përgjegjësisë sonë institucionale ndaj objekteve me status Monument Kulture, bashkëngjitur po ju vënë në dispozicion inspektimin e hartuar nga specialistët e IKTK më datë 03.12.2019, mbi dëmët e*

shkaktuara prej tij, duke konluduar si vijon:
-Sallat e shërbimit të vizitave dhe të lindjes në katin e dytë teknik, (kati i tretë nga kuota 0.00) ka problematika me elementët strukturorë të soletave. Soletat e këtyre ambjenteve të cilat janë të ndërtuara me travetë me tulla sap, si rezultat i amortizimit të tullave sapështë shkëputiur pjesa e poshtme e travetit me tulla sap, së bashku me suvatimin qëështë në një trashësi të konsiderueshme dhe përbën rrezik për pacientët dhe personelin e shërbimit. Njëkohësisht kanë dalë në dukje pozicioni i hekurit, i cili qëndron si rezultat lidhjes së tij me brezin anësor të mureve.
-Problematika u vërejtën edhe në elementët shtesë të objektit, mosrespektimi i fugave, mbushja e tyre me matriate jo të rregullta, elastika që të krijojnë një amortizim në momentet e lëvizjeve sismike.
-Problematika u vërejt në ndërhyrjet e pakontrolluara, adaptimet e bëra në muret mbajtuese, hapjet e dyerve në vende të papërshtatshme, sigurimi i hapësirave me arkitra të projektuar sipas KTZ, e të tjera problematika të cilat kërkojnë një inspektim më të hollësishëm të të gjitha elementeve strukturorë të objekt.

14. Shkresa nr.597/1 prot datë 17.12.2019 nga IN, ku janë përcjellë tre kopjet të akt marrëveshjes ñ*Për kryerjen e Oponencës Teknike* të objektit ñRikonstruksion i godinës së vjetër të Neonatologjisë obstretrikës dhe ndërtim të SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò, me nr 1066/4 datë 17.12.2019 në cilësinë e porositësit, me vlerë realizimi të objektit të marrëveshjes **prej 325,750 lekë** me tvsh. Bashkëngjitur Urdhër-Shpenzimi nr.788 datë 31.12.2019.

15. Shkresa nn.597/3 prot datë 10.01.2020 nga IN me objekt ñDërgim Oponence Teknikeò e shoqëruara me materialin përkatës.

16. Akt Ekspertizë ñMbi Inspektimin në terren objekt ndërtimò nga IN me datë inspektimi 19.02.2021, duke cilësuar në konstatimet gjatë inspektimit , ndër të tjeraelementët si vijon:
-Ndryshime të destinacionit të objektit (ndryshimi i kushteve të përdorimit), të cilat mund të kenë çuar në dëmtime të mundshme të elementëve strukturorë ose jo-strukturorë.
-Dëmtimi i objektit nga tërmentet. (Dëmtim i elementëve strukturorë ose jo-strukturorë).

17. Shtesë Kontrate midis dy titullarëve të SUOGJô ñMbretëresha Geraldinaò dhe Instituti i Ndërtimit nr.477/14 prot datë 26.02.2020 me objekt ñ*Mbi hartimin e projekt preventivit të zbatimit të objektit Rikonstruksioni i godinave të Maternitetit "Mbretëresha geraldina" dhe* ***ndërtim i ri 3 kat."***
Nga auditimi u konstatua, se të gjitha shkresat e mëparshme dhe Kontrata nr.477/10 prot datë 28.06.2019, shprehen për dy ndërtime godina të reja, ndërsa shtesa cileson ndërtim i ri, duke mos dhënë arsyet e ndryshimit .Vlera e **shtesës është prej 7,712,994 lekë** me tvsh, pra gjithsej çmimi total për projektin ñ*Mbi hartimin e projekt preventivit të zbatimit të objektit Rikonstruksioni i godinave të Maternitetit "Mbretëresha Geraldina" dhe* ***ndërtim i ri 3 kat, bëhet 11,000,292 pa tvsh ose 13,200,351)lekë me tvsh,*** nga 5,487,347 leke me tvsh që ishte parashikuar në kontratën e mëparshme, duke u shtuar me rreth 60% më shumë. Si kontrata bazë, ashtu edhe shtesa, duhet të ishin produkt i procedurës së prokurimit publik, dhe për analogji sipas nenit 36, pika (e) paragrafi i fundit të LPP ñ*Në çdo rast, vlera e shtesave të kontratave nuk duhet të kalojë 20% të vlerës së përgjithshme të kontratës*.ò ï qënë këtë rast kjo vlerëështë tejkaluar.
Deri në momentin e hartimit të këtij raport përfundimtari nga SUOGJ-MG, nuk është paraqitur Urdhër-shpenzimi në lidhje me likuidimin e vlerës për shtesënekontratës prej 7,712,994 lekë me tvsh.

18. Shkresa nr.2831/2 prot datë 30.12.2020 nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit drejtuar SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò me objekt ñDërgimi i Vendimit nr.11 datë 03.12.2020 ñPër miratimin e

Lejes së ndërtimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit, për objektin ñRikonstruksioni i godinave të maternitetit ñMbretëresha Geraldinëò dhe ndërtim i ri 3 kat, me vendndodhje në Bashkinë Titanë, me zhvillues ñSpitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik ñMbretëresha Geraldinëò.

Në lidhje mbi problematikat e konstatuara, nga grupi i audituesve u mbajt Aktkonstatimi nr.8 datë 30.04.2021 me nr.415/14 prot të MSHMS, të cilët kanë observuar me shkresa nr.415/29 prot, datë 07.05.2021 të MSHMS dhe nga SUOGJ ñMretëresha Geraldinaò me shkresa nr.379/1 datë 04.05.2021 dhe nr.379/2 prot datë 17.05.2021 me nr.121/6 prot të KLSH datë 19.05.2021 si dhe observimet nga Instituti i Ndërtimit ka observuar me shkresë nr.756/2 prot datë 25.05.2021 derguar SUOGJ-MG, me nr.378/2 datë 28.05.2021, e cila ja ka përcjellë KLSH me nr.121/7 datë 31.05.2021, në lidhje me diferencën e çmimit të evidentuar në Aktkonstatimin nr. 8 datë 30.04.2021 si dhe observimet dërguar nga MSHMS në lidhje mbi Projekt raportin e përcjellë nga KLSH me shkresë nr.121/10 prot datë 03.09.2021, të cilat kanë ardhur më datë 14.10.2021 jashtë afatit kohor të parashikuar në ligjin 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit neni 26 dhe 29ô me shkresë nr.415/47 prot të MSHMS dhe me nr.121/11 prot datë 14.10.2021 të KLSH.
Sa më sipër, audituesit e KLSH , i ri vlerësuan dhe observimet e dyta, të cilat nuk kanë paraqitur dokumentacion shtesë apo argumentim ligjor shtesë në lidhje mbi problematikën e konstatuar, për këtë qëllim, audituesit shprehen me të njëjtin qëndrim, si vijon:

Pretendimi i subjektit:
1.Në fq 1, paragrafi 3 thuhet ñ...*sqarojmë që çdo vonesë në përcjelljen nga ana jonë të dokumentacionit/informacionit që disponojmë ka ndodhur thjesht si pasojë e faktit që SUOGJ-MG nuk ka patur paraprakisht dijeni për ekzistencën e ndonjë kërkese verbale apo shkresore të grupit të auditimit të KLSH.*
2.Në fq 2, paragrafi 2 thuhet se ñ..referuar përmbajtjes së akt-konstatimit nr.8, e vetmja çështje që lidhet me SUOGJ-MG është ajo e kontraktimit nga SUOGJ-MG të Institutit të Ndërtimit, ndërkohë sipas audituesve të KLSH-së, SUOGJ-MG duhej të zhvillonte një procedurë të hapur prokurimi për realizimin e projektit të rikonstruksionit të godinave të maternitetit ñMbretëresha Geraldinaò dhe kryerjen e e një ndërtimin e ri 3 katësh.
3.Në fq 2 dhe3 paragrafi i fundit dhe i parë thuhet se ñ..*edhe grupi i auditimit të KLSH-së ka konstatuar se, SUOGJ-MG nuk disponon kapacitetet e duhura për të kryer zhvillimin e procedurës së prokurimit publik. Pra ideja, konkluzioni apo rekomandimi i grupit të auditimit të KLSH që SUOGJ-MG duhej të zhvillonte një procedurë prokurimi, nuk përputhet me realitetin që vetë grupi i auditimit të KLSH-së konstaton në lidhje me kapacitetet e SUOGJ-MG të cilat në çdo variant i pamundëson këtij institucioni zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe për rrjedhojë edhe zbatimin e referencave përkatëse ligjore e nënligjore në fushën e prokurimit dhe për rrjedhojë edhe zbatimin e referencave përkatëse ligjore e nënligjore në fushën e prokurimit publik. Ndërkohë, në nënshkrimin e një kontrate standarte më Institutin e Ndërtimit për bërjen e projektit të rikonstruksionit të godinave të maternitetit "Mbreteresha Geraldina", nuk ka patur nevojë që të disponojë ndonjë kapacitet administrativ, pasi kontrata e nënshkruar është e standartizuar (tip) dhe marrëdhënia ndërinstitucionale është ndërmjet dy organeve shtetërore, njëri në varësi të MSHMS dhe tjetri në varësi të MIE, bashkëpunim ky në kuadrin e ndihmës administrative të sanksionuar në nenit 71 dhe 73 të Kodit të Procedurës Administrative.*ò
4.Në fq 3 paragrafi 2,3 dhe 4 thuhet se ñ..*Fakti është që shumë institucioneshtetërore kanë hyrë dhe vazhdojnë tëhyjnë në marrëdhënie kontraktore me IN për kryerjen nga ana e këtij institucioni të projekteve të ndryshme të rikonstruksionit apo ndërtimit si dhe kryerjen e oponencave teknike.Nëse grupi i auditimit e konsideron kontratën që SUOGJ-MG ka nënshkruar me IN si një kontratë që ka penguar konkurrencën në treg, ateherë i njëjti konkuzion duhet të jepet edhe projektit që IN ka bërë për vetë godinën ku ndodhet KLSH, apo dhe projektet e tjera që IN ka bërë me për institucione si Kuvendi i Shqipërisë, Byronë Kombëtare të hetimit, etj..*
*Edhe në auditimin më të fundit të përformacës me temë "Sigurimi i cilësisë së veprave ndërtimore" që KLSH ka bërë në zbatim të Programit të auditimit nr.1006/1 datë 31.12.2018 i ndryshuar (ku përgjegjës i grupit të auditimit ka qënë vetë z.A.Z.) KLSH konstaton fakti që IN ka projektuar për nevoja të institucioneve të tjera shtetërore por në lidhje me këtë fakt KLSH nuk ka ngritur asnjë pretendim për detyrimin që institucionet kanë patur në shmangien e marrëdhenies kontraktore me IN dhe zhvillimin me domosdoshmëri të procedurës së procedurës së prokurimit në mbrojtje të konkurrëncës në treg.*ò
5.Për sa sipër, nga Instituti i Ndërtimit ka observuar me shkresë nr.756/2 prot datë 25.05.2021 dërguar SUOGJ-MG, me nr.378/2 datë 28.05.2021 e cila ja ka përcjellë KLSH me nr.121/7 datë 31.05.2021, në lidhje me diferencën e çmimit të evidentuar në Aktkonstatimin nr. 8 datë 30.04.2021, ku shprehen se:

1-Ju bëjmë me dije se në analizën tuaj nuk përfshihen materialet që ne kemi patur parasysh në preventiv. Nga hulumtimi i tregut dhe nga ofertat e marra nga kompani që merren me të tilla procese pune, kemi konkluduar në çmimin njësi 30,000 lekë/m^2. Këtu është patur parasysh që materialet të jenë të cilësisë së lartë, pasi kati nëntokë do të përdoret si laborator dhe kërkon kushte optimale të hidroizolimit dhe termoizolimit të ambienteve të tij.
2- Ju bëjmë me dije se në analizën tuaj nuk përfshihen materialet që ne kemi patur parasysh në preventiv. Nga hulumtimi i tregut dhe nga ofertat e marra nga kompani që merren me të tilla procese pune, kemi konkluduar në çmimin njësi 5000-5500 lekë/m^2. Këtu është patur parasysh që materialet të jenë të cilësisë së lartë, pasi ndërtesa do të shërbejë si spital dhe kërkon kushte optimale pastërtie. Në këtë rast, mendojmë se ofertimi nga interneti i materialeve kineze, nuk është serioz dhe është tendencioz. Nuk mendojmë se materialet duhet të ofertohen pa certifikata cilësie, që për spitalet është shumë e domosdoshme.
Ju bëjmë me dije se për zërat e mësipërm, mund tju vemë në dispozicion ofertat e marra nga kompani të specializuara në procese të tilla pune.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

1.Nga auditimi u konstatua se, (MSHMS) ka realizuar procedurën e hapur me objekt ñ*Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë*ò ,në cilësinë e AK të cilit i është deleguar procedura e prokurimit, nga autoritetit kontraktor Spitali Universitar Obsetrik-Gjinekologjik (SUOGJ)ñMbretëresha Geraldinaò, si institucion i varësisë i MSHMS, në bazë të VKM nr.325 datë 23.06.2000, për rrjedhojë nga audituesit e KLSH, me personat e kontaktit janë bërë njoftimi si dhe me pas nëpërmjet zyrës së protokollit të MSHMS, duke lënë shkresën me nr.415/5 prot datë 13.04.2021 dhe Akt konstatimi nr.1 datë 15.04.2021 me nr.415/6 prot. Pavarësisht kësaj, konstatojmë, pas obseravcioneve te ardhura nga SUGJ, se kjo e fundit nuk eshte njoftuar në kohë nga MSHMS. Për sa më sipër, moskthimin e përgjigjes në kohë nga ana e SUGj e marrim në konsideratë, dhe përgjegjësi për sa më sipër mban é é é é é é é é

2.Grupi i auditimit konstatoi se, nga mosrealizimi nga SUOGJ-MG,i procedurës ñShërbim konsulenteò për përcaktimin e studios së Projektimit për objektin *"Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë* nëpërmjet një gare transparentë, është manaxhuar fillimisht ñProjekti Rikonstruksioni i godinave të maternitetit ñMbretëresha Geraldinëò dhe ndërtim i 2 godinave të rejaò dhe më pas ñProjekti Rikonstruksioni i godinave të maternitetit ñMbretëresha Geraldinëò dhe ndërtim i ri 3 katò, kundrejt vlerës për projektin projektimi në total prej 13,200,351.0 lekë me tvsh. Konstatojme se, Instituti i Ndërtimitka hartuar Projektin Teknik në kundërshtim me ligjin nr.9643 datë 21.11.206 ñPër prokurimin publicòtë ndryshuar, neni 1, neni 2 pika b ,neni 34/1 ñShërbim konsulencëò të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publicò të ndryshuar, neni 37, me ligjin nr.7582 datë 13.07.1992 ñPër ndërmarrjet shtetëroreò i ndryshuar neni 5 ñ*Ndërmarrjet shtetërore, perveç rasteve kur me dispozita të veçanta parashikohet ndryshe, e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të njëjta kushte si dhe ndërmarrjet e tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe dispozitat e këtij ligji. Ato veprojnë në kushtet e konkurrencës së lirë e të ligjshme dhe nuk gëzojnë asnjë privilegj ose të drejtë që prish kushtet e kësaj konkurrence*ò si dhe me ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitòi ndryshuar, neni 5 Kreu III (përcaktimi, mbikqyerja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit) i cili shprehet se ñ*Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit, të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose persona fizike e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me liçensën përkatëse. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në Kreun II të këtij ligji kanë përgjegjësi për projektimin e objektit.*ò. Gjithashtu në dokumentacionin e paraqitur nga SUOGJ-MG, nuk rezultoi /nuk është paraqitur Licenca profesionale për Projektim nga Instituti i Ndërtimit lëshuar nga Ministria e Infrastruktuës dhe Energjisë, pasi vlen të theksohet se insticioni i IN ***nuk merr financim nga Buxheti i shtetit, por është me vetëfinancim*** .

3.Meqënëse SUOGJ-MG, është me mungesë kapacitete me burime njërëzore, duhej të ishte drejtuar MSHMS ashtu siç ka vepruar me shkresën nr.243 prot datë 05.03.2020, në mbështetje të LPP dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar neni 2 pika 2.1, ku citohet se ñ*2.1Nëse një ose disa autoritete kontraktore kanë nevojë të prokurojnë mall/punë ose shërbim, ata mund të bien dakort të delegojnë të drejtën e kryerjes së procedurës së prokurimit një autoriteti tjetër kontraktor për shkak të kapaciteteve që ky i fundit ka në fushën e objektit të prokurimit. ....."*
-Në bazë të observimeve të bëra nga MSHMS në lidhje mbi AktKonstatimin nr.8, me shkresë nr.415/29 prot datë 07.05.2021, shprehet se ñé *SUOGJ-MG është institucion varësie i MSHMS, është njësi shpenzuese e veçantë dhe si AK është autoriteti përgjegjës për administrimin e fondeve dhe kryerjen e proceduarve të prokurimit të nevojave të tyre.....Nisur nga fakti që project-preventivit i zbatimit është realizuar nga IN dhe marrë në dorëzim nga SOUGJ-MG, qëështë autoritet I cili ka patur për detyrë hartimin e detyrës së projektimit e deri në marrjen në dorëzim të të gjithë materialit*.ò
-SUOGJ-MG i referohet Kodi të Procedurave administrative neni 71 dhe 73 (Procedura e ndihmës administrative), ndërsa në hartimin e Kontratës bazë dhe Shtesë, i referohet Kodi Civil neni 850 e vijues, duke shmangur LLP nr.9643 datë 20.11.2006 I ndyshuar, i cili e ka përcaktuar qartë fushën e zbatimit neni 4 ñ*Ky ligj*

zbatohet për të gjitha proocedurat e prokurimit public , me perjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5,6,7,8 e 9 të këtij ligji (rasti I SUOGJ-MG, nuk bën pjesë në asnjë prej rasteve të përjashtuara).

4.IN operon në mbështetje të bazës ligjore, ligji nr.7582 datë 13.07.1992 ñPër ndërmarrjet shtetëroreò i ndryshuar , ligji nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitòi ndryshuar, VKM nr.1055 datë 22.12.2010 ñPër vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimitò, Urdhër i Ministrit Infrastruktures dhe Energjisë nr.243 datë 12.06.2019 ñPër një ndryshim në Urdhërin nr.197 datë 09.10.2014 të Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit ñPër miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e **Oponencës Teknike** për projektet e veprave të ndërtimitôô I ka 1.2 3.4 dhe 5, më konkretisht :

a)Pika 1 ndryshon përmbajtjen si vijon ñ*Për të gjitha projektet (objektet) publike të veprave të ndërtimit, për të cilat kryerja e oponencës teknike është e detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi,* ***oponenca teknike*** *të kryhet nga Instituti i Ndërtimit dhe Universiteti Politeknik i Tiranës."*

-Në lidhje me auditimin e performancës në IN me temë ñSigurimi i cilësisë së veprave ndërtimoreò , në Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.114 datë 30.09.2019 ñPër evadimin e materialeve të auditimit të performancës ñSigurimi I cilësisë së veprave ndërtimoreò, publikuar në faqen zyrtare të KLSH në datën 30.09.2019, faqe 7-8, është cituar:

Gjetje:

-Nga auditimi i projekteve të zbatimit të objekteve ñProjekti i zbatimit të ujësjellës Kuç-Himarëò dhe ñProjektit të objektit ñRikonstruksion i godinës së Autoritetit të Dosjeveò të realizuara nga Instituti i Ndërtimit, nuk administrohet në dosje licenca profesionale e Institutit të Ndërtimit për hartimin e projekteve.

Për sa më sipër rekomandoj:

-Instituti i Ndërtimit të marrë masa për aplikimin pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për dhënien e licencës profesionale për projektim dhe mbikëqyrje punimesh në fushën e ndërtimit.

Brenda vitit 2019

Gjetje

-Për të dy objektet e sipërcituara është hartuar oponenca nga IN, në zbatim të ligjit nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò të ndryshuar, neni 6, por nisur nga fakti qëështë kryer edhe projekti nga ky institucion, oponenca (potencialisht mendimi ndryshe) duhej kryer nga institucion tjetër.

Për sa më sipër rekomandoj:

-Instituti i Ndërtimit të marrë masa që në të ardhmen të eliminojë dhënien e oponencave teknike për objektet, projektit të cilave e ka hartuar vetë IN, pasi nuk mund të bëhën nga i njëjti person fizik apo juridik edhe prodhimi i shërbimit intelektual edhe kundërshtimi i këtij produkti.

Në vijimësi

Nga sa më sipër, edhe në atë auditim të ushtruar në IN, i cili është auditim performance (në të cilin nuk janë audituar procedurat sesi IN ka fituar të drejtën e hartimit të projekteve), KLSh është shprehur, qoftë për mungesën e licencës profesionale të institucionit për projektim- mbikëqyrje punimesh, qoftë për ñkonfliktin e interesitò që ka ky institucion në lidhje me kryerjen e projektim-oponencës.

5.Grupi i auditimit, në Aktkonstatimin nr.8, date datë 30.04.2021, <u>është shprehur që paraqitja në preventiv e zërave komplekse, të cilat mund të kenë lidhje integrale me njëra-tjetrën në fazën e zbatimit, por duhet të paraqiteshin të veçuara, pasi në manualet e çmimeve të punimeve të ndërtimit janë zëra të veçantë. Për këtë arsye, nga ana e preventivuesit, këto çmime duheshin venë për zëra të ndarë dhe me analizat respektive, ku mund të konsideroheshin edhe ñmaterialet cilësoreò.</u> Evidentimi nga ana juaj i hulumtimit nga ndërmarrje të specializuara për këto procese pune, është subjektiv dhe nuk ka lidhje me problemin e evidentuar nga ana jonë. Procese të tilla pune mund të realizohen nga të gjitha shoqëritë që kanë licencën e dhënë për këto procese pune, sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, për të qenë korrekt me observacionin tuaj, <u>duhet të bashkëlidhnit edhe ofertat e marra nga kompani ñtë specializuara në procese të tilla puneò</u>, në mënyrë që nga ana jonë të kishim mundësi të bënim analizimin e kostos. Përsa sipër, pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.

Sa më sipër,

i) Nga SUOGJ ñMbetëresha Geraldinaò e cila pavarësisht se është institucion varësie i MSHMS është njësi shpenzuese e veçantë dhe si Autoritet Kontraktor, është vetë autoriteti përgjegjës për administrimin e fondeve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit të nevojave të tyre, <u>duhej të realizonte procedurën ñShërbim konsulenteò</u> për përcaktimin e studios së Projektimit për objektin *"Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë* nëpërmjet një gare transparentë, nxitëse për pjesëmarrje të operatorëve ekonomik që kanë object fushën e hartimit të projektimit, nxitëse për konkurencë profesionale, në mënyrë të tillë që të sigurohet mirëpërdorimi i fondeve publike.

ii) Instituti i Ndërtimit ka realizuar hartimin e Projektit Teknik, në kundërshtim me ligjin nr.9643 datë 21.11.206 ñPër prokurimin publicòtë ndryshuar, neni 1, neni 2 pika b ,neni 34/1 ñShërbim konsulencëò të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publicò të ndryshuar, neni 37, me ligjin nr.7582 datë 13.07.1992 ñPër ndërmarrjet shtetëroreò i ndryshuar neni 5, ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò neni 5.

iii) Nga auditimi i zerave të Projektit Teknik, u konstatua se vetëm për 15 zëra mungojnë analizat e cmimeve për punimet ndërtimore, për godinën e re dhe godinën ekzistuese,*zërat e mësipërm janë me analizë çmimi, por bashkëlidhur nuk u evidentua një listë e hollësishme çmimesh me analizë të detajuar të çmimit ku futet (vlera e mallit/pajisja +pagesa e sigurimeve shoqërore+pagesa e puntorisë+ transport, etj)*, kjo në kundërshtim me VKM- në nr.514 datë 15.08.2007 ñPër informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.òi ndryshuar me VKM 629 datë 15.07.2015.
Zërat e mësipërme përbëjnë rrisqe potenciale për rritje apo fryrje fiktive të vlerës së kontratës të sjella nga Instituti i Ndërtimit si projektues i objektit dhe konkretisht vlera prej **149,418,232.0 lekë nuk është e argumentuar.**
iv) Nga Instituti i Ndërtimit është realizuar Oponenca teknike për objektin *"Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë",* me kërkesë të SUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò të ndryshuar, neni 37 (Shërbimi i konsulencës) pika 3 /b, me ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar.
v) Nga Instituti i Ndërtimit është realizuar Aktekspertiza i datës 30.11.2019 mbi verifikimin në terren të subjekteve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe Aktekspertiza e thelluar datës 19.02.2020, duke mos reflektuar vlerën financiare për këto ndërhyrje mbas termetit, kjo në kundërshtim me Aktin Normatin nr.9 datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore neni 34 paragrafi 2 dhe në kundërshtim VKM nr.26 datë 15.01.2020 ñpër kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara.ò
Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

6. Titulli i Gjetjes:	Problematika në procedurën e hapur të prokurimit, me objekt ñ*Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë*ò
Situata :	Nga auditimi u konstatua se, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) ka realizuar procedurën e hapur me objekt ñ*Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë*ò me fond limit në vlerën prej 668,493,718.32 lekë pa tvsh, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të cilit i është deleguar procedura e prokurimit në bazë të shkresës nr.243 prot datë 05.03.2020, nga institucioni i varësisë, Spitali Universitar Obsetrik-Gjinekologjik (SUOGJ)ñMbretëresha Geraldinaò (MG), me kërkesë që realizimi i procedurës, të bëhet nga MSHMS, mëqënëse SUOGJ ñMbreteresha Geraldinaò, *nuk disponon kapacitetet e duhura për të kryer zhvillimin e procedurës së prokurimit publik.* -Nga auditimi u konstatua se, vlera e fondit limit, **nuk** është përllogaritur nga MSHMS pasi gjithë dokumentacioni *(Projekti Teknik, Preventiv i punimeve, oponenca teknike, akt ekspertizat, miratimi i projektin nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, miratimi i Lejes së ndërtimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit*) janë përcjellë nga SUOGJ-MG me shkresat nr.4/2 prot datë 10.02.2020 dhe nr.363 prot datë 30.04.2020, në MSHMS. Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm në dosje fizike ï teknike të procedurës, u konstatua se: **(i)** Projekti Teknik është realizuar ngaInstituti i Ndërtimit, si rezultat i bashkëpunimit me SUOGJ ñMbretëresha Geraldinëò (SUOGJ - MG), **dhe jo** nëpërmjet një procesi të hapur të përzgjedhjes në bazë të rregullave të prokurimit publik. SUOGJ është institucion varësie i MSHMS dhe njësi shpenzuese e veçantë dhe si Autoritet Kontraktor, është vetë autoriteti përgjegjës për administrimin e fondeve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit të nevojave të tyre, procedurë të cilën në këtë rast nuk e ka realizuar. Nga auditimi rezultoi se, në dokumentacionin e paraqitur nga SUOGJ-MG, **nuk** është paraqitur Licenca profesionale për Projektim nga Instituti i Ndërtimit lëshuar nga Ministria e Infrastruktuës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr.943 datë 28.12.2016 ñPër disa ndryshime edhe shtesa ne VKM nr.759 datë 12.11.2014 ñPër licensimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtarinë në fushën e studimit në projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjeò, ndonëse IN ka realizuar hartimin e Projektit Teknik, duke ñpërdorurò licencat personale të punonjësve ose të personave fizikë që operojnë në fushën e projektimit. Midis SUOGJ-MG dhe Institutit të Ndërtimit, është realizuar Kontrata nr.477/10 prot SUOGJ-MG ñ*Për hartimin e projektit Teknik për* ñ*Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë*òdatë 28.06.2019 lidhur, me vlerë prej 5,487,357 lekë me tvsh, për të cilën më pas është bërë dhe

	Kontrata shtesë nr.477/14 prot datë 26.02.2020 me vlerë prej 7,712,994 lekë me tvsh.Për kontratat e mësipërme nga SUOGJ-MG nuk janë paraqitur Urdhër-Shpenzime mbi pagesën, në vlerë totale prej 13,200,351 lekë me tvsh, me përfitues Institutin e Ndërtimit,(i cili nuk merr financim nga Buxheti i shtetit, por është me vetëfinancim). Sa më sipër, institucionet shtetërore, SUOGJ-MG dhe IN, kanë manaxhuar fonde publike në vlerën prej 13,200,351 lekë me tvsh, duke shmanguar procedurat e prokurimit si dhe duke eliminuar garën dhe transparencën për realizimin e hartimit të projektit teknik. **ii)** Në vijim, nga Instituti i Ndërtimit në kuadër të bashkëpunimit me SUOGJ-MG, është realizuar Oponenca teknike,duke lidhur kontratë nr.1066/4 datë 17.12.2019 me objekt ñOponenca teknike për *"Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë",* veprim ky në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò të ndryshuar, neni 37 (Shërbimi i konsulencës) pika 3 /b, me ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, neni 5. Në kushtet kur projekti teknik është hartuar nga Instituti i Ndërtimit, oponenca teknike (potencialisht mendimi ndryshe) vlerësojmë se nuk duhet të kryhej nga i njëjti institucion. Ky fakt është kundërshtuar dhe nga MSHMS sipas shkresës nr.1055 prot datë 19.11.2019 të SUOGJ-MG, drejtuar IN për bashkëpunim dhe interpretim të kofliktit të interesit. Në bazë të Urdhër-shpenzimit nr.788 datë 31.12.2019, IN është likuiduar me vlerën prej 325,750 lekë me tvsh, për realizimin e Oponencës teknike. **iii)** Përsëri nga Instituti i Ndërtimit janë realizuar dy Aktekspertiza, njëra e datës 30.11.2019 mbi verifikimin në terren të subjekteve të dëmtuara të tërmeti i datës 26.11.2019 dhe tjetra e datës 19.02.2020, e cila është e thelluar në bazë të VKM nr.26 datë 15.01.2020 ñPër kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuaraò, duke u shprehur në përmbajtje se, duhet të merren *masat për rikonstruksion dhe përforcimi i Godinës së Obstetrikës, ndërsa për Godinën e Neonatoligjisë paraqitet më e vështirë, e për pasojë riparimi dhe përforcimi i strukturës është joeficient për tu riparuar* (dmth duhet të rindërtohet). Në Akespertizën e datës 19.02.2020, anëtarët e grupit **nuk** janë shprehur si ka qënë gjendja e godinave para dhe pas termetit dhe për rrjedhojë dhe ndryshimet në efektet financiare që mund të ketë pësuar preventivi Teknik i hartuar nga vetë IN,kjo në kundërshtim me Aktin Normatin nr.9 datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò neni 34 paragrafi 2. Gjithashtu, dhe në këtë rast konstatuam se anëtaret e grupit që kanë hartuar Aktekspertizën e datës 19.02.2020, janë në konflikt të interesit me detyrat që kanë realizuar, pasi njëkohësisht kanë qenë edhe anëtarë të grupit të hartimit të projektimit Teknik. **iv).**Nga auditimi u konstatua se,procedura e realizuar nga MSHMS në cilësinë e AK, procedurë e hapur me objekt ñRikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranëò me fond limit në vlerën prej 668,493,718.32 lekë pa tvsh, është fituar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ñA.. K...ò shpk & ñB..-I...òshpk me vlerë ofertë fituese prej 466,395,123.98 lekë pa tvsh ose rreth 28 % më e ulët se vlera e fondi limit (Ofertë anomalisht e ulët), fakt që mund të mbart elementë për fryrje fiktive të përllogaritjes së fondit limit, dmth të preventivave të hartuara nga IN. **v)** Nga auditimi i specifikimeve teknike që lidhen me zërat e kapitujve të punimeve elektrike u konstatua se, vendosja e *kodeve dhe serive të produkteve* i bën referencë *prodhuesit "Schneider", duke* bërë të mundur orientimin në drejtim të operatorëve ekonomikë specifikë që kanë këtë produkt. Veprimi i paracaktimit të prodhuesit nga ana e IN, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar ñPër prokurimin publikò neni 23 ñSpecifikimet teknikeò, pika 2 dhe 5.
Kriteri:	ligji nr.9643 datë 21.11.206 ñPër prokurimin publicòtë ndryshuar, neni 1, neni 2 pika b ,neni 34/1 ñShërbim konsulencëò të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publicò të ndryshuar, neni 37, me ligjin nr.7582 datë 13.07.1992 ñPër ndërmarrjet shtetëroreò i ndryshuar neni 5, ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò neni 5.
Ndikimi/Efekti:	Nga SUOGJ ñMbetëresha Geraldinaò e cila pavarësisht se është institucion varësie i MSHMS është njësi shpenzuese e veçantë dhe si Autoritet Kontraktor, është vetë

	autoriteti përgjegjës për administrimin e fondeve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit të nevojave të tyre, duhej të realizonte procedurën ñShërbim konsulenteò për përcaktimin e studios së Projektimit për objektin *"Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë",* nëpërmjet një gare transparentë, nxitëse për pjesëmarrje të operatorëve ekonomik që kanë objekt fushën e hartimit të projektimit, nxitëse për konkurencë profesionale, në mënyrë të tillë që të sigurohet mirëpërdorimi i fondeve publike, në përputhje me ligjin nr.9643 datë 21.11.206 ñPër prokurimin publicòtë ndryshuar, neni 1, neni 2 pika b ,neni 34/1 ñShërbim konsulencëò të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publicò të ndryshuar, neni 37, me ligjin nr.7582 datë 13.07.1992 ñPër ndërmarrjet shtetëroreò i ndryshuar neni 5, ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò neni 5
Shkaku:	Mos ndjekja e procedurës ñShërbim konsulenceò nga ana e SUOGJ MG Realizimi i projektit teknik nga e njëjta strukturë që ka hartuar oponencën teknike (IN) dhe akt ekspertizat.
Rëndësia:	I Lartë
Rekomandimi:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale, si institucioni epror, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim verifikimin dhe vlerësimin e procedurës së ndjekur për *"Rikonstruksionin e godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtimin e ri 3 kat, Tiranë",* në kushtet kur ka munguar procedura e prokurimit, duke e shoqëruar me përgjegjësitë respektive në çdo hallkë të saj, si dhe marrjen e masave për personat përgjegjës.
Afati i zbatimit:	Brenda datës 31.12.2021

7. Titulli i Gjetjes:	Mungese e argumentimit te fondit limit per 149,418,,232 leke, në procedurën e hapur me objekt ñ*Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë*ò
Situata :	Nga auditimi i zërave të Projektit Teknik*"Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë"*nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua sa vijon: - Nga auditimi i preventivit të punimeve, rezultoi që çmimet e një pjese të konsiderueshme të zërave ndërtimorë, si për ndërtimin e godinës së re, ashtu edhe në rikonstruksionin e godinës ekzistuese, janë bërë me analizë cmimesh. Kështu, në godinën e re, kapitulli ñd. Punime muratureò, zëri ñFV shtrim i sallës operative me PVC antibacterialò, Kapitulli ñj. Punime izolimi themele e tarraceò, etj, janë bërë pothuajse me ñANò, duke emërtuar zëra pune komplekse që nuk gjenden me emërtim të njëjtë në manualin e çmimeve dhe të ndryshme nga ato të paraqitura në specifikimet teknike, të cilave nuk i janë*bashkëlidhur një listë e hollësishme çmimesh me analizë të detajuar të çmimit ku futet (vlera e mallit/pajisja + pagesa e sigurimeve shoqërore + pagesa e punëtorisë + transport, etj)*, kjo në kundërshtim me VKM- në nr.514 datë 15.08.2007 ñPër informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.òi ndryshuar me VKM 629 datë 15.07.2015. **Në lidhje më këto zëra, u analizuan zërat si më poshtë:** **1.**Për zërin e punës *"F.V Termo dhe hidroizolim i pllakës së themelit dhe katit nëntokë. Primer, termoizolim me polesterol ekspans me spensor 80mm. Hidroizolim me dy shtresa guajne bituminoze, gjeotekstil, shtresë mbrojtëse",* **me çmimin 30,000 lekë/m^2**, me vlerë totale 33,900,000 lekë pa TVSH (1130 m^2 x 30,000 lekë/m^2), ku konstatuam se,nënzërat e tyre, si: primer, termoizolim me polesterol ekspans me spensor 80 mm, Hidroizolim me dy shtresa guajne bituminoze, gjeotekstil, shtresë mbrojtëseò, janë zëra që mund të gjenden të njëjtë (ose të ngjashëm) në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi dhe nga rillogaritja e çmimit të ri, rezultoi se, *çmimi i këtij zëri pune është rritur me 12,309 lekë/m^2, ose në totalin e preventivit 13,909,170 lekë pa TVSH (12309 lekë/m^2 x 1130 m^2).* **2.** Për zërin e punës nr. 13 të kapitullit ñ*e. Punime shtresash" me përshkrimin "FV shtrim i sallës operative me PVC antibacterial"*, me çmim njësi 4920 lekë/m^2, me vlerë 39,360,000 lekë (8000 m^2 x 4920 lekë/m^2), në mungesë të analizës së çmimit në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe nga kërkimi i bërë në internet për çmimin e këtij materiali në linkun:https://www.made-in-china.com/products-search/hot-china

	products/Pvc_Flooring_For_Hospital.html, rezultoi se çmimi i materialit PVC antibacterial për spitalet, varion nga 5-15 USD/m^2 (ose 505 ï 1545 lekë/m^2). Nga sa sipër, duke shtuar edhe nënzërat e tjerë të analizës së kostos (punëtori, transport dhe makineri), përsëri ekziston rreziku i rritjes së pajustifikuar të çmimit/njësi të këtij zëri pune. Analiza e çmimit me testimin e tregut për nënzërin ñmaterialò, do të jepte një vlerësim objektiv për çmimin e këtij zëri pune.
Kriteri:	ligji nr.9643 datë 21.11.206 ñPër prokurimin publicòtë ndryshuar, neni 1, neni 2 pika b ,neni 34/1 ñShërbim konsulencëò të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publicò të ndryshuar, neni 37, me ligjin nr.7582 datë 13.07.1992 ñPër ndërmarrjet shtetëroreò i ndryshuar neni 5, ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò neni 5.
Ndikimi/Efekti:	Sa më sipër, mungesa e analizës së çmimeve për disa zëra të punimeve ndërtimore, përbëjnë rrisqe potenciale për rritje apo fryrje fiktive të vlerës së kontratës të sjella nga Instituti i Ndërtimit si projektues i objektit.
Shkaku:	Mos ndjekja e procedurës ñShërbim konsulenceò nga ana e SUOGJ MG IN është në koflik të insteresit, pasi ka realizuar hartimin e Projektit Teknik, Oponencën teknike dhe aktekspertizën e godinave
Rëndësia:	I Lartë
Rekomandimi 1:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucion epror, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune të veçantë me specialistë të fushës, të hartojnë edhe njëherë analizat e çmimeve të çdo zëri të preventivit, bazuar në VKM-në nr. 514 datë 15.08.2007 ñPër informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.ò Nëse pas analizës së grupit rezulton se, çmimet e preventivit të hartuar nga IN të hedhur në DT, janë llogaritur më të larta nga rezultatet e ri llogaritjes të dala nga ky grup pune, atëherë të bëhet korrektimi i tyre me çmimet e preventivit fitues, që janë më të larta se fondi limit dhe diferenca e konstatuar, të arkëtohet në Buxhetin e Shtetit, me qëllim menaxhimin me efektivitet, efiçiencë dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore.
Afati:	Menjëherë

8. Titulli i Gjetjes:	Mbivendosje punimesh me efekt financiar ne shumen 1,331,384 leke, ne procedurën e hapur me objekt ñ*Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë*ò
Situata :	Nga auditimi i zërave të Projektit Teknik*"Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë"*nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se: **-**Në bazë të Preventivit teknik të hartuar nga Instituti i Ndërtimit, nëKapitulli i kuadrove elektrike (këtu futen 1.1 derin 1.34) konstatohet se, zëri ñ*F.V Morseta, kanalina plastike, zbara bakri, kabllo dhe të gjithë aksesorët e nevojshme për montim, përfshi kolaudimin, testim dhe komisionim*ò, është zë pune i mbivendosur i strukturës së preventivit të hartuar nga IN, në kundërshtim me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 ñ*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*ñ, pasi i njëjti zë[29] gjithashtu është përshkruar në zërat e tjerë, të veçuar sipas kapitujve të punimeve elektrike - kuadri kryesor, janë zërat për F.V Furnizim vendosje për kapak, automat, siguresa, instrumenta etj. Sa më sipër, për Kapitullin e Kuadrove Eletrike (1.1-1.34) zëri ñ*F.V Morseta, kanalina plastike, zbara bakri, kabllo dhe të gjithë aksesorët e nevojshme për montim, përfshi kolaudimin, testim dhe komisionim*ò në **vlerën prej 1,176,000 lekë pa tvsh përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit, pasi është i mbivendosur në punimet elektrike për zërat përkatës, duke sjellë fryrje të zërave të punës dhe rritje fiktive e vlerës së kontratës, në përfitim të sipërmarrësit. Gjithashtu, në Kapitullin II ñPunime elektrikeò /1.2 ñKanalina Metalikeò dhe Kapitullin III ñPunime Mekanikeò, u konstatua se **nuk** është vendosur sasia në 3 zëra që i korrespondon vlerës prej **155,384.3 lekë pa tvsh, e cila përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit, duke sjellë rritje fiktive e vlerës së kontratës, si vijon:

Nr	Nr.Manuali	Lloji i punimeve	Njësia	sasia	çmimi	Vlera/lekë

[29] Zëri ñ*F.V Morseta, kanalina plastike, zbara bakri, kabllo dhe të gjithë aksesorët e nevojshme për montim, përfshi kolaudimin, testim dhe komisionim*ò

		1.2 Kanalina Metalike				
21	An E-1.2.21	F.V materiale të tjera plotësuese(profile, stafa,aksesor për këndet variabël, elementë tokëzues, kapak për aksesor	copë	0	1,820,070	91,004
		III.Punime Mekanike (H/Sanitare,HVAC, Linja e gazrave, MKZ, etj)				
2	4.3	F.V Konstruksione metalike të thjeshta	ton	0	136,050.0	20,407.6
3	4.34	F.V Tubo Ventilimi me kthim buzësh,kendëdrejtë,Ll.zinguar	ton	0	174,863.5	43,972.7
		Shuma				**155,384.3**

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Institutin e Ndërtimit.

Kriteri:	Ligji nr.9643 datë 21.11.206 ñPër prokurimin publicòtë ndryshuar, neni 1, neni 2 pika b ,neni 34/1 ñShërbim konsulencëò të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publicò të ndryshuar, neni 37, me ligjin nr.7582 datë 13.07.1992 ñPër ndërmarrjet shtetëroreò i ndryshuar neni 5, ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò neni 5.
Ndikimi/Efekti:	Në total **vlera prej 1,331,384.3 pa tvsh përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit, pasi janë të mbivendosur në punimet elektrike, mekanike për zërat përkatës, duke sjellë fryrje të zërave të punës dhe rritje fiktive e vlerës së kontratës, në përfitim të sipërmarrësit. Gjithashtu, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka realizuar asnjë kontroll mbi procedurat ligjore të hartimit të projekteve teknike dhe për cmimet e hartuara, në preventivin përkatës.
Shkaku:	Përcaktimi i studios së projektimit për objektin *"Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë* ,duhej të realizohej nëpërmjet një gare transparentë, nxitëse për pjesëmarrje të operatorëve ekonomik që kanë object fushën e hartimit të projektimit, pasi në mbështetje të fakteve që SUOGJ -MG, është institucion publik që prej vitin 1937 me funksione të shërbimit gjenekologjik, është Qendër Universitare Spitalor Obsetrik-Gjenokologjik, është godinë e Trashëgiminisë Kulturore, është godinë që lejen e ndërtimit e miraton Këshilli Kombëtar i Territorit, dhe për rrjedhojë, nga AK SUOGJ -MG duhej të prokurohej sipas procedurës ñShërbim konsulenceò në mënyrë që të sigurohet mirëpërdorimi i fondeve publike. IN është në koflik të insteresit, pasi ka realizuar hartimin e Projektit Teknik, Oponencën teknike dhe aktekspertizën e godinave
Rëndësia:	I Lartë
Rekomandimi:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucion epror, të marrë masa duke verifikuar gjatë zbatimit të kontratës respektive për këtë investim si në situacionet pjesore /në situacionin përfundimtar, duke mos likuiduar tepër vlerën prej 1,331,384.3 pa tvshsipërmarrësit të punimeve BOE ñAé Ké ò shpk & ñB.-I.òshpk ,për punime mbivendosura, me qëllim mirëmenaxhimin të fondeve buxhetore.
Afati i zbatimit:	Në vijimësi

3. Mbi auditimin e procedurës "me negocim pa shpallje" me objekt "Blerje tamponë nazofaringalë"me fond limit 31,920,000 lekë pa tvsh, realizuar në bazë të rregullave të LPP në maj të vitit 2020.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : ñ*Blerje tamponë nazofaringalë"*		
1. Urdhër Prokurimi nr. 311, datë 13.05.2020 **Njësinë e prokurimit** A.P E. L	**3. Urdhër i brendshëm të ISHP-së me** nr.497/1, datë 21.04.2020 për argumentimin e fondit limit, fartimin e specifikimeve teknike për tampona nazofaringal me përbërje :	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**, i ngritur në bazë të urdhër nr. 311/1, datë 13.05.2020 F. B., L. Sh.i

V. Dh L. P **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** ñMe negocim pa shpallje paraprake të njoftimitò	A. R R. D Xh. M	J. S..
5.Fondi Limit (pa tvsh) 31,920,000 (tridhjetë e një milion e nëntëqind e njëzet mijë) lekë .	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** O.. D.. shpk me vlerë oferte 9,240,000 lekë pa tvsh.	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 22,680,000 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit Data 15.05.2020	**9.Burimi Financimit nga** Buxheti i Shtetit	**10. Operatoret Ekonomike** G..-A.. F.. shpk me vlerë oferte 29,064,000 lekë pa tvsh. O.. D... shpk me vlerë oferte 9,240,000.
11. Ankimime Pranë AK- nuk ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK ï nuk ka	**13. Përgjigje** Ankesës nga KKP ï nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr.2272/4, datë 02.06.2020 me operatorin fitues O.. D.. me vlerë 9,240,000 lekë pa tvsh me afat lëvrimi 20% e sasisë brenda 7 ditëve nga lidhja e kontratës, 30% e sasisë brenda 30 ditëve nga lidhja e kontratës dhe 50% e sasisë brenda 70 ditëve nga lidhja e kontratës.	**Zbatimi i kontratës:** Likuiduar me Urdhër shpenzimin nr.702, datë 10.09.2020	

Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe realizimi i procedurës.

Me shkresën nr.497/3, datë 23.04.2020 nga Instituti i Shëndetit Publik ka ardhur kërkesa për ñBlerje Tamponë nazofaringalëò. Bashkëlidhur është dorëzuar dhe informacioni në lidhje me sasinë, specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit si dhe përllogaritje e fondit limit sipas shkresës me nr.497/2, datë 23.04.2020 në sasi 168.000 copë me fond limit 31,920,000 lekë pa tvsh, nga Komisioni i përbërë nga A. R ,R. D dhe Xh. M, punonjëse të ISHP.

Nga auditimi konstatohet se Komisioni në përllogaritjen e fondit limit ka marrë në konsideratë vetëm kontratën e mëparshme .

Është ngritur Urdhri i Prokurimit me nr.311, datë 13.05.2020, ku është argumentuar dhe lloji i procedurës së prokurimit ñNegocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratësò, për arsyet:

Shkaktimi i një ngjarje të paparashikuar si përhapja e shpërthimit epidemik të koronavirusit të ri COVID-19, ngjarje e paparashikuar nga AK si dhe shpallja e fatkeqësisë natyrore , AK nuk ka përgjegjësi për ngjarjen, ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshëm të një komuniteti të ujerë, nuk është e mundur të ndiqen procedurat standarte mbi ose nën kufirin e ulët monetar.

Me shkresën nr.2272 /1, datë 13.05.2020 , Urdhër nr.311/1, datë 13.05.2020 është krijuar Komisoni i Vlerësimit të Ofertave me përbërje: F.B, L. Sh dhe J. S.

U është ftesë për pjesëmarrje 6 operatorëve ekonomik : O... D.. shpk, F... N.. A.., P.. shpk, M...shpk,E.. shpk dhe G..-A.. F..., si pjesëmarrës në procedura të ngjashme prokurimi

Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Sipas procesverbalit të mbajtur në datën 22.05.2020, janë paraqitur dy operatorë :

1. G..-A.. F... shpk me vlerë oferte 29,064,000 lekë pa tvsh.
2. O.. D... shpk me vlerë oferte 9,240,000.

Sipas procesverbali ka rezultuar se operatorit O.. D.. ju kërkua sqarim pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ku vërtetohet se ai merr përsipër të sigurojë gjithë sasinë e nevojshme brenda afateve të dorëzimit të specifikuara në DST, gjithashtu iu kërkua sqarim mbi ofertën anomalisht të ulët. Sipas komisionit operatori ka dhënë sqarimet e nevojshme dhe është klasifikuar në vend të parë si oferta me vlerë më të ulët.

Nga auditimi konstatohet se në procesverbal nuk është bashkëlidhur arsyetimi që ka dhenë operatori ekonomik lidhur me ofertën anomalisht të ulët dhe me kërkesat e kërkuara në dst.
Sipas Raportit Përmbledhës me nr.2272/2, datë 26.05.2020 është shpallur fitues operatori O ..D... shpk me vlerë oferte 9,240,000 lekë pa tvsh.
Nga auditimi i dokumentave të operatorit fitues në bazë të DST konstatohet se:
Në dokumentet standrate të tenderit , në kriteret e veçanta të kualifikimit , Kapaciteti teknik është kërkuar:
Nga auditimi u konstatua se mungonte autorizimi nga kompania prodhuese ose nga distributor të Autorizuar nga prodhuesi që merr përsipër të sigurojë të gjithë sasinë e kërkuar brenda afateve të dorëzimit të specifikuara, pjesë shumë e rëndësishme e kërkesave të DST nisur dhe nga situata aktuale.
Dokumentacion i sjellë nga operatori , pas kërkesës së AK me nr,39, datë 20.05.2020.
Gjithashtu nuk ka asnjë argumentim nga operatori mbi çmimin e produktit i cili rezulton shumë më i ulët se fondi limit.
Dokumentacion i sjellë më vonë nga operatori , pas kërkesës së AK me nr,39, datë 20.05.2020.
Është lidhur kontrata me nr.2272/4, datë 02.06.2020 me operatorin fitues O.. D.. me vlerë 9,240,000 lekë pa tvsh me afat lëvrimi 20% e sasisë brenda 7 ditëve nga lidhja e kontratës, 30% e sasisë brenda 30 ditëve nga lidhja e kontratës dhe 50% e sasisë brenda 70 ditëve nga lidhja e kontratës.

4.Mbi auditimin e procedurës e hapur me objekt "F.V pajisje mjekësore dhe mobilimi për qendrat shëndetësore që do të rikonstruktohen gjatë vitit 2020-2021" Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara- me afat 2 vjeçar (24 muaj, me vlerë të pritshme në vlerën prej 53,471,360.86 lekë pa tvsh, realizuar në prill 2020.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : ñ***"F.V pajisje mjekësore dhe mobilimi për qendrat shëndetësore që do të rikonstruktohen gjatë vitit 2020-2021"***		
Urdhër Prokurimi nr.272, datë 23.04.2020 . Njësi Prokurimi A.A E.L F. S **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** ñProcedurë e hapurò	Komisioni i llogaritje së fondit limit: 1. E.T, 2. F. S 3. N. A.	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**, Me shkresën nr.1944 /1, datë 03.04.2020 , Urdhër nr.272/1, datë 23.04.2020 me përbërje: 1. J. D 2. E. A 3. E. K
5.Fondi Limit (pa tvsh) 53,471,360.86 lekë pa tvsh	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** OE E... shpk me vlerë oferte të shumatores së çmimeve për njësi 114,400 lekë pa tvsh dhe shuma e vlerës së pritshme të kontratave 51,739,610 lekë pa tvsh.	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 1,731,750 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit Data 03.06.2020	**9.Burimi Financimit nga** Buxheti i Shtetit	**10. Operatoret Ekonomike** 1.OE E.. shpk me vlerë oferte të shumatores së çmimeve për njësi 114,400 lekë pa tvsh dhe shuma e vlerës së pritshme të kontratave 51,739,610 lekë pa tvsh. 2.OE J.. shpk me vlerë oferte të shumatores së çmimeve për njësi 122,185 lekë pa tvsh dhe shuma e vlerës së pritshme të kontratave 49,836,987.25 lekë pa tvsh. 3.OE R.. shpk me vlerë oferte të shumatores së çmimeve për njësi 124,600 lekë pa tvsh dhe shuma e vlerës së pritshme të kontratave 52,599,924 lekë pa tvsh. 4.M... shpk nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

11. Ankimime Pranë AK- Me shkresën nr.1944/3, datë 04.05.2020, pranë AK ka ardhur një ankesë nga Operatori M..-M..	**12. Përgjigje Ankesës** Komisioni me shkresën nr.1944/5, datë 06.05.2020, ka dhënë vendimin mbi ankesën , të cilën ka pranuar pjesërisht vetëm pikën tre dhe pranoi sugjerimin dhe të plotësojë kriterit në : Inxhinier Përpunim Druri/ Dizajn i Mobiljeve dhe Interierit (jo inxhinier pyjor).	**13. Përgjigje** Ankesës nga KKP ï nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës -Me shkresën nr.1944/8, datë 03.07.2020, është miratuar drafti i Marrëveshjes Kuadër midis AK dhe operatorit E...	Me shkresën nr.4699, datë 20.10.2020, me urdhrin me nr.588, datë 20.010.2020, është ngritur Komisioni për dhënien e kontratave të bazuara në marrëveshjen kuadër me objekt F.V pajisje mjekësore dhe mobilimi për qendrat shëndetësore që do të rikonstruktohen gjatë vitit 2020-2021, me përbërje :R.S, O. Gj dhe G. L.	

Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe realizimi i procedurës.

Me shkresën nr.556, datë 31.01.2020 , me urdhrin nr.52, datë 31.01.2020, është ngritur grupi i punës për përcaktimin e sasisë, llojit, specifikimeve teknike si dhe përllogaritjen e fondit limit, me përpërje : E.T, F. S dhe N. A.

Përcaktimi i sasisë, llojit, specifikimeve teknike si dhe përllogaritja e fondit limit,është bërë me shkresën nr.556/1, datë 15.04.2020. Sasitë e nevojshme janë sjellë nga NJVKSH me anë të emaileve zyrtare, specifikimet teknike janë bërë në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik, Llogaritja e fondit limit u bë në bazë të një kontrate të mëparshme të zhvilluar në vititn 2018 me operatorin E..shpk. Për llogaritjen e fondit limit grupi mund të kishte testuar tregun pasi çmimet e tregut ndryshojnë për një periudhë 2 ï vjeçare.

Me shkresën nr.1944, datë 23.04.2020, Urdhër Prokurimi nr.272, datë 23.04.2020, është përcaktuar lloji i procedurës : ñProcedurë e hapurò, njësia e prokurimit me përbërje : A. A, E. L dhe F. S, fondi limit /vlerë e pritshme e kontratave 53,471,361 lekë pa tvsh.

Me shkresën nr.1944 /1, datë 03.04.2020 , Urdhër nr.272/1, datë 23.04.2020 Për ngritje e Komisionit të Vlerësimit me përbërje: J. D, E. A dhe E.K.

Me shkresën nr.1944/3, datë 04.05.2020, pranë AK ka ardhur një ankesë nga Operatori M...-M.. e cila konsiston në :

-Ndarjen e procedurës në dy tre lote më vetë, pasi artikujt nuk kanë ngjashmëri me njëra tjetrën.

-Heqjen e kritereve në pikat 3,4 dhe 5 në Dokumentat standarte të Tenderit.

-Korrigjimin e kriterit Inxhinier mobilesh, pasi nuk ekziston, duhet të vendoset ñIng.Përpunim druriò.

-Ndryshimin e afatit të lëvrimit nga 25 ditë në minimumi 100 ditë.

Nga titullari i AK me shkresën nr.1944/4, datë05.05.2020, është pezulluar procedura dhe është ngritur Komisioni për shqyrtimin e ankesës me përbërje : E. L, E. A dhe E. K.

Komisioni me shkresën nr.1944/5, datë 06.05.2020, ka dhënë vendimin mbi ankesën , të cilën ka pranuar pjesërisht vetëm pikën tre dhe pranoi sugjerimin dhe të plotësojë kriterit në : Inxhinier Përpunim Druri/ Dizajn i Mobiljeve dhe Interierit (jo inxhinier pyjor).

Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Procedura e auditimit u hap në datën 22.05.2020.

Nga procesverbali i mbajtur në datën 05.06.2020, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave u konstatua se janë paraqitur 4 operatorë ekonomik :

1.OE E... shpk me vlerë oferte të shumatores së çmimeve për njësi 114,400 lekë pa tvsh dhe shuma e vlerës së pritshme të kontratave 51,739,610 lekë pa tvsh.

2.OE J... shpk me vlerë oferte të shumatores së çmimeve për njësi 122,185 lekë pa tvsh dhe shuma e vlerës së pritshme të kontratave 49,836,987.25 lekë pa tvsh.

3.OE R..-A... shpk me vlerë oferte të shumatores së çmimeve për njësi 124,600 lekë pa tvsh dhe shuma e vlerës së pritshme të kontratave 52,599,924 lekë pa tvsh.

4.M... shpk nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

KVO konludon se të tre operatorët plotësojnë kriteret e kërkuara, dhe kualifikohet në vend të parë operatori E... si operatori me shumatore çmimesh për njësi më të ulët se operatorët e tjerë.

Me shkresën nr.1944/6, datë 22.06.2020 është miratuar raporti për mbledhës nga titullari i autoritetit

kontraktor dhe shpallur fitues operatori E... shpk.

Lidhja dhe zbatimi i kontratës

Me shkresën nr.1944/8, datë 03.07.2020, është miratuar drafti i Marrëveshjes Kuadër midis AK dhe operatorit E.... Kontrata është në proces dhe do të ekzekutohet pas rikonstruksionit të qendrave shëndetësore.

5. Mbi auditimin e procedurës "me negocim pa shpallje" me objekt "Blerje artikuj për masa mbrojtëse personale (MMP) për përballimin e situatës emergjente COVID-19 nga strukturat shëndetësore publike", me fond limit në vlerën prej 199,965,000 lekë pa tvsh, realizuar në prill 2020.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Blerje artikuj për masa mbrojtëse personale (MMP)për përballimin e situatës emergjente COVID-19 nga strukturat shëndetësore publike"		
Urdhër Prokurimi nr.272, datë 23.04.2020 . Njësi Prokurimi A. A E.L L.P	Komisioni i llogaritje së fondit limit: L. P, S. N N. A	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**, Me shkresën nr.1944 /1, datë 03.04.2020 , Urdhër nr.272/1, datë 23.04.2020 me përbërje: J. J, A. B E.H
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ñNegocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratësò		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 199,965,000 lekë pa tvsh	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** BOE: E.. shpk dhe F.. N.. A.. me vlerë 189,585,000 lekë pa tvsh.	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 10,380,000 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit Data 05.06.2020	**9.Burimi Financimit nga** Buxheti i Shtetit	**10. Operatoret Ekonomike** BOE: E... shpk dhe F.. N.. A... me vlerë 189,585,000 lekë pa tvsh.
11. Ankimime	**12. Përgjigje Ankesës**	**13. Përgjigje** Ankesës nga KKP ï nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Me shkresën nr.2572/5, datë 09.06.2020, është lidhur kontrata midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Bashkimit të Operatorëve E.. shpk dhe F..N.. A... me vlerë 189,585,000 lekë pa tvsh, me afat lëvrimi 50% e sasisë brenda 7 ditëve nga lidhja e kontratës dhe 50% e sasisë brenda 21 ditëve nga data e lidhjes së kontratës.	Me shkresën nr.3572/8, datë 15.06.2020, me urdhrin nr 372, është ngritur grupi i punës për mbikëqyrjen e kontratës me përbërje :F. B, N. A dhe M. Sh. Paguar me Urdhër Shpenzimet 1-Nr,459, datë 30.06.2020, 2-nr.460, datë 30.06.2020,3-nr.500,datë 08.07.2020,4-628, datë 20.08.2020, 5-nr.590, datë 11.08.2020,6- nr.591, datë 11.08.2020,	

Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe realizimi i procedurës.

Me shkresën nr.2047, datë 29.04.2020 , me urdhrin nr.281, datë 29.04.2020, është ngritur grupi i punës për përcaktimin e nevojave, dhe përllogaritjen e fondit limit, me përpërje : L. P, S. N dhe N. A.

Përcaktimi i sasisë, llojit, specifikimeve teknike si dhe përllogaritja e fondit limit,është bërë me shkresën nr.2047/4, datë 20.05.2020. Sipas argumentimit të bërë nga grupi i punës është konstatuar se për sasitë e nevojshme janë mbledhur kërkesat nga të gjithë institucionet shëndetësore në lidhje me masta mbrojtëse personale MMP anti COVID-19. Llogaritja e fondit limit është bërë në bazë të çmimeve për njësi të marra nga dy procedurat e mëparshme për prokurimin e MMP . Me shkresën nr. 2572, datë 29.05.2020, Urdhër Prokurimi nr.354, datë 29.05.2020, është përcaktuar lloji i procedurës : ñNegocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratësò, njësia e prokurimit me përbërje : A. A, E. L dhe L. P , fondi limit /vlerë e pritshme e kontratave 199,965,000 lekë pa tvsh. Është zgjedhur procedura negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për arsyet e mëposhtme: Shkaktimi i një ngjarje të paparashikuar si është përhapja e

shpërthimit epidemik t koronavirusit të ri COVID-19 në nivel pandemie globale është një ngjarje e paparashikuar nga AK, Autoriteti kontraktor nuk ka përgjegjësi për ngjarjen, ngjarja mund të dëmtojë interesat e një komunitetit të gjerë, nuk është e mundur të ndiqen procedurat standarte të prokurimit për shkak të kohës, nevoja ekstreme nuk është shkaktuar nga veprimi apo mosveprimi i AK, kjo procedurë nuk mund të zbatohet për të justifikuar lidhjen e kontratave afatgjata por vetëm për përballimin e nevojës ekstreme.

Me shkresën nr.2572 /1, datë 29.05.2020 , Urdhër nr.354/1, datë 29.05.2020 Për ngritje e Komisionit të Vlerësimit me përbërje: J.J., A. B dhe E. H.

Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Sipas procesverbalit të mbajtur nga Njësia e Prokurimit janë ftuar për të marrë pjesë katër operatorë ekonomik : B...A.., M... shpk , F...N.. A... dhe E... shpk. Këta operatorë janë përzgjedhur për shkak të kontratave të suksesshme me MSHMS lidhur me kontratat e MMP.

Procedura e auditimit u hap në datën 05.06.2020.

Nga procesverbali i mbajtur në datën 05.06.2020, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave u konstatua se është paraqitur 1 bashkim operatorësh ekonomik :

1.BOE: E... shpk dhe F..N.. A...me vlerë 189,585,000 lekë pa tvsh.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO konstatohet se Bashkimi i operatorëve plotëson të gjitha kërkesat e DST dhe kualifikohet në vend të parë.

Është miratuar raporti përmbledhës me shkresën nr.2572/3, datë 05.06.2020 nga titullari i AK ku është shpallur fitues BOE: E... shpk dhe F.. N. A...me vlerë 189,585,000 lekë pa tvsh.

Lidhja dhe zbatimi i kontratës

Me shkresën nr.2572/5, datë 09.06.2020, është lidhur kontrata midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Bashkimit të Operatorëve E...shpk dhe F.. N...A.. me vlerë 189,585,000 lekë pa tvsh, me afat lëvrimi 50% e sasisë brenda 7 ditëve nga lidhja e kontratës dhe 50% e sasisë brenda 21 ditëve nga data e lidhjes së kontratës.

Me shkresën nr.3572/8, datë 15.06.2020, me urdhrin nr 372, është ngritur grupi i punës për mbikëqyrjen e kontratës me përbërje : F. B, N. A dhe M. Sh .

Nga raporti final i mbajtur nga grupi i punës për mbikqyrjen e kontratës në datën 01.07.2020 u konstatua se nga grupet e punës të ngrituar në njësitë përfituese në bazë të procesvebaleve të marrjes në dorëzim, faturat shoqëruese të mallrave , evidentohet se lëvrimi është realizuar konform afateve të përcaktuara në kontratë pa shkaktuar vonesa .

Për spitalet rajonale janë bërë dy lëvrime:

Lëvrmi i parë në datën 15.06.2020, Lëvrimi i dytë në datën 23.06.2020.

Për Spitalet bashkiake lëvrimi është kryer në datën 18.06.2020

Për Spitalet terciare dhe operatorin lëvrimi është bërë I-15.06.2020, II-29.06.2020.

6. Mbi auditimin e procedurës e hapur me objekt "Blerje Barna dhe Materiale Mjekimi për qendrat shëndetësore që mbulojnë me shërbim zonat turistike verore për sezonin 2020,2021 si dhe për qendrat shëndetësore që bllokohen gjatë sezonit të dimrit 2020-2021 dhe 2021-2022", Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara- me afat 2 vjeçar (24 muaj, me vlerë të pritshme në vlerën prej 87,646,057 lekë pa tvsh.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Blerje Barna dhe Materiale Mjekimi për qendrat shëndetësore që mbulojnë me shërbim zonat turistike verore për sezonin 2020,2021 si dhe për qendrat shëndetësore që bllokohen gjatë sezonit të dimrit 2020-2021 dhe 2021-2022",		
Urdhër Prokurimi nr.89, datë 13.02.2020. Njësi Prokurimi A.A E. L L. T E. T N. A	Komisioni i llogaritjes së fondit limit: Urdhër nr.14, datë 14.01.2020: E. T L. T N. A	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**, Me shkresën nr.862 /1, datë 03.02.2020 , Urdhër nr.89/1, datë 03.02.2020 me përbërje: J. J J. S M.K

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur		
5.Fondi Limit (pa tvsh) Vlera e pritshme e kontratës 87,646,057 lekë pa tvsh	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** F... N.. me vlerë oferte 86,935,174 lekë pa tvsh	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 710,883 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit Data 16.03.2020	**9.Burimi Financimit nga** Buxheti i Shtetit	**10. Operatoret Ekonomike** C.. P... me vlerë oferte 85,583,000 lekë pa tvsh F.. N.. me vlerë oferte 86,935,174 lekë pa tvsh M... D... pa ofertë ekonomike
11. Ankimime Është paraqitur një ankesë nga operatori T...shpk me nr.862/3, datë 02.03.2020, lidhur me ndarjen e procedurës në **lote .**	**12. Përgjigje Ankesës** Kjo ankesë nuk është marrë në konsideratë pasi nuk ka respektuar afatin 7 ditor të ankesave . AK i ka kthyer përgjgije operatorit me shkresën nr 862/6, datë 03.03.2020.	**13. Përgjigje** Ankesës nga KKP ï nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Draft marrëveshja kuadër është bërë me shkresën nr.862/9, datë 26.05.2020, midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Operatorit ekonomik F... N.. A... shpk me vlerë të pritshme të kontratës 86,935,174 lekë pa tvsh, dhe kohëzgjatje të marrëveshjes dy vjet.		

Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe realizimi i procedurës.

Me Urdhrin nr.14, datë 14.01.2020, është ngritur grupi i punës për përcaktimin e nevojave, dhe përllogaritjen e fondit limit, me përpërje: E. T, L. T dhe N. A.

Përcaktimi i sasisë, llojit, specifikimeve teknike si dhe përllogaritja e fondit limit,është bërë me shkresën nr.215/1, datë 11.02.2020. Sipas argumentimit të bërë nga grupi i punës është konstatuar se grupi i punës ka komunikuar me institucionet shëndetësore për mbledhjen e informacionit mbi bilancin faktik të barnave apo materialeve të mejkimit , konsumin e pritshëm, nevojat e parashikuara bazuar mbi këtë bilanc. Institucionet propozojnë artikuj të rinj bazuar në eksperiencën e një viti më parë të propozojnë artikuj të rinj . Për vendosjen e çmimit , bazuar në metodologjinë e përcaktuar në urdhrat përkatës, bër barnat merret në konsideratë çmimi i CIF i miratuar për atë vit nga Komisioni i Çmimit të barnave plus marzhin e trgtimit, ndërkohë që për barnat e paautorizuar për tregtim të cilat kërkohen nga shërbimi, çmimi merret si mesatare e çmimeve CIF plus marzhin e tregtimit të lejeve të importit të 3 viteve të fundit . Bari i paautorizuar që ofertohet duhet të ketë : Të ketë marrë autorizim për tregtim dhe të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Europian, SHBA, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi , ose të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm nëse ka marrë autorizim për tregtim nga EMA ose FDA i SHBA. Leja e importit jepet vetëm në rast të shpalljes fitues dhe dhënies së kontratës përkatëse për atë bar. Me shkresën nr.832, datë 13.02.2020, Urdhër Prokurimi nr.89, datë 13.02.2020, është përcaktuar lloji i procedurës : ñProcedurë e hapurò, njësia e prokurimit me përbërje: A. A, E. L, L.T , E.T dhe N. A, fondi limit /vlerë e pritshme e kontratës 87,646,057 lekë pa tvsh. Ministria e Shëndetësisë në këtë procedurë vepron si organ Qëndror Blerës .

Me shkresën nr.862 /1, datë 03.02.2020, është ngritur Urdhri nr.89/1, datë 03.02.2020 ñPër ngritje e Komisionit të Vlerësimitò me përbërje: J.J, J .S dhe M. K.

Është paraqitur një ankesë nga operatori T.. shpk me nr.862/3, datë 02.03.2020, lidhur me ndarjen e procedurës në lote . Kjo ankesë nuk është marrë në konsideratë pasi nuk ka respektuar afatin 7 ditor të ankesave . AK i ka kthyer përgjgije operatorit me shkresën nr 862/6, datë 03.03.2020.

Nga auditimi konstatohet se kjo procedurë prokurimi mund të ishte ndarë me lote nisur nga natyra e produkteve që do të prokurohen, pasi do të prokurohen 57 lloje barnash dhe 27 zëra materiale mjekësore. Ndarja e kësaj procedure në lote mund të siguronte një pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomik në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin Rregullave të Prokurimit Publik" neni 9, pika 5 "Kontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t'i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor."

Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Është mbajtur procesverbali i zhvillimit të Procedurës në datën 30.03.2020, Nga KVO ku janë paraqitur 3 operatorë :

1. C...P... me vlerë oferte 85,583,000 lekë pa tvsh
2. F.. N.. me vlerë oferte 86,935,174 lekë pa tvsh
3. M... D.. pa ofertë ekonomike

Pas shqyrtimit të dokumentacionit u konstatua se Operatori C.. P.. ka mungesë dokumentacioni, Operatori F.. N.. ka paraqitur gjithë dokumentacionin e duhur për tu kualifikuar. .

Është miratuar raporti përmbledhës me nr.862/7, datë 10.04.2020. nga Titullari i Autoritetit Kontraktor ku është shpallur fitues operatori F..N... me vlerë oferte 86,935,174 lekë pa tvsh.

Me shkresën nr.862/8, datë 10.04.2020, ëahtë dërguar formulari i njoftimit të operatorëve ekonomikë të sukseshëm në marrëveshjen kuadër

Lidhja dhe zbatimi i kontratës

Draft marrëveshja kuadër është bërë me shkresën nr.862/9, datë 26.05.2020, midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Operatorit ekonomik F..N.. A... shpk me vlerë të pritshme të kontratës 86,935,174 lekë pa tvsh, dhe kohëzgjatje të marrëveshjes dy vjet.

<u>7. Mbi auditimin e përllogaritjes së fondit limit me objekt "Blerje Autoambulanca" realizuar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP).</u>

Nga auditimi u konstatua se në Ministrinë e Shëndetësisë me shkresën nr,2582, datë 01.06.2020, është ngritur Urdhri i Prokurimit me nr.356, datë 01.06.2020 ñPër ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike (kategorinë / mofdelin/ llojin), sasitë si dhe përllogaritjen e fondit limit të nevojshëm për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt ñBlerje Autoambulancaò nga ABPò. Fondi i parashikuar për vitin 2020 është 300,000,000 lekë me tvsh, komisioni përbëhet nga E.T, V. Dh dhe F. S.

Me procesverbalin e mbajtur në datën 16.06.2020, grupi i punës hartoi specifikimet teknike të autoambulancave, përcaktoi sasitë, llojin dhe fondin limit. Për hartimin e specifikimeve teknike grupi i punës mori në konsideratë plotësimin e standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe kontratave të mëparshme për autoambulancat.Për llogaritjen e fondi limit grupi i punës iu referua kontratës së realizuar në vitin 2018.Llogaritja e fondit limit për sasinë 36 autoambulanca është në vlerën 196,371,000 lekë pa tvsh , me çmim për njësi 5,454,750 lekë pa tvsh.

Me shkresën nr.2582/1, datë 17.06.2020 , me Urdhrin nr,356/1, datë 17.06.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS ñPër një ndryshim në Urdhrin nr.356, datë 01.06.20202020 ñPër ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike (kategorinë/modelin/ llojin), sasitë si dhe përllogaritjen e fondit limit të nevojshëm për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt ñBlerje Autoambulancaò nga ABPò, bëhet ndryshimi i fondit të parashikuar nga 300,000,000 lekë pa tvsh në 240,000,000 lekë me tvsh.

Me shkresën nr.2582/2, datë 17.06.2020, nga grupi i Punës i janë dërguar Sekretarit të Përgjithshëm specifikimet teknike dhe përllogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit . Me shkresën nr.2582/3, datë 19.06.2020, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS i ka dërguar Agjensisë së Blerjeve të Përqëndruara dërgimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit për zhvillimin e procedurës bashkëlidhur dhe procesverbalin e mbajtur nga grupi i punës .

Procedura e Prokurimit u zhvillua nga Agjensia e Blerjeve të Përqendruara.

Me shkresën nr.44/8, datë 10.09.2020, nga Agjensia e Blerjeve të Përqendruara është dërguar shkresa Njoftim për lidhje kontrate, ku është shpallur fitues Operatori ñA..M.. C...ò me vlerë 191,505,600 lekë pa tvsh. Është lidhur kontrata me nr,2582/8, datë 05.10.2020 midis A.. M.. C... shpk dhe Ministrtisë së

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
Me shkresën nr.2582/9, datë 04.12.2020, është ngritur urdhri nr.668, datë 04.12.2020, për krijimin e komisionit për marrjen në dorëzim të Autoambulancave të reja për Qendrën Kombëtare të Urgjencave. Me shkresën nr.751/4, datë 16.12.2020 nga Qëndra Kombëtare e Urgjencave është dërguar dokumentacioni për marrjen në dorëzim të autoambulancave të reja.
Me shkresën nr.199/1, datë 21.01.2021 Nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara është dërguar njofitimi për fillimin e procesit të monitorimit të zbatimit të kontratës.

8. Mbi auditimin e procedurës së hapur me objekt "F.V pajisje mjekësore- Rezonancë magnetike (MRI)" me fond limit në vlerën prej 144,349,418 lekë pa tvsh, realizuar në korrik 2020.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "F.V pajisje mjekësore- Rezonancë magnetike (MRI)"		
Urdhër Prokurimi 411 datë 13.07.2020 Njësi Prokurimi A.A E. L O. Dh **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** Procedurë e hapur	**Llogaritja e fondit limit:** Urdhri Nr. 373, datë 16.06.2020, Nr. 2855 Prot, datë 16.06.2020 të Titullarit të Autoritetit Kontraktori përbërë nga : J. J, F. Sj O. Dh	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**,Urdhri Nr. 411/1 datë 13.07.2020 me nr. 3352/1 prot., datë 13.07.2020, me përbërje si më poshtë: 1. F. B 2. Ing. L. P 3. L. A
5.Fondi Limit (pa tvsh) 144,349,418 lekë pa tvsh	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** ñHealth and Lightò me oferte të me vlerë 97,100,000 lekë lekë pa tvsh.	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 47,249,418 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit Data 06/08/2020	**9.Burimi Financimit nga** Buxheti i Shtetit	**10. Operatoret Ekonomike** A....shpk- me ofertë ekonomike 122,000,000 lekë pa tvsh, M... shpk - me ofertë ekonomike 109,890,000 lekë pa tvsh. H.. and L.. shpk - me ofertë ekonomike 97,100,000 lekë pa tvsh.. M... shpk ï me ofertë ekonomike 129,600,000 lekë pa tvsh.. B.. E... me ofertë ekonomike 98,580,000 lekë pa tvsh.
11. Ankimime Ankesa e OE ñH..&L..tò Shpk me nr. prot. 3352/3, date 17.07.2020 me shkresen nr. prot. 3352/4, date 20.07.2020 eshte pezullimi i kesaj procedure prokurimi dhe me shkresen nr. prot. 3352/11, date 03.08.2020 i eshte kthyer pergjigje OE ku i thuhet se i pranohet pjeserisht ankesa. Ankesa e OE ñB.. E..ò Shpk me nr. prot. 3352/5, date 20.07.2020 me shkresen nr. prot. 3352/8, date 21.07.2020 eshte pezullimi i kesaj procedure prokurimi dhe me shkresen nr. prot. 3352/13, date 03.08.2020 i eshte kthyer pergjigje OE ku i thuhet se i pranohet pjeserisht ankesa. Ankesa e OE ñM..ò Shpk me nr. prot. 3352/6, date 20.07.2020 me shkresen nr. prot. 3352/7, date 21.07.2020 eshte pezullimi i kesaj procedure prokurimi dhe me shkresen nr. prot. 3352/15, date 03.08.2020 i eshte kthyer pergjigje OE ku i thuhet se i pranohet pjeserisht ankesa. 12. Përgjigje Ankesës		**13. Ankesa KPP** Më datën 03.08.2020, OE ñB..E..ò Shpk është ankuar në KPP duke kërkuar modifikimin e dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi. KPP me vendimin nr. 341/2020 date 28.08.2020protokolluar në MSHMS me nr. 3352/22 Prot., datë 31.08.2020, ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës. AK më datë 01.09.2020 modifikoi DST sipas vendimit te KPP-së. Bazuar sa me lart, me shkresen Nr. Prot. 3352/23 date 01.09.2020, u bene modifikimet ne DST
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr.3352/34, datë 30.10.2020 midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Operatorit Ekonomik H.. & L... sh.p.k me vlerë 97,100,000 lekë pa tvsh.		

Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe realizimi i procedurës.
Përllogaritja e fondit limit, specifikimet teknike, sasitë dhe dokumentacioni mbështetës mbi përcaktimin e nevojave etj. janë mbledhur, përpunuar dhe hartuar nga Grupi i Punës i emëruar me Urdhrin Nr. 373, datë 16.06.2020, Nr. 2855 Prot, datë 16.06.2020 të Titullarit të Autoritetit Kontraktori përbërë nga : J.J, F. S dhe O. Dh , janë përcjellë përmes Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes

Sociale me shkresat Nr. Prot. 2855/14, datë 08.07.2020 ñDërgohet lista, specifikimet teknike, sasitë dhe përllogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt ñF.V Pajisje mjekësore për Covid-19 dhe të tjeraò për zërin ñF.V Pajisje mjekësore për COVID-19ò dhe Nr. Prot. 2855/16 datë 09.07.2020 ñ Për një ndryshim në materialin e grupit të punës për përcjelljen e listës, specifikimet teknike, sasive dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt ñF.V Pajisje mjekësore për Covid-19 dhe të tjeraò për zërin ñF.V Pajisje mjekësore për COVID-19ò. Për specifikimet teknike grupi i punës iu referua procedurës së ngjashme të zhvilluar nga QSUT në vitin 2018, si dhe procedurë së zhvilluar nga Banka Botërore, për fondin limit Ak testoi tregun. Lloji i Procedurë ñProcedurë e hapurò fondi limit në vlerën 144,349,418 lekë pa tvsh.

Pas publikimit te DST ne SPE me date 14.07.2020, per proceduren e prokurimit **janë** paraqitur keto ankesa:

Ankesa e OE ñH...&L...ò Shpk me nr. prot. 3352/3, date 17.07.2020 me shkresen nr. prot. 3352/4, date 20.07.2020 eshte pezullimi i kesaj procedure prokurimi dhe me shkresen nr. prot. 3352/11, date 03.08.2020i eshte kthyer pergjigje OE ku i thuhet se i pranohet pjeserisht ankesa.

Ankesa e OE ñB.. E..ò Shpk me nr. prot. 3352/5, date 20.07.2020 me shkresen nr. prot. 3352/8, date 21.07.2020 eshte pezullimi i kesaj procedure prokurimi dhe me shkresen nr. prot. 3352/13, date 03.08.2020i eshte kthyer pergjigje OE ku i thuhet se i pranohet pjeserisht ankesa.

Ankesa e OE ñM...ò Shpk me nr. prot. 3352/6, date 20.07.2020 me shkresen nr. prot. 3352/7, date 21.07.2020 eshte pezullimi i kesaj procedure prokurimi dhe me shkresen nr. prot. 3352/15, date 03.08.2020i eshte kthyer pergjigje OE ku i thuhet se i pranohet pjeserisht ankesa.

Ankesat jane shqyrtuar nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës, i cili ishte Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të kësaj procedure prokurimi, i përbërë nga:

1. F. B - Kryetar
2. Ing. L. P - Anëtar (specialist fushe)
3. L. A - Anëtar (jurist)

Autoriteti kontraktor ka pranuar pjeserisht ankesat e OE ankimues.

Modifikime në DST shkresa nr. prot. 3352/16, date 05.08.2020.

Më datën 03.08.2020, OE ñB.. E..ò Shpk është ankuar në KPP duke kërkuar modifikimin e dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi.

KPP me vendimin nr. 341/2020 date 28.08.2020protokolluar në MSHMS me nr. 3352/22 Prot., datë 31.08.2020, ka vendosur :

1Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik ñB.. E..ò sh.p.k për procedurën e prokurimit ñProcedurë e hapurò me Nr. REF-65281-07-13-2020 dhe objekt " F.V Pajisje mjekesore-Rezonancë magnetike (MRI)", me fond limit 144.349.418 lekë pa TVSH, parashikuar për tôı zhvilluar në datën 06.08.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Autoriteti kontraktor të bëjë sqarimet dhe modifikimet përkatëse në SPE në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.....

AK më datë 01.09.2020 modifikoi DST sipas vendimit te KPP-së.

Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

KVO është përcaktuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor me urdhërin Nr. 411/1 datë 13.07.2020 me nr. 3352/1 prot., datë 13.07.2020, me përbërje si më poshtë:

1. F. B
2. Ing. L.Pic
3. L. A

KVO verifikoi dhe vlerësoi dokumentacionin dhe ofertat e paraqitura në sistem nga operatorët ekonomike pjesëmarrës:

1. A... shpk- me ofertë ekonomike 122,000,000 lekë pa tvsh.
2. M...shpk - me ofertë ekonomike 109,890,000 lekë pa tvsh.
3. H... and L.. shpk - me ofertë ekonomike 97,100,000 lekë pa tvsh.
4. M.. shpk ï me ofertë ekonomike 129,600,000 lekë pa tvsh.

5. B.. E... me ofertë ekonomike 98,580,000 lekë pa tvsh.

Pas vlerësimit nga komisioni u konstatua se operatori me ofertë të vlefshme dhe çmim më të ulët është operatori H..and L.. shpk me vlerë oferte 97,100,000 lekë pa tvsh.
Pranë Autoritetit Kontraktor, eshte paraqitur ankesa ne lidhje me procesin e vleresimit nga Operatori Ekonomik si me poshte:Ankesa nr. prot., 3352/26 date 05.10.2020 e operatorit ekonomik M.. Shpk. me objekt kundërshtimin e vendimit të KVO-së, procedura u pezullua me shkresen nr. prot., 3352/28 date 08.10.2020 dhe u ngrit KSHA per shqyrtimin e ankeses. Në datën 09.10.2020 me shkresën Nr.3352/30 prot., OE ñM..ò ka marrë dijeni lidhur me mospranimin e ankesës nga AK.

Lidhja dhe zbatimi i kontratës
Është lidhur kontrata me nr.3352/34, datë 30.10.2020 midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Operatorit Ekonomik H.. & L.. sh.p.k me vlerë 97,100,000 lekë pa tvsh, dhe Afati i kontratës dhe lëvrimi pika I.2 brenda 60 ditëve nga data e lidhjes së kontratës , ose mund të zgjatet në rast se institucioni nuk mund të përgatisë ambientin për instalim brenda afatit të kërkuar, sipas kërkesave dhe në dokumentat standarte të tenderit
Me shkresën nr. 3352/36, datë 06.11.2020, MSHMS i ka dërguar për zbatimin kontratën me objekt ñF.V. pajisje mjekesore ï Rezonancë magnetike (MRI)ò, autoritetit përfitues Spitalit të Korçës, gjithashtu me shkresën nr.5757, datë 30.12.2020, i ka dërguar dhe një shkresë Spitalit të Korçës lidhur me afatin e përfundimit të përgatitjes së ambientit ku do të instalohet pajisje Rezonancë Magnetike.
Spitali i Korçës me shkresën nr.23, datë 06.01.2021 , citon se ambjentet ku do të instalohet pajisja do të jenë gati në datat 10-15 Prill të vitit 2021.
Me shkresën nr.3352/37, datë 13.01.2021 është bërë një amendim kontrate me objekt ñF.V. pajisje mjekesore ï Rezonancë magnetike (MRI)ò lidhur me mënyrën e pagesës :
-Pagesa e mallrave do të kryeht me LC nga Blerësi (sipas miratimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.24269/1, datë 31.12.2020), brenda 30 ditëve nga dita e marrjes në dorëzim të mallit nga AK.
Nga auditimi konstatohet se kontrata nuk është ekzekutuar dhe pagesa nuk është bërë ende, pasi Spitali Rajonal **nuk** ka mundur të sigurojë në kohë përshtatjen e ambjenteve për vendosjen e kësaj pajisje. Nga informacioni i marrë ambjentet mund të përfundojnë brenda muajit maj.
Ministria e Shëndetësisë si Autoritet Kontraktor duhet të kishte marrë masa në bashkëpunim me Njësitë e Vartësisë për të siguruar në kohë ambjentet ku do të vendosej kjo pajisje në mënyrë të tillë që të pacientët e Rajonit të Korcës të mernin shërbimin e duhur në kohën e duhur për shkak të situatës Covid dhe problemeve të tjera.

ZBATIMI I PUNIMEVE

Në zbatim të pikës 5/b të Programit të Auditimit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bazë të Programit të Auditimit, u krye auditimi i procesit të zbatimit të punimeve në objektin:

1. "*Rikonstruksioni i Shërbimit të Reanimacionit të Spitalit Rajonal Vlorë*"

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2089/9 prot datë 07.08.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të përfaqësuar nga Titullari zj. G. P dhe Operatori Ekonomik ñ2.. K..ò SHPK, me përfaqësues ligjor z. Z. Z, me licencë profesionale NZ 2407/12. Vlera e kontratës është 49,736,034 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 60 ditë nga data e nënshkrimit të procesverbalit të fillimit të punimeve.
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr 2089/10 prot, datë 07.08.2020, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE ñI..-1..ò SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3331/2, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 811,630 lekë me tvsh.
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr 2089/29 prot, datë 25.11.2020, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE ñK.. C..ò SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje

kolaudim punimesh MK. 3596, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 49,920 lekë me tvsh.
Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, me shkresën nr. 481 prot., datë 20.08.2020 të MSHMS, protokolluar me nr.2089/13, datë 20.08.2020, është ngritur grupi i punës me përbërje: Inxhiniere A. F , Oksigjenist S. M , Elektricist A. R , Jurist O. J , Financiere J . Ll , Përgjegjës i zyrës teknike E. Q.

Projektpreventivi
Projektpreventivi i objektit është hartuar nga shoqëria ñ6..-P..ò SHPK, në qershor 2018.

Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 10.08.2020. Punimet duhet të përfundonin ne datën 09.10.2020 dhe kanë përfunduar me datë 08.10.2019, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.
Në bazë të relacionit teknik shpjegues mbi preventivin e përmirësuar, është bërë bërë procesverbali dhe tabela e +/- së volumeve të punimeve, në të cilën janë shtuar punime në vlerën 13,871,513 lekë me TVSH dhe janë pakësuar punime në vlerën 13,872,227 lekë më TVSH.
Nga krahasimi i ofertës ekonomike me situacioni përfundimtar të punimeve, rezulton të ketë diferenca të mëdha në volume, si dhe 6 zëra të rinj pune. Administrohet procesverbali i negociimit të zërave të rinj të punës, i cili është miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Nga auditimi i analizave të çmimeve të zërave të rinj, rezulton se hartimi i tyre nuk është bërë konform Manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Kështu, në analizat e çmimeve për zërat e punës ñPrishje mur gipsi t=10 cmò dhe ñPrishje tavan i varur gipsi 60 x 60 cmò janë vendosur në mënyrë të pajustifikuar në nënzërin material, përkatësisht 1652 lekë/m^2 (2 copë x 700 lekë x 1.18 (10% sh.p. + 8% fitim) në zërin ñPrishje mur gipsi t=10 cmò dhe 1841 lekë/m^2 (2 copë x 780 lekë x 1.18 (10% sh.p. + 8% fitim) në zërin ñPrishje tavan i varur gipsi 60 x 60 cmò. Në hartimin e analizës teknike të zërit ñLiloleum PVC (Për spitale)ò, nuk ka testim tregu për nënzërin ñmaterialò, i cili në analizë rezulton të ketë çmimin 4264 lekë/m^2.
Gjithashtu, nga verifikimi i punimeve në terren, rezulton se zërat e punës së kapitullit ñImpianti i kondicionimitò, ñ2. Pajisje e brendshme dysheme, ftohje/ngrohje 1.7/2.0 kW, sasia e ajrit max/min: 370/500 m^3/hò, ñ3. F. Pajisje e brendshme dysheme, ftohje/ngrohje 2.8/3.0 kW, sasia e ajrit max/min: 420/560 m^3/hò, ñ4. F. Pajisje e brendshme dysheme, ftohje/ngrohje 3.2/4.0 kË, sasia e ajrit max/min: 670/420 m^3/hò dhe ñ5. F. Pajisje e brendshme dysheme, ftohje/ngrohje 5.4/6.3 kW, sasia e ajrit max/min: 670/420 m^3/hò, nuk janë realizuar sipas emërtimit, por janë vendosur pajisje tavanore. Këto janë zëra të rinj pune dhe për pasojë duhet të bëhej negociimi i çmimeve.
Këto veprime janë në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.05.2005 ñPër zbatimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar, KreuII, pika 8.3, sipas të cilës ñ*Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë*ò dhe ngarkon me përgjegjësi Mbikëqyrësin e punimeve.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1) Projektpreventivi,
2) Projekti i azhurnuar,
3) Situacioni përfundimtar,
4) Libri i masave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

14.Lidhja e kontratës nr. 2089/9 prot datë 07.08.2020	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 49,736,034 lekë **OE fitues "2.. K...." SHPK**		**16.Likuiduar deri dt**	
17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera me tvsh 49,735,301 lekë** **-Vlera pa tvsh 41,446,084 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 60 ditë, Zbatuar 60 ditë. Fillimi punimeve: 10.08.2020 Perfundimi punimeve: 08.10.2020		**19. Zgjatja e kontratës** Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "I..-1 " SHPK	Licenca Nr: MK 3331/2	Kontrata me nr. 2089/10 prot, datë 07.08.2020		
21. Kolaudatori i punimeve OE "K.. C.." SHPK	Licenca Nr: MK 3596	Kontrata me nr 2089/29 prot, datë 25.11.2020		
22.Akt Kolaudimi datë 28.11.2020	**23.Akt i marrjes në dorëzim** datë 28.11.2020			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **2,349,902 lekë pa tvsh**.

Tabela nr. 1

Titulli i Gjetjes :	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin ñRikonstruksioni i shërbimit të reanimacionit të Spitalit Rajonal Vlorëò, nga zbatuesi i punimeve OE ñ2.. K..ò SHPK, për zërat e punimeve 1.7, 1.9, 2.5, 2.7, 4.4, 5.4, 5.6, 5.17 dhe 4.5.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës ñPrishje mur gipsi t=10 cm, çmimiò, ñPrishje tavan i varur gipsi 60 x 60 cm, çmimiò, ñGrila d/alumini me roleò, ñVetratë xhami e temperuarò, ñInstalimi i linjave të bakrit + linjat e kondesatitò, ñFV ndriçues emergjence evakuimi (Exit)ò, etj., për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2089/9 prot datë 07.08.2020. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2089/10 prot, datë 07.08.2020. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 2089/29 prot, datë 25.11.2020.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e MSHMS.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga MSHMS të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 2,349,902 lekë pa tvsh nga OE ñ2.. K..ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2089/9

	prot datë 07.08.2020 me ñRikonstruksioni i shërbimit të Reanimacionit të Spitalit Rajonal Vlorëò, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Sa më sipër, është trajtuar me detaje në aktkonstatimin nr. 10, datë 30.04.2021.

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 01 prot., datë 10.05.2021 është observuar nga mbikëqyrësi i punimeve, shoqëria ñI..-1..ò SHPK si dhe observimet dërguar nga MSHMS në lidhje mbi Projekt raportin e përcjellë nga KLSH me shkresë nr.121/10 prot datë 03.09.2021, të cilat kanë ardhur më datë 14.10.2021 jashtë afatit kohor të parashikuar në ligjin 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit neni 26 dhe 29ô me shkresë nr.415/47 prot të MSHMS dhe me nr.121/11 prot datë 14.10.2021 të KLSH.
Sa më sipër, audituesit e KLSH , i ri vlerësuan dhe observimet e dyta, të cilat nuk kanë paraqitur dokumentacion shtesë apo argumentim ligjor shtesë në lidhje mbi problematikën e konstatuar, për këtë qëllim, audituesit shprehen me të njëjtin qëndrim, si vijon:
1.Analizat e Çmimeve – Zeri An-01 dhe An-02, sipas audituesit jane vendosur në mënyrë të pajustifikueshme në nënzërin material përkatësisht **1652 leke /m2** dhe **1841 leke /m2.**
Konstestim-Nisur nga manuali i punimeve të ndërtimit, i pasqyruar dhe në legjislacionin e manualit të ndërtimit Manuali Nr.2 ï Vkm.629, 15.07.2015, zëri i ri i punimeve ñPrishje mur gipsi t=10 cmò dhe ñPrishje tavan i varur gipsi 60x60mmò **nuk janë të përfshira dhe teknikisht kryhet analiza teknike e cmimit.**
AN-01- Prishje mur gipsi t=10 cm - Në këtë analiza, refereuar manualit të ndertimit kostifikimi i zërit është kryer në analogji me zërat e ndërtimit, duke qenë se janë procese të ngjashme pune.
Nisur nga analiza **2.297/b – Veshje muri me kartonxhes**, është e perfshirë në analizë materialet ndihmese te **Të ndryshme 2%**

2.297/b	**Veshje muri me kartonxhes**	**m2**										
	Sp + p	op	1.5	185	278							
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	277.5	0.167	46							
	Transport	T*km				1.20	21	25.2				
	Kartonxhes cimentato	m2							1.05	2800	2940	
	K/metalike	kg							3.7	102	377	
	Rrjete + stukime	m2							0.15	130	20	
	Skele inventar	m2							1.2	192	230	
	Te ndryshme 2 %	**leke**							**3190**	**2%**	**64**	
	Shuma :				**324**			**25.2**			**3631**	**3980**

Pra nënzëri ñTë ndryshmeò (që në tabelë është e qartë që ka të përfshirë nënzërin ñmaterialeò) është një elementë i pashmangshëm kostifikimi si dhe në KTZ.
Bashkangjitur analizat e cmimeve (AN 01 fq 1 ne kolonën emërtimi nënrreshti 5)
AN-02- Prishje tavan i varur gipsi 60x60mm -Ne kete analize refereuar manualit te ndertimit kostifikimi i zerit eshte kryer ne analogji me zerat e ndertimi duke qene se jane procese te ngjashme pune **.**
Nisur nga analiza **2.297/b – Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm** eshte e perfshire ne analize materialet ndihmese te **Te ndryshme 2%**.

2.297 /b	**Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm**	**m2**													
	Sp + p	op	1.09	185	202										

	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	201.7	0.167	34										
	Transport	T*km				0.05	21	1.05							
	Pllaka gipsi 60x60cm + akses	m2							1.02	1200	1224				
	Korrnize dekorative gips	ml							0.8	200	160				
	Skele inventar	m2							1.2	130	156				
	Te ndryshme 2 %	**leke**							**1540**	**2%**	**31**				
	Shuma:				**235**			**1.05**			**1571**	**1807**	145	181	**2132**

Pra, në rrjedhën analogjike, në çdo zë të manualit, ku ka ndërtim, ka të përfshirë edhe nënzërin ñTë ndryshmeò me nje përqindje të caktuar, ku llogaritet cdo gjë e nevojshme për realizimin e punës.
Edhe ne zërin prishje të murit apo ne tavanin e varur është shprehur qartë parimisht kostifikimi i zërave të punës ku zëri ñTë ndryshmeò është i përcaktuar si zë i rëndësishë në një proces pune, qoftë ndërtim apo prishje.
Ky zë ñTë ndryshmeò, në analizën e çmimit ka nënzërin ñmaterialeò si domosdoshmëri per realizimin e punës, ku është e qartë që janë të përfshira mjetet apo materialet e duhura.
KTZ në çdo punim prishje, ashtu si dhe në zërin Ndertim, ka punime te paparashikuara të cilat kërkojne gjithmonë shtesë në volum pune apo ne materaile ndihmëse. Konkretisht, në zërin ñPrishje mure, tavane të murit te Gipsitò, në mes të sallës së Reancimacionit, ku mbaronte kolona elektrike kryesore, ku ishin dhe punimet e tubave të oksigjenit dhe tubacionet hidraulike të cilat kalonin në këtë tavan gipsi, kërkojnë domosdoshmërisht materiale të paparashikuara gjatë prishjes, të cilat janë kategorizuar në nënzërin **"Të ndryshme" 2 %**
Referuar analizes se Manualit nr .2 **2.297/b , Veshje muri kartonxhes me çmim ne manual 4697 leke pa tvsh**, i ulur sipas % se tenderit është **4650 leke pa tvsh**. Nëse ne mendojmë që analiza nuk duhet të përfshije nënzerin të ndryshme 2% , atehere dëmi ekonomik llogaritet bazuar në manualin e punimeve të ndërtimit, ku për prishjen e punimeve të zërave të tjerë, merren normat e kohës së punës së miratuar ose me perafërsi merret **60% e punëtorisë së ndertimit të ri.**
Konkretisht kemi këto llogaritje :

	veshje muri kartonxhes				
	4650				
	2,940	zbritet material kartonxhes			**2000.00**
324	194.40	zbritet 60% punetoria			1,515.60
	1,515.60			**Diferenca**	484.40
			siperfaqja	186.70*484.40=	**90,437**

	tavan kartonxhes				

	5000.00				**2200**
	2,940	zbritet material kartonxhes			1,606.40
756	453.60	zbritet 60% punetoria			593.60
				Diferenca	
	1,606.40		**siperfaqja**	520.02*593.60=	**308,685**

Në Total diferenca 90,437 + 308,685 = 399,122. Lekë pa TVSH

Pretendimi juaj nuk qendron.

Opinioni i grupit të auditimit:
1. Grupi i auditimit, edhe gjatë ballafaqimit në subjekt me mbikëqyrësin e punimeve, për zërat e punës të mësipërm, të trajtuar si zëra pune me çmim të bërë jo konform Manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015, ka paraqitur si argument zërat e ngjashëm të manualit të çmimeve, me numër analize 2.426, 2.426/1, 2.426/2, etj., ñPrishje mur tulle pa pastrimò, ñPrishje mur tulle me pastrimò, ñPrishje mur me blloqe betoniò, etj., në të cilat ka vetëm nënzërat ñPunëtoriò dhe ñTransportò dhe jo nënzërin ñmaterialò. Përsa sipër, pretendimet e ardhura nëpërmjet observacionit, nuk merren në konsideratë.
2. Është pretenduar nga ana e Audituesit se në kapitullin **Impianti i Kondicionimit , zëri në preventinv 2,3,4,5 nuk jane realizuar sipas emërtimit, por janë vendosur pajisje tavanore.**

2	An 51	F. Pajisje e brendshme dysheme, ftohje/ngrohje 1.7/2.0 kË, sasia e ajrit max/min: 370/500 m3/h
3	A 51	F. Pajisje e brendshme dysheme, ftohje/ngrohje 2.8/3.0 kË, sasia e ajrit max/min: 420/560 m3/h
4	An 52	F. Pajisje e brendshme dysheme, ftohje/ngrohje 3.2/4.0 kË, sasia e ajrit max/min: 670/420 m3/h
5	A 52	F. Pajisje e brendshme dysheme, ftohje/ngrohje 5.4/6.3 kË, sasia e ajrit max/min: 670/420 m3/h

Konstestim- Hapësira e ambientit në sallën e reanimacionit si dhe pajisjet e shumta që ndodhen në këtë sallë, si : krevatet e pacientëve , barrelat lëvizëse , gazi mjekesor , fikset e zjarrit , komodinat , thirrja e infermierit, pajisjet mjekësore bëjnë të pamundur vendosjen e pajisjeve të brëndëshme në dysheme .
Barrelat lëvizëse, stafi mjekësor në sallën e reanimacionit kanë të nevojshme hapësirën lëvizëse dhe jopenguese, për këtë arsye është propozuar nga ana e Grupit të punës, Kontraktuesit dhe me miratim të Supervizorit, kalimi i tubacioneve te kondicionimit me kaseta tavanore .
Punimet tavanore kanë kosto më të lartë punimi për kontraktuesin, por nuk është bërë asnjë marrëveshje për ndryshim të çmimit, duke qenë se AK në këtë rast është palë përfituese dhe ky punime është realizuar me të njëjtën kosto si në preventivin fitues të punimeve, duke mos përfituar një kosto më të lartë të zbatimit të punimeve, por kryerjen e tyre pa qënë e nevojshme negocimin e çmimeve.
.....
Bazuar ne Manualin **Nr.2 – Vkm.629, 15.07.2015 , Analiza 2.297/a**
Më poshtë keni një analizë çmimi pikërisht për këtë zë, ku duket qartë që çmimi i tavanorëve është më i lartë.
Pra, në asnjë rast nuk ka dëm ekonomik të shkaktuar nga ky ndryshim i projektit.
...
Opinioni i grupit të auditimit:
2. Në aktkonstatimin e bërë nga ana jonë, për gjetjen e mësipërme, është cituar që këto zëra pune janë zëra të rinj pune (ashtu siç citohet edhe në observacion) dhe për pasojë duhet të bëhej negociimi i çmimeve, pa përmendur në asnjë moment dëmin ekonomik. Për pasojë ky pretendim nuk merret në konsideratë.

3. Zëri - Vetratë xhami e temperuar - është pretenduar nga ana e Audituesit se ka diferenca volumesh në këtë zë punimesh .
Konstestim- Sipas librezës se matjeve për këtë zë punimesh, nga verifikimi i librit të masave, vizatimeve sipas faktit, dhe verifikimit të përbashkët në terren, të reflektuara ndarjet me xham të temperuar janë 9 copë me permasa 2.60

*2.25 , por duam të qartesojme se një copë nga gjithsej 9 (nëntë) e këtyre vetratave është dëmtuar pas marrjes në dorëzim, gjë që e cila do të zëvendësohet gjatë garancisë së punimeve.
Per kete eshte mbajtur dhe proces verbali me date 22.09.2020 i mbajtur nga Grupi punës MSHMS.
Pretendimi juaj nuk qendron.
Opinioni i grupit të auditimit:
3. Grupi i auditimit nuk arrin të kuptojë se si nuk qëndron pretendimi i tij, kur në observacion pranohet që, një nga nëntë copët e situacionuar të xhamit të temperuar, nuk ekziston. Ky pretendim nuk merret në konsideratë.
4 - Është pretenduar nga ana e Audituesit se në kapitullin **Impianti i Kondicionimit , zëri nr.17 "Instalimi i linjave te bakrit + linjat e kondestatit"** kanë diferenca në volume.
Konstestim- Instalimi i linjave te bakrit + linjat e kondestatit si proçes pune, njesia matëse është në ML, ndërsa nga ana e projektuesit është kryer një lapsus, duke vënë njësinë matëse në copë, gjë e cila bie në kundërshtim me logjikën e llojit të materialit, pasi linja e bakrit dhe kondesatit janë të shprehura dhe njësia e tyre është në ML
Pra, është gabimi njerëzor që krijon opinionin që ka diferenca në volume. Emërtimi linjë e tregon qartë njësinë matëse, vetë elementi tub bakri tregon gjatësi dhe jo copë.
Pretendimi juaj nuk qendron.
Opinioni i grupit të auditimit:
4. Grupi i auditimit, edhe gjatë ballafaqimit në subjekt me mbikëqyrësin e punimeve, këtë zë pune (me çmim 7500 lekë/copë) e ka trajtuar si zë që ka të bëjë me set punimesh për çdo kasetë tavanore. Observuesi duhet që ñlapsusinò ta kishte kapur gjatë zbatimit të punimeve dhe ta reflektonte tek preventivi i ndryshuar, duke bërë edhe një analizë të re çmimi dhe duke ja paraqitur atë Autoritetit Kontraktor. Përsa sipër, pretendimet e ardhura nëpërmjet observacionit, nuk merren në konsideratë.
5 - Është pretenduar nga ana e Audituesit se në kapitullin **4. Sistemi i Ndricimit Normal, Emergjences dhe Exvakuimit EXIT**, Zeri nr. **4.5 "F.V. Ndricuesa emergjence evakuimi (EXIT), rezistent ndaj zjarrit, IP40, IK07, LED 8Ë, 100 000 ore pune, bat. NiCd me autonomi 3 ore, 230V, 50Hz"** kanë diferenca në volume .
Konstestim-Sipas fotove bashkëngjitur ju ilustrojmë, se tabelat EXIT janë të vendosura në objekt.
Pretendimi juaj nuk qëndron.
Bazuar në faktet e lartpërmendura, ne nuk jemi dakort që vlera e ketyre volumeve është marrë padrejtësisht nga sipërmarrësi, sepse këto punime janë realizuar plotësisht.
Per sa më sipër **Ju kundërshtojmë**, objekti është i azhornuar sipas faktit nga inxhinieri gjeodet pranë sipërmarrësit të punimeve, shoqërise **"2..K..." Shpk**.

Opinioni i grupit të auditimit:
5. Grupi i auditimit, ka bërë verifikimin në terren, sipas librit të masave dhe ka rezultuar se numri i tabelave ñEXITò të vendosura ka qenë 11. Nëse pretendohet edhe për tabelat, që sipas fotove që shoqërojnë observacionin, rezultojnë të jenë përtokë, nga grupi i auditimit, nuk merret në konsideratë.



Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 2,349,902 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1) Znj. I. S, në cilësinë e mbikëqyrësit të kontratës së sipërmarrjes;
2) Z. I. Anë cilësinë e kolaudatorit të punimeve të përfunduara;
3) Znj. A. F, z. S. M , z. A. R dhe znj. E. Q , në cilësinë e anëtarëve të grupit të marrjes në dorëzim, si specialistë të fushës.

Vlera prej 2,349,902lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të MSHMS.

2. *"Loti I, Rikonstruksione të QSH-ve në qarqet Tiranë, Durrës, Dibër (viti 2020)"*

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1076/72 prot datë 13.08.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të përfaqësuar nga Titullari zj. G. P dhe Operatori Ekonomik ñA.. K..ò SHPK, me përfaqësues ligjor z. A. J, me licencë profesionale NZ 3558/10. Vlera e kontratës është 112,211,676 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 161 ditë nga data e nënshkrimit të procesverbalit të fillimit të punimeve (për objektin e parë).

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr 2769/13 prot, datë 14.08.2020, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE ñD ..ò SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1676/6, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 1,184,646 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr 592/1 prot, datë 01.02.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE ñI..-1..ò SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3331/2, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 811,630 lekë me tvsh., si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 49,920 lekë me tvsh.

Projektpreventivi

Në dosje nuk administrohen deklaratat e punimeve të nënobjekteve.

Projektpreventivi i objektit është hartuar në vitin 2015 nga shoqëri të ndryshme projektuese.

Për objektet e këtij loti, është bërë kontratë për rishikim projektesh ndërmjet MSHMS dhe OE ñT....ò SHPK me Nr. Prot 180/19, datë 18.03.2019 dhe marrëveshje me Universitetin Politeknik të Tiranës, mbështetur në VKM nr. 188, datë 13.03.2019 ñPër ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për instirucionet e qeverisë vendore dhe institucionet në varësi të tyre.

Zbatimi i punimeve

Nga auditimi i dosjes teknike rezultoi se me këtë kontratë janë bërë rikonstruksione në 23 nënobjekte, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 1

Nr.	EMËRTIMI I QENDRËS SHËNDETËSORE/AMB	Bashkia/Njësia administrative	Projekte të rishikuara	Vlera ë Lekë
3	**QARKU DIBER**			**12,323,198**
1	QSH Macukull	Mat/Macukull	U..	3,555,864
2	QSH Brezhdan	Dibër/Tomin	T..	5,120,057
3	Rikonst. Ambul. Lagjja Qyteti Ri Bulqize	Bulqizë	T..	3,647,277
8	**QARKU DURRES**			**25,717,534**
1	QSH.10 (Kënetë 1)	Durrës	U..	2,835,762
2	QSH Fshat Manëz	Durrës	U..	2,401,572

3	Q.SH. nr 3 Durrës	Durrës	U..	3,061,493
4	Q.SH. Fshati Sukth	Durrës/Katund i ri	T..	4,866,721
5	QSH Fshati Tapizë	Krujë/ Nikël	T..	2,825,607
6	Ambulanca Larushk	Krujë/ Fushe Krujë	T..	3,077,133
7	Ambulanca Berbere	Krujë/Krujë	T..	2,414,435
8	Ambulanca Bushnesh	Krujë/ Thumanë	Té	4,234,811
12	**QARKU TIRANE**			**74,170,943**
1	**Rikonstruksion I godines se SOB Tirane**	**Tiranë**	**U..**	**22,412,436**
2	Ambulanca Vaqarr	Tiranë	U..	2,851,437
3	Q.SH.Mjull Bathore/Sauk (Farke)	Tiranë/Nj. Adm. Nr. 2	Ué	381,828
4	Ambulanca Dritas	Tiranë/Zallher	U..	2,992,244
5	Ambulanca Surrel	Tiranë/Komuna Dajt	U..	2,142,186
6	Ambulanca Pinet	Tiranë/Ndroq	Ué	1,919,636
7	Ambulanca Pezë e Vogël	Tiranë/Pezë	Té	2,111,451
8	QSH Krrabe	Tiranë/Krrabë	Té	5,461,784
9	QSH Zall Bastar	Tiranë/Zall Bastar	Té	7,823,313
10	Rikonstruksion ambulance Kashar -2	Tiranë/Kashar	Té	2,795,862
11	**Rikonstruksion I QSH në Synej**	**Kavajë/Synej**	**T….**	**8,590,914**
12	**Rikonstruksion I Q.SH Rrogozhine**	**Rrogozhinë**	**T…**	**14,687,852**
	TOTALE			**112,211,675**

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dher Mbrojrjes Sociale

Nisur nga vlerera e këtyre nënobjekteve janë përzgjedhur për auditim tre objekte me vlerë më të madhe dhe konkretisht:
1. Rikonstruksion i godinës se SOB, Tiranë;
2. Rikonstruksion i Q.SH. në Rrogozhinë;
3.Rikonstruksion i QSH. në Synej.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 31.08.2020. Punimet duhet të përfundonin ne datën 10.02.2021 dhe kanë përfunduar me datë 09.02.2021, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.
Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1) Projektpreventivi
2) Projekti i azhurnuar
3) Situacioni përfundimtar
4) Libri i masave etj.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Loti I, Rikonstruksione të QSH-ve në qarqet Tiranë, Durrës, Dibër (viti 2020)"		
14.Lidhja e kontratës nr. 1076/72 prot datë 13.08.2020	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 112,211,676 lekë **OE fitues "A... K..." SHPK**	**16.Likuiduar deri dt**
17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera me tvsh** **-Vlera pa tvsh**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 161 ditë, Zbatuar 160 ditë. Fillimi punimeve: 31.08.2021 Perfundimi punimeve: 09.02.2021	**19. Zgjatja e kontratës** Nuk ka

20. **Mbikëqyrësi i punimeve** OE ñD... SHPK	Licenca Nr: MK 1676/6	Kontrata me nr. 2769/13 prot, datë 14.08.2020		
21. **Kolaudatori i punimeve** OE ñIN...-1..ò SHPK	Licenca Nr: MK 3331/2	Kontrata me nr 592/1 prot, datë 01.02.2021		
22.Akt Kolaudimi datë 11.03.2021	**23**.**Akt i marrjes në dorëzim** datë 15.03.2021			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,373,684 lekë pa tvsh**.

Titulli i Gjetjes :	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin ñLoti I, Rikonstruksione të QSH-ve në qarqet Tiranë, Durrës, Dibër (viti 2020)ò, nga zbatuesi i punimeve OE ñA.. K...ò SHPK.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës ñThemel e xokol butobetoni C-12/15ò, ñVeshje fasade me polisterol,kompakt jeshil t=5 cm + rrjete + suvaò, ñVeshje me pllaka majolike në ËC dhe lavamanëò, ñFV dyer të blinduara importiò, etj., për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1076/72 prot datë 13.08.2020. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2769/13 prot, datë 14.08.2020. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 592/1 prot, datë 01.02.2021.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e MSHMS.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga MSHMS të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,373,684 lekë pa tvsh nga OE ñA.. K....ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1076/72 prot datë 13.08.2020 me ñLoti I, Rikonstruksione të QSH-ve në qarqet Tiranë, Durrës, Dibër (viti 2020)ò, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 1,373,684 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1) Z. V. T, në cilësinë e mbikëqyrësit të kontratës së sipërmarrjes;
2) Z. R. A., në cilësinë e kolaudatorit të punimeve të përfunduara;

Sa më sipër, është trajtuar me detaje në aktkonstatimin nr. 15, datë 18.05.2020, për të cilin nuk ka

pasur observacion.

III.7. MBI REALIZIMIN E PROCEDURËS DHE MONITORIMI PËR KONTRATËN E PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT "PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE LABORATORIKE MJEKËSORE"

Shënim: Në materialin e Raportit Përfundimtar të Auditimit në subjektin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është bashkuar dhe materiali i auditimit të realizimit të procedurës *për "Koncesionin/partneritetin publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës e Lushnjës*", audituar në bazë të Programit të Auditimit nr.359/1 datë 24.04.2020, përcjellë Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr.359/3 prot datë 28.07.2020, protokolluar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr.1819/22 prot datë 29.07.2020.

***A). Auditimi i procedurës për "Koncesionin/partneritetin publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës e Lushnjës"* .**

Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 417, dt. 02.10.2015 ñ*Për ngritjen e komisionit të dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës*ò i ndryshuar me urdhrin nr. 298, dt. 14.07.2016 dhe nr. 976/2, dt. 14.07.2016 me përbërje:
1.R.C Kryetar, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve, Investimeve & Koncesioneve, Ministria e Shëndetësisë,
2.S.N anëtar, Përgjegjëse, Sektori i Standardeve dhe Protokolleve Spitalore, Drejtoria e Administrimit Spitalor, Ministria e Shëndetësisë.
3.L.H anëtar, Përgjegjëse, Sektori i Programimit dhe Monitorimit Buxhetit, Drejtoria Ekonomike, FSDKSH.
4.A.Kr anëtar, Mjeke ordinatore në Laboratorin Biokimik, Qendra Spitalore Universitare ñNënë Terezaò tiranë.
5.A.A anëtare, Përgjegjëse Sektori i Prokurimeve, Drejtorisë së prokurimeve, Investimeve & Koncesioneve, Ministria e Shëndetësisë.
6.G.V anëtar, Ekonomist ATRAKO.
7.A.A anëtar, Ekonomiste ATRAKO.
8.L. Q përfaqësuese e IFC.
Detyrat e përcaktuara janë:

Të marrë pjesë në përgatitjen e studimit të fizibilitetit të koncesionit/partneritetit publik privat;
Të marrë pjesë në përllogaritjen e vlerës së kontratës .....;
Të marrë pjesë në përgatitjen e dokumenteve standarde .....;
Të aprovojë studimin e fizibilitetit .....

Me urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm z. A. Ç me nr. 52, dt. 13.12.2016 ku kërkohet nga Drejtoria e Financës për të përcjellë njoftimin e kontratës për ñ*Koncesionin/partneritetin publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës e Lushnjës*ò në gazetën ndërkombëtare ñ*Financial Times*ò në datën 21.12.2016.
Gazeta ñ*Financial Times*ò ka botuar njoftimin në datën 21.12.2016 dhe pagesa është kryer në datën 20.12.2016 për 2150 Pound Sterling (Conferma bankare).
Urdhri i Ministrit z. I. B nr. 552, dt. 15.12.2016 për ekzaminimet laboratorike që do të kryhen nga koncesionari sipas listës referencë e analizave laboratorike mjekësore në Shqipëri ku janë përcaktuar edhe çmimet.

Njoftimi i kontratës nr. 976/17, dt. 21.12.2016 nga Ministri i Shëndetësisë z. I. B ku përcaktohet lloji i kontratës së koncesionit shërbime me objekt ñ*financimi, rinovimi, pajisja riorganizimi dhe funksionimi i Koncesionin/partneritetin publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës e Lushnjës*ò. Forma e kontratës ñ*Partneriteti publik privat për shërbime publike*ò.
Data e hapjes së ofertave është caktuar data 15 shkurt 2017.
Vlera e kontratës (projektit) është llogaritur bazuar në mbështetjen financiare të parashikuar për zgjatjen e kontratës në vlerën **13,005,966,000 lekë** pa TVSH.
Me shkresën nr. 5813/5, dt. 26.01.2017 Sekretari i Përgjithshëm i është drejtuar Drejtorit të QSUT për të vënë në dispozicion listën e plotë me volumet përkatëse të testeve laboratorike që janë kryer në QSUT (Të ndarë sipas laboratorëve) gjatë viteve 2015 dhe 2016.

Me shkresën nr. 597/1, dt. 26.01.2017, Drejtori i QSUT ka vënë në dispozicion listën e plotë me volumet përkatëse të testeve laboratorike që janë kryer në QSUT (të ndarë sipas laboratorëve) gjatë viteve 2015 dhe 2016.
Me shkresën nr. 77/3, dt. 06.02.2017 nga Ministri i Shëndetësisë z. I.B janë modifikuar dokumentet e procedurës konkurruese për dhënien me koncesion/partneriteti publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës e Lushnjës. Është modifikuar lista e testeve në dokumente shtojca 1 (dhe shtojca 3 e Marrëveshjes së PPP) ndryshohen (Përcaktuar më parë me urdhrin e Ministrit nr. 552, dt. 15.12.2016.)
Afati i dorëzimit të ofertave është data **27 shkurt 2017** në orën 15.00.
Gjithashtu me shkresën nr. 77/4, dt. 06.02.2017 drejtuar APP nga Kryetari i Komisionit të PPP z. R. C afati i caktuar për dorëzimin e kërkesave për sqarim është shtyrë nga data 10 shkurt 2020 që ishte bëhet **20 shkurt 2017**.
Nga Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 417, dt. 02.10.2015 ñ*Për ngritjen e komisionit të dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës*ò i ndryshuar me urdhrin nr. 298, dt. 14.07.2016 dhe nr. 976/2, dt. 14.07.2016 me procesverbalet nr. **11, dt. 16.12.2016**, nr. 12, dt. 21.12.2016 dhe 13, dt. 06.02.2017 **janë modifikuar draft dokumentet standarde të koncesionit**, kriteret e kualifikimit, kriteret e veçanta të kualifikimit, kriteret e vlerësimit dhe metodologjia e vendosjes së pikëve, ku përcaktohet se ***procedura është e hapur mbi kufirin e lartë monetar dhe zhvillohet me mjete elektronike***. Afati i kontratës së koncesionit është 10 vjet duke filluar nga data e vënies në funksion (e përcaktuar në kontratën e koncesionit). Vlera e kontratës për gjithë kohëzgjatjen e kontratës është **13,005,966,000 lekë** pa TVSH. Afati i dorëzimit dhe hapjes së ofertave bëhet data **27 shkurt 2017.**

Formulari i sigurimit të ofertës nga ñAò dhe ñS.Iò nga Bashkimi i operatorëve (ñL...ò shpk ñE..ò dhe ñA.. L.. S.. B.ò) për vlerën 260,119,320 lekë si kusht për sigurimin e ofertës që i dorëzohet Ministrisë së Shëndetësisë në lidhje me projektin PPP për Laboratorët Spitalore në Shqipëri.
Marrëveshja dt. 09 shkurt 2017 e bashkimit të shoqërive ñE...ò ñL.ò shpk dhe ñA.. L.. S.. B.ò.
Në llogarinë e APP nuk del prokurimi për procedurën e laboratorëve në formatin elektronik pasi procedura nuk ka kaluar si ñ*shpallje e përfunduar*ò, në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 13, datë 28/05/2015 ñ*Për procedurat e dhënies me koncesion dhe partneritet publik privat në sistemin e prokurimit elektronik dhe dorëzimi i ofertave nga operatorët ekonomikë*ò: ñ*Në përfundim të veprimeve të mësipërme, do të shikoni që faza "Njoftimi i kontratës" është ngjyrosur me ngjyrë të gjelbër dhe në krah të saj statusi rezulton "E përfunduar". Pas kësaj, dosja e tenderit i kalon zyrtarëve të publikimit në Agjencinë e Prokurimit Publik.* ***Kujdes*** *në momentin që, nëpunësit të komisionit i dërgohet mesazh automatikisht nëpërmjet SPE për publikimin e procedurës, ky i*

*fundit duhet të bëjë menjëherë verifikimin e kalimin e kësaj procedure nga skedari "Shpallje të Papërfunduara" tek skedari "**Shpallje të Përfunduara**ò.*

Nga Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 417, dt. 02.10.2015 ñ*Për ngritjen e komisionit të dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës*ò i ndryshuar me urdhrin nr. 298, dt. 14.07.2016 dhe nr. 976/2, dt. 14.07.2016 me procesverbalin përmbledhës nr. 14, dt. 20.03.2017, ***ka vlerësuar ofertat*** për ñK*oncesionin/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës"* me këshilltar transaksioni IFC-në.

Me VKM nr.80, dt. 28.01.2015 ñ*Për miratimin, në parim të marrëveshjes së shërbimit këshillimor financiar ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare*ò.

Sqarojmë se Ministria e Shëndetësisë ka caktuar Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC), një anëtare e Grupit të Bankës Botërore, të veprojë si Këshilltari Kryesor i Transaksionit për Projektin. IFC ka marrë këshilltarë teknikë PharmAccess dhe IQLS, dhe këshilltarë ligjorë konsorciumin Gide Loyrette Nouel me Kalo & Associates, ***<u>për të mbështetur përgatitjen e studimit të fizibilitetit dhe për të ndihmuar MSH dhe IFC në përzgjedhjen e partnerit privat</u>*** që do të marrë përsipër ofrimin e shërbimeve laboratorike publike në një kontratë afat-gjatë me Qeverinë. Memorandum informacioni i përgatitur në dhjetor të vitit 2016 miratuar dhe firmosur nga Komisioni i dhënies së Koncesionit..
Në këtë mbledhje të komisionit përfaqësuesja e IFC ka kundërshtuar kualifikimin e BOE*: 1.L...SHPK (%41.7) & E.. F.. (%25) & A. L.. S... B.. (%33.3) H..*; duke ngritur dy arsye:
a.Çështje integriteti të kompanisë A...(duke iu referuar standarteve të IFC në draft kontratën e koncesionit pika 2.1 (j) ku citohet: Që në datën efektive dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes, koncesionari deklaron dhe garanton se;
1. Koncesionari 2.1 deklarimi dhe garancitë e koncesionarit; as ai, as ndonjë prej ortakëve të tij të rëndësishëm (apo në dijeninë e tij, asnjë nga personat e lidhur të tij apo personat e lidhur të tyre) nuk është subjekt i ndonjë hetimi penal për mashtrim, korrupsion, bashkëpunim të fshehtë apo pastrim parash..... etj
IFC lidhur me këtë fakt është bazuar në dy artikuj gazetash spanjolle të cilat hedhin dyshime mbi përfaqësuesin ligjor të shareholder-it të A...-së (orinoco mining&resources B.V dhe anëtarin e bordit të saj, kompaninë ITPS0 i cili, sipas këtij shtypi është në ndjekje penale në Spanjë.
Gjithashtu IFC rekomandon se UBO (ultimate beneficiary owner) i A... nuk rezulton i qartë nëse kompania është shqiptare P. shpk pavarësisht dokumenteve të paraqitura sipas tyre.
b.Çështjen e kontrollit mes kompanive ñE...ò dhe ñS...ò të cilat marrin përsipër realizimin e testeve ku sipas IFC-së ñS...ò nuk kontrollohet nga ñE...ò pasi nuk zotëron mbi 40% të së drejtës së votës te kjo kompani, sipas nenit L 233-3 të kodit Tregtar Francez, pika II.
<u>Për dy arsyet e mësipërme IFC ka rekomanduar skualifikimin e këtij BOE *1. L.. SHPK (%41.7) & E... F.. (%25) & A.. L... S... B.V (%33.3) Holandë.*</u>

Komisioni me gjithë rekomandimin e IFC vlerëson se ñ*Nuk disponon dhe as është në dijeni të ndonjë dokumenti zyrtar (vendim gjykate të formës së prerë) që provon se shoqëria ABLS nuk përmbush kriterin e përcaktuar..*
Gjithashtu lidhur me (ultimate beneficiary oëner) komisioni sqaron se në bazë të dokumenteve të paraqitura nga ñL...ò, UBO është kompani shqiptare ñP...ò SHPK e cila nuk figuron të jetë në ndjekje penale apo e dënuar sipas kriterit të përcaktuar në DST.....

Komisioni shprehet se në datën 27.02.2017 janë hapur ofertat dhe janë paraqitur operatorët ekonomik sipas tabelës me ofertat dhe shënimet përkatëse:

Nr.	Operatorët ekonomikë	Kanë paraqitur ofertat financiare	Shënime të tjera
1	**BOE:** 1. A... S... H... ve T...A.S (%51) & 2. A... L.. S.. H... A.S (%49); Turqi	4.80%	
2	A....H.... SH.A (AL)	Po (Ka hedhur shtojcën përkatëse në SEP)	*Nuk i lexohet oferta financiare (Nuk hapet me asnjë nga formatet e njohura pdf, jpg, et)*
3	B....A.. SHPK (AL)	Pa ofertë financiare	
4	M... SHPK (AL)	Pa ofertë financiare	
5	G...SHPK (AL)	15%	
6	**BOE:** 1. I.. C.. SHPK (%66) dhe 2. B.. (B....) Sha (%34) Greqi	5.700%	
7	K... SHPK	Pa ofertë financiare	
8	**BOE**: 1. L... SHPK (%41.7) & 2. E.. F.. (%25) & 3. A.. L.. S.. B... (%33.3) Holandë	10.7%	
9	F... SHPK	Pa ofertë financiare	

Komisioni ka vendosur të kualifikoje tre ofertuesit e mëposhtëm:

Operatorët Ekonomikë të kualifikuar		
BOE: 1.A.. S.. H.. ve T... A.S (%51) & 2.A... L.. S... H.. A.S (%49); Turqi	**BOE**: 1.I.. C... SHPK (%66) & 2.B.. (B...) Sha (%34) Greqi	**BOE:** 1.L.. SHPK (%41.7) & 2.E... F... (%25) & 3.A. L.. S.. B... (%33.3) Holandë

Gjithashtu Komisioni **ka skualifikuar** operatorët e mposhtëm:
1. A..H.. SH.A (AL)- *Nuk plotëson dokumentacionin kualifikues dhe nuk i lexohet oferta me gjithë kërkesën për ndërhyrje në APP.*
2. B.. A.. SHPK (AL) - *pa ofertë financiare dhe dokumente kualifikuese*
3. M... SHPK (AL) - *pa ofertë financiare dhe dokumente kualifikuese*
4. G... SHPK (AL)- *Nuk plotëson dokumentacionin kualifikues*
5. K.. SHPK - *pa ofertë financiare dhe dokumente kualifikuese*
6. F... SHPK- *pa ofertë financiare dhe dokumente kualifikuese*

Më pas komisioni ka procedura me vlerësimin e ofertuesve të kualifikuar me pikët përkatëse:

Nr.	Përshkrimi	Pikët (Pikët maksimale)	BOE: 1.A.. S.. H. ve T.. A.S (%51) & 2.A.. L.. S.. H.. A.S (%49); Turqi	**BOE**: 1.I..Center SHPK (%66) & 2.B.. (B...) Sha (%34) Greqi	**BOE:** 1.L... SHPK (%41.7) & 2.E... F.. (%25) & 3.A. L.. S....B.V (%33.3) Holandë
1	Rrjeti laboratorik bashkëqendror (*hub and spoke*) dhe Sistemi i Informacionit Laboratorik dhe Sistemi i Logjistikës.	10	7.57	9.29	9.71
2	Plani i Zbatimit të Projektit.	15	11.43	12	14.86

3	Burimet Njerëzore dhe Plani i Trajnimit.	10	8.86	9.57	10
4	Plani i Objekteve dhe Pajisjeve, qasja e mirëmbajtjes dhe strategjia e zëvendësimit gjatë afatit të kontratës.	10	6.86	10	8.71
5	Plani i Menaxhimit të cilësisë dhe metodologjia për kryerjen e analizave.	15	12.57	14.86	14.86
	Totali 1	**60**	**47.29**	**55.72**	**58.14**
6	Zbritja më e lartë e çmimit të testeve T2.	40	17.9	21.3	40
	TOTALI i pikëve (Totali 1 + T2)	**100**	**65.19**	**77.02**	**98.14**

Njoftimi i klasifikimit të ofertave është bërë publik me shkresën nr. 77/7, dt. 20.03.2017 drejtuar APP.

Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 417, dt. 02.10.2015 ñ*Për ngritjen e komisionit të dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës*ò i ndryshuar me urdhrin nr. 298, dt. 14.07.2016 dhe nr. 976/2, dt. 14.07.2016 ka dërguar raportin përmbledhës me nr. **77/11**, dt. **03.04.2017**, i miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor znj. O. M për **Raportin përmbledhës** për procedurën ñK*oncesionin/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës"* ku përshkruhet procedura e hapjes dhe vlerësimit të ofertave, kualifikimin e tyre dhe propozimin për shpalljen **fitues** të BOE: ñ*L...SHPK (%41.7) & .E.. F.. (%25) & A. L.. S.. B.. (%33.3) Holandë me një discount rate 10.7%. (**gjithsej 98.14 pikë**).*

Sipas tabelës janë pikët e marra nga operatorët e kualifikuar përfshirë dhe ofertën ekonomike:

Nr.	Operatorët ekonomikë	Pikët totale	Oferta ekonomike
1	***BOE:****1.L.... SHPK (%41.7) &* *2.E... F... (%25) &* *3.A.. L.. S.. B.V (%33.3) Hollandë.*	**98.14**	**10.7%**
2	***BOE****:1.I... C.. SHPK (%66) &* *2.B... (B...) Sha (%34) Greqi.*	77.02	5.7%
3	***BOE****: 1.A.. S.. H.. T... A.S (%51) &* *2.A.. L... S.. H... A.S (%49); Turqi*	65.19	4.80%

Në këtë raport përmbledhës nuk janë paraqitur kundërshtimet që ka pasur përfaqësuesja e IFC lidhur me kualifikimin e BOE në kundërshtim me Ligjin nr. 125/2013 ñ*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*ò neni 18 pika 5/c; ñ*Komisioni, Formulon propozimin e përzgjedhjes së ofertës së suksesshme ose propozimin e vendimit për ndërprerjen e procedurës së prokurimit, si dhe një shpjegim të tyre*ò;: 1. ñL..ò SHPK (%41.7) & ñE...ò France (%25) & ñA. L.. S.. B..ò (%33.3) Holandë; duke ngritur dy arsye:

a. Çështje integriteti të kompanisë A..(duke iu referuar standarteve të IFC në draft kontratën e koncesionit pika 2.1 (j) ku citohet: Që në datën efektive dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes, koncesionari deklaron dhe garanton se;

1. Koncesionari 2.1 deklarimi dhe garancitë e koncesionarit; as ai , as ndonjë prej ortakëve të tij të rëndësishëm (apo në dijeninë e tij, asnjë nga personat e lidhur të tij apo personat e lidhurt të tyre) nuk është subjekt i ndonjë hetimi penal për mashtrim, korrupsion, bashkëpunim të fshehtë apo pastrim parash..... etj

IFC lidhur me këtë fakt është bazuar në dy artikuj gazetash spanjolle të cilat hedhin dyshime mbi përfaqësuesin ligjor të shareholder-it të A..-së (orinoco mining&resources B.V dhe anëtarin e bordit të saj, kompaninë ITPS0 i cili, sipas këtij shtypi është në ndjekje penale në Spanjë.
Gjithashtu IFC rekomandon se UBO (ultimate beneficiary owner) i ABSL nuk rezulton i qartë nëse kompania është shqiptare ñP.ò shpk pavarësisht dokumenteve të paraqitura sipas tyre.
Për këtë arsye Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 417, dt. 02.10.2015 **duhej të kryente hetimet e arsyeshme** në përputhje me Dokumentet e Procedurës Konkurruese të miratuara në pikën 7.7 *"Autoriteti Kontraktues mund të kryeje çdo hetim të arsyeshëm ose procedure të ngjashme që e gjykon të nevojshëm për të shqyrtuar integritetin dhe gjendjen financiare në lidhje me Ofertën e një Ofertuesi".* Pika 7.8 *"Ofertuesi duhet të japë menjëherë informacionin dhe asistencën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e çdo hetimi të nevojshëm".*

Sipas auditimit të dokumenteve të paraqitura nga operatorët rezulton se J. K është ortak i vetëm te "L..." sh.p.k. dhe "P..." sh.p.k.

b. Çështjen e kontrollit mes kompanive ñE...ò dhe ñS..ò të cilat marrin përsipër realizimin e testeve ku sipas IFC-së ñS...ò nuk kontrollohet nga ñE..ò pasi nuk zotëron mbi 40% të së drejtës së votës te kjo kompani, sipas nenit L 233-3 të kodit Tregtar Francez, pika II.
- Sipas letër konfirmimit dhe angazhimit të datës 09 shkurt 2017 të grupit ñL..ò përfaqësuar nga presidenti z. J.-P B. konfirmohet se ñL.. Groupò është zotërues i ligjshëm direkt i 40% të kapitalit të ñE ...ò; dhe 40% të kapitalit të ñS...ò dhe si e tillë ñL...ò kualifikohet si shoqëria mëmë e ñE..ò dhe ñS...ò dhe në terma ligjorë ajo i kontrollon të dyja si ñS..ò dhe ñE..ò, të cilat njihen sipas ligjit si degë të ñL...ò.

- Sipas letër konfirmimit dhe angazhimit të datës 17 mars 2017 nga presidenti z. J.-P. B. ñL.ò është mbajtësi i drejtpërdrejtë i 33.7% të kapitalit të ñS.ò dhe 34.06% të kapitalit të ñE...ò. Për më tepër të gjithë aksionarët e ñS...ò janë gjithashtu aksionarë të ñL...ò; ndërsa të gjithë aksionerët e ñE...ò janë njëkohësisht aksionarë të ñL...ò. Kështu aksionarët e ñL...ò dhe ñL...ò mbajnë më shumë se 40% të aksioneve.
Gjithashtu sipas Statutit të ñE...ò viti 2016, Artikulli 13, garancitë, pika II, paragrafi i parafundit faqe 39 ñ ... *përcaktohet shprehimisht se çdo investim, çdo hua... çdo hipotekë, çdo garanci, çdo qiradhënie, çdo garanci, çdo veprim që përfshin transferime të pasurive të paluajtshme klientëve. Çdo shitje e elementeve të caktuar të pasurive fikse që tejkalojnë shumën 100,000 Euro, angazhimet që tejkalojnë një shumë prej 100,000 Euro, blerje për një shumë më të madhe se 100,000 Euro nuk mund të kryhen, vetëm me autorizimin e mbledhjes së zakonshme të partnerëve*ò.
Gjithashtu sipas Statutit të ñL...ò viti 2016, Artikulli 13, garancitë, pika II, paragrafi i parafundit faqe 20 ñ ... *përcaktohet shprehimisht se çdo investim, çdo hua... çdo hipotekë, çdo garanci, çdo qiradhënie, çdo garanci, çdo veprim që përfshin transferime të pasurive të paluajtshme klientëve. Çdo shitje e elementeve të caktuar të pasurive fikse që tejkalojnë shumën 40,000 Euro, angazhimet që tejkalojnë një shumë prej 40,000 Euro, blerje për një shumë më të madhe se 40,000 Euro nuk mund të kryhen, vetëm me autorizimin e mbledhjes së zakonshme të partnerëve*ò.
Në dokumentet e paraqitura nga operatori i mësipërm (*të cilat janë në formatin elektronik të pa përkthyera në shqip, të pa noteruara dhe mungojnë në dosjen e operatorit fitues*) ***mungon autorizimi i aksionarëve për angazhimet për shërbimet laboratorike sipas ofertës.***
Për arsyet e mësipërme IFC ka rekomanduar skualifikimin e këtij BOE 1. ñL...ò SH.P.K. (%41.7) & ñE...ò France (%25) & ñA.. L...S... B..ò (%33.3) Holandë.

Komisioni me gjithë rekomandimin e IFC ka vlerësuar se ñ*Nuk disponon dhe as është në dijeni të ndonjë dokumenti zyrtar (vendim gjykate të formës së prerë) që provon se shoqëria A.. nuk përmbush kriterin e përcaktuar*ò.
Gjithashtu lidhur me (*ultimate beneficiary owner*) (*pronari i fundit përfitues*) komisioni sqaron se në bazë të dokumenteve të paraqitura nga ñL...ò, UBO është kompani shqiptare ñP...ò SHPK e cila nuk figuron të jetë në ndjekje penale apo e dënuar sipas kriterit të përcaktuar në DST.....
Sipas letër konfirmimit dhe angazhimit të datës 17 mars 2017 të A... citojmë; ñ*pronari i fundit përfitues i aksioneve të A. L... S..BV Holandë (ABSL) është entiteti shqiptar P... shpk* .....
Ndërkohë nga auditimi i dokumenteve të paraqitura rezulton se e vetmja marrëdhënie si ligjore dhe ekonomike midis ABSL (thë fiduciary) dhe P. shpk (the Principal) është një Fiduicary Agreement (Shares of Ab Laboratory Solution BV) nënshkruar në datë 06 Shkurt 2017, e cila në thelb të saj ka vetëm ruajtjen e 1800 aksioneve me vlerë nominale 10 Euro secila, të cilat sipas kësaj kontrate P... SHPK (the principal) ja beson në ruajtje në emër të Fiduciary (ABSL) por për llogari dhe risk të Principal, veprim ky i cili do te konsiderohet ñthe Servicesò pra shërbimi.
Sipas pikës 4 të po kësaj kontrate "I...", A... në rolin e the fiduciary do të kryej të gjitha detyrat vetëm në përputhje me instruksionet e the Principal dhe vetëm në raste emergjence mund të ndërmarrë ndonjë veprim dhe për të cilin duhet të njoftojë pa vonesë The Principal.
Gjithashtu në pikën 5 po të kësaj kontrate Termination, ndërprerja ose mbarimi i kësaj kontrate është parashikuar në çdo kohë me njoftimin me email brenda tre ditëve pune, dhe në pikën 5.2 është parashikuar që të kryhet transferimi i aksioneve në një palë të tretë pa vonesë dhe pa pretendime.
Pra në thelb kjo kontratë nuk paraqet asnjë angazhim apo dhe pronësi të P... mbi A..., por është përdorur si ñ*koracë*ò përfaqësimi për konsorciumin dhe përfaqësimin në konkurrimin e hapur për koncesionin e laboratorëve., pasi nëse do të ishte paraqitur vetë P... si aksioner në konsorciumin e ngritur atëherë pjesëmarrja e tij rezulton 75% të aksioneve dhe jo ndarja që është paraqitur në marrëveshjen e konsorciumit ñL...ò SH.P.K. (%41.7) & ñE...ò France (%25) & ñA.. L...S... B...ò (%33.3) Holandë, ku natyrisht ndryshojnë dhe kushtet e vlerësimit të cilat në shumicën e detyrimeve i takojnë atij për ti përmbushur si nga ana ligjore dhe financiare, e cila është qartësuar me dokumentacionin e mëposhtëm, ku nga auditimi i dokumenteve të paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës rezulton:
- Certifikata e regjistrimit në datën 07.05.2008 me nr. 70491729 për shoqërinë ñP..ò sh.p.k. Republika e Kosovës ortaku i vetëm J. K .
- Me numrin unik të identifikimit të subjektit J62903750A në datën 01.07.1996 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit ñP...ò SH.P.K ortaku i vetëm J. K .;
- Me numrin unik të identifikimit të subjektit L22312016D në datën 12.11.2012 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit ñP...M..ò SH.P.K ortaku i vetëm J. K.
- Me numrin unik të identifikimit të subjektit K62717603C në datën 12.06.2006 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit ñP..-V..ò SH.P.K me ortakët L. K me 50% të aksioneve dhe Janis Karathano me 50% të aksioneve.
- Me numrin unik të identifikimit të subjektit K72202013A në datën 02.10.2007 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit ñL...ò SH.P.K ortaku i vetëm J. K.

Për sa konstatohet me dokumentet e mësipërme dy nga operatorët e këtij BOE. ñL...ò SH.P.K (%41.7) dhe ñA.. L.. S.. B.Vò i cili sqaron se në bazë të dokumenteve të paraqitura w(ultimate beneficiary owner) (Pronari i fundit përfitues) është ñP...ò SH.P.K . Të dy operatorët e mësipërm **janë kompani shqiptare me ortak të vetëm J.K më 100% të aksioneve.**

Sa më lart kualifikimi i BOE ñ*L..*ò SHPK (%41.7) & ñ*E..*ò France (%25) & ñ*A. L.. S.. B..*ò (%33.3) Holandë është në kundërshtim me Dokumentet e Procedurës Konkurruese të miratuara në pikën 3 ñ*Procedurat konkurruese*ò nënpika 3.16 ñ*Bashkimi i shoqërive*ò pika 3.16.4 ñ*Asnjë Ofertues apo*

*anëtar i një Bashkimi Shoqërish nuk mund të ushtrojë kontrolle mbi një Ofertues tjetër apo mbi një anëtar të një Bashkimi Shoqërish. Për qëllime të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese, "kontroll" nënkupton kompetencën për të zgjedhur shumicën e anëtarëve të bordit drejtues (ose të një organi tjetër të ngjashëm) ose për të drejtuar administrimin dhe politikat e një subjekti, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, qoftë përmes zotërimit të drejtave të votës, sipas kontratës ose ndryshe, dhe "kontrollues" dhe "i kontrolluar" kanë kuptime të lidhura reciprokisht*ò. Për këtë arsye Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 417, dt. 02.10.2015 **duhej të kishte skualifikuar bashkimin e operatorëve të mësipërm.**

Nga auditimi rezulton se në dosjen e dokumenteve të dorëzuara nga BOE fitues nuk janë të gjitha dokumentet origjinale kjo në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, dt. 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò Neni 57 pika 3. Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/jnë detyrat e mëposhtme: .....*"Administrimin e dokumentacionit në formë të shkruar, origjinal ose fotokopje të noterizuar të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktor*ò dhe Dokumenteve të Procedurës Konkurruese pika 5.2.6 ..... *Pas mbylljes së procedurës konkurruese dhe përpara nënshkrimit së koncesionit, Ofertuesi që zgjidhet Ofertues fitues dorëzon Dokumentet origjinale të ofertës për verifikim*..... gjithashtu operatori ñA.. L.. S.. B..ò (%33.3) Holandë nuk ka paraqitur shtojcat përkatëse të kërkuara nga Dokumentet e Procedurës Konkurruese të miratuara pika 12.3.1 Pjesa I ï Kriteret e Kualifikimit; ñ*Në Pjesën I të Dokumenteve të Kualifikimit, Ofertuesi duhet të japë prova se ai përmbush Kriteret e Kualifikimit të përcaktuara në Shtojcën 9/1 (Kriteret e Veçanta të Kualifikimit). Nëse Ofertuesi është një Bashkim Shoqërish, Kriteret e Kualifikimit duhet të përmbushen nga Bashkimi i Shoqërive si një i tërë dhe çdo anëtar mund të kontribuoje në përmbushjen e tyre, në përputhje me pjesëmarrjen e zotëruar nga çdo anëtar i Bashkimit të Shoqërive, me kusht që anëtaret e Bashkimit të Shoqërive që zotërojnë pjesëmarrje më të vogël se 25% në Bashkimin e Shoqërive, të mos merren parasysh për përmbushjen e Pjesës I – Kriteret e Kualifikimit". (**Këto dokumente janë në formatin elektronik PDF të dorëzuar me CD**)*.

Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor znj. O. M me shkresën nr. 77/15, dt. 21.04.2017 është dërguar njoftimi i ofertuesit fitues botuar në buletinin e APP datën 24.04.2017.
Me urdhrin nr. 232, dt. 18.05.2017 Ministri znj. O. M i delegon kompetencat e Titullarit të Autoritetit kontraktor znj. K. N për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave ligjore të prokurimit publik dhe procedurave të koncesionit dhe parteneritetit publik privat në Ministrinë e Shëndetësisë si dhe lidhjen e kontratave me afat deri 31.12.2017.

Nga ministria e Shëndetësisë me shkresën nr. 77/20, dt. 19.05.2017 është njoftuar BOE: ñL...ò SHPK & ñE..ò France & ñA.. L.. S..ò B.. Holandë, me përfaqësues ñL..ò SHPK, Adresa rr. Siri Kodra, nr. 149, Tiranë për fillimin e negociatave për lidhjen e kontratës së koncesionit në ambientet e MSH në datën 29.05.2017.
Me email të datës 27.05.2017 të Kryetarit të Komisionit janë njoftuar për pezullimin e takimit të datës 29.05.2017 për fillimin e negociatave të projektit të laboratorëve në respekt të marrëveshjes PS-PD deri në një njoftim të dytë.
Në dosjen e PPP **nuk ndodhet ndonjë dokument për fillimin e negociatave për lidhjen e kontratës së koncesionit** në kundërshtim kjo me Dokumentet e Procedurës Konkurruese të miratuara pika 10.2 ñ*Do të ketë negociata të kufizuara mes Ofertuesit Fitues dhe Autoritetit Kontraktues për dispozita të kontratës, duke përjashtuar kushtet kryesore të koncesionit në përputhje me ofertën teknike dhe financiare, strukturën e çmimeve të Projektit, ndarjen e riskut dhe kushte kryesore tregtare, dhe më pas Kontrata e Koncesionit do të lidhet kryesisht në formën e*

*bashkëngjitur në Shtojcën 17 (Draft Kontrata e Koncesionit) të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese*ò.
Dosja e koncesionit/partneritetit publik privat nuk është inventarizuar dhe dorëzuar në arkivin e MSHMS konform ligjit të arkivave.

Situatat e mësipërme dhe rekomandimet përkatëse me afatet e zbatimit si më poshtë:

Titulli i Gjetjes:	Nga auditimi i procedurës së PPP rezultoi se në llogarinë e APP nuk del procedura e prokurimit të shërbimit të laboratorëve në formatin elektronik pasi procedura nuk ka kaluar në procesin ñ*shpallje e përfunduar*ò.
Situata 1:	Në llogarinë e APP nuk del prokurimi për procedurën e laboratorëve në formatin elektronik pasi procedura nuk ka kaluar si ñ*shpallje e përfunduar*ò, në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 13, datë 28/05/2015 ñ*Për procedurat e dhënies me konçesion dhe partneritet publik privat në sistemin e prokurimit elektronik dhe dorëzimi i ofertave nga operatorët ekonomikë*ò: ñ*Në përfundim të veprimeve të mësipërme, do të shikoni që faza "Njoftimi i kontratës" është ngjyrosur me ngjyrë të gjelbër dhe në krah të saj statusi rezulton "E përfunduar". Pas kësaj, dosja e tenderit i kalon zyrtarëve të publikimit në Agjencinë e Prokurimit Publik.* ***Kujdes*** *në momentin që, nëpunësit të komisionit i dërgohet mesazh automatikisht nëpërmjet SPE për publikimin e procedurës, ky i fundit duhet të bëjë menjëherë verifikimin e kalimin e kësaj procedure nga skedari "Shpallje të Papërfunduara" tek skedari "**Shpallje të Përfunduara**ò.*
Situata 2:	Nga Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 417, dt. 02.10.2015 ñ*Për ngritjen e komisionit të dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës*ò i ndryshuar me urdhrin nr. 298, dt. 14.07.2016 dhe nr. 976/2, dt. 14.07.2016 **me procesverbalin përmbledhës nr. 14, dt. 20.03.2017,** ***ka vlerësuar ofertat*** për ñK*oncesionin/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës"* me kështilltar transaksioni IFC-në. Në këtë mbledhje të komisionit përfaqësuesja e IFC ka kundërshtuar kualifikimin e BOE*: 1.L.. SHPK (%41.7) & E.. France (%25) & A. L.. S.. B.V (%33.3) Holandë*; duke ngritur dy arsye: **a.** Çështje integriteti të kompanisë A... (duke iu referuar standarteve të IFC në draft kontratën e koncesionit pika 2.1 (j) ku citohet: Që në datën efektive dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes, koncesionari deklaron dhe garanton se; 1. Koncesionari 2.1 deklarimi dhe garancitë e koncesionarit; as ai, as ndonjë prej ortakëve të tij të rëndësishëm (apo në dijeninë e tij, asnjë nga personat e lidhur të tij apo personat e lidhur të tyre) nuk është subjekt i ndonjë hetimi penal për mashtrim, korrupsion, bashkëpunim të fshehtë apo pastrim parash ..... etj IFC lidhur me këtë fakt është bazuar në dy artikuj gazetash spanjolle të cilat hedhin dyshime mbi përfaqësuesin ligjor të shareholder-it të A..-së (orinoco mining&resources B.V dhe anëtarin e bordit të saj, kompaninë ITPS0 i cili, sipas këtij shtypi është në ndjekje penale në Spanjë. Gjithashtu IFC rekomandon se UBO (ultimate beneficiary owner) i A.. nuk rezulton i qartë nëse kompania është shqiptare P. shpk pavarësisht dokumenteve të paraqitura sipas tyre. **b**. Çështjen e kontrollit mes kompanive ñE..ò dhe ñS...ò të cilat marrin përsipër realizimin e testeve ku sipas IFC-së ñS..ò nuk kontrollohet nga ñE..ò pasi nuk zotëron mbi 40% të së drejtës së votës te kjo kompani, sipas nenit L 233-3 të kodit Tregtar Francez, pika II. Për dy arsyet e mësipërme **IFC ka rekomanduar skualifikimin e këtij BOE** *1 .L.. SHPK (%41.7) & E.. France (%25) & A. L.. S..B.V (%33.3) Holandë*. Komisioni me gjithë rekomandimin e IFC vlerëson se ñ*Nuk disponon dhe as është në dijeni të ndonjë dokumenti zyrtar (vendim gjykate të formës së prerë) që provon se shoqëria A.. nuk përmbush kriterin e përcaktuar..* Gjithashtu lidhur me (ultimate beneficiary owner) komisioni sqaron se në bazë të dokumenteve të paraqitura nga L., UBO është kompani shqiptare ñP..ò SHPK e cila nuk figuron të jetë në ndjekje penale apo e dënuar sipas kriterit të përcaktuar në DST.....
Situata 3:	Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë ka dërguar raportin përmbledhës me nr. **77/11**, dt. **03.04.2017**, i miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor znj. O. M për **Raportin përmbledhës** për procedurën ñK*oncesionin/partneritetit publik*

	privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës" ku përshkruhet procedura e hapjes dhe vlerësimit të ofertave, kualifikimin e tyre dhe propozimin për shpalljen **fitues** të BOE: ñ*L.. SHPK (%41.7) & .E.. F.. (%25) & A. L.. S.. B.V (%33.3) Hollandë me një discount rate 10.7%.* (***gjithsej 98.14 pikë***). Në këtë raport përmbledhës nuk janë paraqitur kundërshtimet që ka pasur përfaqësuesja e IFC lidhur me kualifikimin e BOE në kundërshtim me Ligjin nr. 125/2013 ñ*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*ò neni 18 pika 5/c; ñ*Komisioni, Formulon propozimin e përzgjedhjes së ofertës së suksesshme ose propozimin e vendimit për ndërprerjen e procedurës së prokurimit, si dhe një shpjegim të tyre*ò. 1. ñL..ò SHPK (%41.7) & ñE..ò France (%25) & ñA..L.. S.. B.Vò (%33.3) Holandë; Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 417, dt. 02.10.2015 **nuk ka kryer hetimet e arsyeshme** në përputhje me Dokumentet e Procedurës Konkurruese të miratuara në pikën 7.7 *"Autoriteti Kontraktues mund të kryeje çdo hetim të arsyeshëm ose procedure të ngjashme që e gjykon të nevojshëm për të shqyrtuar integritetin dhe gjendjen financiare në lidhje me Ofertën e një Ofertuesi"*. Pika 7.8 *"Ofertuesi duhet të japë menjëherë informacionin dhe asistencën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e çdo hetimi të nevojshëm"*.
Situata 4:	Nga IFC është trajtuar çështja e kontrollit mes kompanive ñE..ò dhe ñS..ò të cilat marrin përsipër realizimin e testeve ku sipas IFC-së ñS..ò nuk kontrollohet nga ñE..ò pasi nuk zotëron mbi 40% të së drejtës së votës te kjo kompani, sipas nenit L 233-3 të kodit Tregtar Francez, pika II. - Sipas letër konfirmimit dhe angazhimit të datës 09 shkurt 2017 të grupit ñL..ò përfaqësuar nga presidenti z. J.-P. B. konfirmohet se ñL.. Groupò është zotërues i ligjshëm direkt i 40% të kapitalit të ñE...ò; dhe 40% të kapitalit të ñS..ò dhe si e tillë ñL..ò kualifikohet si shoqëria mëmë e ñE..ò dhe ñS..ò dhe në terma ligjorë ajo i kontrollon të dyja si ñS..ò dhe ñE..ò, të cilat njihen sipas ligjit si degë të ñL...ò. - Sipas letër konfirmimit dhe angazhimit të datës 17 mars 2017 nga presidenti z. J.-P. B. ñL...ò është mbajtësi i drejtpërdrejtë i 33.7% të kapitalit të ñS...ò dhe 34.06% të kapitalit të ñExalabò. Për më tepër të gjithë aksionarët e ñS..ò janë gjithashtu aksionarë të ñL..ò; ndërsa të gjithë aksionerët e ñE...ò janë njëkohësisht aksionarë të ñL..ò. Kështu aksionarët e ñL...ò dhe ñL..ò mbajnë më shumë se 40% të aksioneve. - Gjithashtu sipas Statutit të ñE..ò viti 2016, Artikulli 13, garancitë, pika II, paragrafi i parafundit faqe 39 ñ ... *përcaktohet shprehimisht se çdo investim, çdo hua... çdo hipotekë, çdo garanci, çdo qiradhënie, çdo garanci, çdo veprim që përfshin transferime të pasurive të paluajtshme klientëve. Çdo shitje e elementeve të caktuar të pasurive fikse që tejkalojnë shumën 100,000 Euro, angazhimet që tejkalojnë një shumë prej 100,000 Euro, blerje për një shumë më të madhe se 100,000 Euro nuk mund të kryhen, vetëm me autorizimin e mbledhjes së zakonshme të partnerëve*ò. - Gjithashtu sipas Statutit të ñL..ò viti 2016, Artikulli 13, garancitë, pika II, paragrafi i parafundit faqe 20 ñ ... *përcaktohet shprehimisht se çdo investim, çdo hua... çdo hipotekë, çdo garanci, çdo qiradhënie, çdo garanci, çdo veprim që përfshin transferime të pasurive të paluajtshme klientëve. Çdo shitje e elementeve të caktuar të pasurive fikse që tejkalojnë shumën 40,000 Euro, angazhimet që tejkalojnë një shumë prej 40,000 Euro, blerje për një shumë më të madhe se 40,000 Euro nuk mund të kryhen, vetëm me autorizimin e mbledhjes së zakonshme të partnerëve*ò. - Në dokumentet e paraqitura nga operatori i mësipërm (*të cilat janë në formatin elektronik të pa përkthyera në shqip, të pa noteruara dhe mungojnë në dosjen e operatorit fitues*) ***mungon autorizimi i aksionarëve për angazhimet për shërbimet laboratorike sipas ofertës.***
Situata 5:	Lidhur me çështjet e integritetit të kompanisë A.., IFC ka rekomanduar skualifikimin e këtij BOE 1. ñL...ò SH.P.K. (%41.7) & ñE..ò F.. (%25) & ñA.. L... S... B.Vò (%33.3) Hollandë. ***Nga auditimi rezultoi se***: - Sipas letër konfirmimit dhe angazhimit të datës 17 mars 2017 të A.. citojmë; ñ*pronari i fundit përfitues i aksioneve të A.. L.. S.. BV Holandë (A..) është entiteti shqiptar P. shpk* ..... Ndërkohë nga auditimi i dokumenteve të paraqitura rezulton se e vetmja marrëdhënie si ligjore dhe ekonomike midis A... (thë fiduciary) dhe P... shpk (the Principal) është një Fiduicary Agreement (Shares of Ab Laboratory Solution BV) nënshkruar në datë 06 Shkurt 2017, e cila në thelb të saj ka vetëm ruajtjen e 1800 aksioneve me vlerë nominale 10 Euro secila, të cilat sipas kësaj kontrate P. SHPK (the principal) ja beson në ruajtje në

	emër të Fiduciary (ABSL) por për llogari dhe risk të Principal, veprim ky i cili do te konsiderohet ñthe Servicesò pra shërbimi. *Sipas pikës 4 të po kësaj kontrate "I...", A.. në rolin e the fiduciary do të kryej të gjitha detyrat vetëm në përputhje me instruksionet e the Principal dhe vetëm në raste emergjence mund të ndërmarrë ndonjë veprim dhe për të cilin duhet të njoftojë pa vonesë The Principal.* *Gjithashtu në pikën 5 po të kësaj kontrate Termination, ndërprerja ose mbarimi i kësaj kontrate është parashikuar në çdo kohë me njoftimin me email brenda tre ditëve pune, dhe në pikën 5.2 është parashikuar që të kryhet transferimi i aksioneve në një palë të tretë pa vonesë dhe pa pretendime.* Pra në thelb kjo kontratë nuk paraqet asnjë angazhim apo dhe pronësi të P.. mbi A..., por është përdorur si ñ*koracë*ò përfaqësimi për konsorciumin dhe përfaqësimin në konkurrimin e hapur për koncesionin e laboratorëve, pasi nëse do të ishte paraqitur vetë P... si aksioner në konsorciumin e ngritur atëherë pjesëmarrja e tij rezulton 75% të aksioneve dhe jo ndarja që është paraqitur në marrëveshjen e konsorciumit ñL...ò SH.P.K. (%41.7) & ñE..ò France (%25) & ñA.. L.. S.. B..ò (%33.3) Holandë, ku natyrisht ndryshojnë dhe kushtet e vlerësimit të cilat në shumicën e detyrimeve i takojnë atij për ti përmbushur si nga ana ligjore dhe financiare. **<u>Sa më lart</u>** është qartësuar me dokumentacionin e mëposhtëm ku nga auditimi i dokumenteve të paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës rezulton: - Certifikata e regjistrimit në datën 07.05.2008 me nr. 70491729 për shoqërinë ñP...ò sh.p.k. Republika e Kosovës ortaku i vetëm J. K. - Me numrin unik të identifikimit të subjektit J62903750A në datën 01.07.1996 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit ñP..ò SH.P.K ortaku i vetëm J. K..; - Me numrin unik të identifikimit të subjektit L22312016D në datën 12.11.2012 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit ñP.. M..ò SH.P.K ortaku i vetëm J. K . - Me numrin unik të identifikimit të subjektit K62717603C në datën 12.06.2006 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit ñP..-V...ò SH.P.K me ortakët L. K me 50% të aksioneve dhe J. K me 50% të aksioneve. - Me numrin unik të identifikimit të subjektit K72202013A në datën 02.10.2007 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit ñL...ò SH.P.K ortaku i vetëm J.K . Për sa konstatohet me dokumentet e mësipërme dy nga operatorët e këtij BOE. ñL...ò SH.P.K (%41.7) dhe ñA. L.. S.. B..ò i cili sqaron se në bazë të dokumenteve të paraqitura UBO (ultimate beneficiary owner) (Pronari i fundit përfitues) është ñP...ò SH.P.K . Të dy operatorët e mësipërme **janë kompani shqiptare me ortak të vetëm J. K. më 100% të aksioneve.** Sa më lart kualifikimi i BOE ñ*L..*ò SHPK (%41.7) & ñ*E..*ò France (%25) & ñ*A. L.. S.. B..*ò (%33.3) Holandë është në kundërshtim me Dokumentet e Procedurës Konkurruese të miratuara në pikën 3 ñ*Procedurat konkurruese*ò nënpika 3.16 ñ*Bashkimi i shoqërive*ò pika 3.16.4 ñ*Asnjë Ofertues apo anëtar i një Bashkimi Shoqërish nuk mund të ushtrojë kontrolle mbi një Ofertues tjetër apo mbi një anëtar të një Bashkimi Shoqërish. Për qëllime të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese, "kontroll" nënkupton kompetencën për të zgjedhur shumicën e anëtarëve të bordit drejtues (ose të një organi tjetër të ngjashëm) ose për të drejtuar administrimin dhe politikat e një subjekti, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, qoftë përmes zotërimit të drejtave të votës, sipas kontratës ose ndryshe, dhe "kontrollues" dhe "i kontrolluar" kanë kuptime të lidhura reciprokisht*ò. Për këtë arsye, Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 417, dt. 02.10.2015 **duhej të kishte skualifikuar bashkimin e operatorëve të mësipërm.**
Kriteri:	Ligjin nr. 125/2013 ñ*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*ò neni 18 pika 5/c; ñ*Komisioni, formulon propozimin e përzgjedhjes së ofertës së suksesshme ose propozimin e vendimit për ndërprerjen e procedurës së prokurimit, si dhe një shpjegim të tyre*ò; Udhëzimin e APP nr. 13, datë 28/05/2015 ñ*Për procedurat e dhënies me koncesion dhe partneritet publik privat në sistemin e prokurimit elektronik dhe dorëzimi i ofertave nga operatorët ekonomikë*ò. Dokumentet e Procedurës Konkurruese të miratuara në pikën 3 ñ*Procedurat konkurruese*ò nënpika 3.16 ñ*Bashkimi i shoqërive*ò pika 3.16.4. pika 7.7 dhe 7.8.

Ndikimi/Efekti	Nga auditimi i procedurës së dhënies së koncesionit rezultoi se nga komisioni i dhënies së koncesioneve: - Në llogarinë e APP procedura e laboratorëve në formatin elektronik nuk ka kaluar si ñ*shpallje e përfunduar*ò, - Në raportin përmbledhës nuk janë paraqitur kundërshtimet që ka pasur përfaqësuesja e IFC lidhur me kualifikimin e BOE dhe informacionet për kualifikimin e operatorëve dhe nuk ka kryer hetimet e arsyeshme në përputhje me Dokumentet e Procedurës Konkurruese. - kompanitë ñE..ò dhe ñS...ò të cilat marrin përsipër realizimin e testeve ku ñS..ò nuk kontrollohet nga ñE..ò pasi nuk zotëron mbi 40% të së drejtës së votës te kjo kompani dhe në dokumentet e paraqitura nga operatori ñE..ò mungon autorizimi i aksionarëve për angazhimet për shërbimet laboratorike sipas ofertës. - Për sa konstatohet me dokumentet e letër konfirmimit dy nga operatorët e këtij BOE. ñL..ò SH.P.K dhe ñA. L.. S.. B..ò i cili sqaron se në bazë të dokumenteve të paraqitura UBO (*ultimate beneficiary owner*) (*Pronari i fundit përfitues*) është ñP..ò SH.P.K Të dy operatorët e mësipërme janë kompani shqiptare me ortak të vetëm J. K më 100% të aksioneve. Për sa janë konstatuar më sipër Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 417, dt. 02.10.2015 ka kualifikuar fitues padrejtësisht bashkimin e operatorëve ñL..ò SH.P.K. (%41.7) & ñE..ò France (%25) & ñA..L.S... B.Vò (%33.3) Holandë.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandimi	BOE ñL...ò SHPK (%41.7) & ñE...ò France (%25) & ñA. L... S.. B.Vò (%33.3) është shpallur fitues në kundërshtim me kërkesat e Dokumenteve të Procedurës Konkurruese me Ofertues që ushtrojnë kontrolle mbi një anëtar të një Bashkimi Operatorësh Ekonomik, që nënkupton kompetencën për të zgjedhur shumicën e anëtarëve të bordit drejtues (ose të një organi tjetër të ngjashëm) ose për të drejtuar administrimin dhe politikat e një subjekti, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, qoftë përmes zotërimit të drejtave të votës, sipas kontratës ose ndryshe. **a.** Autoriteti kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masat për rishikimin e kontratës me BOE të koncesionit/partneritetit publik privat ñ*Për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjë*ò përfituar në kundërshtim me Ligjin nr. 125/2013 ñ*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*ò Neni 36 ñ*Zgjidhja e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat*ò pika 2. ñ*Secila palë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, ka të drejtë të zgjidhë kontratën kur: b) ka shkelje serioze nga pala tjetër dhe se kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe në mënyrën e përcaktuar në kontratë”*. **b**. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duke u këshilluar paraprakisht me Avokaturën e Shtetit të marrë masat për të informuar Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të gjitha rrethanat e njohura, të cilat çojnë dhe krijojnë kushtet për zgjidhjen e kontratës me BOE të koncesionit/partneritetit publik privat ñ*Për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjë*ò dhe të kërkojë mendimin e saj, në përputhje me Ligjin nr. 125/2013 ñ*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*ò Neni 36 ñ*Zgjidhja e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat*ò pika 4.
Afati:	Menjëherë

Mbajtur Akt konstatimi nr. 8, dt. 15.07.2020 *“Mbi auditimin e procedurës së PPP me objekt “Për dhënien koncesionit/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjë”.*

Pretendimi i subjektit:
Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar Komisioni i Dhënies me Koncesion për ñ*Dhënien me Koncesion/PPP për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiakë të Sarandës dhe Lushnjës*ò me shkresën nr. 1819/20 dërguar me email të datës 24.07.2020 ka bërë komente dhe shpjegime për Akt Konstatimin nr. 8, dt. 15.07.2020, **Gjithashtu për Projekt Raportin me shkresën nr. 359/8, dt. 27.08.2020 janë sjellë observacionet e njëjta të cilat shkurtimisht po i paraqesim edhe njëherë në raportin përfundimtar konkretisht:**

“Nga auditimi i ushtruar ne Ministrinë se Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bazë të programit të auditimit nr. 359/1, date 24.04.2020 mbajtur në datë 15.07.2020, ju paraqesim observacionet si me poshtë:

1. *Në llogarinë e APP nuk del prokurimi për procedurën e laboratorëve në formatin elektronik pasi procedura nuk ka kaluar si "shpallje e përfunduar", në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 13, datë 28/05/2015 "Për procedurat e dhënies me koncesion dhe partneritet publik privat në sistemin e prokurimit elektronik dhe dorëzimi i ofertave nga operatorët ekonomikë": "Në përfundim të veprimeve të mësipërme, do të shikoni që faza "Njoftimi i kontratës" është ngjyrosur me ngjyre të gjelbër dhe në krah të saj statusi rezulton "E përfunduar". Pas kësaj, dosja e tenderit i kalon zyrtarëve të publikimit në Agjencinë e Prokurimit Publik.* ***Kujdes*** *në momentin që, nëpunësit të komisionit i dërgohet mesazh automatikisht nëpërmjet SPE për publikimin e procedurës, ky i fundit duhet të bëjë menjëherë verifikimin e kalimin e kësaj procedure nga skedari "Shpallje të Papërfunduara" tek skedari "**Shpallje të Përfunduara**".*

Observacion 1: *Ky konstatim nuk qëndron ligjërisht pasi referenca në të cilën janë mbështetur audituesit është jo e saktë duke i'u referuar fazës "Njoftimi i kontratës".*
Siç rezulton ne SPE (shiko ekstraktin bashkëlidhur) , faza e përmendur nga KLSH është e gjelbër dhe e përfunduar. Te gjitha fazat janë te përfunduara përfshirë këtu edhe "Dorëzimi i ofertave"
Sqarojmë se Komisioni ka zhvilluar procesin e vlerësimit të ofertave referuar paragrafit të fundit të faqes 15 në Seksionin "Hapja e Ofertave" të Udhëzimit nr. 13 date 28/05/2015 "Për procedurat e dhënies me koncesion dhe partneritet publik privat në sistemin e prokurimit elektronik dhe dorëzimi i ofertave nga operatoret ekonomike", i cili citon si më poshtë: "Procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të paraqitura bëhet në rrugë shkresore, sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit në fuqi".
Pra në këtë rast është e shprehur qartë se gjithë procedura e vlerësimit pas dorëzimit të ofertave nuk vazhdon me "Kuotimin" në sistem (SPE) por me rrugë shkresore.
Në sistemin e APP nëse nuk është i mundur te bëhet kuotimi për vlerësimin e ofertave dhe rrjedhimisht nuk mund të kalohet në fazat e tjera të procedurës sepse nuk lejon sistemi.
Kjo procedure mbetet ne rubrikën "Procedurat e publikuara" te anëtarëve te KVO-se dhe është lehtësisht e aksesueshme me llogarinë e njërit prej tyre ne prani te personave kërkues te autorizuar.
E gjithë procedura e ndjekur është finalizuar dhe publikuar ne përputhje me legjislacionin ne fuqi.
Sa me lart ky konstatim nuk qëndron pasi është i pabazuar ne ligj.

2. *Në lidhje me konstatimin e KLSH në paragrafin e parë të faqes 6 të Akt Konstatimit nr. 8 se "Ne këtë raport përmbledhës (Nr. Prot. 77/11, date 03.04.2017) nuk janë paraqitur kundërshtimet qe ka pasur përfaqësuesja e IFC lidhur me kualifikimin e BOE…",*

Observacion 2:
Te gjitha qëndrimet e IFC janë pasqyruar ne proces verbalet nga ku vete KLSH ka marre te dhenat, proces verbale te cilat i bashkëlidhen dokumenteve si Raporti Përmbledhës, etj dhe bëhen pjese e dosjes se projektit.
Neni 18 pika 6 e 125/2013 "Për koncesionet/PPP", te ndryshuar, përcakton se:
6. Komisioni i dhënies së koncesionit /partneritetit publik privat mban procesverbale për pasqyrimin e punës së tij, të cilat duhet të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit".

Në Ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet/PPP", te ndryshuar, dhe VKM 575/2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/PPP" nuk ka ndonjë përcaktim specifik për mënyrën e përgatitjes së raportit përfundimtar përmbledhës dhe veçanërisht për këtë rast specifik pasi IFC nuk është anëtare e Komisionit te Vlerësimit.

Komisioni ka përdorur modelin e zakonshëm për të përgatitur raportin përfundimtar dhe më pas përgatiti një Memo në datën 11.04.2017 për të informuar titullarin në lidhje me problematikat e hasura në proces. (memo bashkëlidhur)
Sqarojmë se Komisioni nuk ka detyrimin ligjor te reflektoje qëndrimet e IFC-se pasi IFC këto qëndrime i ka dërguar zyrtarisht rast pas rasti pranë AK me shkresa zyrtare te përfaqësuesve te larte te saj (si psh. Shkresa e datës 20.05.2017 bashkëlidhur).

Edhe me shkresën nr.extra date 29.04.2017, IFC-se i janë përcjellë qëndrimet e AK lidhur me çështjet e adresuara.
Lidhur me këtë çështje, sic vihet re dhe nga email i përfaqësueses se IFC (bashkëlidhur) date 20.07.2020 lidhur me Akt Konstatimin e KLSH-se, edhe vete IFC konfirmon zyrtarisht se nuk ka gene asnjëherë pjese e Komisionit te Vlerësimit dhe rrjedhimisht nuk do te ishte e përshtatshme për ta për te marre pjese ne takimet e organizuara nga KLSH ose te shprehe qëndrime lidhur me vendimmarrjen e Komisionit.
Ky konstatim nuk qëndron pasi nuk ka baze ligjore mbi te cilën mbështetet.
3. *Në lidhje me konstatimin në faqen 3 të Akt Konstatimit nr. 8 të KLSH "Në këtë mbledhje të komisionit përfaqësuesja e IFC ka kundërshtuar kualifikimin e BOE: 1. L... SHPK (%-11. 7) & E.. France (%25) & A. L... S.. B. . (%33.3) Holande: duke ngritur dy arsye:*
a. çështje integriteti te kompanisë A... (duke iu referuar standarteve te IFC ne draft kontratën e koncesionit pika 2.1 U) ku citohet: Qe ne datën efektive dhe gjate gjithë kohëzgjatjes koncesionari deklaron dhe garanton se;
1. Koncesionari 2.1 deklarimi dhe garancitë e koncesionarit; as ai, as ndonjë prej ortakeve te tij te rëndësishëm (apo ne dijeninë e tij asnjë nga personat e lidhur te tij apo personat e lidhur te tyre) nuk është subjekt i ndonjë hetimi penal për mashtrim, korrupsion, bashkëpunim te fshehte apo pastrim parash ..... etj
IFC lidhur me këtë fakt është bazuar ne dy artikuj gazetash spanjolle te cilat hedhin dyshime mbi përfaqësuesin ligjor te shareholder-it te ABSL-se (Orinoco Mining&Resources B.V dhe anëtarin e bordit te saj, kompaninë ITPS i cili, sipas këtij shtypi është ne ndjekje penale ne Spanje.
Gjithashtu IFC rekomandon se UBO (ultimate beneficiary owner) i A.. nuk rezulton i qartë nëse kompania është shqiptare P.. shpk pavarësisht dokumenteve te paraqitura sipas tyre.
b. çështjen e kontrollit mes kompanive "E..." dhe "S.." te cilat marrin përsipër realizimin e testeve ku sipas IFC-se, "S.." nuk kontrollohet nga "E..." pasi nuk zotëron mbi 40% te se drejtës se votës te kjo kompani, sipas nenit L 233-3 te kodit Tregtar Francez, pika II."...,
Observacion 3 :
Së pari, *KLSH nuk specifikon se ne cilën mbledhje është kundërshtuar nga IFC kualifikimi i BOE fitues.*
Ne fakt IFC nuk e ka kundërshtuar kualifikimin e operatorëve bazuar ne kriteret e kualifikimit fakt të cilin e gjejmë të përshkruar në pikën 1 në faqen 2 të Memos me objekt "Shpjegime mbi çështjet e ngritura nga IFC për vlerësimin e ofertave të "Koncesionit/partneritetit Publik Privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës", ***datë 11.4.2017 në lidhje me procesin e vlerësimit.***
Gjatë procesit të vlerësimit rezultoi se:

1. *Në mbledhjen e datës 03.03.2017, mes Komisionit dhe përfaqësuesve të IFC, pas vleresimit te dokumenteve kualifikuese, IFC u shpreh dakord me kualifikimin si më poshtë:*

1. A.. S.. H... ve T... A.S (%51) & A.. L.. S.. H..i A.S (%49) ; (Turqi), Vlera 4.80 % zbritje nga çmimi i listës së testeve,
2. I.. c.. Sh.p.k (AL) (%66) dhe B.. (B...) Sh.a (%34) Greqi, Vlera 5.70 % zbritje nga çmimi i listës së testeve,
3. L... Sh.p.k (AL) (%41.7) & E..France (%25) & A.. L... S. B..(%33.3) Hollandë, Vlera 10.70 % zbritje nga çmimi i listës së testeve.

2. *IFC mori përsipër* ***vlerësimin e propozimit teknik të tre BOE të kualifikuar (pra duke pranuar kështu kualifikimin për nga pikëpamja e kritereve ligjore)*** *dhe u la si detyrë e përbashkët hartimi i disa pyetjeve sqaruese për këto tre BOE me qëllim verifikimin e disa çështjeve lidhur me dokumentacionin kualifikues të paraqitur prej tyre (por që sipas vendimit të përbashkët nuk mund të konsideroheshin kushte s kualifikimi) .* ***Shiko email z. P. B. lidhur me vleresimin bashkelidhur, drejtuar Komisionit etj.***

3. *Me email-in e datës 07.03.2017 nga ana e IFC (nëpërmjet Studios ligjore K..) u dërguan për Komisionin pyetjet për këto tre BOE.*

4. *Komisioni, me datë 16.03.2017, në bazë të shqetësimeve të ngritura nga Zj.B., hartoi pyetjet për të tre OE ofertues duke i integruar me ato të IFC-së (sipas emailit të konsulentes A.Rr. e studios*

ligjore K. datë 07.03.2017). Për këto pyetje u ra dakord me IFC-në. Këto pyetje iu dërguan të tre BOE me datë 16.03.2017 dhe iu la si afat data 20.03.2017 ora 12.00 për përgjigjet.

5. *Komisioni u mblodh me datë 20.03.2017 ora 14.00 dhe shqyrtoi përgjigjet e këtyre OE dhe në ora 16.00 me IFC.*

Pra nga sa më sipër duket qartë se në mbledhjen e datës 03.03.2017 siç konfirmohet dhe nga Z. B., IFC ka pranuar kualifikimin ligjor te operatorit ekonomik "L.." dhe vetëm më pas gjatë shqyrtimit të pjesës tjetër teknike të ofertës ka ngritur çështjet e integritetit etj. Vlen të theksohet se ne fazën e kualifikimit, operatoret ekonomikë kualifikohen ose s'kualifikohen bazuar në disa kritere te cilat janë të publikuara ne Dokumentet e Procedurës konkurruese ne Aneksin 9 dhe kanë të bëjnë pikërisht me kriteret ligjore, teknike dhe ekonomike te operatoreve.
Në lidhje me çështjet e ngritura nga IFC, është shumë e rëndësishme të gjykohet referuar kritereve të kualifikimit dhe dokumenteve të ofertës të paraqitura nga operatoret.
Përsa i përket përmbushjes së kritereve të kualifkimit nga "L...", theksojmë se në asnjë prej kritereve të vendosura ne RfP nuk janë paraqitur dokumente të cilat përbëjnë shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik për çështjen e integritetit (si të jetë subjekt i dënuar me vendim te formës se prere etj) apo për çështjen e kontrollit mes kompanive.
Për sa më sipër theksojmë se konstatimi se Komisioni ka kundërshtuar IFC-ne në lidhje me kualifikimin nuk qëndron pasi në këtë fazë nuk ekziston asnjë kriter konkret i provuar me dokumentacion mbështetës, i cili e skualifikon operatorin ekonomik ***aq me tepër ofertën më të ulet.***
Për me tepër sqarojmë se: Komisioni vlerëson se nuk disponon dhe as është në dijeni të ndonjë dokumenti zyrtar (vendim gjykate të formës së prerë) që provon se shoqëria A.. (si anëtare e BOE 1. L..Sh.p.k (%41.7) & 2. E.. France (%25) & 3. A. L.. S.. B.V (%33.3) Netherland) nuk përmbush kriterin e përcaktuar në RfP, pra që:

ii. <u>nuk është dënuar</u> për veprat penale të parashikuara në nenin 45/1 të Ligjit për Prokurimin Publik ose për vepra penale të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë profesionale;

-Gjithashtu në bazë të nenit 45/1 dhe 45/2 të LPP, "Autoriteti kontraktor përjashton nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit çdo kandidat ose ofertues, ***<u>kur ka të dhëna se janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjykate të formës së prerë</u>*** *për ndonjë nga veprat e mëposhtme:*
a) pjesëmarrje në organizatë kriminale
b) korrupsion
c) mashtrim
ç) pastrim parash
d) fallsifikim108
*2. Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur: ...****<u>c)</u>***
<u>është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me</u> <u>veprimtarinë profesionale;"</u>
<u>Draft-</u> *kontrata e koncesionit është një dokument i cili është subjekt i ndryshimeve sipas Ligjit për koncesionet*
Komisioni vëren se ky përfaqësues ligjor është zëvendësuar me datë 16.03.2017 sipas dokumenteve të paraqitura nga ky BOE.

- *Se dyti, lidhur me ultimate beneficiary owner (UBO), Komisioni sqaron se në bazë të dokumenteve të paraqitura nga L.., UBO eshte kompania shqiptare P.. sh.p.k e cila nuk figuron të jetë në ndjekje penale apo e dënuar sipas kriterit të përcaktuar në Dokumentet e Procedurës konkurruese. (kjo vërtetohet përmes dokumenteve të paraqitura si: Fiduciary Agreement mes P. Sh.p.k dhe Orinoco Mining &Resources B.V Netherland, date 06.02.2017 si shareholder e ABLS, me board member ITPS, QKR P. etj).*

Lidhur me UBO Komisioni sqaron se:
Karakteristika e Pronarit përfitues fundor (UBO) është se ai shtrihet përtej pronësisë ligjore dhe kontrollit, pra përfaqëson nocionin e fundit të pronësisë (aktuale) dhe kontrollit faktik. Me fjalë të tjera, ky

përkufizim fokusohet ne persona natyral (jo ligjore) që në fakt zotërojnë dhe përfitojnë nga kapitali apo asetet e personit juridik; si dhe për ata që me të vërtetë ushtrojnë kontroll efektiv mbi të, (pra mbi personin juridik) pavarësisht (nëse janë apo jo ata që zënë pozita formale brenda personit juridik), në vend të personave (fizikë ose juridikë) të cilët kanë ligjërisht (në letër) të drejtë për ta bërë këtë.
Për shembull, nëse një kompani është në pronësinë ligjore të një shoqërie të dytë (sipas informacioneve të regjistrimit), pronarët përfitues të vërtetë janë personat fizikë të cilët janë prapa kësaj kompanie të dytë apo të kompanisë fundore dhe e kontrollojnë atë . Po ashtu, personat e listuar në të dhënat e regjistrimit të kompanive, te cilët mbajnë pozita kontrolluese në këtë kompani, por që në të vërtetë janë duke vepruar në emër të dikujt tjetër, nuk mund të konsiderohen pronarët përfitues fundor, për shkak se ata janë në fund të fundit duke u përdorur nga dikush tjetër për të ushtruar kontroll efektiv mbi kompaninë
<u>Sipas këtij arsyetimi, P. rezulton te jete UBO i ABLS-së pavarësisht faktit se për arsye kualifikimi, ky informacion është i panevojshëm.</u>
Pretendimi i ngritur nga IFC në lidhje me kontrollin e "E.." dhe "S.." përsëri nuk qëndron pasi dokumentacioni i paraqitur në SPE dhe ai plotësues, vërtetojnë se këto kompani kanë të njëjtët aksionarë, janë Holding (cross capital participation) dhe shoqata profesionesh, dhe si të tilla rregullohen sipas nenit L 233-3 të Kodit Tregtar francez. (L.. G. ka filial S.. dhe sipas rregullores së organizimit të L..G., kjo e fundit ushtron kontroll efektiv mbi Sealab ku ndërkohë L.. dhe E.. janë cross shareholders).
Për këtë si dokumentacion provues bashkëlidhur do te gjeni:

1. ***Explanatory letter on Commitment 17.03.2017***
2. ***Reglement d'organisation groupe L..***

Sa me lart konstatimet e KLSH nuk qëndrojnë pasi janë te pabazuar ne ligj dhe në prova materiale konkrete.
4. KLSh ka konstatuar se:
a). Në lidhje me konstatimin se Çështje integriteti të kompanisë A..(duke iu referuar standarteve të IFC në draft kontratën e koncesionit pika 2.1 (j) km citohet: Që në datën efektive dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes, koncesionari deklaron dhe garanton se: 1. Koncesionari 2.1 deklarimi dhe garancitë e koncesionarit; as ai, as ndonjë prej ortakëve të tij të rëndësishëm (apo në dijeninë e tij, asnjë nga personat e lidhur të tij apo personat e lidhur të tyre) nuk është subjekt i ndonjë hetimi penal për mashtrim, korrupsion, bashkëpunim të fshehtë apo pastrim parash..... etj.
IFC lidhur me këtë fakt është bazuar në dy artikuj gazetash spanjolle të cilat hedhin dyshime mbi përfaqësuesin ligjor të shareholder-it të A...-së (Orinoco mining & resources) B.V dhe anëtarin e bordit të saj, kompaninë ITPS i cili, sipas këtij shtypi është në ndjekje penale në Spanjë.
Gjithashtu IFC rekomandon se UBO (ultimate beneficiary owner) i A.. nuk rezulton i qartë nëse kompania është shqiptare "P." shpk pavarësisht dokumenteve të paraqitura sipas tyre.
Për këtë arsye Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 417, dt. 02.10.2015 ***duhej të kryente hetimet e arsyeshme*** *në përputhje me Dokumentet e Procedurës Konkurruese të miratuara në pikën 7.7 "AK mund të kryejë çdo hetim të arsyeshëm ose procedurë të ngjashme që e gjykon të nevojshëm për të shqyrtuar integritetin dhe gjendjen financiare në lidhje me Ofertën e një Ofertuesi". Pika 7.8 "Ofertuesi duhet të japë menjëherë informacionin dhe asistencën e kërkuar nga AK për kryerjen e çdo hetimi të nevojshëm".*
Detyrim ky që nuk është kryer, por AK është mjaftuar vetëm me pyetjet dhe përgjigjet e BOE, pa u hetuar në përgjigjet e dhëna për të nxjerrë konkluzione të mjaftueshme me qëllim vlerësimin e drejtë të ofertave nga Komisioni i Vlerësimit.
Observacion 4:
Ky konstatim nuk qëndron pasi në momentin që janë ngritur çështjet nga përfaqësuesit e IFC, AK ka kërkuar informacion dhe dokumentacion shtese fillimisht nga ofertuesi me date 16.03.2017 (siç është administruar dhe ne dosjen e marre nga KLSH) për te cilat ka marre përgjigje me date 19.03.2017 nga ky konsorcium te shoqëruar me dokumentacion mbështetës ne forme elektronike dhe shkresore.
Gjithashtu theksojmë se verifikimet lidhur me këtë konsorcium kane qene shteruese ne një periudhe gati 2 vjeçare gjate se cilës janë bere verifikime ne mënyrë te vazhdueshme nga AK deri ne momentin e nënshkrimit te kontratës dhe për te cilat nuk ka rezultuar asnjë prove qe te çonte ne skualifikimin e këtij konsorciumi dhe rrjedhimisht mos lidhjen e kontratës me te. (ju lutem referojuni dosjes Nr.5 te projektit –emërtuar "Negociatat", dhe korrespondencës se AK me Ambasadën Holandeze etj.)

Sqarojmë se Njoftimi i Fituesit ligjërisht nuk përbën conditio sine qua non për lidhjen e kontratës me Operatorin e shpallur fitues, pasi AK ne çdo kohe përpara lidhjes se kontratës mund te skualifikoje një OE ne përputhje me legjislacionin e aplikueshëm (LPP). Konkretisht neni 47 i tij përcakton se: "Neni 47 Raportimi i skualifikimit[30]*Autoriteti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues,* ***që paraqet të dhëna të rreme***[31]***, për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës***[32]***.*** *Autoriteti kontraktor për çdo skualifikim raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik për qëllimet e parashikuara në nenin 13 pika 3 të këtij ligji."*
Te gjitha verifikimet (qe gjinden ne dosjen e negociatave te PPP) e cila iu dorëzuar KLSH-se, te kryera nga AK janë bere ne dijeni te plote te IFC-se.
Konkretisht vete IFC ka mbështetur negociatat me këtë konsorcium (shiko opinionin ligjor te studios se kontraktuar nga IFC lidhur me nënshkrimin e kontratës. (bashkëlidhur email dhe shkresa date 02.09.2017).
Pra duket qartë angazhimi i gjatë dhe i arsyeshëm i AK por edhe i IFC-se në lidhje me hetimin e kryer për këtë çështje.
Për sa me sipër vlen të theksohet se ***ligjërisht*** *autoriteti kontraktor nuk ka detyrimin taksativ ta bëjë një gjë të tillë siç parashikohet nga Audituesit por referuar pikës 7.7 të dokumenteve te procedurës konkurruese "Autoriteti Kontraktues* ***mund*** *te kryeje çdo hetim të arsyeshëm ose procedurë te ngjashme qe e gjykon të nevojshëm për të shqyrtuar integritetin dhe gjendjen financiare ne lidhje me Ofertën e një Ofertuesi " lihet në diskrecion të autoritetit konkurrues gjykimi në lidhje me hetimin dhe mënyrën e kryerjes së tij (pra dispozite lejuese dhe jo urdhëruese).*
Për një interpretim ne analogji te rastit, ne zbatim te parimeve te përgjithshme te se drejtës, barra e provës bie mbi subjektin qe pretendon një fakt, konkretisht:

- *Në procedurat administrative, (neni 82 i K.Pr. Administrative), ashtu dhe nga përcaktimet e Kodit te Procedurave Civile apo Penale, kur pretendohet një fakt (marrim shembullin e IFC-se), barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion provat e zotëruara prej tij.*
- *Neni 12 i Kodit te Proc. Civile parashikon se... "pala pretenduese ka detyrimin qe ne përputhje me ligjin te provoje faktet mbi te cilat bazon pretendimin e saj"..*
- *Neni 4 i Kodit te Proc Penale parashikon se..."i pandehuri konsiderohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor te formës se prere.." (rasti potencial i ABLS për te cilin u ngritën dyshime mbi bazën e dy artikujve te gazetave)*

(Për me tepër kur IFC ishte caktuar per te ndihmuar AK ne përzgjedhjen e partnerit).
Theksojmë se asnjëherë IFC (ne atë faze te procesit dhe as me vone) nuk ka paraqitur dokumente apo prova me qellim vërtetimin e pretendimeve te saj pavarësisht se ka patur te gjithë kohen dhe mundësitë për ta bere, përkundrazi ka mbështetur projektin duke udhëhequr negociatat.
Pavarësisht sa me lart, meqenëse KLSH ka përdorur për gjetjet e veta konstatimet e hershme te IFC-se lidhur me procesin e vlerësimit, konstatime te cilat janë rrezuar ne mënyrë shteruese ne vazhdimësi kohore, ne përfundim, bëjmë me dije se përpara lidhjes se Marrëveshjes, vete IFC ka drejtuar dhe ka bere verifikimet përkatëse veçanërisht me Exalab, siç është e dukshme edhe nga takimi i mbajtur ne Beograd ne zyrat qendrore te IFC-se mes përfaqësuesve te Konsorciumit dhe IFC-se . (shiko emailin bashkëlidhur nga Znj. P. -IFC).

5. ***KLSH****: Në lidhje me konstatimin fq. 7 se në ofertën e paraqitur nga L. "...mungon autorizimi i aksionareve për angazhimet për shërbimet laboratorike sipas ofertës" për E...:*

[30] Titulli i nenit ñRaportimi i skualifikimitò ,ò i ndryshuar me Ligjin nr. 47/2017 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, të ndryshuar
[31] Hiqen fjalët ñose një dokument të falsifikuarò me ligjin nr. 131/2012ñPër disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, të ndryshuar
[32] fjalët ñ, deri në fazën e shpalljes së kontratës fituese.ò zëvendësohen me fjalët ñ, deri në momentin e lidhjes së kontratës.ò ndryshuar me Ligjin nr. 47/2017 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, të ndryshuar

Observacion 5:
Bashkëlidhur do te gjeni:

- ***Letter of Confirmation and Commitment date 09.02.2017 te lëshuar nga Presidenti i grupit, J. P. B.***
- ***Corporate information on the Bidders appendix 25***
- ***Explanatory letter 21.02.2017***

Dhe i janë vene ne dispozicion KLSH-se direct nga SPE dhe ne hard copy.
Për aq kohe sa bid është firmosur nga "legal representative" vërtetësia e te cilit është provuar me "commercial registry document", pyetja lidhur me vendimet e bordit nuk eshte relevante.
Letra e presidentit konfirmon qe grupi është ne dijeni te investimit ne projekt.
Ndaj ky konstatim është i pa bazuar ne prova.

6. *Ne lidhje me konstatimin fq. 7 se ...."Ndërkohë nga auditimi i dokumenteve te paraqitura rezulton se e vetmja marrëdhënie si ligjore dhe ekonomike midis A.. (the fiduciary) dhe P.. shpk (the principal) eshte nje Fiduicary Agreement (Shares of A.. L.. . B.) nënshkruar ne date 06 Shkurt 2017, e cila ne thelb te saj ka vetëm ruajtjen e 1800 aksioneve me vlere nominale 10 Euro secila, te cilat sipas kësaj kontrate P... SHPK (the principal) ja beson ne ruajtje ne emër te Fiduciary(ABSL) por për llogari dhe risk te Principal , veprim ky i cili do te konsiderohet" the Services" pra shërbimi.",*

….. Pra në thelb, kjo kontratë nuk paraqet asnjë angazhim apo dhe pronësi të P.. mbi A.., por është përdorur si "koracë" përfaqësimi për konsorciumin dhe përfaqësimin në konkurrimin e hapur për koncesionin e laboratorëve., pasi nëse do të ishte paraqitur vetë P... si aksioner në konsorciumin e ngritur atëherë pjesëmarrja e tij rezulton 75% të aksioneve dhe jo ndarja që është paraqitur në marrëveshjen e konsorciumit. "L.." shpk (%41.7) & "E.." France (%25) & "A. L.. S.. B.." (%33.3) Hollandë, ku natyrisht ndryshojnë dhe kushtet e vlerësimit të cilat në shumicën e detyrimeve i takojnë atij për ti përmbushur si nga ana ligjore dhe financiare.
E cila është qartësuar me dokumentacionin e mëposhtëm ku nga auditimi i dokumenteve të paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës rezulton:
- Certifikata e regjistrimit në datën 07.05.2008 me nr. 70491729 për shoqërinë "P..."sh.p.k. Republika e Kosovës ortaku i vetëm J.K.
- Me numrin unik të identifikimit të subjektit J62903750A në datën 01.07.1996 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit "P..." shpk ortaku i vetëm J. K.
- Me numrin unik të identifikimit të subjektit L22312016D në datën l2.11.2012 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit "P... M.." shpk ortaku i vetëm J. K .
- Me numrin unik të identifikimit të subjektit K627l7603C në datën 12.06.2006 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit "P...-V.." shpk me ortakët L. K me 50% të aksioneve dhe J. K me 50% të aksioneve.
- Me numrin unik të identifikimit të subjektit K72202013A në datën 02.10.2007 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit "L..." shpk ortaku i vetëm J.. K.
Për sa konstatohet në dokumentet e mësipërme dy nga operatorët e këtij BOE "L.." shpk (%41.7) dhe A. L.. S.. B.V" i cili sqaron se në bazë të dokumentave të paraqitura UBO (ultimate beneficiary owner) (Pronari i fundit përfitues) është "P..." shpk. Të dy operatorët e mësipërmë ***janë kompani shqiptare me ortak J. K me 100% të aksioneve.***

Observacion 6: *KV shprehet se siç është përshkruar dhe më sipër, kualifikimi dhe vlerësimi i ofertave nuk bëhet në bazë të marrëveshjeve apo supozimeve por duke vlerësuar dokumentet kompanive të cilat janë pjese e marrëveshjes se përkohshme të bashkimit të operatoreve te paraqitur në gare, ndaj ky konstatim është i pa baze.*
Theksojmë se kriteret janë përmbushur nga ky BOE dhe ndryshimi i % ne pjesëmarrje edhe sikur te merrej ne konsiderate ky arsyetim, nuk do te kishte efekt për sa kohe ana teknike e projektit do te kryhej nga E.. e cila ne përqindjen e saj plotësonte dhe tejkalonte kriteret e kualifikimit dhe për sa kohe ne RfP ishte përcaktuar nga IFC se: [1] P.sh. nëse një anëtar zotëron 30% të interesit në Bashkimin e Shoqërive,

kualifikimet e tij mund të kontribuojnë proporcionalisht për përmbushjen e Kritereve të Kualifikimit ***por kjo nuk e përjashton mundësinë e këtij anëtari për të përmbushur i vetëm dhe pa kontributin e antarëve të tjerë Kriteret e Kualifikimit (fq.42, pika 12.3.2)***
Ndaj ky konstatim është supozim dhe i pa bazuar ne lex specialis RfP.
7. *KLSH-Në lidhje me konstatimin se: "3.16.4 Asnjë Ofertues apo anëtar i një Bashkimi Shoqërish nuk mund të ushtrojë kontrolle mbi një Ofertues tjetër apo mbi një anëtar të një Bashkimi Shoqërish. Për qëllime të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese, "kontroll" nënkupton kompetencën për të zgjedhur shumicën e anëtarëve të bordit drejtues (ose të një organi tjetër të ngjashëm) ose për të drejtuar administrimin dhe politikat e një subjekti, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, qoftë përmes zotërimit të drejtave të votës, sipas kontratës ose ndryshe, dhe "kontrollues" dhe "i kontrolluar" kanë kuptime të lidhura reciprokisht",*
Obsevacion 7: *Referuar çështjes se ngritur ne faqen 8 te raportit, sqarojmë se ne zbatim te Nenit 25 pika 7 te VKM nr. 575 date 10.07.2013 (i ndryshuar), i cili parashikon se: Operatori ekonomik, pjesëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht dhe oferta individuale, qëllimi i pikës 3.16.4 dhe 3.16.4 te dokumenteve te tenderit ka qene* ***vetëm qe te ndaloje*** *pjesëmarrjen e një ofertuesi qofte si ofertues i vetëm qofte se anëtar i një bashkimi te shoqërive ne oferta paralele ne tender nëpërmjet shoqërive te tjera te kontrolluara nga i njëjti person te cilat cenojnë konkurrencën e tenderit,* ***dhe jo*** *qe te ndaloje qe një person te ketë kontrollin direkt apo indirekt te shoqërive anëtare* ***te te njëjtit bashkim operatoresh****. Pra, pika 3.16.4 është vendosur* ***me qëllimin e vetëm qe te mos lejoje shmangien nga ndalimi i parashikuar ne piken 3.16.3*** *nëpërmjet shoqërive/entiteve te ndryshme qofte si ofertues i vetëm apo si anëtar te një konsortiumi* ***tjetër*** *nëpërmjet shoqërive te tjera te kontrolluara nga i njëjti person.*
Kjo pikë i referohet kontrolleve te ndonjë ofertuesi mbi ofertues tjetër pra konkurrent dhe jo mbi kompanitë e të njëjtit bashkim të përkohshëm të operatoreve që paraqesin një ofertë të vetme. Në rastin konkret asnjë nga operatoret qe kanë marrë pjesë në garë si kompani e vetme apo bashkim shoqërish përfshirë dhe "P. sh.p.k", nuk ushtrojnë kontrolle në ndonjë kompani apo bashkim shoqërish të ndonjë ofertë tjetër në këtë procedurë. Për këtë arsye, konstatimi se bashkimi i operatoreve "L...", "E..." dhe "A.. L.. S..." duhet skualifikuar, ***është jo ligjor dhe i pabazuar aq me tepër te përbejë arsye skualifikimi.***
8. Në lidhje me konstatimin se "...nga auditimi rezulton se ne dosjen e dokumenteve te dorëzuara nga BOE fitues nuk janë te gjitha dokumentet origjinale kjo ne kundërshtim me kërkesat e Dokumenteve te Procedurës Konkurruese pika 5.2.6...",
Observacion 8: *theksojmë se duke qene procedure me mjete elektronike dokumentacioni i plote kualifikues ndodhet ne SPE. Dokumentacioni i dorëzuar nga konsorciumi pra përpara lidhjes se kontratës është ne dosjen e dorëzuar nga përfaqësuesi i këtij BOE pranë AK i cili ka qene dhe subjekt auditimi te hollësishëm nga KLSH ne vitin 2019, dokumentacion i cili është verifikuar ne lidhje me atë te paraqitur ne SPE. (bashkëlidhur kopje dhe verifikimi mund te behet edhe pranë noterit)*
**Shënim: Ky dokumentacion është dërguar për verifikim dhe ne përfaqësitë e huaja përgjigjet e te cilës i keni ne dosjen nr. 5Negociatat, dorëzuar pranë KLSH.*
Këtu nuk është përfshirë Suport Documents pasi ato kane qene ne dosje te veçantë vene ne dispozicion KLSH. *Nëse kërkohet jemi te gatshëm ta paraqesim.*
9. Në lidhje me konstatimin se "Në dosjen e PPP nuk ndodhet ndonjë dokument për fillimin e negociatave për nënshkrimin e kontratës",
Observacion 9: *shprehemi se ky konstatim nuk qëndron pasi me shkresë nr. 77/20 date* ***19.05.2017*** *është njoftuar ofertuesi fitues dhe IFC për fillimin e procesit të negocimit të kontratës. Kjo shkrese ka qene ne inventarizimin e dosjes se dorëzuar pranë KLSH.* ***(shkresa bashkëlidhur) dhe vete KLSH ne një paragraf me lart ka cituar shkresën e lartpërmendur.***

Përfundime:

1. ***Komisioni vëren se ky projekt është audituar ne vitin 2019 ne themel (ne një auditim përputhshmërie dhe financiar) nga ana e KLSH-se dhe e gjykon te absolutisht te pavlefshëm aktin e konstatim ne tërësinë e tij bazuar ne parimin ligjor te se drejtës "ne bis in idem" ne baze te se cilit nuk mund te ri gjykohet e njëjta çështje disa here.***

2. ***Ne rast se do te veprohej vazhdimisht siç ka vepruar KLSH ne rastin konkret, duke pasqyruar ne vite te ndryshme te njëjtat gjetje por me qëndrime te ndryshme, atëherë e drejta do te***

kompromotohej ne varësi te interpretimeve te grupeve te ndryshme te auditimit duke sjelle pasoja për vete institucionet e përfshira ne këtë proces dhe intimidim te personelit teknik i cili ka punuar me përkushtim për këtë projekt kaq te madh.

3. ***Kontrata është miratuar dhe është bere efektive me Vendim te KM ndaj është shqyrtuar nga te gjitha strukturat shtetërore duke u konsideruar korrekte ne tërësinë e gjithë procedurës dhe duke validuar ate ex post.***
4. ***KLSH ka patur te gjithë mundësitë te kontrolloje qe ne vitin 2017 ketë procedure dhe te nxjerre rezultatet përkatëse për te cilat mund te relationte, gjë te cilën e ka realizuar ne mënyrë shteruese vetëm ne vitin 2019.***

KOMISIONI I DHËNIES ME KONCESION/PPP.
R. C. –Kryetar
L. H. (FSDKSH)-Anetar
A. P.)-Anetar
G. V (ATRAKO))-Anetar
A. A. (ATRAKO))-Anetar
(Zj.A.ka firmosur Raportin Përmbledhës Nr. Prot. 77/11 date 03.04.2017, i cili propozon shpalljen e fituesit, ndërsa me leje ka qene nga data 13.03.2017-27.03.2017).
S. N. – Anëtar

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:
Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar Komisioni i Dhënies me Koncesion për "Dhënien me Koncesion/PPP për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiakë të Sarandës dhe Lushnjës" me shkresën nr. 1819/20 dërguar me Email të datës 24.07.2020 për Akt Konstatimin nr. 8, dt. 15.07.2020, grupi i auditimit gjykon se nga Komisioni i Dhënies me Koncesion nuk janë sjellë argumentuese të qenësishme të cilat nuk ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte.
Për sa më lart argumentet e sjella nga Komisioni i Dhënies me Koncesion, nuk qëndrojnë dhe nuk merren parasysh nga grupi i auditimit.

Mbi bazën e dokumentit të paraqitur u ndryshua konstatimi si më poshtë:
Për hartimin dhe nënshkrimin e kontratës së mësipërme Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është këshilluar paraprakisht me Avokaturën e Shtetit sipas shkresës nr. 2703/1, dt. 05.11.2018, në funksion të Ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 ñ*Për avokaturën e shtetit*ò, kreu v, veprimtaria e Avokaturës së Shtetit dhe marrëdhëniet ndërinstitucionale, Neni 15 Këshillim, pika 4, ñ*Për hartimin dhe nënshkrimin e kontratave administrative, të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative, këshillimi i organit përkatës të administratës publike me Avokaturën e Shtetit është i detyrueshëm. Në këto raste, këshillimi i organeve të administratës publike me Avokaturën e Shtetit zgjat deri në përmbushjen e detyrimeve të kontratave nga palët nënshkruese*ò.

B.Monitorimi i Kontratës Koncesionare "Për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjes."

B.)Për të realizuar objektin e auditimit, grupi i audituesve u fokusua, në zbatimin akteve ligjore dhe nënligjore, të ligjit nr.125/2013 ñPër koncesionet dhe Partneritetin Publik privat, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.258, datë 24.04.2019 ñPër miratimin e kontratës së koncesionit/PPP për ofrimin e shërbimeve laboratorike të Spitaleve Universitare, Rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjësò i ndryshuar , të Kontratës Koncesionare nr.1924/2 prot datë 10.04.2019, të Urdhër të Ministrit të MSHMS nr.634 datë 03.09.2019, me shkresë nr.4311 prot datë 03.09.2019 ñPër ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të Komitetit Ndërlidhës të Kontratës Koncesionare 1924/2, datë 10.04.2019ò, të Urdhër të Titullarit të AK nr.647 datë 11.09.2019 i

ndryshuar me Urdhërin nr.128 datë 02.03.2020, dhe çdo akti juridik që është në fuqi në lidhje mbi kontratat e koncesioneve.

1.Më datë 10.04.2019 MSHMS në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe Koncesionari kanë nënshkruar kontratën për partneritetin publik-privat për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekesore me nr. prot 1924/2 datë 10.04.2019 (Kontrata e koncesionit).
-Këshilli i Ministrave e ka miratuar Kontratën Koncesionare (KK) përmes VKM-së nr.258 datë 24.04.2019 ñPër miratimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat ñPër ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjes.ò, botuar në Fletoren Zyrtare nr.63 datë 02.05.2019.
-Objekti i Kontratës së sipërpërmendur është: Financimi, Projektimi, Ndërtimi, Administrimi, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe transferimi i objekteve laboratorike, në Spitalet Referuese, gjithsej 18 objekte laboratorike, ku përfshihen (Spitali Universitar ñNënë Terezaò, Spitali Universitar i Traumës, Spitali Universitar ñShefqet Ndroqiò, Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik ñKoco Glozheniò, Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik ñMbretëresha Geraldinëò, Spitalet Rajonale të Durrësit, Elbasanit, Shkodrës, Lezhës, Kukës Fierit, Beratit, Vlorës, Korçës, Dibër, Gjirokastër dhe Spitalet bashkiake Lushnjës , Sarandë).
-Kjo KK ka për qëllim përmirësimin e shërbimit të laboratorëve (realizimin e 164 analizave) nëpërmjet ngritjes së një sistemi të integruar në infrastukturë dhe me pajisje të teknologjisë së lartë, të cilat sigurohen nga Koncesionari me shpenzimet e veta, dhe në momentin e fillimit të shërbimit të laboratorëve, realizohet pagesa për çdo muaj, në bazë të numrit të ekzaminimeve laboratorike të realizuara, për një periudhë 10 vjeçare. Më pas i gjithë investimi në infrastrukturë dhe pajisje, ngelet në pronësi të Shtetit shqiptar.
- Pas hyrjes në fuqi palët takohen më pas për të dëshmuar përmbushjen e kushteve të mësipërme dhe nënshkruajnë një deklaratë të përbashkët për këtë qëllim. Data e nënshkrimit të deklaratës së përbashkët do të quhet si "Data e Fillimit". Të drejtat dhe detyrimet e palëve për të kryer Punimet dhe ofruar Shërbimet janë të kushtëzuara dhe fillojnë nga Data e Fillimit.
-Në bazë të Nenit 4.2.4 të Kontratës, Ministria dhe Koncesionari kanë nënshkruar ñDeklaratën e Mbylljesò me shkresë nr.2570/6 prot datë 04.09.2019, për të dëshmuar përmbushjen e kushteve paraprake i cili shprehet se ñData efektive e kësaj kontrate(kur edhe hyn në fuqi) do të jetë data e nënshkrimit të kësaj kontrate në mënyrë të rregullt nga të dyja palët dhe pas miratimit nga Këshilli i Ministrave dhe publikimit në Fletoren Zyrtare. Palët do të takohen më pas për të dëshmuar përmbushjen e kushteve të mësipërme dhe do të nëshkruajnë një deklaratë të përbashkët për këtë qëllim. Data e nënshkrimit të deklaratës së përbashkët do të quhet si ñData e fillimitô Të drejtat dhe detyrimet e palëve për të kryer Punimet dhe ofruar Shërbimet janë të kushtëzuara dhe fillojnë nga Data e Fillimit.ò
2. Nga auditimi u konstatua se, kjo procedurë ka ndalur për gati 2 vjet shpalljen e fituesit të Koncesionit, nga maj 2017 deri në prill të 2019, kur u finalizua (Kontrata e koncesionit) nr.prot 1924/2 datë 10.04.2019, periudhë në cilën detyrimisht grupi i negocimit të kontratës, duhej të reflektonte ndryshimet që duhet të pësonin Shtojcat e KK, në lidhje me afatet kohore të impementimit të laboratorëve për Spitalet universitare, referuese dhe bashkiake.
3. Nga Ministria e Financës dhe ekonomisë është nënshkruar Kontrata e Këshillimit më datë 18.10.2019 me Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC) për monitorimin e KK nr.1924/2 prot datë 10.04.2019.
Gjithashtu në bazë të KK nr.1942/2 prot datë 10.04.2019, neni 28 (Tarifa e Zhvillimit të Projektit) thuhet se ñ..Nga miratimi i kësaj KK nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenin 4.2.4, Koncesionari i paguan International Financial Corporation (IFC) një shumë prej 600,000 Euro (gjashtëqind mijë euro) në një apo dy këste të barabarta, sipas diskrecionit të Koncesionarit, por në çdo rast si kusht paraprak për Datën e Fillimit sipas nenit 4.2.2 (b)é ò
Nga auditimi u konstatua se, Tarifa e zhvillimit të projektit, të Kontratës nr. prot 1924/2 datë

10.04.2019, është paguar më datë 04.10.2019, në bazë të Fatuarës së lëshuar nga IFC, urdhërin e xhirimit dhe konfirmimin e kodit SËIFT e lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare, në vlerën prej 600,000 Euro.

-Nga auditimi u konstatua se, me Urdhër të Ministrit të MSHMS nr.634 datë 03.09.2019, me shkresë nr.4311 prot datë 03.09.2019 ñPër ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të Komitetit Ndërlidhës të Kontratës Koncesionare 1924/2, datë 10.04.2019ò në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr.125/2013 ñPër koncesionet dhe Partneritetin Publik privat, pikës 6.1;6.1.1;6.1.2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.258, datë 24.04.2019 ñPër miratimin e kontratës së koncesionit/PPP për ofrimin e shërbimeve laboratorike të Spitaleve Universitare, Rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjësòi ndryshuar me Urdhërin nr.647 datë 11.09.2019 me shkresë nr.4311/1 prot me Urdhërin nr.128 datë 02.03.2020, me përbërje sipas tabelës si vijon:

Nr	Emër Mbiemër	Përfaqësuesi i Palës	Pozicioni
1	G. P.	MSHMS (Sek i Përgjithshëm)	Kryetar
2	M. R.	MSHMS (Zv/Ministër)	Anetar
3	A. B.	Përfaqësuese e QSUT	Anëtar
4	J. J.	MSHMS (Drejtor I Koncesioneve dhe Prokurimeve	Anëtar
5	L.H.	FSDKSH	Anëtar
6	S. R.	Përfaqësues i Koncesionarit	Anëtar
7	A. Al.	MSHMS	Anëtar
8	L. Q./S. L.	IFC/IFC Consultant	Anëtar

Detyrat e Komitetit të Ndërlidhjes:

-Të shqyrtojë dhe të diskutojë Dokumentat e projektimit (janë të gjitha vizatimet, raportet, dokumentet, llogaritjet e programeve dhe dokumentave të tjera të projektit, duke përfshirë projektet konceptuale, projektet e hollësishme dhe vizatimet përfundimtare të punës që prodhohen nga koncesionari në përputhje me këtë Kontratë, me qëllim për të siguruar lejet dhe kryer punimet), me njësinë e zbatimit të projektit sipas Kontratës Koncesionare të miratuar me VKM ï në nr.258, datë 24.04.2019.

-Të asistojë në administrimin e procesit të zgjidhjes së çështjeve të ndërveprimit, sikurse parashikohet në nenin 16 (ñSecila nga Palët punon me mirëbesim me qëllim lidhjen dhe nënshkrimin nga Koncesionari dhe secili Spital Referues, brenda nëntëdhjetë (90) ditëve por në asnjë rast jo më vonë se njëqind e tetëdhjetë (180) ditë pas Datës Efektive, të një Kontrate që parashikon masa të posacme nga Koncesionari dhe secili prej Spitaleve Referuese në lidhje me çështjet e mëposhtme ñMarrëveshjet e Ndërveprimitò, dhe rreptësisht në përputhje me parimet parashikuara në këtë kontratë në lidhje me këto çështjeò

-Të shqyrtojë çështjet që lidhen me të gjitha aspektet e përditshme të realizimit të kësaj Kontrate, duke përfshirë monitorimin e progresit të punimeve, shkallën e kryerjes së Shërbimeve dhe pajtueshmërinë me detyrimet e E&S nga Koncesionari, sipas kuptimit të dhëna në nenin 20.4 të Kontratës Koncesionare nr.1924/2 datë 10.04.2019, ku citohet:

-Të diskutojë, shqyrtojë dhe japë rekomandime për përshtatjen e Tavanit të Buxhetit Vjetor të Projektit dhe Tavanet e Buxhetit për Spitalet Referuese dhe të propozojë përshtatje periodike tremujore të Tavanit e Buxhetit Vjetor.

-Të sigurojë një forum për diskutime të përbashkëta strategjike, duke shqyrtuar ndryshimet aktuale dhe të parashikuara të kushteve të tregut dhe çështjeve nënpërgjegjësinë e Autoritetit dhe ndryshimeve të mundshme të kësaj Kontrate për të pasqyruar këto ndryshime apo për një performacë më eficente të kësaj Kontrate.

-Të shqyrtojë të gjitha raportet tremujore për punën dhe monitorimin e Shërbimeve, në përputhje me Treguesit e Performancës.
-Të përgatisë dhe dakordojë për planet e korigjimeve në përputhje me Treguesit e Performancës.
-Ti raportojë Titullarit të AK në mënyrë periodike ose sa herë ti kërkohet në lidhje me ecurinë e Kontratës koncesionare nr.1924/2 datë 10.04.2019.
4.Nga auditimi në vijim, nga MSHMS me shkresë nr.4310 prot datë 03.09.2019 është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor Urdhër nr.635 datë 03.09.2019 ñPër përmbushjen e detyrimeve të kontratës koncesionare nr.1924/2 datë 10.04.2019 ñPër ofrimin e shërbimeve laboratorike të Spitaleve Universitare, Rajonale dhe atyre Bashkiake të Sarandës dhe Lushnjësò, ku midis të tjerave urdhërohet që:
-Pika 2/5 ñTë lidhin dhe të nënshkruajnë me Koncesionarin, një Kontratë Ndërveprimi, ku të parashikohen masa të posaçme nga Koncesionari dhe secili prej Spitaleve Referuese sipas pikave të paracaktuar në KK;
-Pika 3 ñKontrata e ndërveprimit duhet të lidhet brenda nëntëdhjetë (90) ditëve por në asnjë rast jo më vonë se njëqind e tetëdhjetë (180) ditë pas Datës Efektive të Kontratës nr.1924/2 datë 10.04.2019ò, kjo në zbatim të Kontratës nr. prot 1924/2 datë 10.04.2019 (Kontrata e koncesionit) neni 16 ñSecila nga Palët punon me mirëbesim me qëllim lidhjen dhe nënshkrimin nga Koncesionari dhe secili Spital Referues, brenda nëntëdhjetë (90) ditëve por në asnjë rast jo më vonë se njëqind e tetëdhjetë (180) ditë pas Datës Efektive, të një Kontrate që parashikon masa të posacme nga Koncesionari dhe secili prej Spitaleve Referuese në lidhje me çështjet e mëposhtme ñMarrëveshjet e Ndërveprimitò, dhe rreptësisht në përputhje me parimet parashikuara në këtë kontratë në lidhje me këto çështjeò, pra jemi në tejkalim të afateve nga Data Efektive (data e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe pas miratimit të Këshillit të Ministrave dhe publikimi në Fletoren Zyrtare).ò
-Pika 4 ñTë raportojë rregullisht për zbatimin e kësaj kontrate në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
-Pika 5 ñNgarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Spitalet Universitare, Rajonale dhe Bashkiake të Lushnjës dhe Sarandësò.
5. Në bazë të KK nr.1924/2 datë 10.04.2019, neni 26 (Garancia e Përformancës) ku thuhet se ñSi garanci për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të Koncesionarit sipas Kontratës, qoftë kur penalizohet nga pagesa e dëmeve të Likuidueshme apo në ndonjë rast tjetër, koncesionari I dorëzon Autoritetit në përputhje me Neni4, një garanci të nënshkruar rregullisht në formën e parashikuar në Shtojcën 15 (Forma e Garancisë së Performancës) e lëshuar nga një bankë e njohur e pranueshme përAutoritetin, të një shume të barabartë me 700,000 Euro (Shtatëqindmijë) e cila do të ruhet gjatë gjithë kohës së kontratës.ò
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, Garancia e performancës (Shtojca 15) lëshuar nga OTP Bank Albania më datë 27.08.219 Garanci bankare me ref.357200 në shumën prej 700,000 Euro e vlefshme deri më datë 27.08.2029.

6. Nga auditimi i deritanishëm mbi ecurinë e projektit të Kontratës së Partneritetit Publik Privat për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore, në laboratorët e spitaleve universitare dhe rajonale sipas fazave:
1.Rikonstruksioni/Përshtatja dhe rregullimi i ambienteve
2.Instalimi i Aparaturave
3.Sistemi LIS
4.Trajnimi mbi procedurat

Aktualisht shërbimi laboratorik nga Koncensionari realizohet si vijon:

1.Në Qendrën Universitare Spitalore ñNënë Terezaò që prej dates 02.11.2020, në mbështetje të

shkresës së MSHMS me nr.3992/7 prot datë 09.11.2020, mbi të cilën Grupi i punës në Raportin e Inspektimit të protokolluar me nr.3992/2 prot datë 14.10.2020, ka verifikuar përputhshmërinë dhe specifikimet me investimin e kryer në këtë object nga shoqëria koncesionare, duke cilësuar se shërbimi laboratorik i Anatomisë Patologjike nuk është objekt i këtij komisionimi referuar shkresës me nr.1950/1 prot datë 29.05.2020 të MSHMS.
Gjithashtu, MSHMS me shkresë nr.3992/7 prot datë 09.11.2020 i është drejtuar Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në mbështetje të nenit 23.1 të kontratës koncesionare të mundësohet alokimi i fondeve për QSUNT për vitin e parë të shfrytëzimit, e më tej vitin e dytë e në vazhdim.
2.Në Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik ñKoco Glozheniò që prej datës 05.04.2021, në mbështetje të shkresës së MSHMS me nr.81/10prot datë 24.03.2021, mbi të cilën Grupi i punës në Raportin e Inspektimit të protokolluar me nr.1521 prot datë 23.03.2021, ka verifikuar përputhshmërinë dhe specifikimet me investimin e kryer në këtë object nga shoqëria koncesionare.
Gjithashtu, MSHMS me shkresë nr.81/10 prot datë 24.03.2021 i është drejtuar Fondit të Sigurimit të detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në mbështetje të nenit 23.1 të kontratës koncesionare të mundësohet alokimi i fondeve për QUOGJ ñKoco Glozheniò, për vitin e parë të shfrytëzimit, e më tej vitin e dytë e në vazhdim.
3.Në Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik ñMbretëresha Geraldinëò që prej datës 19.04.2020, në mbështetje të shkresës së MSHMS me nr.81/10prot datë 24.03.2021, mbi të cilën Grupi i ounës në Raportin e Inspektimit të protokolluar me nr.1521/2 prot datë 23.03.2021, ka verifikuar përputhshmërinë dhe specifikimet me investimin e kryer në këtë object nga shoqëria koncesionare.
Gjithashtu, MSHMS me shkresë nr.81/10 prot datë 24.03.2021 i është drejtuar Fondit të Sigurimit të detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në mbështetje të nenit 23.1 të kontratës koncesionare të mundësohet alokimi i fondeve për QUOGJ ñMbretëresha Geraldinaò, për vitin e parë të shfrytëzimit, e më tej vitin e dytë e në vazhdim.
4.Në Spitalin Universitar të Traumës që prej datës 01.04.2021, në mbështetje të shkresës së MSHMS me nr.81/10prot datë 24.03.2021, mbi të cilën Grupi i punës në Raportin e Inspektimit të protokolluar me nr.1521/1 prot datë 23.03.2021, ka verifikuar përputhshmërinë dhe specifikimet me investimin e kryer në këtë object nga shoqëria koncesionare.
Gjithashtu, MSHMS me shkresë nr.81/10 prot datë 24.03.2021 i është drejtuar Fondit të Sigurimit të detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në mbështetje të nenit 23.1 të kontratës koncesionare të mundësohet alokimi i fondeve për Spitalin Universitar të Traumës , për vitin e parë të shfrytëzimit, e më tej vitin e dytë e në vazhdim.
5.Në Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò që prej datës 26.03.2021, në mbështetje të shkresës së MSHMS me nr.81/10prot datë 24.03.2021, mbi të cilën Grupi i punës në Raportin e Inspektimit të protokolluar me nr.1521/3 prot datë 23.03.2021, ka verifikuar përputhshmërinë dhe specifikimet me investimin e kryer në këtë object nga shoqëria koncesionare.
Gjithashtu, MSHMS me shkresë nr.81/10 prot datë 24.03.2021 i është drejtuar Fondit të Sigurimit të detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në mbështetje të nenit 23.1 të kontratës koncesionare të mundësohet alokimi i fondeve për Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò, për vitin e parë të shfrytëzimit, e më tej vitin e dytë e në vazhdim.

Ndërsa në Spitalet Rajonale të Durrësit, Elbasanit, Shkodrës, Lezhës, Fierit, dhe Beratit kanë përfunduar tre fazat e para të punimeve dhe po vazhdon trajnimi mbi procedurat. Këto spitale janë në pritje të komisionimit nga MSHMS.
Në Spitalet bashkiake të Lushnjes, Sarandës dhe në Spitalin Rajonal të Vlorës dhe Korçës kanë përfunduar përshtatja dhe rregullimi i ambienteve dhe po punohet për instalimin e aparaturave. Me përfundimin e lidhjes dhe testimit të sistemeve do fillojnë trajnimet e stafit mbi sistemet dhe procedurat. Duke ndjekur fazat si më siper, parashikohet që keto objekte te jene gati për

komisionim brenda datës 20 maj 2021.
Ambientet e laboratorëve të Spitalit Rajonal të Dibrës dhe të Gjirokastrës, Kukës ende nuk i janë dorëzuar koncesionarit nga spitalet përkatese.
Sa më sipër, nga MSHMS nuk disponohen raporte monitorimi progresiv mbi ecurinë e implementimit për laboratorët, për secilin spital përfitues, por janë vetëm Protokolli i orëve të takimeve që ka mbajtur Komiteti i Ndërlidhjes me Koncesionarin dhe me përfaqësuesin e IFC.

7.Nga auditimi i Kontratës PPP nr. 1924/2 prot. datë 10.04.2019 (Kontrata e koncesionit), si dhe në mbështetje të fakteve konkretë të mësipërme, më poshtë po paraqesim konstatimet për mosrespektim të detyrimeve kontraktore të kontratës, nga të dyja palët (Autoriteti Kontraktor/ Koncesionari) si vijon:

7.1)Data efektive është në bazë të datës së miratimit të VKM ï së nr.258 datë 24.04.2019), që do të thotë max i lidhjes së kontratave/marrëveshjeve të ndërveprimit do të jenë jo më vonë se data 24.10.2019.
Nga auditimi u konstatua se asnjë nga spitalet referuese së bashku me koncesionarin, nuk kanë realizuar lidhjen e Kontrave/Marrëveshjeve të Ndërveprimit, në kundërshtim me Kontratën PPP nr. prot 1924/2 datë 10.04.2019 (Kontrata e koncesionit) neni 16, Shtojcën 12 dhe me Urdhërin MSHMS nr.635 datë 03.09.2019, por janë lidhur konkretisht :
- Në QSUNT, Marrëveshja e Ndërveprimit është firmosur shkresë me nr. 12/133 prot., datë 08.09.2020, nga përfaqësuesi i QSUNT z. E.J. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm QSUNT, dhe Përfaqësuesi i Koncesionarit z. S. R. në cilësinë e Administratorit të Koncesionarit.
Gjithashtu nga auditimi u konstatua se, kësaj marrëveshje ndërveprimi i është bashkëlidhur Shtojca nr.5 ñÇështje të tjera që nuk janë adresuar ndryshe në Kontratën e Koncesionit ï Marrëveshja për Cocid-19ò. Vlen të theksohet se ky shërbim nuk është i përfshirë në Kontraten PPP nr. prot 1924/2 datë 10.04.2019, e cila duket si ñMarrëveshje gentle-manò pa efekte financiare, me arsyetimin se :
-Palët marrin në konsideratë gjendjen e pandemisë lidhur me Coronavirusin me të cilën po përballet vendi dhe nevojat e paparashikuara për testime të reja;
-Koncesionari është i gatshëm të japë kontributin e tij dhe të bashkëpunojë me QSUNT për të mundësuar realizimin e këtyre testimeve, duke renë dakort si vijon:
1. Në ambientet e Laboratorit të Mikrobiologjisë QSUNT, të marrë në përdorim nga Koncesionari, do të vazhdojnë të kryhen nga QSUNT;
10350 teste RT PCR Covid-19
30000 teste Serologjike SARS-CoV-2IgG (Covid-19) plus plazëm.
2. Koncesionari do të vendosë në dispozicion të QSUNT infrastrukturën e nevojshme dhe do të krijojë kushte për përdorimin e tyre të qetë nga ana e punonjësve të QSUNT për realizimin e testeve sipas pikës 1 të kësaj marrëveshje.
3. Realizimi i testeve të mësipërme do të bëhet me kitet dhe reagentet e QSUNT.
4. QSUNT do të njoftojë Koncesionarin mbi listën e punonjësve të QSUNT(mjekë dhe laborantë) të cilët do të punojnë për realizimin e testeve, me qëllim aksesismin e tyre në laborator.
(a) realizimin e shërbimeve mjekesore laboratorike gjatë punëve rinovuese në periudhën midis Datës së Fillimit dhe Datës reale të Komisionimit;
(b) shërbimet e zjarrfikëseve dhe të shpëtimit;
(c) shërbimet e sigurisë;
(d) hyrjet/daljet e pacientëve, pacientët e urgjencës dhe jo të urgjencës;
(e) hartimin e formularëve të referimit/rekomandimit të Spitalit Referues për Analizat në përputhje me Shtojcën 8 (Procesi i Referimit);
(f) trajnimin e studentëve të mjekesisë;
(g) procesin dhe dokumentacionin për referimin e pacientëve në përputhje me Procesin e

Referimit.
(h) protokollet për bërjen e Analizave;
(i)menaxhimin administrative të dokumenteve dhe të dhënave të pacientëve;
(j) përdorimin e Pajisjeve Ekzistuese në secilin prej Spitaleve Referuese;
é é .
Grupi i auditimit, mori kontakt me përfaqësues të QUSNT, duke realizuar një takim formal në ambjentet e MSHMS me datë 16.04.2021, me grupin në përbërje: znj. E. R. Drejtore e Performancës Spitalore dhe me grupin e monitorimit sasior të KK: zj.S. F., znj.M. M., znj. E. D., znj. M. S. si dhe përfaqësuesen e MSHMS znj. J. J. Drejtore e Prokurimit dhe Koncesionit, duke rakorduar në bazë të dokumentacionit të monitorimit për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekesore për muajin dhjetor, 2020, pasi pagesa e dhjetorit ka pasur mos rakordime mbi problematikat e konstatuara nga QSUNT, nga ku konstatuam se:
-Në bazë të Urdhrit të Titullarit të QSUNT, nr. 345 datë 23.10.2020, protokolluar me nr. 12/192 prot. ñMbi monitorimin e zbatueshmërisë së Kontratës për Partneritetin publik-privat për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekesoreò, i cili ka përgatitur me shkresë nr. 55/50 prot datë 29.01.2021 ñRelacion mbi monitorimin sasior të Kontratës për Partneritetin publik-privat për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekesore ñ për muajin dhjetor 2020 dhe me shkresë nr.55/107 prot datë 18.03.2021 ñRelacion mbi monitorimin sasior të aktivitetit laboratorik për muajin Dhjetor 2020ò, nga grupi sasior i Monitorimit me përbërje: S. F., E. Th., M. M., E.i D., M. S., M.G. dhe E.K..

Nga auditimi u konstatua se, grupi i monitorimit sasior ndjek aspektet sasiore të Kontratës, ndërsa grupi i cilësisë është përgjegjës për monitorimin e aspekteve cilësore dhe koordinimin e veprimtarive tekniko-shkencore, duke zhvilluar proceset e verifikimit duke u bazuar në raportet e detajuara të gjeneruara nga të dhënat e dixhitalizuara, të dërguara nga Koncesionari si dhe referuar raportimit të aktivitetit laboratorik të raportuar nga shërbimet mjekësore.
Kështu, në bazë të dokumentacionit të hartuar nga grupi i monitorimit sasior të QSUT, të cilët kanë bërë verifikime në terren si dhe në bazë të një përzgjedhje rastësore të disa shërbimeve mjekesore, u morën në shqyrtim:
-Shërbimi i Gastrohepatologjisë
-Shërbimi i Hematologjisë
-Shërbimi i Urgjencës Pediatrike
-Shërbimi i Neurologjisë
-Shërbimi Stroke post Stroke
Nga ku rezultoi se:
a. Shërbimet mjekësore nuk kanë raportuar saktë dhe me përgjegjshmëri numrin e ekzaminimeve laboratorike të referuara dhe ato të kryera (përgjigjet).
b. Shumë shërbime kanë diferenca në numërimin e ekzaminimeve të referuara me ato të kryera, për arsye të vonesave të marrjes së përgjigjeve të analizave apo të mos dërgimit në shërbimin e duhur brenda kohës së referuar në kontratë. Në shumë raste përgjigjia e analizave ka mbërritur në shërbim pasi pacienti i hospitalizuar ka lënë shërbimin, psh Shërbimi Covid 4, ashtu siç referon dhe Administratori Spitalor me shkresë nr.55/10 datë 08.01.2021, ku ka referuar 2561 analiza laboratorike në total për muajin dhjetor 2020 dhe ka marrë përgjigje vetëm për 1647 analiza, pra me një diferencë prej 914 analiza, të cilat nuk janë pasqyruar në raportin përfundimtar të këtij shërbimi.
c. Shumë mjekë janë regjistruar në sistemin LIS (laboratory informacion system) të Shoqërisë koçesionare në shërbimet e gabuara, si psh një mjek i Shërbimit të Endokrinologjisë, rezulton si mjek në Shërbimin e Gastrohepatologjisë, etj.
Nga verifikimi i formularëve të referimit, ka rezultuar se gjatë procesit të regjistrimit të formularëve referues në sistemin LIS të shoqërisë koçesionare, janë ngatërruar emrat e mjekëve apo të shërbimeve. Këto janë problematika që sjellin vonesa apo mosdorëzim në shërbimin e

duhur të përgjigjeve të analizave duke çuar deri në humbjen e tyre dhe për këto arsye mjekët referues nuk referojnë si analiza të kryera në raportimet e tyre mujore.
Si problematikë e ngritur nga shërbimet mjekesore dhe e hasur nga grupi sasior i monitorimit është edhe regjistrimi i mjekëve të Shërbimit të Reanimacionit të Specialiteteve të PAI-t Francez. Ky shërbim nuk është i regjistruar në sistemin LIS dhe përgjigjet e këtyre analizave u shkojnë përkatësisht Shërbimeve ORL, OMF dhe Okulistikë.
e. Gjithashtu, një tjetër problematikë është pranimi nga ana e Shoqërisë koncesionare dhe ekzekutimi i ekzaminimeve laboratorike, me formularë të referimit të cilët nuk përmbajnë elementët bazë të idendifikimit.
Kështu në Shërbimin e Gastrohepatologjisë është konstatuar se mjekut i kanë shkuar analiza të validuara për një pacient që nuk rezulton i shtruar në asnjë shërbim të QSUNT-s (sipas sistemit SISP). Ndërkohë nga verifikimi i formularit me barkod Ré é , është vërejtur që formulari nuk ishte i plotësuar me emrin, numrin unik të identifikimit dhe vulën e mjekut referues, infermierin që ka marrë kampionin, etj. Për këtë arsye 43 ekzaminime biokimike të kryera nga laboratori ñN.ò nuk janë raportuar nga Shërbimi i Gastrohepatologjisë.
Rast tjetër problematik është vërejtur që edhe kur Formulari i referimit është referuar me emrin e një mjeku tjetër ndërsa në vulë ka emrin e një tjetër mjeku.
Sa më sipër, formularët e parregullt sipas Kontratës së Ndërveprimit nuk duheshin pranuar dhe ekzekutuar nga ana e shoqërisë koncesionare.

f. Referuar Kontratës së ndërmjetësimit, pika VII ñStandartet e shërbimitò ku ñKoncesionari duhet të respektojë kohën e propozuar për daljen e rezultatave për çdo analizë, qoftë rutinë apo në kushte urgjenceé é ò, konstatuam se, nga ana e shoqërisë konçesionare, jo gjithmonë, është respektuar koha maksimale për daljen e rezultatit.
Nga verifikimi i përgjigjeve të ekzaminimeve laboratorike në Shërbimin e Kardiologjisë 2, u konstatuan një sërë rastesh ku nuk është respektuar afati kohor i kthimit të përgjigjeve, sipas Kontratës së lidhur me Konçesionarin.
Edhe në Shërbimin e USB për datën 17.12.2020 ku pacientët me nré e barkodeve të formularëvejanë referuar analiza me formular urgjence, por përgjigja e tyre ka vonuar më shumë se 8 orë nga koha e parshikuar në kontratë për analizat e urgjencës që është 30 min.
Vonesa në ardhjen e përgjigjeve të ekzaminimeve laboratorike janë raportuar edhe nga Shërbimi Unite X-knife. Si psh për Hemogramë 5 Pl janë kërkuar në total 40 dhe janë marrë përgjigje vetëm për 25 prej tyre. Diferenca e tyre nuk është raportuar nga shërbimi. Ky problem nuk është raportuar në kohë nga Administratori Spitalor, sipas pikës 6 të urdhërit të titullarit.
Për këto analiza dhe për të tjera si këto rekomandojmë të vijohet me penalitetet e parashikuara në kontratë.

g. Nga verifikimet e kryera në Shërbimin e Neurologjisë është konstatuar që laboratori ñN.ò ka kryer ekzaminime të cilat nuk janë kërkuar nga shërbimet, referuar kjo edhe kopjeve të formularëve në kartela, si psh pacienti me nr. Formulari é . Dhe nr.karteleé ., datëé . Është faturuar ekstra testi HBA1c, kjo ka ndodhur edhe për pacientë të tjerë për analizat si LDL, LDH, HDL. Për rrjedhojë këto ekzaminime nuk janë pasqyruar edhe në raportimin mujor të Shërbimit të Neurologjisë.
gj. Në shërbimin e Urgjencës Pedriatrike, grupi sasior i Monitorimit nuk arriti të verifikojë ekzaminimet laboratorike të referuara me ato të kryera (përgjigjet e marra), pasi kopjet e validuara të tyre nuk ishin të doumentuara në shërbim për arsye se pacienti i merrte ato me vete në momentin e daljes nga spitali. Gjithashtu gjatë kontrollit të kartelave të shtrimit ditor u konstatua se në kartelën me nré . nuk ka snjë ekzaminim laboratorik të referuar nga mjeku kurues, ndërkohë për këtë pacient janë kryer një sërë analizash, si ato klinike dhe biokimike.

h. Një diferencë e konsiderueshme edhe në faturimin e analizave laboratorike nga shoqëria konçesionare, është hasur edhe në raportimin e ekzaminimeve laboratorike si Imunfenotipet dhe CD4 të cilat kryhen me markera të ndryshëm. Laboratori i faturon sipas kontratës me nr.markerash të kryer për çdo analizë, ndërsa shërbimet mjekesore i raportojnë si një analizë e vetme, si psh për pacientin me nr. Formularin é , në Shërbimin e sëmundjeve Infektive është kryer një analizë imuno-fenotip dhe është referuar në raportin mujor si një analizë e vetme me vlerë 1,071.60 ALL (Sipas tabëlës së çmimeve referuese në kontratën me PPP). Nga ana e Shoqërisë Koncesionare është referuar sipas markerave të kryera, konkretisht 8 dhe në vlerën 8,572.80 ALL. Kjo mënyrë raportimi sjell disrakordancë në sasinë e testeve laboratorike të kryera.
Gjithashtu në lidhje mbi Shtojcën nr.5 ñÇështje të tjera që nuk janë adresuar ndryshe në Kontratën e Koncesionit ï Marrëveshja për Cocid-19ò, grupi i auditimit konstaton se:
Duke marrë në konsideratë gjendjen e pandemisë Covid-19, Koncensionari, me ndermjetesimin e Ministrise si Autoritet Kontraktor, ka dalë i gatshëm të bashkëpunojë me QSUNT për të mundësuar realizimin e testeve RT-PCR dhe testet e serologjise, duke marrë përsipër të mbulojë vetëm shpenzimet operative që lidhen me energjinë elektrike, ujin, ventilimin dhe duke vendosur në dispozicion të QSUNT infrastrukturen e nevojshme për kryerjen e të gjitha procedurave per realizimi me sukses të ketyre testeve.
Realizimi i testeve të mësipërme bëhet me pajisjet, kitet dhe reagentet e QSUNT dhe nga punonjes profesionistë të QSUNT, si rrjedhoje Koncesionari nuk eshtë përgjegjës për cilësinë e këtyre testeve.
QSUNT ka njoftuar zyrtarisht Koncensionarin mbi listën e punonjësve (mjekë, specializantë dhe laborante) të cilët do të punojnë për realizimin e ketyre analizave per COvid-19, me qëllim aksesimin e tyre në Laborator dhe vazhdimisht monitoron këtë marrëveshje në mënyrë që të mos cënohet mbarëvajtja e procesit të kryerjes së testeve RT-PCR, por në të njejtën kohë, edhe Koncensionari të vazhdojë të kryejë veprimtarinë e tij në ambientet ku do të kryhen këto teste. Për të minizimizuar ekspozimin ndaj Covid-19 , të stafeve që punojnë për Koncesionarin dhe stafit të QSUNT, është dakortësuar që stafi i QSUNT të punojë në orare të ndara duke zbatuar standartet e biosigurisë dhe masat mbrojtëse për të parandaluar përhapjen e COVID-19.
Në bazë të dhënave nga QSUNT të dërguara në adrësën e email të grupit të auditimit , shprehen se, vazhdon kryerjen e testeve RT-PCR për të gjithë pacientet e dyshuar dhe te konfirmuar me Covid-19 dhe gjithashtu të personelit të ekspozuar ndaj Covid-19, duke realizuar në total 7,222 teste RT-PCR me aparatin Existationte të firmës Bioneer, deri në momentin e hartimit të këtij materiali.

Për sa i përket stafit të laboratorëve, mbas datës së komisionimit (Nga MSHMS me urdher të SP është ngritur një grup pune që ka testuar pajisjet per realizimin e analizave, në përmbushje të Kontratës si dhe duke i dhenë të drejtën e fillimit të punës në laborator)në datën 21.06.2020. Puna faktikisht ka filluar më datë 09.11.2020, ku struktura paraqitej: 72 punonjës në strukturën e QSUNT, 3 shefa shërbimi (me kontratë shërbimi) dhe 10 mjek pedagogë (me kontratë shërbimi); për të cilët në momentin e hartimit të materialit, rezultoi si vijon;

- Å 48 punonjes janë transferuar në Koncensionar
- Å 3 punonjes kanë dhënë dorëheqjen
- Å 1 punonjës është larguar pasi ka dal në KEMP të plotë
- Å 1 punonjës është me leje lindje, ska nisur procedurat ende
- Å 10 punonjës janë transferuar në struktura në varësi të MSHMS
- Å 3 punonjës janë transferuar ne strukturat e QSUNT
- Å 6 punonjes janë larguar më procedure nga QSUNT pasi nuk kanë pranuar transferimet
- Å 10 mjekët pedagogë u është ndërprerë kontrata e shërbimit me QSUNT
- Å 3 shefat e sherbimit vijojnë ushtrimin e detyrave të tyre sa i takon kontrollit te cilësisë se zbatimit të kontratës koncensionare si dhe ndjekjen e kërkim -zhvillimit në këto shërbime.

Nga sa më sipër, grupi i auditimit, konstaton se, për koncesionarin punojnë vetëm 48 punonjës, ndërsa për realizimin e analizave për Covid-19, nuk del qartë se cilët punonjës e mbulojnë këtë detyrë. Fakti i mosrakordimeve të punonjësve të laboratorit, deri diku jepet situate për mos përmbushje të detyrimit kontraktor, të KK nr. prot 1924/2 datë 10.04.2019, nga të dyja palët (Autoritetit Kontraktor dhe Koncesionari), duke mbivendosur detyrimin e realizimit të analizave të përcaktuar në kontratë gjithsej 164 analiza (Shtojca 3) me ato të Covid-19.

Në bazë të KK nr.1924/2 prot datë 10.04.2019, Shtojca nr.5 (Plani i rekrutimit) pika 3, Grafiku i planit të rekrutimit për QSUNT, për vitin e parë të zbatimit të kontratës janë (13 mjekë, 80 teknikë laboratory dhe 6 sanitarë, në total 99 punonjës staf). Shifrat e mësipërme nuk janë në përmbushje të detyrimeve kontraktore.
Ndërsa për Spitalet e tjera Universitare dhe Spitalet referuese, MSHMS nuk disponon raporte monitorimi progresiv mbi ecurinë e rekrutimit të stafit, por janë vetëm Protokolli i orëve të takimeve që ka mbajtur Komiteti i Ndërlidhjes me Koncesionarin dhe me perfaqësuesin e IFC.

Për sa i përket pagesave për shërbimin e ofruar nga Koncesionari, QSUNT ka kryer pagesen e faturës për shërbimin e laboratorit për muajin Nëntor 2020 në vlerë prej 30,670,190 lekë. Faturat e muajve pasardhës janë refuzuar për shkak të mosrakordimeve sasiore për të cilat QSUNT po vijon procesin e rishikimit dhe riverifikimit të sasive për muajin Dhjetor 2020 dhe Janar ,Shkurt dhe Mars 2021, për shak të mangësive të evidentuara më sipër.

7.2-Grupi i auditimit, në bazë të dokumentacionit, u fokusua konkretisht në implementimin e KK në QSUNT, për faktin se QSUNT ka filluar shërbimin e laboratorëve më hërët në datë 09.11.2020, në krahasim me Qëndrat Universitare Spitalore, Shefqet Ndroqi, Trauma, Koco Glozheni dhe Mbretëresha Geraldina si dhe vetëm nga QSUNT është dërguar dokumentacion për ecurinë e deritanishme.

Nga auditimi u konstatua:

a) Në bazë të minutave të takimit të realizuar nga Komiteti Ndërlidhës së KK me Koncesionarin, në datë 23.10.2019 janë marrë këto vendime:
1.Koncesionari do të dorëzojë një plan të detajuar për QSUT dhe planin e përditësuar për laboratorët rajonalë dhe të emergjencës.
2.Ministria do të përcaktojë një datë për inspektimin e lokaleve, do të përgatitet një urdhër i brëndshëm nga MSHMS për krijimin e grupit të punës për dorëzimin e lokaleve dhe inventarizimin dhe administrimin e aseteve për çdo spital.
3.Autoriteti (Ministria) do të dorëzojë Koncesionarit kartelat e rifreskuara të pasurisë për QSUT dhe të gjitha ambjentet e tjera. Autoriteti do të sigurojë që Spitalet referuese të ofrojnë të gjithë ndihmën e arsyeshme administrative që mund të kërkohet për përshpejtimin e kërkesave dhe dhënien e Lejeve të kërkuara nga Koncesionari në emrin e tij ose për llogari të Autoritetit ose ndonjërit prej Spitaleve Referuese.
4.Bazuar në relacionin e QSUT datë 20.09.2019, është diskutuar gama e analizave laboratorike nga shërbimet laboratorike të ndryshme të cilat nuk janë të përfshira në kontratën me Koncesionarin.
5.Koncesionari kërkon marrjen në konsideratë të mundësisë për dorëzimin me faza të laboratorëve të QSUT duke patur parasysh, vazhdimin e diskutimeve për përcaktimin përfundimtar të analizave në strukturën e laboratorëve të QSUT (Biokimik Klinik, Mikrobiologji, Imunologji dhe Histopatologjia) me personel dhe shërbime (teste) të ndara dhe vendndodhjen e tyre në godina të ndryshme.
6.Koncesionari do të dorëzojë informacionin më të detajuar në lidhje me Paketën e financimit të

Projektit.
7. Koncesionari do të dorëzojë informacion në lidhje me pagesën e IFC-së.
8. Koncesionari do të propozojë një Model kontrate ndërveprimi.
9.Koncesionari kërkon rishikimin e Datës së Fillimit duke patur parasysh vazhdimin dhe vonesat e mundshme, sipas Kontratës nr.prot 1924/2 datë 10.04.2019 (Kontrata e koncesionit) neni 4.2.4 ñé Palët do të takohen mëpas për të dëshmuar përmbushjen e kushteve të mësipërme dhe do të nënshkruajnë një deklaratë të përbashkët për këtë qëllim. Data nënshkrimit të deklaratës së përbashkët do të quhet si ñData e fillimitò. Të drejtat dhe detyrimet e palëve për të kryer Punimet dhe ofruar Shërbimet janë të kushtëzuara dhe fillojnë nga Data e Fillimitò.
Pra, sa më sipër, jemi në afate prej 6 muaj, të Datës Efektive, dhe lehtësisht konstatohet se të dyja Palët nuk janë në përmbushje të detyrimeve kontraktore. Mos plotësimi i këtyre detyrimeve nuk ka penalizuar asnjë palë, kjo e shprehur në Kontratën nr. prot 1924/2 datë 10.04.2019 (Kontrata e koncesionit) neni 4.3.1dhe 4.3.2 (Pasojat e mosplotësimit të Kushteve paraprake brenda Afatit).

Në bazë të KK nr.1924/2 prot datë 10.04.2019, Shtojca 7 (Kalendari i Projektit) për të gjitha objektet laboratorike, ñData e Synuar e Komisionimitò[33] është 12 muaj nga ñData e fillimitò
MSHMS nuk disponon raporte monitorimi progresiv mbi ecurinë Kalendarit të Projektit, sidomos të spitaleve referuese që ende nuk kanë mbaruar rikonstruksionin/përshtatjen dhe rregullimin e ambjenteve, por janë vetëm Protokolli i orëve të takimeve që ka mbajtur Komiteti i Ndërlidhjes me Koncesionarin dhe me perfaqësuesin e IFC.
Pra, grupi i auditimit konstaton se, data efektive është në bazë të dates së miratimit të VKM -së nr.258 datë 24.04.2019). që do të thotë max i lidhjes së Kontrave/marrëveshjeve të ndërveprimit do të jetë jo më vonë se data 24.10.2019.
Më poshtë gjeni të dhënat për marrëveshjet e ndërveprimit që janë të lidhura dhe funksionale.

SPITALI	MARREVESHJA NDERVEPRIMIT
QSUNT	Nr. 12/133 prot., date 08.09.2020
TRAUMA	Nr.166 prot., date 22.01.2021
SH. NDROQI	Nr. 215/13 prot., date 23.03.2021
K. GLOZHENI	Nr. 893/1 prot., date 9.09.2020
M.GERALDINE	Nr. 71 prot., date 26.01.2021
ELBASANI	Date 22.01.2021
SHKODER	Nr. 110/1 prot., date 20.01.2021
KORCE	Nr. 1262 prot., date 08.09.2020
SARANDE	Nr. 69 prot., date 21.01.2021
LUSHNJE	Nr. 79/1 prot., date 20.01.2021
DIBER	Nr. 871 prot., date 6.10.2020

Pra , të gjitha Spitalet referuese dhe koncesionari, janë në mosplotësim të detyrimit kontraktor të KK nr.1924/2 prot datë 10.04.2019, Shtojca 7 (Kalendari i Projektit), për datën e Komisionimit, pasi Marrëveshjet e Ndërveprimit janë nënshkruar me vonë se data 24.10.2019, e për rrjedhojë janë të vonura datat e Komisionimit.

7.3 Nga auditimi u konstatua se problematika tjetër që është hasur nga Koncesionari për rikonstruksionin e laboratorëve ka të bëjë me termetin e nentorit 2019, i cili ka dëmtuar ambjentet ku do të funksiononin laboratorët në QSUNT, kjo në bazë të shkresës të protokolluar në MSHMS

33ñdata e synuar e Komisionimitò është, për sa u përket të gjithë Objekteve Laboratorike, data e caktuar në Kalendarin e Projektit, Brenda së cilës datë, Koncesionari duhet të ketë kryer gjithçka të nevojshme, përfshirë Punimet dhe marrjen e lejeve, në mënyrë që Objekti Laboratorik të jetë plotësisht i shfrytëzueshëm dhe i gatshëm për ofrimin e Shërbimeveò,

nr.1950 datë 23.04.2020 nga Koncesionari, i cili ka kërkuar konfirmimin dhe njoftimin me shkrim, për sa më poshtë, duke u shprehur ñ..tërmeti i datës 26.11.2019 ka shkaktuar dëme në ndërtesën ku është vendosur laboratori i Anatomisë Patologjike pranë QSUNT dhe vonesa në punimet për rikonstruksionin e ambjenteve të laboratorëve të tjerë. Në vijim të komunikimeve, QSUNT na ka informuar me shkresën nr.12/9 të datës 04.02.2020 se referuar VKM-së me nr.26 datë 15.01.2020 për kryerjen e akt-ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara, QSUNT i është drejtuar Universitetit Politeknik të Tiranës me shkresën nr.74/4 të datës 28.01.2020, ku i kërkon të bëhet vlerësimi i thelluar për disa objekte pjesë e të cilave është dhe godina e Djegie Plastikës ku është i vendosur laboratori i Anatomisë Patologjike dhe të arrihet në një vendimmarrje përfundimtare me ndërhyrjet riparuese,projektine riaftësimit apo rindërtimit të tyre. Në këto kushte në mbledhjet e Komitetit Ndërlidhës përkatësisht të dative 21 .01.2020 dhe 27.02.2020, në përputhje me kushtet e Kontratës, Koncesionari kërkoi:

-Veçimin e Datës së synuar të komisionimit të Laboratorit të Anatomisë Patologjike nga Laboratori Qendror Biokimik/Mikrobiologjik dhe shtyrjen e saj koform Kontratës dhe në varësi të datës së marrjes në dorëzim nga QSUT.

-Rishikimin dhe shtyrjen e datës së Synuar së Komisionimit të Laboratorit Qëndror Biokimin/Mikrobiologjik në 21 .03.2020 dhe datës së Synuar të Komisionimit të të gjithë laboratorëve në 28 janar 2021.

Në mbledhjen e Komitetit Ndërlidhës të datës 27 Shkurt 2020 pas diskutimit në detaje në lidhje me këtë çështje u mor vendimi për:

-Njoftimin e QSUT për vijimin e ofrimit të analizave të anatomisë patologjisë deri në momentin kur laboratori përkatës të jetë marrë në dorëzim nga Koncesionari dhe procesi i instalimit të pajisjeve të reja të ketë përfunduar nga Koncesionri conform Kontratës.ò

Nga auditimi u konstatua se, kjo kërkesë e Koncesionarit, vjen si shqetësim edhe nga QSUT me shkresë nr.74/25 prot datë 11.05.2020, me lëndë mbi gjëndjen e objekteve mbas termetit të nëntorit 2019, ku mbas realizimit të Akt-ekspertizës së thelluar, realizuar nga Univeristeti Politeknik i Tiranës, i cili ka arritur përfundimin se ñNjësia strukturore 4 kate ñBanka e Gjakutò gëzon aftësi mbajtëse të papërshtatshme strukturore për të përballuar veprimin sizmik. Nëse tërmeti i projektimit do të godiste strukturën, jo vetëm që struktura do të arrinte prag shëmbjen por me shumë gjasa do ta kalontë atë. Riaftësim i plotë strukturor është i domosdoshëm.ò

Sa më sipër, nga QSUT, koncesionarit dhe MSHMS , në referim të përcaktimeve të Nenit 10 të kontratës të emërtuar ñProjektimò si dhe referuar paragrafit 10.1.1 gërma (b) Kërkesat Teknike Minimale që kanë të bëjnë me Përgatitjen e skicave të projektimit, me kushtin që të mos bëhet asnjë ndryshim strukturor në ndërtesat e Spitaleve Referuese, i ka vënë në dispozicion informacionin mbi konkluzionet e Akt-ekspertizës së thelluar për ndërtesën e Djegies Plastikës, të hartuar nga UPT.

Nisur nga këto kushte, MSHMS me shkresë nr.1950/1 prot datë 18.05.2020, ka miratuar, shtyrjen e Datës së Komisionimit të Laboratorit Biokimik dhe Mikrobiologjik për në datën 21.06.2020 si dhe të gjithë laboratorëve të tjerë për në datën 28.01.2021, kjo si pasojë e ndërhyrjeve riparuese, projektin e riaftësimit/rindërtimit.

Nga Spitali Universitar i Traumës, me shkresë nr.1058 prot datë 04.06.2020, drejtuar MSHMS, dakortësohen për shtyrjen e Datës së Komisionimit më datë 21.06.2020.

Gjithashtu, nga auditimi,në bazë të problematikave të hasura për realizimin e kontratës,u konstatua se, në përgjigje të shkresës së koncesionarit me nr. 120 Prot., datë 1.12.2020 protokolluar në MSHMS me nr. 5346 Prot. datë 1.1.2020 mbi ñShtyrjen e datës së synuar të komisionimitò si dhe shkresës së Koncesionarit me nr. 11/1 datë 21.01.2021, protokolluar në MSHMS me nr. 5346/4 Prot.datë 22.01.2021 mbi ñInformacion mbi planin e projektitò përmes së cilave është kërkuar nga Koncesionari shtyrjen e óDatës së Synuar të Komisionimitô për 17 objektet laboratorike ende të pakomisionuara objekt i Kontratës Koncesionare me Nr. 1924/2 Prot. datë 10.04.2019 miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 258 datë 24.04.2019, në vijim referuar si óKontrataô, në

vijim të mbledhjeve Komitetit Ndërlidhës të datës 16.02.2021 dhe datës 2.04.2021, opinionit të konsulentit ligjor të mundësuar nga International Finance Corporation të datës 13.04.2021, si dhe në zbatim të dispozitave të Nenit 11.3.3 të Kontratës:

Në bazë të pikave të mësipërme, grupi i auditimit, iu referua Datave të Komisionimit dhe Datave të Kontratave të ndërveprimit të lidhura me spitalet respective, nga të cilat u konstatua se:
-Në vijim të shkresës së shoqërisë koncesionare L.N. shpk me nr. 18 Prot. datë 20.06.2020 me lëndë ñNjoftim mbi përfundimin e punimeve në Laboratorin Qendror Biokimik/Mikrobiologjik pranë QSUNTò, MSHMS aktivizoi grupin e komisionimit, i cili kreu inspektimin e përbashkët dhe komisionoi këtë objekt laboratorik, ku koncesionari filloi ofrimin e shërbimeve nga data 02.11.2020 (bashkëlidhur i gjithë dokumentacioni shkresor).
Kështu nga auditimi, u konstatua se, në zbatim të Urdhrit të titullarit të AK nr.502 datë 02.09.2020 nr.3992 prot datë 02.09.2020 ñPër ngritjen e grupit të punës për komisionimin dhe pranimin e objekteve laboratorike si dhe inspektimin e përbashkët të lokaleve për përmbushjen e kërkesave minimale teknike sipas kontratës koncesionare/PPP me nr.1942 datë 11.09.2020, është mbajtur Raport inspektimi, më datë 15.09.2020 me përbërje: S. K. kryetar, L. P., O. Dh., L. Z., Sh. Q. anatarë, ku midis të cilave shprehen se ñ...konstatimet e grupit të punës paraqiten sipas Shtojcës 13 të KK nr.1942 datë 11.09.2020, të përgjithshme:
1.Dorëzimi real i pajisjeve që ishin ofruar
2.Përputhshmëria e llojit të makinerisë me specifikimet
3.Përputhshmëria e numrit dhe llojeve të pajisjeve si dhe i numrit dhe llojit të pjesëve të konsumit me ato që janë paraqitur në ofertë dhe me specifikimet e kërkuara.
4.Sistemi rezervë i energjisë është operacional dhe funksional.
Pajisjet e instaluara janë në përputhje me kërkesën për të realizuar listën prej 158 testesh, (kjo e konfirmuar nga testimet e bëra).
Nga auditimi i këtij materiali, u konstatua që, lista e pajisjeve të instaluara, referuar Deklaratave të Koncesionarit tejkalon specifikimet teknike të listës së paraqitur nga ky Koncesionar si pjesë e ofertës teknike në procedurë e zhvilluar në vitin 2017, për faktin se duke qënë se ka kaluar një periudhë prej afro tre vjetësh nga data e ofertës, teknologjia e ofruar ka pësuar përmirësime të cilat e ngrenë nivelin e kryerjes së shërbimit në standartet bashkëkohore.Kjo listë është përditësuar duke furnizuar pajisje të teknologjisë së fundit prodhime të vitit 2019.
6.4) Nga auditimi në bazë të dokumentacionit u konstatua se, Komiteti Ndërlidhës ka realizuar 12 takime duke mbajtur Minuta Takimi, duke iu referuar problematikave të evidentuara nga Koncesionari, nga MSHMS dhe nga Spitalet referuese, por nga ana tjetër Komitetit i Ndërlidhjes (MSHMS), nuk ka paraqitur raporte monitorimi në progres, mbi ecurinë e zbatimit Kontratës për partneritet public koncesionare me nr.1924/2 prot datë 10.04.2019, mbi realizimin e rikonstruksionit/ përshtatjen dhe rregullimin e ambjenteve ekzistuese / krijimin e ambjenteve të reja, instalimi I aparaturave, vënia në punë, trajnimi I punonjësve, etj, në kundërshtim me ligjin nr.125/2013 ñPër koncesionet dhe partneritetin public privatò neni 10, pika 4 &5 ku thuhet se ñ4.Autoritet kontraktuese i paraqesin, sa herë që kërkohet që kërkohet, por jo më pak se tri herë në vit, ministrit përgjegjës për financat raporte të përmbledhura të monitorimit të zbatimit të kontratave të koncesionit/PPP me argumentet dhe shpjegimet përkatëse.Forma, përmbajtja dhe afatet e raporteve të monitorimit përcaktohen me udhëzim të veçantë të ministrit përgjegjës për financat.
5.Bazuar në raportet e monitorimit, të specifikuara në pikën 4, të këtij neni, ministria përgjegjëse për financat mund tôu rekomandojë autoriteteve kontraktuese marrjen e masave për përmirësimin e performancës në ofrimin e shërbimeve dhe punëve publike, objekt i këtyre kontratave si dhe për minimizimin apo eleminimin e risqeve të drejtëpërdrejta e të tërthorta që ndikojnë në buxhetin e shtetit.ò
Pra në përfundim, në zbatim të KK nr.1924/2 prot datë 10.04.2019, nga auditimi u konstatua se,

MSHMS në cilësinë e AK, së bashku me Spitalet referuese (njëra palë) dhe Koncesionari (pala tjetër), për arsyet objektive (fatkeqësi natyrore, fatkeqësi shëndetësore) dhe për arsyet subjektive duke mos paraqitur në kohë ambjentet për rikonstruksion, ka bërë të mundur që të dy palët të mos jenë në respektim të detyrimeve kontraktore (efekti kohë).
MSHMS duke mos paraqitur raporte monitorimi në progres, dhe duke mos qenë në koherencë të detyrimeve të lindura nga kjo kontratë koncensionare nga spitalet referuese, njësi të vartësisë së saj rrezikon të mos përmbushë detyrimet kontraktore dhe institucionale, duke mos justifikuar qëllimin për ofrimin e këtij shërbimi për shtetasit shqiptarë, nëpërmjet Koncesionit për Partneritet Publik, me burim financimi Buxhetin e Shetit.
Në lidhje mbi problematikat e konstatuara, nga grupi i audituesve u mbajt Aktkonstatimi nr.11 datë 30.04.2021 me nr.415/23 prot datë 30.01.2012 të MSHMS, të cilët kanë observuar me shkresë nr 415/31prot, datë 07.05.2021 të MSHMS si dhe observimet dërguar nga MSHMS në lidhje mbi Projekt raportin e përcjellë nga KLSH me shkresë nr.121/10 prot datë 03.09.2021, të cilat kanë ardhur më datë 14.10.2021 jashtë afatit kohor të parashikuar në ligjin 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit neni 26 dhe 29ô me shkresë nr.415/47 prot të MSHMS dhe me nr.121/11 prot datë 14.10.2021 të KLSH.
Sa më sipër, audituesit e KLSH, i ri vlerësuan dhe observimet e dyta, të cilat nuk kanë paraqitur dokumentacion shtesë apo argumentim ligjor shtesë në lidhje mbi problematikën e konstatuar, për këtë qëllim, audituesit shprehen me të njëjtin qëndrim, si vijon:

Pretendimi i subjektit:
1.Në observimet e paraqitura, subjekti sqaron se, raportimi i ecurisë së implementimit të Kontratës është përcaktuar në dispozitat e Kontratës, konkretisht Neni 19: óDetyrimet e koncesionarit për të raportuarô dhe Neni 20 óTë drejtat e Autoritetit për auditimô. Neni 19, pika 1, parashikon se Koncesionari i dorëzon Autoritetit duke vendosur në kopje përfaqësuesin e FSDKSH-së. Raportet e specifikuara në Shtojcën 2 (Mekanizmi i Raportimit) në numrin dhe shpeshtësinë e parashikuar në këtë Kontratë. Për formën e raporteve është rënë dakord me Autoritetin. Çdo raport që kërkohet të dorëzohet nga Koncesionarinë lidhje me një periudhë kohe sipas Shtojcës 2, siç u tha më lart (qoftë raport mujor, tremujor apo vjetor apo ndryshe), dorëzohet brenda dhjetë (10) ditësh nga fundi i një periudhe të tillë. Shtojca 2 óMekanizmi i Raportimitô në pikat 1, 2 e në vijim parashikon se Koncesionari do të japë të gjithë raportet e kërkuara në lidhje me dispozitën 22.4 Tavanet Buxhetore. Raportet elektronike do të përfshijnë volumin dhe të ardhurat (analizat e shumëzuara me çmimet përkatëse) sipas Mjekëve Referues, Spitaleve Referues dhe qendrave të kujdesit parësor. Koncesionari do tôi paraqesë Autoritetit dhe Komitetit Ndërlidhës rezultatet e raporteve të vetëvlerësimit. Raportet do të përmbajnë të gjitha të dhënat e nevojshme për vlerësimin e performancës së Koncesionarit kundrejt të jgithë TReguesve të vlerësimit tremujor të Performancës, të specifikuar në shtojcën 14, duke përfshirë ndër të tjera:
-Një raport të veprimtarisë, ku jepet të paktën informacioni i ndarë në zëra për çdo laborator dhe çdo spital referues dhe më pas një informacion përmbledhës për të gjithë rrjetin e laboratorëveé
Për më tepër, Shtojca 14 óTreguesit e performancës dhe penalitetetô parashikon se një pjesë e konsiderueshme e TKP (treguesve kryesorë të performancës) lidhet me shërbimin e kryer dhe të pranuar nga Spitalet Referuese.
Është e qartë se parashikimet në dispozitat e Kontratës flasin për raportim të veprimtarisë, pra nga momenti që shërbimi ofrohet nga Koncesionari. Aktualisht në Spitalet Universitare Obstetrik-Gjinekologjik ñKoco Glozheniò, ñMbreteresha Geraldinë, në Spitalin Universitar të Traumës dhe në Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò, ka filluar të jepet shërbimi laboratorik nga koncensionari, konkretisht në SUSN në 26 Mars 2021, SUT në 1 Prill 2021, SUOGJ Koço Gliozheni në 5 Prill 2021 dhe SUOGJ Mbreterësha Geraldinë në 19 Prill 2021.
Laboratorët në spitalet rajonale të Durrësit, Elbasanit, Shkodrës, Lezhës, Fierit, dhe Beratit po inspektohen aktualisht nga Grupi i Inspektimit dhe janë në pritje të komisionimit.
Në spitalet bashkiake të Lushnjës, Sarandës, në spitalin rajonal të Vlorës dhe Korçës kanë përfunduar përshtatja dhe rregullimi i ambienteve dhe po punohet për instalimin e aparaturave. Me përfundimin e lidhjes dhe testimit të sistemeve do fillojnë trajnimet e stafit mbi sistemet dhe procedurat. Duke ndjekur fazat si më sipër, parashikohet që këto objekte të jenë gati për komisionim brenda datës 20 maj 2021.
Në këto kushte, nuk ka sesi të përgatiten apo disponohen raporte monitorimi progresiv në këtë fazë të hershme të implementimit të shërbimit në shumë prej objekteve laboratorike. Ndërkohë që për QSUNT ku shërbimi ka filluar të ofrohet në datën 2 Nëntor 2020, sikundër konstatohet edhe në Akt Konstatimin tuaj nr. 11 (dokumenti 8/30/04/2021) Palët (Spitali referues QSUNT dhe shoqëria koncesionare) ende po rakordojnë për shërbimin e kryer dhe atë të pranuar. Koncesionri me shkresën e tij me Nr. 52 datë 13.04.2021, porotkolluar me tonën me

Nr. 81/14 datë 14.04.2021 ñMbi vlerësimin e performancësò, shprehet se ka përgatitur dokumentacionin sipas kërkesave të shtojcës 14, por raportimi i saktë i këtyre treguesve do të jetë i mundur sapo të saktësohet nfa Spitali referues lista e formularëve që do të pranohen dhe do të paguhen nga QSUNT (shkresa bashkëlidhur).
Koncensionari ka kryer raportime mbi volumin e sherbimeve te kryera sipas çdo muaji me email zyrtar prane strukturave te FSDKSH, me qellim ndjekjen e buxhetit perkates.
Për arsyet si më sipër, Komiteti Ndërlidhës i ngritur me Urdhrin 634 datë 3.09.2019, i ndryshuar, nuk disponon ende të dhënat paraprake për të hartuar raporte të tilla.
2. KLSH konstaton se data efektive është në bazë të dates së miratimit të VKM -së nr.258 datë 24.04.2019). që do të thotë max i lidhjes së Kontrave/marrëveshjeve të ndërveprimit do të jetë jo më vonë se data 24.10.2019. Nga auditimi u konstatua se asnjë nga spitalet referuese së bashku me koncesionarin, nuk kanë realizuar lidhjen e Kontratave /Marrëveshjeve të Ndërveprimit, në kundërshtim me Kontratën PPP nr. prot 1924/2 date 10.04.2019 (Kontrata e koncesionit) neni 16, Shtojcën 12 dhe me Urdhërin e MSHMS Nr.635 datë 03.09.2019. Më poshtë gjeni të dhënat për marrëveshjet e ndërveprimit që janë të lidhura dhe funksionale.

SPITALI	MARREVESHJA NDERVEPRIMIT
QSUNT	Nr. 12/133 prot., date 08.09.2020
TRAUMA	Nr.166 prot., date 22.01.2021
SH. NDROQI	Nr. 215/13 prot., date 23.03.2021
K. GLOZHENI	Nr. 893/1 prot., date 9.09.2020
M.GERALDINE	Nr. 71 prot., date 26.01.2021
ELBASANI	Date 22.01.2021
SHKODER	Nr. 110/1 prot., date 20.01.2021
KORCE	Nr. 1262 prot., date 08.09.2020
SARANDE	Nr. 69 prot., date 21.01.2021
LUSHNJE	Nr. 79/1 prot., date 20.01.2021
DIBER	Nr. 871 prot., date 6.10.2020

3.Gjithashtu, nje tjeter problematike eshte pranimi nga ana e Shoqerise koncesionare dhe ekzekutimi i ekzaminimeve laboratorike, me formulare te referimit te cilet nuk permbajne elementet baze te idendifikimit.
Keshtu ne Sherbimin e gastrohepatologjise eshte konstatuar se, mjekut i kane shkuar analiza te validuara per nje pacient qe nuk rezulton i shtruar ne asnje sherbim te QSUNT-s (sipas sistemit SISP). Nderkohe nga verifikimi i formularit me barkod R....., eshte verejtur qe formulari nuk ishte i plotesuar me emrin, numrin unik te identifikimit dhe vulen e mjekut referues, infermierin qe ka marre kampionin, etj. Per kete arsye 43 ekzaminime biokimike te kryera nga laboratori "N." nukjane raportuar nga Sherbimi i Gastrohepatologjise.
Rast tjeter problematik eshte verejtur qe edhe kur Formulari i referimit eshte referuar me emrin e nje mjeku tjeter ndersa ne vule ka emrin e nje tjeter mjeku.
Sa me siper, formularet e parregullt sipas Kontrates se Ndërveprimit nuk duheshin pranuar dhe ekzekutuar nga ana e shoqerise koncesionare.
Referuar Kontrates se ndermjetesimit, pika VII "Standartet e sherbimif' ku "Koncesionari duhet te respektoje kohen e propozuar per daljen e rezultatave per çdo analize, qofte rutine apo ne kushte urgjence .....", koha maksimale per daljen e rezultatit nuk eshte respektuar gjithmone nga ana e shoqerise korncesionare.
4.Nje diference te konsiderueshme edhe ne faturimin e analizave laboratorike nga shoqeria koncesionare, eshte hasur edhe ne raportimin e ekzaminimeve laboratorike si Imunfenotipet dhe CD4 te cilat kryhen me markera te ndryshem. Laboratori i faturon sipas kontrates me nr.markerash te kryer per 9do analize, ndersa sherbimet mjekesore i raportojne si nje analize e vetme, si psh per pacientin me nr. Formularin ... , ne Sherbimin e semundjeve Infektive eshte kryer nje analize imuno-fenotip dhe eshte referuar ne raportin mujor si nje analize e vetme me vlere 1071.60 ALL (Sipas tabeles se çmimeve referuese ne kontraten me PPP). Nga ana e Shoqerise Koncesionare eshte referuar sipas markerave te kryera, konkretisht 8 dhe ne vleren 8572.80 ALL. Kjo menyre raportimi sjell disrakordance ne sasine e testeve laboratorike te kryera.
Te gjitha problemet e konstatuara jane evidentuar, analizuar dhe jane marre te gjitha masat nga ana e QSUNT dhe koncensionarit qe te mos perseriten. QSUNT ne bashkepunim me Koncensionarin kane verifikuar rastet e referuara ne menyre jo te rregullt dhe kane hartuar nje procesverbal me perfaqesuesit e QSUNT. Testet sipas ketyre formulareve nuk jane perfshire ne faturen e muajit perkates. Sa me siper eshte relatuar me shkresen e Koncensionarit Nr. 33 prot, date 23.03.2021 ñMbi verifikimin e shumes se fatures se muajit dhjetor 2020ò, emailin e QSUNT drejtuar AK-se dhe mbledhjes me te fundit te Komitetit Nderlidhes me pjesemarrjen e te gjitha Paleve. Keto çeshtje jane ende duke u rakorduar midis Paleve dhe nuk ka ende nje qendrim perfundimtar mbi numrin e testeve te pranuara.
5.Duke marre ne konsiderate gjendjen e pandemise Covid-19, Koncensionari, me ndermjetesimin e

Ministrise si Autoritet Kontraktor, ka dale i gatshem te bashkepunoje me QSUNT per te mundesuar realizimin e testeve RT-PCR dhe testet e serologjise, duke marre persiper te mbuloie vetem shpenzimet operative qe lidhen me energiine elektrike, uiin, ventilimin dhe duke vendosur ne dispozicion te QSUNT infrastrukturen e nevoishme per kryerien e te gjitha procedurave per realizimi me sukses te ketyre testeve.
Realizimi i testeve te mesiperme behet me paisjet, kitet dhe reagentet e QSUNT dhe nga punonjes profesioniste te QSUNT, si rrjedhoje Koncesionari nuk eshte pergjegjes per cilesine e ketyre testeve.
Punesimi i punonjesve te QSUNT eshte bere duke i dhene prioritet absolut punonjesve ekzistues te ketij laboratory (QSUNT-se), sikurse eshte parashikuar ne Kontraten e koncensionit. Koncensionari ka rekrutuar vetem personel nga ish stafi i QSUNT te cilet kane shfaqur interes per te punuar me koncensionarin, plotesonin kerkesat e pozicioneve te punes ne laborator dhe qe pranuan kushtet e punes te ofruara.
Shifrat e parashikuara ne planin e rekrutimit i referohen vitit te pare te punes, nderkohe qe sherbimi i laboratorit te QSUNT ka vetem disa muaj qe ka filluar. Gjithashtu plani i referohet te gjithe sherbimit laboratorik ne QSUNT, pra perfshin edhe laboratorin e Anatomise Patologjike, sherbim i cili nuk ka filluar ende. Ndaj ky plan eshte dinamik dhe procesi i rekrutimit nuk ka perfunduar edhe per QSUNT-ne.
Deri tani, jane punesuar ne Laboratorin prane QSUNT-se ne total 64 punonjes nga te cilet:
44 teknike laboratori
13 mjeke dhe mjeke pedagoge
3 mjeke koordinatore
4 sanitare
Nuk ka asnje mbivendosje detyrash ne laborator dhe ne asnje rast detyrat e parashikuara nga kontrata e koncensionit nuk jane kryer nga punonjes te QSUNT, te cilet nuk kane njohurite per te kryer ekzaminime ne aparaturat e koncensionarit. Ne baze te Shtojces 5, punonjesit e QSUNT kryejne vetem dy teste specifike si test RT PCR Covid -19 dhe test serologjik SARS CoV 2 IgG (plus plazem), te cilat nuk jane pjese e kontrates se koncensionit, pra nuk perfshihen ne 164 testet qe kryen koncensionari.
6.Shtojca 7, óKalendari i Projektitô (bashkëlidhur) parashikon se kalendari i projektit do të jetë në përputhje me Datën e Synuar të Komisionimit të të gjitha Objekteve Laboratorike, ku data e synuar e komisionimit për të gjithë objektet laboratorike: 12 muaj nga Data e fillimit.
Sjellim në vëmendje se me shkresën e koncesionarit me nr. 1950 Prot., datë 23.04.2020 (bashkëlidhur) ky i fundit kërkonte veçimin dhe shtyrjen e óDatës së Synuar të Komisionimitô të Laboratorit të Anatomisë Patologjike (Godina e Gjegie Plastikës e dëmtuar nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019) pranë QSUNT nga Laboratori Qendror Biokimik/Mikrobiologjik sipas Kontratës Koncesionare me nr. 1924/2 datë 10.04.2019 miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 258 datë 24.04.2019, në vijim referuar si óKontrataô, në vijim të mbledhjeve më të fundit (të kësaj periudhe) të Komitetit Ndërlidhës si dhe shkresës së QSUT me nr. 74/25 Prot. datë 11.05.2020 mbi ñInformacion mbi gjendjen e objektit, Godina e Djegie Plastikës, një pjesë e së cilës është objekt i Kontratës Koncesionare me Nr. 1924/2, datë 10.04.2019 ñPër ofrimin e shërbimeve laboratorike të Spitaleve Universitare, Rajonale dhe atyre Bashkiake të Sarandës dhe Lushnjësòò ku përcillet akt-ekspertiza e thelluar e kryer nga Universiteti Politeknik i Tiranës, Autoriteti Kontraktor vendosi tôi miratojë kërkesën (bashkëlidhur) shoqërisë L. N. veçimin dhe shtyrjen e datës së synuar të komisionimit për këtë Laborator konform Kontratës si më poshtë:
Veçimin dhe shtyrjen e Datës se Synuar te Komisionimit për Laboratorin e Anatomisë Patologjike pranë QSUNT nga Laboratori Qendror Biokimik/Mikrobiologjik;
Rishikimin dhe shtyrjen e Datës se Synuar te Komisionimit për:
Laboratorin Qendror Biokimik/Mikrobiologjik pranë QSUNT, jo me vone se data 21.06.2020; dhe
te gjithë laboratorëve te tjerë, jo me vone se data 28.01.2021.

Sërish, në përgjigje të shkresës së koncesionarit me nr. 120 Prot., datë 1.12.2020 (bashkëlidhur), protokolluar me tonën me nr. 5346 Prot. datë 1.1.2020 mbi ñShtyrjen e datës së synuar të komisionimitò si dhe shkresës suaj me nr. 11/1 datë 21.01.2021, protokolluar në MSHMS me nr. 5346/4 Prot.datë 22.01.2021 mbi ñInformacion mbi planin e projektitò përmes së cilave kërkoni shtyrjen e óDatës së Synuar të Komisionimitô për 17 objektet laboratorike ende të pakomisionuara objekt i Kontratës Koncesionare me Nr. 1924/2 Prot. datë 10.04.2019 miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 258 datë 24.04.2019, në vijim referuar si óKontrataô, në vijim të mbledhjeve Komitetit Ndërlidhës të datës 16.02.2021 dhe datës 2.04.2021, opinionit të konsulentit ligjor të mundësuar nga International Finance Corporation të datës 13.04.2021, si dhe në zbatim të dispozitave të Nenit 11.3.3 të Kontratës:
ñNeni 11.3 të Kontratës së Koncesionit [Vonesat, Ngjarjet e Çlirimit nga Detyrimi dhe Dëmshpërblimet] parashikon disa raste, me verifikimin e te cilave, Data e Synuar e Komisionimit për një Objekt Laboratorik te caktuar mund te zgjatet.
Ndër të tjera këto ngjarje përfshijnë:
Një Ngjarje te Forcës Madhore (sipas parashikimit te nenit 31.1) e cila pengon drejtpërdrejtë komisionimin e një Objekti Laboratorik (neni 11.3.3. a);

Një rast Mospërmbushje nga ana e Autoritetit (sipas parashikimit te nenit 34.2) qe pengon drejtpërdrejtë komisionimin e një Objekti Laboratorik te caktuar (neni 11.3.3. c);
Një njoftim Defektesh nga Autoriteti (sipas parashikimit te nenit 11.5.4) mbi Objektin laboratorik ne fjale, i cili është kundërshtuar nga Koncesionari dhe është pranuar nga Autoriteti;
Çdo vonese nga Spitalet Referuar apo Autoriteti ne përmbushjen e detyrimeve te përcaktuara ne Nenin 16.ò
Për këtë arsye, të ndodhur në kushtet e parashikuara nga Neni 11.3.3 më sipër, Autoriteti Kontraktor vendosi të miratojë (bashkëlidhur) kërkesën e shoqërisë koncesionare për shtyrjen e datës së synuar të komisionimit për objektet laboratorike të mbetura për një periudhë 4 (katër) mujore. Theksojmë se Koncesionari përfiton nga shtyrja e datës së Synuar të Komisionimit, por nuk ka asnjë të drejtë kompensimi në lidhje me këtë shtyrje.
Në këto kushte, data e synuar e komisionimit është data 28.05.2021, prandaj vlerësojmë se konstatimet tuaja për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale sikundër jeni shprehur në konstatimin tuaj, pika 6.2, nuk qëndrojnë pasi nuk ka tejkalim të afateve nga ana e Autoritetit, Spitaleve Referuese apo koncesionarit por vetëm përshtatje sipas Datës së re të Synuar të Komisionimit.
7. Nga auditimi ne baze te dokumentacionit u konstatua se, Komiteti Nderlidhes ka realizuar 12 takime duke mbajtur Minuta Takimi, duke iu referuar problematikave te evidentuara nga Koncesionari, nga MSHMS dhe nga Spitalet referuese, por nga ana tjeter Komitetit i Nderlidhjes (MSHMS), nuk ka paraqitur raporte monitorimi ne progres, mbi ecurine e zbatimit Kontrates per partneritet public koncesionare me nr.1924/2 prot date 10.04.2019, mbi realizimin e rikonstruksionit/ pershtatjen dhe rregullimin e ambjenteve ekzistuese / krijimin e ambjenteve te reja, instalimi i aparaturave, venia ne pune, trajnimi i punonjesve, etj, ne kundershtim me ligjin nr.125/2013 "Per koncesionet dhe partneritetin publik privat" neni 19, pika 4 &5 ku thuhet se "4. Autoritet kontraktuese i paraqesin, sa here qe kerkohet, por Jo me pak se tri here ne vit, ministrit pergjegjes per financat raporte te permbledhura te monitorimit te zbatimit te kontratave te koncesionit/PPP me argumentet dhe shpjegimet perkatese. Forma, permbajtja dhe afatet e raporteve te monitorimit percaktohen me udhezim te veçante te ministrit pergjegjes per financat.
Qëndrimi i grupit të auditimit.
1.Është e qartë se parashikimet në dispozitat e Kontratës flasin për raportim të veprimtarisë, pra nga momenti që shërbimi ofrohet nga Koncesionari. Aktualisht në Spitalet Universitare Obstetrik-Gjinekologjik ñKoco Glozheniò, ñMbreteresha Geraldinë, në Spitalin Universitar të Traumës dhe në Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò, ka filluar të jepet shërbimi laboratorik nga koncensionari, konkretisht në SUSN në 26 Mars 2021, QSUT në 1 Prill 2021, SUOGJ Koço Gliozheni në 5 Prill 2021 dhe SUOGJ Mbreterësha Geraldinë në 19 Prill 2021.
Laboratorët në spitalet rajonale të Durrësit, Elbasanit, Shkodrës, Lezhës, Fierit, dhe Beratit po inspektohen aktulaisht nga Grupi i Inspektimit dhe janë në pritje të komisionimit.
Në spitalet bashkiake të Lushnjës, Sarandës, në spitalin rajonal të Vlorës dhe Korçës kanë përfunduar përshtatja dhe rregullimi i ambienteve dhe po punohet për instalimin e aparaturave. Me përfundimin e lidhjes dhe testimit të sistemeve do fillojnë trajnimet e stafit mbi sistemet dhe procedurat. Duke ndjekur fazat si më sipër, parashikohet që këto objekte të jenë gati për komisionim brenda datës 20 maj 2021.
2. Grupi i auditimit konstaton se data efektive në bazë të dates së miratimit të VKM -së nr.258 datë 24.04.2019). që do të thotë max i lidhjes së Kontrave/marrëveshjeve të ndërveprimit do të jetë jo më vonë se data 24.10.2019. Nga auditimi u konstatua se asnjë nga spitalet referuese së bashku me koncesionarin, nuk kanë realizuar lidhjen e Kontratave /Marrëveshjeve të Ndërveprimit, në kundërshtim me Kontratën PPP nr. prot 1924/2 date 10.04.2019 (Kontrata e koncesionit) neni 16, Shtojcën 12 dhe me Urdhërin e MSHMS Nr.635 datë 03.09.2019.
Ky fakt pranohet dhe nga AK, në observimet e mësipërme, duke u shprehur se objektet do të jenë gati për komisionim brënda datës 20.05.2021, e për rrjedhojë AK, nuk ka sesi të përgatiten apo disponohen raporte monitorimi progresiv në këtë fazë të hershme të implementimit të shërbimit në shumë prej objekteve laboratorike.
Koncensionari ka kryer raportime mbi volumin e sherbimeve te kryera sipas çdo muaji me email zyrtar prane strukturave te FSDKSH, me qellim ndjekjen e buxhetit perkates.
Për arsyet si më sipër, Komiteti Ndërlidhës i ngritur me Urdhrin 634 datë 3.09.2019, i ndryshuar, nuk disponon ende të dhënat paraprake për të hartuar raporte të tilla.
3. Nga verifikimi i përgjigjeve të ekzaminimeve laboratorike në QSUT ñNënë Terezaò në Shërbimin e Kardiologjise 2, u konstatuan një sërë rastesh ku nuk është respektuar afati kohor i kthimit të pergjigjeve, sipas Kontrates se lidhur me Korncesionarin.
Edhe në Shërbimin e USB për datën 17.12.2020 ku pacientet me nr... e barkodeve te formulareve..... janë referuar analiza me formular urgjence, por pergjigja e tyre ka vonuar me shume se 8 ore nga koha e parshikuar ne kontrate per analizat e urgjences qe eshte 30 min.
Vonesa në ardhjen e përgjigjeve të ekzaminimeve laboratorike janë raportuar edhe nga Shërbimi Unite X-knife. Si psh per Hemograme 5 Pl janë kërkuar ne total 40 dhe jane inarre pergjigje vetem per 25 prej tyre. Diferenca e tyre nuk eshte raportuar nga sherbimi. Ky problem nuk eshte raportuar ne kohe nga Administratori

Spitalor, sipas pikes 6 te urdherit te titullarit. Për këto analiza dhe për të tjera si këto rekomandojmë të vijohet me penalitetet e parashikuara në kontratë. 4. KLSH konstaton se MSHMS nuk disponon raporte monitorimi progresiv mbi ecurine e Kalendarit te Projektit, sidomos te spitaleve referuese qe ende nuk kane mbaruar rikonstruksionin/pershtatjen dhe rregullimin e ambjenteve, por jane vetem Protokolli i oreve te takimeve qe ka mbajtur Komiteti i Nderlidhjes me Koncesionarin dhe me perfaqesuesin e IFC. Pra, nga auditimi të gjitha Spitalet referuese dhe koncesionari, janë në mosplotësim të detvrimit kontraktor të KK nr.1924/2 prot date 10.04.2019, Shtojca 7 (Kalendari i Projektit). Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Titulli i Gjetjes nr.1:	Zbatimin ecurisë së implementimit të Kontratës Koncesionare nr.prot 1924/2 datë 10.04.2019 ñPër ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjesò.
Situata :	Nga auditimi i kontratës së partneritetit publik privat ñPër ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësorëò rezultoi se deri më 21.05.2021 është likuiduar vetëm një faturë në shumën prej 30,670,190.00 lekë për koncesionarin në QSUNT. Konstatuam se: **1**.Kontrata për partneritetin publik privat është nënshkruar dy vite më vonë, pas dërgimit të raportit mbi propozimin e përzgjedhjes së ofertës së suksesshme tek Titullari i Autoritet Kontraktor. Këto ndryshime në afate nuk janë reflektuar në kontratë. Rezultoi që të gjitha spitalet universitare dhe ato referuese, i kanë lidhur Marrëveshjet e Ndërveprimit më vonë se data e parashikuar. **2**.Si rezultat i situatës së krijuar nga tërmeti i nëntorit 2019, gjendjes së krijuar nga Pandemia, si dhe mos regjistrimit të aseteve nga spitalet referuese, Data e Synuar e Komisionimit është shtyrë jo më vonë se data 21.06.2020 dhe për të gjithë laboratorët e tjerë, jo më vonë se data 28.01.2021. Aktualisht shërbimi laboratorik po realizohet nga Koncesionari në Qendren Universitare Spitalore "Nene Tereza", në Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik ñKoco Glozheniò, në Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik ñMbreteresha Geraldinë, në Spitalin Universitar të Traumës dhe në Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò. Në spitalet bashkiake të Lushnjës, Sarandës, në spitalin rajonal të Vlorës dhe Korçës kanë përfunduar përshtatja dhe rregullimi i ambienteve dhe po punohet për instalimin e aparaturave. **3**.Nga implementimi i kësaj kontrate, në laboratorin e QSUNT rezultoi se, sipas Shtojcës nr.5, pika 3, *Grafiku i planit të rekrutimit* për QSUNT, për vitin e parë të zbatimit të kontratës kërkon punësimin pranë koncesionarit të total 99 punonjësve, nga të cilët 13 mjekë, 80 teknikë laboratori dhe 6 sanitarë; ndërsa nga auditimi u konstatuan se vetëm 48 nga këta punonjës janë transferuar në koncesionar. Në vijim rezultoi se, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucioni epror ndaj Qendrave Universitare Spitalore, Spitaleve Rajonale dhe atyre bashkiake, **nuk** ka kryer raporte periodike të monitorimit mbi zbatimin e kontratës koncesionare dhe ligjit nr.125/2013 ñPër koncesionet dhe parteritet publik privatò neni 10, pika 4,5. Në veçanti, nga verifikimi i raporteve të monitorimit të realizuara nga QSUNT rezultoi se: **1**.Janë përgatitur dy relacione për muajin Dhjetor 2020: relacioni mbi monitorimin sasior, dhe ai mbi monitorimin cilësor të aktivitetit laboratorik. Grupi i punës i ka hartuar relacionet, duke u bazuar në verifikimet në terren si dhe në bazë të përzgjedhjeve rastësore të disa shërbimeve mjekësore, konkretisht në Gastrohepatologji, në Hematologji, në Urgjencën Pediatrike, në Neurologji dhe në Stroke Post Stroke, duke konkluduar se: (i) nuk është raportuar saktë dhe me përgjegjshmëri numri i ekzaminimeve laboratorike të referuara dhe ato të kryera (përgjigjet). Në shumë raste përgjigja e analizave ka mbërritur në shërbim pasi pacienti i hospitalizuar ka lënë shërbimin, me një diferencë prej 914 analiza, të cilat nuk janë pasqyruar në raportin përfundimtar të shërbimeve; (ii) shumë mjekë janë regjistruar në sistemin LIS (*laboratory informacion system*) të Shoqërisë koçesionare në shërbimet e gabuara, duke sjellë vonesa apo mosdorëzim në shërbimin e duhur të përgjigjeve të analizave duke çuar deri mos referimin e tyre si analiza të kryera në raportimet mujore; (iii) nga ana e shoqërisë koncesionare janë pranuar dhe janë realizuar ekzaminime laboratorike, me formularë të cilët nuk përmbajnë elementët

	bazë të identifikimit. Për këtë arsye 43 ekzaminime biokimike të kryera nga laboratori nuk janë raportuar nga Shërbimi i Gastrohepatologjisë. Sa më sipër, formularët e parregullt sipas Kontratës së Ndërveprimit nuk duheshin pranuar dhe ekzekutuar nga ana e shoqërisë koncesionare; (iv) Referuar Kontratës së ndërmjetësimit, pika VII ñ*Standardet e shërbimit*ò ku ñ*Koncesionari duhet të respektojë kohën e propozuar për daljen e rezultateve për çdo analizë, qoftë rutinë apo në kushte urgjence, kohë 30 min....*ò, konstatuam se, nga ana e shoqërisë konçesionare, jo gjithmonë, është respektuar koha maksimale për daljen e rezultatit, për të cilat duhej të aplikohej penalitet të parashikuar në kontratën koncesionare. **2**.Diferenca të konsiderueshme kanë rezultuar edhe në faturimin e analizave laboratorike nga shoqëria konçesionare, gjatë raportimit të ekzaminimeve laboratorike si Imunfenotipet dhe CD4 të cilat kryhen me markera të ndryshëm. Ndërsa Laboratori i faturon sipas kontratës me nr. markerash të kryer për çdo analizë, shërbimet mjekësore i raportojnë si një analizë e vetme. Në përfundim, konkluduam, se MSHMS, në rolin e institucionit epror, nëpërmjet Komitetit Ndërlidhës, **nuk** ka monitoruar ecurinë periodike të kontratës koncesionare në qendrat spitalore universitare, spitalet referuese dhe ato bashkiake. Vecanërisht, pas raportimeve të QSUNT mbi monitorimin periodik të kryer për periudhën Nëntor, Dhjetor 2020, **nuk** ka marrë asnjë masë për verifikimin e mëtejshëm të parregullsive të konstatuara nga grupet e punës së QSUNT, me qëllim korrigjimin e tyre, nxjerrjen e përgjegjësive dhe aplikimin e penaliteteve për rastet e konstatuara me devijime nga kushtet e kontratës koncesionare.
Kriteri:	Ligjin nr.125/2013 ñPër koncesionet dhe partneritetin publik privat, Kontratës Koncesionare nr.prot 1924/2 datë 10.04.2019 ñPër ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjesò
Ndikimi/Efekti:	Grupi i auditimit, konstaton se, parashikimet në dispozitat e Kontratës flasin qartë për raportim të veprimtarisë ose raporte monitorimi progresiv, por për shkak të argumentave të mësipërme, AK justifikohet se në këtë fazë të hershme të implementimit të shërbimit në shumë prej objekteve laboratorike nuk mund të ketë raporte monitorimi të qarta mbi realizimin e pjesëve të veçanta të grafikut të punimeve, të përshtatjes apo rikonstruksionit në spitale, kjo në kundërshtim me ligjin nr.125/2013 ñPër koncesionet dhe partneritetin publik privatò neni 10, pika 4 dhe 5.
Shkaku:	Shërbimi laboratorik nga Koncensionari realizohet, në Qëndren Universitare Spitalore "Nene Tereza" prej datës 02.11.2020, në Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik ñKoco Glozheniò prej datës 05.04.2021, në Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik ñMbreteresha Geraldinë prej datës 19.04.2021, në Spitalin Universitar të Traumës prej datës 01.04.2021dhe në Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò prej datës 26.03.2021. Laboratorët në spitalet rajonale të Durrësit, Elbasanit, Shkodrës, Lezhës, Fierit, dhe Beratit po inspektohen aktulaisht nga Grupi i Inspektimit dhe janë në pritje të komisionimit. Në spitalet bashkiake të Lushnjës, Sarandës, në spitalin rajonal të Vlorës dhe Korçës kanë përfunduar përshtatja dhe rregullimi i ambienteve dhe po punohet për instalimin e aparaturave. Me përfundimin e lidhjes dhe testimit të sistemeve do fillojnë trajnimet e stafit mbi sistemet dhe procedurat. Duke ndjekur fazat si më sipër, parashikohet që këto objekte të jenë gati për komisionim brenda datës 20 maj 2021.
Rëndësia:	I Larte
Rekomandimi:	**1.**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për kryerjen e monitorimit periodik dhe hartimin e raporteve përkatëse mbi zbatimin e kontratës koncesionare, me qëllim, përmirësimin e performancës në ofrimin e shërbimeve laboratorike publike, si dhe për eleminimin e parregullsive dhe minimizimin e risqeve që mund të ndikojnë në buxhetin e shtetit. **2.**Komitetit Ndërlidhës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë në shqyrtim të gjitha raportet periodike të monitorimit të qendrave spitalore universitare, spitaleve referuese dhe atyre bashkiake, të realizuara deri tani, për verifikimin e mëtejshëm të parregullsive të konstatuara nga grupet e punës përkatëse, me qëllim korrigjimin e tyre, nxjerrjen e përgjegjësive dhe aplikimin e penaliteteve për rastet e konstatuara me devijime nga kushtet e kontratës koncesionare.

III.8. MBI VLERËSIMIN E FUNKSIONIMIT TË SISTEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, është kryer vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Planifikimi buxhetor për funksionimin normal të tij hartohet nga institucioni dhe dërgohet për miratohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duke ndjekur ecurinë për miratimin përfundimtar për tu vënë në dispozicion fondet buxhetore.

Monitorimi i veprimtarisë së këtij institucioni është si më poshtë vijon;

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2019 deri në 31.03.2021 rezultoi se:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta.

Sa më sipër, në përmbushje sipas kërkesave të pikës të nenit 18/1, nenit 19, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar, ñNëpunësi autorizues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktualò.

Kështu, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bazë të nenit 19 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, ka hartuar pyetësorin vjetor të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brëndshëm për vitin 2019 dhe vitin 2020 me shkresat nr.1077, datë 25.02.2020, drejtuar Njësisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar e Kontrollit në Ministrinë e Financave, dhe shkresa me nr.1095, datë 25.02.2021, për vitin 2020.

Referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët e kontrollit të brendshëm në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

-Aktivitetet e planifikuara për tu ndërmarrë me qëllim zgjidhjen e mangësive të zbuluara gjatë përgatitjes së raporteve vjetore mbi funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresat 1-nr.2168, datë 15.04.2019, është ngritur Urdhri me nr.333, datë 15.04.2019 dhe 2- Nr.3697, datë 04.08.2020, Urdhri nr.455, datë 04.08.2020 për Ngritjen e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve në Sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale , për hartimin e Projekt Puxhetit Afatmesëm 2020-2020. Programet janë ndarë si më poshtë :

Programi i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor, Programi i Shërbimeve të Kujdesit Spitalor, Programi i Shërbimeve të Shëndetit Publik, Programi i Planifikimit, Administrim dhe Menaxhim, Programi i Shërbimit Kombëtar të Urgjencës, Programi i Përkujdesjes Sociale, Programi i të Përndjekurve Politikë.

-Krijimi i Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), në referencë të ligjit nr. 10296 date 07.08.2010

ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemin e saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljen etike dhe se ky grup përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendës titullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Me urdhrin e brendshëm të Ministrit të MSHMS Znj. O. M. me . 329, datë 15.04.2019është ngritur GMS me këtë përbërje: Znj.O. M., Znj.M. R., Znj.G. P., Z. S. K., Znj.M. Xh., Z. T. Th., Znj.A. A., Znj.A. F., Znj.L. S., Znj.A. Xh., Znj.E. Sh., Znj.N. L., Znj.D. S., Znj.J. D., Znj.E. C., Znj. F. B., Znj.A. Nj. *Nuk ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së GMS për periudhën objekt auditimi, 2019 dhe 2020.*

1. Mjedisi i kontrollit.

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban: Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; politikat menaxheriale dhe stilin e punës; strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

a. *Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.*

Në referencë të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 ñPër rregullat e etikës në administratën publikeò, si dhe ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, nevojitet që punonjësit të respektojnë normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjelltë, mbështetur në krijimin e një Kodi të Brendshëm Etik. Nga auditimi u konstatua se, *Institucioni nuk ka hartuar ka hartuar një kod etike , por rregullat e etikës parashikohen vetëm në nenin 41, të rregullores së brendshme së MSHMS miratuar me Urdhrin nr.178, datë 22.02.2018.*

b. *Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.*

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale funksionon në bazë të strukturës së miratuar me Urdhrin eKryeministrit nr.169, datë 05.10.2017, ndryshuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.174, datë 10.10.2017 . MSHMS ka hartuar rregulloren e re me Urdhrin nr.178, datë 22.02.2018, të Ministrit të Shëndetësisë ku janë përcaktuar: struktura organizative e MSHMS funksionet dhe detyrat e funksioneve të larta të Drejtimit, funksionet e drejtorive dhe sektorëve , si dhe marrëdhëniet midis tyre, kanalet dhe mënyrat e komunikimit, por nuk janë përshkruar *detyrat e secilit punonjës pra nuk ka përshkrim të detajuar për secilin pozicion punë,* ku duhet të jenë edhe kriteret që punonjësi duhet të plotësojë për pozicionin ku punon, si dhe të jenë një dokument zyrtar i unifikuar, sipas VKM-së NR.142, datë 12.03.2014, ñPër Përshkrimin Dhe Klasifikimin E Pozicioneve Të Punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Pavaruraò në mënyrë që secili punonjës të njohë detyrat e tij .

Kjo ndikon në të gjithë funksionimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

c.*Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.* Në Përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, neni 15 ñRregulla të përgjithshme për delegimin e detyraveò, si dhe Kapitulli III ñDelegimi i detyraveò, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kemi konstatuar se ka rregullore të brendshme të miratuar nga titullari,ku të jenë evidentuar delegimi i detyrave dhe mënyra e dokumentimit të tyre.

d.*Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.* Nga auditimi u konstatua se, për periudhën 01.01.2019- 31.03.2021 janë kryer vlerësimet e punonjësve për vitet 2019 dhe të vitit 2020.

e.*Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale tëpunonjësve* gjatë viteve të objekt auditimit, nga auditimi u konstatua se, ky institucion ka paraqitur programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës për periudhën janar ï dhjetor 2020 me shkresën nr.58, datë

07.01.2020 ñPlani i Trajnimeve 2020ò, nuk ka pasur programe për vitin 2019, referuar Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin,Kap.II, pika 2.5.1 ñMjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)ò, paragrafët ñPolitikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzoreò dhe ñProfesionalizmi i stafitò. Institucioni ka kryer trajnime të ndryshme gjithëpërfshirëse.

2. Menaxhimi i riskut.

Nga auditimi u konstatua se, ky institucion ka miratuar regjistrin e riskut, pra ka bërë vlerësimin dhe kontrollin e risqeve për vitin 2019 por jo për vitin 2020, nga institucioni u citua se nuk është hartuar regjistri i riskut për shkak të pandemisë Covid-19, të cilat venë në rrezik arritjen e objektivave ku drejtuesit janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut, por u konstatua se në regjistrin e riskut nuk janë futur pjesë shumë të rëndësishme siç janë monitorimi i kontratave të ndryshme të zhvilluara në MSHMS. Nga auditimi u konstatua se, trajnimi mbi menaxhimin e riskut ishte parashikuar por nuk është realizuar për punonjësit , element ky shumë i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrolli si dhe referuar kapitullit III të ñManualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollitò i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar nëidentifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.

3. Aktivitetet e kontrollit.

Nga auditimi është konstatuar se, janë përcaktuar procedurat mbi kryerjen e monitorimeve, janë hartuar Urdhri me nr.224, datë 08.03.2019 , Për angazhim Auditimi , sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 me ndryshime ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò neni 16 ñDetyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimitò pika 2 ku përcaktohet:*"Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi",* si dhe Manualit të Menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me vendimin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 anekset 2, 3 dhe 4.

4. Informim komunikimi.

Nga auditimi u konstatua se, përgjithësisht komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë është bërë në formën dhe kohën e duhur, për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësive.Titullari është informuar nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, nëpërmjet relacioneve dhe raporteve rreth këtyre mbledhjeve. Sektori i Financës ka raportuar tek nëpunësi autorizues me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, duke hartuar raporte monitorimi mujore, apo tremujore. Punonjësit brenda instiucionit vijojnë të komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. MSHMS ka faqen e tij zyrtare dhe nëpërmjet këtij ëebsite të gjithë të interesuarit mund të informohen rreth punës së përditshme të MSHMS_së.

5. Monitorimi.

Nga auditimi i të gjitha fushave të veprimtarisë së këtij institucioni rezultoi se, janë hartuar raportet e monitorimit të buxhetit dhe raportet e monitorimit vjetor të tij, sipas ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, në nenin 65 ñMonitorimiò, në të cilin citohet:ñNëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes qendrore, i paraqesin sa herë që kërkohet, por jo më pak se katër herë në vit, nëpunësit të parë autorizues, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo projekt të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të projektit buxhetor afatmesëm.

Nga auditimi i pikës mbi prokurimet publike u konstatua se një problematikë e hasur është dhe monitorimi i kontratave, pasi në pjesën më të madhe ku Ministria e Shëndetësisë ka qenë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, lidhja dhe zbatimi i kontratave sështë realizuar në Institucionet

në varësi të saj Psh: Qëndra Spitalore Universitare Nënë Tereza, Spitali Shëfqet Ndroqi, Spitali i Vlorës, Qendra e Urgjencës etj..., prej të cilave nuk kanë marrë një informacion monitorues përshkrues të ecurisë përfundimtare për zbatimin e sukseshëm të kontratave.
Gjithashtu u konstatua se, në bazë të VKM nr.645 datë 01.10.2014 ñPër ngritjen dhe mënyrën e funksionit të komisionit të çmimit të barnaveò i ndryshuar me VKM nr.668 datë 10.10.2019, ka vendosur që, MSHMS, njofton, nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare, të gjithë mbajtësit e autorizimit të tregtimit të barit në Shqipëri, për deklarimin e çmimeve ñCIFò në euro ose dollarë, për barnat e importit dhe çmimet ñEXWò (ex-work) në lekë, për barnat e fabrikuara në vend, ku Drejtoria Farmaceutike, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, bën shpalljen, në faqen zyrtare të ministrisë.Deri në momentin që është hartuar materiali, publikimi nuk është realizuar.
Në lidhje mbi problematikat e konstatuara, nga grupi i audituesve u mbajt Akt konstatimi nr.12 lidhur me zbatimin dhe vlerësimin e MFK protokolluar në MSHMS me nr.415/18, datë 30.04.2021, për të cilin janë sjellë observimet nga MSHMS në lidhje mbi Projekt raportin e përcjellë nga KLSH me shkresë nr.121/10 prot datë 03.09.2021, të cilat kanë ardhur më datë 14.10.2021 jashtë afatit kohor të parashikuar në ligjin 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit neni 26 dhe 29ô me shkresë nr.415/47 prot të MSHMS dhe me nr.121/11 prot datë 14.10.2021 të KLSH.
Në lidhje mbi konstatimin se, në rregulloren e MSH nuk janë përshkruar detyrat e secilit punonjës pra nuk ka përshkrim të detajuar për secilin pozicion punë, ku duhet të jenë edhe kriteret që punonjësi duhet të plotësojë për pozicionin ku punon, si dhe të jenë një dokument zyrtar i unifikuar, në mënyrë që secili punonjës të njohë detyrat e tij, nga MSHMS është paraqitur Urdhër nr.789 datë 19.12.2019 ñ*Për një shtesë në Urdhërin nr.178, datë 22.02.2018 "Për miratimin e Rregullores së brëndshme për organizimin dhe funksionimin i MSHMS", ku pika 1 shprehet se "neni 46/1 Pjesë përbërëse e kësaj rregullore është aneksi nr.1 "Përshkrimet e punës' që i bashkëlidhet këtij urdhëri.*ò
Sa më sipër, audituesit e KLSH , i ri vlerësuan dhe për këtë çështje merret në konsideratë, ndërsa për problematikat e tjera për, të cilat nuk kanë paraqitur dokumentacion shtesë apo argumentim ligjor shtesë në lidhje mbi problematikën e konstatuar, për këtë qëllim, audituesit shprehen me të njëjtin qëndrim, si vijon:

Gjetje	Mbi vlerësimin e sistemit te menaxhimit financiar dhe kontrollit
Situata:	-Institucioni nuk ka hartuar ka hartuar një kod etike , por rregullat e etikës parashikohen vetëm në nenin 41, të rregullores së brendshme së MSHMS miratuar me Urdhrin nr.178, datë 22.02.2018. - Nga auditimi u konstatua se, punonjësit nuk janë trajnuar mbi menaxhimin e riskut element ky shumë i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrolli si dhe referuar kapitullit III të ñManualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollitò i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.
Kriteri:	-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. -VKM-së NR.142, datë 12.03.2014, ñPër Përshkrimin Dhe Klasifikimin E Pozicioneve Të Punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Pavaruraò
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e trajnimeve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka ndikim negative për njësinë pasi stafit i mungojnë njohuritë mbi mënyrën e funksionimit të këtij sistemi, përgjegjësitë, shkallën hierarkike etj. Mungesa e një kodi etike dhe ndarja e detyrave duhet të përcaktohen qartë në mënyrë që secili punonjës të njohë detyrat dhe të drejtat e tij
Shkaku:	Mosveprimi i menaxhimit të MSH-së për hartimin e kodit të Etikës, ndarjen e detyrave të secilit punonjës , planeve të trajnimeve profesionale, si dhe mungesa e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave për trajnimet në fushën e ñMenaxhimit

	financiar dhe kontrollit
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	-MSH duhet të marrë masa për hartimin e programeve specifike të trajnimeve veçanërisht trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut. -Institucioni të marrë masa për hartimin e përshkrimeve të punës, dhe përfshirjen e tyre në Rregulloren e Brendshme. -MSHMS duhet të marrë masa për hartimin e një kodi etike në përmbushje të Rregullave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

III.8. VLERËSIMI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

➢ ***Organika e miratuar për DAB në MSHMS, paraqitet si vijon:***

Nr.	Emertimi	Nr. Punonjësish (Plan)	Nr. Punonjësish (fakt) 2019	Nr. Punonjësish (fakt) 2020
1	Drejtor	1	1	1
2	Specialist Auditi	6	6	6
Total		7	7	7

Me Urdhërin e Kryeministrit nr.169 datë, 05.10.2018, òPër miratimin e strukturës dhe organikës se MSH ò ndryshuar në Urdhërin Nr.174, datë 10.10.2017, të Kryeministrit, për ñMiratimin e strukturës dhe organikës së MSHò Njësia e AB-së varet nga Sekretari i Përgjithshëm, ndërsa lidhur me funksionimin dhe raportimin Njësia varet nga Ministri.
Struktura e personelit të Njësisë është:

❖ Ekonomist 1 drejtor me përvojë pune 16 vite.
❖ Ekonomist 6 auditues ose 100% e stafit. Përvoja e tyre si auditues varion nga 9.8-19 vite.
❖ Të gjithë punonjësit ë njësisë së AB janë të certifikuar si ñAuditues i Brendshëm në Sektorin Publikò
❖ Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, drejtoria ka funksionuar pothuajse me 4 specialistë, pasi 1 specialiste me leje lindje dhe 1 specialiste dalë në pension që nga muaji Mars i këtij viti.
❖ *Gjatë periudhës së auditimit, në MSHMS u vu në zbatim struktura e re e Auditit të Brendshëm, me urdhërin e Kryeministrit Nr.27, datë 09.02.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në urdhërin nr.169, datë 05.10.2017 për "Miratimin e strukturës dhe organikës të MSHMS", të ndryshuar, i cili ka urdhëruar :*

1-Drejtoria e Auditit të Brendshëm - 1 Drejtor dhe 4 Specialistë.

-Ministria e Shëndetësisë dhe Mrojtjes Sociale ka në varësi të saj, 104 subjekte, nga ku 93 subjekte janë subjekte auditimi, duke përfshirë dhe organi qëndror.

➢ ***Viti 2019***

Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, pas miratimit nga titullari i institucionit, dërgohen jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti pranë NjQH/AB. brenda afatit ligjor.

Plani vjetor dhe strategjik është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm me s**hkresën nr. 16350 Prot., datë 12.09.2018**.

Me shkresën nr.5345/1 Prot., datë 12.10.2018 ministri i MSHMS, ka miratuar planin Strategjik dhe Vjetor 2019-2021.

Referuar shkresës nr.5345/2 Prot., datë 15.10.2018 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i ka dërguar Planin Vjetor dhe Strategjik, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Për ushtrimin e veprimtarisë së auditit të brendshëm gjatë vitit 2019 është përgatitur ñPlani vjetor dhe Strategjik 2019 për zhvillimin e auditit për vitet 2019-2021ò.

-Plani Strategjik për periudhën 2019 ï 2021, përbëhet nga :
Pasqyra Nr .1- Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitin 2019-2021
Pasqyra Nr.2 - Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar 2019-2021.
Pasqyra Nr.3- Plani i Angazhimeve të NJAB për vitin 2018.
Pasqyra Nr.4 ï Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2019.
Pasqyra Nr.5 ï Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2019
Në planin vjetor të angazhimeve të auditimeve janë përcaktuar objektivat për tu audituar. Sipas kësaj pasqyre janë përcaktuar për tu audituar në vitin 2019, gjithsej 20 nga të cilat,:

- 1 Auditim Përputhshmërie në Aparatin e e MSHMS, konkretisht në Drejtorinë e Integritetit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës (risk të lartë)
- 1 auditim Performance në Aparatin e MSHMS.(risk i lartë)
- 18 auditime të Kombinuara në Institucionet e varësisë, në kategoritë si : Administrimi 1 subjekt, Shërbimi dytësor 1 subjekt, Shëndeti Publik 8 subjekte, Shërbimi Spitalor 7 subjekte dhe Mbrojtja Sociale 1 subjekt. (risk i mesëm)

➢ **Planifikimi dhe realizimi 2019**

Planifikimi	**Realizimi**
1. Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1.Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. Qendra Kombëtare e Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit Tiranë	2. Qendra Kombëtare e Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit Tiranë
3.Qendra Kombëtare e Inxnierisë Biomjekësore Tiranë	3. Qendra Kombëtare e Inxhinierisë Biomjekësore Tiranë
4. Drejtoria e Shëndetit Publik Kavajë	4. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Kavajë
5.Drejtoria e Shëndetit Publik Krujë	5.Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Krujë
6.Drejtoria e Shëndetit Publik Librazhd	6. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Librazhd
7.Drejtoria e Shëndetit Publik Malësi e Madhe	7. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Malësi e Madhe
8.Drejtoria e Shëndetit Publik Mallakastër	8. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Mallakastër
9. Drejtoria e Shëndetit Publik Mat	9. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Mat
10.Drejtoria e Shëndetit Publik Pogradec	10.Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Pogradec
11.Drejtoria e Shëndetit Publik Tropojë	11. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tropojë
12. Shërbimi Spitalor Krujë	12. Shërbimi Spitalor Krujë
13. Shërbimi Spitalor Malësi e Madhe	13.Shërbimi Spitalor Malësi e Madhe
14. Shërbimi Spitalor Mallakastër	14. Shërbimi Spitalor Mallakastër
15. Shërbimi Spitalor Mat	15. Shërbimi Spitalor Mat
16. Shërbimi Spitalor Përmet	16.Shërbimi Spitalor Përmet
17. Shërbimi Spitalor Tepelenë	17. Shërbimi Spitalor Tepelenë
18. Shërbimi Spitalor Tropojë	18.Shërbimi Spitalor Tropojë
19. Agjencia Shtetërore e Mbrojtjes së Fëmijëve	19.Agjencia Shtetërore e Mbrojtjes së fëmijëve
	20. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë

Burimi: DAB

Me urdhërin nr.214, datë 05.03.2019, nga Ministri i MSHMS, për ñAngazhim Auditimiò, është urdhëruar kryerja e auditimit sipas sistemeve në Autoritetin Shëndetësor Rajonal Tiranë.
Bazuar në shkresën 171/1 Prot., datë 03.02.2020 Ministria e Shëndetetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka dërguar Raportin përmbledhës për periudhën Janar-Dhjetor 2019 , Ministrisë së Financave , Drejtorisë së Përgjithshme së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik. Bashkngjitur gjenden:

Pasqyra nr.1: Të dhënat për burimet njerëzore të auditimit të brendshëm
Pasqyra nr.2: Realizimi i planit të angazhimeve për vitin 2019
Pasqyra nr.3: Përmbledhëse e gjetjeve me dëm ekonomik nga angazhimet e auditimit
Pasqyra nr.4: Përmbledhëse e parregullsive të identifikuara sipas sistemeve
Pasqyra nr.5: Rekomandimet e dhëna sipas kategorive
Aneksi 3: Pyetësori i vetëvlerësimit për Njësitë e Auditimit të Brendshëm
Pasqyra nr.6 ñ Cështjet e dërguara për investigimò nuk është plotësuar për këtë periudhë pasi nuk ka cështje të dërguara me këtë objekt në Ministrinë ë Financave dhe Ekonomisë.
Referuar Raporteve të Auditimit për cdo angazhim janë identifikuar **gjithsej 220 parregullsi dhe gjetje me dëm ekonomik në shumën 2,370.3 mijë lekë.***Nga analiza e misioneve të auditimit , objektivave të auditimeve, rezulton se në fund të vitit 2019, mbeten në proces ecvadimi 3 auditime, në fazën e raportimit dhe në fund të periudhës nuk janë realizuar 2 angazhimet e auditimit të planifikuara në Aparatin e MSHMS, konkretisht:*

1- Auditim përputhmërie për IPA ll
2- Auditim Performance.

➢ ***Viti 2020***

Për periudhën raportuese janë realizuar gjithsej 13 angazhime nga 13 angazhime të planifikuara, ose 100 %. Referuar Raporteve të Auditimit për cdo angazhim janë identifikuar **gjithsej 136 parregullsi dhe gjetje me dëm ekonomik në shumën 13,827 mijë lekë.**
Në vitin 2020 janë planifikuar për auditim 35% subjekte më pak në krahasim me vitet 2018 dhe 2019, kjo për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19 dhe stafit të reduktuar, është bërë në mënyrë të domosdoshme rishikimi i planit vjetor, e tillë që, nga 19 subjekte të parashikuara, plani është reduktuar në 13 subjekte, referuar shkresës 4092/1 Prot.,datë 14.09.2020 , nga ku Drejtoria e Auditit të Brendshëm i ka dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë , Drejtorisë së Përgjithshme së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, planin Vjetor të 2020, të ndryshuar.Me shkresën nr.4879, datë 14.10.2019, ministri, ka miratuar Planin Strategjik 2020-2022. Me shkresën 4879/1 Prot., datë 15.10.2019 MSHMS, Drejtoria e Auditit të Brendshëm, ka dërguar në Ministrinë ë Financave dhe Ekonomisë, Planin Vjetor dhe Strategjik për vitet 2020-2022, datë 15.10.2019. Bashkëngjitur :

1. Deklarata strategjike dhe vjetore
2. Formatet standarte nr.1, 2 dhe 3
3. Pasqyrat nr.1, 2, 3, 4 dhe 5 .

Bazuar në shkresën 266/1 Prot., datë 12.02.2021 Ministria e Shëndetetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka dërguar Raportin përmbledhës për periudhën Janar-Dhjetor 2020, Ministrisë së Financave , Drejtorisë së Përgjithshme së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik. Bashkngjitur gjenden:

3- Pasqyra nr.1: Të dhënat për burimet njerëzore të auditimit të brendshëm.
4- Pasqyra nr.2: Realizimi i planit të angazhimeve për vitin 2020
5- Pasqyra nr.3: Përmbledhëse e gjetjeve me dëm ekonomik nga angazhimet e auditimit
6- Pasqyra nr.4: Përmbledhëse e parregullsive të identifikuara sipas sistemeve
7- Pasqyra nr.5: Rekomandimet e dhëna sipas kategorive.
8- Pasqyra nr.6 : Cështjet e dërguara për investigim
9- Aneksi 3: Pyetësori i vetëvlerësimit për Njësitë e Auditimit të Brendshëm.

➢ **Planifikimi dhe realizimi 2020**

Planifikimi	**Realizimi**

Në fillim të vitit	I rishikuar	
1.Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1.Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1.Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Kukës	2. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Kukës	2. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Kukës
3.Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Lezhë	3. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Lezhë	3. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Lezhë
4. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Has	4. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Has	4. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Has
5. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (Qendror) Tiranë	5. Spitali Rajonal Berat	5. Spitali Rajonal Berat
6. Spitali Rajonal Berat	6. Spitali Rajonal Elbasan	6. Spitali Rajonal Elbasan
7. Spitali Rajonal Elbasan	7. Spitali Rajonal Fier	7. Spitali Rajonal Fier
8. Spitali Rajonal Fier	8 Spitali Rajonal Gjirokastër	8. Spitali Rajonal Gjirokastër
9. Spitali Rajonal Gjirokastër	9. Spitali Rajonal Korçë	9. Spitali Rajonal Korçë
10. Spitali Rajonal Korçë	10.Spitali Rajonal Shkodër	10.Spitali Rajonal Shkodër
11. Spitali Rajonal Kukës	11 Shërbimi Spitalor Devoll	11.Shërbimi Spitalor Devoll
12. Spitali Rajonal Shkodër	12.Shërbimi Spitalor Mirditë	12.Shërbimi Spitalor Mirditë
13. Shërbimi Spitalor Devoll	13.Shërbimi Spitalor Sarandë	13.Shërbimi Spitalor Sarandë
14. Shërbimi Spitalor Gramsh		
15. Shërbimi Spitalor Has		
16. Shërbimi Spitalor Laç		
17. Shërbimi Spitalor Mirditë		
18.Shërbimi Spitalor Sarandë		

Burimi: DAB

Raportimet janë dërguar brenda afateve të kërkuara dhe janë sipas kërkesave dhe metodologjisë së kërkuar nga DAB. Me miratimin e ligjit 114/2015 të ñAuditimit të Brendshëm për Sektorin Publikò, sektori i auditimit ka hartuar kartën e auditimit miratuar nga Drejtori i Auditimit të Brendshëm dhe Ministrit të MSHMS si dhe është ngritur Komiteti i Auditit të Brendshëm.

- ***Dosjet e audituara për vitin 2019 dhe 2020***

1.QKIB Tiranë, ne vlerën 50 mijë lekë. Me datë 25.02.2019 është dërguar ***Njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit, drejtuar QKIB Tiranë me shkresën nr. 1241.Prot, date 25.02.2019,*** takimi fillestar është kryer me datë 01.03.2019 duke ju referuar programit të auditimit nr. 1241/1 datë 26.03.2019 në të cilën janë përshkruar drejtimet kryesore të auditimit, si dhe afatet e miratuara nga tituallari i institucionit. Eshtë kryer auditim i Kombinuar Financiar dhe i Përputhshmërisë, për periudhën 01.01.2014-31.12.2018 dhe ku afati i auditimit është kryër nga data 01.03.2019 deri më datë 05.04.2019. Me shkresën nr.1241/2,datë 23.04.2019 është dërguar raport përfundimtari i auditimit në QKIB Tiranë dhe ku me datë 08.05.2019 nga QKIB Tiranë është kthyer nje kopje e firmosur të Raport përfundimtarit së bashku me abservacionet. Me shkresën nr.1241/4 datë 02.02.2019 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit QKIB Tiranë si dhe Memo drejtuar Ministrit të MSHMS , me shkresën nr.1214/6 Prot, datë 19.07.2019.Nga grupi i auditimit u konstatua se.Nga Subjekti ka ardhur informacion mbi Planin e Veprimit , me shkresën nr.1582/1 Prot., datë 25.09.2020. Me shkresën nr.1241/7, Drejtoria e Auditit të Brendshëm të MSHMS i drejtohet QKIB Tiranë, lidhur me reagimin mbi misionin e Auditimit.

2.DSHP Librazhd, në vlerën 197 mijë lekë. Me datë 25.03.2019 është dërguar Njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit, me shkresën nr.1719 Prot., drejtuar DSHP Librazhd, takimi fillestar është kryer me datë 01.03.2019 duke ju referuar programit të auditimit nr. 1791/3 datë 15.04.2019 në të cilën janë përshkuar drejtimet kryesore të auditimit, si dhe afatet e miratuar nga tituallri i institucionit. Eshtë kryer auditim i Kombinuar Financiar dhe i Përputhshmërisë, për periudhën Tetor 2014- Mars 2019 dhe ku afati i auditimit është kryer nga data 08.04.2019 deri më datë 26.04.2019. Me shkresën nr.1791/4, datë 15.04.2019 është dërguar raport përfundimtari i

auditimit në Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Librazhd dhe ku me datë 24.05.2019 nga NJVKSH Librazhd janë kthyer nje kopje e firmosur të Raport përfundimtarit së bashku me abservacionet. Me shkresën nr.1791/6 datë 05.06.2019 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit NJVKSH Librazhd si dhe Memo drejtuar Ministrit të MSHMS, me shkresën nr.1719/8 Prot, datë 19.07.2019. Me shkresën nr.1791/9, Drejtoria e Auditit të Brendshëm të MSHMS i drejtohet NJVKSH Librazhd, lidhur me reagimin mbi misionin e Auditimit.

3.Spitali Rajonal Elbasan, ne vlerën 1,571 mijë lekë.. Me datë 04.03.2020 është dërguar Njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit me shkesën nr.1248 Prot., drejtuar Spitalit Rajonal Elbasan, takimi fillestar është kryer me datë 05.03.2020 duke ju referuar programit të auditimit nr. 1248/1 datë 11.05.2020 në të cilën janë përshkuar drejtimet kryesore të auditimit, si dhe afatet e miratuar nga tituallri i institucionit. Eshtë kryer auditim i Kombinuar Financiar dhe i Përputhshmërisë, për periudhën 01.07.2019-30.04.2020 dhe ku afati i auditimit është kryer nga data 05.05.2020 deri më datë 29.05.2020. Me shkresën nr.1248/2,datë 22.06.2020 është dërguar raport përfundimtari i auditimit në Spitalin Rajonal Elbasan dhe ku me datë 07.07.2020 nga subjekti është kthyer nje kopje e firmosur të Raport përfundimtarit së bashku me abservacionet, më shkresën nr.1125/2 Prot. Me shkresën nr.1248/3 datë 02.02.2020 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit Spiali Rajonal Elbasan si dhe Memo drejtuar Ministrit të MSHMS , me shkresën nr.1248/6 Prot, datë 13.10.2020. Me shkresën nr.1248/6, datë 27.07.2020, Drejtoria e Auditit të Brendshëm të MSHMS i drejtohet Spitalit Rajonal Elbasan, lidhur me reagimin mbi misionin e Auditimit.

4.NJVKSH Mat, në vlerën 1.526 mijë lekë. Me datë 27.06.2019 është dërguar Njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit, me shkresën nr.3423 Prot., drejtuar NJVKSH Mat, takimi fillestar është kryer me datë 08.07.2019 duke ju referuar programit të auditimit nr. 3423/1 datë 08.07.2019 në të cilën janë përshkuar drejtimet kryesore të auditimit, si dhe afatet e miratuar nga tituallri i institucionit. Eshtë kryer auditim i Kombinuar Financiar dhe i Përputhshmërisë, për periudhën 01.03 2014- 30.06.2019 dhe ku afati i auditimit është kryer nga data 08.07.2019 deri më datë 26.07.2019. Me shkresën nr.3423/2, datë 20.09.2019 është dërguar raport përfundimtari i auditimit në Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Mat dhe ku me datë 02.10.2019 nga NJVKSH Mat janë kthyer nje kopje e firmosur të Raport përfundimtarit së bashku me abservacionet. Me shkresën nr.3423/4 datë 11.11.2019, është dërguar raporti përfundimtar i auditimit NJVKSH Mat si dhe Memo drejtuar Ministrit të MSHMS , me shkresën nr.3423/5 Prot, datë 21.11.2019.

5.Drejtoria e Shërbimit Spitalor Përmet, në vlerën 2,560 mijë lekë. Me datë 21.10.2019 është dërguar Njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit, me shkresën nr.5020 Prot., drejtuar Drejtoria e Shërbimit Spitalor Përmet, takimi fillestar është kryer me datë 05.11.2019 duke ju referuar programit të auditimit nr. 5020/2 datë 05.11.2019 në të cilën janë përshkruar drejtimet kryesore të auditimit, si dhe afatet e miratuara nga titullari i institucionit. Eshtë kryer auditim i Kombinuar Financiar dhe i Përputhshmërisë, për periudhën 01.09.2014- 31.11.2019 dhe ku afati i auditimit është kryer nga data 05.11.2019 deri më datë 27.11.2019. Me shkresën nr.5020/4, datë 14.02.2019 është dërguar raport përfundimtari i auditimit në Drejtoria e Shërbimit Spitalor Përmet dhe ku me datë 04.02.2020 nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Përmet janë kthyer nje kopje e firmosur të Raport përfundimtarit së bashku me abservacionet. Me shkresën nr.2005 datë 27.04.2020 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit Drejtoria e Shërbimit Spitalor Përmet si dhe Memo drejtuar Ministrit të MSHMS , me shkresën nr.3423/5 Prot, datë 21.11.2019.

6.Drejtoria e Shërbimit Spitalor Tepelenë, në vlerën 9,696 mijë lekë. Me datë 19.08.2019 është dërguar Njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit, me shkresën nr.4128 Prot., drejtuar Drejtoria e Shërbimit Spitalor Tepelenë, takimi fillestar është kryer me datë 16.09.2019 duke ju referuar programit të auditimit nr. 4128/1 datë 25.09.2019 në të cilën janë përshkruar drejtimet kryesore të auditimit, si dhe afatet e miratuar nga titullari i institucionit. Eshtë kryer auditim i Kombinuar Financiar dhe i Përputhshmërisë, për periudhën 01.03.2014- 31.08.2019 dhe ku afati i auditimit është kryer nga data 06.09.2019 deri më datë 11.102019, gjithashtu grupi i auditit ka

kërkuar shtyerjen e afatit të auditimit me shkresën nr. 4128/2 Prot., datë 07.10.2019. Me shkresën nr.4128/3, datë 10.12.2019 është dërguar raport përfundimtari i auditimit në Drejtoria e Shërbimit Spitalor Tepelenë dhe ku me datë 07.01.2020 nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Përmet janë kthyer nje kopje e firmosur të Raport përfundimtarit së bashku me abservacionet. Me shkresën nr.2006 datë 27.04.2020 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit Drejtoria e Shërbimit Spitalor Tepelenë ***si dhe në dosje ndodhet Memo drejtuar Ministrit të MSHMS , por e paprotokolluar. Nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të MSHMS subjektit i drejtohet lidhur me reagimin mbi misionin e Auditimit , ku në këtë dosjë mungon një shkresë e tillë***

7.DSHP Kavajë, ne vlerën 1.526 mijë lekë. Me shkresën nr.1182 Prot., datë 21.02.2019 është dërguar Njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit, takimi fillestar është kryer me datë 01.03.2019 duke ju referuar programit të auditimit nr. 1182/2 datë 26.03.2019 në të cilën janë përshkuar drejtimet kryesore të auditimit, si dhe afatet e miratuara nga tituallri i institucionit. Eshtë kryer auditim i Kombinuar Financiar dhe i Përpuethshmërisë, për periudhën 01.01.2014-31.12.2018 dhe ku afati i auditimit është kryër nga data 01.03.2019 deri më datë 05.04.2019. Me shkresën nr.1182/3, datë 17.04.2019 është dërguar raport përfundimtari i auditimit në DSHP Kavajë dhe ku me datë. Me shkresën nr.1182/4 datë 13.05.2019 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit DSHP Kavajë si dhe Memo drejtuar Ministrit të MSHMS , me shkresën nr.1182/6 Prot, datë 10.06.2019. Me shkresën nr.1182/5, Drejtoria e Auditit të Brendshëm të MSHMS i drejtohet DSHP Kavajë, lidhur me reagimin mbi misionin e Auditimit.

➢ ***Nisur nga sa më sipër, grupi audituesve, ka konstatuar si më poshtë vijon:***

-Nga auditimi i grupit të KLSH për vitin 2019 dhe 2020 u audituan 7 dosje të realizuara në, QIKB Tranë, DSHP Librazhd, Spitali Rajonal Elbasan, NJVKSH Mat, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Përmet, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Tepelenë, DSHP Kavajë ku rezulton se nga, NjAB dosjet nga ana dokumentimit administrativ janë korrekte, pra nuk ka patur mangësi në plotësimin e kërkesave që janë të parashikuara në Manualin e Auditimit të brendshëm të miratuar nga Ministri të MSHMS dhe Udhëzimi nr. 12, datë 05.06. 2012 ñMbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publikò, duke vecuar dosjen e ***Drejtoria e Shërbimit Spitalor Tepelenë, ka mungesë të dokumentacionit.*** Në përgjithësi nga NJAB është respektuar procedura e auditimit në përputhje me bazën ligjore dhe manuali i auditimit të brendshëm . Nga auditimi u konstatua se janë respektuar afatet e auditimit, ku me saktësisht, raporti përfundimar i auditimit referuar manualit per manxhimin financiar duhet ti dërgohet subjektit 7 dite pune pas reagimit të subjektit, afat i cili është respektuar.

Nga auditimi u konstatua se plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në
përfundim të angazhimit të auditimit e cila plotësohet nga njësia publike e audituar si dhe e miratuar nga titullari jo me vone se 20 dite pune pasi subjekti njihet me raportin përfundimtar, i është dërguar njësisë.

Observacioni i subjektit mbi Akt konstatimin nr.13 me nr.414/2 Prot., datë 04.05.2021.

Pretendimi i subjektit: Lidhur me Njoftimin e Fillim Auditimit për dosjen QKIB Tiranë, nga Subjekti Sqarohet se MSHMS e ka dërguar dhe protokolluar me shkresën nr. 1241.Prot, date 25.02.2019. Bashkëngjitur me shkresën shpjeguese është vënë në dispozicion dhe një fotokopje e Njoftimit (Formati standart nr.3). **Qëndrimi i grupit të auditimit:** **Për sa më sipër ky observacion merret në konsideratë.**

Pretendimi i subjektit:
Lidhur me mungesën e dokumentacionit, Memo drejtuar titullarit në dosjen *Drejtoria e Shërbimit Spitalor Tepelenë,* MSHMSshprehet se mund të jetë gabim njerëzor i mos regjistrimit në protokoll ose ngatërresë shkresash në dosje, duke theksuar se kjo Memo është firmosur nga grupi i auditimt si dhe nga ana e Drejtorit të Auditimit të Brendshëm.
Qëndrimi i grupit të auditimit:
Referuar ligjit për nëpunësin civil nr.152/2013, seksioni 2, óDetyrimet e Nëpunësit Civilô Neni 43 - Detyrimi i përgjegjshmërisë dhe refuzimit të urdhrave të paligjshëm, pika 1. Nëpunësi civil mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e çdo veprimi apo mosveprimi të tij, gjatë ushtrimit të detyrës në shërbimin civil.
Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A.PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Ministrave në kushtet e emergjencës prej pandemisë Covid-19, gjatë periudhës marsi prill të vitit 2020 për parandalimin e situatës, ka nxjerrë disa akte nën ligjore, ndër to edhe VKM nr 203, datë 26.02.2020 ñ*Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit*ò. Sipas kësaj VKM, çdo kontratë që do të lidhen në zbatim të saj do të miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.
Mirëpo konstatohet se përmbajtja e kësaj VKM, nuk i ka shërbyer situatave emergjente për lehtësimin dhe eliminimin e kësaj fatkeqësie natyrore, pasi përmbajtja e saj ka krijuar disa hapësira në lidhje me zgjatjen e afateve kohore të furnizimit të medikamente, materiale mjekësore apo shërbimeve shëndetësore, me llogaritjet në mënyrë apriori apo subjektive të vlerave të këtyre kontratave; me mënyrën subjektive dhe klienteliste të përzgjedhjes së operatorëve furnizues; me formalizma për monitorimin e zbatimit të kontratave, etj.
Kështu në zbatim të kësaj VKM, autoriteti kontraktor (MSHMS) gjatë periudhës së pandemisë ka realizuar 7 (shtatë) procedura prokurimi, nga auditimi i të cilave u konstatuan disa anomali në lidhje me furnizimin dhe shërbimet emergjente të diktuara nga pandemia, si më poshtë:
(I) Sipas VKM nr 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar pika VII (Miratimi i Kontratës), kontrata hyn në fuqi pas miratimi të VKM respektive dhe në rast se kontrata nuk miratohet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga Këshilli i Ministrave, atëherë procedura do të quhet e anuluar.
Nga auditimi u konstatua se, kontratat janë miratuar, duke filluar nga 7 ditë deri në 10 dhjetë ditë më vonë nga data e lidhjes së kontratës duke bërë që të çedojë *"faktori kohë*ò, në kushtet e emergjencës prej pandemisë Covid 19. Për sa më sipër, u konstatua, miratimi me VKM-të respektive:
1-Procedura ñBlerje Barna Anti Covid -19ò ndarë në 10 Lote, me fond limit total 36,812,915 lekë.
Loti 5-Oseltamivir(Tamiflu) është lidhur kontrata me nr.1573/28, datë 06.04.2020, miratuar VKM nr.314, datë 18.04.2020 (12 ditë më vonë)
Loti 8-Omeprazol është lidhur kontrata me nr.1573/31, datë 07.04.2020, miratuar me VKM nr.313, datë 18.04.2020 (11 ditë më vonë).
Loti 9-Propofol, është lidhur kontrata me nr.1573/30, datë 06.04.2020, miratuar me VKM nr.320, datë 18.04.2020 (12 ditë më vonë).
Loti10-Beclomethasone+salbutamol është lidhur kontrata me nr.1573/32 datë 07.04.2020, miratuar me VKM nr.315, datë 18.04.2020 (11 ditë më vonë).

2-Procedura ñFurnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19ò me fond limit 129,727,371 lekë pa tvsh.
Është lidhur Kontrata e furnizimit me nr.1365/36 datë 27.03.2020, miratuar me VKM nr.274, datë 03.04.2020 (7 ditë më vonë).
3-Procedura ñBlerje Materiale Për Mbrojtje Personale Për Covid -19ò me fond limit prej 307,844,333lekë pa tvsh.
Është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1366/18, datë 18.03.2020, miratuar me VKM nr.241 datë 21.03.2020 (11 ditë më vonë).
4-Procedura ñBlerje kite dhe reagent dhe evadim mbetje anti COVID-19ò, ndarë me 2 Lote.
-Loti I ñBlerje kite dhe reagentë për Laboratorin Mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisjen e Existation të firmës Bioner ose ekuivalentò, është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1574/13, datë 30.03.2020, miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020.
-Loti II ñTrajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19, është lidhur kontrata me nr.1574/12, datë 30.03.2020 , miratuar me VKM nr.273, datë 03.04.2020.
5-Procedura ñFurnizim me produkte letre një përdorimëshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjenike për pacientët me Covid-19 dhe personelin mjekësor.”
Është lidhur Kontrata e furnizimit me nr.1575/18, datë 07.04.2020, miratuar me VKM nr.323 datë 18.04.2020.
6-Procedura ñSpostimi i sistemit të dializës nga Pediatria e Specialiteteve tek godina e Spitalit Infektiv (Shërbimi i Alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me Covid-19ò është lidhur kontrata nr.1575/19, datë 07.04.2020 , miratuar me VKM nr.323 datë 18.04.2020.
7-Procedura ñBlerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPòe ndarë në 4 Lote
-Loti I ñBlerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò është lidhur kontrata me nr.1776/11 datë 14.04.2020 , miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020.
-Loti i II ñBlerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò, është lidhur kontrata me nr.1776/13, datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.316, datë 18.04.2020.
Loti i III ñBlerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHPò, është lidhur kontrata me nr.1776/12, datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.317, datë 18.04.2020.
Pra, sipas VKM-së 203 për (Procedurën e drejtëpërdrejtë), nëse nuk miratohen për 90 ditë, kontratat duke të anullohen, duke lënë hapësirë që Këshilli i Ministrave, mund tõi miratojë kur të mundet brenda 90 ditëve, afat i cili nuk është proporcional me kushtet e emerjencës, si pasojë e Covid-19.
(**II)** VKM nr 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar, pika IV-2 ñProcedura e drejtëpërdrejtëò dhe pika V, **nuk** ka të përcaktuar; mënyrën e përllogaritjes së fondit limit dhe ku duhet mbështetur ky fond si, çmimet e botuara nga INSTAT, çmimet e tregut, çmimet ndërkombëtare, çmimet e kontratave të ngjashme, etj; natyrën e vendosjes së kritereve dhe mënyrën e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të ftuar nga AK. Si pasojë e mungesës së sa më sipër, MSHMS, disa herë ka kërkuar edhe asistencë nëpërmjet kërkesave on-line në Agjencisë e Prokurimit Publik, e cila me arsyetimin shprehet se, në bazë të nenit 6 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimit

publikò i ndryshuar, *"Ky ligj nuk zbatohet në përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike, në rast se zbatimi i tyre kërkon masa të veçanta sigurie, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi ose në rast se një gjë e tillë diktohet nga interesat thelbësore të shtetit,* për rrjedhojë nuk është shprehur në asnjë rast të kërkuar, për asistencë për VKM nr 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar.
Si pasojë e mospërcaktimeve të mësipërme, kanë dështuar disa procedura, si vijon:
a-Nga auditimi i procedurës *"Blerje Barna Anti Covid -19" ndarë në 10 Lote* , me fond limit total 36,812,915 lekë, konkretisht *Loti 1* me objekt ñ*Blerje barna Hidroksichlorokinë 200 mg tableta"* me fond limt në vlerën prej 457,385.00 lekë dhe *Loti 4* me objekt ñ*Blerje barna Lopinavir/ritonavir*ò me fond limit në vlerën prej 179,458.00 lekë, kanë dështuar me argumentimin për shkak të mos pjesëmarrjes së OE.
Nga auditimi u konstatua se, me shkresë nr.1573/3 prot datë 29.03.2020 të MSHMS, Komisioni i Vlerësimit, i është drejtuar operatorëve ekonomikë, ñR..P..ò shpk, ñI..ò shpk, ñE..ò shpk, ñL.. P..òshpk dhe ñD.. P..ò shpk, për testim tregu për 11 barnat, por nga auditimi u konstatua se, jo për të gjithë barnat ka pasur oferta çmimesh të argumentuar qartësisht, ndonëse KV shprehet se ñ*Komisioni për nxjerrjen e fondit limit u mbështet në mesatarizimin e çmimeve dhe ka përcaktuar si fond limit pa tvsh vlerën prej 36,812,915 lekë*...ò më konkretisht:
-Në këtë procedurë ishte planifikuar të realizohej dhe blerja për barin Remdesivir, por OE të përzgjedhur nga MSHMS, nuk kanë kthyer përgjigje, për pasojë Remdesivir nuk është futur në procedurë, ndonëse sipas OBSH, Remdesivir është pjesë e trajtimit të Covid-19 si dhe nga auditimi u konstatua se, bari Remdesivir (sasia 980 Flakon/Ampula) në momentin e hartimit të dokumentave të procedurës nuk ishte i regjistruar dhe asnjë OE nuk ishte i pajisur me leje importi nga MSHMS.
-Gjithashtu sipas procesverbalit nr.1573/4, datë 29.03.2020 për barnat: Hidroksichlorokinë, Chlorochine phosphate, Ribavirin, Lopinavir/ritonavir, nga auditimi, u konstatua se ishin pa status rregjistrimi nga MSHMS; si dhe operatorët ekonomikë të përzgjedhur nga KV, në momentin e përllogaritjes së fondit limit nuk kishin leje importi për këto barna, për rrjedhojë nga ana e KV nuk del e qartë se cilave çmimeve u janë referuar për përllogaritjen e fondit limit.
Kështu, nga KV është cituar për barin, Hidroksichlorokinë është e pajisur me leje importi për 2020 sipas PV nr.1573/5 datë 29.03.2020, por nga auditimi i Autorizimeve Importi për barnat të paregjistruara, për vitin 2020 lëshuar nga MSHMS, u konstatua se për barin Hidroksichlorokinë, Autorizimi nr.55 është marrë më datë 03.07.2020, pra katër muaj më pas. Ndërsa për barin Lopinavir/ritonavir, KLSH, iu referua Autorizimeve Importi për barnat të paregjistruara, për vitin 2019 lëshuar nga MSHMS për QSUNT me nr.80 datë 26.08.2019, forma/doza paketimi 200mg/50 mg Box x120 dhe Box x 30, ndërsa për procedurën është kërkuar Shurup 60 ml/8-mg +20 mg, të cilat nuk përkojnë me të njëjtin çmim. Pra, për këto dy raste nuk del e qartë përllogaritja e fondit limit nga KV.
b- Nga auditimi i procedurës për Loti II me objekt ñ*Trajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me Covid-19*ò, me fond limit në vlerën prej 3,144,150 lekë pa tvsh, KV për përllogaritjen e fondit limit është bazuar në vlerësimin e bërë nga QSUT sipas shkresës nr.1387/4 prot datë 17.03.2020, me periudhë shërbimi për 3 muaj. Nga auditimi u konstatua se, në përllogaritjen e fondit limit për mbetjet ku përfshihen: veshje një përdorimshe, mbetje konsumi ushqimi, age, ampula, shishe serumi qelq/plastike, sistem perfuzioni, etj, është përllogaritur në vlerë prej **510 lekë pa tvsh**, vlerë e cila **nuk** është e kostuar duke u ndarë në elementë si: shpenzime transporti, trajtimi/Incenerimi, ambalazhim & materiale, punëtoria, landfilli, kosto operative, etj.
KLSH, kryqëzoi të dhënat me punën e grupit të auditimit të KLSH-së paralel pranë QSUNT, nga ku u evidentua se, për vazhdimin e kësaj kontrate, nga AK i QSUNT është tenderuar në bazë të ligjit të prokurimit publik për vazhdimësi të këtij shërbimi dhe i njëjti OE, ñE.. R...shpk, me vlerë të kostuar për njësi prej **336 lekë pa tvsh** (ose 174 leke/njësi më pak nga sa përllogaritur nga KV në MSHMS).

Sa më sipër, në të dyja rastet kemi të njëjtin shërbim, por me me vlera për njësi të ndryshme, pasi sipas VKM nr.203, datë 26.02.2020 ñProcedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetitò i ndryshuar, **nuk** përcaktohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit duke lënë shteg për interpretime të ndryshme nga AK, e duke e justifikuar si situatë e panjohur më parë.
Nisur nga sa më sipër, konstatuam se, KV ka gjetur ñmënyra alternative përllogaritjejeò, të cilat në fakt janë të njëjta duke iu referuar procedurave normale të prokurimit publik, por nga KV, kjo ñpërllogaritjeò **nuk** është e shoqëruar me dokumentacion referuar çmimeve.
(III) Sipas VKM nr. 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar, **nuk** është parashikuar elementi i monitorimit të ekzekutimit të kontratave të përftuara, kështu, nga auditimi u konstatua se, vetëm në procedurën ñFurnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19ò, është ngritur grupi monitorimit ndërsa në procedurat e tjera nuk është ngritur asnjë grup i tillë.
MSHMS, është mjaftuar vetëm me ngritjen e komisioneve të marrjes në dorëzim të mallit, barnave,shërbimeve etj. Si pasojë, ka munguar gjurma e auditimit për këto procese dhe nuk rezultojnë të jenë përgatitur informacione përmbledhës për përputhshmërinë, korrektësinë financiare dhe cilësinë e zbatimit të kontratës në mënyrë të vazhdueshme, për të parë efektivitetin, eficiencën dhe ekonomicitetin, e përdorimit të fondeve të siguruara nga Buxheti i Shtetit.
(IV) a. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 118 pika 2 të parashikon se: ñ*Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte"*.
b. Neni 6 i Ligjit të Prokurimit Publik (*ku është mbështetur KM për nxjerrjen e kësaj VKM*) nuk autorizon nxjerrjen e një Akti Normativ të Veçantë për kontratat sekrete, kontratat që kërkojnë masa të veçanta sigurie dhe kontratat që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit.
c. VKM nr. 203 nuk ka përcaktuar përkufizimin e gjendjes, rrethanave, apo rasteve kur kemi të bëjmë me ñ*interesa thelbësorë të shtetit*ò por këto rrethana i ka lënë rast pas rasti në vlerësim të autoriteteve kontraktore; Pra, në kushtet kur termi ñ*interesa thelbësorë të shtetit*ò nuk ka gjetur një rregullim ligjor, ngelet një situatë abstrakte e pa përkufizuar dhe në vlerësimin subjektiv të çdo autoriteti duke rritur riskun për arbitraritet.
(V) Nga auditimi dhe studimi i VKM nr. 203, datë 26.02.2020 i ndryshuar, konkretisht sipas VKM nr.242 datë 22.03.2020 ñPër disa shtesa në VKM nr.203 datë 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësore të shtetitò, pika 2 shprehet se ñ*Për procedurën e drejtëpërdrejtë, të përcaktuar në nënndarjen IV.1, të kreut IV, të këtij vendimi,* ***nuk zbatohet dispozita e parashikuar për procedurën e ankimit***.ò. Mos parashikimi i këtij kriteri, mbart risqe pasi OE nuk mund ta ushtrojnë të drejtën e ankimimit, nëse i lind nevoja.
Për më sipër, KLSH del me konkluzion se, autoriteti kontraktor (MSHMS) apo dhe autoritetet e tjera kontraktore i kanë pasur të gjitha mundësitë që në zbatim ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò i ndryshuar, nenit 33 dhe VKM nr. 914, dt. 29.12.2014 ñP*ër miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar,* neni 36, të realizonin procedura prokurimi me negocim të cilat do të shmangnin parregullsitë e mësipërme. Nisur nga këto parregullsi, nevojitet përmirësimi i përmbajtjes së VKM nr. 203, datë 26.02.2020 ñ*Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit*ò duke e përshtatur atë dhe harmonizuar me disa kërkesa të LPP dhe VKM për rregullat e prokurimeve publike.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 164-185 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masat për të propozuar ndryshimet e nevojshme në VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 ñPër procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetitò.
1.2Rekomandim: Në mënyrë që kjo VKM tôi shërbejë situatave emrgjente për kontrata që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit, në të duhet që afatet e parashikuara për miratimin e

kontratave nga KM, të jenë në proporcion me emergjencën e situatës dhe jo ndryshe.
1.3. Rekomandim: Në VKM duhet të përcaktohet qartë mënyra e përllogaritjes së fondit limit dhe ku duhet të mbështetet autoriteti kontraktor për llogaritjen e tij, si psh: *çmimet e botuara nga INSTAT, çmimet e tregut, çmimet e kontratave të ngjashme, çmimet ndërkombëtare ,….etj..*
1.4. Rekomandim: Në VKM të parashikohen rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave si një element i rëndësishëm i kontrollit të mirëmenaxhimit të fondeve publike, për qëllimet e parashikuara në këtë VKM.
1.5. Rekomandim: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si ministria përgjegjëse të marrë masa që në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, nisur nga teknika legjislative, të rishikojë bazën ligjore të përdorur për nxjerrjen e këtij vendimi, me qëllim përcaktimin e dispozitave që, në kuptimin e nenit 118 të Kushtetutës, autorizojnë nxjerrjen e këtij akti nënligjor nga Këshilli i Ministrave, çështjet që duhen rregulluar si dhe parimet në bazë të të cilave nxirret ky akt.
Në VKM të përcaktohet përkufizimi i gjendjes, rrethanave, apo rasteve kur kemi të bëjmë me ñ*interesa thelbësorë të shtetit*ò duke mos i lënë këto rrethana në vlerësim të autoriteteve kontraktore. Përkufizimi ñ*interesa thelbësorë të shtetit*ò duhet të përjashtojë situatat për furnizime në situata emergjencash dhe fatkeqësish, të cilat gjykojmë se Ligji nr. 9643/2016 ñ*Për prokurimin publik*ò i ka të rregulluar me nenin 33 ñ*Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit*ò mjaftueshëm për të garantuar kontraktime dhe prokurime të shpejta, eficente, inteligjente dhe proporcionale me interesat thelbësore të shtetit dhe përputhen me Aktin Normativ të Qeverisë Për Shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore dhe Pandemia Botërore shpallur nga OBSH.
1.6. Rekomandim: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si ministria përgjegjëse të marrë masa që të propozojë vendosjen e një pike të veçantë 13/1, në të cilën të parashikohet përfshirja e të drejtës së ankimimit në procedurën e drejtëpërdrejtë; gjithashtu në përputhje edhe me parashikimet të Kodit të Procedurës Administrative neni 129, për të shmangur çdo paqartësi gjatë zbatimit të vendimit, të parashikohet e drejta e ankimit të drejtëpërdrejtë në gjykatën kompetente.

Në vijimësi

B. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se MSHMS përgjatë vitit 2020, ka menaxhuar 7 programe buxhetore si me poshtë:
1. 01110 ñ*Planifikim Menaxhim Administrim*ò në shumën 2,633,673,800 lekë, i cili ka zënë rreth 4% të totalit të buxhetit vjetor të shëndetësisë.
2. 07220 ñ*Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor*ò në shumën 7,752,468,000 lekë, i cili ka zënë rreth 11% të totalit të buxhetit vjetor të shëndetësisë.
3. 07330 ñ*Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor*ò në shumën 26,371,245,000 lekë, i cili ka zënë rreth 38% të totalit të buxhetit vjetor të shëndetësisë.
4. 07450 ñ*Shërbime të Shëndetit Publik*ò në shumën 3,002,351,000 lekë, i cili ka zënë rreth 4% të totalit të buxhetit vjetor të shëndetësisë.
5. 07460 ñ*Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore*ò në shumën 347,182,000 lekë, i cili ka zënë rreth 1% të totalit të buxhetit vjetor të shëndetësisë.
6. 10430 ñ*Përkujdesi Social*ò në shumën 28,021,635,000 lekë, i cili ka zënë rreth 41% të totalit të buxhetit vjetor të shëndetësisë.
7. 01190 ñ*Rehabilitimi i të përndjekurve politike*ò në shumën 1,037,300,000 lekë, i cili ka zënë rreth 1% të totalit të buxhetit vjetor të shëndetësisë.
Nga auditimi rezultoi se, fondet buxhetore në total për MSHSM janë çelur me ligjin e buxhetit në shumën 62,969,940 mijë lekë dhe me rishikimet e ndodhura gjatë vitit, këto fonde rezultuan në shumën 69,165,854 mijë lekë në fund të vitit 2020, ose 6,195,914 mijë lekë më shume (ose rritur

buxheti me 10%) nga sa është çelur fillimisht. Vihet re se, peshën më të madhe në fondet buxhetore të shëndetsisë e zë programi 010430 ñPër përkujdesin Socialò në masën 41%, i cili menaxhohet nga institucioni i varësisë ñShërbimi Social Shtetërorò. Ky program gjithashtu ka shënuar rritjen më të madhe me 4,034,675 mijë lekë nga buxheti fillestar në buxhetin e rishikuar në fund të vitit (ose 64% të total rritjes buxhetore prej 6,195,914 mijë lekë).
Programi tjetër me impakt në rritjen totale buxhetore (rreth 35% ndaj total e buxhetit të shtuar), rezultoi programi 01110 ñ*Për planfikimin, menaxhimin dhe administriminò*, i cili u çel fillimisht në vlerën 423,068 mijë dhe nga ndryshimet e ndodhura gjatë vitit rezultoi në fund të vitit 2020 në vlerën 2,633,674, mijë lekë (ose shtuar me 525% nga sa çelur fillimisht). Shtesa në këtë program ka ardhur si rezultat i ndryshimeve të mëposhtme[34]:
-5 VKM kanë shtuar fondet e këtij programi në vlerën **2,276,105 mijë lekë** për të përballuar situatën e shkaktuar nga Covid-19, përkatësisht*VKM-së nr. 205,* datë 09.03.2020 shtuar fondi prej *400,000,000 lekë*; *VKM nr. 240, datë 21.03.2020* shtuar fondi prej *46,105,800 lekë; VKM 249, datë 27.03.2020* ñPër detajimin dhe mënyrën e përdorimit të Fondit AntiCovid-19 *shtuar fondi 1,800,000,000 lekë; VKM nr.259, datë 27.03.2020*, shtuar fondi prej 11,000,000 lekësh;*VKM nr. 354, dt. 29.04.2020* shtuar fondi prej *19,000,000 lekë*;
-1 VKM ka pakësuar fondet e këtij programi me **41,800,000 lekë**, përkatësisht *VKM nr. 926 datë 25.11.2020"Për rishpërndarjen e fondeve në buxhetin e vitit 2020 ndërmjet ministrive dhe institucioneve buxhetore*ò ; dhe
-Akti normativ *nr. 34, datë 16.12.2020 "Për disa ndryshime në ligjin 882019, për buxhetin e vitit 2020*ò ka pakësuar fondin me **24,600,000 lekë**.
Për përballimin e situatës së krijuar nga Covid-19, Aparati MSHMS ka përfituar edhe **171,334,670 lekë donacione.**
Pra, në total për përballimin e situatës së shkaktuar nga pandemia Covid-19, Aparati MSHMS ka përfituar **2,447,440,470 lekë,** prej të cilave 476,105,800 lekë nga Fondi Rezervë i shtetit, 1,800,000,000 lekë nga Fondi Anti-Covid dhe 171,334,670 lekë donacione.
Në përfundim rezultoi se, gjatë vitit 2020 ka pasur lëvizje të **shumta** të buxhetit të MSHMS, ku programi 01110 i cili administrohet kryesisht nga MSHMS, ka pësuar ndryshime me 6 VKM dhe 1 akt normativ; ndërsa në total buxheti i MSHMS është ndryshuar me **3** akte normative dhe **12** VKM.
Në vijim të akordimit të fondeve me VKM-të e mësipërme, buxheti i **Aparatit të MSHMS** ka patur një numër të konsiderueshëm rialokimesh. Gjatë periudhës maj-dhjetor 2020 projektet e çelura për investime në kuadër të përballimit të situatës së shkaktuar nga pandemi Covid 19, kanë ndryshuar 3 herë si më poshtë:
-Deri në maj 2020 ishin çelur **15** projekte me qëllim përballimin e gjendjes së krijuar nga Covid-19. Në korrik 2020, **2** prej 15 projekteve u pakësuan pjesërisht, ndërsa **1** (*F.V pajisje mjekesore per covid 19*) prej 15 projekteve, u rialokua plotësisht, duke i shpërndarë këto fonde në 4 projekte të tjera, 3 prej të cilave çeleshin për herë të parë, ndërsa1 (F.V pajisje elektronike) prej tyre ishte projekt i planifikuar për tu realizuar me buxhetin e shtetit përpara se të ndodhte covdi-19 (trajtuar më në detaje në gjetjen në vijim).
-Në shtator 2020, u pakësuan edhe **2** prej 15 projekteve të çelura që maj të 2020 **(**1 prej të cilëve u rialokuar plotësisht**).** Këto fonde u përdorën për të shlyer 3 detyrime të prapambetura nga viti 2019 (trajtuar më në detaje në gjetjen në vijim).
Në tetor 2020 u pakësuar pjesërisht **1** prej 15 projekteve të celura në maj 2020 dhe **1** projekt i ri i çelur në shtator 2020 (trajtuar më lart), duke shtuar 1 projekt të ri.
1.1. Rekomandim: Në të gjitha rastet në vijim, MSHMS të marrë masat për për kryerjen e një planifikimi sa më efektiv të fondeve në përputhje me objektivat institucionale, duke shmangur rialokimet e shpeshta të buxhetit dhe veçanërisht të projekteve të ndërmarra për të përballuar

[34] *Shtuar fondi i veçantë (për punonjësit që dalin në pension) në fillim të vitit 900,000 lekë.*

situatën e shkaktuar nga Covid-19.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 53-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, fondet prej **16,751,138 lekë** akorduar për përballimin e situatës së krijuar nga Covid -19, kanë ndryshuar destinacionin dhe janë angazhuar për të shlyer detyrime që kanë rrjedhur nga kontrata ose projekte të nisura më parë, nga të cilat: ***15,791,138 lekë*** alokuar për të shlyer detyrime që kanë rrjedhur nga kontrata të mëparshme; dhe ***960,000 lekë*** alokuar për blerje pajisje kompjuterike të planifikuar që në PBA 2020-2022 (përpara situatës së pandemisë), konkretisht*:*
Nga analiza e buxhetit të akorduar për përballimin e fatkeqësisë natyrore konstatohet se, me anë të shkresës nr. 3871, datë 20.08.2020 drejtuar MFE-së, S.P i MSHMS-së ka kërkuar transferimin e fondeve për investime në shëndetësi, sipas të cilës është kërkuar pakësimi i fondeve të parashikuara për projektet:
-ñRehabilitimi i shërbimit të Urologjisë dhe Klinikës së Tretë Kirurgjikale për kthimin e tyre në Konvaleshencës dhe Terapi Intensive në QSUTò në vlerë totale të tij 13,717,119 lekë; dhe
-ñTVSH për projektin për furnizimin me pajisje mjekësore te specializuara per mbrojtje/trajtim te covid-19, ne kuadër te marrëveshjes grant te BE ku përfituesi është MSHMSò në vlerën 2,074,019 lekë.
Këto fonde u përdorën për projektet:
-ñRikonstruksione në disa ambiente të godinës MSHMSò (detyrim i vitit 2019) në vlerën **9,194,988 lekë,**
-ñSupervizim dhe kolaudim për rikonstruksionet e disa godinave të MSHMSò (detyrim i vitit 2019) në vlerën **96,150 lekë,**
-ñHartim i projekt preventivit të zbatimit për ndërtimin e Qendrës së re të Biosimulimit Klinik dhe edukimit në vazhdim për Universitetin e Mjekësisë Tiranë në kuadër të paktit të Universitetitò (detyrim i vitit 2019) **6,500,000 lekë.**
Me anë të shkresës nr. 2818, datë 15.06.2020, S.P i MSHMS i ka drejtuar MFE-së kërkesën për rialokimin e fondeve covid, duke pakësuar projektet:
-*19AD302 F.V monitorë për spitalet* në vlerën 36,727,000 lekë;
-*19AD306 Blerje autoambulancash për spitalet* në vlerën 60,000,000 lekë dhe
-*19AD315 F.V pajisje mjekësore për covid 19* ne vlerën e plotë të këtij projekti 259,741,888 lekë dhe
Këto fonde u alokuar në projektet:
-19AD317 F.*V pajisje mjekësore CT Skaner* 172,935,000 lekë;
-19AD318 *F.V pajisje mjekësore Rezonance magnetike MRI* 167,573,888 lekë;
-19AD316 *Pagese TVSH për pajisjet e furnizuara donacion nga PNUDI ne kuadër te Covid-19* 15,000,000 lekë, dhe
-18BA301 *F.V pajisje elektronike ne kuadër te COVID-19*, **960,000 lekë.**
Nëse do të referoheshim PBA 2020-2022, projekti 18BA301 ka qenë planifikuar më herët për tu realizuar në vitin 2020, pra përpara se të ndodhte pandemia Covid-19.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 53-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Titullari i MSHMS të marrë masa për të ngritur një grupi të veçantë pune për të analizuar shkaqet dhe nxjerrë përgjegjësitë për ndryshimin e destinacionit të 16,751,138 lekë fonde Covid dhe në vijim, cka ka shkaktuar mospërdorimin e tyre për qëllimin për të cilin janë akorduar, përballimin e situatës së shkaktuar nga Covid-19.
2.2. Rekomandim: MSHMS, të marrë masat e nevojshme që në asnjë rast në vijim, mos të ndryshojë destinacioni i fondeve, për të siguruar kështu që fondet e saj të përdoren në funksion të qëllimit për të cilin janë akorduar, në përmbushje të nevojave të institucionit.

Në vijimësi

3.1.Gjetje nga auditimi: Në vitin 2019 nga MSHMS janë njohur detyrime të prapambetura në vlerën **49,700,000 lekë** me burim krijimi ñvendime gjyqësore për largime te padrejta nga punaò. Nga verifikimi i grupit të auditimit rezulton se, faktikisht vlera e detyrimeve te prapambetura në fund të vitin 2019 ishte të paktën 69,063,781 lekë[35], ose *19,363,781 lekë* (39%) më shumë se detyrimi i raportuar në MFE për këtë vit. Gjithashtu rezultoi se, detyrimi i prapambetur në vlerën 69,063,781 lekë ishte jo vetëm për vendime gjyqësore për largime të padrejta nga puna, **por** edhe për vendime të tjera gjyqësore, më hollësisht:
- 34,712,371 lekë, detyrime për largime të padrejta nga puna;
- 24,471,250 lekë detyrim i lindur nga 1 çështje gjyqësorë e Spitalit Gjirokastër; dhe
- 9,880,160 lekë detyrim i lindur nga vendime gjyqësore për mospagim në kohë të faturave ndaj kreditorëve nga ish-MMRS.

Për vitin 2020, në raportimin për Thesarin, si dhe në Pasqyrat Financiare të MSHMS, janë njohur detyrime të prapambetura vetëm për largime të padrejta nga puna në vlerën 27,150,000 lekë. Nga auditimi rezultoi se, në fakt detyrimi i prapambetur për këtë vit ishte të paktën 33,878,384 lekë[36], ose *6,728,384 lekë* (20%) më shumë detyrime se ato të njohura në Pasqyrat Financiare të MSHMS dhe të raportuara në MFE.

Nga auditimi u konstatua se, databaza e mbajtur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Mirëmenaxhimit Financiar në zbatim të pikës 4 të Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014, vënë në dispozicion grupi të auditimit**, nuk** përmban shumën e plotë të detyrimeve për largimet nga puna, pasi në të nuk janë reflektuar detyrimet e parashikuara nga vendimet e formës së prerë të viteve 2011 dhe 2013 për **dy** gjyfitues, Znj. S. L., dhe Z. N. Z.. Në këto kushte, grupi i auditimit nuk ka mundur të përllogarisë detyrimin e prapambetur për këta 2 tatimpagues.

Për vitin 2020, pagesat e kryera për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të cilat rrjedhin nga vendimet gjyqësore, nuk janë kryer **vetëm** për vendime gjyqësore për largime nga puna sikurse është raportuar në MFE, por edhe për vendim të tjera gjyqësore. MSHMS ka raportuar në MFE detyrime të prapambetura të shlyera në vlerë **9,224,000 lekë,** më burim krijimi vendime gjyqësore për largime të padrejta nga puna. Nga auditimi rezultoi se, detyrimet realisht të shlyera janë në vlerën **42,486,262 lekë**, ose 33,262,262 lekë (360%) më shumë se ato të raportuara si të shlyera në MFE dhe **jo** vetëm për vendime gjyqësore për largime të padrejta nga puna, **por** edhe për vendime të tjera gjyqësore, si p.sh. vendim gjyqësor i Spitalit Gjirokastër, apo vendime gjyqësore për fatura të papaguara nga ish-MMRS

3.1.Gjetje nga auditimi: Për vitin 2019**, 2** nga **4 r**aportimet (50% të rasteve) e detyrimeve të prapambetura gjatë këtij viti **nuk**janë bërë sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimi plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 ñPër për zbatimin e buxhetit viti 2019. Në kundërshtim me këtë udhëzim, detyrimet e prapambetura **nuk** janë raportuar në MFE, në mënyrë analitike sipas kreditorëve dhe sipas burimit të krijimit të tyre.

Nga analizimi i raportimeve tre-mujore për vitin 2020 konstatohet se, detyrimet e prapambetura për largimet e padrejta nga puna për aparatin e MSHMS,**nuk** janë raportuar në formatin e duhur (Udhëzimi nr. 2, datë 20.01.2020 dhe Udhëzimi nr. 37, datë 06.10.2020) në MFE, apo në Thesar,

---

[35] *Themi se "detyrimi ishte të**paktën** 69,063,781 lekë" pasi në këtë vlerë nuk janë përfshirë detyrimet e rrjedha nga vendimet e formës së prere të viteve 2011, 2013 për dy gjyqfitues të larguar padrejtësisht nga puna Znj. S.L.j, dhe Z. N. Z.të cilat nuk ishin reflektuar në data bazën e detyrimeve të DBMF, dhe grupi i auditimit nuk mundi të përllogariste detyrimet e tyre.*

[36] *Themi se "detyrimi ishte të **paktën**33,878,384 lekë" pasi në këtë vlerë nuk janë përfshirë detyrimet e rrjedha nga vendimet e formës së prere të viteve 2011, 2013 për dy gjyqfitues të larguar padrejtësisht nga puna Znj. Silvana Lamaj, dhe Z. Nesti Zefi., të cilat nuk ishin reflektuar në data bazën e detyrimeve të DBMF, dhe grupi i auditimit nuk mundi të përllogariste detyrimet e tyre.*

në **asnjë** prej raportimeve të këtij viti. Në kundërshtim me këto udhëzim, detyrimet e prapambetura **nuk** janë raportuar në mënyrë analitike sipas kreditorëve dhe sipas burimit të krijimit të tyre.
Kjo situatë **nuk** siguron transparencë mbi detyrimet e prapambetura, burimin e krijimit, si dhe shlyerjen e tyre .
Sa më sipër, nuk ka rezultuar në vlerësimin e detyrime të papaguara dhe raportimin e tyre në mënyrë të saktë dhe të plotë, sikurse përcaktohet në VKM nr.50, datë 05.02.2014 ñPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimitò, të ndryshuar.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 53-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandim: MSHMS të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar raportimin në MFE, Thesar dhe në vijim në pasqyrat financare të MSHMS, të detyrimeve të prapambetura dhe shlyerjen e tyre, në mënyrë të plotë, të saktë, të vërtetë dhe sipas formateve të diktuara nga Udhëzimet e MFE-së, me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, të cilat mund të shkaktojnë efekte negative në buxhetin e shtetit.
3.2.Rekomandim: DBMF në MSHMS të ndërmarrë masat e nevojshme për paraqitjen e plotë dhe të saktë të gjyqfituesve të larguar në mënyrë të padrejta nga puna, si dhe detyrimet ndaj tyre në bazën e të dhënave që kjo drejtori administron për këtë qëllim.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua thyerje e radhës së pagesave në 30% të rasteve në vitin 2019 dhe 26% të rasteve në vitin 2020, si dhe mungesë transparence mbi planifikimin e shlyerjeve të detyrimeve të prapambetura. Më hollësisht:
Për vitin 2019, është thyer rregulli i pagesave në të paktën 6 nga 20 raste (30%) , pasi nuk janë shlyer të parat ato detyrime që kanë lindur të parat.
Për vitin 2020, është thyer rregulli i pagesave në të paktën 5 nga 19 (26%) të raste sipas të cilit, duhet të shlyhen të parat ato detyrime të cilat lindin të parat.
Për të dy vitet, konstatohen dy gjyqfituesit me vendime të formës së prerë të viteve 2011 dhe 2013 (Znj. L. dhe Z .Z. të cilët nuk kanë marrë pagesa gjatë viteve 2019-2020, ndërsa gjatë kësaj periudhe janë shlyer detyrime të rrjedha nga vendime të formës së prerë të viteve 2018-2019.
Kontatohet gjithashtu se, në kundërshtim me pikën 5 të Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesaritò, MSHMS nuk ka publikuar në faqen web të institucionit grafikun e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.
Mospublikimi i grafikut të pagesave, nuk ofron transparencë mbi radhën e pagesave të planifikuara për tâı shlyer
(Trajtuar më hollësisht në faqet 53-84 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Nëpunësi Autorizes dhe Nëpunësi Zbatues në MSHMS, të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të planifikuar dhe shlyer detyrimet e prapambetura duke respektuar parimin FIFO (detyrimet që lindin të parat shlyhen të parat), si dhe të publikojë në faqen web të institucionit grafikun e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, me qëllim shmangien e penaliteteve që përbëjnë dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar shkelje e disiplinës buxhetore për kryerjen e shpenzimeve mbi 30 ditë vonesë (në 16.2% të rasteve në vitin 2019 dhe 23% të rasteve në vitin 2020) dhe në regjistrimin e kontratave në SIFQ mbi 5 ditë vonesë (97% e rasteve në vitin 2020). Më hollësisht:

Nga analiza e databazës së SIFQ, për Aparatin e MSHMS-së, **për vitin 2019**, konstatohet se nga 1365 pagesa të kryera gjatë këtij viti 2019 deri në 31.12 2020, 221 prej tyre në vlerë119,842,858 lekë, pra 16.2% e rasteve, janë regjistruar për tu kryer me Urdhër-shpenzim nga MSHMS me mbi 30 ditë nga data e lëshimit të faturës nga furnitori*, në kundërshtim* me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar.
Nga analizimi i data bazës së SIFQ, për Aparatin e MSHMS-së, **për vitin 2020**, konstatohet se nga 1510 pagesa të kryera deri në 31.12 2020**,** 347 prej tyre në vlerë 874,836,015 lekë, pra 23% e rasteve, janë regjistruar për tu kryer me Urdhër-shpenzim nga MSHMS me mbi 30 ditë nga data e lëshimit të faturës nga furnitori*, në kundërshtim* me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar.
Kryerja e pagesave në tejkalim të afateve përmban riskun që kreditorët mund të kërkojnë kamatëvonesa dhe shpenzimet e kryera për rimarrjen e kredisë, duke shkaktuar dëm ekonomik për institucionin.
Gjithashtu u konstatua se është shkelur disiplina buxhetore në **62** nga **64** raste (97%) në kundërshtim me pikën 17, të Udhëzimit nr. 9.1, datë 20.03.2018, pasi kontratat e lidhura nga MSHMS në vitin 2020, janë regjistruar në SIFQ me mbi **5** ditë vonesë. Moszbatimi i afatit për regjistrimin e kontratave në SIFQ përmban riskun e penalieteve, të cilat do të shkaktonin dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 53-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandim: Për të gjitha rastet në vijim, Nëpunësi Zbatues në MSHMS të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar përgatitjen e urdhër-shpenzimeve dhe depozitimin e tyre pranë thesarit, brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të faturës së furnitorit, me qëllim shmangien e penaliteteve të mundshme si pasojë e vonesave, me efekte negative në buxhetin e shtetit.;
- Nëpunësi Zbatues në MSHMS të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar regjistrimin e kontratave brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i tyre, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore në funksion të menaxhimit të detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i Urdhër-shpenzimeve u konstatua se, në zbatim të VKM 753, datë 30.11.2019 ñ*Për përkrahjen sociale dhe financiare të familjeve të viktimave të tërmetit të datës 26.11.2019" MSHMS ka* paguar ndihmë financiare prej 1,000,000 lekësh/për familje, për familjet e 48 viktimave të tërmetit të nëntorit 2019, në total 30,000,000 për 30 familje. Referuar VKM-së së mësipërme, mbështetja financiarë është dhënë në bazë të familjeve të viktimave, pra 1,000,000 lekë për secilën familje që ka pasur viktima, dhe jo për secilën viktimë të familjes. Nga auditimi rezultoi se, VKM nr. 753, datë 30.11.2019 e cila parashikon mbështetjen financiare të familjarëve të viktimave të tërmetit të nëntorit 2019, nuk ka bashkëlidhur listën e familjeve përfituese, dhe për këtë grupi i auditimit nuk mund të japë siguri të arsyeshme nëse familjet e mbështetura financiarisht janë në fakt të ato familje, të cilat kanë humbur të afërmit e tyre nga tërmeti.
Shpenzimet e funeralit janë paguar vetëm për 8 familje nga 30 familje në total 3,540,467 lekë (30 familjet janë identifikuar nga pagesat e ndihmës financiare 1,000,000 lekë), të cilat kanë humbur familjarët e tyre nga tërmeti nëntorit 2019.
Nga auditimi rezultoi se, në asnjë rast, kërkesat dhe dokumentet e përcjella nga familjarët e viktimave të tërmetit për përfitimin e ndihmës financiare nuk janë depozituar në protokollin e institucionit, por janë përcjellë dorazi pranë DBMF në MSHMS duke mos siguruar kështu gjurmë mbi kërkesat, dokumentet e dorëzuara dhe kohën e dorëzimit të tyr, në kundërshtim kjo dhe me Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 ñPër Arkivatò, ñNormave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë (neni 8 dhe 9) dhe Ligjin nr.90/2012 "Për Organizimin Dhe Funksionimin E Administratës Shtetërore".

6.1. Rekomandim: Për te gjitha rastet në vijim, me qëllim respektimin e rregullave të parashikuara për ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, dhe shmangien e riskut të tjetërsimit të pasurisë natyrore/ humbjen e tyre, etj., nga MSHMS të merren masat që çdo kërkesë e publikut të kalojë nëpërmjet protokollit të institucionit dhe të ketë të gjithë elementët e nevojshëm sipas normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor
(Trajtuar më hollësisht në faqet 91-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi janë konstatuar pasaktësi në regjistrimin e Urdhër-shpenzimeve në SIFQ. Pika 1 e udhëzimit të MFE, nr. 21920, datë 02.12.2019, përcakton ñFaturat e datuara brenda vitit 2019, do të paraqiten pranë degëve të Thesarit deri më datë 15.12.2019.ò
Nga kontrolli i urdhër-shpenzimeve u konstatua se, në disa raste datat e urdhër-shpenzimeve fizike dhe kontabilizimit të bankës 2019, **nuk** përkojnë me datat e këtyre urdhër-shpenzimeve në SIQF (kolona: data e urdhër-shpenzimit). Nëse do të referoheshim ditarit të bankës 2019, MSHM nuk ka kryer shpenzime gjatë periudhës 17-30 dhjetor të vitit 2019. Ndërsa, nëse do të referoheshim data bazës së marrë nga Thesari, ky institucion ka kryer **53** shpenzime (referuar datës së urdhër-shpenzimit në SIFQ) gjatë periudhës 17-30 dhjetor 2019 në vlerën 133,570,674 lekë. Grupi i auditimit kontrolloi këto urdhër-shpenzime, nga ku rezultoi se datat në to janë sipas ditarëve të MSHMS-së, dhe jo sipas SIFQ, duke ngritur dyshime mbi saktësinë e dokumentacionit që i është vënë në dispozicion grupit të auditimit.
Fakti se, sipas urdhër-shpenzimeve fizike MSHMS ka kryer veprime me bankën deri në 16 dhjetor 2019, ndërsa sipas sistemit SIFQ ky institucion ka 53 veprime pas kësaj date deri në 30 dhjetor 2019, **nuk** ofron siguri mbi periudhën kur këto shpenzime janë kryer realisht dhe nëse janë në përputhje me Udhëzimin nr. 21920, datë 02.12.2019 të MFE-së.
7.1. Rekomandim: Për te gjitha rastet në vijim, Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues në MSHMS të ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar koherencë midis urdhër-shpenzimeve fizike të regjistruara në kontabilitetin e bankës të institucionit dhe atyre të regjistruara në SIFQ, me qëllim ofrimin e sigurisë së arsyeshme, lidhur me shpenzimet e kryera.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 91-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i Regjistri i Aktiveve të MSHMS për vitin 2019, rezulton se në kundërshtim me pikën 26, 28 dhe 30 Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, ai nuk përmban një informacion të plotë mbi aktivet e institucionit, pasi në të nuk është reflektuar data e hyrjes apo marrjes në dorëzim, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes apo data e daljes nga pronësia, etj.
-Inventarizimi i aseteve të Aparatit të MSHMS është bërë mbi gjendjen fizike të aseteve, **pa** bërë krahasimin me gjendjen kontabël, duke **mos** identifikuar dhe analizuar diferenca midis gjendjes fizike dhe asaj kontabël. Nga auditimi u konstatuan diferenca në aktive në vlerën **227,612,894 lekë,** Më hollësisht:
-Nga auditimi u konstatua se, në Regjistrin e Aktiveve **nuk** janë reflektuar ende aktivet e ish-MMRS-së. Përveç tyre, u konstatua edhe aktive të MSHMS-së në vlerën **5,566,024 lekë**, të cilat kanë rezultuar nga inventarizimi dhe që nuk janë përfshirë në këtë Regjistër, në kundërshtim më pikën 28 të Udhëzimit të mësipërm.
-Nga auditimi u konstatuan gjithashtu diferenca midis kostos historike të mjeteve të transportit të regjistruar në Regjistrin e Aktiveve (16,829,991 lekë) dhe kostos historike të mjeteve të transportit sipas inventarizimit (45,009,380 lekë). Pra, rezultojnë **28,179,389 lekë** më shumëmjete transportit fizikisht (kosto historike), se kosto historike e regjistruar në kontabilitet.
-U konstatuan diferenca midis sistemeve elektronike të regjistruara në Regjistrin e Aktiveve në

269,302,755 lekë dhe vlerës për të cilën është shprehur grupi i inventarizimit (75,435,274 lekë). Pra, rezultojnë **193,867,481** lekë më shumë sistemet elektronike të regjistruara në kontabilitet, se vlera sipas kontrollit fizik.

Procesi i invetarizimit fizik:

-Inventarizimi i aseteve të Aparatit të MSHMS është bërë mbi gjendjen fizike të aseteve, **pa** bërë krahasimin me gjendjen kontabël, sikurse parashikon Udhëzimi 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar. Në këto kushte **nuk** janë identifikuar diferenca midis gjendjes fizike dhe asaj kontabël. (diferencat midis gjendjes fizike dhe asaj kontabël, të evidentuara nga grupi i auditimit janë trajtuar më lartë)

-Në dokumentin përmbledhës bashkëlidhur relacionit përfundimtar, përgatitur nga Komisioni në fund të procesit të inventarizimit për vitin 2019, **nuk** janë reflektuar aktivet me vlerë 43,983,687 lekë, si dhe makinat në përdorim dhe ato jashtë përdorimit, të cilat rezultojnë të inventarizuara referuar procesverbaleve, duke **mos** përmbushur kështu kërkesat e Udhëzimit nr. 30, për përgatitjen e një raporti të plotë mbi aktivet e inventarizuara fizikisht. Në relacionit përfundimtar të përgatitur nga Komisioni i Inventarizimit nuk janë përcaktuar saktësisht, sa procesverbale janë përgatitur, sa ishte numri totali i aktiveve të inventarizuara fizikisht, apo vlera totale e tyre, si dhe përmbledhësja nuk përkon me vlerën totale të aktiveve të inventarizuara sipas procesverbaleve.

-Aktivet e inventarizuara fizikisht janë dokumentuar vetëm nëpërmjet procesverbaleve të mbajtura me punonjësit me përgjegjësi materiale,. Këto procesverbale, nuk kanë datë, nuk janë të protokolluar, dhe shpesh herë janë të firmosur vetëm nga Komisioni i Inventarizimit dhe jo nga punonjësi/t me përgjegjësi materiale në kundërshtim me sa përcakton Udhëzimi nr. 30. Procesverbalet nuk kanë numra rendor.

-Dosja e inventarizimit nuk ishte e inventarizuar dhe disa procesverbale mungonin në të dhe u vunë në dispozicion pas kërkesës së grupit të auditimit.

Kjo situatë përmban riskun që aktivet e institucionit të humbasin, keqpërdoren, etj. P.sh. mungesa e raportit të plotë të inventarizimit, apo mungesa e numrave rendor të procesverbaleve të inventarizimit, etj. nuk siguron ruajtjen efektive të mjeteve të transportit (procesverbali i të cilave nuk ishte në dosje, por u vu në dispozicion pas kërkesë së grupit të auditimit), në kushtet kur në regjistrin e aktiveve ato nuk janë të detajuara dhe janë paraqitur me vlerën kontabël 0.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 91-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandim: Titullari i MSHMS të marrë masa për të ngritur një grup të veçantë punë për të identifikuar, analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për diferencat e konstatuara në aktive midis gjendjes fizike dhe asaj kontabël, me qëllim shmangien e risqeve të humbjes apo tjetërsimit të tyre dhe për të siguruar paraqitjen e drejtë të pasurisë së institucionit në Regjistrin e aktiveve dhe pasqyrat financiare të MSHMS.

Brenda datës 31.12.2021

8.2. Rekomandim: Në të gjitha rastet në vijim, Nëpunësi Zbatues i MSHMS-së të marri masat e nevojshme për të vënë në dispozicion grupeve të inventarizimit listën e aktiveve për tu inventarizuar bazuar në të dhënat kontabël, me qëllim që në përfundim të procesit të inventarizimit të identifikohen, analizohen dhe adresohen diferencave midis gjendjes kontabël dhe asaj fizike të aktiveve të institucionit.

Në vijimësi, në çdo proces inventarizimi

8.3. Rekomandim: MSHMS të ndërmarrë masat e nevojshme, që në përfundim të çdo procesi inventarizimi të aktiveve të institucionit të hartohet një raport i plotë, si dhe procesverbalet e mbajtura gjatë procesit të jenë me numra rendor, dhe të firmosur nga të gjithë personat me përgjegjësi materiale, për të siguruar që ky procesi i inventarizimit të shërbejë qëllimit për të cilin kryhet.

Në vijimësi, në çdo proces inventarizimi

8.1. Rekomandim: DBMF në MSHMS të ndërmarrë masat e nevojshme që në Regjistrin e Aktiveve të paraqiten në mënyrë të plotë dhe të saktë aktivet afatgjata, aktivet afatshkurtra

materiale dhe monetare, në pronësi dhe në përdorim të MSHMS, mbështetur në rezultatet e procesit të inventarizimit, me qëllim ruajtjen e tyre dhe paraqitjen e drejtë të pasurisë së këtij institucionit.

Me përfundimin e procesit të inventarizimit 2021 dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, të gjitha sistemet e IT-së, janë ende pjesë e regjistrit të kontabilitetit të MSHMS. Midis MSHMS dhe AKSHI nuk është nënshkruar një marrëveshje ku të përcaktohen përgjegjësitë e ndërsjellta lidhur me këto sisteme.
Referuar urdhrit nr.776 datë 09.11.2019 ñMbi ngritjen e komisionit për kalimin kapital të sistemeve te infrastrukturës TIK nga MSHMS tek AKSHI, miratuar nga sekretari i Përgjithshëm, është ngritur grupi i punës ku referuar Relacioni shpjegues drejtuar Titullarit të Intitucionit me numër protokolli nr.841, datë 11.02.2021, komisioni ka njoftuar se është mbajtur procesverbali për mundësinë e rialokimit të paisjeve nga MSHMS te AKSHI-t për kalimin e tre sistemeve:
1.Sistemi i Burimeve Njerëzore
2.Sistemi i regjistrimit të barnave
3.Sistemi i regjistrave elektronik të Shëndetësisë.
Në përfundim konstatuam se, ***palët nuk kanë arritur në marrëveshje*** duke sjellë për pasojë mos çregjistrimin e tyre nga regjistri i inventarit të kontabilitetit të MSHMS, duke ngelur në te njëjtën situate prej vitesh.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 125-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandim: MSHMS ne bashkëpunim me AKSHI-n, duhet të marrë masa të menjëhershme për të kryer kalimin e kapitalit për llogari të AKSHI-t, për të pasqyruar saktë dhe drejtë gjendjen e invetarit, për llog. (218)., në pasqyrat financiare të MSHMS.
Institucioni gjithashtu të marrë masa për transferimin e sistemeve në përputhje me detyrimet ligjore, me qëllim gjurmimin e këtij procesi si dhe mirëfunksionimin e proceseve të punës që lidhen dhe ndikohen nga këto sisteme, duke minimizuar risqet për abuzime.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Pasqyrat Financiare për vitin 2019 dhe vitin 2020 përfshijnë vetëm
ñTë drejtatò dhe ñDetyrimetò e ish-Ministrisë së Shëndetësisë duke mos përfshirë në të, treguesit financiarë të ish-Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, duke ***sjellë si pasojë jo vetëm mosnjohje dhe moskontabilizim të saktë dhe të plotë të të drejtave dhe detyrimeve të subjketit, si dhe siguri të kufizuar në konfirmimin e pohimit të ekzistencës së tyre,*** duke bërë një pasqyrim të mangët dhe jo real të bilancit kontabël.
MSHMS në vitin 2020 ka lidhur kontratën me shoqërinë ñS... L.E.A.Lò, me objekt realizimin dhe akt rakordimet me thesarin, për pasqyrat financiare për ish MMSR, me nr. 491/5 prot.date 12.02.2020. Bilanci i MMSR-së, për periudhën 01.01 ï 30.11.2017, ka përfunduar nga studio, dhe është dorëzuar në MSHMS me procesverbalin datë 19.10.2020; Gjithashtu është përcjellë në Thesar me shkresën nr.1320, datë 09.03.2021.
Nga auditimi rezultoi se, edhe pse ndodhemi përpara faktit të pasjes së një bilanci për ish-MMSR, nga MSHMS nuk është marrë asnjë masë për të ndarë te drejtat dhe detyrimet e MMSR, mes tre institucioneve (Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) , të cilat pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 508, date 13.09.2017 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Socialeò përthithën programet e MMSR-së.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 125-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandim: Nga ana e MSHMS duhet të merren masa në mënyrë ***urgjente***, për bashkëpunimin me dy ministritë e tjera : Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së

Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për ndarjen e të drejtave dhe detyrimeve sipas bilancit të hartuar dhe miratuar nga thesari te ish-MMSR, me qëllim pasqyrimin ***real, të plotë, të qartë të aktivitetit ekonomiko-financiar të ish-Ministrisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale si një Institucion i vetëm buxhetor.***
Gjithashtu pas përfundimit të ndarjes së të ñTë drejtaveò dhe ñDetyrimeveò, MSHMS të marrë masa në inkorporimin e tyre si dhe kontabilizimin e plotë, të cilat në kushtet aktuale krijojnë jo vetëm risk për ruajtjen dhe mirëadministrimin e tyre por denatyrojnë gjithashtu treguesit financiarë të shtetit.

Brenda datës 28.02.2022

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi referuar inventarit te kryer nga MSHMS per vitin 2020, me urdhrin nr.30, nr.367 prot datë 20.01.2020 miratuar nga titullari i institucionit ñ*Ngritjen e komisionit për invetarizimin e pasurisë*ò, komisioni i grupit ka kryer ndër të tjera edhe inventarizimin e mjeteve te transportit te aparatit të MSHMS, ku kanë rezultuar, *12 makina në total,* ku *9 prej tyre janë në përdorim*, një është i llojit motor dhe *3 prej tyre janë vlerësuar si jashtë përdorimit të cilat ndodhen në ruajtje tek Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor*, por nuk ka përfunduar procesi i nxjerrjes së tyre jashtë përdorimit.
Pas kryqëzimit te vlerës kontabël, me vlerën e inventarit te kryes nga MSHMS konstatojmë se:
-ne kontabilitet janë të regjistruara vetëm 4 prej makinave me vlerë kontabël 0 (zero) të cilat vijojnë të marrin shërbime referuar kontratës së mirëmbajtjes se makinave;
-5 makina te cilat janë në përdorim nga MSHMS dhe marrin shërbime, por nuk janë të kontabilizuara
-3 makina, të cilat sipas realcionit të inventarizimit janë vlerësuar për tôu nxjerrë jashtë përdorimit, por ky procesi nuk ka përfunduar duke u tejzgjatur.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 125-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandim : Nepunësi Autorizues (NA) të marrë masa për ngritjen e një komisioni me ekspertë të fushave, për artikujt respective - automjete, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të tyre, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi i vlerës së aktivit.
-Mbi bazën e aktivit të rivlerësuar, institucioni të rrealizojë regjistrimet e vlerës së tyre në kontabilitet.
-NA te marrë masa për ngritjen e grupit të punës për të nisur dhe përfunduar procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit të automjeteve që rezultojnë si të tilla nga komisioni i inventarizimit, nëpërmjet shitjes si material mbeturine apo asgjësimit përfundimtar, duke ndjekur të gjitha procedurat sikundër kërkon Udhëzimi nr. 30, date 27.12.2012 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se institucioni nuk ka hartuar ka hartuar një kod etike , por rregullat e etikës parashikohen vetëm në nenin 41, të rregullores së brendshme së MSHMS miratuar me Urdhrin nr.178, datë 22.02.2018.
- Nga auditimi u konstatua se, punonjësit nuk janë trajnuar mbi menaxhimin e riskut element ky shumë i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrolli si dhe referuar kapitullit III të ñManualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollitò i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 308-312 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandim: MSHMS duhet të marrë masa për hartimin e programeve specifike të trajnimeve veçanërisht trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.

-MSHMS duhet të marrë masa për hartimin e një kodi etike në përmbushje të Rregullave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Në vijimësi

13.Gjetje nga auditimi: Në llogarinë e APP <u>në formatin elektronik</u> nuk del procedura e prokurimit ñ*Për dhënien e koncesionin /partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës"* pasi procedura nuk ka kaluar si ñ*shpallje e përfunduar*ò, në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 13, datë 28/05/2015 ñ*Për procedurat e dhënies me konçesion dhe partneritet publik privat në sistemin e prokurimit elektronik dhe dorëzimi i ofertave nga operatorët ekonomikë*ò.

-Nga Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 417, dt. 02.10.2015 ñ*Për ngritjen e komisionit të dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës*ò i ndryshuar me urdhrin nr. 298, dt. 14.07.2016 dhe nr. 976/2, dt. 14.07.2016 me procesverbalin përmbledhës nr. 14, dt. 20.03.2017, ***janë vlerësuar ofertat*** për ñK*oncesionin/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës"* me këshilltar transaksioni IFC-në.

Në këtë mbledhje të komisionit përfaqësuesja e IFC ka kundërshtuar kualifikimin e BOE*: 1.L... SHPK (%41.7) & E... France (%25) & A.. L.. S.. B.V (%33.3) Holandë*; duke ngritur **dy arsye**:

a. Çështje integriteti të kompanisë ABLS (duke iu referuar standarteve të IFC në draft kontratën e koncesionit pika 2.1 (j) ku citohet: Që në datën efektive dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes, koncesionari deklaron dhe garanton se:

1. Koncesionari 2.1 deklarimi dhe garancitë e koncesionarit; as ai, as ndonjë prej ortakëve të tij të rëndësishëm (apo në dijeninë e tij, asnjë nga personat e lidhur të tij apo personat e lidhur të tyre) nuk është subjekt i ndonjë hetimi penal për mashtrim, korrupsion, bashkëpunim të fshehtë apo pastrim parash ..... etj

IFC lidhur me këtë fakt është bazuar në dy artikuj gazetash spanjolle të cilat hedhin dyshime mbi përfaqësuesin ligjor të shareholder-it të ABSL-së (orinoco mining&resources B.V dhe anëtarin e bordit të saj, kompaninë ITPS0 i cili, sipas këtij shtypi është në ndjekje penale në Spanjë.

Gjithashtu IFC rekomandon se UBO (ultimate beneficiary owner) i ABSL nuk rezulton i qartë nëse kompania është shqiptare P. shpk pavarësisht dokumenteve të paraqitura sipas tyre.

b. Çështjen e kontrollit mes kompanive ñE..ò dhe ñS.ò të cilat marrin përsipër realizimin e testeve ku sipas IFC-së ñS.ò nuk kontrollohet nga ñE..ò pasi nuk zotëron mbi 40% të së drejtës së votës te kjo kompani, sipas nenit L 233-3 të kodit Tregtar Francez, pika II.

Për dy arsyet e mësipërme **IFC ka rekomanduar skualifikimin e këtij BOE** *1. L.. SHPK (%41.7) & E... France (%25) & A. L... S.. B.V (%33.3) Holandë.*

<u>Komisioni me gjithë rekomandimin e IFC vlerëson se "Nuk disponon dhe as është në dijeni të ndonjë dokumenti zyrtar (vendim gjykate të formës së prerë) që provon se shoqëria A.. nuk përmbush kriterin e përcaktuar..</u>

<u>Gjithashtu lidhur me (ultimate beneficiary oëner) komisioni sqaron se në bazë të dokumenteve të paraqitura nga L.., UBO është kompani shqiptare "P..." SHPK e cila nuk figuron të jetë në ndjekje penale apo e dënuar sipas kriterit të përcaktuar në DST.....</u>

-Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë ka dërguar raportin përmbledhës me nr. **77/11**, dt. **03.04.2017**, i miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor znj. O.M. për **Raportin përmbledhës** për procedurën ñK*oncesionin/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës"* ku përshkruhet procedura e hapjes dhe vlerësimit të ofertave, kualifikimin e tyre dhe propozimin për shpalljen **fitues** të BOE: ñ*L.. SHPK (%41.7) & .E... France (%25) & A.. L..S.. B.V (%33.3) Hollandë me një discount rate 10.7%. (**gjithsej 98.14 pikë**).*

Në këtë raport përmbledhës nuk janë paraqitur kundërshtimet që ka pasur përfaqësuesja e IFC lidhur me kualifikimin e BOE në kundërshtim me Ligjin nr. 125/2013 ñ*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*ò neni 18 pika 5/c; 1. ñL..ò SHPK (%41.7) & ñE..ò France (%25) & ñA. L... S... B.Vò (%33.3) Holandë;
-Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 417, dt. 02.10.2015 **nuk ka kryer hetimet e arsyeshme** në përputhje me Dokumentet e Procedurës Konkurruese të miratuara në pikën 7.7, pikën 7.8.
-Nga IFC është trajtuar çështja e kontrollit mes kompanive ñE..ò dhe ñS..ò të cilat marrin përsipër realizimin e testeve ku sipas IFC-së ñS..ò nuk kontrollohet nga ñE...ò pasi nuk zotëron mbi 40% të së drejtës së votës te kjo kompani, sipas nenit L 233-3 të kodit Tregtar Francez, pika II.
a. Sipas letër konfirmimit dhe angazhimit të datës 09 shkurt 2017 të grupit ñL..ò përfaqësuar nga presidenti z. J.-P. Br. konfirmohet se ñL.. Groupò është zotërues i ligjshëm direkt i 40% të kapitalit të ñE..ò; dhe 40% të kapitalit të ñS..ò dhe si e tillë ñL..ò kualifikohet si shoqëria mëmë e ñE..ò dhe ñS...ò dhe në terma ligjorë ajo i kontrollon të dyja si ñS...ò dhe ñE...ò, të cilat njihen sipas ligjit si degë të ñL...ò.
b. Sipas letër konfirmimit dhe angazhimit të datës 17 mars 2017 nga presidenti z. J.-P. B. ñL.ò është mbajtësi i drejtpërdrejtë i 33.7% të kapitalit të ñS...ò dhe 34.06% të kapitalit të ñE...ò. Për më tepër të gjithë aksionarët e ñS...ò janë gjithashtu aksionarë të ñL...ò; ndërsa të gjithë aksionerët e ñE....ò janë njëkohësisht aksionarë të ñL..ò. Kështu aksionarët e ñL...ò dhe ñL...ò mbajnë më shumë se 40% të aksioneve.
c. Gjithashtu sipas Statutit të ñE...ò viti 2016, Artikulli 13, garancitë, pika II, paragrafi i parafundit faqe 39 ñ ... *përcaktohet shprehimisht se çdo investim, çdo hua... çdo hipotekë, çdo garanci, çdo qiradhënie, çdo garanci, çdo veprim që përfshin transferime të pasurive të paluajtshme klientëve. Çdo shitje e elementeve të caktuar të pasurive fikse që tejkalojnë shumën 100,000 Euro, angazhimet që tejkalojnë një shumë prej 100,000 Euro, blerje për një shumë më të madhe se 100,000 Euro nuk mund të kryhen, vetëm me autorizimin e mbledhjes së zakonshme të partnerëve".*
d. Gjithashtu sipas Statutit të ñL...ò viti 2016, Artikulli 13, garancitë, pika II, paragrafi i parafundit faqe 20 ñ ... *përcaktohet shprehimisht se çdo investim, çdo hua... çdo hipotekë, çdo garanci, çdo qiradhënie, çdo garanci, çdo veprim që përfshin transferime të pasurive të paluajtshme klientëve. Çdo shitje e elementeve të caktuar të pasurive fikse që tejkalojnë shumën 40,000 Euro, angazhimet që tejkalojnë një shumë prej 40,000 Euro, blerje për një shumë më të madhe se 40,000 Euro nuk mund të kryhen, vetëm me autorizimin e mbledhjes së zakonshme të partnerëve*ò.
e. Në dokumentet e paraqitura nga operatori i mësipërm (të cilat janë në formatin elektronik të pa përkthyera në shqip, të pa noteruara dhe mungojnë në dosjen e operatorit fitues) mungon autorizimi i aksionarëve për angazhimet për shërbimet laboratorike sipas ofertës.
-Lidhur me çështjet e integritetit të kompanisë A..., IFC ka rekomanduar skualifikimin e këtij BOE 1. ñL...ò SH.P.K. (%41.7) & ñE..ò France (%25) & ñA.. L.. S.. B.Vò (%33.3) Hollandë. Nga auditimi rezultoi se:

a. Sipas letër konfirmimit dhe angazhimit të datës 17 mars 2017 të ABSL citojmë; ñ*pronari i fundit përfitues i aksioneve të A.. L... S.. B. Holandë (ABSL) është entiteti shqiptar "P..." shpk* .....ò ndërkohë nga auditimi i dokumenteve të paraqitura rezulton se e vetmja marrëdhënie si ligjore dhe ekonomike midis A.. (*të fiduciary*) dhe P... shpk (*the Principal*) është një Fiduicary Agreement (*Shares of Ab Laboratory Solution BV*) nënshkruar në datë 06 Shkurt 2017, e cila në thelb të saj ka vetëm ruajtjen e 1800 aksioneve me vlerë nominale 10 Euro secila, të cilat sipas kësaj kontrate P...SHPK (*the principal*) ja beson në ruajtje në emër të Fiduciary (A...) por për llogari dhe risk të Principal, veprim ky i cili do të konsiderohet ñ*the Services*ò, shërbimi.

Sipas pikës 4 të po kësaj kontrate ñI....ò, A.. në rolin e the fiduciary do të kryej të gjitha detyrat vetëm në përputhje me instruksionet e the Principal dhe vetëm në raste emergjence mund të ndërmarrë ndonjë veprim dhe për të cilin duhet të njoftojë pa vonesë The Principal.
Gjithashtu në pikën 5 po të kësaj kontrate Termination, ndërprerja ose mbarimi i kësaj kontrate është parashikuar në çdo kohë me njoftimin me email brenda tre ditëve pune, dhe në pikën 5.2 është parashikuar që të kryhet transferimi i aksioneve në një palë të tretë pa vonesë dhe pa pretendime.
-Në thelb kjo kontratë nuk paraqet asnjë angazhim apo dhe pronësi të P... mbi A..., por është përdorur si ñ*koracë*ò përfaqësimi për konsorciumin dhe përfaqësimin në konkurrimin e hapur për koncesionin e laboratorëve, pasi nëse do të ishte paraqitur vetë P... si aksioner në konsorciumin e ngritur atëherë pjesëmarrja e tij rezulton 75% të aksioneve dhe jo ndarja që është paraqitur në marrëveshjen e konsorciumit ñL...ò SH.P.K. (%41.7) & ñE..ò France (%25) & ñA..L... Solutions B..ò (%33.3) Holandë, ku natyrisht ndryshojnë dhe kushtet e vlerësimit të cilat në shumicën e detyrimeve i takojnë atij për ti përmbushur si nga ana ligjore dhe financiare.
Sa më lart është qartësuar me dokumentacionin e mëposhtëm ku nga auditimi i dokumenteve të paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës **rezulton**:
- Certifikata e regjistrimit në datën 07.05.2008 me nr. 70491729 për shoqërinë ñP...ò sh.p.k. Republika e Kosovës ortaku i vetëm J. K..
- Me numrin unik të identifikimit të subjektit J62903750A në datën 01.07.1996 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit ñP...ò SH.P.K ortaku i vetëm J. K..;
- Me numrin unik të identifikimit të subjektit L...D në datën 12.11.2012 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit ñP... M..ò SH.P.K ortaku i vetëm J. K..
- Me numrin unik të identifikimit të subjektit K....C në datën 12.06.2006 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit ñP...-V...ò SH.P.K me ortakët L. K. me 50% të aksioneve dhe J.K. me 50% të aksioneve.
- Me numrin unik të identifikimit të subjektit K....A në datën 02.10.2007 është regjistruar në QKB me emrin e subjektit ñL...ò SH.P.K ortaku i vetëm J. K..
-Për sa konstatohet me dokumentet e mësipërme dy nga operatorët e këtij BOE. ñL...ò SH.P.K (%41.7) dhe ñA. L...S.. B..ò i cili sqaron se në bazë të dokumenteve të paraqitura UBO (*ultimate beneficiary owner*) (*Pronari i fundit përfitues*) është ñP...ò SH.P.K ***janë kompani shqiptare me ortak të vetëm J. K. më 100% të aksioneve.***
-Sa më lart kualifikimi i BOE ñL.ò SHPK (%41.7) & ñE.ò France (%25) & ñA. L..S.. B..ò (%33.3) Holandë është në kundërshtim me Dokumentet e Procedurës Konkurruese të miratuara në pikën 3 ñ*Procedurat konkurruese*ò nënpika 3.16 ñ*Bashkimi i shoqërive*ò pika 3.16.4.
-Për këtë arsye Komisioni i dhënies së Koncesionit/PPP të Laboratorëve spitalorë të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 417, dt. 02.10.2015 duhej të kishte skualifikuar bashkimin e operatorëve të mësipërm.
(Më hollësisht trajtuar në faqe 268 – 287 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandim: Autoriteti kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masat për rishikimin e zgjidhjen e kontratës me BOE të koncesionit/partneritetit publik privat ñ*Për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjë*ò përfituar në kundërshtim me Ligjin nr. 125, datë 25.04.2013 ñ*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*ò Neni 36 ñ*Zgjidhja e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat*ò pika 2.
13.2. Rekomandim: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duke u këshilluar paraprakisht me Avokaturën e Shtetit të marrë masat për të informuar Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të gjitha rrethanat e njohura, të cilat çojnë dhe krijojnë kushtet për zgjidhjen e kontratës me BOE të koncesionit/partneritetit publik privat ñ*Për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjë*ò dhe të kërkojë

mendimin e saj, në përputhje me Ligjin nr. 125, datë 25.04.2013 ñ*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*ò, Neni 36 ñ*Zgjidhja e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat*ò pika 4.

Menjëherë.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës së partneritetit publik privat ñPër ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësoreò rezultoi se deri më 21.05.2021 është likuiduar vetëm një faturë në shumën prej 30,670,190.00 lekë për koncesionarin në QSUNT.
Konstatuam se:
1.Kontrata për partneritetin publik privat është nënshkruar dy vite më vonë, pas dërgimit të raportit mbi propozimin e përzgjedhjes së ofertës së suksesshme tek Titullari i Autoritet Kontraktor. Këto ndryshime në afate nuk janë reflektuar në kontratë. Rezultoi që të gjitha spitalet universitare dhe ato referuese, i kanë lidhur Marrëveshjet e Ndërveprimit më vonë se data e parashikuar.
2.Si rezultat i situatës së krijuar nga tërmeti i nëntorit 2019, gjendjes së krijuar nga Pandemia, si dhe mos regjistrimit të aseteve nga spitalet referuese, Data e Synuar e Komisionimit është shtyrë jo më vonë se data 21.06.2020 dhe për të gjithë laboratorët e tjerë, jo më vonë se data 28.01.2021.Aktualisht shërbimi laboratorik po realizohet nga Koncesionari në Qendren Universitare Spitalore "Nene Tereza", në Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik ñKoco Glozheniò, në Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik ñMbreteresha Geraldinëò, në Spitalin Universitar të Traumës dhe në Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò. Në spitalet bashkiake të Lushnjës, Sarandës, në spitalin rajonal të Vlorës dhe Korçës kanë përfunduar përshtatja dhe rregullimi i ambienteve dhe po punohet për instalimin e aparaturave.
3.Nga implementimi i kësaj kontrate, në laboratorin e QSUNT rezultoi se, sipas Shtojcës nr.5, pika 3, *Grafiku i planit të rekrutimit* për QSUNT, për vitin e parë të zbatimit të kontratës kërkon punësimin pranë koncesionarit të total 99 punonjësve, nga të cilët 13 mjekë, 80 teknikë laboratori dhe 6 sanitarë; ndërsa nga auditimi u konstatuan se vetëm 48 nga këta punonjës janë transferuar në koncesionar.
Në vijim rezultoi se, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucioni epror ndaj Qendrave Universitare Spitalore, Spitaleve Rajonale dhe atyre bashkiake, **nuk** ka kryer raporte periodike të monitorimit mbi zbatimin e kontratës koncesionare dhe ligjit nr.125/2013 ñPër koncesionet dhe parteritet publik privatò neni 10, pika 4,5. Në veçanti, nga verifikimi i raporteve të monitorimit të realizuara nga QSUNT rezultoi se:
1.Janë përgatitur dy relacione për muajin Dhjetor 2020: relacioni mbi monitorimin sasior, dhe ai mbi monitorimin cilësor të aktivitetit laboratorik. Grupi i punës i ka hartuar relacionet, duke u bazuar në verifikimet në terren si dhe në bazë të përzgjedhjeve rastësore të disa shërbimeve mjekësore, konkretisht në Gastrohepatologji, në Hematologji, në Urgjencën Pediatrike, në Neurologji dhe në Stroke Post Stroke, duke konkluduar se: (i) nuk është raportuar saktë dhe me përgjegjshmëri numri i ekzaminimeve laboratorike të referuara dhe ato të kryera (përgjigjet). Në shumë raste përgjigja e analizave ka mbërritur në shërbim pasi pacienti i hospitalizuar ka lënë shërbimin, me një diferencë prej 914 analiza, të cilat nuk janë pasqyruar në raportin përfundimtar të shërbimeve; (ii) shumë mjekë janë regjistruar në sistemin LIS (*laboratory informacion system*) të Shoqërisë konçesionare në shërbimet e gabuara, duke sjellë vonesa apo mosdorëzim në shërbimin e duhur të përgjigjeve të analizave duke çuar deri mos referimin e tyre si analiza të kryera në raportimet mujore; (iii) nga ana e shoqërisë koncesionare janë pranuar dhe janë realizuar ekzaminime laboratorike, me formularë të cilët nuk përmbajnë elementët bazë të identifikimit. Për këtë arsye 43 ekzaminime biokimike të kryera nga laboratori nuk janë raportuar nga Shërbimi i Gastrohepatologjisë. Sa më sipër, formularët e parregullt sipas Kontratës së Ndërveprimit nuk duheshin pranuar dhe ekzekutuar nga ana e shoqërisë koncesionare; (iv) Referuar Kontratës së ndërmjetësimit, pika VII ñ*Standardet e shërbimit*ò ku ñ*Koncesionari duhet të respektojë kohën e*

*propozuar për daljen e rezultateve për çdo analizë, qoftë rutinë apo në kushte urgjence, kohë 30 min....*ò, konstatuam se, nga ana e shoqërisë konçesionare, jo gjithmonë, është respektuar koha maksimale për daljen e rezultatit, për të cilat duhej të aplikohej penalitet të parashikuar në kontratën koncesionare.

2.Diferenca të konsiderueshme kanë rezultuar edhe në faturimin e analizave laboratorike nga shoqëria konçesionare, gjatë raportimit të ekzaminimeve laboratorike si Imunfenotipet dhe CD4 të cilat kryhen me markera të ndryshëm. Ndërsa Laboratori i faturon sipas kontratës me nr. markerash të kryer për çdo analizë, shërbimet mjekësore i raportojnë si një analizë e vetme.

Në përfundim, konkluduam, se MSHMS, në rolin e institucionit epror, nëpërmjet Komitetit Ndërlidhës, **nuk** ka monitoruar ecurinë periodike të kontratës koncesionare në qendrat spitalore universitare, spitalet referuese dhe ato bashkiake. Vecanërisht, pas raportimeve të QSUNT mbi monitorimin periodik të kryer për periudhën Nëntor, Dhjetor 2020, **nuk** ka marrë asnjë masë për verifikimin e mëtejshëm të parregullsive të konstatuara nga grupet e punës së QSUNT, me qëllim korrigjimin e tyre, nxjerrjen e përgjegjësive dhe aplikimin e penaliteteve për rastet e konstatuara me devijime nga kushtet e kontratës koncesionare.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 286-304 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandim: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për kryerjen e monitorimit periodik dhe hartimin e raporteve përkatëse mbi zbatimin e kontratës koncesionare, me qëllim, përmirësimin e performancës në ofrimin e shërbimeve laboratorike publike, si dhe për eleminimin e parregullsive dhe minimizimin e risqeve që mund të ndikojnë në buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.2 Rekomandim: Komitetit Ndërlidhës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë në shqyrtim të gjitha raportet periodike të monitorimit të qendrave spitalore universitare, spitaleve referuese dhe atyre bashkiake, të realizuara deri tani, për verifikimin e mëtejshëm të parregullsive të konstatuara nga grupet e punës përkatëse, me qëllim korrigjimin e tyre, nxjerrjen e përgjegjësive dhe aplikimin e penaliteteve për rastet e konstatuara me devijime nga kushtet e kontratës koncesionare.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Komisioni i Vlerësimit (KV), ka negociuar afatet e lëvrimit të mallit, në kundërshtim me afatet e përcaktuara në dokumentacionin ñFtesë për ofertëò, duke denatyruar njëkohësisht edhe nevojën për përzgjedhjen e ñprocedures së drejtpërdrejtëò, përzgjedhur kjo nga KV dhe miratuar nga Titullari i autoritetit kontraktor, për procedurat si vijon:

a-Nga auditimi i procedurës ñ*Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19*ò me fond limit 129,727,371 lekë pa tvsh, rezultoi se, nga Komisioni i Vlerësimit, më datë 25.03.2020 sipas Ftesë për Ofertë, është parashikuar si afat lëvrimi për 54 respiratorë afati 10 ditor. Në vijim është lidhur kontrata e furnizimit nr.1365/36, dt. 27.03.2020 me objekt ñ*Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adulte dhe moshë pediatrike për COVID-19*ò me vlerën 75,060,000 lekë pa tvsh me afat lëvrimi 20 respiratorë do të lëvrohen për 7 ditë nga hyrja në fuqi e kontratës dhe 34 respiratorë do të lëvrohen për 25 ditë nga dita e hyrjes në fuqi e kontratës (pra 25 ditë nga miratimi i kontratës me VKM nr.274, datë 03.04.2020).

Në përfundim konkludojmë se, KV ka tejkaluar kompetencat e veta, duke negociuar afatet në kontrata, në kundërshtim me afatet e përcaktuara në dokumentacionin ñFtesë për ofertëò me

argumentimin e nevojës për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit (procedurë kjo e cila ka dështuar, pasi në përfundim u siguruan vetëm 5 respiratorë).

b- Nga auditimi i procedurës *"Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën seriologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHP"*e ndarë në 4 Lote, me fond limit në vlerën prej 29,008,273 lekë, nga KV janë negociuar kushtet e kontratës në lidhje me afatin e levrimit, duke u lënë furnizimi për të gjithë sasinë e mallit,në mënyrë variabël nga 7 ditë deri në 55 ditë, nga 7 ditë që ishte kërkuar fillimisht në dokumentin ñFtesë për ofertëò sipas shkresës nr. 1621/2, datë 05.04.2021. Negocimi i afateve nga KV, duke i zgjatur ato përtej afateve të kërkuara, gjithashtu nuk justifikon procedurën e përzgjedhur, e cila ka për qëllim përgjigjen emergjente ndaj situatës së pandemisë.

c-Nga auditimi i procedures ñBlerje Materiale Për Mbrojtje Personale Për Covid -19ò me fond limit prej 307,844,333 lekë pa tvsh, nga Komisioni i Vlerësimit në dokumentacionin ñFtesë për ofertëò është kërkuar që, jo më pak se 15% e sasisë së artikujve nga 1-9 të lëvrohen brenda 7 ditëve nga miratimi i kontratës me VKM-në përkatës, 75% e sasisë së artikujve nga 1-9 të lëvrohen sipas kërkesë së AK, por jo më vonë se 6 javë nga miratimi i kontratës me VKM, ndërsa për artikullin 10 (tampon laboratory) e gjithë sasia të lëvrohet jo më vonë se 8 javë nga miratimi i kontratës me VKM.

Pra, në këtë rast nga KV vetëm 15% e sasisë së kërkuar është në përmbushje të nevojës emergjentë brenda 7 ditëve, ndërsa pjesa prej 75% nuk na rezulton të jetë në këto kushte. Nëse do të krahasonim afatin e parashikuar me afatet që dikton Ligji per Prokurimin Publik, për paraqitjen e ofertave në ñProcedurën e hapurò kërkon jo më pak se 52 ditë, ndërsa për ñProcedurën me negocimò afati minimal është 15 ditë, pra dukshëm më pak se 6 jave deri në 8 javë (56 ditë). Përdorimi i VKM nr.203 nga MSHMS, synon realizimin në kohë sa më të shpejtë të barnave, pajisjeve dhe shërbimeve mjekesore, si reagim për përballimin e situatave që diktohen nga interesat thelbësore të shtetit. Në këtë rast, vendosja e afateve të tilla ka humbur konceptin e emergjencës, në kushtet kur nga prokurimi i drejtpërdrejte në fakt është përfituar vetëm 15% e nëvojës ekstreme

Përzgjedhja e ñprocedurës së drejtpërdrejtëò, në kushtet kur afatet për lëvrimin e mallit rezultojnë të realizueshme edhe me procedura të tjera prokurimi, ka denatyruar ñkonceptin e emergjencësò ndaj nevojës për materialet për Covid-19.

Autoriteti konraktor në rastin e këtij prokurimi, në përcaktimin e procedurës **nuk** i është referuar Ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò i ndryshuar, Neni 33 pika 2/c ñ*kur për arsye të nevojës ekstreme të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara nga autoriteti kontraktor* .....ò, d, ñ*për blerje, që mundësojnë prokurimin e mallrave për një kohë lëvrimi shumë të shkurtër, ose për një rast veçanërisht të leverdishëm, që paraqitet në një kohë shumë të shkurtër dhe me një çmim, dukshëm, më të ulët se çmimet normale të tregut dhe në përputhje me kriteret e parashikuara në rregullat e prokurimit publik"; si* dhe VKM nr. 914, dt. 29.12.2014 ñP*ër miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar neni 36, pika 2/c, ku parashikohet se në rastin e një nevoje ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, që nuk i ngarkohen autoritetit kontraktor, duhet të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme: - Shkaktimi i një ngjarjeje të paparashikuar; - Autoriteti kontraktor nuk ka përgjegjësi për ngjarjen; -Ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshëm të një komuniteti të gjerë;* pika 3*, ñUrdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 60 të këtyre rregullave, duhet të paraqesë arsyet e përdorimit të kësaj procedure. 4, 6, pika 7, ñNë rastin e procedurës së prokurimit me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, afatet kohore parashikohen nga vetë autoriteti kontraktor, në varësi të objektit të prokurimit dhe rrethanave".*

Sa më lartë për aplikimin e procedurës *"Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit"* gjykojmë bazuar në Urdhrin nr.133, datë 08.03.2020 ñ*Për kufizimin e lëvizjes së shoqëruesve dhe ose familjarëve të pacientëve nëpër spitale*ò, urdhrin 135/1 datë 09.03.23020

ñ*Për mbylljen e veprimtarisë çerdheve, për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-19",* Urdhrin nr 135, datë 09.03.2020 ñ*Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së COVID-19*ò, vendimin e Komitetit Teknik nr. 566/3, dt. 06.03.2020 *"Për domosdoshmërinë e krijimit të stokut për Mjetet Mbrojtëse Personale".*
(Trajtuar më hollësisht në faqet 185-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandim: Nga Komisionet e Vlerësimit, përgjatë negocimit dhe hartimit të kontratave të furnizimit, të merren parasysh afatet e përcaktuara në dokumentet standarde, dhe që përmbushin nevojat emergjente, në funksion të procedurës së përzgjedhur, parashikuar nga VKM nr. 203, dt. 26.02.2020 *"Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit".*
- Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Titullari i Autoritetit kontraktor të merren masat që për rastet e nevojave ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, kur ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshëm të një komuniteti të gjerë, për blerje, që mundësojnë prokurimin e mallrave për një kohë lëvrimi shumë të shkurtër, (*afatet kohore parashikohen nga vetë autoriteti kontraktor, në varësi të objektit të prokurimit dhe rrethanave)*në përputhje me kriteret e parashikuara në rregullat e prokurimit publik autoriteti kontraktor të përzgjedhë procedurën parashikuar nga Ligji nr. 9643, dt. 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò i ndryshuar, Neni 33 ñ*Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit".*

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) ka realizuar procedurën e hapur me objekt ñ*Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë*ò me fond limit në vlerën prej 668,493,718.32 lekë pa tvsh, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të cilit i është deleguar procedura e prokurimit në bazë të shkresës nr.243 prot datë 05.03.2020, nga institucioni i varësisë, Spitali Universitar Obsetrik-Gjinekologjik (SUOGJ)ñMbretëresha Geraldinaò (MG), me kërkesë që realizimi i procedurës, të bëhet nga MSHMS, mëqënëse SUOGJ ñMbreteresha Geraldinaò, <u>*nuk disponon kapacitetet e duhura për të kryer zhvillimin e procedurës së prokurimit publik.*</u>
-Nga auditimi u konstatua se, vlera e fondit limit, **nuk** është përllogaritur nga MSHMS pasi gjithë <u>dokumentacioni</u> *(Projekti Teknik, Preventiv i punimeve, oponenca teknike, akt ekspertizat, miratimi i projektin nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, miratimi i Lejes së ndërtimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit*) janë përcjellë nga SUOGJ-MG me shkresat nr.4/2 prot datë 10.02.2020 dhe nr.363 prot datë 30.04.2020, në MSHMS.
Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm në dosje fizike ï teknike të procedurës, u konstatua se:
(i) Projekti Teknik është realizuar ngaInstituti i Ndërtimit, si rezultat i bashkëpunimit me SUOGJ ñMbretëresha Geraldinëò (SUOGJ - MG), **dhe jo** nëpërmjet një procesi të hapur të përzgjedhjes në bazë të rregullave të prokurimit publik. SUOGJ është institucion varësie i MSHMS dhe njësi shpenzuese e veçantë dhe si Autoritet Kontraktor, është vetë autoriteti përgjegjës për administrimin e fondeve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit të nevojave të tyre, procedurë të cilën në këtë rast nuk e ka realizuar.
Nga auditimi rezultoi se, në dokumentacionin e paraqitur nga SUOGJ-MG, **nuk** është paraqitur <u>Licenca profesionale për Projektim nga Instituti i Ndërtimit</u> lëshuar nga Ministria e Infrastruktuës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr.943 datë 28.12.2016 ñPër disa ndryshime edhe shtesa ne VKM nr.759 datë 12.11.2014 ñPër licensimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtarinë në fushën e studimit në projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjeò, ndonëse IN ka realizuar hartimin e Projektit Teknik, duke ñpërdorurò <u>liçencat personale</u> të punonjësve ose të personave fizikë që operojnë në fushën e projektimit.
Midis SUOGJ-MG dhe Institutit të Ndërtimit, është realizuar Kontrata nr.477/10 prot SUOGJ-

MG ñ*Për hartimin e projektit Teknik për* ñ*Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë*òdatë 28.06.2019 lidhur, me vlerë prej 5,487,357 lekë me tvsh, për të cilën më pas është bërë dhe Kontrata shtesë nr.477/14 prot datë 26.02.2020 me vlerë prej 7,712,994 lekë me tvsh.Për kontratat e mësipërme nga SUOGJ-MG nuk janë paraqitur Urdhër-Shpenzime mbi pagesën, në vlerë totale prej 13,200,351 lekë me tvsh, me përfitues Institutin e Ndërtimit,(i cili nuk merr financim nga Buxheti i shtetit, por është me vetëfinancim). Sa më sipër, institucionet shtetërore, SUOGJ-MG dhe IN, kanë manaxhuar fonde publike në vlerën prej 13,200,351 lekë me tvsh, duke shmanguar procedurat e prokurimit si dhe duke eliminuar garën dhe transparencën për realizimin e hartimit të projektit teknik.

ii) Në vijim, nga Instituti i Ndërtimit në kuadër të bashkëpunimit me SUOGJ-MG, është realizuar Oponenca teknike,duke lidhur kontratë nr.1066/4 datë 17.12.2019 me objekt ñOponenca teknike për *"Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë",* veprim ky në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò të ndryshuar, neni 37 (Shërbimi i konsulencës) pika 3 /b, me ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, neni 5. Në kushtet kur projekti teknik është hartuar nga Instituti i Ndërtimit, oponenca teknike (potencialisht mendimi ndryshe) vlerësojmë se nuk duhet të kryhej nga i njëjti institucion. Ky fakt është kundërshtuar dhe nga MSHMS sipas shkresës nr.1055 prot datë 19.11.2019 të SUOGJ-MG, drejtuar IN për bashkëpunim dhe interpretim të kofliktit të interesit.

Në bazë të Urdhër-shpenzimit nr.788 datë 31.12.2019, IN është likuiduar me vlerën prej 325,750 lekë me tvsh, për realizimin e Oponencës teknike.

iii) Përsëri nga Instituti i Ndërtimit janë realizuar dy Aktekspertiza, njëra e datës 30.11.2019 mbi verifikimin në terren të subjekteve të dëmtuara të tërmeti i datës 26.11.2019 dhe tjetra e datës 19.02.2020, e cila është e thelluar në bazë të VKM nr.26 datë 15.01.2020 ñPër kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuaraò, duke u shprehur në përmbajtje se, duhet të merren *masat për rikonstruksion dhe përforcimi i Godinës së Obstetrikës, ndërsa për Godinën e Neonatoligjisë paraqitet më e vështirë, e për pasojë riparimi dhe përforcimi i strukturës është joeficient për tu riparuar* (dmth duhet të rindërtohet). Në Akespertizën e datës 19.02.2020, anëtarët e grupit **nuk** janë shprehur si ka qënë gjendja e godinave para dhe pas termetit dhe për rrjedhojë dhe ndryshimet në efektet financiare që mund të ketë pësuar preventivi Teknik i hartuar nga vetë IN, kjo në kundërshtim me Aktin Normatin nr.9 datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò neni 34 paragrafi 2.

Gjithashtu, dhe në këtë rast konstatuam se anëtaret e grupit që kanë hartuar Aktekspertizën e datës 19.02.2020, janë në konflikt të interest me detyrat që kanë realizuar, pasi njëkohësisht kanë qenë edhe anëtarë të grupit të hartimit të projektimit Teknik.

iv*)*.Nga auditimi u konstatua se,procedura e realizuar nga MSHMS në cilësinë e AK, procedurë e hapur me objekt ñRikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranëò me fond limit në vlerën prej 668,493,718.32 lekë pa tvsh, është fituar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ñA... K...ò shpk & ñB..-I...òshpk me vlerë ofertë fituese prej 466,395,123.98 lekë pa tvsh ose rreth 28 % më e ulët se vlera e fondi limit (Ofertë anomalisht e ulët), fakt që mund të mbart elementë për fryrje fiktive të përllogaritjes së fondit limit, dmth të preventivave të hartuara nga IN.

v) Nga auditimi i specifikimeve teknike që lidhen me zërat e kapitujve të punimeve elektrike u konstatua se, vendosja e *kodeve dhe serive të produkteve* i bën referencë *prodhuesit "Schneider", duke* bërë të mundur orientimin në drejtim të operatorëve ekonomikë specifikë që kanë këtë produkt. Veprimi i paracaktimit të prodhuesit nga ana e IN, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar ñPër prokurimin publikò neni 23 ñSpecifikimet teknikeò, pika 2 dhe 5.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 226-248 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandim: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale, si institucioni epror, të marrë

masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim verifikimin dhe vlerësimin e procedurës së ndjekur për *"Rikonstruksionin e godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtimin e ri 3 kat, Tiranë",* në kushtet kur ka munguar procedura e prokurimit, duke e shoqëruar me përgjegjësitë respektive në çdo hallkë të saj, si dhe marrjen e masave për personat përgjegjës.

Brenda datës 31.12.2021

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave të Projektit Teknik*"Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë"*nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua sa vijon:

- Nga auditimi i preventivit të punimeve, të prokuruar nga MSHMS, dhe të hartuar nga Instituti i Ndërtimit rezultoi se për godinën e re dhe në rikonstruksionin e godinës ekzistuese, zërat ndërtimore, në një pjese të konsiderueshme të tyre (llogaritur në shumën 149,418,232 lekë), janë bërë me analizë çmimesh (AN), dhe jo me çmime sipas manualit të çmimeve. Kështu, në godinën e re, kapitulli ñd. Punime muratureò, zëri ñFV shtrim i sallës operative me PVC antibacterialò, Kapitulli ñj. Punime izolimi themele e tarraceò, etj, janë bërë pothuajse me ñANò, duke emërtuar zëra pune komplekse që nuk gjenden me emërtim të njëjtë në manualin e çmimeve dhe të ndryshme nga ato të paraqitura në specifikimet teknike. Pra edhe pse këto zëra janë me analizë çmimi, bashkëlidhur **nuk** u evidentua asnjë listë e hollësishme çmimesh me analizë të detajuar të çmimit ku të përfshihet: vlera e mallit/pajisja +pagesa e sigurimeve shoqërore+pagesa e puntorisë+ transport, etj.kjo në kundërshtim me VKM- në nr.514 datë 15.08.2007 ñPër informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.òi ndryshuar me VKM 629 datë 15.07.2015.

Në llogaritjen e kostove për punimet ndërtimore, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, **nuk** u gjet asnjë përllogaritje e çmimeve apo studim tregut sipas VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò Kreu VII, neni 59, ñPërllogaritja e vlerës limit të kontratësò pika 2, ku përcaktohet se: *në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); **ose/dhe** a) Çmimet e tregut; ose/dhe b) Çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe ç) Çmimet ndërkombëtare, të botuara.*

Në lidhje më këto zëra, u analizuan zërat si më poshtë:

1.Për zërin e punës *"F.V Termo dhe hidroizolim i pllakës së themelit dhe katit nëntokë. Primer, termoizolim me polesterol ekspans me spensor 80mm. Hidroizolim me dy shtresa guajne bituminoze, gjeotekstil, shtresë mbrojtëse",* **me çmimin 30,000 lekë/m^2**, me vlerë totale 33,900,000 lekë pa TVSH (1130 m^2 x 30,000 lekë/m^2), ku konstatuam se,nënzërat e tyre, si: primer, termoizolim me polesterol ekspans me spensor 80 mm, Hidroizolim me dy shtresa guajne bituminoze, gjeotekstil, shtresë mbrojtëseò, janë zëra që mund të gjenden të njëjtë (ose të ngjashëm) në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi dhe nga rillogaritja e çmimit të ri, rezultoi se, *çmimi i këtij zëri pune është rritur me 12,309 lekë/m^2, ose në totalin e preventivit* ***13,909,170 lekë pa TVSH*** *(12309 lekë/m^2 x 1130 m^2).*

2. Për zërin e punës nr. 13 të kapitullit ñ*e. Punime shtresash" me përshkrimin "FV shtrim i sallës operative me PVC antibacterial"*, me çmim njësi 4920 lekë/m^2, me vlerë 39,360,000 lekë (8000 m^2 x 4920 lekë/m^2), në mungesë të analizës së çmimit në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe nga kërkimi i bërë në internet për çmimin e këtij materiali në linkun https://www.made-in-china.com/products-search/hot-china-products/Pvc_Flooring_For_Hospital.html, rezultoi se çmimi i materialit PVC antibacterial për spitalet, varion nga 5-15 USD/m^2 (ose 505 ï 1545 lekë/m^2).

Nga sa sipër, duke shtuar edhe nënzërat e tjerë të analizës së kostos (punëtori, transport dhe

makineri), përsëri ekziston rreziku i rritjes së pajustifikuar të çmimit/njësi të këtij zëri pune. Analiza e çmimit me testimin e tregut për nënzërin ñmaterialò, do të jepte një vlerësim objektiv për çmimin e këtij zëri pune.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 226-248 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandim: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale, si institucion epror i Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik, të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mosargumentimin dhe mosdokumentimin në përllogaritjen e fondit limit, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet, si dhe të marrë masa për eliminimin këtyre praktikave në të ardhmen.

Menjëherë

C.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, me VKM nr.274, datë 03.04.2020, mes MSHMS dhe operatorit ekonomik ñT.....ò, është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1365/36, datë 27.03.2020, me vlerë kontrate 75,060,000 leke pa tvsh ose 90,072,000 me tvsh me objekt ñFurnizim vendosje respiratore me dy modalitete per adulte dhe moshe pediatrike per Covid -19ò, me afate lëvrimi: 20 respiratorë brenda 7 ditëve dhe 34 brenda 25 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të kontratës (datë 03.04.2020).
-Nga MSHMS vetëm për kontratën ñFurnizim vendosje respiratore me dy modalitete per adulte dhe moshe pediatrike per Covid -19ò, është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës , në bazë të shkresës nr.1365/38, datë 03.04.2020, i cili ka raportuar vetëm dorëzimin e 5 respiratorëve të cilët janë dërguar në Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò SUSHN, në cilësinë Spitali ñCovid 2ò, ku më Urdhër të titullarit të SUSHN është ngritur Komisioni për pritjen e mallit për pajisjet mjekësore respiratore, kjo në bazë të PV në datën 04.04.2020 , duke u shprehur se janë marrë në ruajtje 5 respiratorë.
-MSHMS me shkresën nr.1782, datë 09.04.2020, i është drejtuar SUSHN në lidhje me marrjen në dorëzim të pajisjeve mjekësore, është kërkuar që pas instalimit dhe vënies në punë të hartohet një procesverbal dhe të bëhet kontabilizimi, dokumentacioni të dërgohet në MSHMS.
-MSHMS me shkresën nr.1365/40, datë 27.04.2020, është vendosur transferimi i 5 respiratorëve nga Spitali Shefqet Ndroqi për në Qëndrën Spitalore Universitare ñ Nënë Terezaò QSUNT.
Komisioni i pritjes së mallit në Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò është mbajtur procesverbali në datën 30.04.2020 mbi dorëzimin e pesë pajisjeve respiratorë, në drejtim të QSUNT. Nga auditimi u konstatua se, respiratorët nuk u përdorën nga Spitali Universitar Shefqet Ndroqi, ndërsa qëndruan fizikisht për gati 1 muaj në këtë spital.
-Nga auditimi konstatohet se përgjatë një muaji që respiratorët qëndruan në spitalin Shefqet Ndroqi, në MSHMS nuk është dërguar asnjë dokumentacion mbi marrjen në dorëzim të tyre. Si pasojë, arsyet e mospërdorimit të tyre nga ky spital **nuk** reflektohen nga grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, ngritur me shkresë nr.1365/38, datë 03.04.2020, duke rezultuar se ka munguar gjurma e auditimit, që lidhet me përgatitjen e informacionit përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës në mënyrë të vazhdueshme.
-Me shkresën nr.578/303, datë 08.05.2020, nga Qendra Spitalore Universitare ñNënë Terezaò është dërguar një kopje e relacionit të kolaudimit të pajisjeve mjekësore në formë dhurimi , dhe kalimi nga SUSHN në QSUT, është trajtuar si donacion.
- Nga auditimi u konstatua se, me shkresat nr.1803, datë 10.04.2020 dhe nr.1365/39 datë 24.04.2020 nga operatori ekonomik fitues T....shpk, është kërkuar zgjatje e afateve të dorëzimit të pajisjeve deri në periudhën maj ï qershor (për shkak të mbylljes të transportit ajror, tokësor dhe detar), duke ceduar kështu kriteri i ñemergjencësò. Pavarësisht kësaj, AK nuk rezultoi të ketë marrë ndonjë veprim administrativ- juridik për amendimin e kësaj kontrate.

- Nga auditimi rezultoi se, OE deri më 10.04.2020 ka dorëzuar ***vetëm 5 copë,*** nga 20 copë që duhet të dorëzonte brenda 7 ditëve, ndërsa 34 respiratorë do të lëvroheshin brenda 25 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e kontratës, ku as këto nuk mundën të siguroheshin, duke sjellë gjithashtu edhe dështimin e kontratës së mësipërme. Grupi i auditimit, pas kontrolleve të cilësisë në KLSH, si dhe në bazë të evidencave të auditimit si: kontratat respektive, proces verbalet dhe faturat tatimore të dorëzimit të mallit/pajisje/shërbimit, rishqyrtoi edhe njëherë dhe rivlerësoi detyrimin kontraktor në lidhje mbi ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò dhe me ñSigurimin e kontratësò, në lidhje me furnzimin me respiratorë sipas kontratës nr. 1365/36, datë 27.03.2020, si më poshtë:

a. Në zbatim të nenit 10 të kontratës nr. 1365/36, datë 27.03.2020 parashikohet se: **"**Kontraktuesi, **kur nuk realizon ketë kontratë brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000** të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratësò.

Grupi i auditimit, verifikoi edhe njëëherë evidencat e auditimit si: kontratën përkatëse, proces verbalet dhe faturave tatimore të dorëzimit të mallit/pajisje/ shërbim për secilën kontratë, dhe më pas rivlerësoi dhe rillogariti detyrimin kontraktor në lidhje mbi ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò sipas nenit 10 të kontratës nr. 1365/36, datë 27.03.2020. Nga auditimi rezultoi se:

- OE ñT.. ..ô shpkò, deri më 10.04.2020 ka dorëzuar ***vetëm 5 copë respiratorë ,*** nga 20 copë që duhet të dorëzonte për 7 ditë, ndërsa 15 copë respiratorë rezultojnë të padorëzuar në tejkalim të afatit 7 ditor (vlera e një respiratori është 1,390,000 lekë pa tvsh ose 1,668,000 lekë me tvsh). Për këtë furnizim të padorëzuar OE-së duhet tôi përllogariten dhe mbahen shuma prej 700,560 lekë me tvsh ((15 resperatorë x 1,668,000) x 0.004 x 7 ditë=**700,560 lekë me tvsh**.)
- Gjithashtu 34 copë respiratorë **nuk** u dorëzuan fare, duke mos respektuar as afatin e parashikuar në kontratë prej 25 ditesh. Për këtë furnzim të padorëzuar OE-së duhet tôi përllogariten dhe mbahet shuma prej 5,671,200 lekë me tvsh ((34 respirator x 1,668,000) x 0,004 x 25 ditë = **5,671,200 lekë me tvsh**)

Pra. në total, për mosrealizimin e afateve dhe mos dorëzimin e 49 respiratorëve, kontraktuesi duhet të paguajë 4/1000 të vlerës **së mbetur pa u zbatuar**, nga çmimi total i kontratës, në vlerën totale **prej 6, 371,760 lekë me tvsh,** e cila nga auditimi rezultoi si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

b. Gjithashtu, **në zbatim të nenit 16 (Sigurimi i Kontratës), të Kontratës Furnizim nr.1365/36, datë 27.03.2020** ñ *Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë AK garancinë e sigurimit të kontratës, 10% të vlerës së kontratës me tvsh në shumën* ***prej 9,007,200 lekë.*** *Kontrata të sigurohet deri në përfundimi të kontratës. Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet AK si kompesim për çdo humbje të rezultuar nga* ***dështimi i kontraktorit*** *në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës. Garancia e sigurimit të kontratës do t'i kthehet Kontraktuesit pas përfundimit të kohëzgjatjes së kontratës*ò.

-Nga auditimi u konstatua se, nga OE ñT...ò shpk, është paraqitur Formulari i Sigurimit të Kontratës nga Kompania e Sigurimeve ñE...ò me Nr. Serial 070350260029567, datë 27.03.2020, midis të tjera thuhet se ñ..*Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e Ministria e Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, vlerën e siguruar, brenda 15 ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmënde mospërbushjen e kushteve të kontratës."*

Nisur nga këto rrethana e kushte, MSHMS si pasojë e mosplotësimit të detyrimit kontraktor nga OE si dhe në zbatim të neni 16 (Sigurimi i Kontratës), me shkresat nr.1365/43, datë 27.05.2020; nr.1782/1, datë 16.06.2020 dhe nr.633, datë 03.02.2021, ka kërkuar nga Kompania e Sigurimeve ñE....ò dhe për dijeni OE fitues ñT.ò shpk, për shkak të mospërmbushjes së kushteve të kontratës, transferimin në llogarinë e MSHMS të vlerës prej 10% të kontratës.

Nga auditimi u konstatua se, deri në momentin e hartimit të këtij materiali nga Kompania e Sigurimeve ñE....ò, nuk është depozituar vlera e garancisë së kontratës si dhe nga MSHMS nuk

<u>është ndërmarrë asnjë veprim ligjor duke shkuar në gjykatë administrative për arkëtimin e kësaj vlerë, e cila mund të sjellë risk ekonomik në disfavor të Buxhetit të Shtetit, ***<u>në vlerën prej 9,007,200 (nëntë milion e shtatë mijë e dyqind) lekë si e ardhur e munguar.</u>***</u>
Në përfundim, rezultoi se furnizimi me respiratorë, u realizua nga dy OE të tjera konkretisht MSE shpk dhe Mé shpk (referuar faturave te likuidimit date 28.10.2020 (M.. shpk), date 13.11.2020 (M.. shpk) dhe date 09.10.2020 (Mé . shpk). Edhe pse planifikuar per nevoja emergjente, kjo procedure në fakt dështoi të ofronte në kohë këtë pajisje kaq të rëndësishme/jetesore në kushtet e pandemisë Covid19.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 185-191 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Nga MSHMS të merren masa për arkëtimin e penaliteteve të krijuara si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor, duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, konkretisht nga operatori ekonomik ñT.. ..ò shpk, në vlerën prej 6, 371,760 lekë me tvsh, për mosrealizimin e afateve dhe mos dorëzimin në kohë të 49 respiratorëve.
1.2. Rekomandim: MSHMS, të ngrejnë grup pune të veçantë, për analizimin e shkaqeve dhe arsyeve, të mos arkëtimit të vlerës prej **9,007,200.00** lekë, si pasojë e mos konfiskimit të sigurimit të kontratës në favor të MSHMS si dhe te kërkojë arkëtimin e vlerës së mësipërme në favor të Buxhetit e Shtetit, duke ndjekur të gjithë rrugët ligjore.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi:
a- Në përfundim të procedurës ñ*Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisje e Existation të firmës Bioneer ose ekuvalent*ò është lidhur kontrata e furnizimit me nr.1574/13, datë 30.03.2020, miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020, me vlerë kontrate 10,200, 000lekë me tvsh.
Rezultoi se, operatori ekonomik ñO.. D..ò shpk ka dorëzuar 20 kite *"AccurPower Sars –Cov – 2 real time PCR"* 17 ditë me vonesë, për të cilin nuk u konstatua njoftim apo ndonjë dokumentacion shkresor, mbi vonesat e dorëzimit të mallrave. Kështu në bazë të detyrimit kontraktor neni 24 ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò ku parashikohet se ñ*Kontraktuesi, kur nuk realizon ketë kontratë brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratë*s.ô
Sa më sipër, për vonesat e dorëzimit të mallit me 17 dite, nga data 30.03.2020 deri në 16.04.2020, penaliteti i llogaritur për dorëzim të vonuar është (10,200,00 lekë me tvsh x 0,004 x17 ditë = **<u>693,600 lekë me tvsh,</u>** <u>si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.</u>
b-Nga zbatimi i kontratës, në lidhje për procedurën ñ***Spostimi i sistemit të dializës nga Pediatria e Specialiteteve tek godina e Spitalit Infektiv*** *(Shërbimi i Alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me Covid-19*ò është lidhur kontrata nr.1575/19, datë <u>07.04.2020</u> miratuar me VKM nr.323 datë <u>18.04.2020</u>, me vlerë kontrate 850,000 lekë pa tvsh ose 1,020,000 lekë me tvsh. Ky shërbim dhe furnizimi duhej bërë brenda 24 orëve, ndërkohë që ka ardhur më datë 22.04.2020, dmth 2 ditë me vonesë (Nga Qendra Spitalore universitare, është dërguar proces verbali nr. Dt. 22.04.2020 i mbajtur nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 57/1, dt. 21.04.2020 ku vërteton kryerjen e punimeve (Cinstalim, transporti, instalimi) ..... Këto punime u kryen respektivisht sipas kushteve të kontratës si dhe detyrimit vtë të gjitha palëve. Fatura tatimore nr. 4055, dt. 22.04.2020 për 850,000 lekë pa tvsh ose 1,020,000 lekë me tvsh.)
Për rrjedhojë në zbatim të detyrimit kontraktor neni. 24 ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò ku parashikohet se ñ*Kontraktuesi, kur nuk realizon ketë kontratë Brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25%*

të vlerës së kontratës.ô AK duhet të kishte përllogaritur dhe ndalur penalitetin për dorëzimin e vonuar nga operatori ñT...ò shpk është (1,020,000x0,0,004 x2 ditë =**8,160 lekë me tvsh**, vlerë kjo e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

c-Nga zbatimi i kontratës, në lidhje për procedurën **Loti I** ñ*Blerje kite dhe reagent të përshtatshëm për të përdorur në pajisje Maglum 800 Snibe CoLtd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për Covid-19*ò është lidhur kontrata lidhur kontrata me nr.1776/11 datë 14.04.2020 , miratuar me VKM nr.322, datë 18.04.2020, me vlerë kontrate3,512,000 lekë pa tvsh ose 4,214,400 lekë me tvsh. Në detyrim kontraktor neni 2 dhe sipas ofertës nga operatori ekonomik ñG....òshpk, 50 kite duhet të lëvroheshin për 5 ditë nga hyrja në fuqi e kontratës. Nga auditimi u konstatua se, 6 kite me vlerë prej 252,864 lekë janë sjellë më datë 30.05.2020, pra 36 ditë me vonesë (24.04.2020 deri në 30.05.2020). Sipas faturës tatimore të shitjes nr.2202 datë 24.04.2020 në vlerën prej 3,301,280 lekë pa tvsh ose 3,961,536 lekë me tvsh.

Kështu në bazë të detyrimit kontraktor neni 24 ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò ku parashikohet se ñ*Kontraktuesi, kur nuk realizon ketë kontratë Brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës*.ô dëmi i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñG...òshpk do të ishtë: (25% x 4,214,400) x 0,004 x 36 ditë = **151,718 lekë me tvsh,** vlerë kjo e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit

d -Nga zbatimi i kontratës, në lidhje me procedurën **Loti 2** ñ*Blerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHP*ò është lidhur kontrata e furnizimit nr.1776/13 datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.316 datë 18.04.2020, me vlerë kontrate 21,725,500 lekë pa tvsh ose 26,070,600 lekë me tvsh.

d.1) Në detyrimin kontraktor neni 2 dhe sipas formularit të ofertës nga operatori ekonomik ñB.. A.òshpk ku parashikohen afatet e lëvrimit, sasia prej 3000 reaksione në vlerë prej 2,340,000 lekë me tvsh, nuk është sjellë ditën kur hyn në fuqi kontrata, por ka ardhur 5 ditë me vonë(18.04.2020-23.04.2020) si dhe sasia prej 100 shishe në vlerë prej 102,000 lekë me tvsh nuk është sjellë në datë 18.04.2020, por më datë 23.04.2020.

Në bazë të nenit 24 të kontratës, ñLikujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuarò, parashikohet se ñ*Kontraktuesi, kur nuk realizon ketë kontratë brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës*.ô Nga AK duhet të përllogaritet dhe ndalet penaliteti për dorëzim të vonuar nga OE ñB.. A...ò shpk në vlerë prej (26,070,600 x 25%) x 0,004 x 5 ditë = **130,353 lekë me tvsh**), vlerë kjo e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

d.2) Për artikujt nga 1 deri në tre, sipas formularit të ofertës do të levroheshin 5 kuti për secilën përmasë, 500 rack për secilin artikull brenda 30 ditëve që i përket data 18.05.2020, të cilët kanë ardhur më datë 30.05.2020, dmth 12 ditë me vonesë, (500 rack x 1925 lekë pa tvsh=1,155,000 lekë me tvsh x 3 artikuj = 3,465,000 lekë me tvsh vlerë e pa lëvruar.

Në bazë të nenit 24 të kontratës, penaliteti i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñB..A...shpk është e baravlefshme në vlerë prej (26,070,600 x 0.25) x 0.004 x12 ditë = **312,847 lekë me tvsh),** vlerë kjo e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

d.3) Për artikullin 4 në sasinë prej 3000 sipas formularit të ofertës do të levroheshin brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës, që i përket data 08.05.2020, të cilët kanë ardhur më datë 30.05.2020, dmth 22 ditë me vonesë, (3000 reaksione x490 lekë pa tvsh = 1,764,000 lekë me tvsh, vlera e palëvruar.

Në bazë të nenit 24 të kontratës (Likujdimin e dëmeve për dorëzimin e vonuar) shprehet se ñ*Kontraktuesi, kur nuk realizon ketë kontratë Brenda afatit të përcaktuar tarifa ditore për dorëzimin e vonuar do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi*

*total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratë*s.ò.
Sa më sipër, penaliteti i llogaritur për dorëzim të vonuar nga OE ñB.. A..òshpk është e baravlefshme në vlerë prej (26,070,600 x 0.25) x 0.004 x22 ditë = **573,553 lekë me tvsh**, si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit.
Pra, operatori ekonomik ñB.. A..òshpk, për dorëzimin e e vonuar nga detyrimi kontraktor me nr.1776/13 datë 14.04.2020, miratuar me VKM nr.316 datë 18.04.2020, duhet të paguar nga vlera e sigurimit të kontratës, penalitetin total në vlerë prej **1,016,753 lekë me tvsh,** si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 210-218 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Nga MSHMS të merren masat dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore, në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e penaliteteve të përllogaritura si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor për dorëzimin në kohë të mallit, të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, për arkëtimin e vlerave si vijon:
-Për procedurën ñ*Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për tu përdorur për pajisje e Existation të firmës Bioneer ose ekuvalent*ò, nga ñO... D....ò shpk , vlera prej **693,600 lekë me tvsh.**
-Për kontratën ñSpostimi i sistemit të dializës nga Pediatria e Specialiteteve tek godina e Spitalit Infektiv (Shërbimi i Alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me Covid-19ò, nga OE T...ò shpk vlera perj **8,160 lekë** me tvsh;
-Për procedurën Loti I ñ*Blerje kite dhe reagent të përshtatshëm për të përdorur në pajisje Maglum 800 Snibe CoLtd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për Covid-19*ò, nga OE ñGé .òshpk , vlera prej **151,718 lekë me tvsh;**
-Për procedurën Loti 2 ñ*Blerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHP*ò, nga OE ñB...A....ò shpk, vlera prej prej **1,016,753 lekë me tvsh.**

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave të Projektit Teknik*"Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë"* nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se:
-Në bazë të Preventivit teknik të hartuar nga Instituti i Ndërtimit, në Kapitulli i kuadrove elektrike (këtu futen 1.1 derin 1.34) konstatohet se, zëri ñ*F.V Morseta, kanalina plastike, zbara bakri, kabllo dhe të gjithë aksesorët e nevojshme për montim, përfshi kolaudimin, testim dhe komisionim*ò, është zë pune i mbivendosur i strukturës së preventivit të hartuar nga IN, në kundërshtim me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 ñ*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*ñ, pasi i njëjti zë[37] gjithashtu është përshkruar në zërat e tjerë, të veçuar sipas kapitujve të punimeve elektrike - kuadri kryesor, janë zërat për F.V Furnizim vendosje për kapak, automat, siguresa, instrumenta etj.
Sa më sipër, për Kapitullin e Kuadrove Eletrike (1.1-1.34) zëri ñ*F.V Morseta, kanalina plastike, zbara bakri, kabllo dhe të gjithë aksesorët e nevojshme për montim, përfshi kolaudimin, testim dhe komisionim*ò në **vlerën prej 1,176,000 lekë pa tvsh përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit, pasi është i mbivendosur në punimet elektrike për zërat përkatës, duke sjellë fryrje të zërave të punës dhe rritje fiktive e vlerës së kontratës, në përfitim të sipërmarrësit.
Gjithashtu, në Kapitullin II ñPunime elektrikeò /1.2 ñKanalina Metalikeò dhe Kapitullin III ñPunime Mekanikeò, u konstatua se **nuk** është vendosur sasia në 3 zëra që i korrespondon vlerës prej **155,384.3 lekë pa tvsh, e cila përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit, duke sjellë rritje fiktive e vlerës së kontratës, si vijon:

[37] Zëri ñ*F.V Morseta, kanalina plastike, zbara bakri, kabllo dhe të gjithë aksesorët e nevojshme për montim, përfshi kolaudimin, testim dhe komisionim*ò

Nr	Nr.Manuali	Lloji i punimeve	Njësia	sasia	çmimi	Vlera/lekë
		1.2 Kanalina Metalike				
21	An E-1.2.21	F.V materiale të tjera plotësuese(profile, stafa,aksesor për këndet variabël, elementë tokëzues, kapak për aksesor	copë	0	1,820,070	91,004
		III.Punime Mekanike (H/Sanitare,HVAC, Linja e gazrave, MKZ, etj)				
2	4.3	F.V Konstruksione metalike të thjeshta	ton	0	136,050.0	20,407.6
3	4.34	F.V Tubo Ventilimi me kthim buzësh,kendëdrejtë,Ll.zinguar	ton	0	174,863.5	43,972.7
		Shuma				**155,384.3**

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Institutin e Ndërtimit.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 226-248 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandim: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale si institucion epror, të marrë masa duke verifikuar gjatë zbatimit të kontratës respektive për këtë investim si në situacionet pjesore /në situacionin përfundimtar, duke mos likuiduar tepër vlerën prej 1,331,384.3 pa tvshsipërmarrësit të punimeve BOE ñAé K..ò shpk & ñB..-I..òshpk, për punime mbivendosura, me qëllim mirëmenaxhimin të fondeve buxhetore.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:
-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës ñPrishje mur gipsi t=10 cm, çmimiò, ñPrishje tavan i varur gipsi 60 x 60 cm, çmimiò, ñGrila d/alumini me roleò, ñVetratë xhami e temperuarò, ñInstalimi i linjave të bakrit + linjat e kondesatitò, ñFV ndriçues emergjence evakuimi (Exit)ò, etj., për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 258-268 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Nga MSHMS të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 2,349,902 lekë pa tvsh nga OE ñ2.. K..ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2089/9 prot datë 07.08.2020 me ñRikonstruksioni i shërbimit të Reanimacionit të Spitalit Rajonal Vlorëò, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:
-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës ñThemel e xokol butobetoni C-12/15ò, ñVeshje fasade me polisterol,kompakt jeshil t=5 cm + rrjete + suvaò, ñVeshje me pllaka majolike në WC dhe lavamanëò, ñFV dyer të blinduara importiò, etj., për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 258-268 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandim: Nga MSHMS të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,373,684 lekë pa tvsh nga OE ñA... K...ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1076/72 prot datë 13.08.2020 me ñLoti I, Rikonstruksione të QSH-ve në qarqet Tiranë, Durrës, Dibër (viti 2020)ò, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua dëm ekonomik ne vlerën **3,695,819 lekë** për

likuidim e tarifave përmbarimore për vendime gjyqësore të formës së prerë të ish-MMRS prej të cilave**, 1,028,079 lekë** të paguara në vitin 2019, dhe **2,667,740 lekë** të paguara në vitin 2020.
Më hollësisht:
Në vitin 2019, në 3 raste nga 15, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për largime të padrejta nga puna, të kryer nëpërmjet firmave përmbarimore, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën *1,013,079 lekë* për likuidimin e tarifave përmbarimore, dhe një rast për cështje gjyqësore me shoqëri sigurimesh në vlerën *15,000 lekë*:
-Vendimi gjyqësorë për gjyqfituesin i cili ka marr formë të prerë në 05.02.2015, A. Xh., tarifa përmbarimore në vlerën 413,804 lekë;
-Vendimi gjyqësorë për gjyqfituesin M. C. tarifa, i cili ka marr formë të prerë në 03.03.2016, përmbarimore në vlerën 534,325 lekë;
-Vendimi gjyqësorë për gjyqfituesin A. Xh. tarifa, i cili ka marr formë të prerë 24.05.201, tarifa përmbarimore në vlerën 64,950 lekë;
-Vendimi i gjykatës i cila ka marr formë të prerë më datë 24.05.2017 me gjyqfitues Shoqërinë ñA..-S..ò, tarifa përmbarimore në vlerën 15,000 lekë, shlyer me urdhër shpenzimin nr. 986, datë 11.12.2019.
Në vitin 2020, vendim gjyqësor i shoqëruar me gjoba, kamatvonesa dhe tarifa përmbarimore në vlerën *2,667,740 lekë*:
-Vendimi i gjykatës me gjyqfitues shoqëria ñD.. P..A..ò për një detyrim të vitit 2015 të ish MMRS-në, është shoqëruar me 1,883,281 lekë kamatëvonesave, 5000 lekë gjoba, 15,000 lekë shpenzime për ekspertin fiskal, dhe 764,459 lekë tarifë përmbarimore, shlyer me urdhër shpenzimin nr. 450, datë 25.06.2020.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 91-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandim: Pasi të jenë ezauruar të gjitha hapat ligjore, për mundësinë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë (referuar kërkesave të Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 ñPër zbatimin e vendimeve gjyqësore te formës së prerë, nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civilò, por edhe Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012, para.62, DHE Udhezimit nr.1, date 04.06.2014), strukturat përkatëse në MSHMS, për të gjitha rastet në vijim, të marrin masat e nevojshme për të shlyer në kohë detyrimeve financiare që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prere, me qëllim shmangen e gjobave, kamatvonesave dhe tarifave përmbarimore të cilat përbëjnë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.
Ekzekutimi i vendimeve gjyqesore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, të bëhet sipas rradhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes të bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të MSHMS, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut, në mënyrë që edhe përmbaruesi tõ përmbahet grafikut të shyerjes së detyrimit të publikuar, duke shmangur kështu kostot e përmbarimit të cilat rëndojnë buxhetin e shtetit, në përputhje me sa dikton Udhëzimi nr. 1, datë Nr. 1, datë 4.6.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të Thesaritò.

Në vijimësi

D.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit **"**Blerje monitor pacienti për masat anti Covid-19ò, realizuar nga MSHMS, të zhvilluar në vitin 2020. Titullari i MSHMS ka miratuar Urdhrin e Prokurimit nr. 359, datë 06.06.2020, me njësi prokurimi me përbërje: A.P., E.

L. dhe L. P., të cilët kanë argumentuar përdorimin e llojit të procedurës së prokurimit ñNegocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratësò. Gjithashtu, titullari i AK, me shkresën nr. 2587 /1, datë 01.06.2020, ka miratuar Urdhër nr.359/1, datë 01.06.2020 për emërimin e Komisonit të Vlerësimit të Ofertave me përbërje: F. B., O. Dh. dhe O. A.. Në bazë të PV, të njësisë së prokurimit, janë përzgjedhur tre OE për të marrë pjesë si operatorë që kanë pasur kontrata të mëparshme të sukseshme me MSHMS, konkretisht O.. D.. shpk, M.. shpk dhe B.. E.., të cilëve u janë dërguar ftesë për pjesëmarrje, kjo në përputhje me VKM nr.914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregulave të prokurimit publikò i ndryshuar, neni 36 pika 4.
Nga auditimi u konstatua se, sipas procesverbalit të mbajtur nga KVO në datën 08.06.2020, është paraqitur *vetëm* një operator ñO.. D.. ñ shpk, me ofertë ekonomike 54,905,000 lekë pa tvsh (ose 30,605,265, lekë më pak nga fondi limit), ku midis të tjerave është konstatuar se, operatori ekonomik ñO.. D...ò shpk.
Nga verifikimi qe bëri grupi i auditimit rezultoi se, modelet e paraqitura në formularin e ofertës, në fakt: (1) kanë *rezolucionin 800*600* dhe jo *1024*768*, sikundër është kërkuar në specifikimet teknike në DST(**pra me rezolucion më të ulët nga sa kërkuar në DST**).; dhe (2) *nuk kanë ndërfaqe të integruar protokolli HL7 dhe jo DIAP*sikundër është kërkuar në specifikimet teknike.
Pamvarësisht sa më sipër, KVO ka vendosur ta pranojë këtë ofertë duke e konsideruar shmangien nga ky kriter si devijim të vogël, dhe që nuk ndikon në funksionet klinike të monitorit.
Në fakt, devijime te vogla, në kuptimin që i njeh Ligji i Prokurimit Publik jane devijimet qe nuk ndryshojne materialisht ose nuk i kalojne specifikimet, kushtet, termat dhe kerkesat e tjera ose gabimet e shtypit apo pakujdesite dhe qe mund te korrigjohen pa ndryshuar thelbësisht karakteristikat dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në DST, ndërkohë që konstatojmë se elementet e ndryshuar tek malli i kërkuar ï monitorë, lidhen direkt me karakteristikat e produktit të kërkuar në DST (kjo gjithashtu është arsyeja dhe pse është vlerësuar që këto specifikime teknike (dhe jo të tjera) të hartuara nga institucionet përfituese - QSUT me shkresën nr.1403/1, datë 17.03.2020, SU ñShefqet Ndroqiò me nr.34/21, datë 31.03.2020 dhe SUOGJ ñMbretëresha Geraldinëò me nr.296, datë 27.03.2020) të kërkohen në DST).
- Në vijim. operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumente duhet te refuzohen si te papranueshme, ne mbeshtetje edhe te pikes 3, te nenit 66 te VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, ne te cilen percaktohet se komisioni verifikon dhe vlereson ofertat e dorezuara, duke kualifikuar vetem ato oferta, qe perrnbushin kriteret per kualifikim, te percaktuara ne dokumentet e tenderit.
Nisur nga sa më sipër, duke kualifikuar një ofertë që nuk i plotëson të gjitha karakteristikat sipas DST, KVO ka vepruar në kundërshtim me piken 3, te nenit 66 te VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, ne te cilen percaktohet se komisioni verifikon dhe vlereson ofertat e dorezuara, duke kualifikuar vetem ato oferta, qe permbushin kriteret per kualifikim, te percaktuara ne dokumentet e tenderi.
-Gjithashtu nje ndër parimet kryesore te zhvillimit te procedures se prokurimit eshte ai barazise ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve, parashikuar nga neni 2, i Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", te ndryshuar. Zbatimi i parimit te transparences, barazise dhe mos diskriminimit jane garancite kryesore ndaj ofertuesve qe ofron kuadri ligjor ne fuqi. Keto parime, nder te tjera nenkuptojne se operatoret ekonomike duhet te jene ne nje pozicion barazie, si kur pergatisin ofertat e tyre ashtu dhe kur këto oferta vleresohen. Në rastin konkret, parashikimi në DST: (1) i një **rezulocioni më të lartë** i cili më pas rezulton të jetë pranuar më i vogël, për OE fitues duke u trajtuar si ñdevijim i vogëlò; dhe (2) i **ndërfaqes së integruar të protokollit DIAP,** e cila më pas rezulton të jetë ndryshuar dhe pranuar në HL7, për OE fitues duke u trajtuar si ñdevijim i vogëlò,tregon se KVO ka shkelur parimin e barazisë, duke i vendosur OE-të në pozita jo të barabarta përgjatë fazës së përgatitjes së ofertave dhe si pasojë edhe gjatë vlerësimit të ofertës.

Vlerësimi i ofertave referuar kritereve të tjera të kualifikimit të cilat nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 55 pika 2 e LPP-së, por cënon gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar në nenin 2 të Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", te ndryshuar, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.
Në vijim të sa më sipër, nga auditimi , rezultoi se Njësia e Prokurimit me anëtarë A.P., E. L. dhe L. P.nuk kanë reflektuar në Aneksin nr.2, devijimet e vogla për monitorët, të miratuara nga KVO sipas proces-verbalit të datës 08.06.2020, por i kanë lënë specifikimet teknike të pandryshuara sikundër ishin në DST.
Me shkresën nr.2587/7, datë 19.06.2020, është dërguar për zbatim kontrata me objekt ñBlerje monitorë pacienti për masat anti COVID-19ò autoriteteve përfituese: Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza, SU Shefqet Ndroqi dhe SUOGJ Mbretëresha Geraldinë.
-Me shkresën nr.2587/9, datë 26.06.2020, titullari i AK ka miratuar Urdhrin me nr. 382, datë 26.06.2020 ñPër caktimin e koordinatorit për mbikqyrjen e kontratës së furnizimit nr.2587/6, datë 17.06.2020ò, znj.L. P. e cila është përgjegjëse për monitorimin e kontratës .
Me anë të emaileve të datës 08.07.2020, znj.P., koordinatorja për mbikqyrjen e kontratës i ka kërkuar spitaleve përfituese të këtij prokurimi Procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallit, ku është konstatuar se, lista e pajisjeve, prodhuesi, modeli, numri i serisë, sasitë përkatëse, dokumentin e hyrjes në magazinë, janë marrë në zbatim të kontratës (pjese integrale e së cilës janë edhe DST, edhe oferta e OE-së). Materialet e mësipërme janë dërguar në MSHMS pa shkresa përcjellëse. Në observacionet e dërguara nga MSHMS, në KLSH, konfirmohet, shoqëruar me evidencat përkatëse se, malli i marrë në dorëzim i referohet saktësisht modeleve të ofertuara nga O...D..., pjesë e ofertës së tij teknike e shpallur fituese, dhe jo DST.
Nga auditimi rezultoi se, koordinatori për mbikqyrjen e kontratës nuk ka përgatitur raportin përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me Urdhrin me nr.382, datë 26.06.2020 ñPër caktimin e koordinatorit për mbikqyrjen e kontratës së furnizimit nr.2587/6, datë 17.06.2020ò.
Si përfundim, pajisjet monitorë janë marrë në dorëzim në kundërshtim me kontratën e nënshkruar . Zëri Monitor Pacienti multiparametrik në sasinë 50 copë në vlerën 18,250,000 lekë pa tvsh është marrë në kundërshtim me specifikimet teknike sipas kontratës me nr.2587/6, datë 17.06.2020 ñBlerje monitorë pacienti për masat anti COVID-19ò, duke vendosur në diskutim cilësinë e produkteve për rrjedhojë vlera prej **18,250,000 lekë pa tvsh** ***janë shpenzuar, pa ekonomicitet, pa eficiencë dhe pa efektivitet, të financuara nga Buxheti i Shtetit.***
(Trajtuar më hollësisht në faqet 219-226 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Për të gjitha rastet në vijim, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të veprojnë në përputhje me parimet transparences, barazise dhe mos diskriminimit përgjatë zhvillimit të procedurave të tenderave në MSHMS, me qëllim vendosjen e operatorëve ekonomikë në kushte barazie si përgjatë fazës së përgatitjes së ofertave, ashtu dhe gjatë vlerësimit të tyre.
Gjithashtu KVO-të, në cdo rast, të vleresojë si oferta te vlefshme, me devijime të vogla vetëm rastet kur këto devijime janë të argumentuara se **nuk ndryshojne thelbesisht** karakteristikat e percaktuara ne dokumentet e tenderit, në përputhje me sa dikton kuadri ligjor në fuqi, konkretisht KVO të konsiderojnë si oferta te vlefshme rastet kur oferta:
a) permban devijime te vogla, te cilat materialisht nuk ndryshojne ose devijojne kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentet e tenderit; dhe
b) oferta permban gabime apo lapsuse, te cilat mund te korrigjohen pa prekur perrnbajtjen e ofertes.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i likuidimit te shpenzimeve nga MSHMS u konstatuan problematika në urdhër shpenzimet, dhe dokumentacionet justifikuese bashkëlidhur tyre, në bazë

të të cilave janë kryer pagesat, duke shkaktuar kështu përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerë 1,058,000 lekë prej të cilave 206,000 lekë në vitin 2019 dhe 852,000 lekë në vitin 2020. Me hollësisht:
-Nga auditimi u konstatua se në urdhër shpenzimi nr. 684, 03.09.2019, me vlerë 206,000 lekëpër likuidimin e pagesave për dieta për një inspektim të kryer nga punonjësit e MSHMS, **nuk** ka bashkëlidhur dokumentet justifikuese për kryerjen e tij (miratimin dhe urdhrin e ngritjes së grupit të punës për këta punonjës). Bashkëlidhur gjendet relacioni i përgatitur në përfundim të inspektimit.
-U konstatua urdhër shpenzimi nr.1082 datë 28.12.2020, është realizuar pagesa në vlerën prej 852,000 lekë me TVSh, për OE. Referuar kontratës bazë nr. 491/5 datë 12.02.2020, afati për dorëzimin e pasqyrave ishte 15.03.2020. Referuar procesverbalit të marrjes në dorëzim, pasqyrat financiare janë marrë në dorëzim në tetor 2020. Nga auditimi u konstatua se, bashkëlidhur me këtë Urdhër-shpenzim nuk gjendeshe Urdhri për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të Pasqyrave Financiare, si dhe nuk gjendeshe shtyrja e afatit të kontratës.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 91-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues në MSHMS, të marrin masat e nevojshme që në cdo rast në vijim, për likuidimin e urdhër shpenzimeve të mbështeten në dokumentacionin e nevojshëm vërtetues, si dhe këto të fundit tôi bashkëlidhen në çdo rast urdhër shpenzimeve, me qellim shmangien e efekteve financiare për buxhetin e shtetit.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan shpenzime pa efektivitet në buxhetin e shtetit në vlerë **74,521,023** lekë, prej të cilave **23,945,042** në vitin 2019 dhe **50,575,981** në vitin 2020, për likuidimin e vendimeve gjyqësore.
-Në vitin 2019 janë paguar gjithsej për vendimet gjyqësore për rikthimin largime të padrejta nga puna të punonjësve nga ish-MMRS në vlerën 23,862,662 lekëpër 15 raste në vitin 2019 dhe në vlerën 43,363,561 lekë për 16 raste për vitin 2020, detyrime të ardhura nga ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë përbën shpenzime pa efektivitet për buxhetin e shtetit.
Nga auditimi i urdhër-shpenzimeve u konstatuan pagesa për vendime gjyqësore të formës së prerë, jo vetëm për largime të padrejta nga puna po edhe për çështje gjyqësore me kompani sigurimesh dhe për vonesa në shlyerjen e furnitorëve nga ish-MMRS në vlerën 7,294,800 lekë, prej të cilave 82,380 lekë në vitin 2019 dhe 7,212,420 lekë në vitin 2020. Më hollësisht:
-Urdhër shpenzimi nr. 986, datë 11.12.2019, me vlerë 97,380 lekë. Bashkëlidhur gjendet vendimi i gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 4020, datë 08.05.2017, e cila ka marr formë të prerë më datë 24.05.2017, sipas të cilës pranohet padia e Shoqërisë ñA.S.ò, sh.a., ndaj ish-MMRS, me objekt ñPërmbushja e detyrimeve në vlerën 75,980 lekë që rrjedhë nga kontrata e sigurimit që konsiston në pagimin e primeve të papaguara, si rezultat i lëshimit të kontratave të sigurimit TP, kamatvonesat sipas penaliteti të sigurimi të kontratës dhe shpenzimet gjyqësore. Vlera 97,380 lekë përfshinë detyrimin e papaguar që rrjedh nga kontrata 78,980 lekë, 3,400 lekë shpenzime gjyqësore dhe 15,000 lekë tarifë ekzekutimi e përmbaruesit.
-U konstatua Urdhër-Shpenzimi nr. 450, datë 25.06.2020 për vlerën 9,880,160 lekë, si shpenzimit për vendimet gjyqësore. Ky është një detyrim i ish- MMSR, për mospagim të një fature të lëshuar nga shoqëria ñD. P. Alò, në vitin 2015, për një shërbim të kryer ndaj kësaj ministrie. Bashkëlidhur me këtë Urdhër Shpenzim, gjendet kërkesa për ekzekutim nga përmbaruesi, e datës 05.04.2018, i cili kërkon, shlyerjen e vlerës totale 9,880,160 lekë, prej të cilave 7,212,420 lekë detyrim qe rrjedh nga titulli ekzekutiv, 1,883,281 lekë kamatëvonesave, 5000 lekë gjoba, 15,000 lekë shpenzime për ekspertin fiskal, dhe 764,459 lekë tarifë përmbarimore.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 91-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandim: Për të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore në vijim, që lidhen me largime të padrejta nga puna, MSHMS të marrë masat e nevojshme për krijimin e Komisionit të Posacëm, me vëzhgues një përfaqësues nga DAP, me qëllim shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit të formës së prerë (duke konsideruar këtu edhe ristrukturimin e nëntorit 2017), si dhe shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të gjyqfituesve në një pozicion të rregullt në shërbimin civil (sipas rastit) sipas kritereve të pozicionit të punës, dhe kategorisë përkatëse brenda institucionit apo njësive të varësisë, duke ndjekur të gjithë hapat e nevojshëm që parashikon Urdhri nr. 5151, datë 28.10.2015 ñPër zbatimin e vendimeve gjyqësore te formës së prerë, nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civilò, *me qëllim shmangien/minimizimin e efekteve negative në buxhetin e shtetit.*
- Të gjitha vendimet gjyqësore në vijim, të analizohen dhe të nxirren përgjegjësitë administrative dhe këto vendime të mos likuidohen pa aktin përfundimtar të titullarit të institucionit që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në përputhje me paragrafin 62 të Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012

Në vijimësi

E. MASA DISIPLINORE

E.1 PËR PUNONJËS JANË PJESË E SHËRBIMIT CIVIL

Mbështetur në ligjin nr.154/2014 datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e KLSHò neni 15 pika b dhe c, në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurim publikò i ndryshuar, të ligjit nr. 152/2013 "Statusi i nëpunësit civil", datë 13.05.2013 i ndryshuar ñLlojet e masave disiplinoreò neni 57, 58, të VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" *i rekomandojmë* **Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, që referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve në bazë të përgjegjësive individuale të evidentuara dhe pasqyruar në aktkonstatimin përkatës dhe pjesës takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të vlerësojë shkeljet dhe të vendosë fillimin proçedurës për dhënien e masës disiplinore ñ*vërejte"* deri në *"largim nga shërbimi civil*ò si më poshtë vijon:

A. Për mospërgatitje të raportit përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar neni 77 pika 4 dhe me Urdhrin e titullarit të AK nr.382, datë 26.06.2020 ñPër caktimin e koordinatorit për mbikqyrjen e kontratës së furnizimit nr.2587/6, datë 17.06.2020ò, për pasojë pajisjet monitorë janë marrë në dorëzim në kundërshtim me kontratën e nënshkruar, konkretisht (Zëri Monitor Pacienti Multiparametrik) në sasinë 50 copë me vlerë 18,250,000 lekë pa tvsh, duke vendosur në diskutim cilësinë e produkteve për rrjedhojë vlera prej 18,250,000 lekë pa tvsh është shpenzuar, pa ekonomicitet, pa eficiencë dhe pa efektivitet, të financuara nga Buxheti i Shtetit, për punonjësen:

1. **zj. L.P.** me detyrë shefe sektorit të Rregullimit të Çështjeve Sociale në Drejtorinë e Deregulimit, Lejeve, në cilësinë e kordinatores së mbikqyrjes së kontratës.

B. Për kualifikim të padrejtë të Operatorit Ekonomik, pasi disa shmangie nga kriteret e kërkuara, janë konsideruar devijime të vogla në kundërshtim me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 2, neni 55 pika 2 dhe pikën 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, neni 66 pika3, e për pasojë pajisjet monitorë janë marrë në dorëzim në kundërshtim me kontratën e nënshkruar,

konkretisht (Zëri Monitor Pacienti Multiparametrik) në sasinë 50 copë me vlerë 18,250,000 lekë pa tvsh, duke vendosur në diskutim cilësinë e produkteve për rrjedhojë vlera prej 18,250,000 lekë pa tvsh është shpenzuar, pa ekonomicitet, pa eficiencë dhe pa efektivitet, të financuara nga Buxheti i Shtetit (Konkretisht modelet e paraqitura në formularin e ofertës, në fakt: (1) kanë rezolucionin 800*600 dhe jo 1024*768, sikundër është kërkuar në specifikimet teknike në DST(pra me rezolucion më të ulët nga sa kërkuar në DST); dhe (2) nuk kanë ndërfaqe të integruar protokolli HL7 dhe jo DIAP si kundër është kërkuar në specifikimet teknike), për punonjësit:

2. **zj.F.B.**, me detyrë drejtor i Drejtorisë i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
3. **z.O. Dh.,** me detyrë drejtor Qendra Kombëtare teknike Bio-Mjekesore (njësi e varësisë së MSHMS), në cilësinë e anëtarit Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,
4. **z.O.A.**, me detyrë përgjegjës sektori i Ankesave dhe Administrative dhe Gjyqësore, në cilësinë e anëtarit Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

(Trajtuar më hollësisht në faqet 219-226 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

C. Mbështetur në ligjin nr.154/2014 datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e KLSHò në ligjin nr. 152/2013 "Statusi i nëpunësit civil", datë 13.05.2013 i ndryshuar ñLlojet e masave disiplinoreò neni 57, 58, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" *i rekomandojmë* **Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, të marrë masa për të ngritur një grup pune, për të analizuar, shkaqet, arsyet dhe për të evidentuar përgjegjësitë me qëllim fillimin proçedurës për dhënien e masës disiplinore ñ*vërejte"* deri në *"largim nga shërbimi civil*ò për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi për cështjet si më poshtë:

-Për mosaplikimin e penaliteteve prej furnizimeve të vonuara me barna ose pajisje mjekësore për kontratat me objekt: ñFurnizim vendosje respiratore me dy modalitete per adulte dhe moshe pediatrike per Covid -19ò, ñBlerje materiale për mbrojtje personale (MMP) për Covid-19ò; ñSpostimi i sistemit të dializës nga Pediatria e Specialiteteve tek godina e Spitalit Infektiv (Shërbimi i Alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me Covid-19ò, ñBlerje kite dhe reagent të përshtatshëm për të përdorur në pajisje Maglum 800 Snibe CoLtd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për Covid-19ò, dhe ñBlerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHPò.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 201-218 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

- **Për ndryshimin e destinacionit të fondeve të akorduara për përballimin e situatës së krijuar nga Covid -19 në shumën 16,751,138 lekë,** dhe angazhimin e tyre për të shlyer detyrime të prapambetura, në kundështim me VKM nr.249 date 27.03.2020 ñPër detajimin dhe mënyrën e përdorimit të fondit ANTICOVID-19ò; Ligjin me nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar dhe Udhëzimit plotësues të MFE-së Nr. 2, datë 20.01.2020, ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 53-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

- **Për mungesën e gjurmës së auditimit në procedurat e ndjekura familjarët e viktimave të tërmetit** për përfitimin e ndihmës financiare në kundërshtim kjo dhe me Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 ñPër Arkivatò, ñNormave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë (neni 8 dhe 9) dhe Ligjin nr.90/2012 "Për Organizimin Dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore".

- **Për mosreflektimin e saktë të vlerës së detyrimeve të prapambetura** në kundërshtim me Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesaritò, pika 4; VKM nr.50, datë 05.02.2014 ñPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të

veprimitò, të ndryshuar; Urdhrin nr. 37, datë 06.10.2020 të MFE ñPër monitorimin dhe publikimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të qeverisjes së përgjithshmeò.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 91-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

E.2 PËR PUNONJËS QË MARRËDHËNIET E PUNËS RREGULLOHEN ME KODIN E PUNËS

Mbështetur në ligjin nr.154/2014 datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e KLSHò neni 15 pika b dhe c, në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurim publikò i ndryshuar, në referim ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 i ndryshuar *i rekomandojmë* **Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, që referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve, menaxhimit financiar dhe kontrolli dhe disiplinimi i punimeve të ndërtimit, si dhe përgjegjësive individuale të evidentuara dhe pasqyruar në aktkonstatimin nr.8 dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit, të vlerësojë shkeljet dhe të vendosë marrjen e masave disiplinore ñ*vërejte"* deri në *"largim nga puna"* (për punonjësit që janë punësuar sipas Kodi të Punës), për punonjësen:

5. Znj. E. D., me detyrë Drejtor i Spitalit Universitar Obsetrik-Gjinekologjik (SUOGJ)ñMbretëresha Geraldinaò, për shkak se në bashkëpunim me Institutin e Ndërtimit (IN), për realizimin e Projektit Teknik për ñ*Rikonstruksion i godinave të Maternitetit Mbretëresha Geraldina dhe ndërtim i ri 3 kat Tiranë*ò, **jo nëpërmjet një procesi të hapur të përzgjedhjes dhe transparent,** në bazë të rregullave të prokurimit publik, në kundërshtim me ligji nr.9643 datë 21.11.206 ñPër prokurimin publicò të ndryshuar, neni 1, neni 2 pika b ,neni 34/1 ñShërbim konsulencëò të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publicò të ndryshuar, neni 37, me ligjin nr.7582 datë 13.07.1992 ñPër ndërmarrjet shtetëroreò i ndryshuar neni 5, ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò neni 5. Sa më sipër, institucionet shtetërore, SUOGJ-MG dhe IN, kanë manaxhuar fonde publike në vlerën prej 13,200,351 lekë me tvsh, duke shmanguar procedurat e prokurimit si dhe duke eliminuar garën dhe transparencën për realizimin e hartimit të projektit teknik.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 226-248 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT